



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË**

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR
I AUDITIMIT MBI PËRPUTHSHMËRINË**

në

**DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**

**Për periudhën
01.01.2020- 31.12.2020**

Tiranë, tetor 2021



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
II.	HYRJA	18
II.	PERSHKRIMI I AUDITIMIT	20
1	Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe kuadrit rregullator në fuqi lidhur me ciklin buxhetor. Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit me Drejtoritë në varësi të saj në funksion të arritjes së menaxhimit të kujdesshëm të ciklit buxhetor. Nxjerrja e akteve të nevojshme nënligjore për zbatimin e buxhetit për ministritë dhe institucionet buxhetore. Monitorimi i treguesve të Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike lidhur me veprimtarinë e kësaj drejtorie.	20-41
2	Mbi procesin e planifikimit në drejtim të përgatitjes së dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 dhe Projekt Buxhetit vjetor 2020. Kryerja e analizave për efektet financiare të strategjive dhe politikave të reja, dhe dhënia e rekomandimeve për njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Ndjekja e regjistrimit të kërkesave buxhetore të BPA 2020-2022 të njësisve e qeverisjes qendrore, përmes sistemit AFMIS, dhe moduleve respektive të përgatitjes së PBA.	42-70
3	Vlerësimi i veprimtarisë në drejtim të detajimit të planit buxhetor dhe çeljeve fillestare në SIFQ, bazuar në ligjin nr. 88 datë 18.12.2019 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2020”. Rishpërndarja e fondeve buxhetore me ndryshimet sipas Akteve Normative duke përfshirë të gjitha ndryshimet për përballimin e situatës së pandemisë COVID-19 dhe rindërtimit.	70-131
4	Mbi rregullshmërinë dhe saktësinë së regjistrimeve në llogarinë “Depozitë e Qeverisë” dhe rakordimi i saj me Bankën e Shqipërisë. Konsolidimi i njësisve që operojnë në llogari speciale në Bankën e Shqipërisë nëpërmjet transfertës nga Llogaria e Unifikuar e Thesarit.	131-160
5	Mbi saktësinë dhe plotësinë e evidentimit të shpenzimeve kapitale me financim të huaj duke përfshirë planifikimin, disbursimet, saktësinë, përdorimin dhe plotësinë e raportimit të tyre.	160-171
6	Mbi procesin e menaxhimit të financave publike në nivel vendor në bazë të ligjit nr. 68, datë 27.04.2018 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Planifikimi dhe transferimi i transfertës së pakushtëzuar. Monitorimi dhe analiza e treguesve të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit vendor.	171-189
7	Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit të shtetit. Monitorimi dhe analiza e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, dhënia e rekomandimeve, për të gjithë strukturën programore të çdo ministrie linje/institucion qendror.	189-254



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

	7.1 Vlerësimi i projekteve të investimeve, monitorimi dhe raportimi i tyre me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura. 7.2 Raportimi i treguesve fiskalë të realizuar dhe monitorimi i tyre.	
8	Mbi auditimin e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, programi, monitorimi dhe zbatimi i programeve rajonale dhe vendore.	254-272
9	Mbi auditimin e përputhshmërisë së përdorimit të Fondit Rezervë të Këshillit të Ministrave dhe Fondit të Kontigjencës.	273-290
10	Risqet fiskale dhe detyrimet kontigjente: 10.1 Monitorimi i pagesave për kontratat e koncesioneve/PPP me mbështetje buxhetore. 10.2 Monitorimi i detyrimeve të prapambetura.	290-322
11	Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të mëparshëm	322-336
III	GJETJE DHE REKOMANDIME	337-376
IV	OPINIONI I AUDITIMIT	376-379
V	DOKUMENTACIONI SHOQËRUES	379-380
VI	ANEKSE	381-392



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:

I.a. Përshkrimi i shkurtër i auditimit:

Nga evidencat e marra për veprimtarinë e Drejtorisë ë Përgjithshme të Buxhetit në MFE, rezultoi se: Edhe për këtë vit, problematikat e konstatuara dhe të përsëritura nga vitet e kaluara konsolidojnë gjetjet e KLSH se jemi në kushtet e një mungese të kredibilitetit të buxhetit në buxhetim dhe ekzekutim. Më konkretisht:

Nga auditimi u konstatuan diferenca të mëdha të fondeve të alokuara për vitin 2020, nga PBA 2019-2021 në PBA 2020-2022, çka flet për një parashikim të dobët, duke zbehur vlerën e parashikimeve afatmesme për shpenzimet e buxhetit të shtetit. Përgjatë vitit janë konstatuar problematika mbi detajimin dhe rishpërndarjen e fondeve të investimeve në projekte investimi që përfshijnë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore në dispozicion, detajimin e projekteve të investimeve publike me akt normativ pa kaluar në PBA 2020-2022, detajimin e fondeve të investimeve për vetëm vlerën e 20% të koston së projektit pa buxhet në vitet pasardhëse buxhetore, detajimin e planit buxhetor në 3 vite për investime që përfshijnë periudhë faturimi për kontrata që parashikojnë periudhë faturimi më të vogël se një vit, shkurtimeve të fondeve të investimit në momentin e lidhjes së kontratës dhe rialokimin e këtyre fondeve drejt projekteve të tjera të investimit publik detyrime të prapambetura apo në proces nga vitet e kaluara, mos regjistrimin e kontratave dhe rrjedhimisht mos regjistrimin e obligimit në SIFQ duke lejuar ndërmarrjen e angazhimeve buxhetore dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Shpërndarja e fondeve me VKM nuk është shoqëruar me ndryshim të vlerës së fondit të rindërtimit në vitet pasardhëse buxhetore, duke qenë se plani paraqitet në shumën 0 lekë për vitet 2021 dhe 2022 sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 88/2019 për buxhetin e vitit 2020, të ndryshuar. Gjithashtu edhe plani i investimeve për fondet e alokuara për përballimin e situatës së shkaktuar nga COVID-19 nuk është reflektuar në tabelat shoqëruese të akteve normative.

Nga analizimi i të dhënave të vëna në dispozicion, mbi rishikimet buxhetore përgjatë vitit 2020, u konstatua se ka patur një numër të lartë të fondeve buxhetore të cilat prekin kryesisht investime kapitale.

Nga auditimi i të dhënave të rishikimeve buxhetore, u konstatua se janë kryer një numër i lartë rishikimesh pas datës 15 nëntor të vitit 2020. Ndryshimet buxhetore që prekin vitin 2020 vazhdojnë deri në datën 24 shkurt 2021, edhe pse ligjërisht pagesat me efekt kontabël 2020 lejohen deri në datën 21 janar 2021.

Nga auditimi mbi fondet e alokuara për programin buxhetor të arsimit bazë është konstatuar se gjatë vitit janë kryer rishpërndarje ndërmjet projekteve të investimit duke pakësuar vlerën e FZHR dhe rritur financimin për projekte të cilat nuk financohen nga FZHR, pasi nuk ka pasur vendime të KZHR për periudhën objekt auditimi.

Nga përpunimi i të dhënave të pagesave të kryera gjatë vitit 2020, evidentohen një numër i lartë regjistrimesh për fatura shpenzimesh të kryera në vitet e mëparshme.

Nga auditimi u konstatuan problematika mbi sistemin e SIFQ të cilat mund të ndikojnë në sigurinë e sistemit në drejtim të kryerjes së pagesave pa pasur fonde të mjaftueshme të alokuara.

Stoku i detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2020 sipas raportit të MFE për njësitë e qeverisjes qendrore dhe ato të vetëqeverisjes vendore paraqiten në nivele të larta dhe gjithashtu konstatohet se raportimi aktual i vlerës totale të detyrimeve të prapambetura nuk është i plotë dhe i saktë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Për projektet me financim të huaj janë konstatuar raste të keqklasifikimit të tyre në dy grupe kryesore keq klasifikimesh: projekte shërbimi, studimi, asistence. Gjithashtu konstatohet realizim projektesh pa patur plan buxhetor si dhe në tejkalim të planit buxhetor.

Nga auditimi rezulton se të ardhurat e trashëguara për vitin 2021 për njësitë e qeverisjes vendore paraqiten me diferencë me vlerën e të ardhurave që duhet të ishte trashëguar realisht.

Fondi Rezervë rezulton të jetë përdorur edhe për shpenzime të cilat duhej të ishin planifikuar në ligjin e buxhetit vjetor dhe përgjatë vitit ai është rishpërndarë në projekte të tjera nga sa planifikuar fillimisht.

Nga auditimi i rishikimeve të fondeve buxhetore për sa i përket fondeve të dedikuara për situatën COVID-19 dhe të rindërtimit u konstatua se krahas faktit se nuk janë konsistente, janë kryer rishikime të shumta të këtyre fondeve, duke e bërë të vështirë gjurmimin e realizimit përfundimtar dhe verifikimin e saktësisë së raportit të gjeneruar nga MFE për përdorimin e fondit të rindërtimit.

I.b. Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve:

Nr	Përmbledhja e gjetjes	Referenca në raport	Rëndësia	Rekomandimi
1.	Për vitin 2020 për 13 kontrata koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore në total, plani përfundimtar paraqitet në shumën 9,734,118 mijë lekë, ndërkohë që pagesat rezultuan në shumën 9,633,635 mijë lekë, me një realizim në masën 99%. Aktualisht, pagesat vjetore faktike nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për kontratat koncesionare apo PPP, në shumën 9,634 milion lekë zënë 2.26% e totalit të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2019, prej rreth 426,271 milion lekë, duke qenë brenda kufirit të pagesave prej 5% të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2019 që përlogaritet në rreth 21.3 miliard lekë. Dy projekte koncesionare, janë krijuar detyrime të prapambetura si dhe gjatë vitit janë shlyer detyrime të viteve të mëparshme, konkretisht projekti i inceneratorit të Tiranës dhe koncesioni i skanimit në dogana. Në një rast, detyrimet kontraktuale nuk rezultojnë të buxhetuara, dhe as të regjistruara si obligim në SIFQ, konkretisht për projektin e ndërtimit të shkollave në Bashkinë e Tiranës, konstatim i njëjtë me vitin e kaluar, ku kontrata e nënshkruar nuk është regjistruar dhe nuk është buxhetuar.	Pika 10	E lartë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me autoritetet kontraktuese, të monitorojë me rigorozitet detyrimet që lindin nga kontratat koncesionare, pagesat e të cilave bazohen në nivelin e shërbimit dhe që krijojnë detyrime të prapambetura për t'u mbartur në vitet e ardhshme buxhetore ndërkohë që nisin edhe projekte të reja koncesionare për zbatim.
2.	Banka e Shqipërisë çdo muaj ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë shkresa për konfirmimin e gjendjes së Llogarisë së Unifikuar të Thesarit ÷Depozitë Qeverieë, mbi të ardhurat totale dhe shpenzimet totale, por jo të grupuara në të paktën 7 grupe kryesore, duke sjellë vështirësi në auditimin e kësaj llogarie dhe krahasimin e saj me regjistrimin midis dy institucioneve. Si rezultat i regjistrimit të ndryshëm të llogarisë së Unifikuar të Thesarit ÷Depozitë Qeverieë në të dy institucionet, për faktin e dizenjimit të sistemeve të ndryshme nga njëri tjetri, të dy grupet e analizuara të shpenzimeve dhe të ardhurave, rezultoi se nga mbledhja e diferencave të zërave të shpenzimeve dhe të ardhurave, totali nuk reflekton diferenca, pra është zero. Gjithashtu diferenca midis totali të të ardhurave dhe totalit të shpenzimeve sipas Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është në vlerë të njëjtë, për 20,245,602 mijë lekë, vlerë e cila paraqet edhe gjendjen e	Pika 4	E lartë	Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe departamentet e Bankës së Shqipërisë si agjentë fiskal të saj, të cilët regjistrojnë dhe konfirmojnë llogarinë e unifikuar të thesarit ÷Depozitë qeverieë, të përcaktojnë qartë se kush departament duhet të konfirmojë të ndarë në grupe të ardhurat dhe shpenzimet e kësaj llogarie në mbështetje të përcaktimeve ligjore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCIVE DHE EKONOMISË

3.	<p>Ilogarive në fund të vitit 2020 sipas dy institucioneve.</p> <p>Nga auditimi në lidhje me procesin e menaxhimit të financave publike në nivel vendor u konstatua në mbyllje të vitit 2020, të ardhurat e trashëguara për vitin 2021 kanë diferencë prej 3,813 milionë lekë me vlerën e të ardhurave që duhet të ishte trashëguar realisht. Në total për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore raportohet se janë trashëguar 19,910 milion lekë, ndërkohë sipas testimeve të kryera nga grupi i auditimit duhet të ishin trashëguar 16,097 milion lekë. Nëse do të vlerësohej situata e stokut të detyrimeve të bashkive (6,931 milion lekë), përkundrajt të ardhurave të pa përdorura të cilat trashëgoohen në vitin buxhetor pasardhës prej 19,562 milion lekë referuar të dhënave të MFE-së, kjo vlerë është afërsisht tre herë më e madhe se vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura të deklaruara dhe që nëpërmjet një planifikimi të drejtë do të përdoshin për uljen e këtij stoku dhe përmirësimin e gjendjes financiare të qeverisjes vendore.</p>	Pika 6	E lartë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë-Drejtoria e Financave Vendore, në rolin e mbikëqyrësit financiar të veprimtarisë të njësisë të qeverisjes vendore, duhet të marrë të gjithë masat e nevojshme për monitorimin e shpërndarjes së planit buxhetor të njësisë të qeverisjes vendore sipas prioriteteve me qëllim shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja, duke përfshirë planifikimin sipas prioriteteve si të fondeve të trashëguara nga transfertat e pakushtëzuar edhe të fondeve të veta.
4.	<p>Drejtoria e Financave Vendore, ka hartuar Raportin mbi statusin e vështirësive financiare, ku, 37 bashki janë klasifikuar òpa probleme financiare, 11 bashkia janë klasifikuar òme probleme financiare dhe 10 bashki janë klasifikuar ònë vështirësi financiare. Rezultoni se nuk është analizuar gjendja financiare për 61 bashki por për 58 bashki. Llogaritja e gjendjes financiare të paraqitura në këtë raport është hartuar duke u bazuar në vetë deklarin e bashkive në lidhje me vlerën e detyrimeve të prapambetura dhe jo në vlerën e detyrimeve të kontabilizuar dhe të raportuar në llogarinë 486 të thesari për çdo bashki, si dhe nuk është përfshirë vlera e borxhit afatgjatë për njësitë e qeverisjes vendore.</p> <p>Grupi i auditimit ka vlerësuar situatën financiare të njësisë të qeverisjes vendore në përputhje me Ligjin nr. 68/2017, udhëzimin nr. 26, datë 27.09.2019 ku rezultoni se më problematike paraqitet gjendja dhe situata financiare për Bashkinë Kavajë dhe për Bashkinë Vorë. Sipas të dhënave të MFE-së, totali i shpenzimeve të miratuara është në vlerën 68,955 milion lekë ndërsa totali i shpenzimeve faktike të njësisë të qeverisjes vendore rezultoni të jetë 50,991 milion lekë. Kundrejt totalit të shpenzimeve faktike të 61 bashkive, stoku i detyrimeve paraqitet në masën 14.7% të totalit, ndërsa kundrejt shpenzimeve të miratuar stoku i detyrimeve është në masën 10.3%. Kjo tregon jo vetëm për një planifikimin të dobët nga ana e njësisë të qeverisjes vendore por këto vlera ndikojnë edhe në mos paraqitjen e drejtë të gjendjes financiare reale të njësisë të qeverisjes vendore.</p>	Pika 6	E lartë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në rolin e mbikëqyrësit financiar të veprimtarisë të njësisë të qeverisjes vendore, të analizojë situatën për të gjitha ato bashki të cilat paraqiten në òvështirësi financiarë dhe òvështirësi serioze financiare me qëllim hartimin e një plani veprimi për daljen nga situata e krijuar.
5	<p>Fondi i rindërtimit për shkak të fatkeqësisë natyrore të tërmetit të ndodhur në vitin 2019 me Aktin Normativ nr.34 datë 16.12.2020 në shumën 32 miliard lekë, nga të cilat 3 miliard lekë grante dhe 29 miliard lekë financim nga buxheti qendror. Fondet për procesin e rindërtimit janë realizuar në shumën 16,591 milion lekë, nga 32,000 milion lekë të planifikuara sipas Aktit Normativ nr.34, ose 51.8% me një mos realizim në shumën 15,409 milion lekë. Referuar tabelës 4 òTreguesit Fiskal të konsoliduar të ligjit nr.88/2019, konstatohet se vlera e parashikuar për fondin e rindërtimit për vitet 2021 dhe 2022 është 0 lekë, ndërkohë që është parashikuar që fondi i rindërtimit i papërdorur në vitin 2020 trashëgohet në vitin pasardhës</p>	Pika 7	E lartë	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të reflektohet në vitet pasardhëse buxhetore për secilin komponent të treguesve fiskalë të buxhetit të konsoliduar, referuar tabelave shoqëruese të ligjit të buxhetit të vitit, efekti i fondeve të shpërndara me VKM në mënyrë që të realizohet programimi i saktë i shpenzimeve buxhetore brenda limiteve buxhetore të miratuara në këtë ligj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

	<p>buxhetor. Më bazë të VKM-ve përkatëse, konstatohet se janë shpërndarë në total fonde për rindërtimin në shumën 78,470,721 mijë lekë, nga të cilat detajuar për vitin 2020 në shumën 28,077,992 mijë lekë, pra mbi vlerën e përcaktuar në ligjin e buxhetit për fondet e parashikuara të rindërtimit prej 32 miliard lekë (shumë kjo e përcaktuar vetëm për vitin 2020). Kështu, shpërndarja e fondeve me VKM nuk është shoqëruar me ndryshim të vlerës së fondit të rindërtimit në vitet pasardhëse buxhetore, duke qenë se plani vijon të paraqitet në shumën 0 lekë për vitet 2021 dhe 2022 tabelat shoqëruese të ligjit nr. 88/2019 òPër buxhetin e vitit 2020, të ndryshuar.</p> <p>- Aktet Normative të miratuara gjatë vitit 2020, nuk kanë reflektuar në tabelat shoqëruese respektive të gjitha shtesat e fondeve të akorduara me VKM përgjatë këtij viti.</p>			
6	<p>Për vitin 2020 Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR) përbëhet nga granti konkurrues për arsimin. Parashikimi i fondeve për këto projekte është kryer në një projekt të vetëm investimi me emërtimin òFondi për Zhvillimin e Rajoneve në vazhdim, me njësi zbatuese Aparatin e Ministrisë, ndërkohë që këto fonde, janë të miratuara me vendim të KZHR përkatëse për projekte me përfitues njësitë e vetëqeverisjes vendore. Nga ana e KZHR nuk është marrë asnjë vendim për shpërndarjen e financimit për projekte të reja përgjatë vitit 2020, por vlera e alokuar për këtë fond është përdorur për financimin e kontratave në vazhdim nga vitet e kaluara si dhe për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura në total për 327,010 mijë lekë.</p> <p>Gjatë vitit janë kryer rishpërndarje ndërmjet projekteve të investimit, duke përdorur FZHR për projekte të cilat nuk financohen nga FZHR. Konstatohen gjithashtu rishpërndarje fondesh ndërmjet projekteve duke pakësuar òfondin e ngrirë ò të detajuara në fillim të vitit dhe duke rritur financimin për projekte të cilat paraqesin detyrime të prapambetura për fatura të vitit 2013. Vlera e detyrimeve të prapambetura të paguara në vitin 2020 për programin buxhetor ò94506 òArsimi I Lartë ò paraqitet në shumën 111,055 mijë lekë dhe në muajin shtator 2020 janë kryer rishpërndarje fondesh buxhetore ndërmjet projekteve të detajuara si òprojekte të reja ò por që janë kontrata të lidhura në vitin 2016 dhe faturuara që në vitin 2018 duke ulur vlerën e FZHR 2017-2019 me 61,055 mijë lekë.</p>	Pika 8	E lartë	<p>Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në procesin e miratimit të detajimit të investimeve publike, në çdo rast të zbatohet radha prioritare e buxhetimit në përputhje me aktet ligjore, duke përfshirë me përparësi detyrimet e prapambetura dhe detyrimet që lindin nga kontratat në proces ekzekutimi me burim financimi FZHR, në mënyrë që të shmanget kontraktimi i projekteve të reja në kushtet e kufizimeve buxhetore sipas kufijve të programeve buxhetore dhe duke parandaluar kështu e krijimin e detyrimeve të prapambetura. Procesi i miratimit të projekteve të reja të investimit me akte normative për financimin e detyrimeve të prapambetura dhe kontrata të viteve të kaluara, të paraprihet nga një inspektim financiar në lidhje me ligjshmërinë e tyre në momentin e nënshkrimit.</p> <p>Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në paraqitjen e listës së investimeve publike të projekt buxhetit të vitit të paraqitet vlera e plotë e secilës kontratë në vazhdim duke specifikuar buxhetin për secilin vit sipas periudhës së ekzekutimit të projektit dhe të shmanget praktika e paraqitjes sintetike në një projekt të vetëm me emërtimin òFZHR në proces.</p>
7	<p>Për vitin 2020, fondet òpër infrastrukturën vendore dhe rajonale ò janë parashikuar si program buxhetor në Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Konstatohet se financimi i detyrimeve të FZHR nuk është kryer sipas përparësisë së përcaktuar në aneksin 3 të ligjit nr. 88/2019 òPër buxhetin e vitit 2020, të ndryshuar duke detajuar fondet në projekte të tjera për të cilat kanë filluar procedurat e prokurimit, ndërkohë që vlera për financimin e projekteve në vazhdim sipas rishikimeve buxhetore, paraqitet në</p>	Pika 8	E lartë	<p>Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në miratimin e detajimit të investimeve publike të mbahet parasysh prioriteti në financimin e projekteve me detyrime të prapambetura dhe detyrimet që lindin nga kontratat në proces ekzekutimi me burim financimi FZHR, në mënyrë që të shtyhet</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

	shumën 803,029 mijë lekë, pasi procesi i shlyerjes së detyrimeve të njësisve të vetqeverisjes vendore është shoqëruar me verifikim nga FSHZH përgjatë vitit sipas argumentimit të MFE sipas rastit.			kontraktimi i projekteve të reja në kushtet e mundësive të kufizuara buxhetore me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura të reja.
8	Në listën e investimeve publike është paraqitur i planifikuar dhe realizuar në shumën 198,000 mijë lekë projekti “Pagesa ndërkombëtare në institucione financiare të tjera”, në programin 1130 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ndërkohë, nga auditimi i databazës së pagesave në SIFQ janë kryer pagesa duke përdorur logarinë e garancisë së vitit në vazhdim, ndërkohë që sipas informacioneve mbi investimet kapitale të dërguara nga Drejtoria e Investimeve kjo pagesë rezultoi e planifikuar dhe realizuar nga llogaritë e investimeve. Për këtë arsye, vlera prej 197,802 mijë lekë nuk rezultoi të jetë e pasqyruar në treguesit fiskalë në zërin e investimeve kapitale, duke nënvlerësuar këtë tregues në publikim.	Pika 7	E lartë	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të reflektohen në treguesit fiskalë efektet e pagesës së kryer për projektin 18AV703 sipas fondeve të miratuara për këtë qëllim dhe të shmangat praktika e pagesës së detyrimeve që nuk kanë lidhje me përdorimin e llogarive të garancive të cilat përdoren sipas rezervimit fillestar të krijuar për to dhe jo vetëm.
9	Nga auditimi konstatohet se në kushtet kur ende nuk është përcaktuar një afat maksimal për kryerjen e detajimit në udhëzimet për zbatimin e buxhetit, shkresat për detajimin e shpenzimeve kapitale rezultojnë deri në muajin Mars 2020, duke reflektuar kështu një proces të tejzgjatur për ekzekutimin e çeljeve buxhetore në nivel projektiv, problematikë kjo e trajtuar edhe në auditimet e mëparshme të KLSH-së. Kjo situatë mund të bëhet shkak për shkeljen e disiplinës në ndërmarrjen e angazhimeve buxhetore, pra fillimin e procedurave të prokurimit përpara miratimit dhe çeljes së fondeve në SIFQ. Konkretisht, rezultojnë 3 procedura prokurimi të iniciuara nga FSHZH, 2 procedura të iniciuara nga KLGJ, dhe 1 procedurë e iniciuar nga Ministria e Mbrojtjes.	Pika 3	E lartë	Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të marrë masat për të përcaktuar afate konkrete të detajimit dhe miratimit të fondeve buxhetore në kuadrin rregullator për zbatimin e buxhetit për kontrollin e angazhimeve buxhetore, në mënyrë që të shmangen situatat e tejzgjatjes së këtij procesi me impakt në iniciimin e procedurave të prokurimit në kushtet kur fondet nuk bëhen disponibël sipas projekteve që në fillim të vitit.
10	Nga auditimi u konstatua se pavarësisht kontrolleve ekzistuese, si funksionet dhe raportet e ndërtuara në SIFQ për qëllime të planifikimit buxhetor, për të garantuar saktësinë e tavanëve të miratuar, ashtu sikundër është trajtuar edhe në auditimin e mëparshëm, u konstatuan diferencat në të dhënat e raportuara në treguesit fiskalë të buxhetit të konsoliduar sipas Tabelës nr. 4 të Ligjit të Buxhetit me atë të regjistruar në sistemin SIFQ në planin fillestar të vitit 2020, konkretisht në zërat e shpenzimeve dhe financimit të deficitit.	Pika 3	E lartë	Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të vlerësojë kontrollet ekzistuese dhe procedurat aktuale për garantimin e saktësisë së regjistrimeve të planit fillestar pas miratimit të ligjit, në vijim të konstatimit më sipër duke parashikuar procedura periodike për të kryer rakordimet përkatëse dhe kontrolle/procedura shtesë për të shmangur pasaktësitë në hedhjen e planit të miratuar në SIFQ.
11	Nga analizimi i të dhënave të vëna në dispozicion, mbi rishikimet buxhetore përgjatë vitit 2020, u konstatua se ka patur rreth 2327 rishikime të fondeve buxhetore me një ndryshim neto midis projekteve prej 50.7 miliard lekë, nga të cilat 632 rishikime prekin projekte për investime kapitale që tregojnë për një planifikim të dobët të shpenzimeve për investime ashtu edhe ato për shpenzime operationale, nga ana e institucioneve qendrore dhe vendore, mungesës së analizave të mirëfillta gjatë planifikimit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, mungesë monitorimi i zbatimit të buxhetit dhe veçanërisht të ecurisë së zbatimit të investimeve. U konstatua se janë kryer 442 rishikime pas datës 15 nëntor të vitit 2020 në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, dhe se ekzekutimi në SIFQ i rishikimeve buxhetore buxhetore që prekin vitin 2020 kanë vazhduar të kryhen deri në datën 24 shkurt 2021.	Pika 3	E lartë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë me drejtoritë përgjegjëse: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në kuadër të zbatimit të Metodologjisë për Monitorimin e Investimeve Publike, të marrë në konsideratë përfshirjen e numrit të rishpërndarjeve të kërkuara nga çdo njësi në grupin e treguesve të matjes së performancës financiare me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë dhe cilësisë së programimit buxhetor. Nëpunësi i Parë Autorizues të marrë masa për verifikimin e të gjitha rasteve të regjistrimeve pas datës 15



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

				Nëntor, të rishpërndarjeve buxhetore të vitit 2020 për të nxjerrë përgjegjësitë administrative përkatëse.
12	Nga përpunimi i të dhënave të pagesave të kryera gjatë vitit 2020, evidentohen 7212 regjistrime për fatura për shpenzime të kryera në vitet e mëparshme, në vlerën prej 14.5 miliard lekë nga të cilat 1845 regjistrime në vlerën 11.3 miliard lekë për shpenzime për investime. 54 projekte për investime me një vlerë totale të paguar prej 2,168,664 mijë lekë, fondet disponibël të të cilave janë buxhetuar gjatë vitit për të paguar detyrimet e prapambetura të këtyre projekteve/kontratave në 33 institucione të pa planifikuara në ligjin e buxhetit nr. 88/20219.	Pika 3	E lartë	Nëpunësi i Parë Autorizues të marrë masat e nevojshme për Drejtorinë e Përgjithshme e Buxhetit dhe njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për të respektuar radhën prioritare së angazhimeve buxhetore gjatë detajimit dhe miratimit të planit të buxhetit, për të shmangur rishikimet e kryera për të likuiduar detyrimet e periudhave të mëparshme, apo për të krijuar rishtaz detyrime të tjera të prapambetura.
13	U konstatuan problematika mbi sistemin e SIFQ të cilat mund të ndikojnë në sigurinë e sistemit në drejtim të kryerjes së pagesave pa pasur fonde të mjaftueshme të alokuara që tregojnë për thyerje të mekanizmave parandalues të sistemit duke mbetur një risk potencial të tejkallimit të vlerave të alokuara	Pika 3	E lartë	MFE në bashkëpunim me AKSHI-n, nisur nga rastet e konstatuara në drejtim të thyerjes së mekanizmave parandalues të sistemit SIFQ, të kryejnë një analizë të përgjithshme të sistemeve të kontrollit dhe gjithë problematikave të konstatuara ndër vite në lidhje me anën funksionale të sistemit, për të mundësuar kontraktimin e mirëmbajtjes funksionale të sistemit.
14	<p>-Nga auditimi i rishikimeve të fondeve buxhetore për sa i përket fondeve të dedikuara për përbalimin e situatës së shkaktuar nga COVID-19, u konstatua se krahas faktit se kodet e projekteve nuk janë konsistente, janë kryer rishikime të shumta të këtyre fondeve, pas akteve normative me një sërë VKM, duke e bërë të vështirë gjurmimin e realizimit përfundimtar. Kështu, grupi i auditimit testoi në regjistrin e pagesave, disa nga kodet e projekteve të cilat sipas përshkrimit janë të dedikuara për mbulimin e shpenzimeve për COVID-19, dhe rezultoi se në disa raste këto fonde janë përdorur për mbulimin e shpenzimeve të tjera operative, si: likuidime të energjisë elektrike, internetit, dieta, shërbim ruajtje objekti, lavanterie, kontrata të ndryshme mirëmbajtjeje në vazhdim, etj. Në total, vetëm për rastet e konstatuara më sipër, rezultoi se janë paguar 203,376 mijë lekë për shpenzime të ndryshme nga COVID-19. Nga auditimi i regjistrin të rishikimeve të MSHMS u konstatuan 3 projekte me vlerë totale 15,791 mijë lekë të çelura për t'u realizuar me burim financimi nga fondi i COVID-19 (nga 1 miliard lekë të alokuara nga ky fond për investime në kuadër të pandemisë) dhe me këto fonde janë likuiduar fatura të kontratave të lidhura një vit më pare.</p> <p>-Nga auditimi u konstatua se monitorimi i ekzekutimit të buxhetit të alokuar për rindërtimin është i cunguar pasi kodet e projekteve të çelura për këtë qëllim nuk janë lehtësisht të gjurmueshme. Rishikimet e kryera gjatë vitit nuk mundësojnë identifikimin e projekteve në të cilat janë akorduar fondet dhe nuk mund të verifikohet reflektimi i VKM-ve në regjistrin e rishikimeve, për të identifikuar vlerat e fondeve që u janë akorduar njësitëve, dhe periudhën kohore në të cilën janë miratuar fondet në sistem. Duke qenë se kodet e produkteve /projekteve të</p>	Pika 3	E lartë	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit pranë MFE, të marrë masat për të kryer sistemit e nevojshme në kodet e projekteve të çelura në kuadër të pandemisë dhe atyre të rindërtimit si dhe raportimin e konsoliduar sipas burimit të financimit të këtyre fondeve duke përfshirë grantet, në mënyrë që të mundësohet monitorimi i këtyre projekteve si për efekt të rishpërndarjeve në planin buxhetor, ashtu edhe në realizimin e tyre deri në fund të vitit, në zbatim edhe të parimeve të qeverisjes bazuar mbi transparencën e informacionit në mënyrë që ai të jetë lehtësisht i aksesueshëm nga palët e interesit.</p> <p>-Për rastet e trajtuar më sipër ku përshkrimi i faturës nuk rezultoi të lidhet me situatën e shkaktuar nga COVID-19, Nëpunësi i Parë Autorizues të marrë masat për të ngritur një grup pune për të verifikuar nëse kemi të bëjmë me një keq klasifikim të shpenzimeve në kodin e COVID-19 apo këto institucione kanë shpenzuar fondet e COVID-19 për mbulimin e detyrimeve të tjera ndaj atyre të parashikuara për rastet e trajtuara, dhe të marrë masat kundrejt NA dhe NZ respektive.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

	<p>rindërtimit nuk janë konsistente nga momenti i alokimit të fondeve në zbatim të VKM-ve, deri në realizimin e shpenzimeve sipas regjistrit të pagesave, nuk është i mundur verifikimi i saktësisë së raportit të gjeneruar nga MFE për përdorimin e fondit të rindërtimit. Në zbatim të VKM-ve të dala për përdorimin e fondeve të rindërtimit për bashkitë, në rastet kur si burim i financimit është përcaktuar granti i rindërtimit, kjo shtesë e fondeve buxhetore nuk rezulton të jetë reflektuar në planin buxhetor. Si rezultat, raporti i gjeneruar nga MFE për përdorimin e fondit të rindërtimit krahasuar me planin, nuk pasqyron të dhëna për pjesën e Fondit të Rindërtimit me burim financimi grante. Referuar të dhënave të raportuar nga MFE për përdorimin e fondit të rindërtimit, duke marrë në konsideratë vetëm pjesën e fondeve të buxhetit të shtetit dhe jo grantet, rezulton të jetë rreth 25 miliard lekë nga të cilat janë realizuar pagesa rreth 15 miliard lekë ose 60% e fondit të shpërndarë. Sipas SIFQ gjendja e pashpërndarë e fondeve të dedikuara për Rindërtimin (pa përfshirë grantet) sipas Akteve normative në fund të vitit 2020 është 3,235,626 mijë lekë.</p>			
15	<p>Nga auditimi u konstatua se afatet e përcaktuara në dispozitat ligjore mbi përgatitjen e PBA, nuk janë zbatuar plotësisht, ku përmendim: Kalendarin i menaxhimit të shpenzimeve publike, Udhëzimi për përgatitjen e PBA, Tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2020-2022, Udhëzimi plotësues për përgatitjen e PBA, Dokumenti i rishikuar i PBA 2020-2022.</p>	Pika 2	E lartë	<p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, si përgjegjëse për hartimin e dokumentit të Planit Buxhetor Afatmesëm (PBA), duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për përgatitjen e etapave të Programit Buxhetor Afatmesëm brenda kohës së përcaktuar në dispozitat ligjore dhe kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike, duke nxjerrë përgjegjësitë për vonesat që ndikojnë në përgatitjen e tyre.</p>
16	<p>Nga auditimi i zbatimit të afateve të dorëzimit të kërkesave të PBA për fazën strategjike dhe teknike nga ana e njësisë të qeverisjes qendrore, u konstatua mos zbatim i afateve për kërkesat e PBA jashtë afateve problematika në hartimin e tyre.</p>	Pika 2	E lartë	<p>Nëpunësi i Parë Autorizues të vlerësorë arsyet e vonesave dhe mangësive të evidentuara mbi kërkesat e PBA, duke marrë masat kundrejt NA dhe NZ të institucioneve të cilat kanë dorëzuar me vonesë apo me mangësi fazat e kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm.</p>
17	<p>U konstatuan diferenca të mëdha të fondeve të alokuara për projekte të caktuara, nga PBA 2019-2021 në PBA 2020-2022, çka flet për një parashikim të dobët, duke zbehur vlerën e parashikimeve afatmesme për shpenzimet e buxhetit të shtetit.</p>	Pika 2	E lartë	<p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë/ Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, në vijimësi të krahasojë kërkesat buxhetore edhe me PBA-të e viteve të kaluara duke rakorduar ecurinë e investimeve kapitale me qëllim mirë menaxhimin e tyre për të evituar krijimin e detyrimeve të prapambetura, ndryshimet në prioritetet e projekteve, si dhe cënimin apo favorizimin e projekteve specifike.</p>
18	<p>- Në zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin Social", çdo subjekt privat, që pas hyrjes në fuqi të ligjit, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2000 m² ka detyrimin të kalojë pranë bashkisë të paktën 3% të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm në favor të fondit publik të banesave sociale. Për zbatimin e</p>	Pika 1	E lartë	<p>MFE të marrë masat për të hartuar një udhëzues për strehimin social duke përcaktuar procedurat konkrete që do të ndiqen për të përllogaritur dhe kaluar në pronësi të bashkive banesat e shërbimit social për lejet e dhëna mbi 2000 m², dhe</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

	këtij kriteri pranë Drejtorisë së Strehimit është përcjellë informacion përgjatë vitit 2019 nga vetëm 7 bashki (nga të cilat vetëm Bashkia Elbasan ka raportuar për 3 banesa sociale në vijim të lejeve të dhëna mbi 2000m2), dhe përgjatë vitit 2020 nga asnjë bashki.			periodicitetin e raportimit të njërive të vetëqeverisjes vendore për numrin e lejeve të ndërtimit të përcjella nga data 30 Nëntor 2018; sipërfaqen totale ndërtimore të banimit sipas lejes së ndërtimit dhe sipërfaqen që i takon bashkisë dhe numrin e banesave sociale që sigurohen deri në vitin 2021 pranë Drejtorisë së Strehimit në MFE.
19	Nga auditimi u konstatua se monitorimi aktual i stokut të detyrimeve të prapambetura i kryer nga Ministria e Financave nuk mundëson përputhshmërinë e plotë me Udhëzimin nr.5, datë 27.02.2014 për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Në kushtet kur MFE, nuk ka shfuqizuar udhëzimin e vitit 2014, në udhëzimin e ri të vitit 2020 nuk ka parashikuar procedura të ngjashme monitoruese, por ka rregulluar procesin e raportimit të informacionit mbi këto detyrime nëpërmjet sistemit të thesarit dhe DPT, por pa mundur të përmirësojë raportimin e detyrimeve të reja të prapambetura, ky mbetet sërisht një proces vetëdeklarues i cili nuk siguron protësinë dhe saktësinë e stokut të detyrimeve të prapambetura. Nga auditimi konstatohet se nuk ka një plan veprimi të miratuar për ndërmarrjen e iniciativave në drejtim të menaxhimit të detyrimeve të prapambetura dhe një plani konkret për likuidimin e tyre. Në këto kushte nuk mund të kryhet një raportim në bazë të objektivave të paracaktuara për të monitoruar kështu rritjen/pakësimin e stokut apo krijimit rishtaz të detyrimeve të prapambetura nga ana e njërive publike.	Pika 10	E lartë	<ul style="list-style-type: none"> - NPA dhe strukturat përgjegjëse pranë MFE të marrin masat për kryerjen e sondazheve periodike tek ministritë e linjës, nëse ekzistojnë detyrime financiare të krijuara rishtaz dhe të papaguara në kohë për të përcaktuar pagesat e reja të kërkueshme, që rrjedhin nga faturat ose pretendimet e marra përtej fondeve në dispozicion duke përcaktuar përgjegjësinë dhe vendosur masa administrative sipas kuadrit ligjor në fuqi. - Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit Financiar Publik, apo struktura të tjera të MFE të marrin masat për të hartuar dhe miratuar një plan veprimi konkret dhe një plan shlyerjeje në drejtim të masave që duhet të ndërmerren për pakësimin e stokut ekzistues të detyrimeve të prapambetura dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja, duke u kërkuar njërive e qeverisjes qendrore që gjatë hartimit të taveveve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm të përfshihet edhe plani i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, sikundër është vepruar për njësitë e vetëqeverisjes vendore, për të garantuar kështu respektimin e prioriteteve që duhet të merren në konsideratë në planifikimin e buxhetit.
20	Nga auditimi mbi investimet kapitale me financim të brendshëm të realizuara me burim financimi të ardhurat e arsimit të lartë konstatohet se janë kontabilizuar në llogarinë 231 ÷Investime Kapitale Të Trupëzuar÷ 13 projekte investimi me vlerë 192,670 mijë lekë me përshkrimin investimi ÷Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve÷ dhe 1 projekt investimi në shumën 977 mijë lekë me përshkrimin ÷IAL dhe programe studimi të akredituara÷, në disa njësi shpenzuese të ndryshme. Gjithashtu konstatohet se për këto investime është përdorur i njëjti kod projekti investimi për disa institucione të arsimit të lartë, duke mos identifikuar specifikisht investimet e kryera në nivel produkti investimi me impakt në cilësinë e informacionit të raportuar dhe vështirësi në ndjekjen e ecurisë së tyre.	Pika 7	E lartë	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të reflektohet në treguesit fiskalë të konsoliduar, sipas tabelës 4 të ligjit të buxhetit të vitit, plani buxhetor për të gjitha investimet kapitale të brendshme me burim financimi të ardhurat e veta sikurse parashikohen për investimet nga të ardhurat e arsimit të lartë. Në të njëjtën kohë, të detajohen në nivel analitik investimet e realizuara nga të ardhurat e veta të arsimit të lartë dhe të shmanget çelja e projekteve të investimit në një kod të përgjithshëm ndërkohë që projektet zbatohen nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

				njësi shpenzuese të ndryshme.	
21	<p>Nga auditimi i të dhënave në lidhje me kontratat e nënshkruara për investimet përgjatë vitit 2020, sipas modulit të kontratave në SIFQ konstatohet se janë nënshkruar mbi 500 kontrata për investime publike me vlerë të kontraktuar rreth 23 miliard lekë, pas datës 15 Tetor, jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. Institucionet më përfaqësuese të cilat nuk respektojnë këtë përcaktim të ligjit përfshijnë Fondin Shqiptar të Zhvillimit me vlerë të kontraktuar 10 miliard lekë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me vlerë të kontraktuar në shumën 7.8 miliard lekë. Lidhja e kontratave pas kësaj date krijon kushtet për lindjen e detyrimeve të prapambetura dhe në të njëjtën kohë për përdorim pa efikasitet të fondeve buxhetore në nivelin e 20% (rreth 5 miliard lekë) të koston së projektit në vitin e parë të zbatimit të tij, pasi koha e mbetur për përdorimin e këtij fondi deri në fund të vitit buxhetor është shumë e shkurtër.</p>	Pika 7	E lartë	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me APP të parashikohen procedura kontrolli përtej atyre aktuale si dhe të integrohen sistemet informatike përkatëse me qëllim disiplinimin e ndërmarrjes së angazhimeve buxhetore.	
22	<p>Nga auditimi mbi planifikimin, realizimin dhe raportimin e investimeve kapitale me financim të brendshëm konstatohet se janë raportuar si investime kapitale shpenzime të kryera për aktivitetin korent të institucioneve buxhetore në shumën 1,197,956 mijë lekë, të cilat duhet të ishin planifikuar dhe realizuar në zërin e shpenzimeve korente sipas klasifikimit të bërë në tabelën 4 të ligjit të buxhetit të vitit.</p>	Pika 7	E lartë	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë gjatë fazës së diskutimit të kërkesave buxhetore dhe në vijim të detajimit të fondeve sipas kërkesave të institucioneve buxhetore të zhvillohet një analizë mbi natyrën ekonomike të fondeve të kërkuara me qëllim klasifikimin dhe raportimin e drejtë të shpenzimeve sipas natyrës dhe destinacionit.	
23	<p>Për vitin 2020, nga auditimi i investimeve kapitale me financim të huaj është konstatuar se, 2 projekte investimi në vlerën 12,769 mijë lekë janë realizuar pa pasur një plan buxhetor të miratuar me Ligjin e Buxhetit apo me Aktet Normative në zbatim të tij. 12 projekte investimesh të huaja me Kredi për vlerën 1,995,290 mijë lekë janë realizuar në tejkallim të planit të buxhetit dhe 48 projekte investimesh të huaja në formën e Grandit për vlerën 1,423,373 mijë lekë janë realizuar në tejkallim të planit të buxhetit. Referuar të dhënave në SIFQ. Është konstatuar se në 3 raste, i njëjti projekt investimi është çelur në SIFQ, me më shumë se dy kode.</p> <p>Gjithashtu për 39 projekte investimi me financim të huaj në vlerën totale 2,273,373 mijë lekë, referuar përshkrimit janë konstatuar keq klasifikuar llogarish ekonomike kryesisht në llogarinë 231 ÷ investime për aktiveve afatgjata materiale.</p>	Pika 5	E lartë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për fuqizimin e kontrollit të brendshëm në drejtim të raportimit të saktë dhe të plotë të investimeve publike me financim të huaj, nëpërmjet përfshirjes së tyre në ciklin e menaxhimit të shpenzimeve buxhetore për t'u siguruar për përputhshmërinë me planet vjetore dhe tavanet përkatës buxhetore.	-Ministria e Financave dhe Ekonomisë/ Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të marrë masa për fuqizimin e rolit të Drejtorisë së Menaxhimit të Investimeve Publike në MFE, në drejtim të monitorimit të procesit të investimeve publike me financim të huaj me qëllim rritjen e cilësisë së menaxhimit të fondeve publike dhe llogaridhënies së strukturave që kryejnë shpenzime buxhetore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

24	<p>Nga audimi mbi detajimin dhe rishpërndarjen e fondeve të investimeve përgjatë vitit 2020 janë konstatuar problematika që përfshijnë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore në dispozicion, detajimin e projekteve të investimeve publike me akt normativ pa kaluar në PBA 2020-2022, detajimin e fondeve të investimeve për vetëm vlerën e 20% të kostos së projektit pa buxhet në vitet pasardhëse buxhetore, detajimin e planit buxhetor në 3 vite për kontrata që parashikojnë periudhë faturimi më të vogël se një vit, shkurtimin e fondeve të investimit në momentin e lidhjes së kontratës dhe rialokimin drejt projekteve të tjera të investimit publik detyrime të prapambetura apo në proces nga vitet e kaluara, mos regjistrimin e kontratave dhe obligimit në SIFQ duke krijuar detyrime të prapambetura. Këto parregullsi të identifikuar janë mundësuar edhe nga miratimi i dhënë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në detajimin fillestar të fondeve të investimit apo rialokimet e kryera përgjatë vitit.</p>	Pika 7	E lartë	<p>Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të ndërmerren inspektime financiare dhe masa administrative përkatëse për të gjitha rastet problematike të identifikuar sipas përgjegjësisë përkatëse; të kryejë përputhjen e kostos së plotë të projekteve të investimeve publike me vlerën e përcaktuar në PBA; të shmanget praktika e shtyrjes së planit buxhetor përtej periudhës së parashikuar për kohëzgjatjen e kontratave; të merren masa për regjistrimin në kohë të fondeve të obliguara në SIFQ, duke koordinuar edhe me Agjencinë e Prokurimit Publik si dhe integrimin e sistemit elektronik të prokurimit publik me sistemin informatik financiar të qeverisë.</p> <p>-Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të reflektohet efekti i VKM të dala gjatë vitit në tabelën e ligjit të buxhetit të vitit në të cilin miratohen fondet në nivel programi për çdo institucion.</p> <p>-Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të shmanget detajimi i projekteve të reja të investimit publik me akte normative gjatë si dhe në përfundim të vitit buxhetor, të cilat nuk krijojnë mundësinë e përdorimit të buxhetit prej 20% të kërkuar në vitin e parë të zbatimit të tij.</p>
25	<p>Sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 88/2019 të ndryshuar, programi buxhetor 6210 òPrograme zhvillimio është përdorur për procesin e rindërtimit, ku rast pas rasti me Vendim të Këshillit të Ministrave janë detajuar fonde për Fondin Shqiptar të Zhvillimit për rindërtimin e objekteve të dëmtuara nga tërmeti. Efekti i VKM-ve të dala në funksion të procesit të rindërtimit me përfitues FSHZH nuk është pasqyruar në tabelën nr.1 të ligjit të buxhetit ku pasqyrohet buxheti i miratuar me programe sipas institucioneve. Nga auditimi mbi fondin e rindërtimit konstatohet se buxheti i investimeve për rindërtimin paraqitet në shumën 10,451,538 mijë lekë dhe realizimi faktik në shumën 7,120,407 mijë lekë sipas të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Buxhetit. Nga auditimi mbi të dhënat e publikuara në treguesit fiskalë të konsoliduar mbi investimet nga buxheti qendror me burim financimi fondin e rindërtimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, konstatohet se vlera e buxhetit paraqitet në shumën 10,149,495 mijë lekë ndërkohë që realizimi faktik paraqitet në shumën 6,818,365 mijë lekë, duke paraqitur diferencë në krahasim me raportimin e Drejtorisë së Buxhetit.</p>	Pika 7	E lartë	<p>Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masa për regjistrimin e të gjitha kontratave të nënshkruara përgjatë periudhës objekt auditimi dhe ato të kontraktuara gjatë vitit pasardhës në sistemin informatik financiar të qeverisë nga njësitë përkatëse.</p> <p>Nga ana e Ministrisë së Financave të bëhet detajimi në nivel analitik sipas objektit të infrastrukturës, banesave, ndërtesave pallat në të cilin është realizuar investimi publik, në mënyrë që të merret në kontroll procesi i rindërtimit sipas VKM-ve respektive, duke qenë se shumë nga këto asetë publike janë objekt edhe i transferimit kapital pas përfundimit të punimeve drejt përfituesve të procesit të rindërtimit.</p>
26	<p>Nga auditimi mbi projektet e investimeve publike në vazhdim të buxhetuara për programin buxhetor 062200 òInfrastruktura vendore dhe rajonaleò në Fondin Shqiptar të Zhvillimit janë konstatuar problematika që përfshijnë detajimin e planit buxhetor në 3 vite për kontrata që</p>	Pika 8	E lartë	<p>Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të përfshihet në mënyrë të menjëhershme përputhja e planit buxhetor të miratuar me periudhën e faturimit për secilën</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

	<p>përfshijnë periudhë ekzekutimi deri në 12 muaj, duke krijuar detyrime të prapambetura në këtë program, pasi periudha e faturimit nuk përputhet me periudhën e buxhetit të planifikuar për shlyerjen e tyre.</p>			<p>kontratë të nënshkruar për investimet e financuara nga programi buxhetor infrastruktura vendore dhe rajonale. Të ndalohet rishpërndarja e fondeve me akte normative përtej afatit të sanksionuar për kryerjen e rishpërndarjes së fondeve, me qëllim shmangien e krijimit të detyrimeve të prapambetura si dhe të ndalohet praktika e detajimit të projekteve të reja të investimit në periudhën e fundit të vitit buxhetor.</p>
27	<p>Stoku i detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2020 sipas raportit të MFE për njësitë e qeverisjes qendrore dhe ato të vetëqeverisjes vendore paraqiten në shumën rreth 14,316,777 mijë lekë (në vitin 2019 paraqitej në 17,371,031 mijë lekë) ose 17% më pak se një vit më parë.</p> <p>Nga auditimi u konstatua se pavarësisht procedurave të hollësishme të udhëzimit të ri për konsolidimin dhe raportimin e detyrimeve të prapambetura, të dhënat e raportuara nga MFE paraqiten me diferencë krahasuar me të dhënat që rezultojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në MFE, ashtu edhe me të dhënat që rezultojnë nga auditimi i KLSH-së pranë kësaj drejtorie.</p> <p>Në konkluzion konstatohet se raportimi aktual i vlerës totale të detyrimeve të prapambetura nuk është i plotë dhe i saktë për shkak të: Mungesës së raportimeve mbi detyrimet e prapambetura nga disa njësi të mëdha shpenzuese ku përmendim FSHZH, AKSHI-n, të cilat vijojnë të mos raportojnë; Mos përfshirjen e stokut të detyrimeve të prapambetura të Ujësjellës Kanalizimeve; Pamundësi për të evidentuar shtesat e kryera përgjatë vitit për të monitoruar respektimin e parimit FIFO; Klasifikim të detyrimeve sipas kohës së krijimit; Diferencave të konstatuara në stokun e fillim vitit për shkak të regjistrimeve të kryera pas kryerjes së sistemimeve finale për efekt raportimi; Diferencat në vetë deklarinë e stokut për efekt regjistrimi në SIFQ me atë të njohur në pasqyrat financiare në njësi; Diferencat në vlerën e stokut edhe në rang institucionesh, pa efekt në total; -Pagesa të kryera jashtë skemës së likuidimit të detyrimeve të prapambetura; -Mungesa e monitorimeve për të evidentuar se vlera e regjistruar në pasqyrat financiare të institucioneve reflekton stokun real dhe të plotë të detyrimeve të prapambetura; Mos reflektim i të gjithë detyrimeve të prapambetura.</p>	Pika 10	E lartë	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit të marrin masat për implementimin e kontrolleve shtesë për të shmangur në të ardhmen diferencat mes tyre në përlllogaritjet e stokut të detyrimeve të prapambetura, duke mundësuar verifikimin e detyrimeve të prapambetura sipas kohës së krijimit të tyre apo shtesave përgjatë vitit me qëllim kryerjen e një raportimi sa më të saktë dhe të plotë të tyre në materialin përfundimtar të përgatitur dhe publikuar nga njësi përgjegjëse për monitorimin e risqeve të përgjithshme në MFE.</p> <p>-DPB të marrë masat që raporti final i detyrimeve të prapambetura të reflektojë stokun real e gjithëpërfshirës të sistemit të qeverisjes së përgjithshme duke përfshirë këtu edhe institucione si FSHZH, AKSHI, Ujësjellës Kanalizimeve, etj.</p> <p>-MFE të parashikojë procedura shtesë kontrolli për të monitoruar raportimin aktual të detyrimeve të prapambetura për të shmangur si diferencat mes vlerës së raportuar të detyrimeve me atë të pasqyrave financiare, ashtu edhe mes vlerës së njohur në pasqyrat financiare dhe atë që faktikisht duhet të ishte regjistruar, ku përmendim vendimet gjyqësore me risk të lartë për këtë fenomen.</p>
28	<p>Problematika të konstatuara në planifikimi i Fondit Rezervë dhe Fondit të Kontigjencës në përputhje me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 òPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, kreun e II, nenin 5, sipas të cilit: òBuxheti i Shtetit përfshin një fond rezervë dhe një fond kontigjence të pashpërndarë, i cili miratohet nga Kuvendi në ligjin e buxhetit vjetor, deri në masën 3% të vlerës totale të fondeve të miratuara. Në zbatim të ligjit vjetor nr.88/2019, datë 18.12.2019 òPër buxhetin e vitit 2020, në nenin 11, 14 dhe 15, Fondi rezervë i buxhetit të shtetit prej 1,700 milion lekë, përdoret nga Këshilli i</p>	Pika 9	E lartë	<p>Strukturat drejtuese të Ministrisë së Financave/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, të krijojë për çdo VKM të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit, dosjen e plotë të dokumentacionit të domosdoshëm për të vlerësuar kriteret e përdorimit të Fondit Rezervë i cili edhe gjatë vitit 2020, pavarësisht situatës së veçantë të pandemisë, është përdorur për shpenzime të cilat duhej të ishin planifikuar në ligjin e buxhetit dhe</p>



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Ministrave për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme; Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4,000 milionë lekësh përdoret nga Ministri përgjegjës për Financat për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në shpenzimet për interesa.			nuk e plotësojnë në vlerë dhe koherencë pagese kriterin e pa parashikueshmërisë dhe emergjencës. Gjithashtu për të gjitha kërkesat për përdorimin e fondit rezervë sipas procedurës, të shmanget praktika e mos marrjes së mendimit të Minsitrisë së Financave dhe Ekonomisë.
---	--	--	---

I.c. Opinioni i auditimit

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve mbi të cilat kjo drejtori realizon misionin e saj.

Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë¹, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për disa zëra buxhetorë, u konstatuan parregullsi dhe vendimmarrje jo në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale dhe të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e **një opinionit të kundërt të përputhshmërisë**² (ISSAI 4000).³

Baza për opinionin e auditimit

Nga evidencat e marra për veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në MFE, rezultoi se problematikat e konstatuara nga KLSH edhe në vitet e mëparshme janë të pranishme edhe në vitin 2020 në të gjitha fazat e planifikimit, miratimit, ezekutimit, monitorimit dhe raportimit të buxhetit dhe kryesisht konsistojnë në:

-detajimin e projekteve të investimeve publike me akt normativ pa kaluar në PBA 2020-2022, detajimin e fondeve të investimeve për vetëm vlerën e 20% të kostos së projektit pa buxhet në vitet pasardhëse buxhetore,

- shkurtimin e fondeve të investimit në momentin e lidhjes së kontratës dhe rialokimin e këtyre fondeve drejt projekteve të tjera të investimit publik për detyrime të prapambetura apo në proces nga vitet e kaluara, mos regjistrimin e kontratave dhe rrjedhimisht mos regjistrimin e obligimit në SIFQ duke lejuar ndërmarrjen e angazhimeve buxhetore dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura.

-Nga auditimi i pagesave të kryera gjatë vitit 2020, evidentohen 7212 regjistrime për fatura për shpenzime të kryera në vitet e mëparshme, në vlerën prej 14.5 miliard lekë nga të cilat 1845 regjistrime në vlerën 11.3 miliard lekë për shpenzime për investime.

-Është konstatuar ndërmarrja e angazhimeve pa fonde buxhetore dhe mos respektimi i tavaneve të ligjit për vitet e ardhshme buxhetore, kryesisht në programet buxhetore oprograme zhvillimi në rreth 2.4 miliard lekë, otransporti rrugorë në rreth 4.5 miliard lekë, ofunizimi me ujë dhe kanalizime në rreth 6.3 miliard lekë.

¹ Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së"

² Një opinion i kundërt shprehet kur efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, janë materiale dhe të përhapura

³ ISSAI 4000 – Udhërrëfytyesi i Auditimit të Përputhshmërisë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

-Nga auditimi i të dhënave në lidhje me kontratat e nënshkruara për investimet përgjatë vitit 2020, sipas modulit të kontratave në SIFQ konstatohet se janë nënshkruar mbi 500 kontrata për investime publike me vlerë të kontraktuar rreth 23 miliard lekë, pas datës 15 Tetor

- Shpërndarja e fondeve me VKM nuk është shoqëruar me ndryshim të vlerës së fondit të rindërtimit në vitet pasardhëse buxhetore, duke qenë se plani paraqitet në shumën 0 lekë për vitet 2021 dhe 2022 sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 88/2019 për buxhetin e vitit 2020, të ndryshuar.

- Nga auditimi konstatohet se nga ana e KZHR nuk është marrë asnjë vendim për shpërndarjen e financimit për projekte të reja përgjatë vitit 2020, por vlera e alokuar për këtë fond është përdorur për financimin e kontratave në vazhdim nga vitet e kaluara si dhe për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura në total **për 327 milion lekë**.

-Afatet për procesin e planifikimit të buxhetit të vitit 2020 janë shkëlur në përgatitjen e kalendarit të shpenzimeve, tavanëve buxhetore si dhe udhëzimeve përkatëse.

- Nga auditimi i të dhënave të rishikimeve buxhetore, u konstatua se janë kryer një numër i lartë rishikimesh buxhetore pas datës 15 nëntor të vitit 2020. Ndryshimet buxhetore që prekin vitin 2020 vazhdojnë deri në datën 24 shkurt 2021, edhe pse ligjërisht pagesat me efekt kontabël 2020 lejohen deri në datën 21 janar 2021.

- Fondi Rezervë rezultojn të jetë përdorur edhe për shpenzime të cilat duhej të ishin planifikuar në ligjin e buxhetit vjetor dhe përgjatë vitit ai është rishpërndarë në projekte të tjera nga sa planifikuar fillimisht.

- Nga auditimi i rishikimeve të fondeve buxhetore për sa i përket fondeve të dedikuara për situatën COVID-19 dhe të rindërtimit u konstatua se krahas faktit se nuk janë konsistente, janë kryer rishikime të shumta të këtyre fondeve, duke e bërë të vështirë gjurmimin e realizimit përfundimtar dhe verifikimin e saktësisë së raportit të gjeneruar nga MFE për përdorimin e fondit të rindërtimit.

Në regjistrin e pagesave, disa nga kodet e projekteve të cilat sipas përshkrimit janë të dedikuara për mbulimin e shpenzimeve për COVID-19, dhe nga auditimi rezultoi se në disa raste këto fonde janë përdorur për mbulimin e shpenzimeve të tjera operative, si: likuidime të energjisë elektrike, internetit, dieta, shërbim ruajtje objekti, lavaxantierie, kontratave të ndryshme mirëmbajtjeje në vazhdim në shumën 203 milion lekë.

-Në fondin e rindërtimit janë konstatuar problematika në planin e akorduar sipas VKM-ve dhe atij të regjistruar në SIFQ si dhe në të njetjën kohë mos regjistrim të obligimeve në bazë të kontratave të nënshkruara.

-Të ardhurat e trashëguara nga pushteti vendor rezultojnë tre herë më të larta se detyrimet e prapambetura të tij, që në rast se do shoqëroheshin me planifikimin e shpenzimeve për pushtetin vendor do të sillnin përmirësimin e treguesit të vështirësës financiare për shumë bashki.

- Detyrimet e prapambetura raportuar nga MFE në rreth 23,826 milion lekë nuk janë të përfshira në treguesit fiskalë të konsoliduar si dhe kjo vlerë nuk paraqitet e saktë me diferenca të konstatuara në rreth 590 milion lekë.

-Për vitin 2020, nga auditimi i investimeve kapitale me financim të huaj është konstatuar se, 2 projekte investimi në vlerën 12.7 milion lekë janë realizuar pa pasur një plan buxhetor, 12 projekte investimesh të huaja me Kredi për vlerën 1,995 milion lekë janë realizuar në tejkalim të planit të buxhetit dhe 48 projekte investimesh të huaja në formën e Grandit për vlerën 1,423 milion lekë janë realizuar në tejkalim të planit të buxhetit.

-Janë konstatuar 39 projekte investimi me financim të huaj në vlerën totale 2,273 milion lekë, të cilat referuar përshkrimit rezultojnë me keq klasifikime në llogarinë 231 Investime për aktiveve afatgjata materiale.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

-Nga auditimi mbi investimet kapitale me financim të brendshëm konstatohet se janë raportuar si investime kapitale, shpenzime të kryera për aktivitetin korent të institucioneve buxhetore në **shumën 1,198 milion lekë**, të cilat duhet të ishin planifikuar dhe realizuar në zërin e shpenzimeve korente sipas klasifikimit të bërë në tabelën 4 të ligjit të buxhetit të vitit.

Përgjegjësitë e Drejtimit.

Drejtimi është përgjegjës për menaxhimin e procesit të hartimit, ekzekutimit dhe raportimit buxhetor, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Ligjit nr. 88/2019 òPër buxhetin e vitit 2020, të ndryshuar, nxjerrjen dhe garantimin e zbatimit të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre, ndërkohe që theksojmë se të gjitha institucionet qendrore dhe vendore, janë përgjegjës për programimin dhe ekzekutimin e shpenzimeve për realizimin e aktivitetit të tyre dhe disiplinën financiare që garanton ligjshmërinë dhe përputhshmërinë me kuadrin ligjor buxhetor të nxjerrë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, por Drejtimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit të treguesve fiskal.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse treguesit fiskalë të raportuar nuk paraqesin anomali materiale, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi përputhshmërinë e hartimit, ekzekutimit, raportimit dhe monitorimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2020, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar.

Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne: Identifikojmë dhe përpunojmë riskun e anomalive materiale, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikojmë dhe kryejmë procedura auditimi sipas risqeve të identifikuar, dhe grumbullojmë evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë. Risku që vjen nga mos identifikimi i këtyre anomalive për shkak të mashtrimeve, është më i lartë se ai i gabimeve, sepse mashtrimi mund të përfshijë falsifikime, fshirje të qëllimshme, keqinterpretime, apo edhe mungesë të qëllimshme të kontrollit të brendshëm.

Krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale, por jo duke paur si qëllim kryesor dhënien e një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Krijojmë një konkluzion final nëse çështjet rutine të raportimit të treguesve fiskalë janë kryer në mënyrën e duhur dhe bazohemi në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çojnë në një dyshim edhe më të madh mbi aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht. Nëse ne arrijmë në konkluzionin se ekziston një pasiguri e arsyeshme, ne duhet të kushtojmë më tepër rëndësi këtyre çështjeve gjatë auditimit tonë, dhe të modifikojmë opinionin. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese dhe standartet e auditimit ISSAI, megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të institucionit.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Ne komunikojmë me drejtuesin nëse, ndër çështjet e tjera, planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit dhe gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë në lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 ÷Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSHö, në zbatim të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 514/1, datë 14.05.2021, në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, nga data 17.05.2020 deri në 13.08.2020, për periudhën nga 01.01.2020 deri në 31.12.2020, u krye auditimi i përputhshmërisë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë -Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. V. G., Përgjegjëse Grupi
2. R. G., Auditues
2. H. S., Auditues
4. B. D., Auditues
5. J. T., Auditues

Objektivat dhe qëllimi i auditimit: Ky auditim përputhshmërie ka për qëllim dhënien e opinionit mbi përputhshmërinë të veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit lidhur me zbatimin e kuadrit rregullator në realizimin e ciklit buxhetor. Vlerësimin objektiv, profesional e të pavarur të përputhjes së veprimeve procedurale, administrative me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi në lidhje me hartimin, miratimin, ndryshimet, monitorimin dhe raportimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2020.

Identifikimi i çështjes: Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit pranë MFE, për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2020 deri më datë 31.12.2020. Kjo drejtori ka si mision planifikimin dhe menaxhimin me ekonomi, eficientë dhe efektivitet të shpenzimeve publike. Funksionet kryesore të saj janë: Përgatitja e buxhetit të shtetit, menaxhimi dhe monitorimi i buxhetit, kryerja e analizave për shpenzimet publike dhe zhvillimi i politikave buxhetore, të llogarisë dhe transferojë me drejtësi e transparencë transfertat e buxhetit të shtetit për pushtetin vendor, menaxhimi me efektivitet i të dhënave mbi detyrimet e prapambetura dhe forcimi i disiplinës financiare për parandalimin e akumulimit të tyre në të ardhmen, për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim: Strukturat drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit janë përgjegjëse për menaxhimin e mirë e korrekt të financave publike në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë por pa u kufizuar në Ligjin e Buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin për menaxhimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, Ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin për Huamarrjen dhe aktet nënligjore në zbatim të saj.

Përgjegjësitë e audituesve. Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Kriteret e vlerësimit.

Për kryerjen e këtij auditimi, në lidhje me dhënien e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit lidhur me zbatimin e kuadrit rregullator në realizimin e ciklit buxhetor jemi bazuar në Ligjin e Buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, Ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin për Huamarrjen dhe aktet nënligjore në zbatim të saj, Ligjin për Financat e Vetëqeverisjes Vendore.

Standardet e auditimit.

Auditimi u bazua në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren për Procedurat e Auditimit, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.107 datë 08.09.2017, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit si Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë. Gjithashtu referencë në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Informacioni i përgjithshëm:

Misioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit është planifikimi dhe menaxhimi me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet të shpenzimeve publike.

Funksionet kryesore të kësaj drejtorie janë: Përgatitja e buxhetit të shtetit; Menaxhimi dhe monitorimi i buxhetit; Klasifikimi dhe sistemi buxhetor; Kryerja e analizave për shpenzimet publike dhe zhvillimi i politikave buxhetore; Përgatitja e akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë proceset e planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, si dhe sistemin buxhetor në tërësi, duke shfrytëzuar përvojën më të mirë ndërkombëtare. Të llogarisë dhe transferojë me drejtësi e transparencë transfertat e buxhetit të shtetit për pushtetin vendor, të mbështesë dhe plotësojë me aktet e nevojshme ligjore, decentralizimin fiskal, duke synuar rritjen e të ardhurave, rritjen e efikasitetit të përdorimit të fondeve publike për pushtetin vendor. Monitorimi dhe raportimi i i



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

detyrimeve të prapambetura dhe forcimi i disiplinës financiare për parandalimin e akumulimit të tyre në të ardhmen, për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:

Në këtë angazhim auditimi të Kontrollit të Lartë të Shtetit, fokusi kryesor është vlerësimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Baza Ligjore:

Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 òPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;

Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar;

Ligjin nr.68/2017 datë 18.05.2017 òPër Financat e Vetëqeverisjes Vendore;

Ligjin nr.88/2019 datë 18.12.2018 òPër Buxhetin e Vitit 2020;

Udhëzimin nr.9 datë 20.07.2018 òPër Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit;

Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 òPër Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm;

Udhëzimin nr.22, datë 17.11.2016 òPër Procedurat Standarte të Monitorimit të Buxhetit për Njësitë e Qeverisjes Qendrorë;

Udhëzimin nr.1, datë 17.01.2019, òPër Zbatimin e Buxhetit 2019;

Udhëzimin nr.8, datë 28.02.2019 òPër Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022;

Udhëzimin nr.37 datë 6.10.2020 òPër Monitorimin dhe Publikimin periodik të Stokut të Detyrimeve të Prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme;

-Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2019-2022;

-Urdhri e Kryeministrit nr.89 datë 13.06.2018 òPër miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit;

Rregulloren e Brendshme të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Drejtimet kryesore të auditimit:

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në Programin e Auditimit 514/1, datë 14.05.2020, si më poshtë vijon.

Rezultatet e auditimit sipas pikave të programit paraqiten në vijim:

1. Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe kuadrit rregullator në fuqi lidhur me ciklin buxhetor. Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit me Drejtoritë në varësi të saj në funksion të arritjes së menaxhimit të kujdesshëm të ciklit buxhetor. Nxjerrja e akteve të nevojshme nënligjore për zbatimin e buxhetit për ministritë dhe institucionet buxhetore. Monitorimi i treguesve të Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike lidhur me veprimtarinë e kësaj drejtorie.

Baza ligjore

Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 òPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;

Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar;

Ligji nr.68/2017 datë 18.05.2017 òPër Financat e Vetëqeverisjes Vendore;

Ligji nr.88/2019 òPër buxhetin e vitit 2020;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT **RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E** **PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE** **EKONOMISË**

Ligji nr. 22/2018 ÷Për Strehimin Social÷;

Udhëzimi nr.7, datë 28.02.2018 ÷Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm÷;

Udhëzimi plotësues nr.28, datë 10.07.2020 ÷Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023÷;

Udhëzimi nr.22, datë 17.11.2016 ÷Për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit për Njësitë e Qeverisjes Qendrorë÷;

Udhëzimi nr.9 datë 20.07.2018 ÷Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit÷;

Udhëzimi nr. 2, datë 20.01.2020 ÷Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020÷;

Udhëzimi plotësues nr.26, datë 08.07.2020 ÷Për një shtesë dhe disa ndryshime në udhëzimin plotësues nr.2, datë 20.01.2020 ÷Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020÷;

Udhëzimi plotësues nr.2/1, datë 21.09.2020 ÷Për një shtesë në udhëzimin plotësues nr.2, datë 20.01.2020 ÷Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020, të ndryshuar÷;

-Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020;

-Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2019-2022;

-Urdhri i Kryeministrit nr.89 datë 13.06.2018 ÷Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit÷;

- Urdhrin nr. 53, datë 10.03.2021 i Ministrit të Financave për miratimin e Rregullores së Brendshme të MFE÷

-Etj.

Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit me Drejtoritë në varësi të saj në funksion të arritjes së menaxhimit të kujdesshëm të ciklit buxhetor.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit ka funksionuar sipas strukturës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.89 datë 13.06.2018 *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit”*, ku ajo është përcaktuar me 5 drejtori dhe 39 nëpunës. Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit ka si mision planifikimin dhe menaxhimin me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet të shpenzimeve publike, mision ky i realizuar sipas funksioneve të mëposhtme:

1. Përgatitja e buxhetit të shtetit;

2. Menaxhimi dhe monitorimi i buxhetit;

3. Klasifikimi dhe sistemi buxhetor;

4. Kryerja e analizave për shpenzimet publike dhe zhvillimi i politikave buxhetore;

5. Përgatitja e akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë proceset e planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, si dhe sistemin buxhetor në tërësi, duke shfrytëzuar përvojën më të mirë ndërkombëtare.

6. Të llogarisë dhe transferojë me drejtësi e transparencë transfertat e buxhetit të shtetit për pushtetin vendor, të mbështesë dhe plotësojë me aktet e nevojshme ligjore, decentralizimin fiskal, duke synuar rritjen e të ardhurave, rritjen e efikasitetit të përdorimit të fondeve publike për pushtetin vendor.

7. Shlyerja e detyrimeve të prapambetura. Menaxhimi me efektivitet i të dhënave mbi detyrimet e prapambetura dhe forcimi i disiplinës financiare për parandalimin e akumulimit të tyre në të ardhmen, për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Organigrama aktuale e Drejtorisë paraqitet si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

Figura 1: Organigrama e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Dhjetor 2020.

Nga auditimi konstatohet se pas miratimit të strukturës së institucionit me Urdhrin nr.89 datë 13.06.2018 të Kryeministrit, përgjatë vitit 2020 nuk është rishikuar Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për rrjedhojë edhe e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit. Rregullorja e Brendshme miratuar me Urdhrin nr.17 datë 29.01.2016 të Ministrit (në fuqi përgjatë kësaj periudhe) nuk ka parashikuar një sërë pozicionesh të krijuara me strukturën e re, dhe paraqitet në mospërputhje me nenet 8 dhe 9 të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar. Ministria e Financës dhe Ekonomisë ka miratuar rregulloren e re me urdhrin nr. 53, datë 10.03.2021. Në këtë dokument janë përshkruar detyrat, misioni dhe objektivat e Drejtorive të Përgjithshme, Drejtorive dhe Sektorëve të institucionit, duke mos u detajuar deri në detyrat specifike e funksionet që do të mbulojnë punonjësit sipas pozicioneve të tyre.

Deri në fund të vitit 2020, në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit kanë rezultuar **2 vakanca**, përkatësisht 1 përgjegjës sektori dhe një specialist; gjithashtu 2 pozicione të tjera janë plotësuar nga punonjës me kontrata pune deri në 31.12.2020. Grupi i auditimit kërkoi informacion pranë subjektit nëse janë shpallur këto vakanca për të kryer procedurat respektive të rekrutimit nga Departamenti i Administratës Publike për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, për të cilin nuk u dha informacion. Në zbatim të urdhrin nr.5151 datë 28.10.2015 për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil, nga informacioni i vendosur në dispozicion rezultoi se nuk ka patur asnjë vendim gjyqësor të pa ekzekutuar për ish punonjësit e kësaj drejtorie.

Në regjistrin e riskut të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit konstatohen sërisht problematikat e trajtuara në auditimin e mëparshëm. Ky dokument i referohet risqeve vetëm për 2 Drejtori nga 5 të DPB (konkretisht Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor dhe Drejtorinë e Menaxhimit të Buxhetit) dhe risqet e adresuara janë të përditësuara vetëm për Drejtorinë e Menaxhimit të Buxhetit. Pjesa tjetër e risqeve i referohet periudhave të mëparshme duke mos qenë risqe relevante të lidhura me periudhën objekt auditimi.

Drejtorinë e Strehimit, si pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit

Pas ristrukturimit të ministrive në vendim nr. 503, datë 13.9.2017 të Kryeministrit “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” dhe me urdhrin nr. 89/2018 të Kryeministrit për miratimin e organikes dhe strukturës së MFE Drejtoria e Strehimit është bërë pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në MFE. Në vijim të



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

këtij ndryshimi, konstatohet se nuk është rishikuar rregullorja e brendshme e MFE, në mënyrë që misioni dhe objektivat e punës së drejtorisë të bëhen pjesë e saj. Si rezultat përgjatë vitit 2020 drejtorja ka operuar në mungesë të akti rregullativ për veprimtarinë e saj. Gjithashtu, për një pjesë të konsiderueshme kohore (2018-2020), struktura e kësaj ka qenë e paplotësuar, situatë kjo që është përmirësuar gjatë vitit 2021.

Misioni i Drejtorisë së Strehimit është të sigurojë bazën ligjore, financiare dhe institucionale për përmirësimin e kushteve të banimit, rritjen e aksesit në strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm dhe përmirësimin dhe mirëmbajtjen e banesave dhe vendbanimeve urbane. Ky mision i drejtorisë synon të realizohet nëpërmjet objektivave të punës si më poshtë:

- të mbështesin, të zbatojnë dhe të përshtatin objektivat e qeverisë në politika e programe për strehimin;
- të zhvillojnë politika, strategji dhe programe strehimi që mbështesin zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, të cilat synojnë:
- përmirësimin e kushteve të jetesës për shtresat e varfra dhe të marginalizuara, përmes financimit të programeve sociale të strehimit
- rritjen e aksesit në strehim të rinjve dhe shtresës së mesme të shoqërisë;
- zhvillimin e mekanizmave financiar të strehimit dhe partneritetet midis sektorit shtetëror e atij privat bankar e ndërtues për sigurimin e ofertave të përbalueshme;
- nxitjen e programeve të ripërtëritjes urbane dhe mirëmbajtjes së banesave
- të përmirësojnë performancën e njësisë të ngarkuara me zbatimin e këtyre politikave lidhur me eficiencën dhe efektivitetin e përdorimit të fondeve dhe arritjen e grupeve të synuara.

Ministria e Financës dhe Ekonomisë ka miratuar rregulloren e re me urdhrin nr. 53, datë 10.03.2021. Sipas këtij dokumenti misioni i Drejtorisë së Strehimit është të sigurojë bazën ligjore, financiare dhe institucionale për përmirësimin e kushteve të banimit, rritjen e aksesit në strehim të përshtatshëm, dhe të përbalueshëm dhe përmirësimin dhe mirëmbajtjen e banesave dhe vendbanimeve urbane. Ndër detyrat e saj përfshihen:

- Hartimi i strategjisë kombëtare të strehimit, politikave dhe kuadrit ligjor;
- Planifikimi i fondeve për mbështetjen e programeve të strehimit;
- Krijimi i bazë së të dhënave në nivel kombëtar, bazuar në informacionet e njësisë të vetëqeverisjes vendore;
- Asistencë teknike për fushën e projektimit dhe ndërtimit për programe strehimi;
- Mbikëqyrje e realizimit të investimeve në programet sociale të strehimit;
- Etj.

Drejtorja e Strehimit, pjesë e strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, planifikon fondet për Programin e Strehimit (06190), duke përcjellë më pas propozimet për fondet që i nevojiten këtij programi pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, e cila është më pas përgjegjëse për menaxhimin në tërësi të procesit të përgatitjes së dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm dhe projektligjit të buxhetit vjetor në përputhje me politikat dhe prioritetet e Qeverisë. Pas miratimit të buxhetit për programin e strehimit, Drejtorja e Strehimit kryen shpërndarjen e fondeve në njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas produkteve. Përgjatë vitit, kjo drejtori (varësi e DPB) monitoron ekzekutimin e buxhetit në programin e strehimit dhe përcjell pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit kërkesat për rialokim të fondeve sipas nevojave.

Drejtorja e Strehimit për hartimin e kërkesave buxhetore për PBA mbështetet në Strategjinë Sociale të Strehimit 2016-2025. Megjithatë, niveli i financimit aktual për mbulimin e nevojave



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

financiare në programet sociale të strehimit rezultojnë ulët, krahasuar me objektivat e parashikuara në Strategjinë për Strehimin Social. Sipas një draft- vlerësimi të ndërmjetëm të zbatimit të strategjisë, për periudhën 2016-2025 sipas strategjisë janë planifikuar të alokohen fonde në vlerë rreth 5.66 miliard lekë për programe strehimi, subvencione, grante dhe investime në fushën e strehimit. Niveli i realizimit të shpenzimeve për këtë periudhë rezultojnë rreth 5.4 miliard lekë, pra në dukje kemi të bëjmë me një tejkalim të fondeve të parashikuara në strategji, por faktikisht strategjia e miratuar nuk ka marrë në konsideratë situatat e jashtëzakonshme sikundër ishte ajo e tërmetit. Nëse analizojmë fondet e alokuara, pa përfshirë ato të alokuara përgjatë vitit 2020 për subvencionimin e qerave të familjeve të prekura nga tërmeti dhe shpronësimet në vijim të programit të rindërtimit, fondet për financimin e programeve të strehimit në zbatim të strategjisë rezultojnë vetëm 2.44 miliard lekë, pra është arritur vetëm 43% e objektivave të strategjisë në drejtim të buxhetit në fushën e strehimit.

Në mijë lekë

Periudha 2016-2020	Fondet e planifikuara për OS5 (2016-2025)	Investimet dhe subvencionet (2016-2020)
Programet e strehimit	2,176,434	1,161,262
Subvencione dhe grante	3,484,317	4,237,507
Totali	5,660,751	5,398,769
<i>Nga të cilat, subvencionim i qirasë për familjet e prekura nga tërmeti dhe pronarë të shpronësuar në zbatim të programit të rindërtimit në bashkinë Laç</i>		2,955,439
Totali i fondeve të strehimit pa përfshirë produktet e lidhura me tërmetin		2,443,330

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Strehimit

Sipas PBA 2020-2022, niveli i shpenzimeve për vitin 2020 është planifikuar i njëjtë me atë të vitit 2019 (për çdo vit 630 milion lekë), ku vetëm shpenzimet kapitale janë planifikuar 100 milion lekë më pak se viti paraardhës (duke përfshirë vetëm projektet e investimit ekzistuese). Më hollësisht, duke mos marrë në konsideratë 1 miliard lekë të alokuara si mbështetje për strehimin e personave të prekur nga tërmeti, në fazën e projekt buxhetit janë kërkuar nga Drejtoria e Strehimit për këtë program 630 milion lekë, dhe janë alokuar 629 milion lekë, pra alokimi i fondeve paraqitet pothuajse në kufirin e planit në projektbuxhet. Ndërkohë që në alokimin e fondeve nuk janë marrë në konsideratë projektet e reja të propozuara nga DS në hartimin e projektbuxhetit (378,066 mijë lekë) përcjellë nga Drejtoria e Strehimit ato paraqiten si projekte në anekset sipas Formularëve të Propozimit të Projektit të Investimit (FPPI).

Buxheti i propozuar nga Drejtoria e Strehimit në fazën e PBA, ai i çelur me Ligjin e Buxhetit, shtesat dhe pakësimet përgjatë vitit (ku duhet theksuar se për shkak të situatës së krijuar nga tërmeti i Nëntorit të vitit 2019, një pjesë e fokusit të këtij programi është drejtuar në projektin e sistemimit të personave të prekur nga ky tërmet dhe akomodimit të tyre) paraqiten si më poshtë:

Në mijë lekë

Programi Strehimit	PBA 2020-2022, viti 2020			Plani fillestar			Plani rishikuar		
	Shpenzime korrente	Shpenzime kapitale	Total	Shpenzime korrente	Shpenzime kapitale	Total	Shpenzime korrente	Shpenzime kapitale	Total
	380,000	628,066	1,008,066	1,309,000	320,000	1,629,000	3,230,359	354,963	3,585,322

Në nivel produkti, fondet e planifikuara dhe akorduara për Programin e Strehimit rezultojnë si më poshtë:

Në mijë lekë

Programi Strehimit	PBA 2020-2022	Ligji	AN6	VKM nr.359 dt 4.5.2020	AN. 28	Rialokime	AN 34	Plani i rishikuar	Realizimi
91010AE Subvencionim i		1,000,000	1,000,000		900,000		45,604	2,945,604	2,893,793



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

	qirasë për familjet e prekura nga tërmeti								
91010AC	Bonusi i qerasë	72,622	90,000			10,000	(12,123)	87,876	84,994
91010AA	Kredi ekzistuese	212,979	108,000			50,000	(4,389)	153,610	153,606
91010AB	Kredi të reja	84,399	100,000			(60,000)	(39,974)	25	12
91010AD	Grant i menjëhershëm	10,000	11,000				(10,767)	232	232
91010AF	Pronarë të shpronësuar në zbatim të programit të rindërtimit në Bashkinë Laç				43,009			43,009	13,275
Total shpenzime korrente (A)		380,000	1,309,000	1,000,000	43,009	900,000	(21,650)	3,230,359	3,145,915
Projekte ekzistuese									
M100399	Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit	170,000	240,000			(31,487)	31,655	240,168	239,361
M100397	Rikonstrukcion i godinave në pronësi të njëjësive të vetëqeverisjes vendore	80,000	80,000			31,487	3,307	114,794	114,794
M100522	Banasa me kosto të ulët	-							
Projekte të reja			0						
Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit		90,000							
Streha tranzitore		57,066							
Banasa të blera në treg		230,000							
Trajnim për sistemin e banesave		1,000							
Total shpenzime kapitale (B)		628,066	320,000				34,963	354,963	354,155
Total shpenzime (A)+(B)		1,008,066	1,629,000	1,000,000	43,009	900,000	0	3,585,322	3,500,071

Sikundër vërehet edhe nga tabela e mësipërme, niveli më i lartë i fondeve është akorduar për subvencionimin e qerasë për familjet e prekura nga tërmeti (rreth 82% e totalit). Për vitin 2020 nga Programi i Strehimit nuk është realizuar asnjë shpenzim në kuadër të subvencionimit të kredive të reja, pasi edhe për shkak të pandemisë afatet për nënshkrimin e këtyre kontratave janë shtyre në kohë dhe fondet e planifikuara për këtë produkt deri në fund të vitit janë rishpërndarë në produkte të tjera. Për sa i përket projekteve të investimit, janë akorduar fonde vetëm për 2 projekte në vazhdim në vlerë totale rreth 354 milion lekë, duke mos përfshirë në buxhetin e vitit 2020 projekte të reja investime, apo projektin në vazhdim banesa me kosto të ulët (M100522).

Ndryshimet në planin e rishikuar të buxhetit të vitit 2020

1. Në zbatim të aktit Normativ nr. 6, datë 21.03.2020, përcjellë me shkresën nr. 5815/1, prot datë 27.03.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm për Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, dhe me shkresën nr. 5800/15, prot datë 2.4.2020 për Drejtorinë e Strehimit, janë rritur me 1,000 milion lekë fondet në produktin 91010AE ÷Subvencionimi i pagesës së qerasë për familjet e prekura nga tërmeti.

2. Në zbatim të Aktit Normativ nr. 28, datë 02.07.2020, përcjellë me shkresën nr. 12507/46, prot datë 10.07.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm për Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, janë rritur me 900 milion lekë fondet në produktin 91010AE ÷Subvencionimi i pagesës së qerasë për familjet e prekura nga tërmeti.

Përpara këtij akti, me shkresat nr. 11.05.2020 dhe 11.06.2020 të Drejtorisë së Strehimit është përcjellë informacion mbi përdorimin e fondeve të planifikuara për subvencionimin e qerasë, duke përcaktuar edhe diferencën me rreth 880 milion lekë që do të nevojitet të alokohet për 4 mujorin e fundit të vitit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

-Me shkresën e datës 23.10.2020 të Drejtorisë së Strehimit është informuar Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit për përfundimin e afati 1 vjeçar përcaktuar në Aktin Normativ nr.8, datë 7.12.2019. Për shkak të për shumicën e familjeve të pastreha procesi i rindërtimit ende nuk ka nisur, janë parashtruar dy alternativa:

1. Rishikimi i Aktit Normativ ku periudha e pagesës së subvencionimi të shtyhet deri në momentin kur familjeve do u rikonstruktohet banesa.

2. Në aktin normativ, përveç shtyrjes së afatit, masa e subvencionimit të jetë në varësi të ardhurave dhe të llogaritjet sipas VKM nr. 362, datë 29.05.2019 òPër kriteret e dhënies së subvencionimit të qerasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qerasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij.

-Më aktin normative nr. 37 òPër një ndryshimin në aktin normative nr. 8, datë 07.12.2019 të Këshillit të Ministrave òPër përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qerasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019 është ndryshuar neni 7 duke zgjatur subvencionimin e qerasë deri në momentin që familjeve u rindërtohen apo rikonstruktohen banesat që janë shembur ose deklaruar si të pa banueshme.

3. Me shkresën nr. 23645, datë 21.12.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm janë përcjellë ndryshimet e aktit normativ nr. 34, datë 16.12.2020. Si rezultat i këtij rishikimi janë pakësuar fondet në produktin 91010AE janë shtuar me rreth 45 milion lekë; fondet në produktin 91010AC janë pakësuar me rreth 12 milion lekë; fondet në produktin 91010AA janë pakësuar me rreth 4 milion lekë; fondet në produktin 91010AB janë pakësuar me rreth 40 milion lekë; fondet në produktin 91010AD janë pakësuar me rreth 10 milion lekë.

Rishpërndarja e fondeve nëpërmjet zërave të shpenzimeve korrente

-Me shkresën e datës 4.08.2020, Drejtoresha e Drejtorisë së Strehimit ka përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit kërkesa për kryerjen e rishpërndarjes së fondeve prej 10 milion lekë nga produkti 91010AB òSubvencionimi i kredive të reja ò në produktin 91010AC òSubvencionimi i qerasë në treg të lirë. Fondet fillestare në këtë produkt (75 milion lekë) janë shpërndarë për bashkitë që kanë zbatuar afatet e përcaktuara në udhëzimin nr. 31, datë 18.11.2019 òPër procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret e përfitimit të fondeve nga buxheti i shtetit për programet e Strehimit. Në këto bashki nuk përfshihen bashkia Tropojë, Përrenjas dhe Cërrik që nuk kanë respektuar afatet, po kanë kërkuar mbështetje buxhetore për produktin e subvencionimit të qerasë në treg të lirë.

-Me shkresën e datës 07.08.2020, Drejtoresha e Drejtorisë së Strehimit ka përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit kërkesa për kryerjen e rishpërndarjes së fondeve prej 50 milion lekë nga produkti 91010AB òSubvencionimi i kredive të reja ò në produktin 91010AA òKredi ekzistuese. Shkak për këtë rishpërndarje ka qenë rritja e interesave të bonove të thesarit nga viti i kaluar, dhe mos realizimi i fondeve të alokuara për kreditë e reja pasi afatet e aplikimit për këto kredi janë zgjatur për shkak të pandemisë.

Miratimi i dy shkresave të mësipërme është kryer me shkresën nr. 15064/1, prot datë 13.08.2020.

Subvencionimi i qerasë nga tërmeti

Në vijim të Aktit normativ nr. 8, datë 07.12.2019 janë përcjellë nga bashkitë e prekura nga tërmeti shkresat si më poshtë për fondet që do u nevojiten dhe numrin e banesave që do të nevojiten për pagesat e qerave dhe financimi i nevojshëm:

Nr	Bashkia	Nr. Banesave	Vlera e qerasë	Shkresa
1	Shijak	1854	390,636,000	Shkresa nr. Prot në MFE të 06.01.2020



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

2	Vorë	mbi 1000	222,000,000	Shkresa nr.23222 prot në MFE datë 17.12.2019
3	Durrës	2500	700,000,000	Shkresa nr.22732 prot në MFE datë 11.12.2019
4	Lezhë	173	30,729,600	Shkresa nr.1098 prot në MFE datë 20.01.2020
5	Mirditë	75	13,166,400	Shkresa nr.22412/2 prot në MFE datë 13.02.2020
6	Krujë	2000	360,000,000	Shkresa nr.24151 prot në MFE datë 26.11.2019
7	Tiranë	1542	635,880,000	Shkresa nr.22388/1 prot në MFE datë 12.12.2019
8	Kavajë		46,800,000	Shkresa nr.23326/1 prot në MFE datë 23.12.2019
9	Kurbin	1500	251,000,000	Shkresa nr.22412/1 prot në MFE datë 30.12.2019
10	Rrogozhinë	63	6,984,000	Shkresa nr.507 prot në MFE datë 13.01.2020
11	Kamëz	73	11,388,000	Shkresa nr.102 prot në MFE datë 7.12.2020
Total			2,668,584,000	

1. Me shkresën e datës 06.01.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MFE, konceptuar dhe miratuar nga Drejtoria e Strehimit është përcjellë për Ministrin e Financave dhe Ekonomisë informacioni mbi kërkesat e ardhura nga bashkitë për subvencionimin e qerasë së familjeve të prekura nga tërmeti i datës 26.11.2019. Mbështetja financiare në bazë të këtyre kërkesave (9 bashki, ku mungon informacioni për bashkinë Shijak dhe Mirditë) rezultojnë në vlerën 2,264,674,400 lekë. Në këtë shkresë është evidentuar edhe fakti se fondi në dispozicion bazuar në aktin normativ nr.8, datë 17.12.2019 për përdorimin e procedurës së përsheptuar për subvencionimin e pagesës së qerasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019 është 1,000,000,000 lekë, duke plotësuar vetëm 44% të kërkesave.

2. Me shkresën nr. 685, prot datë 15.01.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MFE është përcjellë për Ministrin e Financave dhe Ekonomisë informacioni mbi kërkesat e ardhura nga bashkitë për subvencionimin e qerasë së familjeve të prekura nga tërmeti i datës 26.11.2019. Mbështetja financiare në bazë të këtyre kërkesave (10 bashki, ku mungon informacioni për bashkinë Mirditë) rezultojnë në vlerën 2,623,637,400 lekë për rreth 11,600 familje të prekura. Në këtë shkresë është evidentuar edhe fakti se fondi në dispozicion bazuar në aktin normativ është 1,000,000,000 lekë, duke plotësuar vetëm 38% të kërkesave.

Përgjatë vitit, në kërkesat e përcjella nga bashkitë janë rishikuar fondet e nevojshme për subvencionimin e qerave, dhe për këto nga Drejtoria e Strehimit ka patur një komunikim të vijueshme. Deri në fund të vitit 2020 fondet e alokuara në nivel bashkie për subvencionimin e qerave rezultojnë si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Bashkia	Fonde të alokuara
1	Shijak	167,078
2	Vorë	201,140
3	Durrës	1,180,586
4	Lezhë	68,417
5	Mirditë	16,264
6	Krujë	372,029
7	Tiranë	592,462
8	Kavajë	48,425
9	Kurbin	220,751
10	Rrogozhinë	17,473
11	Kamëz	60,980
Total		2,945,604

Gjithashtu, në kushtet kur programi i rindërtimit vijon të jetë në proces dhe nuk është finalizuar, subvencionimi i qerave për punonjësit e prekur nga tërmeti ka vijuar edhe gjatë vitit 2021.

Mbi zbatimin e parashikimeve të nenit 19 të ligjit 22/2018 për strehimin socialë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Në zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 22/2018 òPër Strehimin Socialò, çdo subjekt privat që pas hyrjes në fuqi të ligjit aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2000 m² ka detyrimin të kalojë pranë bashkisë të paktën 3% të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm në favor të fondit publik të banesave socialeò. Me shkresën nr. 18181 prot datë 10.10.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të MFE është përcjellë pranë bashkive kërkesa për vendosjen në dispozicion të numrit të lejeve të ndërtimit të përcjella nga data 30 Nëntor 2018; sipërfaqen totale ndërtimore të banimit sipas lejes së ndërtimit dhe sipërfaqen që I takon bashkisë dhe numrin e banesave sociale që sigurohen. Në zbatim të kësaj shkrese, është përcjellë informacion përgjatë vitit 2019 nga **vetëm 7 bashki** si më poshtë:

Nr	Bashkia	Nr i banesave
1	Elbasan	3
2	Shkodër	0
3	Lushnjë	0
4	Kuçovë	0
5	Vlorë	0
6	Pogradec	0
7	Berat	0

Me shkresën nr.2904, prot në MFE datë 20.02.2019, Bashkia Tiranë ka përcjellë një kërkesë për informimin lidhur me procedurën që duhet ndjekur lidhur me funksionimin dhe zbatimin e këtij detyrimi. Në përgjigje të saj, nga Ministri i Financave është përcjellë shkresa nr. 2904/1, prot datë 19.03.2019 ku sqarohet se për zbatimin e nenit nr. 19 të ligjit për strehimin social, nuk ka nevojë për hartimin e një akti apo udhëzimi. Megjithatë, bashkëlidhur shkresës, MFE ka përcjellë edhe një metodë orientuese për të ndihmuar bashkinë për zbatimin e këtij kriteri ligjor. Në këtë metodë orientuese, ndër të tjera përcaktohet se nëse sipërfaqja që duhet kaluar në pronësinë e bashkisë nuk përbën dot sipërfaqen e një apartamenti, bashkia mund të kërkojë konvertimin në vlerë leku duke shumëzuar sipërfaqen me vlerat e tregut të banesave apo mund ta akumulojë në formë bonusi duke e njohur si borxh të subjektit ndaj bashkisë, për tu shlyer në objekte të tjera. Në vijim, nuk ka patur një përgjigje nga ana e Bashkisë Tiranë, dhe bashkitë e tjera për sipërfaqet e kaluara na pronësinë e saj sipas lejeve të ndërtimit të dhëna. Për vitin 2020 nuk është përcjellë asnjë informacion nga bashkitë lidhur me këtë çështje.

-Për sa i përket detyrimit për krijimin e një bazë të dhënave në nivel kombëtar bazuar në informacionet e njërive të vetëqeverisjes vendore, si detyrë e Drejtorisë së Strehimit, në zbatim edhe të nënti 72, gërma d dhe neni 73, pika 2 të ligjit nr.22/2018 òPër Strehimin Socialò për:

- nevojat për strehim, me programe sociale strehimi;
- inventarin e banesave sociale me qira, pronë publike;
- kushtet fizike dhe teknike të banesave sociale me qira;
- numrin e familjeve të strehuara me programet sociale të strehimit;
- sipërfaqen e nevojshme të truallit që duhet pajisur me plan zhvillimi dhe infrastrukturë për ndërtim banesash;
- sipërfaqet e trojeve, të pajisura me infrastrukturë për ndërtim banesash;

nga ana e Drejtorisë së Strehimit ka patur një sërë korrespondencash për zbatueshmërinë e këtij kriteri. Kjo për shkak se nenet e mësipërme parashikojnë se baza e të dhënave do të hartohet sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për strehimin (MFE), në një kohë ku Vendimi nr. 673, datë 12.07.2017 òPër riorganizimin e AKSH-it..ò ka përcaktuar se AKSHI ngre/instalon , etj vetëm nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave. Sipas përgjigjes nga AKSH-i është bërë me dije se që një



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

databazë të quhet shtetërorë duhet të ngrihet me ligj ose VKM, dhe interpretimi i pikës d të nenit 72 të ligjit ngarkon MFE nëpërmjet Drejtorisë së Strehimit krijimin e regjistrit kombëtar dhe jo ngritjen e databazës shtetërore. Për këtë është kërkuar mendim në Drejtorinë Juridike në fund të muajit Korrik 2021, për të cilat ende nuk është marrë përgjigje deri në fund të periudhës audituese në terren. Aktualisht, sipas aplikimit në e-albania për të aplikuar në programet e sistemit, parashikohen që të dhënat e vendosura nga aplikanti të përpunohen dhe administrohen në bazën e të dhënave, por në kushtet kur nga ana e disa qytetarëve është i vështirë ky lloj aplikimi, hedhja e të dhënave online duhet të bëhet nga bashkia përgjegjëse. Në mënyrë që të përfshihen të dhënat në nivel kombëtar dhe vendor, duke përcaktuar si përgjegjës për administrimin e tij Drejtorinë e Strehimit dhe NJVV, nga ana e Drejtorisë së Strehimit është përcjellë në vitin 2021 një draft projekt udhëzimi për bazën e të dhënave të strehimit social, por ende i pa miratuar. Si rezultat i sa më sipër ende nuk është mundësuar krijimi i këtij regjistri.

Nxjerrja e akteve të nevojshme nënligjore për zbatimin e buxhetit për ministrinë

Në përgjigje të kërkesës së grupit të auditimit për përcjelljen e informacioneve lidhur me aktet ligjore dhe nënligjore për zbatimin e buxhetit të nxjerra nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, informacioni i vendosur në dispozicion ka detajuar udhëzimet e nxjerra nga Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, si më poshtë:

- Udhëzimi plotësues nr. 2, datë 20.01.2020, *“Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”*.
- Udhëzimi nr. 26, datë 8.07.2020, *“Për një shtesë në udhëzimin plotësues nr. 2, datë 20.01.2020 ‘Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020’*.
- Udhëzimi nr. 2/1, datë 21.09.2020, *“Për një shtesë në Udhëzimin Plotësues nr. 2, datë 20.01.2020 ‘Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020’*”.
- Udhëzimi nr. 37, datë 6.10.2020, *“Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme*.

Udhëzimet e përbashkëta me ministrinë/institucionet

- Udhëzim i përbashkët me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, nr. 4, date 25.02.2020, *“Për mënyrën e përdorimit të fondit ‘Grand / Transferte korrente e brendshme’, për Federatat Shqiptare Sportive dhe Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe sistemin e pikëzimit të kritereve prioritare të vlerësimit”*.
- Udhëzim i përbashkët me MBZHR, nr. 3, datë 24.02.2020 *“Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”* për vitin 2020.
- Udhëzim i përbashkët me Ministrinë e Drejtësisë Nr.22, datë 20.10.2020 *“Për përcaktimin e tarifave të shpërblimit të noterit për kryerjen e veprimeve dhe akteve noteriale”*.
- Udhëzim i përbashkët me Ministrinë e Drejtësisë nr. 21, date 14.10.2020 *“Për disa ndryshime në ‘Udhëzimin e përbashkët nr. 8451/4, datë 05.01.2015 ‘Për caktimin e çmimit dhe tarifave të botimeve të Qendrës së Botimeve Zyrtare, si dhe institucionet që përfitojnë falas kopje të botuara të Fletore Zyrtare’”*.
- Udhëzim i përbashkët me Ministrinë e Drejtësisë nr.12, date 21.07.2020 *“Për përcaktimin e numrit të faqeve për të cilat informacioni përfitohet falas, rastet e përjashtimit nga tarifa, si dhe rregulla për mënyrën e kryerjes së pagesës për pajisjen me informacion që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike”*.

Nga vlerësimi i disa prej udhëzimeve ekzistuese lidhur me procedurat për zbatimin e buxhetit u



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

konstatua se:

-Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 òPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 48 i tij òAfatit për rishpërndarjen e fondeve buxhetore, përcakton se ò*E drejta e njësisive të qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve, të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri në datën 15 nëntor të çdo viti buxhetor.* Nëse i referohemi afatit të përcaktuar në udhëzimin nr.9 datë 20.07.2018 òPër Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit, pika 76 e tij përcakton se “ *E drejta e njësisë së qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri në datën 15 nëntor të çdo viti, e cila konsiderohet data e fundit e paraqitjes së kërkesës tek Nëpunësi i Parë Autorizues.* Në kuptim të kësaj pike, çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme mund të kryejë rishpërndarje të fondeve të miratuara me kusht që kërkesa nga ana e tyre të jetë inciuar dhe dorëzuar tek NPA përpara datës 15 Nëntor, ndërkohe që përcaktimi në ligj i referohet datës së fundit ku mund të ushtrohet e drejta për rishpërndarje të fondeve nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në dallim me përcaktimin në udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018 ku data 15 nëntor i referohet datës së fundit kur mund të përcillet kërkesa për rishpërndarje pranë NPA. Si rezultat, rishpërndarjet e fondeve të njësisive të qeverisjes së përgjithshme janë konstatuar të miratohen dhe reflektohen në SIFQ jo vetëm pas datës 15 Nëntor, por edhe në fillim të vitit pasardhës, me kushtin e vetëm që kërkesa nga njësitë të jetë përcjellë deri në datën 15 Nëntor.

Në të njëjtën linjë si më sipër, neni 51, pika ògö e Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH, përcaktohet se ò*Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor*”. Ndërkohë, udhëzimi për zbatimin e buxhetit, në pikën 83 të tij se “*Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor*”, dhe në aneksin òGjurma Standarte e Auditimit për Ekzekutimin e Shpenzimeve 2/5 përcakton se “*Angazhim, do të thotë ngurtësim i fondeve për shumën e kontratës.*”. VKM nr. 807 datë 16.11.2016 òPër disiplinimin e angazhimeve buxhetore publike, e dalë në zbatim të ligjit, e lidh ndërmarrjen e angazhimeve me publikimin e procedurave të reja të prokurimit, duke përcaktuar në pikën 1 të saj se: ò*Pas dates 15 tetor të çdo viti buxhetor, njësitë e qeverisjes së përgjithshme nuk mund të publikojnë njoftimin për prokurimin e mallrave/punëve/shërbimeve, të cilat nuk janë përfshirë në regjistrin e prokurimeve publike, deri në këtë datë.*”. Pika. 2 e kësaj VKM përcakton se: ò*Pas datës 15 tetor, procedurat e prokurimeve publike, të parashikuara në regjistrin e prokurimeve publike, mund të fillojnë/vazhdojnë vetëm për ato projekte që janë pjesë e buxhetit tre-vjeçar, të miratuar për njësinë përkatëse të qeverisjes së përgjithshme. Lidhja e kontratës në këtë rast bëhet vetëm pasi fondi të jetë vënë në dispozicion në llogarinë e autoritetit kontraktor, në buxhetin e tij, të miratuar për vitin buxhetor pasardhës.*

Udhëzimi nr.22, datë 17.11.2016 òPër Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit për Njësitë e Qeverisjes Qendrorë, përcakton procedurat dhe afatet që duhet të ndjekin njësitë e qeverisjes qendrore gjatë monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e politikës së realizuar për çdo program të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të PBA. Nga auditimi konstatohet se për sa i përket procedurave që duhet të ndjekin të gjitha institucionet e buxhetore të varësisë nga ana e MFE nuk është hartuar një udhëzues i



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

ngjashëm. Si rezultat, mbetet i pa rregulluar procesi i monitorimit të ekzekutimit të buxhetit nga këto njësi, me qëllim vlerësimin e performancës nëpërmjet krahasimit të treguesve faktik me ato të planifikuar, si dhe propozimin e ndërmarrjes së veprimeve korrigjuese për ri alokimin e burimeve, problematikë kjo e konstatuar edhe në auditimet e KLSH pranë tyre. Mungesa e këtyre raporteve të progresit për performancën e objektivave, produkteve dhe shpenzimeve, nuk mundëson sigurimin e informacionit nga ana e njësisve të qeverisjes qendrore eprore ku këto institucione e cila është thelbësore veçanërisht në fondet e investimeve, për të kryer më pas rishikime të fondeve në dispozicion bazuar në ecurisë e implementimit të tyre.

Monitorimi i treguesve të Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike lidhur me veprimtarinë e kësaj drejtorie.

Vizioni i Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike është garantimi i një sistemi të financave publike që nxit transparencën, përgjegjshmërinë, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike për ofrimin e shërbimeve të përmirësuara dhe zhvillimin ekonomik. Objektivi i përgjithshëm i Strategjisë është që të arrijë një buxhet më të mirëbalancuar dhe të qëndrueshëm me një raport të ulur të borxhit nëpërmjet kontrollit dhe menaxhimit më të fortë financiar si dhe me anë të proceseve audituese, dhe ku zbatimi i buxhetit është i lidhur siç duhet me politikat e qeverisë. Strategjia për MFP 2019-2022 ka rishikuar planin e veprimit në afatet e përcaktuar në Strategjinë për MFP 2014-2020. Ajo është e organizuar në objektiva specifike, të cilët përbëhen nga disa komponentë , e më tej zërthehen në produkte konkrete, realizimi i të cilëve, bëhet i mundur nëpërmjet kontributit të secilës strukturë specifike dhe bashkëpunimit midis tyre të përcaktuar në dokumentin e strategjisë, dhe monitoruar nga Komiteti Drejtues i Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike.

Gjatë auditimit është kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në lidhje me 18 produktet e shkëputura nga Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2019-2022 që i përkasin kësaj drejtorie, në lidhje me masat e marra për implementimin e secilit produkt gjatë vitit 2020, dokumentacionin mbështetës si dhe statusin e realizimit të tyre, apo raportin e monitorimit të vitit 2020 nëse është kryer nga Drejtoria e PFM në MFE (në kushtet kur në faqen zyrtare nuk është i publikuar) për të cilat u vendos në dispozicion informacioni vetëm për objektivat që lidhen me Drejtorinë e Menaxhimit të Buxhetit, si më poshtë:

PRODUKTET E STRATEGJISË SË MENAXHIMIT TË FINANCEVE PUBLIKE 2019-2022 PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT			
OBJEKTIVI SPECIFIK 1: KUADËR FISKAL I QËNDRUESHËM DHE I MATUR			
Komponenti 1.2 : Menaxhimi i riskut fiskal			
Produkti	Dr.	Masat e marra 2020 sipas MFE	Realizimi
Produkti 1.2.1: Numri i risqeve fiskale të identifikuar është rritur dhe risqet janë ulur në mënyrë të suksesshme.	DMB	Bazuar në Udhëzimin nr. 2 të Ministrisë së Financave, datë 20.01.2020 "Për Zbatimin e Buxhetit 2020", FRU monitoron dhe përgatit, në baza tremujore (3M), analizat e NSH-ve kryesore. Ky monitorim përqendrohet kryesisht në analizën e performancës financiare dhe jofinanciare të sektorit të energjisë. Këto raporte analitike, të cilat përgatiten rregullisht në baza tremujore, përfshihen në të gjitha raportet periodike të DMB/MoFE, si tek Raporti për zbatimin e buxhetit vjetor, Raporti i mes-vitit, Relacioni i projektbuxhetit. Gjatë vitit 2020, FRU asistuar nga AT e BB-së ka zgjeruar procesin e monitorimit të NSH duke përfshirë në analizat e	Pjesërisht e realizuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

		saj sektori edhe performancën e sektorit të te ujit për vitet e mëparshme 2018 dhe 2019. Lidhur me monitorimin e performancës së NSH-ve për VF2020, FRU është duke mbledhur informacion nga kompanitë e sektorit të energjisë dhe gjithashtu nga UKT, Hekurudhat Shqiptare, Posta Shqiptare, Albgas. FRU monitoron në mënyrë periodike (në baza mujore) performancën financiare dhe jo-financiare të kontratave të koncesionit / PPP me mbështetje buxhetore. Pjesë e Deklaratës së Riskut Fiskal janë edhe detyrimet që vijnë nga vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg, vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit dhe vendimet përfundimtare të gjykatës administrative.	
OBJEKTIVI SPECIFIK 2: PLANIFIKIM I MIRËINTEGRUAR DHE EFIKAS			
Komponenti 2.2: Programi buxhetor afatmesëm			
Produkti	Dr.	Masat e marra 2020 sipas MFE	Realizimi
Produkti 2.2.1: Të vendoset buxhetimi me bazë performancë e të rritet përputhshmëria me metodologjinë e re të sapo prezantuar	DAPB	-	-
Produkti 2.2.2: Nismat për politika të reja të shqyrtuara dhe të financuara;	DAPB	-	-
Produkti 2.2.3: Mbështetja e buxheti në nivel qendror dhe vendor në barazinë gjinore;	DFV	-	-
Produkti 2.2.4: Objektivat e politikave dhe TKP-të përkatëse për secilin program buxhetor janë inkorporuar në ligjin vjetor për buxhetin;	DAPB	-	
Produkti 2.2.5: Cilësi dhe përmbajtje më e mirë e dokumenteve buxhetorë që shkojnë në parlament për aprovim.	DPB	-	
Komponenti 2.3: Planifikimi dhe mbikëqyrja e investimeve publike			
Produkti	Dr.	Masat e marra 2020 sipas MFE	Realizimi
Produkti 2.3.1: Lista e Unifikuar e Projekteve të Miratuara, pavarësisht burimit të financimit, është	DMIP	-	-



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

zhvilluar dhe ruajtur;			
Produkti 2.3.2: Cilësi e rritur e propozimeve për projektet madhorë të investimeve publike që dorëzohen për aprovim;	DMIP	-	-
Produkti 2.3.3: Monitorim i përmirësuar i investimeve publike përfshirë projektet PPP dhe koncesionet.	DMIP	-	-
Komponenti 2.4: MFP-ja në qeverinë vendore			
Produkti	Dr.	Masat e marra 2020 sipas MFE	Realizimi
Produkti 2.4.1: Planifikim strategjik i forcuar dhe menaxhim buxheti në nivel të qeverisë vendore;	DFV	-	-
Produkti 2.4.2: Menaxhim efektiv i të ardhurave;	DFV	-	-
Produkti 2.4.3: Përmirësim i sistemit financiar ndërqeveritar të transfertave;	DFV	-	-
Produkti 2.4.5: Kapacitete të rritura të MFE-së për të menaxhuar reformat e MFP-së në nivelin e qeverisë vendore;	DFV	-	-
OBJEKTIVI SPECIFIK 5: TRANSPARENCA E FINANCAVE PUBLIKE			
Komponenti 5.2: Monitorimi dhe raportimi financiar dhe i performancës			
Produkti	Dr.	Masat e marra 2020 sipas MFE	Realizimi
Produkti 5.2.1: Publikimi i raportit të përmirësuar vjetor për ekzekutimin e buxhetit;	DMB	Përmbajtja e Raportit të buxhetit faktik/ për vitin 2019, është përditësuar sipas udhëzimit dhe asistencës së ofruar nga projekti Ecorys AT.	Realizuar plotësisht
Produkti 5.2.2: Raport i përditësuar për ekzekutimin e buxhetit gjatë vitit, përfshirë raportin e mes vitit për	DMB	Përmbajtja e Raportit të mes vitit për vitin 2020, është përditësuar sipas udhëzimit dhe asistencës së ofruar nga projekti Ecorys AT.	Realizuar plotësisht



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

rishikimin e buxhetit;			
Komponenti 5.3: Angazhimi qytetar			
Produkti	Dr.	Masat e marra 2020 sipas MFE	Realizimi
Produkti 5.3.1: Përgatitja e një udhëzuesi për Buxhetin për Qytetarët;	DAPB	-	-
Produkti 5.3.2: Është përgatitur dhe është vënë në zbatim kalendari për dëgjesat buxhetore me proceset buxhetore kryesore;	DAPB	-	-

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr 8595/33, prot në MFE datë 30.09.2021 dhe në KLSH prot me shkresën nr. 514/21, datë 01.10.2021 “Mbi projektraportin e auditimit”, përcjellë nga Ministri i Financave, znj. D. I., ku janë paraqitur objeksionet si më poshtë sipas drejtorive të MFE:

Pretendimi i subjektit: Nga Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit lidhur me situatën në faqen nr. 26 të projektraportit për sa i përket Udhëzimit nr.9, datë 20.07.2018, është dhënë mendimi se ky përcaktim është bërë për të unifikuar dhe saktësuar momentin e fundit të paraqitjes së kërkesave për rishpërndarje që është data 15 nëntor. përcaktim ky që nuk lë hapësira për të justifikuar rishpërndarjet pas kësaj date. Për këtë mendojmë se në vijim të përcaktimit tonë në këtë udhëzim, në udhëzimin vjetor për zbatimin e buxhetit duhet të bëhet një plotësim për afatin e fundit të rialokimeve që janë në kompetencë të vetë njësisive të qeverisjes qendrore. Gjithashtu edhe lidhur me afatin e fundit kur do të ushtrohet e drejta për ndërmarrje angazhimesh, në ligjin për buxhetin e vitit 2021 është përcaktuar se NJQQ mund të fillojnë procedurën e prokurimit që në muajin nëntor të vitit korrent nëse fondet janë akorduar/regjistruar në sistemin e thesarit për vitet 2021 dhe 2022 me kushtin që lidhja e kontratës të bëhet efektive pas hyrjes së këtij ligji.

Lidhur me konstatimin se nga MFE nuk është nxjerrë udhëzim për procesin që duhet të ndjekin NJQP për vlerësimin e performancës, sqarojmë se udhëzimi nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit për NJQQ” pika 9 përcakton se titullari është kreu i organit qendror të njësisë së qeverisjes qendrore dhe është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Për sa i përket rishikimeve pas datës 15 nëntor, sqarojmë se në kuptim të ligjit ky afat i referohet datës së fundit për ushtrimin e të drejtës për kryerje rishikimi, dhe në zbatim të tij, kjo datë lidhet me afatin e fundit për miratimin dhe reflektimin në sistem të këtij veprimi (pra kur fillon të ushtrohet efekti i rishikimit), pavarësisht se kur ka ardhur kërkesa. Hartimi i një udhëzuesi që përcakton datën 15 si afat të fundit për të përcjellë kërkesën, dhe jo miratimin e saj, lë hapësira për kryerjen e këtyre miratimeve/rishikimeve në sistem edhe deri në fund të vitit, me kushtin e vetëm që ajo të jetë përcjellë brenda datës 15 nëntor.

Për sa i përket udhëzuesit për NJQP, sqarojmë se udhëzuesi i hartuar nga MFE i referohet vetëm NJQQ dhe jo varësive të tyre, dhe për të facilituar procesin e hartimit të udhëzuesve specifik nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

çdo NJQQ për varësitë e tyre, gjykojmë të nevojshme që disa kritere bazë sipas së cilave duhet të rregullohet ky proces të hartohen nga MFE nëpërmjet një udhëzimi apo një guide të posaçme.

Pretendimi i subjektit: Nga Drejtoria e Strehimit lidhur me rekomandimin nr.1, faqe 21 të projektraportit është sqaruar se Drejtoria e Strehimit do të marrë masat për të hartuar një udhëzues për zbatimin e nenit nr. 19, ku deri në këtë moment do t asistojë bashkitë nëpërmjet korrespondencave shkresore siç është vepruar deri tani. Lidhur me rekomandimin nr.2, për diferencimin e shpenzimeve të kryera për tërmetin në programin e strehimit, sqarojmë se e pranojmë rekomandimin; dhe lidhur me rekomandimin nr.3, sqarojmë se në faqen 53-54 të draft vlerësimit të strategjisë së strehimit social 2016-2025 citohet ndër të tjera se niveli i shpenzimeve të raportuara atribuohet gjendjes së tërmetit dhe barrës së lartë financiare...

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Për sa i përket diferencimit të fondeve të alokuara nga tërmeti me të tjera të strehimit, gjykojmë se rekomandimi nr. 3, i referohet paraqitjes në formë tabelore të fondeve të realizuara në programin e strehimit gjatë hartimit të dokumentit të vlerësimit të strategjisë së strehimit social

Titulli i gjetjes:	Problematika të konstatuara në vlerësimin e strukturës dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm të DPB në funksion të arritjes së menaxhimit të kujdesshëm të ciklit buxhetor dhe monitorimit të treguesve të Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike
Situata:	<p>- Me Urdhrin nr.89 datë 13.06.2018 të Kryeministrit është miratuar struktura organizative e MFE, ku Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit paraqitet me 5 drejtori varësie: Drejtoria e Analizës dhe Programit Buxhetor, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike, Drejtoria e Financave Vendore dhe Drejtoria e Strehimit. Nga auditimi konstatohet se pas miratimit të strukturës nuk është rishikuar Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për rrjedhojë edhe e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit. Rregullorja e Brendshme miratuar me Urdhrin nr.17 datë 29.01.2016 të Ministrit (në fuqi për gjatë kësaj periudhe) nuk ka parashikuar një sërë pozicionesh të krijuara me strukturën e re, dhe paraqitet në mospërputhje me nenet 8 dhe 9 të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar. Pjesë e strukturës së DPB është bërë edhe Drejtoria e Strehimit, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e programit të strehimit duke hartuar për gjatë vitit propozimet për hartimin e buxhetit nën këtë program, përcjelljen e kërkesave për rishikim të fondeve të këtij programi gjatë vitit (si për shpenzime operative, subvencionime apo projekte investimi) dhe monitorimin e realizimit të buxhetit. Këto dokumentacione përcillen pranë DPB, e cila nga ana tjetër është përgjegjëse për menaxhimin në tërësi të procedurave lidhur me buxhetin, dhe janë pikërisht drejtoritë e DPB që kryejnë vlerësimet e sipas detyrave dhe përgjegjësi përkatës për procedurat e hartimit, rishikimit dhe monitorimit të buxhetit sipas programeve të miratuara, ku një ndër programet është pikërisht ai i strehimit, i menaxhuar nga një drejtori varësie e DPB.</p> <p>- Në zbatim të Urdhrit nr. 53, datë 10.03.2021 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë është miratuar rregullorja e re e brendshme e institucionit duke përkrahur strukturën, detyrat, misionin dhe funksionet kryesore të Drejtorive të Përgjithshme dhe drejtorive të varësisë së MFE, por pa u detajuar deri në</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

	<p>detyrat specifike e përgjegjësitë që do të mbulojnë sektorët, drejtorët, përgjegjësit apo pjesa tjetër e stafit. Si rezultat, edhe për drejtorët e drejtorive dhe specialistët pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit nuk janë të përshkruara elementë të tillë thelbësore si detyrat apo përgjegjësitë konkrete sipas pozicioneve të tyre.</p> <p>- Nga auditimi konstatohet se në regjistrin për risqet që i përkasin Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit konstatohen sërish problematikat e trajtuara edhe në auditimin e mëparshëm të KLSH. Konkretisht, ky dokument i referohet risqeve vetëm për 2 Drejtori nga 5 të DPB (Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor dhe Drejtorinë e Menaxhimit të Buxhetit) ku risqet e adresuara janë të përditësuara vetëm për Drejtorinë e Menaxhimit të Buxhetit. Pjesa tjetër e risqeve i referohet periudhave të mëparshme duke mos qenë risqe relevante të lidhura me periudhën objekt auditimi.</p> <p>- Nga auditimi u konstatua se në vijim të masave të marra për implementimin e 18 produkteve të shkëputura nga Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2019-2022 që i përkasin Drejtorisë së Përgjithshme e Buxhetit, është përcjellë informacion vetëm për objektivat që lidhen me Drejtorinë e Menaxhimit të Buxhetit, konkretisht 3 produkte. Në kushtet ku nuk është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacionin mbështetës si dhe statusin e realizimit të këtyre produkteve, apo raporti e monitorimit të vitit 2020 nga Drejtoria e PFM pranë MFE (i cili rezultoi i pa publikuar në faqen zyrtare), arrijmë në konkluzionin se për vitin 2020 nuk është ndërmarrë asnjë masë për arritjen e tyre. Risqet që mund të jenë identifikuar gjatë vitit 2020 që kanë çuar më pas në mos realizim (si periudha e tërmetit apo Covidit), nuk janë reflektuar në regjistrin e risqeve për të parashikuar këtu edhe planin e aktiviteteve për periudhën e mbetur të strategjisë.</p>
Kriteri:	Urdhri nr.89 datë 13.06.2018 për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit; Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar; Urdhri nr. 53, datë 10.03.2021 i Ministrit të Financave për miratimin e Rregullores së Brendshme të MFE; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit; Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2019-2022.
Impakti:	Mos përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësiave deri në nivel sektori, drejtori apo specialisti sipas strukturës së MFE; dhe identifikimi/rishikimi i risqeve që çojnë veprimtarinë, nuk mundëson monitorimin e kornizës sipas së cilës planifikohen, zbatohen, kontrollohen dhe raportohen aktivitetet e njësisë në përputhje me misionin e saj. Risk për mos realizimin e produkteve të Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike 2019-2022.
Shkaku:	Mangësitë e identifikuar në hartimin e rregullores së re të MFE dhe regjistrin të riskut; mos ndërmarrja e masave në kuadër të arritjes së objektivave të Strategjisë së miratuar.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	- Ministri i Financave dhe Ekonomisë të analizojë rolin dhe rëndësinë e programit që Drejtoria e Strehimit menaxhon, dhe ekzistencën e një konflikti



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

	<p>të mundshëm në procesin e miratimit të buxhetit për shkak të organigramës aktuale, e cila e cakton këtë drejtori në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit.</p> <p>-Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për plotësimin e Rregullores së Brendshme të institucionit më qëllim reflektimin në të, të disa elementëve thelbësorë si përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive deri në nivelin e drejtorëve, përgjegjësve, specialistëve, etj; sipas strukturës organizative të institucionit, si dhe të rishikojë regjistrin e risqeve duke identifikuar, vlerësuar dhe kontrolluar problematikat koherente të pesë drejtorive në strukturën e saj, në zbatim të ligjit për MFK.</p>
--	---

Titulli i Gjetjes:	Problematika të konstatuara në vlerësimin e Drejtorisë së Strehimit, si pjesë e DPB
Situata:	<p>- Drejtorja e Strehimit, pjesë e strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit menaxhon fondet për Programin e Strehimit (06190), duke hartuar kërkesat buxhetore për PBA-në mbështetur në Strategjinë Sociale të Strehimit 2016-2025. Pas miratimit të buxhetit për programin e strehimit, Drejtorja e Strehimit kryen detajimin e fondeve në njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas produkteve, referuar kërkesave të tyre. Përgjatë vitit, kjo drejtori (varësi e DPB) monitoron ekzekutimin e buxhetit në programin e strehimit, i cili ka përfshirë <u>shpenzime operative</u> për bonusin e qerasë, subvencionimin e kredive ekzistuese, kredive të reja, grant i menjëhershëm; dhe <u>shpenzime kapitale</u> për projektet e investimit për përmirësimin e kushteve të banimit, rikonstruksionin e godinave në pronësi të njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe banesave me kosto të ulët. Në vitin 2020 është shtuar edhe produkti i subvencionimit të qerave të familjeve të prekura nga tërmeti.</p> <p>Konstatohet se niveli aktual i financimit për mbulimin e nevojave financiare në programet sociale të strehimit rezulton të ketë mbuluar deri në fund të vitit 2020, <u>2.44 miliard lekë ose 43% të buxhetit parashikuar në Strategjinë për Strehimin Social 2016-2025</u>, ku rezulton se në vijim të propozimeve të DS gjatë PBA-së, për vitin 2020 janë miratuar fondet vetëm për investimet në vazhdim, dhe jo për projekte të reja. Draft vlerësimi i Strategjisë së hartuar nga Drejtorja e Strehimit është kryer duke përfshirë në realizim edhe fondet e alokuara përgjatë vitit 2020 për subvencionimin e qerave të familjeve të prekura nga tërmeti dhe shpronësimet në vijim të programit të rindërtimit të cilat faktikisht nuk janë marrë në konsideratë në momentin e hartimit të strategjisë. Një analizim i tillë, e paraqet nivelin e realizimit deri në vitin 2020 në masën <u>95% të objektivave planifikuar në harkun 10 vjeçar 2016-2025</u>, ku faktikisht në mënyrë që të jenë të <u>krahasueshëm dhe të mos mbivlerësohen, nuk duhet të përfshijnë fondet e subvencionimit të qerave të tërmetit</u>, të cilat i përkasin një situatë emergjente.</p> <p>Akti normativ nr.8, datë 17.12.2019 <u>ËPër përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qerasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019</u> ka parashikuar fondin sipas produktit 91010AE ËSubvencionim</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

	<p>i qirasë për familjet e prekura nga tërmeti” në Programin e Strehimit prej 1 miliard lekë me afat 1 vjeçar. Nga auditimi konstatohet se në bazë informacionit të vendosur në dispozicion nga bashkitë për kërkesat për subvencionim qeraje në fillim të vitit 2020, ky nivel financim do të mbulonte vetëm 44% të kërkesave. Deri në fund të vitit, pas shtesave të fondeve nën këtë produkt janë alokuar për 13 bashki rreth 2.9 miliard lekë, pra rreth 1.9 miliard më shumë se plani fillestar, dhe gjithashtu është shtyrë periudha e subvencionimit parashikuar me aktin normativ fillimisht për vetëm 1 vit, duke vijuar edhe përgjatë vitit 2021, në kushtet kur ende nuk ka përfunduar rindërtimi i objekteve për sistemimin e qytetarëve të prekura nga tërmeti.</p> <p>- Në zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Socialë, çdo subjekt privat, që pas hyrjes në fuqi të ligjit, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2000 m² ka detyrimin të kalojë pranë bashkisë të paktën 3% të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm në favor të fondit publik të banesave sociale. Për zbatimin e këtij kriteri nga ana e SP të MFE është përcjellë në vitin 2019 shkresa për vendosjen në dispozicion të informacioneve përkatëse, pra për lejet e dhëna mbi 2000 m² dhe sipërfaqet e kaluara në funksion të banesave sociale. Në zbatim të saj, pranë Drejtorisë së Strehimit është përcjellë informacion përgjatë vitit 2019 nga vetëm 7 bashki (nga të cilat vetëm Bashkia Elbasan ka raportuar për 3 banesa sociale në vijim të lejeve të dhëna mbi 2000m²), dhe përgjatë vitit 2020 nga asnjë bashki. Në zbatim të ligjit nuk rezultoi të jetë hartuar një akt apo udhëzimi për të saktësuar procedurat konkrete që do të ndiqen si për efekt përllogaritjes të këtyre banesave që do të kalohen në pronësi të bashkisë, ashtu edhe për raportimin që duhet të kryhet (pra çdo fund viti, apo sa herë jepet një leje e tillë, etj).</p> <p>- Nga auditimi konstatohet se deri në fund të periudhës së auditimit, nuk është hartuar nga Drejtoria e Strehimit një bazë e të dhënave në nivel kombëtar për: nevojat për strehim, me programe sociale strehimi; inventarin e banesave sociale me qira, pronë publike; kushtet fizike dhe teknike të banesave sociale me qira; numrin e familjeve të strehuara me programet sociale të strehimit; sipërfaqen e nevojshme të truallit që duhet pajisur me plan zhvillimi dhe infrastrukturë për ndërtim banesash; sipërfaqet e trojeve, të pajisura me infrastrukturë për ndërtim banesash; bazuar në informacionet e njësisive të vetëqeverisjes vendore, detyrë kjo e përcaktuar në të nenin 72, gërma d dhe neni 73, pika 2 të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Socialë. Për zbatueshmërinë e këtij kriteri Drejtoria e Strehimit nëpërmjet strukturave drejtuese të MFE ka patur një sërë korrespondencash me AKSHI-n dhe Drejtorinë Juridike në MFE dhe Drejtorinë e Strehimit për të saktësuar nëse autoriteti për krijimin e një databaze kombëtare mund të ushtrohet nga ministri me një udhëzim sikundër përcakton ligji, apo ky udhëzim duhet miratuar nga nivele më të larta hierarkike; ku konstatohet se në vijim të cilave ende nuk <u>ende nuk është mundësuar krijimi i këtij regjistri</u> apo miratimi i udhëzimit përkatës i cili do të parashikonte procedurat që do të ndiqen.</p>
Kriteri:	Ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Socialë, Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

	Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar; Ligji nr.88/2019 òPër buxhetin e vitit 2020ò.
Impakti:	Pamundësi për monitorimin nga Drejtoria e Strehimit të zbatimit të kriterit për kalimin e sipërfaqeve për banesat sociale nga bashkitë në kushtet kur nuk përcillet informacion; mos krijimi i regjistrit kombëtar për të dhënat e njësive të vetëqeverisjes rreh 3 vjet pas miratimit të ligjit.
Shkaku:	Mos përcjellja e informacionit nga bashkitë për zbatimin e kriterit ligjor për kalimin e 3% të lejeve të dhëna; Pamundësia për të zgjidhur ngërçin që nuk ka lejuar hartimin e regjistrit kombëtar të të dhënave për njësitë vendore;
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	<p>- MFE të marrë masat për të hartuar një udhëzues për strehimin social duke përcaktuar procedurat konkrete që do të ndiqen për të përllogaritur dhe kaluar në pronësi të bashkive banesat e shërbimit social për lejet e dhëna mbi 2000 m², dhe periodicitetin e raportimit të njësive të vetëqeverisjes vendore për numrin e lejeve të ndërtimit të përcjella nga data 30 Nëntor 2018; sipërfaqen totale ndërtimore të banimit sipas lejes së ndërtimit dhe sipërfaqen që i takon bashkisë dhe numrin e banesave sociale që sigurohen deri në vitin 2021 pranë Drejtorisë së Strehimit në MFE.</p> <p>-MFE, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në drejtorinë juridike të institucionit të marrin masat për zgjidhjen e problematikave që nuk kanë mundësuar deri në këto momente krijimin e një bazë të dhënave në nivel kombëtar bazuar në informacionet e njësive të vetëqeverisjes vendore.</p> <p>-Gjatë hartimit të vlerësimit afatmesëm të Strategjisë së Strehimit, Drejtoria e Strehimit të diferencojë fondet e realizuara në kuadër të tërmetit, me fondet e akorduara për aktivitetin normal të programit të strehimit, në mënyrë që plani i objektivave në hartimin e strategjisë 10 vjeçare të jetë i krahasueshëm me faktin, duke mos e mbivlerësuar këtë të fundit.</p>

Titulli i gjetjes:	Problematika të konstatuara në vlerësimin e kuadrit rregullator në fuqi lidhur me ciklin buxhetor; nxjerrjen e akteve të nevojshme nënligjore për zbatimin e buxhetit për ministritë dhe institucionet buxhetore.
Situata 1:	<p>Nga vlerësimi i kuadrit rregullator në fuqi lidhur me ciklin buxhetor u konstatua se:</p> <p>-Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 òPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 48 i tij òAfati për rishpërndarjen e fondeve buxhetoreò, përcakton se òE drejta e njësive të qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve, të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri në datën 15 nëntor të çdo viti buxhetor.ò Nëse i referohemi afatit të përcaktuar në udhëzimin nr.9 datë 20.07.2018 òPër Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetitò, pika 76 e tij përcakton se “ E drejta e njësisë së qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri në datën 15 nëntor të çdo viti, e cila konsiderohet data e fundit e paraqitjes së kërkesës tek Nëpunësi i Parë Autorizues.ò. Në kuptim të kësaj pike, çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme mund të kryejë rishpërndarje të fondeve të miratuara me kusht që kërkesa nga</p>



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

	<p>ana e tyre të jetë inciuar dhe dorëzuar tek NPA përpara datës 15 Nëntor, ndërkohe që përcaktimi në ligj i referohet datës së fundit ku mund të ushtrohet e drejta për rishpërndarje të fondeve nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në dallim me përcaktimin në udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018 ku data 15 nëntor i referohet datës së fundit kur mund të përcillet kërkesa për rishpërndarje pranë NPA. Si rezultat, rishpërndarjet e fondeve të njërive të qeverisjes së përgjithshme janë konstatuar të miratohen dhe reflektohen në SIFQ jo vetëm pas datës 15 Nëntor, por edhe në fillim të vitit pasardhës, me kushtin e vetëm që kërkesa nga njësitë të jetë përcjellë deri në datën 15 Nëntor.</p> <p>-Në të njëjtën linjë si më sipër, neni 51, pika 6 dhe Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH, përcaktohet se <i>“Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor”</i>. Ndërkohë, udhëzimi për zbatimin e buxhetit, në pikën 83 të tij se <i>“Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor”</i>, dhe në aneksin 6Gjurma Standarte e Auditimit për Ekzekutimin e Shpenzimeve 2/50 përcakton se “Angazhim, do të thotë ngurtësim i fondeve për shumën e kontratës.” VKM nr. 807 datë 16.11.2016 për disiplinimin e angazhimeve buxhetore publike, e dalë në zbatim të ligjit, e lidh ndërmarrjen e angazhimeve me publikimin e procedurave të reja të prokurimit, duke përcaktuar në pikën 1 të saj se: <i>“Pas datës 15 tetor të çdo viti buxhetor, njësitë e qeverisjes së përgjithshme nuk mund të publikojnë njoftimin për prokurimin e mallrave/punëve/shërbimeve, të cilat nuk janë përfshirë në regjistrin e prokurimeve publike, deri në këtë datë.”</i> Pika. 2 e kësaj VKM përcakton se: “Pas datës 15 tetor, procedurat e prokurimeve publike, të parashikuara në regjistrin e prokurimeve publike, mund të fillojnë/vazhdojnë vetëm për ato projekte që janë pjesë e buxhetit tre-vjeçar, të miratuar për njësinë përkatëse të qeverisjes së përgjithshme. Lidhja e kontratës në këtë rast bëhet vetëm pasi fondi të jetë vënë në dispozicion në llogarinë e autoritetit kontraktor, në buxhetin e tij, të miratuar për vitin buxhetor pasardhës.</p>
Situata 2	<p>Udhëzimi nr.22, datë 17.11.2016 për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit për Njësitë e Qeverisjes Qendrorë, përcakton procedurat dhe afatet që duhet të ndjekin njësitë e qeverisjes qendrore gjatë monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e politikës së realizuar për çdo program të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të PBA. Nga auditimi konstatohet se për sa i përket procedurave që duhet të ndjekin të gjitha institucionet e buxhetore të varësisë nga ana e MFE nuk është hartuar një udhëzues i ngjashëm. Si rezultat, mbetet i pa rregulluar procesi i monitorimit të ekzekutimit të buxhetit nga këto njësi, me qëllim vlerësimin e performancës nëpërmjet krahasimit të treguesve faktik me ato të planifikuar, si dhe propozimin e ndërmarrjes së veprimeve korigjuese për ri alokimin e burimeve, problematikë kjo e konstatuar edhe në auditimet e KLSH pranë tyre. Mungesa e këtyre raporteve</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

	të progresit për performancën e objektivave, produkteve dhe shpenzimeve, nuk mundëson sigurimin e informacionit nga ana e njësive të qeverisjes qendrore eprore ku këto institucione e cila është thelbësore veçanërisht në fondet e investimeve, për të kryer më pas rishikime të fondeve në dispozicion bazuar në ecurisë e implementimit të tyre.
Kriteri:	Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 <i>o</i> Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar ; Udhëzimi nr.9 datë 20.07.2018 <i>o</i> Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit; Udhëzimi nr.22, datë 17.11.2016 <i>o</i> Për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit për Njësitë e Qeverisjes Qendrore.
Impakti:	Rishpërndarjet e fondeve të njësive të qeverisjes së përgjithshme në kundërshtim me kriteret përcaktuar në ligj; Mungesa e kuadrit rregullativ për ndjekjen e progresit për performancën e objektivave, produkteve dhe shpenzimeve të njësive të varësisë nuk mundëson sigurimin e informacionit për ekzekutimin e buxhetit nga ana e njësive të qeverisjes qendrore eprore ku këto institucione bëjnë pjesë, për të ndërmarrë veprimeve korigjuese për ri alokimin e burimeve sipas rastit.
Shkaku:	Udhëzimi nr.9 datë 20.07.2018 <i>o</i> Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit njeh datën 15 Nëntor si afat të fundit për përcjelljen e kërkesës, dhe jo miratimin apo kryerjen në sistem të rishikimit; Mos hartimi i një udhëzuesi për monitorimin e zbatimit të buxhetit për institucionet e varësisë.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë me strukturat e saj të iniciojnë procesin e vlerësimit dhe harmonizimit të kuadrit ligjor me atë nënligjor, në lidhje me afatin e fundit të rishpërndarjeve buxhetore në kuptim të <i>o</i> ushtrimit të së drejtës së institucioneve të njësive të qeverisjes së përgjithshme duke përcaktuar një datë kërkesë më të hershme që mundëson miratimin e tyre në një afat kohor ku është i mundur përdorimi i tyre brenda vitit buxhetor, dhe shmang nxjerrjen e akteve normative për rishpërndarje buxhetore në fundvit. -Ministria e Financave dhe Ekonomisë me strukturat e saj të iniciojnë procesin e vlerësimit dhe harmonizimit të kuadrit ligjor me atë nënligjor, në kuptim të nenit 51, pika 6 e Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 <i>o</i> Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH: <i>o</i> <i>Nëpunësi autorizues i njësive të qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor</i> ”. -Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik të marrin masat për hartimin e një udhëzuesi të brendshëm për procedurat e monitorimit të buxhetit nga njësitë e varësive të njësive të qeverisjes qendrore, në mënyrë që informacioni i konsoliduar mbi ecurinë e investimeve publike në përgjegjësinë e tyre të jetë i plotë dhe koherent me statusin aktual të ecurisë së projekteve. Kjo për të shërbyer ndërmarrjes në kohë të veprimeve korigjuese për rishpërndarjen e fondeve buxhetore të këtyre njësive sipas rastit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

2. Mbi procesin e planifikimit në drejtim të përgatitjes së dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 dhe Projekt Buxhetit vjetor 2020. Kryerja e analizave për efektet financiare të strategjive dhe politikave të reja, dhe dhënia e rekomandimeve për njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Ndjekja e regjistrimit të kërkesave buxhetore të BPA 2020-2022 të njësive e qeverisjes qendrore, përmes sistemit AFMIS, dhe moduleve respektive të përgatitjes së PBA.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua:

A. Afatet e përgatitjes së PBA 2020-2022

Kalendari i MSHP

Nga auditimi u konstatua se kalendari i menaxhimit të shpenzimeve publike është miratuar me VKM nr. 52, datë 06.02.2019, veprim në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *ËPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ËPërgatitja e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike, citohet: ËMinistri i Financave përgatit dhe i propozon Këshillit të Ministrave kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike, duke përcaktuar me hollësi afatet e procesit të menaxhimit të shpenzimeve publike. Kalendari i menaxhimit të shpenzimeve publike miratohet, si pjesë përbërëse e kalendarit të planifikimit strategjik, nga Këshilli i Ministrave dhe bëhet efektiv në ditën e parë të çdo viti, si dhe në kundërshtim me Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 ËPër procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm, pika 3.1 dhe 3.2, ku citohet: Ël. Ministri i Financave në fund të çdo viti buxhetor përgatit projektvendimin për kalendarin e Menaxhimit të Shpenzimeve Publike për vitin e ardhshëm buxhetor, për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm për njësitë e qeverisjes qendrore. 2. Këshilli i Ministrave miraton kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike për njësitë e qeverisjes qendrore si pjesë përbërëse të kalendarit të planifikimit strategjik. Sipas pikës 2 të këtij vendimi ËKy vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2019, ndërkohë VKM mban datën 06.02.2019. Sipas kalendarit, janë miratuar 5 veprime me data përpara marrjes së këtij vendimi. Ndër të cilat edhe datat e përgatitjes e paraqitjes së kalendarit në KM, si dhe miratimi i tij. Data e miratuar në kalendar për miratimin e kalendarit të MSHP është 09.01.2019, edhe pse vetë VKM mban datën 06.02.2019!*

Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka dërguar kalendarin e shpenzimeve publike në Këshillin e Ministrave me shkresën nr. 74 prot, datë 07.01.2019, në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *ËPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, pikën 3.1/1 dhe 3.1/2 të Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 ËPër procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm, si dhe kalendarin e MSHP.*

Kuadrin Makroekonomik e Fiskal

Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka paraqitur Kuadrin Makroekonomik e Fiskal në Këshillin e Ministrave me shkresën nr. 92, datë 07.01.2019, në përputhje me nenin nr. 23 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *ËPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar dhe me kalendarin e MSHP.*

Kuadrin Makroekonomik e Fiskal është miratuar me VKM nr. 4, datë 09.01.2019, në përputhje me nenin nr. 23 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *ËPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar dhe me kalendarin e MSHP.*

Tavanet përgatitore të përgatitjes së PBA 2020-2022



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka paraqitur tavanet përgatitore të përgatitjes së PBA 2020-2022, për fazën strategjike, në Këshillin e Ministrave me shkresën nr. 3515, datë 28.02.2019, në përputhje me afatin e caktuar në kalendarin e MSHP, ku si afat përcaktohet data 28 janar.

Tavanet përgatitore të përgatitjes së PBA 2020-2022, për fazën strategjike, janë miratuar me VKM nr. 117, datë 13.03.2019, në kundërshtim me afatin e caktuar në kalendarin e MSHP, ku përcaktohet data 20 shkurt.

Udhëzimi i Përgatitjes së Buxhetit

Ministri i Financave dhe Ekonomisë në zbatim të nenit 24 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ka miratuar Udhëzimin nr. 8, datë 28.02.2019 òPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022. Sipas këtij Udhëzimi, saktësisht në pikën 2, citohet: *òTavanet përgatitore të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e PBA 2019-2021, janë miratuar me VKM nr. 117, datë 13.03.2019 “Për miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve për PBA 2020-2022”, në nivel programi, dhe gjendet bashkëlidhur këtij udhëzimi”ò.*

Nga sa më sipër, konstatohet se udhëzimi i referohet një Vendimi të Këshillit të Ministrave kronologjikisht të mëvonshëm, çka do të thotë se data e vendosur në udhëzim nuk është reale.

Pra, udhëzimi për përgatitjen e PBA, është miratuar në shkelje të afatit të përcaktuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. Saktësisht: Neni 24 òUdhëzimi për përgatitjen e buxhetit, citon: *òMinistri i Financave, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të vlerësimeve dhe parashikimeve makroekonomike dhe buxhetore, brenda muajit shkurt miraton dhe dërgon për zbatim në njësitë e qeverisjes së përgjithshme udhëzimin për përgatitjen buxhetit”.*

Edhe pse udhëzimi në letër mban datë brenda afatit të përcaktuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, i ndryshuar, faktikisht ky akt ka dalë më vonë, vërtetuar kjo me datën e Vendimit të Këshillit të Ministrave.

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2020-2022

Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka paraqitur tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2020-2022, në Këshillin e Ministrave me shkresën nr. 11904, datë 21.06.2019, në përputhje me afatin e caktuar në kalendarin e MSHP, ku si afat përcaktohet data 21 qershor.

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2020-2022, janë miratuar me VKM nr. 523, datë 25.07.2019, në kundërshtim me afatin e caktuar në kalendarin e MSHP, ku përcaktohet data 29 qershor.

Udhëzimi plotësues i përgatitjes së Buxhetit

Ministri i Financave dhe Ekonomisë në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ka miratuar Udhëzimin plotësues nr. 21, datë 10.07.2019 òPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022. Sipas këtij Udhëzimi, saktësisht në pikën 2, citohet: *“Tavanet përgatitore të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e PBA 2020-2022, janë miratuar me VKM nr. 523, datë 25.07.2019 “Për miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2020-2022”, në nivel programi, dhe gjendet bashkëlidhur këtij udhëzimi””.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Nga sa më sipër, konstatohet se udhëzimi i referohet një Vendimi të Këshillit të Ministrave kronologjikisht të mëvonshëm, çka do të thotë se data e vendosur në udhëzim nuk është reale.

Pra, udhëzimi plotësues për përgatitjen e PBA, është miratuar në shkelje të afatit të përcaktuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. Saktësisht: Neni 27 Udhëzimi plotësues për përgatitjen e buxhetit, citon: *“Pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, Ministri i Financave nxjerr udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit, brenda datës 10 të muajit korrik, për nëpunësit autorizues të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme”*.

Edhe pse udhëzimi në letër mban datë brenda afatit të përcaktuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, i ndryshuar, faktikisht ky akt ka dalë më vonë, vërtetuar kjo me datën e Vendimit të Këshillit të Ministrave.

Dokumenti i rishikuar i PBA 2020-2022

Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka paraqitur për shqyrtim në Projektbuxhetin e vitit 2020 si dhe, dokumentin e rishikuar të PBA 2020-2022, në Këshillin e Ministrave me shkresën nr. 15962 prot, datë 06.09.2019, në përputhje me afatin e caktuar në kalendarin e MSHP, ku si afat përcaktohet data 11 tetor.

Dokumenti i rishikuar i PBA 2020-2022, është miratuar me VKM nr. 845, datë 24.12.2019 për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022, të rishikuar, në kundërshtim me Nenin 29 Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm, ku citohet: *“Brenda datës 25 tetor, Këshilli i Ministrave miraton, me vendim, projektbuxhetin vjetor dhe programin buxhetor afatmesëm, të rishikuar, si dhe pikën 3.2.5 të Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm, ku citohet: Udhëzimi i programit buxhetor afatmesëm, i rishikuar, së bashku me projektligjin e buxhetit vjetor paraqiten nga Ministri i Financave për miratim brenda datës 10 tetor në Këshillin e Ministrave”*.

Dokumenti përfundimtar i PBA 2020-2022 është miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 59, datë 28.02.2020 për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022, të rishikuar, në përputhje me pikën 3.2.10 të Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm.

Titulli i gjetjes:	Mosrespektim i afateve të përgatitjes së PBA 2020-2022 nga MFE.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se afatet e përcaktuara në dispozitat ligjore mbi përgatitjen e PBA, nuk janë zbatuar plotësisht. Më konkretisht: Kalendari i menaxhimit të shpenzimeve publike është miratuar me VKM nr. 52, datë 06.02.2019 , veprim në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Udhëzimi i kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike, si dhe në kundërshtim me Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm, pika 3.1 dhe 3.2. Udhëzimi për përgatitjen e PBA, është miratuar në shkelje të afatit të përcaktuar në nenin 24 Udhëzimi për përgatitjen e buxhetit të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

	<p>Shqipërisë, i ndryshuar, i cili përcakton muajin shkurt si afatin për përgatitjen e buxhetit. Ndërkohë, edhe pse udhëzimi nr. 8 mban datën 28 shkurt 2019, në pikën 2 të tij ai i referohet VKM-së nr. 117 datë 13.03.2019 të datës 13 mars, çka vërteton se udhëzimi realisht ka dalë pas datës 13 mars.</p> <p>Tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2020-2022, janë miratuar me VKM nr. 523, datë 25.07.2019, në kundërshtim me afatin e caktuar në kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike, ku përcaktohet data 29 qershor.</p> <p>Udhëzimi plotësues për përgatitjen e PBA, është miratuar në shkelje të afatit të përcaktuar në nenin 27 ÷ Udhëzimi plotësues për përgatitjen e buxhetit të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ÷ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, i cili përcakton datën 10 korrik si afatin e fundit për nxjerrjen e Udhëzimit. Edhe pse udhëzimi në letër mban datën 10.07.2019, pra brenda afatit të përcaktuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, i ndryshuar, faktikisht ky akt ka dalë më vonë, pasi në udhëzim përmendet VKM nr. 523 datë 25.07.2019 (datë e mëvonshme nga udhëzimi), pra udhëzimi realisht ka dalë pas datës 25.07.2019.</p> <p>Dokumenti i rishikuar i PBA 2020-2022, është miratuar me VKM nr. 845, datë 24.12.2019 ÷ Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022, të rishikuar, në kundërshtim me Nenin 29 ÷ Projektbuxheti vjetor, i cili përcakton datën 25 tetor si afatin për miratimin e projekt buxhetit, si dhe pikën 3.2.5 të Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 ÷ Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm, i cili përcakton datën 10 Tetor si afatin për paraqitjen për miratim të projektligjit nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ÷ Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. Udhëzimi nr. 8, datë 28.02.2019 ÷ Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022. Kalendari i MSHP.
Ndikimi/efekti:	Vonesa në përgatitjen e PBA.
Shkaku:	Mos respektimi i kërkesave dhe përcaktimeve të udhëzimeve të përgatitjes së PBA.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, si përgjegjëse për hartimin e dokumentit të Planit Buxhetor Afatmesëm (PBA), duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për përgatitjen e etapave të Programit Buxhetor Afatmesëm brenda kohës së përcaktuar në dispozitat ligjore dhe kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike, duke nxjerrë përgjegjësitë për vonesat që ndikojnë në përgatitjen e tyre.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, si dhe punonjësit e angazhuar në hartimin dhe përpunimin e materialeve të miratuara me vonesë.

B. Zbatimi i afateve dhe përputhja me kërkesat për përpilimin e PBA nga njësitë e qeverisjes



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

Nga vlerësimi dhe auditimi mbi bazë risku, u kërkuar praktikat e kërkesave buxhetore në fazën strategjike dhe fazën teknike të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, AKSHI-t dhe FSHZH-së. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, u verifikuan afatet e dorëzimit dhe zbatimi i kërkesave të Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

- Faza I

Me shkresën nr. 7697 prot, datë 25.04.2019, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë i ka dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 për fazën strategjike.

Për këtë nuk ka analizë nga MFE, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 "Për Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", pika 2.2/4.

- Faza II

Me shkresën nr. 13217/3 prot, datë 27.08.2019, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë i ka dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 për fazën teknike.

Për këtë nuk ka analizë nga MFE, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 "Për Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", pika 2.2/4.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

- Faza I

Nga auditimi rezultoi se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kërkesat për programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 për fazën strategjike në rrugë shkresore, por vetëm në format elektronik, *veprim nëkundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 28.02.2019 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022", si dhe me kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike, ku afati për dorëzimin e kërkesave buxhetore në këtë fazë është data 1 maj.*

Komente të përgjithshme të analizës së kryer nga MFE:

1. Kërkesat buxhetore u dorëzuan jashtë afatit të përcaktuar në udhëzimin nr. 8, datë 28.02.2019 për përgatitjen e PBA 2020-2022, vetëm në format elektronik dhe nuk janë të firmosura nga titullari. Materiali nuk është paraqitur i plotë pasi mungojnë kërkesat buxhetore të programit ombështetje për Energjinë.

2. Raportet e kërkesave buxhetore të paraqitura nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë janë dërguar përgjithësisht në përputhje me udhëzimin nr. 8, datë 28.02.2019 për përgatitjen e PBA 2020-2022. Plotësimi i këtyre raporteve nuk është bërë plotësisht në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në udhëzimin standard të përgatitjes së PBA.

3. Kërkesat buxhetore janë shoqëruar nga një relacion shpjegues në zbatim të përcaktimit të pikës 8/g kapitulli 1, i udhëzimit nr. 7/2018 për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm.

4. Nga shqyrtimi i Deklaratës së Politikës së Programit, konstatojmë se është paraqitur sipas formatit të ri, por lidhur me formulimin e qëllimeve, objektivave dhe treguesve të performancës vlerësojmë se ka nevojë për përmirësime.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

5. Janë paraqitur kërkesa për politika të reja apo kërkesa buxhetore shtesë mbi tavanin e miratuar në të gjitha programet buxhetore. Këto kërkesa përgjithësisht nuk janë paraqitur të prioritarizuara sipas nivelit të rëndësisë.

6. Institucioni nuk ka paraqitur informacion nëse ka zhvilluar konsultime me shoqërinë civile.

Konkluzione të analizës së kryer nga MFE:

1. Së pari, formatet duhet të plotësohen sipas atyre që janë dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë duke respektuar udhëzimin standard dhe atë vjetor për përgatitjen e PBA, specifikisht duke mbajtur në konsideratë përcaktimet dhe përkufizimet për Deklaratën e Politikës së Programit (qëllimi i politikës, objektivi apo Treguesit Kyç të Performancës). Për përcaktimin, përkufizimin dhe identifikimin e saktë të këtyre elementëve mund ti referoheni sugjerimeve të dhëna nga ana jonë për çdo rast specifik.

2. Së dyti, gjatë plotësimit të formateve duhet mbajtur në konsideratë fakti se luhatja e shpenzimeve për artikullin 602 Mallra dhe Shërbime duhet të shpjegohet nga luhatja e sasisë së produktit. Në çdo rast të ndryshimit të sasisë së produktit përgjatë viteve nevojitet të qartësohet ku është mbështetur ky ndryshim. Nëse ky ndryshim është miratuar sipas një plani paraprak apo është e miratuar ligjërisht. Në të kundërt në zbatim të metodologjisë kjo shifër nuk duhet të ketë luhatje të pajustificuara dhe shpenzimet duhet të ndryshojnë sa norma e inflacionit.

3. Së fundi, kërkesat për politika të reja/për financimin e politikave ekzistuese duhet të prioritarizohen në përputhje me nevojat emergjente dhe të domosdoshme të institucionit.

- Faza II

Nga auditimi rezultoi se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kërkesat për programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 për fazën teknike, *veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 28.02.2019 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022", si dhe me kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike, ku afati për dorëzimin e kërkesave buxhetore në këtë fazë është data 2 shtator.*

Konkluzione të analizës së kryer nga MFE:

1. Kërkesat buxhetore u dorëzuan jashtë afatit të përcaktuar në udhëzimit 07/2019 për përgatitjen e PBA 2020-2022, vetëm në format elektronik dhe nuk janë të firmosura nga titullari. Materiali nuk është paraqitur i plotë pasi mungojnë kërkesat buxhetore të programit mbështetje për Energjinë.

2. Raportet e kërkesave buxhetore të paraqitura nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë janë dërguar përgjithësisht në përputhje me udhëzimin nr. 8, datë 28.02.2019 për përgatitjen e PBA 2020-2022. Plotësimi i këtyre raporteve nuk është bërë plotësisht në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në udhëzimin standard të përgatitjes së PBA.

3. Kërkesat buxhetore nuk janë shoqëruar nga një relacion shpjegues në zbatim të përcaktimit të pikës 8 (g) kapitulli 1, i udhëzimit nr. 7/2018 për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm.

4. Nga shqyrtimi i Deklaratës së Politikës së Programit, konstatojmë se është paraqitur sipas formatit të ri, por lidhur me formulimin e qëllimeve, objektivave dhe treguesve të performancës vlerësojmë se ka nevojë për përmirësime.

5. Janë paraqitur kërkesa për politika të reja apo kërkesa buxhetore shtesë mbi tavanin e miratuar në të gjitha programet buxhetore. Këto kërkesa përgjithësisht nuk janë paraqitur të prioritarizuara sipas nivelit të rëndësisë.

6. Institucioni nuk ka paraqitur informacion nëse ka zhvilluar konsultime me shoqërinë civile.

Komente të përgjithshme të analizës së kryer nga MFE:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

1. Së pari, formatet duhet të plotësohen sipas atyre që janë dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë duke respektuar udhëzimin standard dhe atë vjetor për përgatitjen e PBA, specifiku duke mbajtur në konsideratë përcaktimet dhe përkufizimet për Deklaratën e Politikës së Programit (qëllimi i politikës, objektivi apo Treguesit Kyç të Performancës). Për përcaktimin, përkufizimin dhe identifikimin e saktë të këtyre elementeve mund ti referoheni sugjerimeve të dhëna nga ana jonë për çdo rast specifik.
2. Së dyti, gjatë plotësimit të formateve duhet mbajtur në konsideratë fakti se luhatja e shpenzimeve për artikullin 602 Mallra dhe Shërbime duhet të shpjegohet nga luhatja e sasisë së produktit. Në çdo rast të ndryshimit të sasisë së produktit përgjatë viteve nevojitet të qartësohet ku është mbështetur ky ndryshim. Nëse ky ndryshim është miratuar sipas një plani paraprak apo është e miratuar ligjërisht. Në të kundërt në zbatim të metodologjisë kjo shifër nuk duhet të ketë luhatje të pajustificuara dhe shpenzimet duhet të ndryshojnë sa norma e inflacionit.
3. Së fundi, kërkesat për politika të reja/për financimin e politikave ekzistuese duhet të prioritarizohen në përputhje me nevojat emergjente dhe të domosdoshme të institucionit.

Ministria e Mbrojtjes

- Faza I

Me shkresën nr. 2726/3 prot, datë **07.05.2019**, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kërkesat për programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 për fazën strategjike. *Afati i dorëzimit është në kundërshtim me afatet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 28.02.2019 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022", si dhe me kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike, ku afati për dorëzimin e kërkesave buxhetore në këtë fazë është data 1 maj.*

Komente të përgjithshme të analizës së kryer nga MFE:

1. Kërkesat buxhetore janë dorëzuar vetëm në formatin elektronik dhe nuk janë përcjellë në hardcopy sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. nr.8, date 28.2.2019 "Për përgatitjen e PBA 2020-2022ö.
2. Raportet e kërkesave buxhetore të paraqitura nga Ministria e Mbrojtjes janë dërguar deri diku në përputhje me udhëzimin nr.8, date 28.2.2019 "Për përgatitjen e PBA 2020-2022ö. Plotësimi i këtyre raporteve nuk është bërë plotësisht në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në udhëzimin standard të përgatitjes së PBA. Në shumë produkte ka luhatshmëri të kostos e cila nuk është argumentuar.
3. Kërkesat buxhetore nuk janë shoqëruar nga një relacion shpjegues në zbatim të përcaktimit të pikës 8 (g) kapitulli 1, i udhëzimit nr.7/2018 òPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëmö.
4. Nga shqyrtimi i deklaratës së politikës, konstatojmë se është paraqitur sipas formatit të ri, janë përcaktuar qëllimet, objektivat dhe janë evidentuar treguesit e performancës.
5. Janë evidentuar dhe kostuar politikat ekzistuese. Kostimi i politikave ekzistuese nuk është bërë plotësisht në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në udhëzimin standard, duke rezultuar në rritje të kostos për njësi të shumicës së produkteve përtej kufirit prej 4% të përcaktuar në udhëzimin vjetor, rritje e cila rezulton e paargumentuar.
6. Në programin òEmergjencat Civileö dhe òForcat e Luftimitö nuk është shpërndarë tavani i dhënë për projektet e investimeve. Konkretisht nuk janë shpërndarë investimet me financim të huaj dhe nuk janë paraqitur arsyet mbi këtë situatë.
7. Ministria e Mbrojtjes në disa programe ka bërë riorganizimin e objektivave dhe produkteve pa dhënë argumenta mbi këto riorganizime. Nga ky riorganizim humbet historiku i produkteve, me të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

cilat aktualisht po ekzekutohet buxheti për vitin 2019 në sistemin e thesarit. Për më tepër, ndryshimi i produkteve kryesore tregon për inkonsistencë në planifikim.

8. Institucioni nuk ka sqaruar nëse ka zhvilluar konsultime me shoqërinë civile.

9. Ministria e Mbrojtjes duhet të ripunojë dokumentin e PBA-së në përputhje me udhëzimin standard të përgatitjes së PBA-së, udhëzimin vjetor si dhe rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Konkluzione të analizës së kryer nga MFE:

1. Për programin Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi:

Ministria e Mbrojtjes duhet të rishikojë në tërësi dokumentin e PBA-së të paraqitur për këtë program buxhetor në përputhje me udhëzimin standard të PBA-së dhe rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

2. Për programin Forcat e Luftimit:

a) Ministria e Mbrojtjes duhet të bëjë zberthimin e standardeve për treguesit e performancës në nivel objektiv në terminologji të kuptueshme dhe në përputhje me udhëzimin standard të PBA-së.

b) Ministria e Mbrojtjes duhet të japë argumenta mbi ndryshimin e politikës së programit.

c) Ministria e Mbrojtjes duhet të rishikojë përlllogaritjet e kostove të produktet në përputhje me metodologjinë.

3. Për programin Arsimi Ushtarak:

Formati i politikave të reja duhet të plotësohet në përputhje me përcaktimet e udhëzimit standard të përgatitjes së PBA-së.

4. Për programin Mbështetja e Luftimit:

a) Ministria e Mbrojtjes duhet të rishikojë treguesit e performancës në nivel qëllimi dhe objektiv në përputhje me udhëzimin standard të përgatitjes së PBA-së.

b) Ministria e Mbrojtjes duhet të rishikojë përlllogaritjet e kostos së produktit dhe të japë argumenta kur kjo kosto luhet.

c) Lidhur me politikat e reja të propozuara duhet të rishikohen në përputhje me udhëzimin standard të përgatitjes së PBA-së.

5. Për programin Mbështetje për Shëndetësinë:

Ministria e Mbrojtjes duhet të rishikojë koston e produkteve duke respektuar udhëzimin vjetor dhe standard të PBA-së dhe të japë argumenta kur kosto ndryshon.

6. Për programin Mbështetje Sociale për Ushtarakët:

Ministria e Mbrojtjes duhet të argumentojë ndryshimet në kosto dhe ndryshimet e theksuara të numrit të përfituesve.

7. Për programin Emergjencat Civile dhe Rezervat:

a) Ministria e Mbrojtjes duhet të rishikojë formulimin e Qëllimit të Politikës së Programit, të identifikojë objektivin që i shërben arritjes së qëllimit dhe të rishikojë formulimin e produkteve.

b) Ministria e Mbrojtjes duhet të identifikojë tregues performance në nivel qëllimi dhe objektiv në përputhje me udhëzimin standard të përgatitjes së PBA-së.

c) Ministria e Mbrojtjes duhet të rishikojë përlllogaritjet e kostos së produkteve dhe të japë argumenta kur kjo kosto luhet duke respektuar udhëzimin standard dhe vjetor të PBA-së.

d) Investimet e reja duhet të përfshihen në formatin e politikave të reja dhe jo në formatin e politikave ekzistuese.

- Faza II

Me shkresën nr. 5437 prot, datë 02.09.2019., Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kërkesat për programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 për fazën teknike.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCIVE DHE EKONOMISË

Komente të përgjithshme të analizës së kryer nga MFE:

1. Kërkesat buxhetore u dorëzuan brenda afatit të përcaktuar në udhëzimin nr.21, datë 10.07.2019 për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022, në mënyrë elektronike.
2. Formatet e PBA-së nuk janë dërguar në hardcopy. Dokumenti i PBA-së nuk është firmosur nga titullari i institucionit.
3. Raportet e kërkesave buxhetore të paraqitura nga Ministria e Mbrojtjes janë dërguar në përputhje me udhëzimin nr.21, datë 10.07.2019 për përgatitjen e PBA 2020-2022. Plotësimi i këtyre raporteve është bërë në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në udhëzimin standard të përgatitjes së PBA.
4. Kërkesat buxhetore janë shoqëruar nga një relacion shpjegues në zbatim të përcaktimit të pikës 8 (g) kapitulli 1, i udhëzimit nr. 7/2018 për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm.
5. Nga Ministria e Mbrojtjes janë paraqitur kërkesa shtesë në realacionin shoqëruar të projektit e cila bie ndesh me përcaktimet e udhëzimit standard dhe vjetor të përgatitjes së PBA-së.
6. Referuar cilësisë së dokumentit të PBA për Ministrinë e Mbrojtjes, mbështetur në komentet dhe sugjerimet e paraqitura nga ana jonë në fazën e parë, vlerësojmë se nga Ministria e Mbrojtjes janë marrë në konsideratë dhe janë reflektuar komentet e bëra nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Në këtë fazë cilësia e dokumentit të PBA-së e paraqitur nga Ministria e Mbrojtjes është përmirësuar ndjeshëm krahasuar me fazën strategjike.

Konkluzione të analizës së kryer nga MFE:

1. Ministria e Mbrojtjes ka identifikuar tregues performancë për qëllimin dhe objektivin e këtij programi. Treguesit e performancës duhet të saktësohen më tej si psh., treguesi ÷Akte ligjore e nënligjore të paraqitura kundrejt planifikimit. Treguesi 25 akte të paraqitura duhet të vendoset në formë raporti pasi në mënyrën e vendosur nuk të jep informacion sesa është planifikuar ky numër dhe sa është përqindja e realizimit.
2. Produktet kanë problem lidhur me përlogaritjen e kostove pasi pothuajse në të gjitha produktet e këtij programi kosto luhet nga viti në vit Lidhur me këto luhetje të kosto nuk janë dhënë argumente të mjaftueshme. Për të gjitha produktet duhet të rishikohet kosto e produkteve dhe të jepen argumente kur kosto ndryshon.

Ministria e Brendshme

- Faza I

Me shkresën nr. 2299/13 prot, datë 30.04.2019 (protokolluar në MFE me nr. 3321/59 prot, datë 20.05.2019), Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kërkesat për programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 për fazën strategjike.

Komente të përgjithshme të analizës së kryer nga MFE:

1. Kërkesat buxhetore u dorëzuan brenda afatit të përcaktuar në udhëzimin nr. 8, datë 28.02.2019 për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022.
2. Raportet e kërkesave buxhetore të paraqitura nga Institucioni janë pjesërisht në përputhje me udhëzimin nr. 8, datë 28.02.2019 për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022. Raportet janë pothuajse në përputhje me udhëzimin vjetor nr. 7/1, datë 28.02.2018.
3. Kërkesat buxhetore janë shoqëruar nga një relacion shpjegues në zbatim të përcaktimit të pikës 8 (g) kapitulli 1, i udhëzimit nr. 7/2018 për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

4. Nga shqyrtimi i deklaratës së politikës, kostatojmë se është paraqitur sipas formatit, janë përcaktuar qëllimet, objektivat dhe janë evidentuar treguesit e performancës.

5. Janë evidentuar dhe kostuar politikat ekzistuese. Kostimi i politikave ekzistuese nuk është bërë plotësisht në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në udhëzimin vjetor nr.8, datë 28.02.2019 për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022ö.

6. Në përgjithësi nuk janë paraqitur kërkesa për politika të reja për pesë programet e Ministrisë së Brendshme, por janë paraqitur kërkesa për financimin e politikave ekzistuese.

7. Institucioni nuk ka sqaruar nëse ka zhvilluar konsultime me shoqërinë civile apo jo.

Konkluzione të analizës së kryer nga MFE:

1. Së pari, gjatë plotësimit të formateve për politikat ekzistuese duhet mbajtur në konsideratë fakti se luhatja e shpenzimeve korrente, duhet të argumentohet kur tejkalohe kufiri i lejuar. Në çdo rast të ndryshimit të sasisë së produktit përgjatë viteve nevojitet të qartësohet ku është mbështetur ky ndryshim. Nëse ky ndryshim është miratuar sipas një plani paraprak apo është e miratuar ligjërisht. Në të kundërt në zbatim të metodologjisë nuk duhet të ketë luhatje të pajustificuara dhe shpenzimet duhet të ndryshojnë sa kufiri i lejuar në udhëzim prej 4%.

2. Së dyti, gjatë plotësimit të formateve duhet të mbajtur në konsideratë luhatja e shpenzimeve të personelit (600+601), e cila rezulton e pa argumentuar, për më tepër që për pjesën më të madhe të produkteve sasisë nuk ndryshojnë. Të qartësohet, nëse ky ndryshim është mbështetur në akte ligjor/nënligjor që justifikojnë këtë ndryshim.

3. Së treti, Ministria e Brendshme duhet të prioritarizojë kërkesat, duke reduktuar numrin e propozimeve për financimin e politikave të reja.

4. Së fundmi, të respektohet metodologjia ku me prioritet financimi i Politikave Ekzistuese dhe pastaj Politikat e Reja.

- Faza II

Me shkresën nr. 6459/4 prot, datë 30.08.2019, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kërkesat për programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 për fazën teknike.

Komente të përgjithshme të analizës së kryer nga MFE:

1. Kërkesat buxhetore u dorëzuan brenda afatit të përcaktuar (referuar materialit ardhur elektronikisht) në udhëzimin nr.21, datë 10.07.2019 për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022ö.

2. Raportet e kërkesave buxhetore të paraqitura nga Institucioni janë në përputhje me udhëzimin nr.21, datë 10.07.2019 për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022ö.

3. Kërkesat buxhetore janë shoqëruar nga një relacion shpjegues në zbatim të përcaktimit të pikës 8 (g) kapitulli 1, i udhëzimit nr.7/2018 për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëmö.

4. Janë evidentuar dhe kostuar politikat ekzistuese. Referuar formatit nr.2, konstatojmë se janë paraqitur brenda tavaneve buxhetore dhe politika të reja, kryesisht projekte investimi që propozohen të financohen brenda tavaneve buxhetore nga institucioni.

5. Institucioni, edhe pse në fazën teknike Njësitë e Qeverisjes Qendrore nuk mund të ri-sjellin kërkesa për financimin e politikave të reja dhe kërkesa për mangësitë në financim të politikave ekzistuese, ka paraqitur kërkesa shtesë në relacionin shpjegues.

6. Vlen të përmendet se institucioni ka marrë në konsideratë komentet dhe sugjerimet tona të dhëna gjatë Fazës strategjike, duke përmirësuar dokumentin e PBA.

Konkluzione të analizës së kryer nga MFE



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

1. Së pari, gjatë plotësimit të formateve për politikën ekzistuese duhet mbajtur në konsideratë fakti se luhatja e shpenzimeve korrente, duhet të argumentohet kur tejkalohe kufiri i lejuar. Në çdo rast të ndryshimit të sasisë së produktit përgjatë viteve nevojitet të qartësohet ku është mbështetur ky ndryshim. Nëse ky ndryshim është miratuar sipas një plani paraprak apo është e miratuar ligjërisht. Në të kundërt në zbatim të metodologjisë nuk duhet të ketë luhatje të pajustificuara dhe shpenzimet duhet të ndryshojnë sa kufiri i lejuar në udhëzim prej 4%.

2. Së dyti, Ministria e Brendshme duhet të ri-prioritarizojë kërkesat, duke reduktuar numrin e propozimeve për financimin e politikave të reja.

3. Së fundmi, të respektohet metodologjia ku me prioritet financimi i Politikave Ekzistuese dhe më pas Politikave të Reja.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

- Faza I

Me shkresën nr. 2629 prot, datë **13.05.2019** (protokolluar në MFE me nr. 3321/48 prot, datë 13.05.2019), Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kërkesat për programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 për fazën strategjike. *Afati i dorëzimit është në kundërshtim me afatet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 28.02.2019 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022", si dhe me kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike, ku afati për dorëzimin e kërkesave buxhetore në këtë fazë është data 1 maj.*

Komente të përgjithshme të analizës së kryer nga MFE:

1. Kërkesat buxhetore u dorëzuan brenda afatit të përcaktuar në udhëzimin nr.8, datë 28.02.2019 për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022, në mënyrë elektronike, dhe në hardcopy.

2. Raportet e kërkesave buxhetore të paraqitura nga Institucioni janë dërguar pjesërisht në përputhje me udhëzimin nr.8, datë 28.02.2019 për përgatitjen e PBA 2020-2022 dhe janë të firmosura nga titullari i institucionit. Më konkretisht konstatojmë se nuk janë paraqitur të plotësuara formatet e përcaktuara sipas udhëzimit të sipërcituar: Formatit 1, Misioni; Formatit 3, Politika të reja; Formatit 4, Alokimi i taveve për Politikën ekzistuese; Formatit 5, Investimet në vazhdim; Formatit 6, Investime të reja.

3. Kërkesat buxhetore janë shoqëruar nga një relacion shpjegues në zbatim të përcaktimit të pikës 8 (g) kapitulli 1, i udhëzimit nr. 7/2018 për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm.

4. Institucioni ka respektuar përcaktimet e udhëzimit, duke përpunuar teknikisht kërkesat buxhetore mbështetur në tavanet përgatitore të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e PBA 2020-2022.

5. Referuar cilësisë së dokumentit të PBA për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, vlerësojmë se nevojitet që Ekipet e Menaxhimit të Programeve të intensifikojnë përpjekjet për të përmirësuar më tej argumentimin e kërkesave të tyre buxhetore.

6. Lidhur me projektet e investimeve publike, nuk janë plotësuar formatet F5-Shpenzimet për financimin e politikave ekzistuese për projektet në vazhdim dhe F6- Shpenzimet për projektet e reja të investimeve publike, ndërkohë që janë siguruar tabelat e detajimit të investimeve sipas formateve të tjera.

Projektet e reja të propozuara për financim nuk janë të shoqëruara me Formularin F2 sipas procedurave të menaxhimit të investimeve publike, miratuar me VKM nr.185 datë 29.03.2018.

7. Institucioni nuk ka paraqitur informacion lidhur me thirrjet publike për zhvillimin e takimeve konsultative me përfaqësues të shoqërisë civile.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Konkluzione të analizës së kryer nga MFE:

1. Lidhur me treguesit e performancës së evidentuar nga EMP e programit, vlerësojmë që treguesit duhet të plotësohet me vlera nominale sikurse në vitin 2019, dhe të vijojë në periudhën 2020-2022 me vlera konkrete dhe jo me trend.

2. Sa i përket formulimit të objektivit dhe treguesve të performancës për këtë program, theksojmë që treguesit e performancës duhet të plotësohen me synime konkrete.

3. Lidhur me produktet, konstatojmë që në produktin ÷Pacientë të trajtuar me recetë me rimbursim nga mjeku i familjesë vihet re një rritje e madhe e transfertës së brendshme në masën rreth 40%. Kërkojmë që kjo rritje të argumentohet në relacionin shoqërues.

4. Formulimi i Qëllimit të Politikës së këtij programi është realizuar përgjithësisht mirë. Janë evidentuar 3 tregues performance në nivel qëllimi. Lidhur me treguesin ÷Spitale të akredituara ndaj totalit (42)ö, vlerësojmë se duhet të vendoset në vlerë nominale dhe jo në përqindje, pasi nuk del qartë sa janë akredituar dhe cili është synimi për vitet e ardhshme në vlerë nominale.

5. Është evidentuar një Objektiv si dhe 13 Tregues Performance (TP) për këtë objektiv. Treguesit e performancës janë plotësuar me të dhëna vetëm për vitin 2019, por nuk janë plotësuar me të dhëna nominale për vitet 2020-2022. Sugjerojmë që aty ku është e mundur të mos vendoset trendi por synime konkrete për t'u arritur.

6. Lidhur me produktet e identifikuar në kategorinë 1 ÷Shpenzimet korrenteö, konstatojmë se janë identifikuar 8 Produkte.

a) Për produktin ÷Pacientë të trajtuar në shërbimin spitalorë vihet re ulja e kostos totale për vitin 2020 dhe rrjedhimisht dhe transfertat e brendshme, ndërsa numri i pacientëve të trajtuar rritet. Ndërkohë për vitet në vijim kosto paraqitet me rritje. Kërkojmë arsyet e kësaj luhateje për vitin 2020. Lidhur me këtë produkt, referuar relacionit paraqitet edhe një kërkesë shtesë në vlerën rreth 1.5 miliardë lekë në vit për përbalimin e nevojave të PPP për sterilizimin dhe laboratorët.

b) Për produktin ÷Pacientë të trajtuar në spitalet psikiatrikeö vihet re një rritje e kostos për vitin 2020 dhe më konkretisht në zerin e shpenzimeve operative (602). Kërkojmë të paraqiten arsyet e kësaj rritje të kostos ndërkohë që numri i pacientëve nuk ndryshon.

c) Lidhur me produktin ÷Pacientë të trajtuar me kataraktëö konstatojmë një rritje të kostos për vitin 2020 e në vijim përtej kufirit prej 4%, si rrjedhojë rritje e transfertës së brendshme. Kërkojmë të sqarohen arsyet e kësaj rritje gjithashtu të vendoset sasia për vitin 2019.

d) Lidhur me produktin ÷Pacientë të trajtuar me radioterapië konstatojmë një rritje të kostos për vitin 2020 e në vijim përtej kufirit prej 4%, si rrjedhojë rritje e transfertës. Kërkojmë të sqarohen arsyet e kësaj rritje gjithashtu të vendoset sasia për vitin 2019.

7. Në lidhje me shpërndarjen e shpenzimeve për investime, vërehet:

a) Përfundimi brenda një viti buxhetor i projekteve të cilat, thjesht nga ndikimi i tavanit të miratuar (ndonëse të propozuar për shtesë me rreth 254 milion lekë), shtrihen në më shumë se 1 vit (kur ka mundësi të mbyllen brenda tij). Psh. projekti ÷Rikonstruksion dhe shtesë i maternitetit për sp. Berat, me vlerë të plotë 216 milion lekë dhe shpërndarje financimi respektivisht: v.2019 rreth 43 milion lekë, v.2020 rreth 123 milion lekë dhe v.2021 rreth 50 milion lekë. Financimi i v.2021 duhet të përfshihet në v.2020.

b) Parashikimi i financimit në zerin ÷F.V pajisje teknologjike për fazën II sp. Kukësö, nuk mund të ndahet në dy vite buxhetore, dhe konkretisht: në v.2020 rreth 50 milion lekë dhe në v.2021 rreth 127 milion lekë.

c) Parashikimi i financimit të pajisjeve mjekësore që lidhen me përfundimin në të njëjtin vit edhe të rikonstruksionit të spitalit përkatës, mund të rrezikojë këtë të fundit. Psh rasti i rikonstruksionit të Spitali Psikiatrik Elbasan dhe rikonstruksionit të Pediatriisë Durrës etj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

8. Lidhur me produktin 1 (Numër kontrollesh për situatat epidemiologjike të objektivit 2, nevojiten të paraqiten shpjegime mbi arsyet e luhatjes së kostos totale/njësi nga viti 2019 në vitin 2020, informacion i cili duhet të jepet në pjesën e shënimeve në formatin nr. 2. Vihet re një ulje e kostos në vitin 2020 ndërsa sasia paraqitet me rritje, me konkretisht kosto në zërin e shpenzimeve operative ulet ndjeshëm për vitin 2020 dhe më pas vijon me rritje për vitet 2021-2022.

- Faza II

Me shkresën nr. 2629/1 prot, datë 02.09.2019, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kërkesat për programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 për fazën teknike.

Komente të përgjithshme të analizës së kryer nga MFE:

1. Kërkesat buxhetore u dorëzuan brenda afatit të përcaktuar në udhëzimin nr.21, datë 10.07.2019 (Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022), në mënyrë elektronike, dhe në hard copy.

2. Janë paraqitur të gjitha raportet e kërkesave buxhetore nga Institucioni në përputhje me pikën 4 të udhëzimit plotësues të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm nr.21, datë 10.07.20189.

3. Kërkesat buxhetore janë shoqëruar nga një relacion shpjegues në zbatim të përcaktimit të pikës 8 (g) kapitulli 1, i udhëzimit nr. 7/2018 (Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm).

4. Institucioni ka respektuar në total tavanin e alokuar për MSHMS por nuk ka përpunuar kërkesat buxhetore duke respektuar tavanet buxhetore të miratuara sipas programeve pasi është dakordësuar me MFE për rialokimet ndërmjet programeve buxhetore. Referuar relacionit shpjegues këto ndryshime argumentohet të jenë si pasojë e përmbushjes së prioriteteve dhe politikave të MSHMS.

5. Institucioni ka paraqitur kërkesa shtesë të cila tejkalojnë tavanet përfundimtare të miratuara për dy nga shtatë programet në administrim të tij, konkretisht në programin e Kujdesit Dytësor, dhe programin e Përkujdesit Social e cila bie ndesh me pikën 2 dhe pikën 3 të udhëzimit nr. 21 date 10.7.2019 sipas të cilat nuk lejohet paraqitja e kërkesave shtesë.

Konkluzione të analizës së kryer nga MFE:

1. Lidhur me treguesit e performancës së evidentuar nga EMP e programit, vlerësojmë që treguesit duhet të plotësohen me vlera nominale sikurse në vitin 2019, dhe të vijojë në periudhën 2020-2022 me vlera konkrete dhe jo me trend.

2. Sa i përket formulimit të objektivit dhe treguesve të performancës për këtë program, theksojmë që treguesit e performancës duhet të plotësohen me synime konkrete.

3. Lidhur me produktet, konstatojmë që në produktin (Pacientë të trajtuar me recetë me rimbursim nga mjeku i familjes) vihet re një rritje e madhe e transfertës së brendshme në masën rreth 40%. Vlerësojmë që kjo rritje duhet të argumentohet më tepër në relacionin shoqëruar.

4. Formulimi i Qëllimit të Politikës së këtij programi është realizuar përgjithësisht mirë. Janë evidentuar 3 tregues performance në nivel qëllimi. Lidhur me treguesin (Spitale të akredituara ndaj totalit (42)), vlerësojmë se duhet të vendoset në vlerë nominale dhe jo në përqindje, pasi nuk del qartë sa janë akredituar dhe cili është synimi për vitet e ardhshme në vlerë nominale.

5. Është evidentuar një Objektiv si dhe 13 Tregues Performance (TP) për këtë objektiv. Treguesit e performancës janë plotësuar me të dhëna vetëm për vitin 2019, por nuk janë plotësuar me të dhëna nominale për vitet 2020-2022. Sugjerojmë që aty ku është e mundur të mos vendoset trendi por synime konkrete për të arritur.

6. Lidhur me produktet e identifikuar në kategorinë 1 (Shpenzimet korrente), konstatojmë se janë identifikuar 8 Produkte.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

- a) Për produktin ÷Pacientë të trajtuar në shërbimin spitalorë vihet re ulja e kostos totale për vitin 2020 dhe rrjedhimisht dhe transferta e brendshme, ndërsa numri i pacientëve të trajtuar rritet. Ndërkohë për vitet në vijim kosto paraqitet me rritje. Kërkojmë arsyet e kësaj luhatje për vitin 2020. Lidhur me këtë produkt, referuar relacionit paraqitet edhe një kërkesë shtesë në vlerën rreth 1.5 miliardë lekë në vit për përbalimin e nevojave të PPP për sterilizimin dhe laboratorët.
- b) Për produktin ÷Pacientë të trajtuar në spitalet psikiatrike vihet re një rritje e kostos për vitin 2020 dhe më konkretisht në zerin e shpenzimeve operative (602). Kërkojmë të paraqiten arsyet e kësaj rritje të kostos ndërkohë që numri i pacientëve nuk ndryshon.
- c) Lidhur me produktin ÷ Pacientë të trajtuar me katarakte konstatojmë një rritje të kostos për vitin 2020 e në vijim përtej kufirit prej 4%, si rrjedhojë rritje e transfertës së brendshme. Kërkojmë të sqarohen arsyet e kësaj rritje gjithashtu të vendoset sasia për vitin 2019.
- d) Lidhur me produktin ÷Pacientë të trajtuar me radioterapië konstatojmë një rritje të kostos për vitin 2020 e në vijim përtej kufirit prej 4%, si rrjedhojë rritje e transfertës. Kërkojmë të sqarohen arsyet e kësaj rritje gjithashtu të vendoset sasia për vitin 2019.

7. Rritja e tavanit të miratuar për këtë program me gati 3 herë në v.2020 (sipas propozimit të MFE), ka të bëjë me projektin ÷Rikonstruksion i godinës qendrore të ISHPö, dhe ÷Blerje e pajisjeve diagnostikuese për laboratorët e ISHP-sëö. Lidhur me projektin e parë, ndërkohë që vlera e plotë është 118 mln është çelur vetëm 20 mln në v.2019 dhe nuk ka parashikim fondesh për vitet në vijim për përfundimin e tij. Kjo reflektohet edhe në ndryshimin e kërkuar të tavanit të këtij programi. Nga ana e MSHMS duhet të sigurohet vazhdueshmëria e financimit të tij duke ndryshuar tavanet dhe duke mos hapur asnjë projekt tjetër i ri në këtë program në 2021 dhe 2022.

AKSHI

- Faza I

Me shkresën nr. 2950 prot, datë **31.05.2019**, Drejtori i Përgjithshëm i AKSHI-t ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kërkesat për programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 për fazën strategjike. *Afati i dorëzimit është në kundërshtim me afatet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 28.02.2019 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022", si dhe me kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike, ku afati për dorëzimin e kërkesave buxhetore në këtë fazë është data 1 maj.*

Për këtë nuk ka analizë nga MFE, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 "Për Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", pika 2.2/4.

- Faza II

Me shkresën nr. 5185 prot, datë 02.09.2019 (ardhur dhe protokolluar në MFE me nr. 18785 prot, datë 18.10.2019), Drejtori i Përgjithshëm i AKSHI-t ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kërkesat për programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 për fazën teknike. *Afati i dorëzimit është në kundërshtim me afatet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 28.02.2019 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022", si dhe me kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike, ku afati për dorëzimin e kërkesave buxhetore në këtë fazë është data 2 shtator.*

Për këtë nuk ka analizë nga MFE, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 "Për Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", pika 2.2/4.

FSHZH

- Faza I



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Me shkresën nr. 466/3 prot, datë 30.04.2019 (protokolluar në MFE me nr. 3321/44 prot, datë 09.05.2019), Drejtori Ekzekutiv i FSHZH ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kërkesat për programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 për fazën strategjike.

Për këtë nuk ka analizë nga MFE, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 “Për Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, pika 2.2/4.

- Faza II

Me shkresën nr. 466/5 prot, datë 30.08.2019, Drejtori Ekzekutiv i FSHZH ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kërkesat për programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 për fazën teknike.

Për këtë nuk ka analizë nga MFE, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 “Për Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, pika 2.2/4.

Si përfundim, nga verifikimi i PBA të institucioneve të qeverisjes, si dhe analizave të kryera nga ana e MFE, u konstatua se paraqitja e kërkesave buxhetore shfaq problematika të tilla si:

- Mungesa e kërkesave buxhetore për programe të caktuara;
 - Mos respektim i afateve të dorëzimit të PBA;
 - Mos respektim i formateve të miratuara për paraqitjen e PBA;
 - Mungesë e relacioneve për kërkesat buxhetore;
 - Mungesë e analizës nga ana e MFE;
 - Paraqitja e kërkesave për politika të reja apo kërkesa buxhetore shtesë mbi tavanin e miratuar në të gjitha programet buxhetore;
 - Nuk është paraqitur informacion nëse ka zhvilluar konsultime me shoqërinë civile; etj.
- Në lidhje me këto, edhe pse janë problematika të cilat vazhdojnë vit pas viti, nuk rezulton të jetë marrë asnjë masë nga ana e NPA.

Për dërgimin me vonesë të kërkesave të PBA, mbajnë përgjegjësi NA dhe NZ të institucioneve. Për mungesën e analizës mbi kërkesat e PBA, mban përgjegjësi Drejtori i DPB.

Titulli i gjetjes:	Mosrespektim i afateve të përgatitjes së PBA 2020-2022 nga njësitë e qeverisjes qendrore, si dhe mangësi në përgatitjen e kërkesave. Mungesë e analizës nga MFE.
Situata:	<p>Nga auditimi me zgjedhje i zbatimit të afateve të dorëzimit të kërkesave të PBA për fazën strategjike dhe teknike nga ana e njësive të qeverisjes qendrore, u konstatua se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Mbrojtjes (faza 1), Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (faza 2) dhe AKSHI, kanë dorëzuar kërkesat e PBA jashtë afateve të caktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 28.02.2019 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022”.</p> <p>Gjithashtu nga verifikimi i PBA të dorëzuara nga institucionet e qeverisjes qendrore, si dhe analizave të kryera nga ana e MFE mbi to, u konstatua se paraqitja e kërkesave buxhetore shfaq problematika të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none">- Mungesa e kërkesave buxhetore për programe të caktuara;- Mos respektim i afateve të dorëzimit të PBA;- Mos respektim i formateve të miratuara për paraqitjen e PBA;- Mungesë e relacioneve për kërkesat buxhetore;- Mungesë e analizës nga ana e MFE;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

	<p>- Paraqitja e kërkesave për politika të reja apo kërkesa buxhetore shtesë mbi tavanin e miratuar në të gjitha programet buxhetore;</p> <p>- Nuk është paraqitur informacion nëse ka zhvilluar konsultime me shoqërinë civile;</p> <p>etj.</p> <p>Në lidhje me këto, edhe pse janë problematika të cilat vazhdojnë vit pas viti, nuk rezulton të jetë marrë asnjë masë nga ana e NPA.</p> <p>Gjithashtu u konstatuan raste të mungesës së analizës së kërkesave të PBA nga ana e DPB, veprim në kundërshtim me <i>Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 "Për Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm"</i>, pika 2.2/4. Konkretisht mungojnë analizat për institucionet MFE, AKSHI dhe FSHZH.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.</p> <p>Udhëzimi nr. 8, datë 28.02.2019 për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022.</p> <p>Udhëzimi nr. 7, datë 28.02.2018 për Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm.</p>
Ndikimi/efekti:	Vonesa në dorëzimin e kërkesave të PBA e për pasojë përgatitjen e PBA.
Shkaku:	-
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nëpunësi i Parë Autorizues të vlerësojë arsyet e vonesave dhe mangësive të evidentuara mbi kërkesat e PBA, duke marrë masat kundrejt NA dhe NZ të institucioneve të cilat kanë dorëzuar me vonesë apo me mangësi fazat e kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm.

C.AFMIS –Albanian Financial Management Integrated System

Për sistemin e AFMIS (ose SIMF), është miratuar VKM nr. 527 , datë 25.7.2019 për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të menaxhimit financiar. Referuar VKM-së: SIMF-i përbëhet nga modulet, si më poshtë vijon:

- Moduli i përgatitjes dhe monitorimit të programit buxhetor afatmesëm;
- Moduli i menaxhimit të investimeve publike;
- Moduli i monitorimit të portofolit të projekteve;
- Arkivi elektronik për arkivimin e dokumentacionit mbështetës të transaksioneve buxhetore.

SIMF-i ndërvepron me:

- Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), në administrim të ministrisë përgjegjëse për financat;
- Sistemin Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI), në administrim funksional të njësisë përgjegjëse për sistemet e mirëqeverisjes në Kryeministri;
- Sistemin Informatik të Menaxhimit të Ndihmës së Huaj (SIMNH), në administrim të ministrisë përgjegjëse për financat.

Subjektet përgjegjëse të SIMF-it janë, si më poshtë vijon:

- Institucioni administrues i SIMF-it është ministria përgjegjëse për financat;
- Institucionet, palë të interesuara, janë: ministria përgjegjëse për financat, ministrinë e linjës dhe institucionet buxhetore qendrore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Në lidhje me përgjegjësitë e përdoruesve Ministri i Financave dhe Ekonomisë ka nxjerrë Udhëzimin nr. 36, datë 17.12.2019 për përgjegjësitë e përdoruesve në sistemin informatik të menaxhimit financiar për modulën e përgatitjes së buxhetit, modulën e menaxhimit të investimeve publike dhe modulën e monitorimit të buxhetit dhe portofolit të projekteve.

Palët e përfshira në këtë proces janë:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit (DPB);
2. Njësitë e Qeverisjes Qendrore (NJQQ);
3. Drejtoria e Sistemit Informatik të Menaxhimit Financiar;
4. Drejtoria e Menaxhimit TIK për Ministrinë e Linjës;
5. AKSHI.

Për sa i përket kërkesave buxhetore për PBA 2020-2022 nëpërmjet AFMIS, u konstatua se nuk janë përgatitur sipas përcaktimeve në pikën 4 të Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2019 për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022, ku citohet: *“Të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore, do të përgatisin kërkesat buxhetore për PBA 2020-2022, përmes AFMIS, dhe moduleve respektive të përgatitjes së PBA dhe PIM”*.

Me anë të shkresës me nr. 16222 prot, datë 11.09.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm, u është kërkuar tre institucioneve, saktësisht Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Departamentit të Administratës Publike, dërgimi i emrave të përdoruesve për sistemin e AFMIS.

Nisur nga kjo shkresë, rezulton se kanë filluar ta përdorin këtë sistem pas datës 11.09.2019 vetëm tre institucione (pra nuk ka filluar prej fillimit të përgatitjes së kërkesave të PBA). Ndërkohë institucionet e tjera nuk kanë përgatitur asnjë fazë të PBA përmes AFMIS, veprim në kundërshtim me pikën 4 të Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2019 për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022.

Titulli i gjetjes:	Sistemi i AFMIS rezulton të mos jetë përdorur për kërkesat e PBA 2020-2022
Situata:	Për sa i përket kërkesave buxhetore për PBA 2020-2022 nëpërmjet AFMIS, u konstatua se nuk janë përgatitur sipas përcaktimeve në pikën 4 të Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2019 për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022, ku citohet: <i>“Të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore, do të përgatisin kërkesat buxhetore për PBA 2020-2022, përmes AFMIS, dhe moduleve respektive të përgatitjes së PBA dhe PIM”</i> . Me anë të shkresës me nr. 16222 prot, datë 11.09.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm, u është kërkuar tre institucioneve, saktësisht Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Departamentit të Administratës Publike, dërgimi i emrave të përdoruesve për sistemin e AFMIS. Nisur nga kjo shkresë, rezulton se kanë filluar ta përdorin këtë sistem pas datës 11.09.2019 vetëm tre institucione (pra nuk ka filluar prej fillimit të përgatitjes së kërkesave të PBA). Ndërkohë institucionet e tjera nuk kanë përgatitur asnjë fazë të PBA përmes AFMIS, veprim në kundërshtim me pikën 4 të Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2019 për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022.
Kriteri:	Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2019 për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

Ndikimi/efekti:	Kërkesat e PBA 2020-2022 nuk janë kryer nëpërmjet sistemit AFMIS.
Shkaku:	Sistemi nuk perdoret nga te gjithë userat (institucionet).
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	MFE me strukturën përgjegjëse -Drejtorinë e AFMIS të marrë masa për implementimin e plotë të AFMIS, si dhe të monitorojë zbatimin e tij nga ana e institucioneve qendrorë në drejtim të plotësimit të kërkesave të PBA nëpërmjet këtij sistemi.

D. Ndryshimet midis PBA 2019-2021 dhe PBA 2020-2022

Grupi i auditimit verifikoi buxhetin e alokuar për vitin 2020 sipas institucioneve dhe programeve, në PBA 2019-2021 dhe PBA 2020-2022. Më poshtë listojmë programet që kanë patur rritjen më të madhe në fonde për vitin 2020:

Në mijë lekë

Kodi i programit	Programi	Rritje e buxhetit të vitit 2020
7330	Sherbimet e Kujdesit Dytësor	3,004,063
1140	Menaxhimi i te Ardhurave Tatimore	2,007,584
9450	Arsimi Universitar	1,900,000
6190	Strehimi	999,000
9120	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	783,720
3310	Ndihma Juridike	751,150
1320	Veprimtaria Statistikore	719,000
1120	Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	667,311
4240	Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes	415,000
3520	Veprimtaria Informative Shteterore	279,500

Më poshtë listojmë programet që kanë patur uljen më të madhe në fonde për vitin 2020:

Në mijë lekë

Kodi i programit	Programi	Ulja e buxhetit të vitit 2020
4520	Transporti rrugor	6,930,199
6370	Furnizimi me Uje dhe Kanalizime	2,482,349
2150	Mbeshtetja e Luftimit	1,791,700
1180	Sherbimi i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave	1,628,000
2120	Forcat e Luftimit	1,577,550
6210	Programe Zhvillimi	1,404,000
4320	Mbeshtetje per Energjine	1,369,100
7220	Sherbimet e Kujdesit Paresor	1,017,182
6220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	572,000
4550	Transporti Hekurudhor	440,600

Më poshtë listojmë institucionet që kanë patur rritjen më të madhe në fonde për vitin 2020:

Në mijë lekë

Kodi i institucionit	Institucioni	Rritja e buxhetit të vitit 2020
11	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise	1,972,720
87	Institucione te tjera Qeveritare	1,714,168
5	Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	1,441,100
13	Ministria e Shendetesise	1,316,260
29	Zyra e Administrimit Buxhetit Gjyqesor	977,000



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE
EKONOMISË

50	Instituti Statistikes	719,000
15	Ministria e Puneve te Jashtme	596,250
28	Prokuroria e Pergjithshme	518,800
10	Ministria e Financave	497,097
18	Sherbimi Informativ Shteteror	279,500

Më poshtë listojmë institucionet që kanë patur uljen më të madhe në fonde për vitin 2020:

Në mijë lekë

Kodi i institucionit	Institucioni	Ulja e buxhetit të vitit 2020
6	Ministria e Infrastruktures dhe Energjise	11,503,589
17	Ministria e Mbrojtjes	3,090,000
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	2,704,000
14	Ministria e Drejtesise	2,006,826
3	Kryeministria	319,000
16	Ministria e Brendshme	298,762
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	184,700
63	Institucionet e sistemit te drejtesise	53,300
40	Partite Politike	50,000
55	Shkolla e Magjistratures	43,000

Në vlerësimin e grupit të auditimit, diferencat e mëdha të fondeve të alokuara për vitin 2020, nga një PBA në tjetrën, flasin për një parashikim të dobët, duke zbehur vlerën e parashikimeve afatmesme për shpenzimet e buxhetit të shtetit.

Nga auditimi me zgjedhje i ndryshimeve midis PBA 2019-2021 me PBA 2020-2022 në nivel projekti, u konstatuan **15 raste ku projektet e investimit të miratuara për PBA 2019-2021, nuk reflektohen në PBA 2020-2022, ose reflektohen me vlera konsiderueshëm më të ulëta me qëllim ruajtjen e tavaneve të miratuara dhe alokimin e fondeve për projekte të reja.** Më poshtë po i trajtojmë të detajuara:

1.Kodi i Projektit: 18BP203 “Projekti Implementim i firmës dixhitale për të gjithë përdoruesit e portalit qeveritar te pagesave AFMIS”.

Institucioni: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Sipas PBA 2019-2021

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia		1	1	1
Kosto totale (në mijë lekë)	0	36,479	41,479	24,479

Sipas PBA 2020-2022

	2019	2020	2021	2022
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	1	1	0	0
Kosto totale (në mijë lekë)	33,234	27,180	0	0

Sipas PBA 2019-2021 vlera e projektit është 102,437 mijë lekë, ndërsa sipas PBA 2020-2022 vlera e projektit është 60,414 mijë lekë.

Referuar regjistrimit të rishikimeve, rezulton se ky projekt nuk është çelur me buxhetin e miratuar:

BUDGET_R E VISION_I	GL PERI OD_NAM	BUDGET_ BALANC	REVISI ON_TYP	REVISION _AMOUNT	SEG MEN	Llogari E konomike	LAST_UPD ATE_DAT	CREATI ON_DAT	A N
------------------------	-------------------	-------------------	------------------	---------------------	------------	-----------------------	---------------------	------------------	--------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

D	E	E	E		T5		E	E	
6192292	04-2020	35,180,200	D	8,000,000	01110	2300000	14-APR-20	14-APR-20	-
6323307	12-2020	27,180,200	I	9,860,378	01110	2300000	24-DEC-20	24-DEC-20	3 4
6326299	12-2020	37,040,578	I	10,000,000	01110	2300000	29-DEC-20	29-DEC-20	3 4
6339304	12-2020	47,040,578	D	546,578	01110	2300000	19-JAN-21	19-JAN-21	-

Projekti është çelur me vlerë 35,180,200 lekë, dhe në muajin prill është zvogëluar në vlerën 27,180,200 lekë (duke e çuar vlerën sa PBA 2020-2022).

Gjithsesi nëpërmjet AN 34 i janë alokuar 19,860,378 lekë me qëllim mbulimin e vlerës së kontratave, si më poshtë:

DATA_KONTRATES	CREATION_DATE	BILLED_AMOUNT	SHUMA
2019/09/24 00:00:00	05-JAN-21	18,597,600	18,597,600
2019/09/24 00:00:00	05-JAN-21	27,896,400	27,896,400

Pra, edhe pse fondi i vitit 2020, referuar PBA 2019-2021, është miratuar në vlerën 41,479 mijë lekë, kjo nuk është reflektuar e tillë në PBA 2020-2022, duke alokuar më pas fonde me AN 34. Theksojmë se kontrata është të lidhur në datën 24.09.2019.

2. Projekti: “Sisteme te vetëmbrojtjes se helikopterëve (AS -532 AL, Ec 145)”.

Institucioni: Ministria e Mbrojtjes

Sipas PBA 2019-2021

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Sasia			1	
Kostototale (në mijë lekë)			420,000	

Nga verifikimi i PBA 2020-2022, rezulton se ky projekt nuk është reflektuar.

3. Projekti: “Rikonstruksione në disa ambiente të godinës së MSHMS”.

Institucioni: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Sipas PBA 2019-2021

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Sasia	0	770	765	770
Kostototale (në mijëlekë)	0	16,440	15,850	17,710

Nga verifikimi i PBA 2020-2022, rezulton se ky projekt nuk është reflektuar.

4. Kodi i Projektit 18BB010: “Rikonstruksion i spitalit psikiatrik ne QSUT”.

Institucioni: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Sipas PBA 2019-2021

	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Sasia	0	0	0	5,200
Kostototale (në mijëlekë)	0	0	0	325,000

Sipas PBA 2020-2022

	2019 Buxheti	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi	2022 Parashikimi
Sasia	0	0	0	1,490



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

Kostototale (nëmijëlekë)	0	0	0	100,000
--------------------------	---	---	---	---------

Sipas PBA 2019-2021 vlera e projektit është 325,000 mijë lekë, ndërsa sipas PBA 2020-2022 vlera e projektit është 100,000 mijë lekë.

5. Kodi i Projektit M133471: “TVSH perndertimin e spitalit te semundjeve te brendshme (8 katshi- A2) ne QSUT”.

Institucioni: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Sipas PBA 2019-2021

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	1	1	1	1
Kostototale (nëmijëlekë)	35,000	40,000	140,000	117,500

Sipas PBA 2020-2022

	2019	2020	2021	2022
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	1	1	0	0
Kostototale (nëmijëlekë)	75,502	118,251	0	0

Sipas PBA 2019-2021 vlera e projektit është 297,500 mijë lekë, ndërsa sipas PBA 2020-2022 vlera e projektit është 193,753 mijë lekë.

6. Projekti: “Rikonstruksioni godinës qendrore të ISHP”.

Institucioni: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia		444	1890	280
Kostototale (nëmijëlekë)	0	20,000	85,111	12,700

Nga verifikimi i PBA 2020-2022, rezulton se ky projekt nuk është reflektuar.

7. Kodi i Projektit M870052: “Rikonstruksioni i zyrave të AKSHI-it dhe Datacenter-it Qeveritar”.

Institucioni: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

Sipas PBA 2019-2021

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	1	1	1	1
Kosto totale (nëmijëlekë)	110,000	142,051	329,660	229,000

Nga verifikimi i PBA 2020-2022, rezulton se ky projekt nuk është reflektuar.

Edhe pse nuk është i reflektuar, projekti ka çelje në vlerën 24,830,696 lekë dhe realizim në vlerën 21,250,883 për vitin 2020.

8. Kodi i Projektit M870309: “Përmirësimi i infrastrukturës hardware”.

Institucioni: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

Sipas PBA 2019-2021

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	1	1	1	1
Kosto totale (në mijë lekë)	24,000	50,000	49,600	0

Nga verifikimi i PBA 2020-2022, rezulton se ky projekt nuk është reflektuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

9. Kodi i Projektit M870317: “Përmirësimi i Sistemeve IT”.

Institucioni: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

Sipas PBA 2019-2021

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	0	0	1	1
Kostototale (nëmijëlekë)	0	0	126,000	230,000

Nga verifikimi i PBA 2020-2022, rezulton se ky projekt nuk është reflektuar.

10. Kodi i Projektit M870311: “Ndërtimi i portalit për qeverisjen e hapur, opendata.gov.al”.

Institucioni: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

Sipas PBA 2019-2021

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	1	1	1	0
Kostototale (nëmijëlekë)	20,000	36,000	32,740	0

Nga verifikimi i PBA 2020-2022, rezulton se ky projekt nuk është reflektuar.

11. Kodi i Projektit 18AK302: “Mbrojtje nga lumi Vjosë Zona Selenicë, Vlorë”.

Institucioni: Ministria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Sipas PBA 2019-2021

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia		1.2	0.8	
Kostototale (nëmijëlekë)		140,000	88,695	

Sipas PBA 2020-2022

	2019	2020	2021	2022
	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	1.2	0		
Kostototale (nëmijëlekë)	100,000	0		

Sipas PBA 2019-2021 vlera e projektit është 248,695 mijë lekë, ndërsa sipas PBA 2020-2022 vlera e projektit është 100,000 mijë lekë.

12. Kodi i Projektit 18AK307: “Rehabilitimi argjaturës së lumit Buna, Pentar-Luarez, Shkoder”.

Institucioni: Ministria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Sipas PBA 2019-2021

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia		4	2.5	
Kostototale (nëmijëlekë)	0	79,812	50,188	0

Sipas PBA 2020-2022

	2019	2020	2021	2022
	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	4	0		
Kostototale (nëmijëlekë)	79,812	0	0	0



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

Sipas PBA 2019-2021 vlera e projektit është 130,000 mijë lekë, ndërsa sipas PBA 2020-2022 vlera e projektit është 79,812 mijë lekë.

13. Kodi i Projektit M160817: “Rikonstruksioni çatise kapanonit makinave rezervë, çatisë magazinës pjesëve të këmbimit, motorrave dhe gomave në Q.SH.A.M.T.”.

Institucioni: Ministria e Brendshme

Sipas PBA 2019-2021

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia			2	
Kostototale (nëmijëlekë)			9,449	

Nga verifikimi i PBA 2020-2022, rezulton se ky projekt nuk është reflektuar.

14. Kodi i Projektit M160493: “Rikonstruksioni i Hotelit Nr. 1 + Mobilim në Sh.P.D.”.

Institucioni: Ministria e Brendshme

Sipas PBA 2019-2021

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	0		1	1
Kosto totale (nëmijë lekë)	0		83,000	27,000

Sipas PBA 2020-2022 (faza 3)

	2019	2020	2021	2022
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	0	0	0	0
Kosto totale (nëmijëlekë)	0	0	0	0

Nga sa më sipër rezulton se për këtë projekt, nuk janë parashikuar vlera në PBA 2020-2022.

15. Kodi i Projektit M160987: “Rikonstruksioni I Hotelit Nr. 3 në Sh.P.D.”.

Institucioni: Ministria e Brendshme

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia				1
Kostototale (nëmijëlekë)				28,000

Nga verifikimi i PBA 2020-2022, rezulton se ky projekt nuk është reflektuar.

Nga auditimi konstatohen **12 raste ku projektet e investimit miratohen fillimisht në PBA 2019-2021 si projekte të reja me vlerë të ulët, duke ruajtur tavanet e miratuar dhe më pas rriten në PBA 2020-2022 me vlerë të konsiderueshme.** Më poshtë po i trajtojmë të detajuara:

1.Kodi i Projektit: 18BR903 “Zhvillimi i kontabilitetit në Sektorin Publik”.

Institucioni: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Sipas PBA 2019-2021

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE
EKONOMISË

Sasia	0	1	0	0
Kosto totale (në mijë lekë)	0	38,919	0	0

Sipas PBA 2020-2022

	2019	2020	2021	2022
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	1	1	1	0
Kosto totale (në mijë lekë)	20,275	10,000	73,130	73,129

Projekti është miratuar fillimisht me vlerën 38,919 mijë lekë, dhe më pas shkon 176,534 mijë lekë. Për vitin 2020 rezulton me realizim 0 lekë.

2. Kodi i Projektit: M100024 “Pajisje, sisteme dhe makineri të ndryshme”.

Institucioni: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Sipas PBA 2019-2021

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	20	0	15	0
Kosto totale (në mijë lekë)	17,480	0	10,000	0

Sipas PBA 2020-2022

	2019	2020	2021	2022
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	20	0	0	100
Kosto totale (në mijë lekë)	4,000	0	33,000	33,000

Projekti është miratuar fillimisht me vlerën 10,000 mijë lekë (nga viti 2019), dhe më pas shkon 70,000 mijë lekë.

3. Kodi i Projektit: 18AË101 “Pajisje Kompjuterike, licensa, softë”.

Institucioni: Ministria e Financave dhe Ekonomisë / Programi i Doganës

Sipas PBA 2019-2021

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	503	406		80
Kostototale (në mijë lekë)	88,934	72,000	0	15,000

Sipas PBA 2020-2022

	2019	2020	2021	2022
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	327	5	50	5
Kosto totale (në mijë lekë)	71,700	50,000	44,760	20,000

Projekti është miratuar fillimisht me vlerën 87,000 mijë lekë (nga viti 2019), dhe më pas shkon 186,460 mijë lekë.

4. Kodi i Projektit: M133441 “Projekt-preventiva për rikonstruksionin e qendrave shëndetësore”.

Institucioni: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

Sipas PBA 2019-2021

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia		140		
Kostototale (nëmijëlekë)	0	10,000	0	0

Sipas PBA 2020-2022

	2019	2020	2021	2022
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	144	80		
Kostototale (nëmijëlekë)	10,000	4,000	0	0

Projekti është miratuar fillimisht me vlerën 10,000 mijë lekë, dhe më pas shkon 14,000 mijë lekë.

5. Kodi i Projektit: KM13001 “Poliklinika te rikonstruara”.

Institucioni: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Sipas PBA 2019-2021

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	1,200	1,550	450	
Kostototale (nëmijëlekë)	108,600	135,000	44,000	0

Sipas PBA 2020-2022

	2019	2020	2021	2022
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	1,600	948	0	
Kostototale (nëmijëlekë)	135,000	80,000	0	0

Projekti është miratuar fillimisht me vlerën 179,000 mijë lekë, dhe më pas shkon 215,000 mijë lekë.

6.Kodi i Projektit: GM13021 “Qendra shendetesore te rikonstruara”.

Institucioni: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Sipas PBA 2019-2021

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	1,833	511	2,530	
Kostototale (nëmijëlekë)	82,600	23,000	114,000	0

Sipas PBA 2020-2022

	2019	2020	2021	2022
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	1	1	1	1
Kostototale (nëmijëlekë)	143,000	53,000	158,000	158,000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Projekti është miratuar fillimisht me vlerën 137,000 mijë lekë (nga viti 2019), dhe më pas shkon 512,000 mijë lekë.

7.Kodi i Projektit: 18BB003 “Rikonstruksion në spitalin Lezhë dhe shtesë për Maternitetin Lezhë”.

Institucioni: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Sipas PBA 2019-2021

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia		769	3,077	0
Kosto totale (në mijëlekë)	0	50,000	200,000	0

Sipas PBA 2020-2022

	2019	2020	2021	2022
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	632	1,379	2,039	1,120
Kosto totale (në mijëlekë)	42,347	92,404	136,601	74,987

Projekti është miratuar fillimisht me vlerën 250,000 mijë lekë, dhe më pas shkon 346,339 mijë lekë.

Gjithashtu konstatohet se në PBA 2020-2022, për vitin 2020 janë kërkuar më pak fonde nga sa janë kërkuar tek PBA 2019-2020. Nga verifikimi i ecurisë së këtij investimi gjatë vitit 2020, konstatohet se gjatë vitit i janë alokuar fonde, dhe në fund vlera e paguar është 168,353,413 lekë

BUDGET_REVISION_ID	GL_PERIOD_NAME	BUDGET_BALANCE	REVISION_TYPE	REVISION_AMOUNT	SEGMENT5	Llogari_Ekonomike	CREATION_DATE	AN
6298318	10-2020	92,404,000	I	41,000,000	07330	2310000	26-OCT-20	-
6327293	12-2020	133,404,000	I	35,000,000	07330	2310000	30-DEC-20	3 4

8. Kodi i Projektit: 18BB006 “Rikonstruksion dhe shtese materniteti persp. Berat”.

Institucioni: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Sipas PBA 2019-2021

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia		385	1,540	0
Kostototale (në mijëlekë)	0	25,000	100,000	0

Sipas PBA 2020-2022

	2019	2020	2021	2022
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	850	1,753	780	0
Kostototale (në mijëlekë)	56,123	96,192	71,354	0

Projekti është miratuar fillimisht me vlerën 125,000 mijë lekë, dhe më pas shkon 223,669 mijë lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

9.Kodi i Projektit: 18BB007 “Rikonstruksion i QKMZHRF Tirane”.

Institucioni: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Sipas PBA 2019-2021

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia		462	770	0
Kostototale (nëmijëlekë)	0	30,000	50,000	0

Sipas PBA 2020-2022

	2019	2020	2021	2022
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia		417	1,669	0
Kostototale (nëmijëlekë)		22,952	91,804	0

Projekti është miratuar fillimisht me vlerën 80,000 mijë lekë, dhe më pas shkon 114,756 mijë lekë.

10. Kodi i Projektit: 18BB103 “F. V aparatura mjekësore për spitali e ri të ndërtuar në QSUT me kredi të CEB-it (kontributi i qev. shqiptare)”.

Institucioni: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Sipas PBA 2019-2021

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	0	0	0	1,100
Kostototale (nëmijëlekë)	0	0	0	312,000

Sipas PBA 2020-2022

	2019	2020	2021	2022
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	0	0	1,950	450
Kostototale (nëmijëlekë)	0	0	415,000	95,000

Projekti është miratuar fillimisht me vlerën 312,000 mijë lekë, dhe më pas shkon 510,000 mijë lekë.

11. Kodi i Projektit: 18BB901 “Blerje pajisje mjekësore për autoambulancat e shërbimit të urgjencës”.

Institucioni: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Sipas PBA 2019-2021

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	0	35	0	0
Kosto totale (nëmijëlekë)	0	20,098	0	0

Sipas PBA 2020-2022

	2019	2020	2021	2022
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	40	41	0	0



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

Kostototale (nëmijëlekë)	20,098	21,100	0	0
--------------------------	--------	--------	---	---

Projekti është miratuar fillimisht me vlerën 20,098 mijë lekë, dhe më pas shkon 41,198 mijë lekë.

12. Projekti: 18BB901 “Rikonstruksion ambientesh në MBZHR”.

Institucioni: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Sipas PBA 2019-2021

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia				1
Kostototale (nëmijëlekë)				15,000

Sipas PBA 2020-2022

	2019	2020	2021	2022
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	1	1	1	1
Kostototale (nëmijëlekë)	4,700	25,000	45,000	15,000

Projekti është miratuar fillimisht me vlerën 15,000 mijë lekë, dhe më pas shkon 89,700 mijë lekë.

13. Kodi i Projektit:18AK401“Projekte zbatimi për objektet e infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja”.

Institucioni: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Sipas PBA 2019-2021

	2018	2019	2020	2021
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	4	4	4	4
Kostototale (nëmijëlekë)	20,000	20,000	20,000	20,000

Sipas PBA 2020-2022

	2019	2020	2021	2022
	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Sasia	8	4	4	4
Kostototale (nëmijëlekë)	40,000	44,971	30,000	30,000

Projekti është miratuar fillimisht me vlerën 60,000 mijë lekë (nga viti 2019), dhe më pas shkon 144,971 mijë lekë.

Ndërkohë rezulton se çelja dhe realizimi janë në vlerën 4,970,822 lekë

Titulli i gjetjes:	Ndryshime të vlerave të investimeve kapitale ndërmjet PBA 2019-2021 dhe PBA 2020-2022
Situata:	Nga auditimi u konstatuan diferenca të mëdha të fondeve të alokuara për projekte të caktuara, nga PBA 2019-2021 në PBA 2020-2022, çka flet për një parashikim të dobët, duke zbehur vlerën e parashikimeve afatmesme për shpenzimet e buxhetit të shtetit. Nga auditimi i ndryshimeve midis PBA 2019-2021 dhe PBA 2020-2022, u konstatuan: 15 raste ku projektet e investimit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

	miratuara për PBA 2019-2021, nuk reflektohen në PBA 2020-2022, ose reflektohen me vlera konsiderueshëm më të ulëta me qëllim ruajtjen e tavaneve të miratuara dhe alokimin e fondeve për projekte të reja, si dhe 13 raste ku projektet e investimit miratohen fillimisht në PBA 2019-2021 si projekte të reja me vlerë të ulët, duke ruajtur tavanet e miratuara dhe më pas rriten në PBA 2020-2022 me vlerë të konsiderueshme.
Kriteri:	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.
Ndikimi/efekti:	Krijim detyrimesh të prapambetura. Keqmenaxhim i investimeve.
Shkaku:	Ndryshimet e vlerave të projekteve të investimeve kapitale në vite.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë/ Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, në vijimësi të krahasojë kërkesat buxhetore edhe me PBA-të e viteve të kaluara duke rakorduar ecurinë e investimeve kapitale me qëllim mirë menaxhimin e tyre për të evituar krijimin e detyrimeve të prapambetura, ndryshimet në prioritetet e projekteve, si dhe cënimin apo favorizimin e projekteve specifike.

Për sa më sipër u mbajt Akt konstatimi nr. 4, datë 13.08.2021.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 8595/13, datë 30.09.2021 “Mbi Projekt raportin e Auditimit” nga Drejtoria e Analizave dhe Programimit Buxhetor, ku janë shprehur observacionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Drejtoria e Analizave dhe Programimit Buxhetor pretendon se puna e kryer nga kjo drejtori është në përputhje me afatet të cilat rezultojnë të tejkaluara. Gjithashtu janë paraqitur observime të cilat nuk e ndryshojnë faktin se rastet e përmendura nga grupi i auditimit janë në tejkalim të afateve ligjore. Për këtë, nuk rezultojnë të jenë paraqitur fakte të reja për të cilat grupi i auditimit nuk është vënë më parë në dijeni.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Për sa më sipër, qëndrimi mbi çështjet e trajtuara nuk ndryshon.

3. Vlerësimi i veprimtarisë në drejtim të detajimit të planit buxhetor dhe çeljeve fillestare në SIFQ, bazuar në ligjin nr. 88 datë 18.12.2019 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2020”. Rishpërndarja e fondeve buxhetore me ndryshimet sipas Akteve Normative duke përfshirë të gjitha ndryshimet për përballimin e situatës së pandemisë COVID-19 dhe rindërtimit.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua:

A. Mbi procesin e çeljeve 2020

Në zbatim të Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 20.01.2020 òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020 dhe në mbështetje të nenit 11 të Ligjit të Buxhetit nr.88/2019 òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020, NPA njofton nëpunësit autorizues të çdo njësie të qeverisjes qendrore për shpërndarjen e fondeve buxhetore sipas klasifikimit buxhetor për vitet 2020-2022, dhe më pas njësia përgjegjëse për buxhetin në MFE regjistron në SIFQ. Pas detajimit, nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes qendrore dërgojnë pranë NPA për miratim detajimin e tyre, i cili bëhet i vlefshëm për zbatim vetëm pasi regjistrohet në SIFQ.

Mbi procesin e detajimit të fondeve buxhetore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Për sa i përket procedurave të ndjekura nga institucionet për detajimin e fondeve buxhetore, konstatohet se vijnë problematikat e konstatuara në auditimin e mëparshëm për konsolidimin e këtij procesi, kryesisht për shkak të mungesës së kontrolleve dhe rakordimeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, apo vonesave në miratim.

Pas miratimit të Ligjit për buxhetin dhe planin 3-vjeçar, Drejtoria e Analizës dhe Programimit hedh në SIFQ tavanet buxhetore sipas tabelës 5 të Ligjit të Buxhetit, të cilat më pas detajohen deri në nivel projekti nga njësitë buxhetore. Njësitë e qeverisjes qendrore me akses në SIFQ kryejnë vetë detajimin dhe ngarkimin e çeljeve buxhetore në SIFQ, ndërsa për njësitë pa akses në SIFQ çeljet buxhetore/ ngarkimi në SIFQ për shpenzimet kapitale, ky proces kryhet nga Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike, dhe për shpenzimet korrente kryhet nga Drejtoria e Monitorimit dhe Menaxhimit të Buxhetit.

Sa më sipër, u auditua dokumentacioni i vënë në dispozicion për detajimin e fondeve për investime për vitin 2020-2022, për 10 Ministri të linjës dhe 40 institucione të pavarura.

- Në kushtet kur ende nuk është përcaktuar një afat maksimal për kryerjen e detajimit në udhëzimet për zbatimin e buxhetit, shkresat për detajimin e shpenzimeve kapitale për periudhën 3 vjeçare shkojnë deri në Mars 2020. Në zbatim të ligjit nr. 88/2019 për buxhetin e vitit 2020, udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, në vijim të shkresës nr. 24325/4, datë 30.12.2019 për detajimin e buxhetit për vitet 2020-2022, dhe për një menaxhim efektiv të fondeve buxhetore për shpenzime kapitale, MFE ka kërkuar me shkresën nr. 216, datë 03.02.2020 institucioneve dërgimin pranë MFE të detajimit të planit të buxhetit për shpenzime kapitale për vitet 2020, 2021, 2022; dhe me shkresën nr. 2169/12, datë 24.02.2020 është ritheksuar dërgimi i detajimit të këtij plani, por pa përcaktuar një afat për dërgimin e tij. Më hollësisht nga auditimi i dokumentacioneve të vendosura në dispozicion për detajimin e fondeve për investime për periudhën 2020-2022, shkresat miratuese janë përcjellë gjatë periudhës 28.01.2020-09.03.2020, si më poshtë:

- Ministria e Mbrojtjes ka dërguar detajimin pranë MFE me shkresën nr.733/1, datë 11.02.2020 dhe miratimi i tyre është përcjellë me shkresën nr. 2169/41 datë 09.03.2020.
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka dërguar detajimin pranë MFE me shkresën nr.1436, datë 12.02.2020 dhe miratimi i tyre është përcjellë me shkresën nr. 24325/236 datë 24.02.2020.
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 130/2, datë 24.01.2020 ka përcjellë një pjesë të detajimit, në përgjigje të së cilës MFE ka dërguar shkresën nr. 24325/137, datë 31.01.2020 ku është kryer miratimi i detajimit pjesor për shpenzimet kapitale për programin "Transporti Rrugorë"; me shkresën nr. 24325/152, datë 04.02.2020 ku është kryer miratimi i detajimit pjesor për shpenzimet kapitale për programin "Furnizimi me ujë dhe kanalizime"; me shkresën nr. 130/7, datë 5.02.2020 është dërguar detajimi pranë MFE, miratimi për disa programe i të cilave është kryer me shkresën nr. 2647/1 datë 21.02.2020 të MFE; me shkresën nr. 1718, datë 13.02.2020 është dërguar detajimi pranë MFE, miratimi për disa programe i të cilave është kryer me shkresën nr. 2169/30, datë 03.03.2020 të MFE; me shkresën nr. 2182/1, datë 28.02.2020 është dërguar detajimi pranë MFE për programin "Transporti Rrugorë", miratimi për disa programe i të cilave është kryer me shkresën nr. 2169/34, datë 05.03.2020 të MFE; për një pjesë të programit ka dërguar detajimin pranë MFE me shkresën nr.2182/1, datë 28.02.2020 dhe miratimi i tyre është përcjellë me shkresën nr. 2169/34 datë 05.03.2020.
- Ministria e Drejtësisë ka dërguar detajimin pranë MFE me shkresën nr.833/1 datë 10.02.2020 dhe miratimi i tyre është përcjellë me shkresën nr. 2169/10 datë 24.02.2020.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka dërguar detajimin pranë MFE me shkresën nr.307/1, datë 10.02.2020 dhe miratimi i tyre është përcjellë me shkresën nr. 2169/8 datë 21.02.2020.
- Ministria e Brendshme ka dërguar detajimin pranë MFE me shkresën nr.144/8, datë 24.02.2020 dhe miratimi i tyre është përcjellë me shkresën nr. 2169/35 datë 05.03.2020.
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka dërguar detajimin pranë MFE me shkresën nr.1130/1, datë 13.02.2020 dhe miratimi i tyre është përcjellë me shkresën nr. 2169/13 datë 25.02.2020.
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka dërguar detajimin pranë MFE me shkresën nr.844, datë 31.01.2020 dhe miratimi i tyre është përcjellë me shkresën nr. 24325/234 datë 21.02.2020.
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar detajimin pranë MFE me shkresën nr.1296, datë 21.01.2020 dhe miratimi i tyre është përcjellë me shkresën nr. 1296/1 datë 09.03.2020.
- Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme ka dërguar detajimin pranë MFE me shkresën nr.18558, datë 27.12.2019 dhe miratimi i tyre është përcjellë me shkresën nr. 24325/114 datë 28.01.2020.

Në mënyrë të përmblodhur janë përcjelle edhe shkresat nga institucionet si më poshtë:

Nr	Institucioni	Shkresa e miratimit të detajimit të buxhetit nga MFE
1.	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	30.03.2020
2.	KLD	09.03.2020
3.	Komisioneri Publik	28.01.2020
4.	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	03.02.2020
5.	Kryeministria	27.02.2020
6.	KLJG	25.03.2020
7.	Agjensia Telegrafike Shqiptare	10.02.2020
8.	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	10.02.2020
9.	ILDKPKI	28.01.2020
10.	APP	29.01.2020
11.	RTSH	29.01.2020
12.	Presidenca	29.01.2020
13.	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile	29.01.2020
14.	Autoriteti i Konkurrencës	28.01.2020
15.	KPP	28.01.2020
16.	Prokuroria e Përgjithshme	06.03.2020
17.	Avokati i Popullit	06.03.2020
18.	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale	28.01.2020
19.	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	24.02.2020
20.	SHISH	08.01.2020
21.	KQZ	17.02.2020
22.	KLSH	29.01.2020
23.	Kuvendi	31.01.2020
24.	Akademia e Shkencave	10.02.2020
25.	KMSHC	28.01.2020
26.	Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës	17.02.2020
27.	Qendra e Botimeve për Diasporën	14.02.2020
28.	Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore	18.03.2020
29.	Avokatura e Shtetit	18.03.2020
30.	Shkolla e Magjistraturës	14.02.2020
31.	Kolegji i Posaçëm i Apelit	14.02.2020
32.	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	14.02.2020
33.	INSTAT	29.01.2020
34.	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	28.01.2020
35.	Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të	28.01.2020



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

	Shtetit	
36.	KLP	29.01.2020
37.	AKSHI	27.02.2020
38.	Gjykata Kushtetuese	06.03.2020
39.	Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare	06.03.2020
40.	Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar	28.01.2020

Pra, miratimi i detajimit të fondeve buxhetore në vijim të shkresave të përcjella nga njësitë publike, varion nga muaji janar deri në mars. Tezgjatja e këtij procesi ndikon në zhvillimin më pas të procedurave të prokurimit për realizimin e shpenzimeve në kuadër të aktivitetit dhe misionit të institucioneve, të cilat do të duhet të iniciohen pas këtij momenti.

Nga kryqëzimi i të dhënave me regjistrin e APP, u konstatuan rastet si më poshtë, në të cilat procedura e prokurimit është shpallur përpara datës së shkresës së MFE për miratimin e detajimit të shpenzimeve kapitale nga ana e ministrive të linjës:

Objekti i Prokurimit	Autoriteti Kontraktor	Data e publikimit të procedurës në SPE	Fondi limit i procedurës kryesore (pa TVSH)	Data dërguar shkresa
Loti -I Zhvillim, modifikim, përmirësim dhe mirëmbajtje e sistemit ICMIS në 35 Gjykata	Këshilli i Larte Gjyqësor	06/03/2020	14,823,694	25.03.2020
Loti -II Zhvillim, modifikim, përmirësim dhe mirëmbajtje e sistemit ARKIT në 2 Gjykata	Këshilli i Larte Gjyqësor	06/03/2020	5,858,149	25.03.2020
Blerje pajisje të laboratorit kriminalistik të Policisë Ushtarake	Ministria e Mbrojtjes	12/02/2020	1,905,964	09.03.2020
Shërbimi i projektimit të detajuar për Infrastrukturën Publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim të detjuar	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	06/02/2020	99,881,847	26.02.2020
Rruga e Malit të Shenjtë, Mali i Tomorrit Loti 26	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	10/01/2020	663,234,718	26.02.2020
Ndërtimi i by passit në qendrën historike të Gjirokastrës (Ura e Nanxës ó Urat e Mëdha Dunavat	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	10/01/2020	577,824,644	26.02.2020

(Grupi i auditimit me qëllim verifikimin e saktësisë së hedhjes së çeljeve buxhetore në përputhje me miratimet sipas ligjit vjetor të buxhetit 2020, ka kërkuar çeljet e këtij viti të nxjerra nga sistemi, por nuk është vënë në dispozicion).

Mbi diferencat e planit në SIFQ me planin fillestar në ligj

- Nga auditimi u konstatua se pavarësisht kontrolleve ekzistente si funksionet dhe raportet e ndërtuara në SIFQ për qëllime të planifikimit buxhetor për të garantuar saktësinë e taveve të miratuar, ashtu sikundër është trajtuar edhe në auditimin e mëparshëm u konstatuan diferenca në të dhënat e raportuara në treguesit fiskale të buxhetit të konsoliduar sipas Tabelës nr. 4 të Ligjit të Buxhetit me atë të hedhur në sistem në planin fillestar të vitit 2020 në SIFQ, konkretisht në zërat e shpenzimeve dhe financimit të deficitit, si më poshtë:

Në milion lekë

Emërtimi	Tabela sipas Ligjit	Tabela Plani fillestar në SIFQ
Shpenzime Kapitale	81,639	80,640
Financimi Brendshëm	51,321	51,322
Investime nga te ardhurat e Arsimit të Lartë	1,000	0
Financimi Huaj	29,318	29,318
DEFICITI	-39,699	-71,656
FINANCIMI DEFICITIT	39,699	71,656



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Brendshëm	25,204	215,751
Te ardhura nga privatizimi		
Hua-marrje e brendshme	29,900	-25,387
Hua-marrje e brendshme (Nacionale)		-25,204
(E marre-V		-183
Te tjera	-4,696	241,138
I Huaj	14,494	-144,095
1. Hua afatgjate (e marre)	77,545	-77,545
Mbështetje buxhetore	3,500	0

Tabela fiskale e gjeneruar nga SIFQ pasaqitur më sipër si plani fillestar në SIFQ është vënë në dispozicion nga Sektori i Raportimit Financiar në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit. Kjo drejtori është faktikisht përgjegjëse për saktësinë e të dhënave të raportuara për realizimin faktik dhe jo për hedhjen e të dhënave në celje, paraqitur si plan më sipër. Drejtorja e Analizës dhe Programit Buxhetor është përgjegjëse për hedhjen e tavaneve buxhetore, dhe për njësitë që nuk kanë akses në SIFQ është përgjegjëse për detajimin Drejtorja e Monitorimit dhe Menaxhimit të Buxhetit. Sistemi SIFQ ka dizenuar kontrole për të garantuar saktësinë e hedhjes së këtyre të dhënave sipas formateve të miratuara. Megjithatë, diferencat e evidentuara në tabelën fiskale të gjeneruar nga SIFQ me atë të miratuar në ligj janë një tregues që formatet e standartizuara të përdorura për ngarkimin e çeljeve apo detajimin buxhetor sipas ndarjes së detyrave mes drejtorive të MFE përgjegjëse për këtë proces, nuk janë implementuar nga njësitë përgjegjëse, ose nuk janë të mjaftueshme për të garantuar saktësinë e detajimit brenda tavaneve të miratuara.

-Grupi i auditimit verifikoi raportin e gjeneruar nga SIFQ për buxhetin fillestar dhe atë operativ me qëllim vlerësimin e saktësisë së raportimit të shpenzimeve krahasuar me planin e miratuar sipas projekteve. Nga verifikimi i raporteve të gjeneruara për buxhetin fillestar dhe atë operativ në SIFQ u konstatua se vlerat e regjistruara për projektet janë të dublikuara, çka përbën risk për pasaktësi mbi raportimin e treguesve të planifikimit dhe realizimit të projekteve.

Titulli i gjetjes	Problematika të konstatuara në procesin e detajimit dhe miratimit të fondeve buxhetore për shkak të mos përcaktimit të afateve konkrete në kuadrin rregullator për të përfunduar dhe bërë disponibël në SIFQ fondet buxhetore, në mënyrë që të vijohet me procedurat e prokurimit.
Situata	Në zbatim të Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 20.01.2020 òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020ò dhe në mbështetje të nenit 11 të Ligjit të Buxhetit nr.88/2019 òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020ò, NPA njofton nëpunësit autorizues të çdo njësie të qeverisjes qendrore për shpërndarjen e fondeve buxhetore sipas klasifikimit buxhetor për vitet 2020-2022, dhe më pas njësia përgjegjëse për buxhetin në MFE regjistron në SIFQ. Pas detajimit, nëpunësit autorizues të njërive të qeverisjes qendrore dërgojnë pranë NPA për miratim detajimin e tyre, i cili bëhet i vlefshëm për zbatim vetëm pasi regjistrohet në SIFQ. Nga auditimi konstatohet se në kushtet kur ende nuk është përcaktuar një afat maksimal për kryerjen e detajimit në udhëzimet për zbatimin e buxhetit, shkresat për detajimin e shpenzimeve kapitale rezultojnë deri në muajin Mars 2020, duke reflektuar kështu një proces të tejzgjatur, problematikë kjo e trajtuar edhe në auditimet e mëparshme të KLSH-së. Më hollësisht, nga auditimi i dokumentacioneve të vendosura në dispozicion për detajimin e fondeve për investime për periudhën 2020-2022, shkresat miratuese janë përcjellë gjatë periudhës 28.01.2020-09.03.2020, si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

- Ministria e Mbrojtjes ka dërguar detajimin pranë MFE me shkresën nr.733/1, datë 11.02.2020 dhe miratimi i tyre është përcjellë me shkresën nr. 2169/41 datë 09.03.2020.
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka dërguar detajimin pranë MFE me shkresën nr.1436, datë 12.02.2020 dhe miratimi i tyre është përcjellë me shkresën nr. 24325/236 datë 24.02.2020.
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 130/2, datë 24.01.2020 ka përcjellë një pjesë të detajimit, në përgjigje të së cilës MFE ka dërguar shkresën nr. 24325/137, datë 31.01.2020 ku është kryer miratimi i detajimit pjesor për shpenzimet kapitale për programin ÷Transporti Rrugorë; me shkresën nr. 24325/152, datë 04.02.2020 ku është kryer miratimi i detajimit pjesor për shpenzimet kapitale për programin ÷Furnizimi me ujë dhe kanalizime; me shkresën nr. 130/7, datë 5.02.2020 është dërguar detajimi pranë MFE, miratimi për disa programe i të cilave është kryer me shkresën nr. 2647/1 datë 21.02.2020 të MFE; me shkresën nr. 1718, datë 13.02.2020 është dërguar detajimi pranë MFE, miratimi për disa programe i të cilave është kryer me shkresën nr. 2169/30, datë 03.03.2020 të MFE; me shkresën nr. 2182/1, datë 28.02.2020 është dërguar detajimi pranë MFE për programin ÷Transporti Rrugorë, miratimi për disa programe i të cilave është kryer me shkresën nr. 2169/34, datë 05.03.2020 të MFE; për një pjesë të programit ka dërguar detajimin pranë MFE me shkresën nr.2182/1, datë 28.02.2020 dhe miratimi i tyre është përcjellë me shkresën nr. 2169/34 datë 05.03.2020.
- Ministria e Drejtësisë ka dërguar detajimin pranë MFE me shkresën nr.833/1 datë 10.02.2020 dhe miratimi i tyre është përcjellë me shkresën nr. 2169/10 datë 24.02.2020.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka dërguar detajimin pranë MFE me shkresën nr.307/1, datë 10.02.2020 dhe miratimi i tyre është përcjellë me shkresën nr. 2169/8 datë 21.02.2020.
- Ministria e Brendshme ka dërguar detajimin pranë MFE me shkresën nr.144/8, datë 24.02.2020 dhe miratimi i tyre është përcjellë me shkresën nr. 2169/35 datë 05.03.2020.
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka dërguar detajimin pranë MFE me shkresën nr.1130/1, datë 13.02.2020 dhe miratimi i tyre është përcjellë me shkresën nr. 2169/13 datë 25.02.2020.
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka dërguar detajimin pranë MFE me shkresën nr.844, datë 31.01.2020 dhe miratimi i tyre është përcjellë me shkresën nr. 24325/234 datë 21.02.2020.
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar detajimin pranë MFE me shkresën nr.1296, datë 21.01.2020 dhe miratimi i tyre është përcjellë me shkresën nr. 1296/1 datë 09.03.2020.
- Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme ka dërguar detajimin pranë MFE me shkresën nr.18558, datë 27.12.2019 dhe miratimi i tyre është përcjellë me shkresën nr. 24325/114 datë 28.01.2020.

Gjithashtu, procesi i miratimit të fondeve buxhetore dhe bërjen disponibël të tyre në SIFQ duhet paralelisht të reflektohet në planet e prokurimit që njësitë e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

	<p>përgjithshme duhet të dorëzojnë në Degën e Thesarit çdo fillim viti, por në kushtet kur për çeljen e fondeve nuk janë sanksionuar afate konkrete, kjo situatë mund të bëhet shkak për shkeljen e disiplinës në ndërmarrjen e angazhimeve buxhetore. Kështu, nga kryqëzimi i të dhënave me regjistrin e APP, u konstatuan rastet, në të cilat procedura e prokurimit janë shpallur përpara datës së shkresës së MFE për miratimin e detajimit të shpenzimeve kapitale nga ana e ministrive të linjës. Konkretisht, rezultojnë 3 procedura prokurimi të iniciuara nga FSHZH, 2 procedura të iniciuara nga KLGJ, dhe 1 procedurë e iniciuar nga MM.</p>
Kriteri	<p>Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar Ligji nr.10296, datë 08.07.2010òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar Ligji nr. 88/2019 òPër buxhetin e vitit 2020ò Udhëzimi nr.9, datë 20.03.2018 òPër procedurat standarde të Zbatimit të Buxhetitò: Udhëzimi nr. 2, datë 20.01.2020 òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020ò Udhëzimi plotësues nr.26, datë 08.07.2020 òPër një shtesë dhe disa ndryshime në udhëzimin plotësues nr.2, datë 20.01.2020 òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020ò Udhëzimi plotësues nr.2/1, datë 21.09.2020 òPër një shtesë në udhëzimin plotësues nr.2, datë 20.01.2020 òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020ò, të ndryshuar</p>
Impakti	<p>Vonesat në miratimin dhe bërjen disponibël të fondeve nuk lejojnë fillimin në kohë të procedurave të prokurimit; Shpallja e procedurave të prokurimit pa fonde në dispozicion, situatë që mund të bëhet shkak për krijimin e detyrimeve të prapambetura dhe cenojnë disiplinimin fiskal.</p>
Shkaku	<p>Vonesa në detajimin e fondeve buxhetore në nivel projekti nga njësitë buxhetore për shkak të mos përcaktimit të afateve për përfundimin e këtij procesi</p>
Rëndësia	<p>E lartë</p>
Rekomandimi	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të marrë masat për të përcaktuar afate konkrete të detajimit dhe miratimit të fondeve buxhetore në kuadrin rregullator për zbatimin e buxhetit për kontrollin e angazhimeve buxhetore, në mënyrë që të shmangen situatat e tejzgjatjes së këtij procesi me impakt në iniciimin e procedurave të prokurimit në kushtet kur fondet nuk bëhen disponibël sipas projekteve që në fillim të vitit.</p>

Titulli i gjetjes:	Kontrollet në SIFQ për të garantuar saktësinë e detajimit brenda tavaneve të miratuara nuk janë implementuar nga njësitë përgjegjëse, ose nuk janë të mjaftueshme, duke rezultuar me diferenca
Situata	<p>- Nga auditimi u konstatua se pavarësisht kontrolleve ekzistente si funksionet dhe raportet e ndërtuara në SIFQ për qëllime të planifikimit buxhetor për të garantuar saktësinë e tavaneve të miratuara, ashtu sikundër është trajtuar edhe në auditimin e mëparshëm u konstatuan diferenca në të dhënat e raportuara në treguesit fiskale të buxhetit të konsoliduar sipas Tabelës nr. 4 të Ligjit të Buxhetit me atë të hedhur në sistem në planin fillestar të vitit 2020 në SIFQ, konkretisht në zërat e shpenzimeve dhe financimit të deficitit, si më poshtë: <i>Në milion lekë</i></p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

Emërtimi	Tabela sipas Ligjit	Tabela Plani fillestar në SIFQ
Shpenzime Kapitale	81,639	80,640
Financimi Brendshëm	51,321	51,322
Investime nga te ardhurat e Arsimit te Larte	1,000	0
Financimi Huaj	29,318	29,318
DEFICITI	-39,699	-71,656
FINANCIMI DEFICITIT	39,699	71,656
Brendshëm	25,204	215,751
Te ardhura nga privatizimi		
Hua-marrje e brendshme	29,900	-25,387
Hua-marrje e brendshme (Nacionale)		-25,204
(E marre-V		-183
Te tjera	-4,696	241,138
I Huaj	14,494	-144,095
1. Hua afatgjate (e marre)	77,545	-77,545
Mbështetje buxhetore	3,500	0

Tabela fiskale e gjeneruar nga SIFQ pasaqitur më sipër si plani fillestar në SIFQ është vënë në dispozicion nga Sektori i Raportimit Financiar në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit. Kjo drejtori është faktikisht përgjegjëse për saktësinë e të dhënave të raportuara për realizimin faktik dhe jo për hedhjen e të dhënave në celje, paraqitur si plan më sipër. Drejtoria e Analizës dhe Programit Buxhetor është përgjegjëse për hedhjen e taveve buxhetore, dhe për njësitë që nuk kanë akses në SIFQ është përgjegjëse për detajimin Drejtoria e Monitorimit dhe Menaxhimit të Buxhetit. Sistemi SIFQ ka dizenuar kontrole për të garantuar saktësinë e hedhjes së këtyre të dhënave sipas formateve të miratuara. Megjithatë, diferencat e evidentuara në tabelën fiskale të gjeneruar nga SIFQ me atë të miratuar në ligj janë një tregues që formatet e standartizuara të përdorura për ngarkimin e çeljeve apo detajimin buxhetor sipas ndarjes së detyrave mes drejtorive të MFE përgjegjëse për këtë proces, nuk janë implementuar nga njësitë përgjegjëse, ose nuk janë të njafueshme për të garantuar saktësinë e detajimit brenda taveve të miratuara.

- Gjithashtu, nga verifikimi i raporteve të gjeneruara për buxhetin fillestar dhe atë operativ në SIFQ u konstatua se vlerat e regjistruara për projektet janë të dublikuara, çka përbën risk për pasaktësi mbi raportimin e treguesve të planifikimit dhe realizimit të projekteve.

Kriteri	Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar Ligji nr.10296, datë 08.07.2010òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar; Udhëzimi nr.9, datë 20.03.2018 òPër procedurat standarde të Zbatimit të Buxhetitò: Udhëzimi nr.9/1, datë 20.03.2018 òPër procedurat standarde të Zbatimit të Buxhetitò për njësitë e qeverisjes së Përgjithshme që përdorin SIFQ; Udhëzimi nr. 2, datë 20.01.2020 òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020ò Udhëzimi plotësues nr.26, datë 08.07.2020 òPër një shtesë dhe disa ndryshime në udhëzimin plotësues nr.2, datë 20.01.2020 òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020ò Udhëzimi plotësues nr.2/1, datë 21.09.2020 òPër një shtesë në udhëzimin plotësues nr.2, datë 20.01.2020 òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020ò, të ndryshuarò
Impakti	Diferenca në raportet e gjeneruara për buxhetin fillestar dhe operativ në SIFQ apo me treguesit fiskal të miratuar
Shkaku	Mos koordinim i punës nëpërmjet drejtorive, në mënyrë që procesi të konsolidohet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

	dhe të mundësojë monitorimin e tij.
Rëndësia	E lartë
Rekomandi mi	Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të vlerësojë kontrollet ekzistuese dhe procedurat aktuale për garantimin e saktësisë së regjistrimeve të planit fillestar pas miratimit të ligjit, në vijim të konstatimit më sipër duke parashikuar procedura periodike për të kryer rakordimet përkatëse dhe kontrolle/procedura shtesë për të shmangur pasaktësitë në hedhjen e planit të miratuar në SIFQ.

B. Ndryshimet buxhetore që kanë sjellë aktet normative

Buxheti i vitit 2020 është miratuar me ligjin nr. 88/2019 òPër buxhetin e vitit 2020. Sipas tij, më poshtë paraqesim situatën fiskale për tre vitet e mëparshme, vitin 2020 si dhe dy vitet e ardhshme:

Në milion lekë

	Totali i të ardhurave	Totali i shpenzimeve	Defiçiti	(PBB)
Faktik 2017	430,397	461,410	-31,012	1,551,281
Në % të PBB	27.7%	29.7%	-2.0%	100%
Faktik 2018	449,909	476,147	-26,238	1,630,905
Në % të PBB	27.6%	29.2%	-1.6%	100%
Akti Normativ 2019	486,677	519,577	-32,900	1,705,246
Në % të PBB	28.5%	30.5%	-1.9%	100.0%
Buxheti 2020	509,675	549,374	-39,699	1,793,466
Në % të PBB	28.4%	30.6%	-2.2%	100.0%
Buxheti 2021	529,826	554,858	-25,032	1,905,129
Në % të PBB	27.8%	29.1%	-1.3%	100.0%
Buxheti 2022	566,017	588,722	-22,705	2,039,554
Në % të PBB	27.8%	28.9%	-1.1%	100.0%

Burimi: Publikimet e MFE

Gjatë vitit ky ligj ka ndryshuar gjithsej 4 herë nëpërmjet akteve normative si më poshtë:

1. Akti normativ nr. 6 datë 21.3.2020, miratuar me ligjin nr. 27/2020 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 6, datë 21.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”.

Sipas relacionit të këtij akti normativ:

Ky rishikim ka ardhur kryesisht si rezultat i nevojës dhe emergjencës që lidhet me alokimin e fondeve të nevojshme buxhetore për përballimin të situatës emergjente të krijuar nga pandemia COVID-19, përmes financimit të sektorit të shëndetësisë për pajisje, medikamente, materiale mjekësore dhe shërbimet e tjera të nevojshme, si dhe financimin e paketave sociale, në kuadër të saj.

Njëkohësisht, nevoja dhe urgjenca ka konsistuar edhe në faktin se, si rezultat i gjendjes të emergjencës shëndetësore, ky akt normativ ka synuar:

- Të reflektojë reduktimin në masën 20 miliard lekë, të zërit òTë ardhura tatimore, si pasojë e ngadalësimit të pritshëm në mbledhjen e tyre.
- Të reflektojë rritjen e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, në masën 9 miliard lekë ku, përfshirë edhe rialokimet e brendshme, mbështetja financiare për masat anti Covid-19 arrin në 12 miliard lekë.
- Të reflektojë, për rrjedhojë, rritjen e deficitit buxhetor në nivelin 68.7 miliard lekë, ose 3.9% të PBB-së, nga përkatësisht 39.7 miliard lekë ose 2.2% e PBB-së që ishin sipas buxhetit fillestar.
- Të reflektojë, për rrjedhojë, rritjen e borxhit publik total në nivelin e pritur prej rreth 68.8% e PBB-së, nga 65.4% të PBB-së që pritej sipas buxhetit fillestar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Rritja e borxhit publik total të pritshëm si raport ndaj PBB-së në këtë akt normativ kundrejt buxhetit fillestar reflekton:

- rritjen e deficitit buxhetor dhe të huamarrjes totale neto (përmendur më lart);
- rritjen e stokut të pritshëm të borxhit të garantuar (përmendur më poshtë);
- reduktimin e PBB-së nominale të parashikuar (përmendur më poshtë).

Ndërkohë, ndryshe nga rregulli fiskal i përcaktuar në ligjin organik të buxhetit për targetimin e një niveli të borxhit publik më të ulët se sa një vit më parë, devijimi i përkohshëm nga ky rregull fiskal në këtë akt normativ, ku borxhi publik i pritshëm për vitin 2020 prej rreth 68.8% e PBB-së, është më i lartë se sa ai i vitit 2019 prej 65.9% të PBB-së, është në përputhje me një prej rasteve të rrethanave të jashtëzakonshme të përcaktuara në shkronjën òaò, të nenit 4/4, të ligjit organik të buxhetit (Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008, i ndryshuar), rast në të cilin qeveria mund të devijojë përkohësisht nga rregulli fiskal i sipërpërmendur.

Në terma konkretë dhe të detajuar, akti normativ ka synuar:

- Të akordojë një fond prej 6.5 miliard lekësh në zërin e ri òKontingjenca për paketën sociale anti COVID-19. Ky fond i dedikohet financimit të masave me karakter social, në funksion të lehtësimit dhe mbështetjes së punëmarrësve dhe/ose shtresave të tjera të prekura nga pezullimi i proceseve të punës në shkallë vendi dhe, konkretisht, do të lëvrohet: Për shtresat në nevojë, për të papunët, si rrjedhojë e situatës, për mbështetje të ndryshme të komuniteteve dhe sektorëve, që do të rezultojnë më të dëmtuarit, për shkak të situatës.

- Të akordojë një fond prej 2.5 miliard lekësh në programin òShërbimet e kujdesit dytësor (spitalori)ò të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ky fond ka pasur për qëllim financimin e shpenzimeve, korrente dhe kapitale, të sektorit shëndetësor, për furnizimin me medikamente, aparatura dhe urgjenca të ndryshme dhe në mbështetje të stafëve mjekësore.

- Të rrisë me 1 miliard lekë fondin rezervë të buxhetit të shtetit, me qëllim krijimin e hapësirës për financimin e shpenzimeve të domosdoshme me karakter të paparashikuar, për muajt në vijim.

- Të rialokojë brenda Ministrisë së Mbrojtjes, pa efekt shtesë buxhetor, një fond prej 2 miliard lekësh nga programi òForcat e luftimitò dhe òMbështetja e luftimitò, në programin òMbështetje për Shëndetësinëò. Ky fond, do të përdoret në logjikën e një fondi emergjence, duke u alokuar si për shpenzime korrente ashtu edhe për kapitale. Si i tillë, ai do të përdoret për furnizimin me ushqim të komuniteteve të caktuara që do të rezultojnë të prekura nga pandemia, apo për familje me ndihmë ekonomike dhe pensionistë të vetmuar që do të kenë nevojë për ndihmë direkte. Njëkohësisht, ky fond do të përdoret edhe për nevoja të ekipeve mjekësore, si në spitalet civile ashtu edhe në spitalin ushtarak.

Krahas mbylljes dhe reduktimit të veprimtarive prodhuese, të ardhurat tatimore do të impaktohen në ulje edhe nga shtyrja e afateve ligjore të deklarimit të një sërë detyrimeve. Për pasojë, është parashikuar që impakti negativ në të ardhura do të jetë -20 miliard lekë krahasuar me buxhetin fillestar 2020, reduktim ky që do të prekë të gjitha zërat e të ardhurave tatimore.

Ndërkohë, në paketën e masave për përbalimin e situatës emergjente antiCOVID-19, është përfshirë edhe mbështetja për biznesin, në formën e instrumentit të garancisë sovrane në masën 11 miliard lekë (100 milion USD).

2. Akti normativ nr. 15 datë 15.04.2020, miratuar me ligjin nr. 50/2020 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 15, datë 15.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar””.

Sipas relacionit të këtij akti normativ:

Ky rishikim ka ardhur kryesisht si rezultat i nevojës dhe emergjencës të së cilit lidhet me financimin e paketës së dytë të masave anti-COVID19 të qeverisë dhe, konkretisht:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

- Përmes një alokimi shpenzimesh në masën 7 miliard lekë për këtë qëllim;
 - Përmes miratimit të një garancie sovrane në masën 15 miliard lekë.
- Njëkohësisht, nevoja dhe urgjenca konsiston edhe në faktin sesi rezultat i gjendjes të emergjencës shëndetësore, ky akt normativ ka synuar:
- të reflektojë reduktimin në masën 7 miliard lekë të zërave të shpenzimeve buxhetore, korrente dhe kapitale, referuar kursimeve të evidentuara dhe atyre të pritshme për vitin 2020;
 - të reflektojë rritjen në masën 7 miliard lekë të paketës financiare në mbështetje të masave anti-Covid19.

- Ruajtjen të pandryshuar të deficitit buxhetor, për rrjedhojë.

Në terma konkretë dhe të detajuar, akti normativ përcakton dhe ka synuar:

- të akordojë një fond prej 7 miliard lekësh në zërin ÷Kontingjenca për paketën sociale anti-COVID. Ky fond i dedikohet financimit të masave të reja me karakter social që do të ndërmarrë qeveria, në funksion të lehtësimit e të mbështetjes së punëmarrësve dhe/ose shtresave të tjera të prekura nga pezullimi i proceseve të punës në shkallë vendi, si për biznesin e madh ashtu edhe për pjesën e mbetur të biznesit të vogël.

- të reflektojë një total pakësimesh prej 7 miliard lekësh, me qëllim financimin e paketës së re anti-COVID19, pra pa kosto shtesë në buxhet, konkretisht përmes:

i. kursimeve në shpenzimet e personelit rreth 829 milion lekë;

ii. kursimeve në shpenzime operative rreth 1.28 miliard lekë, ku ndër kryesoret përmendim:

É Rreth 582 milion lekë kursime të evidentuara nga ngadalësimi i aktivitetit të institucioneve buxhetore për periudhën mars-maj.

É 700 milion lekë nga kontrata vjetore e Rapiscan.

iii. kursimeve në investimet me financim të brendshëm rreth 4.25 miliard lekë, konkretisht:

É Rreth 1 miliard lekë nga projektet e shkollave;

É Rreth 1 miliard lekë nga projekti i Rrugës së Arbit;

É Rreth 1 miliard lekë nga Ministria e Mbrojtjes;

É Rreth 800 milion lekë nga kontratat e inceneratorëve Fier & Elbasan.

iv. kursimeve në investimet me financim të huaj rreth 634 milion lekë.

Ndërkohë, në paketën e masave për përballimin e situatës emergjente anti-COVID-19 është përfshirë edhe mbështetja për biznesin, në formën e instrumentit të garancisë së re sovrane, në masën 15 miliard lekë. Ajo do të shkojë si garanci për kompanitë që janë gjendur përballë vështirësive, jo vetëm për pagesën e pagave të punonjësve gjatë këtyre muajve, por edhe në nivel kapitali apo likuiditeti në tërësi.

3. Akti normativ nr. 28 datë 02.07.2020, miratuar me ligjin nr. 103/2020 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 28, datë 2.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar””.

Sipas relacionit të këtij akti normativ:

Ky rishikim ka ardhur kryesisht si rezultat i nevojës dhe emergjencës të së cilit lidhet me financimin e paketës së dytë të masave anti-COVID19 të qeverisë dhe konkretisht:

- Përmes një alokimi shpenzimesh në masën 7 miliard lekë për këtë qëllim;

- Përmes miratimit të një garancie sovrane në masën 15 miliard lekë.

Njëkohësisht, nevoja dhe urgjenca konsiston edhe në faktin sesi rezultat i gjendjes të emergjencës shëndetësore, ky akt normativ ka synuar:

a) Të reflektojë një reduktim në masën -63.1 miliard lekë të planit të arkëtimit të ardhurave buxhetore, kundrejt planit fillestar 2020, si rrjedhojë e impaktit negativ të pandemisë Covid-19, ku pjesën kryesore e zë reduktimi i të ardhurave tatimore me rreth -57 miliard lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

b) Të reflektojë një rritje të shpenzimeve buxhetore prej rreth 30.16 miliard lekë, me synim kryesor injektimin me financim të sektorëve prioritarë të ekonomisë, specifikisht përmes investimeve publike.

c) Të reflektojë rritjen e deficitit buxhetor, për rrjedhojë, në nivelin -132.9 miliard lekë ose rreth 8.4% e PBB-së, nga përkatësisht 39.7 miliard lekë ose 2.2% e PBB-së që ishin sipas buxhetit fillestar dhe nga 68.7 miliard lekë ose rreth 3.9% në rishikimin e parë sipas aktit normativ nr. 6/2020.

d) Të reflektojë për rrjedhojë, rritjen e borxhit publik total në nivelin e pritur prej rreth 80% të PBB, nga rreth 65% të PBB që pritej sipas buxhetit fillestar dhe nga rreth 69% e PBB në rishikimin e parë sipas aktit normativ nr. 6/2020.

Rritja e borxhit publik total të pritshëm si raport ndaj PBB-së në këtë akt normativ, kundrejt buxhetit fillestar reflekton:

i) rritjen e deficitit buxhetor dhe huamarrjes totale neto;

ii) rritjen e stokut të pritshëm të borxhit të garantuar;

iii) reduktimin e PBB nominale të parashikuar.

Rritja vetëm si rrjedhojë e reduktimit të PBB-së nominale të parashikuar nga buxheti fillestar është rreth 8 pikë përqindje.

Ndërkohë, ndryshe nga rregulli fiskal i përcaktuar në ligjin organik të buxhetit për targetimin e një niveli të borxhit publik më të ulët sesa një vit më parë, devijimi i përkohshëm nga ky rregull fiskal në këtë akt normativ, ku borxhi publik i pritshëm për vitin 2020 prej rreth 80% e PBB-së është më i lartë sesa ai i vitit 2019 prej 66% të PBB-së, është në përputhje me një prej rasteve të rrethanave të jashtëzakonshme, përcaktuar në nenin 4/4, shkronja òaò, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, i ndryshuar, rast në të cilin qeveria mund të devijojë përkohësisht nga rregulli fiskal i sipërpërmendur.

Referuar alokimeve më të rëndësishme, akti normativ përcakton:

Shpenzime korrente:

- Financimin shtesë në masën 900 milion lekë të nevojës së NJVQV-ve për bonusin e qirasë sociale në kuadër të tërmetit të datës 26.11.2019, deri në fund të vitit 2020.

- Alokimin e fondit shtesë prej 400 milion lekësh për skemën e fermerëve, bazuar në tejkalimin e pritshmërive të MBZHR-së për aplikimet e vitit 2020.

- Financimin në masën 400 milion lekë të programit të ri të anglishtes dhe IT-së për ciklin e ulët.

- Alokimin e një fondi prej 200 milion lekësh, si parakusht për përthithjen e mbështetjes buxhetore të BE-së në kuadër të projekteve IPA.

- Rritjen me 200 milion lekë të fondit të planifikuar për skemën e papunësisë, si rrjedhojë e parashikimeve dhe pritshmërive deri në fund të vitit 2020.

- Sigurimin e organikës së mjaftueshme për strukturën e re të OFL-së prej 87 efektivësh, me një kosto prej 40 milion lekësh.

- Rritjen e strukturës organike të Policisë së Shtetit me 500 efektivë të rinj, pa kosto shtesë në buxhet.

Shpenzime kapitale:

- Alokimin e fondit në masën 4 miliard lekë për shpenzime shpronësimi dhe shlyerje detyrimesh të prapambetura në sektorin e infrastrukturës.

- Financimin shtesë prej 1 miliard lekësh për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve në shkallë vendi.

- Alokimin e fondit shtesë prej 3 miliard lekësh për FSHZH, për programe zhvillimi.

- Alokimin e fondit prej 2 miliard lekësh për projektin madhor të Unazës së Re të Tiranës.

- Financimin e projektit të Rrugës së Ersekës, në masën 800 milion lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

- Financimin prej 600 milion lekësh të studim-projektimit të tunelit të Llogorasë.
- Financimin prej 500 milion lekësh të studim-projektimit të konvikteve nga Bashkia Tiranë.
- Financimin e By-Pass-it Tepelenë, në masën 300 milion lekë.
- Akordimin e një fondi prej 573 milion lekësh për blerjen e pajisjeve e përshtatjen e godinës së SPAK.
- Alokimin e fondit shtesë prej 100 milion lekësh për projektet e kanaleve ujëtare/kulluese.
- Financimin prej 73 milion lekësh të studim-projektimit të aksit Sheshi Shqiponja-Bulevardi i ri.

4. Akti normativ nr. 34 datë 16.12.2020, miratuar me ligjin nr. 4/2021 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 34, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar””.

Ky rishikim ka ardhur kryesisht si rezultat i nevojës dhe emergjencës të së cilit lidhet kryesisht me:

- financimin e shpërblimit të fund vitit për kategorinë e pensionistëve, në masën 3.4 miliard lekë;
- shtesën e fondeve për financimin e skemës së ndihmës ekonomike & paaftësisë, në masën 1 miliard lekë.

Referuar alokimeve më të rëndësishme, akti normativ që propozohet, përcakton:

Shpenzime korente:

- Alokimin e fondit 3.4 miliard lekë për financimin e shpërblimit të fund vitit për kategorinë e pensionistëve, përkatësisht në masën 5,000 (pesë mijë) lekë për çdo pensionist. Ky shpërblim do të përballohet:

- Në masën 1.7 miliard lekë nga rritja e kontributeve të sigurimeve shoqërore;
- Në masën 1.7 miliard lekë nga fondet e vetë ISSH, të buxhetuara për vitin 2020.

- Shtesën e fondeve në masën 1.4 miliard lekë, për financimin e disa nevojave shtesë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kryesisht për skemën e ndihmës ekonomike & paaftësisë, si rrjedhojë e specifikave të përdorimit të saj gjatë vitit 2020, të karakterizuar nga pasojat sociale të pandemisë COVID-19. Konkretisht:

- Pagesa e PAK, rreth 816 milion lekë;
- Pagesa e NE, rreth 184 milion lekë.

- Shtesën e fondeve në masën 420 milion lekë në zërin e subvencionit të ndërmarrjeve ujësjellës-kanalizimeve sh.a., me qëllim, përkatësisht, për:

- shlyerjen në masën 100% të stokut të detyrimeve të prapambetura në zërin kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, përmes akordimit të fondit 300 milion lekë për këtë qëllim;
- shlyerjen në masën 20% të stokut të detyrimeve të prapambetura në zërin tatimfitimi, përmes akordimit të fondit 120 milion lekë për këtë qëllim.

Akordimi i këtij fondi prej 420 milion lekë në zërin subvencione ka një efekt neutral në buxhetin e vitit 2020, pasi ai do të shkojë automatikisht për pagesën e detyrimeve të sipërcituara, duke u regjistruar si hyrje (të ardhura) në buxhetin 2020.

- Shtesën e fondeve për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë në masën:

- 200 milion lekë, për financimin e përpunimit të mbetjeve urbane;
- 9.4 milion lekë, kundër vlefte e 75,000 eurove, për pagesën e studios së konsulentëve ligjorë në procesin e arbitrazhit ndërkombëtar për çështjen TIA.

Shpenzime kapitale:

- Financimin shtesë prej 2.9 miliard lekësh për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve në shkallë vendi, për përmirësimin e furnizimit me ujë të popullsisë.
- Financimin prej 982 milion lekësh për projektet e përpunimit të mbetjeve urbane.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCIVE DHE EKONOMISË

- Financim shtesë në masën 673 milion lekë për dy projekte prioritare të KQZ-së, përkatësisht ÷Projektin e identifikimit elektronik të zgjedhësve dhe ÷Projektin pilot të votimit dhe numërimit elektronik.
- Alokimin e fondit në masën 200 milion lekësh për shpenzime shpronësimi dhe shlyerje detyrimesh të prapambetura në sektorin e infrastrukturës.
- Alokimin e fondit shtesë prej 100 milion lekësh, në programin e kërkimit shkencor, për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
- Akordimin e një fondi prej 97 milion lekësh për ngritjen e sistemeve mbështetëse për funksionimin e godinës së SPAK-ut dhe BKH-së.

Sa i përket financave vendore:

Ashtu si e gjithë ekonomia në tërësi edhe njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë vitit buxhetor 2020 janë përballur me problematika në mbledhjen e të ardhurave vendore si pasojë e pandemisë COVID-19. Në këto kushte, në raport me planin e miratuar të buxhetit vjetor është vlerësuar e domosdoshme shtesa prej 70 milion lekësh për disa nga njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat kanë paraqitur problematikat e vështirësisë financiare në likuidimin e shpenzimeve. Kjo vlerë iu shtohet njësitë të vetëqeverisjes vendore në formën e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2020. Gjithashtu, në shpenzimet e pushtetit vendor janë bërë ndryshimet si më poshtë:

- Shtesa prej 200 milion lekësh në planin e taksave të ndara, me qëllim mbulimin e plotë të fondit që u takon njësitë të vetëqeverisjes vendore në formën e taksës së ndarë nga tatimi mbi të ardhurat personale në zbatim të shkronjës ç, pika 2, e nenit 25, të ligjit nr. 68, datë 27.4.2017, ÷Për financat e vetëqeverisjes vendore;
- Gjithashtu, një ndryshim do të reflektohet në financimin e huaj të pushtetit vendor ku, si pasojë e përfundimit të një pjese të rëndësishme të projekteve me këtë financim, realizimi është vetëm 200 milion lekë krahasuar me planin prej 1 miliard lekësh të miratuar. Si rrjedhim, më qëllim rritjen e efikasitetit të përdorimit të parave publike vlerësojmë shkurtimin në masën 470 milion lekë të shpenzimeve për financimin e huaj.

Më poshtë paraqitet në mënyrë të përmbledhur ndryshimi i situatës fiskale për vitin 2020, sipas akteve normative:

Në milion lekë

Nr .	EMERTIMI	Buxheti 2020	Ne % te PBB	AN 6	Ne % te PBB	AN 15	Ne % te PBB	AN 28	Ne % te PBB	AN 35	Ne % te PBB
	TOTALI TE ARDHURAVE	509,675	28.4%	489,675	28.1%	489,675	28.1%	446,570	28.2%	446,570	28.2%
I.	Te ardhura nga ndihmat	23,000	1.3%	23,000	1.3%	23,000	1.3%	18,000	1.1%	16,000	1.0%
II.	Te ardhura tatimore	465,090	25.9%	445,090	25.6%	445,090	25.6%	408,045	25.8%	410,045	25.9%
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	334,121	18.6%	314,121	18.0%	314,121	18.0%	290,000	18.3%	290,000	18.3%
II.2	Te ardhura nga Pushteti Vendor	26,944	1.5%	26,944	1.5%	26,944	1.5%	23,045	1.5%	23,045	1.5%
II.3	Te ardhurat nga Fondet Speciale	104,025	5.8%	104,025	6.0%	104,025	6.0%	95,000	6.0%	97,000	6.1%
III.	Te ardhura Jotatimore	21,585	1.2%	21,585	1.2%	21,585	1.2%	20,525	1.3%	20,525	1.3%
	TOTALI I SHPENZIMEVE	549,374	30.6%	558,374	32.1%	558,374	32.1%	579,535	36.7%	579,535	36.7%
I.	Shpenzime Korrente	446,035	24.9%	448,335	25.7%	446,223	25.6%	441,498	27.9%	441,998	28.0%
1	Personeli	83,203	4.6%	83,023	4.8%	82,152	4.7%	81,884	5.2%	81,134	5.1%
2	Interesat	40,950	2.3%	41,450	2.4%	41,450	2.4%	40,300	2.5%	39,160	2.5%
3	Shpenzime Operative Mirembajtje	49,846	2.8%	50,626	2.9%	49,336	2.8%	51,117	3.2%	51,287	3.2%
4	Subvencionet	1,290	0.1%	1,290	0.1%	1,340	0.1%	1,540	0.1%	1,960	0.1%
5	Shpenzime për Fondet Speciale	188,592	10.5%	189,792	10.9%	189,792	10.9%	188,372	11.9%	189,372	12.0%
6	Shpenzime për Buxhetin Vendor	57,554	3.2%	57,554	3.3%	57,554	3.3%	53,485	3.4%	53,285	3.4%
7	Shpenzime te tjera	24,600	1.4%	24,600	1.4%	24,600	1.4%	24,800	1.6%	25,800	1.6%
II.	Fondi Rezerve	1,700	0.1%	9,200	0.5%	16,200	0.9%	16,200	1.0%	16,200	1.0%
III.	Shpenzime Kapitale	81,639	4.6%	80,839	4.6%	75,950	4.4%	87,837	5.6%	89,337	5.7%
VII	Fondi i Rindërtimit	20,000	1.1%	20,000	1.1%	20,000	1.1%	34,000	2.2%	32,000	2.0%
	DEFIÇITI	-39,699	-2.2%	-68,699	-3.9%	-68,699	-3.9%	-132,965	-8.4%	-132,965	-8.4%
	FINANCIMI DEFIÇITIT	39,699	2.2%	68,699	3.9%	68,699	3.9%	132,965	8.4%	132,965	8.4%



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

	Brendshëm	25,204	1.4%	35,754	2.1%	35,754	2.1%	50,371	3.2%	50,371	3.2%
	I Huaj	14,494	0.8%	32,945	1.9%	32,945	1.9%	82,594	5.2%	82,594	5.2%
	Produkti i Brendshëm Bruto (PBB)	1,793,466	100.0%	1,741,639	100.0%	1,741,639	100.0%	1,580,960	100.0%	1,580,960	100.0%

Burimi: Publikimet e MFE

Më poshtë paraqiten ndryshimet që kanë prekur 4 aktet normative të vitit 2020:

Në milion lekë

Nr.	EMERTIMI	AN 6 - Ligji vjetor	AN 15 - AN 6	AN 28 - AN 15	AN 35 - AN 28	AN 35 - Ligji vjetor
	TOTALI TË ARDHURAVE	-20,000	0	0	-43,105	-63,105
I.	Te ardhura nga ndihmat	0	0	0	-5,000	-7,000
II.	Te ardhura tatimore	-20,000	0	0	-37,045	-55,045
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	-20,000	0	0	-24,121	-44,121
II.2	Te ardhura nga Pushteti Vendor	0	0	0	-3,899	-3,899
II.3	Te ardhurat nga Fondet Speciale	0	0	0	-9,025	-7,025
III.	Te ardhura Jotatimore	0	0	0	-1,060	-1,060
	TOTALI I SHPENZIMEVE	9,000	0	21,161	0	30,162
I.	Shpenzime Korrente	2,300	-2,111	-4,726	500	-4,037
1	Personeli	-180	-871	-268	-750	-2,069
2	Interesat	500	0	-1,150	-1,140	-1,790
3	Shpenzime Operative Mirembajtje	780	-1,291	1,781	170	1,441
4	Subvencionet	0	50	200	420	670
5	Shpenzime për Fondet Speciale	1,200	0	-1,420	1,000	780
6	Shpenzime për Buxhetin Vendor	0	0	-4,069	-200	-4,269
7	Shpenzime te tjera	0	0	200	1,000	1,200
II.	Fondi Rezerve	7,500	7,000	0	0	14,500
III.	Shpenzime Kapitale	-800	-4,889	11,887	1,500	7,698
VII	Fondi i Rindërtimit	0	0	14,000	-2,000	12,000
	DEFIÇITI	-29,000	0	-64,266	0	-93,267
	FINANCIMI DEFIÇITIT	29,000	0	64,266	0	93,266
	Brendshëm	10,550	0	14,617	0	25,167
	I Huaj	18,450	0	49,650	0	68,100

Burimi: Publikimet e MFE

Numri i rishikimeve buxhetore të cilat kanë materializuar aktet normative për vitin 2020 është 130 nga 2327 rishikime në total, përfshirë këtu rishikimet për investime kapitale dhe shpenzime korrente.

Rishikimet e akteve normative që kanë prekur investime kapitale janë 62 ose 48% e rishikimeve me akte normative.

Institucionet e prekura nga rishikimet e akteve normative janë 430, nga të cilat institucionet të cilat më së shumti kanë qenë pjesë e këtyre rishikimeve janë:

Institucioni	Numri i rishikimeve
Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (3535)	10
Aparati i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (3535)	8
Repartit Ushtarak Nr.1111 Tirane (3535)	8
Aparati i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (3535)	7
Aparati i Ministrisë së Mbrojtjes (3535)	6
Aparati i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (3535)	6
Bashkia Tirana (3535)	6
Aparati i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (3535)	5
Aparati i Ministrisë së Drejtësisë (3535)	5
Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) (3535)	5
Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	5
Repartit Ushtarak Nr.3111 Tirane (3535)	5
Spitali Universitar i Traumës (3535)	5
Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (3535)	4
Agjencia e Trajtimit të Pronave (3535)	4
Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR) (3535)	4
Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Shkodër (3333)	4
Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (3535)	4
Aparati Drejt.Pergj.Doganave (3535)	4



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE
EKONOMISË

Aparati i Akademisë (3535)	4
Aparati Qendror INSTAT (3535)	4
Bashkia Përrenjas (1821)	4
Bashkia Rrogozhinë (3513)	4
Drejtoria e Mbikëqyrjes së Shërbimit të Provës (3535)	4
Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit (3535)	4
Drejtoria Rajonale AKU Berat (1212)	4
Drejtoria Rajonale AKU Vlorë (3737)	4
Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (3535)	4
Reparti Ushtarak Nr.2111 Durrës (1717)	4
Reparti Ushtarak Nr.6111 Tiranë (3535)	4
Sh.A. Ujësjellës-Kanalizime Rrogozhinë (3513)	4

Numri i rishikimeve që ka prekur institucionet qendrore është 126, ndërsa ato vendore është 14. Gjithsej janë rishikuar 905 kode projektesh. Nga këto rezulton se vlerat më të larta të alokimit (Shtesa-Pakësime) të fondeve i kanë projektet e mëposhtme:

Në lekë

Institucioni	Pakësim	Shtesë	Shtesë - Pakësim
Transferte buxhetore për të mbuluar diferencën midis të ardhurave dhe shpenzimeve të skemës së Pensioneve publike		7,269,000,00	7,269,000,00
Projekte të reja investimi		3,000,000,00	3,000,000,00
Shpronësime	363,406,788	3,004,598,699	2,641,191,911
Subvencionim i qirasë për familjet e prekura nga tërmeti	1,051,334	1,946,656,010	1,945,604,676
Pacientë të trajtuar në shërbimin spitalor		1,356,000,00	1,356,000,00
Pacientë të trajtuar në shërbimin spitalor për Covid-19		1,200,000,00	1,200,000,00
Ndërtim By Pass i Fierit (Kontrate e Re)		975,000,000	975,000,000
Projekti I Burimeve Ujore dhe Ujitjes (IBRD)		782,950,000	782,950,000
PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa		754,593,000	754,593,000
Ndërtim rruga Korçë - Erseke Loti 2 (pjesa e pare)		606,827,933	606,827,933
Rishikimi i studimit të fizibilitetit dhe hartimi i projektit të detajuar inxhinierik "Ndërtimi i Tunelit të Llogarisë"		600,000,000	600,000,000
Përshtatja e Mjedisëve të Punës për prokurorinë e Posaçme të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe byronë kombëtare të hetimit dhe sigurimi i mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për funksionimin e tyre		573,000,000	573,000,000
Ndërtim I rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore(seg Kth Saukut-Bregu I lumit) loti 2		497,000,000	497,000,000
Mbyllja e vendëzimit ekzistues të mbetjeve të ngurta EKO - Park, Durrës		495,000,000	495,000,000
Mirëmbajtja e sistemeve IT të AKSHI dhe Institucioneve Qeveritare	19,000,000	500,000,000	481,000,000
Fatkeqësi natyrore të menaxhuara	150,000,000	626,706,000	476,706,000
Programi I Infrastrukturrës Bashkiake III dhe IV (Kredi)		473,085,103	473,085,103
Projekti i Identifikimit Elektronik të Zgjedhësve		423,000,000	423,000,000
Ndërmarrje të ujësjellës kanalizimeve të subvencionuara		420,000,000	420,000,000
Përfitues nga masat mbështetëse në bujqësi viti 2018 (për vitet 2019, 2020 dhe 2021 edhe në blegtori)	7,426,000	400,000,000	392,574,000

Me poshtë listohen programet të cilat kanë patur rritjen më të madhe të fondeve:

Në mijë lekë

Nr.	Kodi i programit	Emërtimi i programit	Pakësim	Shtesë	Ndryshimi NETO (Shtesë)
1	10220	Sigurimi Shoqëror	4,600	7,269,000	7,264,400
2	04520	Transporti rrugor	4,363,204	10,451,646	6,088,442



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE
EKONOMISË

3	06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	1,524,257	5,568,394	4,044,137
4	07330	Shërbimet e Kujdesit Dytësor	437,962	2,793,366	2,355,404
5	06190	Strehimi	79,954	1,993,267	1,913,313
6	06210	Programe Zhvillimi	1,300,000	3,150,000	1,850,000
7	10430	Përkujdesi Social	85,000	1,053,000	968,000
8	04240	Menaxhimi i infrastrukturës se kullimit dhe ujitjes	278,866	998,866	720,000
9	01610	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	7,000	673,000	666,000
10	01140	e-Qeverisja	127,280	790,650	663,370

Me poshtë listohen programet të cilat kanë patur uljen më të madhe të fondeve:

Në mijë lekë

Nr.	Kodi i programit	Emërtimi i programit	Pakësim	Shtesë	Ndryshimi NETO (Pakësim)
1	04220	Menaxhimi i infrastrukturës se kullimit dhe ujitjes	451,594	86,319	-365,275
2	09230	Arsimi i Mesëm (i përgjithshëm)	390,213		-390,213
3	01150	Menaxhimi i te Ardhurave Doganore	763,600	301,500	-462,100
4	01320	Veprimtaria Statistikore	540,200	75,200	-465,000
5	09120	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	1,046,876	468,576	-578,300
6	04230	Mbështetje për Peshkimin	768,044	46,340	-721,704
7	06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	2,200,000	1,182,000	-1,018,000
8	04550	Transporti Hekurudhor	1,030,000		-1,030,000
9	01180	Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave	1,661,904	5,100	-1,656,804
10	02120	Forcat e Luftimit	3,024,322	1,224,008	-1,800,314

Përmbledhje e ndryshimeve që kanë pësuar shpenzimet nga aktet normative:

Në mijë lekë

Emërtimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore
		Financim i Brendshëm	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
AN6 - LIGJI	1,800,000	-800,000	0	-800,000	1,000,000
AN15 - AN6	-2,111,425	-4,255,000	-633,700	-4,888,700	-7,000,125
AN28 - AN15	10,424,186	12,887,000	-1,000,000	11,887,000	22,311,186
AN34 - AN28	-159,568	1,499,999	0	1,499,999	1,340,431

Më poshtë, paraqiten shtesat dhe pakësimet e shpenzimeve kapitale dhe korrente të ndara sipas akteve normativ në nivel institucioni:

Akti Normativ nr. 6

Në mijë lekë

Emërtimi i Institucionit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore
		Financim i Brendshëm	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	-200,000	-700,000	0	-700,000	-900,000
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1,000,000	0	0	0	1,000,000
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise	100,000	-100,000	0	-100,000	0
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1,200,000	0	0	0	1,200,000
Ministria e Drejtësisë	-40,000	0	0	0	-40,000
Ministria e Brendshme	-10,000	0	0	0	-10,000
Instituti Statistikës	-300,000	0	0	0	-300,000
Institucione te tjera Qeveritare	50,000	0	0	0	50,000
	1,800,000	-800,000	0	-800,000	1,000,000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

Akti Normativ nr. 15

Në mijë lekë

Emërtimi i Institucionit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale		Totali i Shp. Kapitale	Totali i Shpenzimeve Buxhetore
		Financim i Brendshëm	Financimi i Huaj		
Presidenca	-17,000	0	0	0	-17,000
Kuvendi	-54,000	0	0	0	-54,000
Kryeministria	0	45,000	0	45,000	45,000
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	-159,500	-265,000	-133,700	-398,700	-558,200
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	-71,500	-1,800,000	-500,000	-2,300,000	-2,371,500
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	-919,600	-45,000	0	-45,000	-964,600
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	-231,000	-1,000,000	0	-1,000,000	-1,231,000
Ministria e Kulturës	-29,000	0	0	0	-29,000
Ministria e Drejtësisë	-56,775	-100,000	0	-100,000	-156,775
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme	-125,000	0	0	0	-125,000
Ministria e Brendshme	-21,000	-91,200	0	-91,200	-112,200
Ministria e Mbrojtjes	-7,000	-1,000,000	0	-1,000,000	-1,007,000
Shërbimi Informativ Shtetëror	-25,000	0	0	0	-25,000
Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	-3,000	0	0	0	-3,000
Akademia e Shkencës	-8,000	0	0	0	-8,000
Kontrolli i Lartë i Shtetit	-13,000	-11,000	0	-11,000	-24,000
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	-22,000	15,200	0	15,200	-6,800
Prokuroria e Përgjithshme	-10,000	0	0	0	-10,000
Këshilli i Lartë i Gjyqësor	-109,000	0	0	0	-109,000
Gjykata Kushtetuese	-19,000	0	0	0	-19,000
Këshilli i Lartë i Prokurorisë	-8,800	0	0	0	-8,800
Instituti Statistikës	-26,000	0	0	0	-26,000
Shkolla e Magjistraturës	-2,000	0	0	0	-2,000
Qendra Kombëtare e Kinematografisë	-9,900	0	0	0	-9,900
Institucionet e sistemit të drejtësisë	-14,300	0	0	0	-14,300
Avokati i Popullit	-1,960	0	0	0	-1,960
Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	-1,000	-1,000	0	-1,000	-2,000
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	-7,000	0	0	0	-7,000
Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	-4,000	0	0	0	-4,000
Autoriteti i Konkurrencës	-2,000	0	0	0	-2,000
Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	-1,000	0	0	0	-1,000
Institucione të tjera Qeveritare	-69,200	-2,000	0	-2,000	-71,200
Mbështetje për Shoqërinë Civile	-40,000	0	0	0	-40,000
Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	-3,000	0	0	0	-3,000
Komisioni i Prokurimit Publik	-10,000	0	0	0	-10,000
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	-1,890	0	0	0	-1,890
Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit	-4,000	0	0	0	-4,000
Autoriteti për të Drejtën e Informimit	-5,000	0	0	0	-5,000
TOTALI	-2,111,425	-4,255,000	-633,700	-4,888,700	-7,000,125

Akti Normativ nr. 28

Në mijë lekë

Emërtimi i Institucionit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale		Totali i Shp. Kapitale	Totali i Shpenzimeve Buxhetore
		Financim i Brendshëm	Financimi i Huaj		
Presidenca	0	0	0	0	0
Kuvendi	-28,000	-30,000	0	-30,000	-58,000
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	264,000	0	-8,000	-8,000	256,000
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	-4,000	8,586,336	-1,000,000	7,586,336	7,582,336
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	9,116,000	57,000	0	57,000	9,173,000
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	400,000	420,200	0	420,200	820,200
Ministria e Kulturës	-4,000	-55,000	0	-55,000	-59,000
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1,286,000	-60,000	0	-60,000	1,226,000
Ministria e Drejtësisë	-535,200	0	0	0	-535,200
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme	-19,000	0	0	0	-19,000
Ministria e Brendshme	105,500	585,200	0	585,200	690,700
Ministria e Mbrojtjes	-419,264	419,264	0	419,264	0
Shërbimi Informativ Shtetëror	0	7,000	0	7,000	7,000
Akademia e Shkencës	-5,000	0	0	0	-5,000
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	-15,000	0	0	0	-15,000
Këshilli i Lartë i Gjyqësor	-153,000	0	0	0	-153,000
Gjykata Kushtetuese	-13,000	0	0	0	-13,000
Agjensia Telegrafike Shqiptare	5,650	0	0	0	5,650
Instituti Statistikës	0	-20,000	0	-20,000	-20,000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	3,000,000	0	3,000,000	3,000,000
Institucionet e sistemit te drejtësisë	10,000	0	0	0	10,000
Institucione te tjera Qeveritare	432,500	-23,000	0	-23,000	409,500
Autoriteti për te Drejtën e Informimit	0	0	8,000	8,000	8,000
	10,424,186	12,887,000	-1,000,000	11,887,000	22,311,186

Akti Normativ nr. 34

Në mijë lekë

Emërtimi i Institucionit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shp. Kapitale	Totali i Shpenzimeve Buxhetore
		Financim i Brendshëm	Financimi i Huaj			
Kryeministria	5,000	0	0	0	5,000	
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	-53,600	-51,515	-119,137	-170,652	-224,252	
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	630,400	4,095,706	-265,863	3,829,843	4,460,243	
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	17,350	125,913	65,000	190,913	208,263	
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise	-280,000	-609,841	100,000	-509,841	-789,841	
Ministria e Kulturës	0	0	0	0	0	
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1,100,000	-360,026	-120,000	-480,026	619,974	
Ministria e Drejtësisë	-1,104,868	0	0	0	-1,104,868	
Ministria e Evropës dhe Punëve te Jashtme	-9,000	0	0	0	-9,000	
Ministria e Brendshme	0	-15,000	-100,000	-115,000	-115,000	
Ministria e Mbrojtjes	-382,500	-41,687	0	-41,687	-424,187	
Akademia e Shkencës	97,600	1,000	0	1,000	98,600	
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	60,000	-109,921	389,000	279,079	339,079	
Këshilli I Lartë I Gjyqësor	-103,000	0	0	0	-103,000	
Partitë Politike	10,850	0	0	0	10,850	
Instituti Statistikës	0	0	-169,000	-169,000	-169,000	
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	-2,300,000	150,000	-2,150,000	-2,150,000	
Institucionet e sistemit te drejtësisë	-49,300	0	0	0	-49,300	
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	0	673,000	0	673,000	673,000	
Institucione te tjera Qeveritare	1,500	92,370	70,000	162,370	163,870	
	-159,568	1,499,999	0	1,499,999	1,340,431	

C. Mbi regjistrimet për rishikimet buxhetore për vitin 2020

Nga analizimi i të dhënave të vëna në dispozicion, mbi rishikimet buxhetore përgjatë vitit 2020, u konstatua:

1. Edhe për vitin 2020 ka patur rishikime të shumta të fondeve buxhetore. Për sa i përket periudhës, edhe këtë vit, numri i lartë i rishikimeve buxhetore është i pranishëm përgjatë gjithë vitit. Kërkesat për rishikime vijnë nga pothuaj të gjitha njësitë ekonomike buxhetore, saktësisht 1033 të tilla.

Konkretisht, gjithsej rezultojnë **rreth 2327 rishikime me një ndryshim buxheti prej 50.7 miliard lekë**, nga të cilat 632 rishikime prekin investime kapitale.

Sipas Udhëzimit të përhershëm nr. 2 datë 06.12.2012, të ndryshuar, pika 79: *“Numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit”, dhe në bazë të numrit të lartë të rishikimeve mund të konkludojmë për një planifikim tepër të dobët të shpenzimeve për investime ashtu edhe ato për shpenzime operationale, nga ana e institucioneve qendrore dhe vendore, mungesës së analizave të mirëfillta para planifikimit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, mungesë monitorimi i zbatimit të buxhetit dhe veçanërisht të ecurisë së zbatimit të investimeve me rrjedhojë numrin e lartë të faturave të prapambetura nga vitit në vitë.*

Duhet të vlerësojmë se numri i lartë i akteve normative, lidhur edhe nga situata e krijuar nga Covid19, ka ndikuar në numrin e lartë të rishikimeve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

2. Nga shqyrtimi i të dhënave të rishikimeve buxhetore, një tjetër fenomen që vihet re është regjistrimi i rialokimeve me data kontabile efektive më të hershme (retrospektive). Referuar Udhëzimit standard për zbatimin e buxhetit, detajimi i buxhetit dërgohet zyrtarisht tek çdo njësi qendrore dhe bëhet i vlefshëm për zbatim vetëm pasi regjistrohet në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ) nga struktura përgjegjëse për buxhetin. Çdo regjistrim kalon nëpër disa faza miratimi. Kështu sipas udhëzuesit Urdhrit nr. 62 datë 31.08.2010 për zbatimin e operacioneve ditore në sistemin e Thesaritë ku parashikohen këto hapa: 1) Pranimi i dokumentacionit nga institucionet buxhetore; 2) Hetimi i të dhënave në sistemin e thesarit; 3) Regjistrimi i transaksionit të rishikimit; 4) Paraqitja për aprovim; Veprimi i aprovimit; Postimi i rishikimit të buxhetit në Librin e Madh; Kryerja e mbylljeve ditore në sistem, duke parashikuar kështu mjaftueshëm kontrolle për shmangien e gabimeve në regjistrim.

Gjithsej janë konstatuar 181 regjistrime datat efektive të cilave janë të një ose disa muajve më të hershëm, nga të cilat 52 raste janë regjistruar në vitin 2021, me datë efektive vitin 2020. Diferenca ndërmjet regjistrimit dhe datës efektive arrin deri në 1 vit.

Tabela në vijim bën një paraqitje të rasteve të 52 regjistrimeve në vitin 2021, me data efektive (GL2020) retrospektive, datat efektive të cilave janë më shumë se 30 ditë më të hershme:

Nr.	BUDGET REVISION ID	Diferenca ndërmjet regjistrimit dhe datës efektive
1	6342301	387
2	6350314	368
3	6342303	356
4	6343308	269
5	6333298	132
6	6359314	108
7	6338300	106
8	6347307	89
9	6347308	89
10	6364305	85
11	6364306	85
12	6338299	75
13	6348305	62
14	6346305	58
15	6345304	57
16	6345316	57
17	6344300	56
18	6343300	55
19	6343301	55
20	6343302	55
21	6343303	55
22	6343305	55
23	6342300	52
24	6341300	51
25	6341301	51
26	6341302	51
27	6341303	51
28	6341305	51
29	6339299	50
30	6339303	50
31	6339305	50
32	6339301	49
33	6339302	49
34	6339304	49
35	6338301	45
36	6337299	44



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

37	6334298	42
38	6334299	42
39	6333299	41
40	6333301	41
41	6333302	41
42	6333297	38
43	6332294	37
44	6332295	37
45	6332296	37
46	6332297	37
47	6332298	37
48	6331292	36
49	6331293	36
50	6331294	36
51	6330293	35
52	6330295	35

Burimi: AKSHI, (përpunuar nga grupi i auditimit)

Nisur nga sa më sipër, po evidentojmë të dhënat për 4 rishikimet e para të tabelës më sipër:

Rishikimet (4): 6342301, 6350314, 6342303, 6343308.

Vlera totale e rishikuar: **10,000 mijë lekë.**

Projektet e prekura (4): 91101AE ÷Veprimtari e MASR sipas kërkesave ligjore, 91103AB ÷Nxënës përfitues të shërbimit arsimor ne sistemin 9 vjeçar, 91104AA ÷Nxënës që regjistrohet dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë ne institucionet arsimore publike, 0, M063763 ÷Projekti COMM.98-Frot/AID98/001/00. Furnizim pajisje Sha Ujësllës - Kanalizime (shlyerje kredie).

Institucionet e prekura nga këto rishikime (16):

Në mijë lekë

Institucioni	Numri i rishikimeve	Vlera e rishikuar
Aparati i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (3535)	4	-2,563
Drejtoria e Përgjithshme e Ujësllës Kanalizimeve (3535)	1	5,000
PIU I Ujit (3535)	1	5,000
Zyra Vendore Arsimore, Bulqizë (0603)	2	90
Zyra Vendore Arsimore, Divjakë (0922)	2	276
Zyra Vendore Arsimore, Kamëz (3535)	3	332
Zyra Vendore Arsimore, Kavajë (3513)	2	107
Zyra Vendore Arsimore, Krujë (0716)	3	282
Zyra Vendore Arsimore, Lushnjë (0922)	4	374
Zyra Vendore Arsimore, Mat (0625)	4	422
Zyra Vendore Arsimore, Patos (0909)	2	60
Zyra Vendore Arsimore, Përmet-Këlcyrë (1128)	2	60
Zyra Vendore Arsimore, Roskovec (0909)	3	292
Zyra Vendore Arsimore, Rrogozhinë (3513)	2	60
Zyra Vendore Arsimore, Sarandë -Konispol (3731)	2	100
Zyra Vendore Arsimore, Shijak (0707)	2	107
TOTAL		10,000

Burimi: AKSHI, (përpunuar nga grupi i auditimit)

3. Janë kryer 442 rishikime pas datës 15 nëntor të vitit 2020, veprim në kundërshtim me nenin 48 ÷Afati për rishpërndarjen e fondeve buxhetore të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ÷Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ku citohet: ÷E drejta e njëjësive të qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve, të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri në datën 15 nëntor të çdo viti buxhetor. Më poshtë jepet tabela mbi numrin e rishikimeve pas datës 15 nëntor sipas muajve:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Nr.	Muaji	Numri i rishikimeve
1	16-30 Nëntor 2020	104
2	Dhjetor 2020	286
3	Janar 2021	47
4	Shkurt 2021	5
	TOTAL	442

Burimi: AKSHI, (përpunuar nga grupi i auditimit)

Siç shihet nga tabela, konstatohet se ndryshimet buxhetore që prekin vitin 2020 vazhdojnë deri në muajin shkurt të vitit 2021. Saktësisht deri në datën 24 shkurt 2021.

Rishikimet e muajit shkurt 2021:

Rishikimet (5): 6348305, 6350314, 6359314, 6364305, 6364306.

Vlera totale e rishikuar: **409,216 mijë lekë.**

Projektet e prekura (10): 1240017 òKompjuteraò, 18CF302 òProjekt IPA Milestone II DRKK Vloreò, 18CF303 òProjekt IPA Polyphonia MKò, 18CF311 òProjekti IPA SMART-CUL-TOURò, 18CF312 òProjekte IPA Milestone III DRKK Vlorëò, 18CF313 òIPA CREATURES, Promovimi i Turizmit Kreativò, 19AA102 òProjekti Unesco Inventarizimi me bazë Komunitare i Trashëgimisë Kulturore Jo materialeò, 91101AE òVeprimtari e MASR sipas kërkesave ligjoreò, 91103AB òNxënës përfitues të shërbimit arsimor ne sistemin 9 vjeçarò, 91104AA òNxënës që regjistrohet dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë ne institucionet arsimore publikeò.

Institucionet fondet e të cilave janë prekura nga këto rishikime **(18):**

Në mijë lekë

Institucioni	Numri i rishikimeve	Shuma e rishikimeve
Aparati Ministrisë Arsimit e Shkencës (3535)	4	-2,563
Bashkia Tirana (3535)	2	400,000
Drejtoria Rajonale e Monumenteve Vlore (3737)	4	6,585
Drejtoria Rajonale Kombëtare e Kulturës Korçë (1515)	1	498
Kultura Dhe Sporti (0217)	2	-100
Qendra Kombëtare e veprimtarive Folklorike (3535)	2	2,233
Zyra Arsimore Kamez (3535)	3	332
Zyra Arsimore Kavajë (3513)	2	107
Zyra Arsimore Krujë (0716)	3	282
Zyra Arsimore Lushnjë (0922)	4	374
Zyra Arsimore Mat (0625)	4	422
Zyra Vendore Arsimore, Bulqizë (0603)	4	150
Zyra Vendore Arsimore, Divjakë (0922)	2	276
Zyra Vendore Arsimore, Patos (0909)	2	60
Zyra Vendore Arsimore, Roskovec (0909)	3	292
Zyra Vendore Arsimore, Rogozhinë (3513)	2	60
Zyra Vendore Arsimore, Sarandë -Konispol (3731)	2	100
Zyra Vendore Arsimore, Shijak (0707)	2	107
TOTAL		409,216

Burimi: AKSHI, (përpunuar nga grupi i auditimit)

Rishikimet e muajit janar 2021 (pas datës 21):

Rishikimet (15): 6342300, 6342301, 6342303, 6343300, 6343301, 6343302, 6343303, 6343305, 6343308, 6344300, 6345304, 6345316, 6346305, 6347307, 6347308.

Vlera totale e rishikuar: **22,109,447 mijë lekë,** (rritje buxheti në vlerën 12,465,941 mijë lekë, dhe ulje buxheti në vlerën 9,643,506 mijë lekë).

91004AD	Gjoha të rimbursuara të COVID-19(rimbursimi i gjobave të vëna nga autoritetet e shteteve të huaja, shtetasve shqiptarë)
91305AH	Persona të vaksinuar me vaksinën anti COVID-19



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Nga verifikimi i detajuar i rezultoi se në tre projekte të COVID19, referuar regjistrin të pagesave, këto fonde janë përdorur edhe për mbulimin e shpenzimeve të tjera.

Konkretisht:

1. Projekti me kod 91301AB òMateriale mbrojtëse të blera për COVID-19. Vlera totale e pagesave për këtë kod projekti është 964,107,637 lekë.

Nga sa shihet nga tabela, nga ky kod projekti janë paguar 15 fatura me vlerë totale 39,740,293 lekë për pagesën e faturave të cilat nuk lidhen me COVID. 14 nga 15 fatura i përkasin viteve 2018 dhe 2019. Pra janë mbuluar detyrime të prapambetura të viteve të kaluara.

2. Projekti me kod 91704AF òFond Emergjence per masat anti-Covid-19 (me VKM)(Korente)ò. Vlera totale e pagesave për këtë kod projekti është 167,530,864 lekë.

Nga sa shihet nga tabela e mëposhtme, nga ky kod projekti janë paguar 30 fatura me vlerë totale 48,760,576 lekë për pagesën e faturave të cilat nuk lidhen me COVID.

3. Projekti me kod 91304AJòPacientë të trajtuar në shërbimin spitalor per Covid-19. Vlera totale e pagesave për këtë kod projekti është 464,328,503 lekë. Nga sa shihet nga tabela e mëposhtme, nga ky kod projekti janë paguar 58 fatura me vlerë totale 114,875,805 lekë për pagesën e faturave të cilat nuk lidhen me COVID.

Tabelat e detajuara të rasteve janë pasqyruar në Aneksin nr. 1

Në total për rastet e testuara më sipër, rezultoi se janë paguar 203,376,674 lekë për shpenzime të ndryshme nga COVID19.

Pagesa e faturave që nuk lidhen me objektin e projektit është në kundërshtim me Udhëzimin nr.9, datë 20.03.2018 òPër Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetitò, i ndryshuar. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi NA dhe NZ të institucioneve si dhe degët e thesarit të cilat kanë kryer veprimet për këto pagesa.

G. Fondet e rindërtimit

Në zbatim të ligjit nr. 88/2019 òPër buxhetin e vitit 2020ò, neni 7 është përcaktuar se Fondi i Rindërtimit prej 20 miliardë lekë i cili përdoret për përbalimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019, përbëhet nga:

- Grante 7 miliardë lekë
- Shpenzime të buxhetit të shtetit 13 miliardë lekë

Fondi prej 20 miliardë lekë, shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi, të miratuar në tabelën 1, të nenit 11 të këtij ligji.

Çdo e ardhur në formë granti me destinacion përbalimin e pasojave të tërmetit, mbi tavanin prej 7 miliardë lekë, rrit në të njëjtën masë të ardhurat dhe shpenzimet e Fondit të Rindërtimit, duke shtuar kufijtë e përcaktuar në nenin 1, 2, 8 dhe 11, si dhe kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4, të nenit 11, të këtij ligji.

Në fund të vitit buxhetor, fondet e pashpenzuara trashëgohen në vitin pasardhës dhe përdoren për të njëjtin qëllim.

Mënyra e përdorimit të Fondit të Rindërtimit, programet buxhetore ku do alokohet fondi si dhe institucionet dhe agjencitë, zbatuese të tij, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Me aktin normativ nr. 6 datë 21.03.2020 paragrafi i tretë i nenit 7 është riformuluar duke përcaktuar se fondi prej 20 miliard lekë, shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi, të miratuar në tabelën 1, të nenit 11 të këtij ligji, si dhe kufijtë e transfertës së pakushtëzuar të miratuar në tabelën 3, të nenit 15 të këtij ligji.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

Me aktin normativ nr. 28, datë, 02.02.2020 neni 7, Fondi i Rindërtimit është ndryshuar dhe është bërë ò... 34 miliardë lekësh...ò dhe nënndarjet e dytë dhe e tretë kanë ndryshuar:

ò-Grante 3 miliardë lekë.

- Shpenzime të buxhetit të shtetit 31 miliard lekë.

Me aktin normativ nr. 34, datë 16.12.2020 neni 7, Fondi i Rindërtimit është ndryshuar dhe është bërë ò... 32 miliardë lekë...ò dhe nënndarjet e dytë dhe e tretë ndryshohen si vijon:

ò-Grante 3 miliardë lekë.

- Shpenzime të buxhetit të shtetit 29 miliard lekë.

Paragrafi i tretë është riformuluar si me poshtë:

Fondi prej 32 miliard lekë, shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi, të miratuar në tabelën 1, të nenit 11 të këtij ligji, si dhe kufijtë e transfertës së pakushtëzuar të miratuar në tabelën 3, të nenit 15 të këtij ligji.

Në mënyrë të përmbledhur ndryshimet e ligjit për këtë fond paraqiten si më poshtë:

Në miliard lekë

Fondi i rindërtimit	Ligji nr.88/2019	AN 28	AN 34
Grant	7	3	3
Shpenzime të buxhetit të shtetit	13	31	29
Total	20	34	32

Referuar të dhënave të raportuar nga MFE për përdorimin e fondit të rindërtimit, duke marrë në konsideratë vetëm pjesën e fondeve të buxhetit të shtetit (sipas së cilave bazohet ky fond, pasi sikundër do të trajtohet më poshtë pjesa e alokimit të fondeve me burim grantet e rindërtimit nuk reflektohet si plan), dhe duke hequr planin dhe pagesat e kapitullit 6 për shpenzimet e kryera nga disa bashki, plani deri në fund të vitit i Fondit të Rindërtimit rezulton rreth 25 miliard lekë, dhe realizimi deri në fund të vitit rreth 15 miliard lekë. *Referuar SIFQ gjendja e pashpërndarë e fondeve të rindërtimit në fund të vitit 2020 është 3,235,625,501 lekë.*

Në opinionin e grupit të auditimit, monitorimi i ekzekutimit të buxhetit të alokuar në kuadër të rindërtimit është i cunguar pasi kodet e projekteve të çelura për këtë qëllim nuk janë konsistente. Në lidhje me këtë problematikë, Ministri i Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 23038 prot, datë 10.12.2020, ka kërkuar sistemimin e fondit të rindërtimit sipas kodeve të produkteve specifike, për shkak se rezultojnë të regjistruar në të njëjtin kod produkti si fondet për kryerjen e veprimtarisë normale të njësisë shpenzuese ashtu edhe fondet e rindërtimit.

Më hollësisht, pas miratimit të Ligjit për vitin 2020, në databazën e pagesave nga SIFQ është çelur projekti i rindërtimit me kod 94902AA në vlerën 20,000,000,000 mijë lekë. Rishikimet e kryera gjatë vitit në këtë kod, për alokimet e kryera në njësitë e qeverisjes së përgjithshme qendrore dhe vendore nuk mundësojnë identifikimin e projekteve në të cilat janë akorduar fondet. Në këto kushte, nuk mund të verifikohet reflektimi i VKM-ve në regjistrin e rishikimeve, për të identifikuar vlerat e fondeve që u janë akorduar njësisë, dhe periudhën kohore në të cilën janë miratuar fondet në sistem. Gjithashtu, në lidhje me realizimin e fondeve, duke qenë se kodet e produkteve /projekteve të rindërtimit nuk janë konsistente nga momenti i alokimit të fondeve në zbatim të VKM-ve, deri në realizimin e shpenzimeve sipas databazës së pagesave nga SIFQ, nuk është i mundur verifikimi i saktësisë së raportit të gjeneruar nga MFE për përdorimin e fondit të rindërtimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

Nëse bazohemi në dokumentacionet e vendosura në dispozicion, niveli i realizimit të fondit të rindërtimit për çdo institucion sipas databazës së pagesave nga SIFQ për kodet e vëna në dispozicion si kodet e programit të rindërtimit, krahasuar me raportin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, rezulton si më poshtë:

Në lekë

Institucioni	Niveli i realizimit sipas raportit të MFE për fondin e Rindërtimit	Niveli i realizimit sipas modulit të pagesave në SIFQ
Agjencia Kombëtare e Planifikimi	89,467,590	88,159,590
Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	16,501,200	16,501,200
Agjencia Kombëtare e Bregdetit	152,535,999	
Aparati i Ministrisë së Infrastr	160,000,000	160,000,000
Bashkia Durrës (0707)	3,708,237,149	107,121,922
Bashkia Kamez (3535)	18,263,702	
Bashkia Kruje (0716)	754,835,326	68,085,326
Bashkia Laç (2019)	574,905,738	
Bashkia Lezhe (2020)	376,376,144	53,876,144
Bashkia Shijak (0707)	798,504,296	222,424,965
Bashkia Tirana (3535)	2,154,086,563	84,273,900
Enti Kombëtar i Banesave (3535)	13,275,898	13,275,898
Fondi i Zhvillimit Shqiptar (353)	6,522,220,932	6,522,608,412
Instituti Kombëtar i Trashëgimisë	190,174,800	219,510,800
Grand Total	15,529,385,337	7,555,838,157

Ndërkohë për rastet e tabelës së mëposhtme konstatohet se rezultojnë me pagesa sipas raportit të MFE, ndërkohë sipas databazës së pagesave nga SIFQ, nuk rezulton asnjë pagesë:

Në lekë

Institucioni	Realizimi sipas modulit të pagesave	Realizimi sipas raportit të MFE
Bashkia Rrogozhine		110,900,000
Bashkia Kavaje		334,350,000
Bashkia Laç		574,905,738
Bashkia Vore		183,900,000
Bashkia Kamez		350,025,702

- Nga auditimi u konstatua se në zbatim të VKM-ve të dala për përdorimin e fondeve të rindërtimit për bashkitë, në rastet kur si burim i financimit është përcaktuar granti i rindërtimit, kjo shtesë e fondeve buxhetore nuk rezulton të jetë reflektuar në planin buxhetor. Si rezultat, raporti i gjeneruar nga MFE për përdorimin e fondit të rindërtimit krahasuar me planin, nuk pasqyron të dhëna për pjesën e Fondit të Rindërtimit me burim financimi grante. Më hollësisht, për bashkitë plani i fondeve të miratuara sipas VKM-ve për rindërtimin sipas MFE për vitin 2020 është në vlerë 14,908,746,914 lekë (pa përfshirë këtu kapitullin 6) dhe realizimi në vlerë 8,385,208,918 lekë. Ndërkohë, sipas VKM-ve, pjesë e planit buxhetor në kuadër të fondit të rindërtimit duhet të reflektohej edhe vlera prej 2,256,737,866 lekë. Raporti i MFE nuk mundëson gjenerimin e informacionit për nivelin e realizimit të këtyre fondeve për vitin 2020. Më hollësisht në nivel bashkie situata paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Bashkia	Fondi i rindërtimit			Përdorimi i fondeve të rindërtimit			Realizimi % ⁶
		Buxheti i Shtetit	Grant	Total Plani	Realizimi buxhet shtetit	Realizimi grant	Total realizimi	

⁶ Niveli i realizimit kundrejt planit për pjesën e fondeve të rindërtimit me financim nga buxheti i shtetit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

1	Tiranë	5,919,650	0	5,919,650	2,154,086		2,154,086	36%
2	Shijak	1,155,506	108,540	1,264,046	798,504	NA	798,504	63%
3	Kavajë	18,250	428,500	446,750	0	NA	0	0%
4	Mirditë	0	29,820	29,820		NA		0%
5	Rrogozhinë	0	110,900	110,900		NA		0%
6	Krujë	1,056,325	72,377	1,128,702	754,835	NA	754,835	67%
7	Durrës	4,949,880	128,595	5,078,475	3,708,237	NA	3,708,237	73%
8	Lezhë	541,630	501,041	1,042,671	376,376	NA	376,376	36%
9	Kamëz	18,264	359,543	377,807	18,263	NA	18,263	5%
10	Kurbin	1,249,241	296,969	1,546,210	574,905	NA	574,905	37%
11	Vorë		220,450	220,450		NA		0%
Total		14,908,746	2,256,735	17,165,481	8,385,208	NA	8,385,208	49%

Projekti òRindërtimi i Urës së Tapizësò, është miratuar si projekt me VKM nr. 525 datë 01.07.2020 òPër përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të Urës së Tapizës dhe caktimin e Autoritetit Rrugor Shqiptar si njësi zbatueseò ku i kanë kaluar ARRSH-së fondet prej **151,539 mijë lekë**. Nga regjistri i rishikimeve rezulton se fondet janë bërë disponibël në datë 22.07.2020. Procedura e prokurimit për këtë projekt është shpallur ne 30.07.2020 dhe kontrata është lidhur në 22.09.2020 me afat 12 muaj. Deri në fund të vitit 2020 për këtë projekt **nuk është bërë asnjë pagese, dhe fondet në vlerë 151 milion lekë nuk rezultojnë të jenë rishpërndarë**.

Kodi_Institucioni	Institucioni	Institucioni	Prog		Llog	Kodi_Projektit	Emërtim projekti	Llog	Balanc	Vlera
Ministria e Infrastrukturës	1006054	Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	4520	Transporti Rrugor	231	3535	19AH101	Rindërtimi i urës së Tapizës	-	151,539,896

Me VKM nr. 88, datë **31.1.2020** “Për një shtesë fondi, nga fondi për rindërtimin në buxhetin e miratuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2020, për akomodimin e përkohshëm të dëmtuarve ne qarqet Durrës, Tiranë e Lezhë” është përcaktuar se për Ministrinë e Turizmit do të kalojnë fondet 200,000 mijë lekë, për institucionin Agjencia Kombëtare e Bregdetit. Nëse i referohemi regjistrit të rishikimeve, rezulton se në sistem është çelur projekti 92603AD òTë dëmtuar nga tërmeti të akomoduar përkohësishtò në llogarinë 602 në **21 Dhjetor 2020**, ku është reflektuar kjo shtesë e fondit. Nga databaza e pagesave nga SIFQ nuk rezulton asnjë pagesë për këtë kod, dhe fondet në vlerën **200 milion lekë nuk janë rishpërndarë**.

Me VKM nr. 499, datë **24.06.2020** òPër disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 359, datë 04.05.2020 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit, për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësi administrative Laç, Bashkia Kurbinò është përcaktuar vlera e kompensimit prej 44,889,589 lekë dhe bashkëlidhur lista e personave që do të kompensohen. Nëse i referohemi regjistrit të rishikimeve, në datën 26.05.2020 është çelur projekti 91010AF në vlerën 43,009,339 lekë. Shtesa e VKM me 1,880,250 leke nuk reflektohet. Pagesat e kryera për periudhën shtator, dhjetor dhe janar 2021 për këtë kod janë në vlerën 13,275,898, pra rreth 1/3 e buxhetit.

Me VKM nr.103, datë **5.2.2020** “Për caktimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit(AKSHI) si njësi zbatuese për ngritjen e portalit unik qeveritar të procesit të rindërtimit dhe financimin e tij nga fondi i rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020ò, ku nëse i referohemi regjistrit të rishikimit është bërë transferimi i fondeve në llogarinë 602 në vlerën 1,080,000 lekë në 8 Prill, dhe në 7 Prill vlera prej 18,360,360 lekë në kodin 19AD901 òNgritja e sistemit unik qeveritar për procesin e rindërtimit dhe transparencësò, ku sipas regjistrit është lidhur kontrata në 10.03.2020 dhe është ekzekutuar pagesa në datën 23.07.2020 në vlerë 16,501,200 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Lidhur me VKM nr. 213, datë 11.3.2020 *ËPër caktimin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore si Njësi Zbatuese, dhe për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020 për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e restaurimit /rindërtimit të pasurive kulturore* janë kaluar për Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), 236,627,069 lekë, përkatësisht: a) Vlerën prej 197,500,584 lekë pa TVSH, dhe b) Vlerën prej 39,126,485 lekë pa TVSH. Nëse i referohemi rishikimeve të kryera në sistem rezultojnë se në datën 8 Prill janë çelur projektet si me poshtë, dhe me pas janë rishikuar në 20.05.2020.

Projekti	Çelja 08.04.2020	Rishikim 20.05.2020	Realizimi	
19AD701	Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruse në 4 objekte kulti pasuri kulturore"	7,753,831	6,461,526	7,921,200
19AD702	Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruse në 8 objekte pasuri kulturore dhe muze në Bashkinë Durrës"	50,401,210	42,001,008	56,848,000.00
19AD703	Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruse në 5 objekte pasuri kulturore"	114,480,166	95,400,138	72,124,000.00
19AD704	Hartim Projekti për "Ndërhyrje Përforcuese dhe Rehabilitimi i 9 objekteve institucione publike në Bashkinë Tiranë"	35,663,405	29,719,504	29,422,600.00
19AD705	Hartim Projekti për "Ndërhyrje Përforcuese dhe Rehabilitimi i 12 objekteve në Bashkinë Tiranë, Krujë, Lezhë, Kavajë, Mirëditë"	28,702,090	23,918,408	22,515,000
19AD801	Hartimi i Raporteve të Vëzhgimit Arkeologjik në 24 Zonat e Reja të Zhvillimit	9,613,093	8,010,911	7983500
19AD802	Kryerja dhe Hartimi i Raporteve të Sondazheve Arkeologjike në 2 zonat e reja të Zhvillimit	21,112,589	17,593,824	1,7468,700
19AD803	Kryerja e Monitorimit Arkeologjik në 26 zonat e reja të Zhvillimit	16,226,100	13,521,750	0
Total		283,952,484	236,627,069	214,283,000

Titulli i gjetjes:	Mangësi të konstatuara në drejtim të rishikimeve buxhetore të kryera si rezultat i situatës së shkaktuar nga pandemia COVID dhe tërmeti i Nëntorit 2019, ku monitorimi dhe verifikimi i ekzekutimit të fondeve të alokuar nuk është i plotësisht i mundur pasi kodet e projekteve të çelura për këtë qëllim nuk janë konsistente, janë kryer një numër i lartë rishpërndarjesh në kode projektesh jo të dedikuara për gjurmimin e destinacionit dhe autorizimit të fondit, janë kaluar në formën e transfertës së pakushtëzuar të pushtetit vendor, etj.
Situata 1	Nga auditimi i rishikimeve të fondeve buxhetore për sa i përket fondeve të dedikuara për përballimin e situatës së shkaktuar nga COVID-19, u konstatua se krahas faktit se kodet e projekteve nuk janë konsistente, janë kryer rishikime të shumta të këtyre fondeve, pas akteve normative me një sërë VKM, duke e bërë të vështirë gjurmimin e realizimit përfundimtar. Kështu, grupi i auditimit testoi në regjistrin e pagesave, disa nga kodet e projekteve të cilat sipas përshkrimit janë të dedikuara për mbulimin e shpenzimeve për COVID-19, dhe rezultoi se në disa raste këto fonde janë përdorur për mbulimin e shpenzimeve të tjera operative, si: likuidime të energjisë elektrike, internetit, dieta, shërbim ruajtje objekti, luanterie, kontratave të ndryshme mirëmbajtjeje në vazhdim, etj. Konkretisht: - Projekti me kod 91301AB <i>Materialë mbrojtëse të blera për COVID-19</i> . Vlera totale e pagesave për këtë kod projekti është 964,108 mijë lekë, nga të cilat janë paguar 15 fatura me vlerë totale 39,740 mijë lekë për pagesën e shpenzimeve të cilat nuk lidhen me COVID-19; Projekti me kod 91704AF <i>Fond Emergjence për masat anti-Covid-19 (me VKM) (Korentë)</i> . Vlera totale e pagesave për këtë kod projekti është 167,530 mijë lekë. Nga ky kod projekti janë paguar 30 fatura me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

vlere totale 48,760 mijë lekë për pagesën e shpenzimeve të cilat nuk lidhen me COVID-19; Projekti me kod 91304AJ òPacientë të trajtuar në shërbimin spitalor për Covid-19. Vlera totale e pagesave për këtë kod projekti është 464,328 mijë lekë, nga të cilat janë paguar 58 fatura me vlerë totale 114,876 mijë lekë për pagesën e shpenzimeve të cilat nuk lidhen me COVID-19. **Në total, vetëm për rastet e konstatuara më sipër, rezultoi se janë paguar 203,376 mijë lekë për shpenzime të ndryshme nga COVID-19.** Shkak për këtë situatë mund të jetë edhe pamundësia e institucioneve përfituese për të raportuar shpenzimet në kodet e duhura gjatë rakordimeve me degën e thesarit, apo për të veçuar këto shpenzime nga ato të aktivitetit rutinë të institucionit, në rastet kur këto të fundit janë të lidhura ngushtësisht me njëra tjetrin (si p.sh. rasti i spitaleve rajonale).

Me Aktin Normativ nr. 6 datë 21.03.2020, është parashikuar krijimi i një fondi anti-Covid-19 prej **2,500 milion lekë**, i cili do të detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për shpenzime korente dhe kapitale. Për këtë, është vendosur kryerja e një ndryshimi në nenin 5 të ligjit nr. 88/2019 òPër buxhetin e vitit 2020, duke shtuar transferimet nga buxheti i shtetit për sigurimet shëndetësore me vlerën 1,200 milion lekë. Nga rishikimet e kryera në programet e FSDKSSH ku janë reflektuar këto ndryshime rezultojnë se fillimisht **shtesa prej 1,200 milion lekë** është akorduar në kodin e çelur për COVID-19: 91304AJ òPacientë të trajtuar në shërbimin spitalor për Covid-19. Për të mundësuar financimin e **pjesës tjetër të fondit për Covid-19 prej 1,300 milion lekë**, janë pakësuar 450 milion lekë fonde nga programi parësor 07220 (reduktuar shpenzimet e akorduara në kodin e projektit 91303AB òPersona që përfitojnë check up) dhe 850 milionë lekë nga programi dytësor (spitalor) 07330 òPacientë të trajtuar në shërbimin spitalor. Pra, në total nga 1.3 miliard lekë të akorduara fillimisht për programet shëndetësore të FSDKSSH, duke marrë në konsideratë shtesën prej 0.5 miliard lekë që i janë akorduar institucionit, janë reduktuar me 0.8 miliard lekë fondet për programet parësore dhe dytësore të FSDKSSH, në mënyrë që të mundësohej financimi prej 2.5 miliard lekë i COVID-19 në kushtet kur shtesa e transferimit buxhetor për shërbimin spitalor me Aktin Normativ nr. 6 ka qenë vetëm 1.2 miliard lekë.

-Me Aktin Normativ nr. 6 është parashikuar gjithashtu që duke përfshirë edhe rialokimet e brendshme, mbështetja financiare për masat anti-Covid-19 të arrijë në 12 miliard lekë, nga të cilat sipas nenit 7 të këtij AN, **2 miliard lekë** (1 miliard lekë shpenzime korrente dhe 1 miliard lekë shpenzime kapitale) janë rialokuar brenda buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes nga disa programe: në programin òMbështetje për Shëndetësinë për t'u përdorur për furnizimin me ushqim të komuniteteve të caktuara që do të rezultojnë të prekura nga pandemia, për familje me ndihmë ekonomike, pensionistë të vetmuar që do të kenë nevojë për ndihmë direkte dhe për nevoja të ekipeve mjekësore, si në spitalet civile ashtu edhe në spitalin ushtarak. Me Aktin Normativ nr. 15, datë 15.04.2020 në nenin 1 të tij, vlera prej 2 miliard lekë është pakësuar me 1 miliard lekë; dhe më pas me Aktin Normativ nr. 28, datë 02.07.2020 me nenin 5, pika 2 të tij, paragrafi i fundit i nenit 11 të ligjit është shfuqizuar, duke e çuar në 0 mbështetjen financiare për shëndetësinë në Ministrinë e Mbrojtjes. Nga verifikimi i regjistrit të rishikimeve rezultojnë se nga fondi prej 2 miliard lekë, është pakësuar rreth 1.8 miliard lekë, ndërsa rreth 181 milion lekë të akorduara në këtë program si shpenzime korrente për Spitalin e Traumës nuk janë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

rishpërndarë, por i kanë mbetur spitalit. Nga auditimi i shitesave dhe pakësimeve të programeve të Ministrisë së Mbrojtjes, rezulton se pakësimet e programit ombështetje për Shëndetësinë, planifikuar fillimisht si mbështetje e pandemisë, janë rialokuar si shtesa në programin e ÷Emergjencave Civile÷ të këtij institucioni. Për këtë program fillimisht me ligjin e buxhetit ishin planifikuar 315 milionë lekë nga të cilat 295 milion lekë shpenzime korrente dhe 20 milion lekë shpenzime kapitale; dhe pas shitesave dhe pakësimeve përgjatë vitit pas Aktit Normativ nr. 34, ky program rezulton me një buxhet prej 815 milionë lekë nga të cilat 314 milion shpenzime korrente dhe **501 milion lekë shpenzime kapitale**. Në këtë program janë likuiduar fatura të kontratave të lidhura një vit më parë në kuadër të tërmetit në qytetin e Korçës, fondet për të cilat në fillim të vitit me Ligjin e Buxhetit rezultojnë se nuk kanë qenë të planifikuara. Më hollësisht, buxhetet e planifikuara me ligj buxheti, si shtesat/pakësimet sipas Akteve Normative për këto dy programe paraqiten si më poshtë:

Në mijë lekë

Programi	Ligji	AN 6		AN 15		AN 28		AN 34			
		Korren te	kapitale	Korren te	kapitale	Korren te	kapitale	Korren te	Kapitale		
07340	Mbështetje për Shëndetësinë	845,550	50,000	1,276,864	1,618,686	1,276,864	618,686	1,026,864	50,000	1,106,864	50,000
10910	Emergjencat Civile	295,000	20,000	295,000	20,000	295,000	20,000	330,000	661,000	314,000	501,000

- Nga auditimi i regjistrimit të rishikimeve të MSHMS u konstatuan 3 projekte me vlerë totale **15,791 mijë lekë** të çelura për t'u realizuar me **burim financimi nga fondi** i COVID-19 (nga 1 miliard lekë të alokuara nga ky fond për investime në kuadër të pandemisë). Me këto fonde janë likuiduar fatura të kontratave të lidhura një vit më parë: ÷Rikonstruksione në disa ambiente të godinës së MSHMS÷. Sipas përshkrimit të faturës së likuiduar rezulton me urdhër prokurimi nr.685 dt 08.10.2019, kontratë nr. 4805.10 datë 05.12.2019; ÷Projekti Hartim i projekt preventivit të zbatimit për ndërtimin e Qendrës së re të Biosimulimit Klinik dhe edukimit në vazhdim për Universitetin e Mjekësisë Tiranë, në kuadër të paktit për universitetin me urdhër prokurimi nr.626 dt 29.08.2019, kontrata nr. 4254.21 datë 10.12.2019. Më hollësisht këto projekte janë trajtuar në pikën C, gjetja 6 e këtij vendimi.

Në mijë lekë

Nr	Kodi i projektit	Projekti	Vlera
1	18BA502	Rikonstruksione ne disa ambiente te godinës se MSHMS	9,194
2	18BA503	Superv+kolaud per rikonstruksionin e disa ambiente te godinës se MSHMS	96
3	18BA506	Hartim i projekt preventivit te zbatimit per ndërtimin e Qendrës se re te Biosimulimit Klinik dhe edukimit ne vazhdim per Universitetin e Mjekësisë Tirane, ne kuadër te paktit per universitetin	6,500

-Nga auditimi i të dhënave të rishikimeve të kryera në kuadër të pandemisë, konstatohet se **nga Fondi i Kontigjencës për COVID-19** ndër të tjera janë alokuar për Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive **118,344 mijë lekë** në programin 10550- ÷Tregu i punës÷, të cilat janë shpërndarë më pas në disa drejtori rajonale AKPA, si fonde për të akorduar ndihmë financiare për punonjësit e prekur



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

nga virusi COVID-19. Në vijim, me VKM nr. 856, datë 04.11.2020 është vendosur akordimi i një ndihme financiare për disa prej kategorive kryesore të ndërmarrjeve, të cilat zbatojnë protokollet e sigurisë, në kuadër të parandalimit të pandemisë COVID-19. Për financimin e këtyre shpenzimeve nuk është akorduar një buxhet shtesë, por është vendosur që efektet financiare në vlerë deri në masën **187,092 mijë lekë** të përballohen nga zëri “*Nxitja e punësimit*”, në programin 10550-0Tregu i punës, në buxhetin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, miratuar për vitin 2020. Në konkluzion, në total për programin 0Tregu i punës duke krahasuar shtesat nga Fondi i Kontigjencës për COVID-19, me pakësimin e kryer për të mundësuar zbatimin e VKM nr. 856, datë 04.11.2020, i kanë reduktuar me **68,742 mijë lekë** fondet për Drejtoritë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive në programin 10550.

Situata 2

Nga auditimi u konstatua se monitorimi i ekzekutimit të buxhetit të alokuar për rindërtimin është i cunguar pasi kodet e projekteve të çelura për këtë qëllim nuk janë lehtësisht të gjurmueshme. Në lidhje me këtë problematikë, Ministri i Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 23038 prot, datë 10.12.2020, ka kërkuar sistemimin e fondit të rindërtimit sipas kodeve të produkteve specifike, për shkak se rezultojnë të regjistruar në të njëjtin kod produkti si fondet për kryerjen e veprimtarisë normale të njësisë shpenzuese ashtu edhe fondet e rindërtimit. Më hollësisht, pas miratimit të Ligjit për vitin 2020, në regjistrin e SIFQ është çelur projekti i rindërtimit me kod 94902AA në vlerën 20,000,000 mijë lekë. Rishikimet e kryera gjatë vitit në këtë kod, për alokimet e kryera në njësitë e qeverisjes së përgjithshme qendrore dhe vendore nuk mundësojnë identifikimin e projekteve në të cilat janë akorduar fondet. Në këto kushte, nuk mund të verifikohet reflektimi i VKM-ve në regjistrin e rishikimeve, për të identifikuar vlerat e fondeve që u janë akorduar njësisë, dhe periudhën kohore në të cilën janë miratuar fondet në sistem. Gjithashtu, në lidhje me realizimin e fondeve, duke qenë se kodet e produkteve /projekteve të rindërtimit nuk janë konsistente nga momenti i alokimit të fondeve në zbatim të VKM-ve, deri në realizimin e shpenzimeve sipas regjistrit të pagesave, nuk është i mundur verifikimi i saktësisë së raportit të gjeneruar nga MFE për përdorimin e fondit të rindërtimit.

Në miliard lekë

Fondi i rindërtimit	Ligji nr.88/2019	AN 28	AN 34
Grant	7	3	3
Shpenzime të buxhetit të shtetit	13	31	29
Total	20	34	32

Nga auditimi u konstatua se në zbatim të VKM-ve të dala për përdorimin e fondeve të rindërtimit për bashkitë, në rastet kur si burim i financimit është përcaktuar granti i rindërtimit, kjo shtesë e fondeve buxhetore nuk rezulton të jetë reflektuar në planin buxhetor. Si rezultat, raporti i gjeneruar nga MFE për përdorimin e fondit të rindërtimit krahasuar me planin, nuk pasqyron të dhëna për pjesën e Fondit të Rindërtimit me burim financimi grante. Më hollësisht, për bashkitë plani i fondeve të miratuara sipas VKM-ve për rindërtimin sipas MFE për vitin 2020 është në vlerë 14,908,747 mijë lekë (pa përfshirë këtu kapitullin 6) dhe realizimi në vlerë 8,385,209 mijë lekë. Ndërkohë, sipas VKM-ve, pjesë e planit buxhetor në kuadër të fondit të rindërtimit duhet të reflektohej edhe vlera prej 2,256,738 mijë lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

	<p>Raporti i MFE nuk mundëson gjenerimin e informacionit përmbledhës për nivelin e realizimit të këtyre fondeve për vitin 2020.</p> <p>Referuar të dhënave të raportuar nga MFE për përdorimin e fondit të rindërtimit, duke marrë në konsideratë vetëm pjesën e fondeve të buxhetit të shtetit dhe jo grantet, rezulton të jetë rreth 25 miliard lekë nga të cilat janë realizuar pagesa rreth 15 miliard lekë ose 60% e fondit të shpërndarë. Sipas SIFQ gjendja e pashpërndarë e fondeve të dedikuara për Rindërtimin (pa përfshirë grantet) sipas Akteve normative në fund të vitit 2020 është 3,235,626 mijë lekë.</p>
Kriteri	<p>Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ndryshuar</p> <p>Ligji nr.10296, datë 08.07.2010òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar;</p> <p>Udhëzimi nr.9, datë 20.03.2018 òPër procedurat standarde të Zbatimit të Buxhetitò:</p> <p>Udhëzimi nr.9/1, datë 20.03.2018 òPër procedurat standarde të Zbatimit të Buxhetitò për njësitë e qeverisjes së Përgjithshme që përdorin SIFQ:</p> <p>Udhëzimi nr. 2, datë 20.01.2020 òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020ò</p> <p>Udhëzimi plotësues nr.26, datë 08.07.2020 òPër një shtesë dhe disa ndryshime në udhëzimin plotësues nr.2, datë 20.01.2020 òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020ò</p> <p>Udhëzimi plotësues nr.2/1, datë 21.09.2020 òPër një shtesë në udhëzimin plotësues nr.2, datë 20.01.2020 òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020ò, të ndryshuarò</p> <p>Akti Normativ nr. 6, datë 21.03.2020; nr. 15, datë 15.04.2020; nr. 28, datë 02.07.2020; nr. 34, datë 16.12.2020.</p>
Impakti	<p>Pamundësi për të monitoruar shpërndarjen e fondeve buxhetore në planifikim dhe realizimin e tyre sipas institucioneve përfituese; Risk për përdorimin e këtyre fondeve për mbulimin e detyrimeve jashtë qëllimit të alokuar.</p>
Shkaku	<p>Mungesa e konsistencës në kodet e çelura për këto fonde si në plan dhe në fakt.</p>
Rëndësia	<p>E lartë</p>
Rekomandimi	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit pranë MFE, të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme në kodet e projekteve të çelura në kuadër të pandemisë dhe atyre të rindërtimit si dhe raportimin e konsoliduar sipas burimit të financimit të këtyre fondeve duke përfshirë grantet, në mënyrë që të mundësohet monitorimi i këtyre projekteve si për efekt të rishpërndarjeve në planin buxhetor, ashtu edhe në realizimin e tyre deri në fund të vitit, në zbatim edhe të parimeve të qeverisjes bazuar mbi transparencën e informacionit në mënyrë që ai të jetë lehtësisht i aksesueshëm nga palët e interesit.</p> <p>-Për rastet e trajtuar më sipër ku përshtkrimi i faturës nuk rezulton të lidhet me situatën e shkaktuar nga COVID-19, Nëpunësi i Parë Autorizues të marrë masat për të ngritur një grup pune për të verifikuar nëse kemi të bëjmë me një keq klasifikim të shpenzimeve në kodin e COVID-19 apo këto institucione kanë shpenzuar fondet e COVID-19 për mbulimin e detyrimeve të tjera ndaj atyre të parashikuara për rastet e trajtuara, dhe të marrë masat kundrejt NA dhe NZ respektive.</p>
Titulli i gjetjes:	<p>Mos reflektim i VKM-ve të miratuara përgjatë vitit për shtesa në kufirin e planit të buxhetit në dispozicion, në tabelat shoqëruese të akteve normative të dala përgjatë vitit</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

Situata	<p>- Nga auditimi konstatohet se Aktet Normative të miratuara gjatë vitit 2020, nuk kanë reflektuar në tabelat shoqëruese respektive të gjitha shtesat e fondeve të akorduara me VKM përgjatë këtij viti. Më hollësisht, në zbatim të VKM-së nr. 205, datë 09.03.2020 është përcaktuar se Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në programin e Planifikimit Menaxhim dhe Administrimit i shtohet fondi prej 200 milionë lekë shpenzime kapitale dhe 200 milionë lekë shpenzime korrente. Më pas, me VKM nr. 249, datë 27.03.2020 është përcaktuar se në buxhetin e MSHMS detajohet alokimi i fondeve të tjera shtesë në programin e Planifikimit Menaxhim dhe Administrimit prej 800 milionë lekë si shpenzime korrente dhe 1 miliard lekë si shpenzime kapitale. Nga auditimi konstatohet se referuar tabelës nr.1, shoqëruese të Akteve Normative të dala përgjatë vitit nuk janë reflektuar shtesat e këtyre dy VKM-ve në planin e miratuar për shpenzimet e MSHMS.</p> <p style="text-align: right;"><i>Në mijë lekë</i></p> <table border="1" data-bbox="343 851 1437 1160"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kod</th> <th rowspan="2">Emërtimi i Institucionit / Programit</th> <th colspan="3">Shpenzimet Kapitale (Ligji)</th> <th colspan="3">Shpenzimet Kapitale (AN 6 datë 21.03.2020)</th> <th colspan="3">Shpenzimet Kapitale (AN 15 datë 15.04.2020)</th> <th colspan="3">Shpenzimet Kapitale (AN 28 datë 02.07.2020)</th> </tr> <tr> <th>F. Brendshëm</th> <th>F. i Huaj</th> <th>Totali i Shp. Kapitale</th> <th>Financimi Brendshëm</th> <th>Financimi i Huaj</th> <th>Totali i Shp. Kapitale</th> <th>Financimi Brendshëm</th> <th>Financimi i Huaj</th> <th>Totali i Shp. Kapitale</th> <th>Financimi Brendshëm</th> <th>Financimi i Huaj</th> <th>Totali i Shp. Kapitale</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>13</td> <td>MSHMS</td> <td>1,922,000</td> <td>1,110</td> <td>3,032,000</td> <td>1,922,000</td> <td>1,110</td> <td>3,032,000</td> <td>1,922,000</td> <td>1,110</td> <td>3,032,000</td> <td>1,862,000</td> <td>1,110</td> <td>2,972,000</td> </tr> </tbody> </table> <p>Konkretisht sikundër vërehet më sipër, veçanërisht për shpenzimet kapitale sipas ligjit i janë miratuar MSHMS 1,922 milion lekë, të cilat nuk kanë pësuar ndryshim në aktet normative të dala pas VKM-ve. Si rezultat, Akti i fundit Normativ, ai nr. 34 datë 16.12.2020, nuk pasqyron plotësisht planin e rishikuar bazuar në totalin e fondeve buxhetore që i është akorduar MSHMS.</p>	Kod	Emërtimi i Institucionit / Programit	Shpenzimet Kapitale (Ligji)			Shpenzimet Kapitale (AN 6 datë 21.03.2020)			Shpenzimet Kapitale (AN 15 datë 15.04.2020)			Shpenzimet Kapitale (AN 28 datë 02.07.2020)			F. Brendshëm	F. i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	Financimi Brendshëm	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	Financimi Brendshëm	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	Financimi Brendshëm	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	13	MSHMS	1,922,000	1,110	3,032,000	1,922,000	1,110	3,032,000	1,922,000	1,110	3,032,000	1,862,000	1,110	2,972,000
Kod	Emërtimi i Institucionit / Programit			Shpenzimet Kapitale (Ligji)			Shpenzimet Kapitale (AN 6 datë 21.03.2020)			Shpenzimet Kapitale (AN 15 datë 15.04.2020)			Shpenzimet Kapitale (AN 28 datë 02.07.2020)																												
		F. Brendshëm	F. i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	Financimi Brendshëm	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	Financimi Brendshëm	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	Financimi Brendshëm	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale																												
13	MSHMS	1,922,000	1,110	3,032,000	1,922,000	1,110	3,032,000	1,922,000	1,110	3,032,000	1,862,000	1,110	2,972,000																												
Kriteri	<p>Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ndryshuar</p> <p>Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin e ndryshuar;</p> <p>Udhëzimi nr.9, datë 20.03.2018 për procedurat standarde të Zbatimit të Buxhetit;</p> <p>Udhëzimi nr.9/1, datë 20.03.2018 për procedurat standarde të Zbatimit të Buxhetit për njësitë e qeverisjes së Përgjithshme që përdorin SIFQ;</p> <p>Udhëzimi nr. 2, datë 20.01.2020 për zbatimin e buxhetit të vitit 2020</p> <p>Udhëzimi plotësues nr.26, datë 08.07.2020 për një shtesë dhe disa ndryshime në udhëzimin plotësues nr.2, datë 20.01.2020 për zbatimin e buxhetit të vitit 2020</p> <p>Udhëzimi plotësues nr.2/1, datë 21.09.2020 për një shtesë në udhëzimin plotësues nr.2, datë 20.01.2020 për zbatimin e buxhetit të vitit 2020, të ndryshuar</p> <p>Akti Normativ nr. 6, datë 21.03.2020; nr. 15, datë 15.04.2020; nr. 28, datë 02.07.2020; nr. 34, datë 16.12.2020.</p>																																								
Impakti	Pamundësi për të identifikuar kufirin e miratuar të planit për buxhetin në dispozicion																																								
Shkaku	Mos reflektim i shtesave të akorduara me VKM në aktet normative të dala në vijim të tyre																																								
Rëndësia	E lartë																																								



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Për sa më sipër, u mbajt Akt konstatimi nr. 5, date 13.08.2021.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 8595/13, datë 30.09.2021 “Mbi Projekt raportin e Auditimit” nga Drejtoria e Analizave dhe Programimit Buxhetor, ku janë shprehur observacionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me rastet e rishikimit si më poshtë sqarojnë:

Numrat e rishikimit 6342301 dhe 6342303 kane te bëjnë me veprime sistemi qe lidhen me numrin e punonjësve dhe jo me fonde buxhetore.

Numri i rishikimit 6350314 ka te beje me një veprim qe është në kompetencë të vet ministrisë, te MASR, pra MFE nuk miraton as veprimin e hedhur në sistem nga MASR dhe as shkresën e transferimit. Gjithashtu nuk mund te kontrollojmë në sistem përmbajtjen e veprimit të kryer.

Shpjegimi nga MASR është ky: Shkresa e MASR nr.611/1 date 03.02.2021, është rialokim fondesh qe i përket planit te buxhetit te vitit 2021, i cili hedhur ne sistemin e thesarit fillimisht me nr veprimi 6350314, por gabimisht me vit buxhetor 2020, e cila dështoi si veprim dhe me pas është rihedhur me vit buxhetor 2021 me nr veprimi 6356305.

Numri i rishikimit 6334298,ka te beje me veprimin e sistemimit për kodin e shpenzimeve te rindërtimit, te cilat janë evidentuar me kod produkti me vete, ne zbatim te shkresës se MFE nr. 23038, date 10.12.2020.

Numri i rishikimit 6343305,lidhet me zbatimin e Aktit Normativ nr. 34, date 16.12.2020 për Fondin e Rindërtimit, veprim i cili kushtëzohej dhe mund te kryhej vetëm pas kryerjes se veprimeve me fondet e akorduara te Fondit te Rindërtimit Njësave te Qeverisjes se Përgjithshme.

Numri i rishikimit 6330295, lidhet me zbatimin e shkresës se datajimit për AN nr.34 date 16.12.2020 për Akademinë e Shkencave e cila është firmosur ne datë 24.12.2020 (shkresa nr.23412/50).

Nga llogaritjet e ditëve të punës miratimi dhe hedhja ne SIFQ është bërë brenda 5 ditëve pune, konkretisht ditën që ka ardhur në DPB shkresa e firmosur 05.01.2021.

Pra rishikimet ne zbatim te AN nr. 34, date 16.12.2020 , te regjistruara ne Janar 2021, lidhen me afatet kohore te zbatimit te procedurave te firmosjes se shkresave te cilat duhet te regjistrohen për llogari te buxhetit te vitit 2020, pra ne Dhjetor 2020.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Për sa i përket rishpërndarjes së fondeve me data retrospektive, grupi i auditimit i vlerëson argumentet e dhëna si shpjegues të arsyeve pse kanë ndodhur këto rishikime, dhe jo kundërshtues, për pasojë qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

Pretendimi i subjektit: Lidhur me faktin e mungesës së konsistencës së fondeve për rindërtimin, sqarohet se fondet e akorduara për shpenzimet korrente që janë përgjegjësi e Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit, sistemet e kodeve të fondeve të akorduara për rindërtimin janë sistemuar dhe janë reflektuar në planin e buxhetit për vitin 2020.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me observimet mbi mungesën e konsistencës së fondeve të rindërtimit, sqarojmë se nga verifikimi rezultojnë të regjistruara në të njëjtin kod produkti si fondet për kryerjen e veprimtarisë normale të njësisë shpenzuese ashtu edhe fondet e rindërtimit.

Pas miratimit të Ligjit për vitin 2020, në regjistrin e SIFQ është çelur projekti i rindërtimit me kod 94902AA në vlerën 20,000,000,000 mijë lekë. Rishikimet e kryera gjatë vitit në këtë kod, për alokimet e kryera në njësitë e qeverisjes së përgjithshme qendrore dhe vendore nuk mundësojnë identifikimin e projekteve në të cilat janë akorduar fondet. Në këto kushte, nuk mund të verifikohet reflektimi i VKM-ve në regjistrin e rishikimeve, për të identifikuar vlerat e fondeve që u janë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

akorduar njësisive, dhe periudhën kohore në të cilën janë miratuar fondet në sistem. Gjithashtu, në lidhje me realizimin e fondeve, duke qenë se kodet e produkteve /projekteve të rindërtimit nuk janë konsistente nga momenti i alokimit të fondeve në zbatim të VKM-ve, deri në realizimin e shpenzimeve sipas regjistrit të pagesave, nuk është i mundur verifikimi i saktësisë së raportit të gjeneruar nga MFE për përdorimin e fondit të rindërtimit.

Pretendimi i subjektit (Drejtorja e Menaxhimit të Investimeve Publike): Rialokimi i fondeve buxhetore është një mekanizëm përmes së cilit LM/IB adresojnë rialokimin e fondeve nga projektet me ecuri më të ulët në krahasim me planifikimin e tyre drejt projekteve të investimeve publike të cilat rezultojnë me progres të mirë duke ndikuar në një përdorim më efikas të burimeve të alokuara...

Qëndrimi i grupit të auditimit: Argumentet e përdorur nuk e kundërshtojnë konstatimin e grupit të auditimit por janë sqaruese.

Pretendimi i subjektit (Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit): Në lidhje me dy rastet e konstatuar nga grupi i auditimit, kemi të bëjmë me kontratat e viteve të mëparshme të cilat regjistrohen paraprakisht si obligim. Rregullimi i kësaj problematike kërkon një asistencë të specializuar pasi aktualisht mirëmbahet manualisht.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Argumentet e përdorur nuk e kundërshtojnë konstatimin e grupit të auditimit por janë sqaruese. Edhe pse grupi i auditimit shprehet parimisht dakord mbi shpjegimin e dhënë, kjo nuk e hedh poshtë konstatimin.

Pretendimi i subjektit (Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit): Degët e thesarit kanë paraqitur argumente mbi kryerjen e shpenzimeve të tjera brenda kodeve të projekteve të alokuara për COVID, ku sqarojnë se janë kryer si pasojë: e rritjes së kostove si pasojë e COVID e për pasojë janë përdorur këto fonde; e urdhrave të MSH; gabime njerëzore; etj.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Argumentet e përdorur nuk e kundërshtojnë konstatimin e grupit të auditimit por janë sqaruese.

Për sa më sipër, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

4. Mbi rregullshmërinë dhe saktësisë së regjistrimeve në llogarinë “Depozitë e Qeverisë” dhe rakordimi i saj me Bankën e Shqipërisë. Konsolidimi i njësisive që operojnë në llogari speciale në Bankën e Shqipërisë nëpërmjet transfertës nga Llogaria e Unifikuar e Thesarit.

Baza ligjore afatet e raportimit për të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit:

Ligjet: nr.9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar me ligjin nr.57/2016, datë 02.06.2016, në nenet:

Neni 1, pika 37 citohet: òSistem i thesarit është tërësia e rregullave dhe e procedurave, si dhe struktura organizative përkatëse, e ngarkuar për ekzekutimin e buxhetit, administrimin e mjeteve monetare, mbajtjen e llogarive dhe raportimin financiar të qeverisjes së përgjithshme, pika 45. òSistemi informatik financiar i Qeverisë (SIFQ) është sistemi financiar, nëpërmjet të cilit Qeveria e Republikës së Shqipërisë kryen të gjitha proceset e ekzekutimit dhe raportimit financiar të Buxhetit të Shtetit.

Në nenin 8 “Menaxhimi i mjeteve monetare të qeverisjes së përgjithshme” citohet: òArkëtimet dhe pagesat e qeverisjes së përgjithshme kryhen nëpërmjet llogarisë së unifikuar të thesarit, e mbajtur në lekë dhe në valuta të huaja. Llogaria e unifikuar e thesarit mbahet në Bankën e Shqipërisë. Ministri i Financave, në rast se kërkohet, për fondet speciale, për financimet e projekteve ose për qëllimet e menaxhimit eficient të mjeteve monetare, mund të mbajë një numër të kufizuar llogarish në Bankën e Shqipërisë. Ministri i Financave është i autorizuar të nënshkruajë marrëveshje me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Bankën e Shqipërisë dhe me bankat e nivelit të dytë, për kryerjen e operacioneve bankare dhe menaxhimin e mjeteve monetare të qeverisjes së përgjithshme. Teprica e mjeteve monetare, përkohësisht të lira, të llogarive të qeverisjes së përgjithshme në Bankën e Shqipërisë investohet sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 54 "Kryerja e pagesave" citohet: ÷Angazhimet dhe detyrimet financiare të njësive të qeverisjes së përgjithshme paguhen vetëm nga llogaria e unifikuar e thesarit, nëpërmjet sistemit informatikë financiar të Qeverisë, nga personat e caktuar sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Nëpunësi autorizues i njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme, të cilat janë përdoruese të drejtpërdrejta të sistemit informatikë financiar të Qeverisë, miraton transaksionet e regjistruara nga nëpunësi zbatues i njësisë brenda 5 ditëve, nga data e regjistrimit të tyre në sistem. Nëse përfituesi është njësi që operon me sistemin e thesarit, atëherë transaksioni procesohet me anë të kontabilizimeve në sistem, pa lëvizje të mjeteve monetare që prekin llogarinë e unifikuar të thesarit. Transaksionet e shpenzimeve që rrjedhin nga angazhimet financiare procesohen të përputhura me urdhrat e blerjes, të regjistruara më parë në sistemin e thesarit. E drejta për të kryer pagesa për detyrime financiare, të konstatuara deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës, skadon në fund të muajit janar të vitit pasardhës, pavarësisht nëse detyrimi financiar paraqitet në sistemin e thesarit në vitin buxhetor pasardhës, duke respektuar afatet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare. Pagesat e kryera gjatë vitit buxhetor, pavarësisht kohës së konstatimit të detyrimit financiar, regjistrohen si pagesa të këtij viti.

Pagesat e kthyera për llogari të detyrimeve financiare të vitit paraardhës, të cilat nuk do të ri paguhen, do të trajtohen si arkëtim në vitin ushtrimor.

Në nenin 61 "Standardet dhe procedurat e kontabilitetit", citohet: ÷Metoda e njohjes së shpenzimeve dhe të ardhurave, për qëllim të këtij ligji, ka të bëjë me: ÷Njohjen e shpenzimeve të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës; Njohjen e të ardhurave bëhet në çastin e arkëtimit të tyre.

Në nenin 63 "Miratimi i raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit", shkronja ç, citohet: ÷Këshilli i Ministrave, brenda muajit Qershor, miraton dhe përcjell në Kuvend raportin vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit, i cili përmban: pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit.

-Ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 ÷Për Bankën e Shqipërisë, i ndryshuar;

-Ligjit nr.99/2019, ÷Për buxhetin e vitit 2020.

UMFE: nr.9, datë ÷Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, ndryshuar me udhëzimin nr.3, datë 16.01.2015 ÷Për një shtesë dhe ndryshim të Udhëzimit të përhershëm nr.2, datë 06.02.2012 ÷Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, ndryshuar me UMF nr.9, datë 20.03.2018, në pikën 18. Ministri përgjegjës për Financat është përgjegjës për evidentimin, regjistrimin dhe menaxhimin e të gjitha huave të qeverisjes qendrore, garancive shtetërore në regjistrin e borxhit publik, gjithashtu është përgjegjës për evidentimin dhe regjistrimin e të gjitha huave vendore, garancive vendore në regjistrin e borxhit publik.

Në pikën 28 citohet: Nëpunësi i Parë Autorizues shqyrton kërkesat për fonde shtesë të njësive të qeverisjes qendrore dhe i rekomandon Ministrit përgjegjës për Financat refuzimin ose pranimin e kërkesave për fonde shtesë të argumentuara.

Në pikën 138, citohet: ÷Sistemi i thesarit është tërësia e rregullave, procedurave, si dhe struktura organizative përkatëse, e ngarkuar për ekzekutimin e buxhetit, administrimin e mjeteve monetare, mbajtjen e llogarive dhe raportimin financiar të qeverisjes së përgjithshme.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Të ardhurat që arkëtohen në bankat e nivelit të dytë në datën e fundit të vitit buxhetor, në zbatim të marrëveshjes me sistemin bankar, ngarkohen me të njëjtën datë-valutë nga struktura përgjegjëse për thesarin në SIFQ në ditën pasardhëse të punës. Këto të ardhura konsiderohen likuiditete në udhëtim dhe reflektohen në llogarinë e unifikuar të thesarit në Bankën e Shqipërisë në ditën/ditët pasardhëse të punës sipas nxjerrjes së llogarisë të dërguar nga Banka e Shqipërisë. Gjendja e mjeteve monetare e mbartur në vitin pasardhës e llogarisë së unifikuar të thesarit si dhe të ardhurat që arkëtohen në bankat e nivelit të dytë në datën 31 dhjetor të vitit të mëparshëm buxhetor (likuiditetet në udhëtim), do të shërbejnë si likuiditetet në ditët pasardhëse të punës për të paguar urdhër-shpenzimet e regjistruara dhe të miratuara kundrejt planit buxhetor të vitit të mëparshëm deri në datën 31 janar të vitit pasardhës.

Në pikën 247 citohet: Në fillim të çdo muaji bankat e nivelit të dytë dërgojnë zyrtarisht në Ministrinë përgjegjëse për Financat (strukturën përgjegjëse për thesarin) konfirmimin për gjendjen e likuiditeteve në llogarinë e ISSH në fund të muajit të mëparshëm.

Në pikën 256 citohet: Pas marrjes së informacionit nga struktura tatimore FSDKSH rakordon me strukturën qendrore përgjegjëse për thesarin. Personat e autorizuar prej tyre bashkë firmosin akt rakordimit për sistemin e diferencave lidhur me transferimet e likuiditeteve gjatë muajit të mëparshëm nga llogaria e unifikuar e thesarit. Në bazë të aktrakordimit, struktura qendrore përgjegjëse për thesarin procedon me reflektimin e sistemeve në transfertën e radhës nga llogaria e unifikuar e thesarit në llogaritë speciale FSDKSH në Bankën e Shqipërisë.

Në pikën 257 citohet: Në fillim të çdo muaji bankat e nivelit të dytë dërgojnë zyrtarisht në Ministrinë përgjegjëse për Financat (strukturë përgjegjëse për thesarin), konfirmimin për gjendjen e likuiditeteve në llogarinë e FSDKSH në fund të muajit të mëparshëm.

-UMFE nr.46, datë 24.12.2020 òPër procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2020, ku është përcaktuar:

Për llogari të Buxhetit të Shtetit të vitit 2020, në pasqyrën vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme përfshihen: Të gjitha të ardhurat e arkëtuara, të regjistruara në Sistemin Informatikë Financiar të Qeverisë (SIFQ) nga data 01.01.2020 deri më 31.12.2020 (duke përfshirë datën 31.12.2020 si dhe arkëtimet e kontributeve vullnetare, çelur në planin kontabël posaçërisht për gjendjen e shpallur të fatkeqësive natyrore dhe emergjencës nga Këshilli i Ministrave, të cilat trashëgohen dhe përdoren në vitin 2020 për financimin e shpenzimeve të jashtëzakonshme.

Të gjitha shpenzimet publike (përfshirë edhe shpenzimet nga nënhatat e raportuara nga njësitë e zbatimit të projekteve të financimit të huaj dhe të konfirmuara nga struktura përgjegjëse për borxhin publik) të ndodhura (të dokumentuara) nga data 01.01.2020 deri më 31.12.2020 të njohura brenda kufirit të fondeve buxhetore disponibël dhe të regjistruara në SIFQ për llogari të vitit 2020, pavarësisht nga data e kryerjes së pagesave.

-Për llogari të buxhetit të shtetit 2020 në pasqyrën vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme, në seksionin e financimit të deficitit fiskal të përfshihen të gjitha transaksionet e regjistruara në SIFQ si më poshtë: Të gjitha të ardhurat e arkëtuara nga shitja/privatizimi i aktiveve afatgjata publike gjatë vitit 2020; Të gjitha arkëtimet e lidhura me huamarrjen e huaj deri në fund të datës 31.12.2020; Të gjitha ri-pagesat e borxhit të jashtëm të kryera deri më datë 31.12.2020; Ndryshimi i gjendjes së mjeteve monetare në të gjitha llogaritë e çelura nga ministri përgjegjës për financat në Bankën e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë; Gjendja e likuiditeteve në udhëtim që figurojnë si të tilla në fund të datës 31.12.2020. Fitimi/humbja që rezulton nga transaksionet e këmbimit të mjeteve monetare ndërmjet nën llogarive në monedhat Lek, Euro, USD dhe SDR të llogarisë së unifikuar të Thesarit òDepozitë e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

qeverisë (TSA) në Bankën e Shqipërisë si dhe ato të zhvlerësimit/rivlerësimit periodik të gjendjes vjetore të mbartur (balanca e llogarive të planit kontabël 657, 767, 766, etj.) të raportohen në nën zërin ÷Balanca nga kursi i këmbimit÷ të zërit ÷Të tjera÷ të burimeve të brendshme të financimit të deficitit. Nga auditim rezulton se:

-Struktura përgjegjëse për thesarin në qendër kanë përgatit të dhënat faktike përfundimtare të pasqyrës vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme brenda datës 15.02.2020.

-Pasqyra vjetore e konsoliduar e shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme e shoqëruar me raportin përfundimtar të gjendjes faktike të shpenzimeve dhe të ardhurave i është dërguar Këshillit të Ministrave me shkresën nr. 9596, datë 31.02.2021, brenda afateve ligjore.

Marrëdhëniet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me njësitë e qeverisjes së përgjithshme:

-Njësitë e Projekteve me Financime të Huaja, ISSH dhe FSDKSH dorëzojnë raportin përfundimtar të të ardhurave e shpenzimeve në strukturën përgjegjëse për thesarin në qendër brenda datës 15.01.2020. Nga auditimi rezulton se FSDKSH me shkresën nr. 184, datë 13.01.2021 ka dërguar evidencën e realizimit të buxhetit për muajin Dhjetor 2020 si dhe progresiven për vitin 2020, brenda afateve kohore. ISSH me shkresën nr. 308, datë 14.01.2021 ka dërguar evidencat e muajit Dhjetor 2020 si dhe progresiven e vitit 2020, brenda afateve kohore.

- Në pikën 31 përcaktohet se procesi i regjistrimit në SIFQ dhe rakordimit me kreditorët për financimet e huaja midis strukturave përgjegjëse të thesarit, borxhit dhe njërive të qeverisjes së përgjithshme duhet të përfundojë brenda datës 31.02.2021. Nga auditimi është konstatuar se më datë 24.03.2021 është kryer në SIFQ regjistrimi i disbursimit për kredinë ÷Bypass Fier- Vlorë. Gjithashtu është konstatuar se për disburimet e financimeve të huaja me kredi janë mbajtur 2 akt rakordime midis strukturës përgjegjëse të thesarit dhe strukturës së borxhit. Disburimi i regjistruar më datë 24.03.2021 dhe mbajtja e akt rakordimit pas datës 31.02.2021 bien në kundërshtim me kërkesat e pikës 31 të Udhëzimit 46, datë 24.12.2021 ÷Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2020.

Në Marrëveshjen Kuadër, midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Bankës së Shqipërisë, në aneksin 2 është përcaktuar se: ÷MFE ka siguruar brenda orareve të përcaktuara, likuiditetin e nevojshëm për mbulimin e shpenzimeve, nga llogaria kryesore e qeverisë dhe llogaritë e tjera të saj. Në rast se Banka e Shqipërisë konstaton pamjaftueshmëri likuiditeti, ajo komunikon menjëherë me Ministrinë e Financave, e cila ka për detyrë të ndërmarrë sa më shpejt të gjitha masat e nevojshme për krijimin e likuiditetit.

Gjithashtu në auditim u mbështetëm edhe në Marrëveshjen ÷Menaxhimit të disa llogarive të Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë. Në aneksin e ÷Marrëveshjes Kuadër, është përcaktuar: ÷Banka e Shqipërisë duhet të dërgojë çdo ditë me e-mail lëvizjet në llogaritë kryesore të qeverisë, të grupuara sipas zërave të identifikueshëm nga raportimet e bankave, apo nga urdhër pagesat, por jo më pak të detajuara se në 7 grupe si: 1.Të ardhura tatimore; 2.Të ardhura jo tatimore; 3.Shpenzime të përgjithshme; 4.Shpenzime për interesa; 5.Financim i brendshëm nëpërmjet emetimit; 6.Financimi i jashtëm; 7.Instrumentet.

Nga auditimi rezultoi se transaksionet e bëra në Llogarinë e Unifikuar të Thesarit ÷Depozitë e Qeverisë, kanë ruajtur grupet e mësipërme nga Ministra e Financës dhe Ekonomisë, ndërsa nga Banka e Shqipërisë janë dërguar çdo ditë me e-mail lëvizjet në llogaritë kryesore të qeverisë, të grupuara sipas zërave të identifikueshëm nga raportimet e bankave, apo nga urdhër pagesat, sipas



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

detajimeve në grupe si në udhëzimin dhe marrëveshjen e mësipërme, por në rakordimin mujor nuk ka analizë të tillë shoqëruese.

Për vitin 2020, rezulton se për çdo muaj Banka e Shqipërisë nëpërmjet shkresave zyrtare ka konfirmuar vetëm vlerën totale të të ardhurave dhe shpenzimeve, por jo të grupuara në jo më pak se 7 grupe: Të ardhura tatimore; Të ardhura jo tatimore; Shpenzime të përgjithshme; Shpenzime për interesa; Financim i brendshëm nëpërmjet emetimit; Financimi i jashtëm; Instrumentet.

Rakordimi i të dhënave të llogarisë së Unifikuar të Thesarit (TSA) “Depozitë qeverie”, me Sektorin e Borxhit të Jashtëm dhe Sektorin e Borxhit të Brendshëm, me ISSH dhe FSDKSH dhe me bankat e nivelit të dytë:

Mbështetur në udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012 òPër procedurat standarde të Zbatimit të buxhetit, kapitulli V, dhe në udhëzimin nr.46, datë 24.12.2020 òPër procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2020, nga auditimi raportet e rakordimit kanë rezultuar:

a. Rakordimi për “Financim i Brendshëm” dhe “Financim i Jashtëm”:

Në fund të çdo muaji dhe në fund të vitit 2020, Sektori i Transaksioneve Qendrore, pranë Drejtorisë së Thesarit ka rakorduar në lidhje me arkëtimet dhe pagesat e bëra me Sektorin e Borxhit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, në zërin òFinancim i Brendshëm dhe me Sektorin e Borxhit të Jashtëm në zërin òFinancim i Jashtëm.

Sipas akt rakordimit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit dhe Bashkërendimit të ndihmës së Huaj dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, pagesat e shërbimit për borxhin e jashtëm janë në total 73,635.80 mijë lekë nga të cilat princilapi është në vlerën 61,98.30 mijë lekë dhe interesat së bashku me kamatë vonesat janë në vlerën 11,937.50 mijë lekë. Akt rakordimi është i firmosur nga specialisti i thesarit dhe borxhit. Kjo vlerë rakordon me vlerën totale 73,635.80 mijë lekë të paraqitur në zërin òPagesat e borxhit të jashtëm të tabelës lëvizjet e llogarisë 211008 òDepozitë e Qeverisë për vitin 2020.

Sipas akt rakordimit midis Sektorit të Transaksioneve Qendror dhe Sektorit të Borxhit të Brendshëm, pagesat për borxhin e brendshëm janë në total në vlerën 22,350,990.27 mijë lekë nga të cilat vlera e interesave të Bonove të Thesarit të maturuara në vitin 2020 është 3,268,341.98 mijë lekë, interesat e obligacioneve me afat 2 vjeçar janë në vlerën 1,821,650.65 mijë lekë, interesat e obligacioneve në Euro me afat 2 vjeçar janë në vlerën 121,549.4 mijë lekë, interesat e obligacioneve me afat 3 vjeçar janë në vlerën 703,867.30 mijë lekë, interesat e obligacioneve me afat 5 vjeçar janë në vlerën 5,356,709.25 mijë lekë, interesat e obligacioneve me afat 7 vjeçar janë në vlerën 5,176,680.51 mijë lekë, interesat e obligacioneve me afat 10 vjeçar janë në vlerën 5,854,162.09 mijë lekë dhe interesat e garancive sovraane 1 janë në vlerën 47,948.09 mijë lekë. Akt rakordimi është i firmosur nga specialisti i thesarit dhe borxhit. Në tabelën e lëvizjeve të llogarisë 211008 òDepozitë e Qeverisë për vitin 2020, pagesat e borxhit të brendshëm paraqiten në vlerën 22,302,961.18 mijë lekë. Diferenca në vlerën 47,948.09 mijë lekë paraqet vlerën e interesave të garancive sovraane.

Sipas akt rakordimit midis Sektorit të Transaksioneve Qendror dhe Sektorit të Borxhit të Brendshëm të arkëtimet nga borxhi i brendshëm janë në total 48,558,061.13 mijë lekë nga të cilat vlera e bono thesarit neto është 6,697,273.06 mijë lekë (emetimi në vlerën 223,854,401.09 mijë lekë minus vlerën e maturimit 217,157,128.02 mijë lekë), vlera e obligacioneve me afat kthimi 2 vjeçar është -1,770,891.38 mijë lekë, vlera e obligacioneve në Euro me afat kthimi 2 vjeçar 12,636,000 mijë lekë, obligacione me afat kthimi 3 vjeçar në vlerën 17,161,605.09 mijë lekë, obligacione me afat kthimi 5 vjeçar në vlerën 5,039,138.62 mijë lekë, obligacion me afat kthimi 7 vjeçar në vlerën minus 4,657,029.04 mijë lekë dhe obligacion me afat kthimi 10 vjeçar në vlerën



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

13,451,964.77 mijë lekë. Këto vlera rakordojnë me vlerat e paraqitura tek të Hyrat/ Arkëtime nga Borxhi i Brendshëm i paraqitur në lëvizjet e llogarisë 211008 ÷Depozitë e Qeverisë për vitin 2020.

Sipas akt rakordimit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit vlerë e nënhuasë për vitin 2020 është 1,317,002.58 mijë lekë nga të cilat vlera 1,015,951.02 mijë lekë është principal dhe vlera 301,051.56 mijë lekë përfaqëson interesat. Akt rakordimi është i firmosur nga specialisti i thesarit dhe borxhit. Kjo vlerë rakordon me vlerën totale 1,317,002.58 mijë lekë të paraqitur në zërin Të hyra/Nën Huaja të tabelës lëvizjet e llogarisë 211008 ÷Depozitë e Qeverisë për vitin 2020.

b. Rakordimi mujor dhe vjetor i FSDKSH me MFE:

Në fund të çdo muaji dhe në fund të vitit 2020, Sektori i Transaksioneve Qendrore, pranë Drejtorisë së Thesarit ka rakorduar me strukturat e FSDKSH për të ardhurat tatimore dhe transfertat e tyre nga TSA. Në fund të vitit 2020, rakordimi është bërë me shkresën nr.187, datë 13.01.2021 ÷Dërgohet rakordimi vjetor për arkëtimet dhe transferimet e kontributeve të sigurimit shëndetësorë. Për arkëtimet nga llogaria e unifikuar e thesarit ÷Depozitë Qeverieë (TSA) dhe nga kontributet e sigurimeve shëndetësore, ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe rakorduar me MFE, për vitin 2020, por edhe 3 vjet më parë, është paraqitur tabela e mëposhtme:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	2017	2018	2019	2020
1	Gjendja në 01.01	859,881.76	90,367.46	218,351.01	950,724.13
2	Të ardhura tatimore gjatë vitit (llogaria 75)	11,430,485.70	12,314,983.56	12,952,373.12	12,943,485.54
I	Totali të ardhurave (1+2)	12,290,367.46	12,405,351.02	13,170,724.13	13,894,209.67
II	Transferuar nga TSA	12,000,000.00	12,187,000.00	12,220,000.00	13,612,000.00
III	Gjendja në fund të vitit	90,367.46	218,351.01	950,724.13	282,209.67

Shënim: Tabela konceptuar nga grupi auditimit me të dhëna të subjektit.

Gjatë raportit të rakordimit nuk kanë rezultuar diferenca dhe janë të miratuara e cikluara nga FSDKSH & MFE, pra për FSDKSH-në nga Sektori i të Ardhurave dhe Likuiditeteve-përgjegjës dhe specialist dhe nga MFE, nga Sektori Raportimit Financiar dhe Kontabilitetit-përgjegjës dhe specialist dhe nga Sektori i Llogarisë së Unifikuar të Thesarit TSA ÷Depozitë qeverieë -përgjegjës dhe specialist. Për vitin 2020, transfertat nga llogaria e Unifikuar e Thesarit ÷Depozitë Qeverieë (TSA) për **FSDKSH**, në vlerë **13,612,000 mijë lekë**, rezultuan se janë kontabilizuar si shpenzim të llogaria e TSA dhe shumat e kaluara me këto shkresa, ishin të barabarta me nxjerrjen e evidencës së shpenzimeve të ÷Depozitës së Qeverisë nga të dy institucionet (Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë), por edhe nga të dhënat e nxjerra nga llogaria vjetore e FSDKSH-së.

c. Rakordimi mujor e vjetor i ISSH me MFE:

Në fund të çdo muaji dhe në fund të vitit 2020, Sektori i Transaksioneve Qendrore, pranë Drejtorisë së Thesarit ka rakorduar për të ardhurat tatimore e jo tatimore e kamat vonesat, si dhe për transfertat që i kanë kaluar institucionit nga TSA. Në fund të vitit 2020, rakordimi është bërë me shkresën nr.308/1, datë 14.01.2021 ÷Mbi rakordimin e të ardhurave të realizuara nga DPT për kontributet e sigurimeve shoqërore. Arkëtimet nga llogaria e unifikuar e thesarit ÷Depozitë Qeverieë (TSA) dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, për këtë vit, por dhe tre vite më parë, ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe rakorduar me MFE, janë si në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	2017	2018	2019	2020
I	Gjendja në fillim të vitit	261,517.95	415,570.40	2,064,157.68	1,960,242.94
1	Të ardhura tatimore (llog 75)	70,543,830.13	75,853,051.64	80,537,941.63	80,430,251.27



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

2	Të ardhura jo tatimore (llog.711-gjoha)	140,857.85	163,707.94	205,920.30	229,822.448
3	Kamat vonesa të sigurimeve (llog.709-gjoha)	49,364.47	61,825.70	100,233.34	126,424.683
II	Totali të ardhurave për vitin (1+2+3)	70,734,052.45	76,078,587.28	80,844,085.27	80,786,498.40
I+II	Totali të ardhurave në fund të vitit	70,995,570.40	76,493,157.68	82,908,242.95	82,746,741.34
III	Transferuar nga TSA në ISSH për vitin	70,580,000.00	74,430,000.00	80,948,000.00	79,869,741.99
	Gjendja në fund të vitit	415,570.40	2,064,157.68	1,960,242.95	2,876,999.35

Shënim: Tabela konceptuar nga grupi auditimit me të dhëna të subjektit.

Këto shifra janë të cikluara dhe vulosur nga të dy institucionet në tabelën përmbledhëse nga ISSH & MFE, pra për ISSH-^{ne} nga: zv/drejtori i përgjithshëm, Drejtori i Financës, Përgjegjësi i Sektorit dhe specialisti i Buxhetit, për MFE nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit, Drejtori i Operacioneve të Thesarit, nga Sektori i Raportimit Financiar dhe Kontabilitetit-përgjegjësi dhe specialist, për të ardhurat dhe Sektori i Llogarisë së Unifikuar të Thesarit ÷Depozitë Qeverieo (TSA) - përgjegjës dhe specialist për transfertat në favor të ISSH-^{se}.

Nga auditimi për vitin 2020 i transfertave, nga llogaria e unifikuar e thesarit ÷Depozitë Qeverieo për ISSH, në vlerë **79,869,741.99 mijë lekë**, rezultoi se në këtë llogari kanë kaluar dhe janë kontabilizuar si shpenzim këto shuma, të cilat ishin të barabarta me nxjerrjen e evidencës së shpenzimeve të ÷Depozitës së Qeverisë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bankës së Shqipërisë.

d. Rakordimi i Bankave të Nivelit të Dytë me Bankën e Shqipërisë dhe me Degët e Thesarit në rrethë çdo muaj dhe për vitin 2020:

Në mbështetje të udhëzimit nr.46, datë 24.12.2020 ÷Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2020, kapitulli II ÷Marrëdhëniet e Ministrisë së Financave me bankat e nivelit të dytë, në pikat e mëposhtme përcaktohet:

-Në zbatim të marrëveshjes me ministrinë përgjegjëse për financat, bankat e nivelit të dytë kryejnë arkëtime të fondeve publike për llogari të vitit 2020 deri në fund të vitit 2020. Bankat e nivelit të dytë transferojnë në Bankën e Shqipërisë brenda orës 10:00 të datës së parë të punës në muajin Janar 2021 të gjitha mjetet monetare të arkëtuara për buxhetin e shtetit deri në fund të vitit 2020. Llogaritë e degëve të thesarit në bankat e nivelit të dytë do të fillojnë me gjendje zero në vitin 2020. Ky afat është realizuar.

-Degët e Thesarit përfundojnë rakordimin me bankat e nivelit të dytë dhe raportojnë elektronikisht në strukturën përgjegjëse për thesarin në qendër brenda datës 11.01.2021. Nga auditimi rezultoi se ky afat është realizuar. Nga konfirmimet rezultoi se të ardhurat sipas drejtorive rajonale paraqiten si të tabelën në vijim. Gjithashtu tabela në vijim paraqet edhe të ardhurat e konfirmuara nga degët për vitin 2019.

Në mijë lekë

Nr.	Degët thesarit ^e	Shuma të ardhurave		Nr.	Degët thesarit ^e	Shuma të ardhurave	
		2019	2020			2019	2020
1	Librazhd	170,096.36	176,782.38	19	Lushnjë	555,414.87	534,746.21
2	Durrës	2,243,160.05	2,110,944.320	20	Devoll	159,666.30	141,759.57
3	Gramsh	54,754.88	57,854.72	21	Pogradec	351,185.37	340,816.47
4	Kurbini	102,317.23	93,547.74	22	Sarandë	678,177.13	635,302.87
5	Kolonjë	44,148.44	51,530.60	23	Kruje	366,655.55	355,427.11
6	Mallakastër	148,578.12	110,793.39	24	Fier	1,334,349.29	1,308,940.85
7	Shkodër	1,259,689.90	1,124,739.66	25	Lezhe	830,087.62	546,808.31
8	Delvine	93,708.45	99,329.80	26	Peqin	63,012.66	54,194.47
9	Tepelenë	47,989.40	48,942.94	27	Kukës	183,818.97	228,000.97
10	Bulqizë	59,613.70	59,162.50	28	Skrapar	104,154.34	90,408.90



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

11	M.Madhe	62,494.29	66,518.47	29	Kavajë	528,426.03	522,415.55
12	Gjirokastrë	428,489.35	363,789.26	30	Korçë	1,093,665.74	991,012.66
13	Kuçovë	136,492.38	111,521.26	31	Has	18,011.57	23,607.54
14	Berat	542,879.12	567,482.63	32	Mat	122,290.74	131,683.29
15	Dibër	177,778.06	178,749.42	33	Pukë	40,876.35	53,119.86
16	Përmet	59,476.13	52,726.86	34	Elbasan	1,455,499.97	1,437,654.28
17	Mirditë	59,129.78	50,685.43	35	Tirana	416,877,124.84	379,512,717.13
18	Vlorë	1,410,650.19	1,562,418.51	36	Tropoja	52,829.16	44,461.40
Shuma					Shuma	431,916,693.33	393,840,597.33

Shënim: Tabela konceptuar nga grupi auditimit me të dhëna të subjektit.

Konstatohet se 96.34% e të ardhurave realizohet nga DTH Tiranë. Në krahasim me vitin e mëparshëm këto të ardhura janë realizuar më pak në vlerën 38,076,096 mijë lekë ose 8.8% më pak. Në pikën 13 të udhëzimit nr. 46, datë 24.12.2020, përcaktohet se: òDrejtoria qendrore të bankave të nivelit të dytë, rakordojnë me strukturën përgjegjëse për thesarin në Ministrinë e Financave, sipas formatit të dërguar nga kjo e fundit brenda datës **19.01.2021**ò. Tabela në vijim paraqet datat e konfirmimit të të ardhurave sipas bankave.

Në mijë lekë

Bankat e Nivelit të II-të	Datat e konfirmimit B.N.II-të		Të ardhurat sipas MOF/DOTH	Të ndara:			
	elektronike	shkresë		DPT	DPD	THESARI	Nenhua
R...	13.01.2021	19.01.2021	87,481,067.34	38,980,053.86	40,556,100.19	7,944,913.29	-
B...	18.01.2021	18.01.2021	81,349,433.48	37,140,445.10	38,169,903.08	6,039,085.30	-
B. ...	18.01.2021	18.01.2021	1,704,356.70	518,000.99	976,602.52	209,753.19	
B. C...	13.01.2021	13.01.2021	72,602,062.04	32,364,115.99	25,843,404.14	14,394,541.91	
A.	11.01.2021	22.01.2021	13,641,427.94	5,014,868.17	7,811,222.33	815,337.44	
I...	12.01.2021	19.01.2021	45,927,528.93	24,022,656.83	20,228,821.14	1,676,050.96	
B.....	13.01.2021	18.01.2021	8,756,855.72	5,707,659.56	2,047,832.25	1,001,363.91	
P....	11.01.2021	26.01.2021	15,449,719.00	5,238,841.27	9,828,859.41	382,018.32	
F...	11.01.2021	27.01.2021	5,504,833.47	2,657,802.53	2,491,584.78	355,446.16	
T....	11.01.2021	18.01.2021	19,473,189.12	7,914,551.74	9,648,047.16	1,910,590.22	
B. O....	18.01.2021	19.01.2021	29,146,789.74	12,215,985.40	14,591,352.31	2,339,452.03	
U.... B...	18.01.2021	27.01.2021	12,803,333.84	5,731,569.08	4,258,063.98	2,813,700.78	
Shuma			393,840,597.33	177,506,550.53	176,451,793.28	39,882,253.52	

Shënim: Tabela konceptuar nga grupi auditimit me të dhëna të subjektit.

Nga auditimi rezulton se në rrugë elektronike të gjitha bankat e nivelit të dytë kanë respektuar afatin kohor për rakordim. Ndërsa shkresat zyrtare për rakordim, bankat, A..., P..., F..., U..... i kanë dorëzuar pas datës 19.01.2021.

Shuma e rakorduar nga Bankat e nivelit të dytë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në vlerë **393,840,597.33**, është e realizuar dhe rakorduar:

-Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për shumën 177,506,550.53 mijë lekë, ose 45% të totalit;

-Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganës, për shumën 173,451,793.28 mijë lekë, ose 44.8% të totalit;

-Nga degët e thesarit për shumën 39,882,253.52 mijë lekë, ose 10.2% të totalit.

Konfirmim mbi të ardhurat nga bankat e nivelit të dytë me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, është bërë me shkresën e Departamentit të Operacioneve Monetare nr.410/1, datë 26.01.2021 për òKonfirmim mbi të ardhurat nga bankat për periudhën 01.01.2020-31.12.2020ò, drejtuar DPTH/Drejtorisë së Operacioneve të thesarit të MFE, në bazë të kërkesës



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

nr.1498, datë 24.01.2020, ku janë konfirmuar të ardhurat e kaluara nga këto Banka për vitin 20120, në shumën **393,840,597.33 mijë lekë**.

Ministria e Financës dhe Ekonomisë dhe Banka e Shqipërisë e regjistrojnë llogarinë e Unifikuar të Thesarit ÷Depozitë qeverieë **me sisteme të ndryshme regjistrimi**, pra në sistemin informatikë të qeverisë (SIFQ), regjistrimi i zërit të ardhurave dhe shpenzime nga bankat e nivelit të dytë në llogarinë e unifikuar të thesarit ÷Depozitë qeverieë regjistrohet vetëm për diferencë midis të ardhurave dhe shpenzimeve, ndërsa në sistemet regjistruese të bankave të nivelit të dytë dhe Bankës së Shqipërisë, regjistrimet për llogarinë e unifikuar të thesarit ÷Depozitë qeverieë bëhen jo për diferencë midis të ardhurave dhe shpenzimeve, por në bazë cash¹.

Në Llogarinë e Unifikuar të Thesarit ÷Depozitë qeverieë, zëri ÷Të ardhurat nga Bankat e Nivelit të Dytë (BNII-^{te}) të raportuar në fund të vitit 2020, ka rezultuar për të dy institucionet (BOA & MFE) në shumën 394,148,321.28 mijë lekë, ndërsa të ardhurat të konfirmuara nga bankat e nivelit të dytë e të rakorduara si në degët e thesarit, në Drejtorinë e Thesarit dhe në Bankën e Shqipërisë, janë 393,840,597.33 mijë lekë. Midis këtyre dy raportimeve rezulton një diferencë për të ardhurat, në vlerë **307,723.95 mijë lekë**, e cila përbëhet nga:

a. Diferencën në shumën 249,765.18 mijë lekë, rezultat i “Accrualitë në datën 05.01.2021, i cili bazë të udhëzimit të Ministrisë së Financave njihen si të ardhura për datën 31.12.2020, në vlerën 1,328,505.41 mijë lekë, dhe ÷Accrualitë më datën 06.01.2020, që në bazë të udhëzimit të Ministrisë së Financave njihen si të ardhura për datën 31.12.2019, në shumën 1,578,270.59 mijë lekë;

b. Vlera e të ardhurave përmes sistemit “AECH” në shumën 57,958.77 mijë lekë. Kjo shumë është e përfshirë në zërin kthime nga BND-të, shumë e regjistruar vetëm në sistemin e Bankës së Shqipërisë, ndërsa në sistemin informatikë të qeverisë kalojnë automatikisht në Degët përkatëse të Thesarit dhe nuk shfaqen të veçanta në sistem. Pra në sistemin e regjistrimit të Bankës së Shqipërisë shfaqen me zë më vete ÷Të tjera të ardhura vetëm nga AECHö.

Të ardhurat në Llogarinë e Unifikuar të Thesarit ÷Depozitë qeverieë, në zërin ÷Të ardhurat nga Bankat e Nivelit të dytë, accruali i datës 06.01.2020, accruali i datës 05.01.2021 dhe raportimi i bankave të nivelit të dytë për vitin 2020, janë si në tabelën e mëposhtme: *Në mijë lekë*

Bankat e Nivelit të II- ^{te}	Të ardhurat sipas depozitës së qeverisë	Accrualli më 06.01.2020	Accrualli më 05.01.2021	Të ardhurat sipas Raportimit BSH&MFE në
	1	2	3	4= (1+2)-3
B.K.....	81,349,433.48	257,727.44	202,410.42	81,404,750.50
B. R.....	87,481,067.34	576,602.21	418,340.50	87,639,329.05
B. I.....	45,927,528.93	22,038.71	33,121.25	45,916,446.39
P.....	15,449,719.00	26,685.53	45,287.79	15,431,116.74
A.....	13,641,427.94	64,177.40	27,203.18	13,678,402.16
T.....	19,473,189.12	44,269.57	45,989.30	19,471,469.39
B....	1,704,356.70	2,181.52	21,950.88	1,684,587.34
B. A.....	8,756,855.72	274,517.75	6,171.75	9,025,201.72
B. c....	72,602,062.04	170,954.44	400,085.60	72,372,930.88
B. O....	29,146,789.74	-	73,950.99	29,072,838.75
B. S.....	-	118,733.46		118,733.46
U....	12,803,333.84	15,830.02	29,627.55	12,789,536.31
F.....	5,504,833.47	4,552.54	24,366.22	5,485,019.79
B.....				57,958.77
Shuma	393,840,597.33	1,578,270.59	1,328,505.41	394,148,321.28

Shënim: Tabela është përpiluar e sistemuar nga grupi i kontrollit, në bazë të tabelave shoqëruese nga dy institucionet (MFE & BOA).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Rakordimi i bankave të nivelit të dytë me Bankën e Shqipërisë dhe me Degët e Thesarit në rrethe për vitin 2020, është kryer në kohë sipas legjislacionit dhe në të gjitha nivelet dhe i njëjtë për të dyja institucionet.

Mbi saktësinë e raportimeve të Llogarisë së Unifikuar të Thesarit (TSA) “Depozitë Qeverie”, me Bankën e Shqipërisë çdo muaj dhe në fund të vitit 2020:

a. Rakordimi i llogarisë së Unifikuar të thesarit “Depozitë qeverie” çdo muaj dhe në fund të vitit 2020:

Ministria e Financës dhe Ekonomisë rakordon me Bankën e Shqipërisë për lëvizjet dhe gjendje e Llogarisë së Unifikuar të Thesarit (TSA) òDepozitë Qeverieò çdo muaj dhe në fund të vitit financiar, në mbështetje të marrëveshjes kuadër. Çdo muaj të vitit 2020, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit/Drejtoria Operacioneve të Thesarit pranë Ministrisë së Financave, rakordon me Departamentin e Operacioneve Monetare dhe Departamentin e Sistemit të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës pranë Bankës së Shqipërisë, në lidhje me òGjendjen dhe lëvizjet e llogarisë së unifikuar të thesarit òDepozitë Qeverieò në lekë, në euro, në dollarë dhe SDR, të shoqëruara me evidencat mujore të tyre. Çdo evidencë mujore e transaksioneve të òDepozitës së Qeverisë në lekë dhe valutë, ka bashkëngjitur datën e kryerjes së transaksionit, kursin e këmbimit dhe përshkrimin e zërave, në të cilat janë kontabilizuar transaksionet.

Çdo shkresë mujore e Bankës së Shqipërisë/Departamenti i Operacioneve Monetare, konfirmon të ardhurat totale të raportuara nga BN-II dhe shpenzimet totale të iniciuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, *por pa evidencën e me zëra të ndarë në 7 grupe shpenzimesh e të ardhurash.*

Nga auditimi i korrespondencës për gjendjen e llogarisë së unifikuar të thesarit **“Depozitë e qeverisë” TSA, e konvertuar në lekë**, ndërmjet dy institucioneve dhe tre departamenteve, rezultoi se gjendja e kësaj llogarie është e njëjtë. Konfirmimi nga DOM çdo muaj dhe në fund të vitit bëhet për shumën e të ardhurave dhe shpenzimeve, ndërsa DSPKF konfirmon çdo muaj dhe në fund të vitit gjendjen e llogarisë dhe në valuta. Pra konfirmimi nga të tre departamentet dhe lëvizja çdo muaj për vitin 2020 është si në tabelën e mëposhtme:

2020	MOF	MFE& DSPKF					DOM (në mijë lekë)		
	data	data	në mijë lekë	Në euro	Në USD	Në SDR	data	Të ardhura	Shpenzime
Janar	17.02	04.03	12,559,747.77	101,235,612.14	2,663,425.94	13,983,933.20	02.03	34,632,236.37	31,836,447.97
Shkurt	17.03	09.04	12,939,439.07	95,633,543.83	244,426.15	8,727,441.20	09.04	66,243,624.18	55,021,644.24
Mars	17.04	30.04	9,883,696.81	74,160,019.68	398,065.68	8,727,441.20	30.04	94,063,504.48	80,297,544.10
Prill	15.05	27.05	13,292,964.95	50,863,085.34	2,763,260.94	145,368,441.20	27.05	121,842,442.78	111,210,957.44
Maj	17.06	25.06	17,031,045.54	81,810,155.97	670,912.83	46,791,515.20	25.06	147,141,553.54	139,276,959.55
Qershor	17.07	27.07	10,458,169.39	712,325,334.89	1,336,607.1	44,829,015.20	27.07	178,977,000.49	171,244,743.82
Korrik	17.08	25.08	8,165,222.13	655,309,758.5	651,290.03	44,829,015.20	20.08	215,703,347.77	203,732,523.86
Gusht	18.09	22.09	4,894,380.36	520,832,476.09	447,354.76	69,129,106.20	22.09	249,979,668.46	231,139,828.28
Shtator	16.10	27.10	9,783,591.88	504,321,725.21	447,354.76	69,129,106.20	26.10	284,999,370.92	261,439,854.88
Tetor	17.11	25.11	12,013,184.13	464,566,310.95	765,971.12	67,166,606.20	23.11	320,979,963.26	291,789,181.12
Nentor	17.12	29.12	7,578,186.25	129,645,424.18	1,358,335.18	60,468,451.20	29.12	325,980,575.03	318,079,437.61
Dhjetor	25.01	03.02	7,798,904.99	48,736,483.30	599,612.52	28,505,951.20	01.02	394,148,321.28	372,619,464.48

Shënim: Tabela konceptuar nga grupi auditimit me të dhëna të subjektit.

Gjendja dhe rakordimi i Llogarisë së Unifikuar të Thesarit **“Depozitë e qeverisë”, në fund të vitit 2020**, është bërë me shkresat:

Me shkresën nr.2572, datë 08.02.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë/ **Drejtoria e Përgjithshme Thesarit/Drejtoria e Operacioneve të Thesarit**, drejtuar Bankës së Shqipërisë/ Departamentin e Operacioneve Monetare dhe Departamentin e Sistemit të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës për òRakordimin e llogarisë e llogarisë òDepozitë e Qeverisëò për periudhën 1



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Dhjetor-31 Dhjetor 2020, të shoqëruar me tabelën përmbledhëse për të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit të kryera për periudhën 1 Dhjetor-31 Dhjetor 2020 në llogarinë e Depozitë e qeverisë në lekë si dhe evidencën e transaksioneve në llogarinë e Depozitë e qeverisë në valutë, datën e kryerjes, kursin e këmbimit dhe përshkrimin e zërave të cilët janë kontabilizuar. Gjendja e Depozitës së Qeverisë në fund të periudhës paraqitet:

- Depozitë e Qeverisë (TSA) në lekë, për vlerën 7,798,905 mijë lekë;
- Depozitë e Qeverisë (TSA) në Euro për vlerën 48,736,483.30 euro, e konvertuar me kursin kur janë kryer veprimet në vlerë 6,495,190.26 mijë lekë dhe me kursin e datës 31.12.2020, pra **123.7 lekë**, vlera e konvertuar është 6,028,702.98 mijë lekë;
- Depozitë e Qeverisë (TSA) në USD për vlerën 599,612.52 USD, e konvertuar me kursin kur janë kryer veprimet në vlerë 64,154.14 mijë lekë dhe me kursin e datës së fundit (31.12.2020), pra **100.84 lekë**, vlera e konvertuar është 60,464.93 mijë lekë;
- Depozitë e Qeverisë (TSA) në SDR për 28,505,951.20 SDR e konvertuar me kursin kur janë kryer veprimet në vlerë 5,585,213.29 mijë lekë dhe me kursin e datës së fundit (31.12.2020), pra **145.24 lekë**, vlera e konvertuar është 4,140,204.35 mijë lekë.

Me shkresën nr. 842/1, datë 09.02.2019 dhe shkresën nr. 578/1, datë 01.02.2021 të Bankës së Shqipërisë, **Departamenti i Operacioneve Monetare**, drejtuar Ministrisë së Financave/Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Financiare/Drejtoria e Operacioneve të Thesarit me lënde e Konfirmim mbi të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën 01 Janar ó 31 Dhjetor 2020. Të ardhurat totale, raportuar nga Bankat dhe shpenzimet totale të iniciuara nga Ministria e Financës për periudhë 01.01.2020-31.12.2020, të pasqyruara në evidencën e buxhetit të Bankës së Shqipërisë, paraqiten:

- Të ardhurat totale 394,148,321,277.90 lekë;
- Shpenzimet totale 372,619,464,478.76 lekë;

Me shkresën nr.1088/1, datë 12.02.2019 të Bankës së Shqipërisë/**Departamenti i Sistemit të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës**, drejtuar Ministrisë së Financave/Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Financiare/Drejtoria e Operacioneve të Thesarit: e Konfirmim për gjendjet e llogarive të Qeverisë pranë Bankës së Shqipërisë për periudhën 1 Dhjetor- 31 Dhjetor 2020, ku gjendja e llogarive sipas monedhave në Bilancin e Bankës së Shqipërisë në datë 31 Dhjetor paraqitet:

- Depozitat e Qeverisë (TSA) në lekë, për vlerën 7,798,904,996.14 Lekë;
- Depozitat e Qeverisë (TSA) në euro, për vlerën 48,736,483.30 Euro;
- Depozitat e Qeverisë (TSA) në dollarë për vlerën 599,612.52 USD;
- Depozitat e Qeverisë (TSA) në SDR për vlerën 28,505,951.20 SDR.

Pra ky departament rakordon për këtë llogari me Ministrinë e Financave për valutën dhe për gjendjen e saj, pa e konvertuar atë në lekë.

Nga auditimi i regjistrimit të ardhurave dhe shpenzimeve, për të dy institucionet, si dhe gjendje e tyre në fund të vitit, rezultoi: Departamenti i Operacioneve Monetare, informacionin mujor mbi të ardhurat totale dhe shpenzimet e konfirmon vetëm për vlerat totale dhe nuk konfirmon informacionin të grupuar në të paktën 7 grupe të ardhurash dhe shpenzimesh (të ardhura tatimore dhe jo tatimore; shpenzime të përgjithshme dhe për interesa; financimi i brendshëm nëpërmjet emetimit; financimi i jashtëm dhe instrumentet), ndërsa çdo ditë transferojnë me e-mail të gjitha lëvizjet ditore të llogarisë së Unifikuar të Thesarit. *Llogaria e unifikuar e thesarit (TSA) është llogaria kryesore e qeverisë, e cila pasqyron lëvizjet e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore. Nisur nga rëndësia e saj, konfirmimet nga të dy institucionet, janë shumë të rëndësishme.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Informacioni i cili duhet të konfirmohet duhet të jenë sa më i detajuar ku, të përfshijë të gjitha lëvizjet mujore e vjetore, si dhe kostot apo fitimet nga përdorimi i valutës gjatë vitit.

Gjendja e “Depozitës së qeverisë” në lekë, ndërmjet dy institucioneve dhe tre departamenteve rezultojnë të jetë e njëjtë. Konfirmimi nga 2 departamentet dhe lëvizjet çdo muaj për vitin 2020 si dhe gjendja e saj, është si në tabelën e mëposhtme:

2020	Gjendja në fillim	Të dala	Të hyra	Gjendja në fund
Janar	21,934,541,421.19	54,563,606,691.26	45,188,813,043.95	12,559,747,773.88
Shkurt	12,559,747,773.88	41,220,738,501.86	41,600,429,795.05	12,939,439,067.07
Mars	12,939,439,067.07	46,081,361,124.60	43,025,618,870.56	9,883,696,813.03
Prill	9,883,696,813.03	46,151,675,818.04	49,560,943,954.25	13,292,964,949.24
Maj	13,292,964,949.24	49,829,276,652.14	53,567,357,239.50	17,031,045,536.60
Qershor	17,031,045,536.60	44,839,378,720.08	38,266,502,570.06	10,458,169,386.58
Korrik	10,458,169,386.58	58,860,344,938.14	56,567,397,683.57	8,165,222,132.01
Gusht	8,165,222,132.01	64,612,597,502.53	61,341,755,732.99	4,894,380,362.47
Shtator	4,894,380,362.47	47,304,462,395.69	52,193,673,916.09	9,783,591,882.87
Tetor	9,783,591,882.87	44,751,616,077.57	46,981,208,326.86	12,013,184,132.16
Nëntor	12,013,184,132.16	67,011,299,168.62	62,576,301,286.20	7,578,186,249.74
Dhjetor	7,578,186,249.74	77,168,355,723.88	77,389,074,470.28	7,798,904,996.14
Shuma	21,934,541,421.19	642,394,713,314.41	628,259,076,889.36	7,798,904,996.14

Shënim: Tabela konceptuar nga grupi auditimit me të dhëna të subjektit.

Për vitin 2020 konfirmimi i lëvizjes dhe gjendjes së kësaj llogarie nga dy departamentet e Bankës së Shqipërisë është bërë për të gjithë muajt. Shuma e hyrjeve gjatë vitit 2020 është 628,259,078.89 mijë lekë ndërsa daljet janë në shumën 642,394,713.31 mijë lekë dhe nga përllogaritjet e ditarët mujore, rezultoi se gjendja e saj, është e barabartë me konfirmimin në fund të vitit 2020 në shumën 7,798,905 mijë lekë.

Gjendja e “Depozitës së qeverisë” në euro, ndërmjet dy institucioneve dhe tre departamenteve, rezultojnë të jetë e njëjtë. Konfirmimi nga 2 departamentet dhe lëvizjet çdo muaj për vitin 2020 si dhe gjendja e saj, është si në tabelën e mëposhtme:

2020	Gjendja në fillim	Të dala	Të hyra	Gjendja në fund
Janar	65,512,739.11	20,892,794.53	56,615,667.56	101,235,612.14
Shkurt	101,235,612.14	9,278,331.80	3,676,266.49	95,633,546.83
Mars	95,633,546.83	23,201,539.49	1,728,012.34	74,160,019.68
Prill	95,633,546.83	130,934,104.16	107,637,169.82	50,863,085.34
Maj	74,160,019.68	11,658,061.22	42,605,131.85	81,810,155.97
Qershor	50,863,085.34	27,854,274.78	658,369,453.70	712,325,334.89
Korrik	81,810,155.97	96,798,360.08	39,782,783.69	655,309,758.50
Gusht	712,325,334.89	135,456,748.16	979,465.75	520,832,476.09
Shtator	655,309,758.50	19,709,751.75	3,199,000.87	504,321,725.21
Tetor	520,832,476.09	42,912,756.79	3,157,342.53	464,566,310.95
Nëntor	504,321,725.21	413,084,890.41	78,164,003.64	129,645,424.18
Dhjetor	464,566,310.95	171,485,397.03	90,576,456.15	48,736,483.30
Shuma	65,512,739.11	1,103,267,010.20	1,086,490,754.39	48,736,483.30

Shënim: Tabela konceptuar nga grupi auditimit me të dhëna të subjektit.

Për vitin 2020 konfirmimi i lëvizjes dhe gjendjes së kësaj llogarie nga dy departamentet e Bankës së Shqipërisë është bërë për të gjithë muajt. Shuma e hyrjeve gjatë vitit 2020 është 1,086,490,754.39 Euro, ndërsa daljet janë në shumën 1,103,267,010.20 Euro dhe nga përllogaritjet e ditarët mujore, rezultoi se gjendja e saj, është e barabartë me konfirmimin në fund të vitit 2020 në shumën 48,736,483.30 Euro.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Gjendja e “Depozitës së qeverisë” në USD, ndërmjet dy institucioneve dhe tre departamenteve, rezultojnë të jetë e njëjtë. Konfirmimi nga 2 departamentet dhe lëvizjet çdo muaj për vitin 2020 si dhe gjendja e saj, është si në tabelën e mëposhtme:

2020	Gjendja në fillim	Të dala	Të hyra	Gjendja në fund
Janar	7,020,453.31	8,659,456.56	4,302,429.19	2,663,425.94
Shkurt	2,663,425.94	2,567,271.25	148,271.46	244,426.15
Mars	244,426.15	0.00	153,638.88	398,065.03
Prill	398,065.03	1,237,212.10	3,602,408.01	2,763,260.94
Maj	2,763,260.94	2,162,955.61	70,607.50	670,912.83
Qershor	670,912.83	3,410,848.25	4,076,596.13	1,336,660.71
Korrik	1,336,660.71	1,002,522.81	317,152.13	651,290.03
Gusht	651,290.03	4,346,356.27	4,142,421.00	447,354.76
Shtator	447,354.76	-	-	447,354.76
Tetor	447,354.76	1,176,304.02	1,494,920.38	765,971.12
Nentor	765,971.12	120,189.50	712,573.56	1,358,355.18
Dhjetor	1,358,355.18	786,742.66	28,000.00	599,612.52
Shuma	7,020,453.31	25,469,859.03	19,049,018.24	599,612.52

Shënim: Tabela konceptuar nga grupi auditimit me të dhëna të subjektit.

Për vitin 2020 konfirmimi i lëvizjes dhe gjendjes së kësaj llogarie nga dy departamentet e Bankës së Shqipërisë është bërë për të gjithë muajt. Shuma e hyrjeve gjatë vitit 2020 është USD ndërsa daljet janë në shumën 25,469,859.03 USD dhe nga përlllogaritjet e ditareve mujore, rezultoi se gjendja e saj, është e barabartë me konfirmimin në fund të vitit 2020 në shumën 599,612.52 USD.

- Gjendja e “Depozitës së qeverisë” në SDR, ndërmjet dy institucioneve dhe tre departamenteve, rezultojnë të jetë e njëjtë. Konfirmimi nga 2 departamentet dhe lëvizjet çdo muaj për vitin 2020 si dhe gjendja e saj, është si në tabelën e mëposhtme:

2020	Gjendja në fillim	Të dala	Të hyra	Gjendja në fund
Janar	13,983,933.20	-	-	13,983,933.20
Shkurt	13,983,933.20	5,256,492.00	-	8,727,441.20
Mars	8,727,441.20	-	-	8,727,441.20
Prill	8,727,441.20	2,659,000.00	139,300,000.00	145,368,441.20
Maj	145,368,441.20	98,576,926.00	-	46,791,515.20
Qershor	46,791,515.20	1,962,500.00	-	44,829,015.20
Korrik	44,829,015.20	-	-	44,829,015.20
Gusht	44,829,015.20	70,699,909.00	95,000,000.00	69,129,106.20
Shtator	69,129,106.20	-	-	69,129,106.20
Tetor	69,129,106.20	1,962,500.00	-	67,166,606.20
Nentor	67,166,606.20	6,698,155.00	-	60,468,451.20
Dhjetor	60,468,451.20	31,962,500.00	-	28,505,951.20
Shuma	13,983,933.20	219,777,982	234,300,000	28,505,951.20

Shënim: Tabela konceptuar nga grupi auditimit me të dhëna të subjektit.

Për vitin 2020 konfirmimi i lëvizjes dhe gjendjes së kësaj llogarie nga dy departamentet e Bankës së Shqipërisë është bërë për të gjithë muajt. Shuma e hyrjeve gjatë vitit 2020 është 234,300,000 SDR ndërsa daljet janë në shumën 219,777,982 SDR dhe nga përlllogaritjet e ditareve mujore, rezultoi se gjendja e saj, është e barabartë me konfirmimin në fund të vitit 2020 në shumën 28,505,951.20 SDR.




KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

Trendi i Gjendjes së Llogarisë së Unifikuar të Thesarit ÷ Depozitë Qeverie, për vitet 2014 -2020 në të gjitha valutat, paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Nr	Llogaritë Kryesore të Qeverisë	Gjendja më 31.12.2014	Gjendja më 31.12.2015	Gjendja më 31.12.2016	Gjendja më 31.12.2017	Gjendja më 31.12.2018	Gjendja më 31.12.2019	Gjendja më 31.12.2020
	TSA në mijë lekë	7,048,535.14	3,144,763.76	1,674,830.28	12,466,825.15	10,582,513.08	21,434,541.42	7,798,905.00
	Depozitë garancie	500,000.00	500,000.00	500,000.00	500,000.00	500,000.00	500,000.00	500,000.00
1	TSA në mijë lekë	7,548,535.14	3,644,763.76	2,174,830.28	12,966,825.15	11,085,513.08	21,934,541.42	8,298,905
	<i>Krahasimi me një vit më parë</i>		- 48%	- 40%	496%	-14.5%	97%	-64.4%
2	TSA në euro	13,077,467.58	47,800,228.06	32,704,134.31	64,630,583.29	308,844,134.58	65,512,739.11	48,736,483.40
	<i>Krahasimi me një vit më parë</i>		+265%	+32%	+ 97.6%	+378%	-78%	-25.6%
3	TSA në dollarë	649,341	235,174.90	688,986.23	750,993.18	10,001.00	7,020,453.31	599,612.52
	<i>Krahasimi me një vit më parë</i>		-64%	+2.9 herë	+9%	-88.7%	+70 herë	-91.5%
4	TSA në SDR	1,577,671.00	4,658,035.30	19,812,271.55	4,822,433.20	4,656,739.20	13,983,933.20	28,505,951.20
	<i>Krahasimi me një vit më parë</i>		+2.9 herë	+4.2 herë	-4.1 herë	-3.5%	+2.3 herë	+103.85%
	Shuma e konvert në mijë lekë	9,719,348.37	11,554,229.47	11,961,323.51	22,404,069.39	49,899,412.52	33,275,535.99	20,245,602.61
	<i>Krahasimi me një vit më parë në vlerë</i>		1,834,881.10	407,094.04	10,442,745.88	27,495,343.13	-16,623,876.5	-
	<i>në %</i>		18.9	3.5	87.3	122.7	-33.3	-39.2

Shënim: Tabela hartuar nga grupi i auditimit.

Trendi i gjendjes së llogarisë së unifikuar të thesarit të konvertuar edhe të tre monedhat në mijë lekë, paraqitet si në grafikun e mëposhtëm:




- Për vitin 2015 gjendja e saj e konvertuar në mijë lekë është 18.9% më shumë se një vit më parë;
- Për vitin 2016 gjendja e saj e konvertuar në mijë lekë është 3.5% më shumë se një vit më parë;
- Për vitin 2017 gjendja e saj e konvertuar në mijë lekë është 87.3% më shumë se një vit më parë;
- Për vitin 2018 gjendja e saj e konvertuar në mijë lekë është 122.7% më shumë se një vit më parë;
- Për vitin 2019 gjendja e llogarisë e konvertuar në mijë lekë është 33.3% më pak se një vit më parë;
- Për vitin 2020 gjendja e llogarisë e konvertuar në mijë lekë është 39.2% më pak se një vit më parë.

Ndërsa trendi i gjendjes së llogarisë së qeverisë, në 6 vitet e fundit në mënyrë grafike, **gjendja e llogarisë së Unifikuar të Thesarit “Depozitë qeverie”** në të 4 monedhat, paraqitet:



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË



b. Rakordimi dhe konfirmimi me zëra i të ardhurave, shpenzimeve dhe gjendjes së llogarisë së Unifikuar të Thesarit “Depozitë e Qeverisë” më 31.12.2020.

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Thesarit/Sektorit të Llogarisë së Unifikuar të Thesarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të dhënave të dërguara në rrugë elektronike nga Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës së Shqipërisë, të ardhurat, shpenzimet dhe gjendja e llogarisë së Unifikuar të Thesarit të Depozitë e Qeverisë më 31.12.2020, e të konfirmuara për gjendjen edhe nga Departamenti i Sistemit të Pagesave Kontabilitetit e Financës në Bankën e Shqipërisë, paraqiten të grupuara si në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Nr.	EMËRTIMI I ZËRAVE	Gjendja e llogarisë sipas:		Diferenca MFE-BOA
		MFE	BOA	
A+B	TË ARDHURAT, FINANCIMI DEPOZITËS	212,829,070.28	523,985,891.32	(311,156,821.04)
A (I+II+III)	TË ARDHURAT TATIMORE DHE JO TATIMORE	24,774,817.94	397,081,586.96	(372,306,769.02)
I	Të ardhura nga taksat (1+2)	21,559,840.78	352,631,715.97	(331,071,875.19)
1	Nga Tatimet		178,188,919.98	(178,188,919.98)
2	Nga Doganat		174,442,795.99	(174,442,795.99)
II	Të ardhura jo tatimore (1 deri 11)	3,214,977.16	42,989,281.46	39,774,304.30
1	Të ardhura jo tatimore sipas raportit të bankave		39,880,375.94	(39,880,375.94)
2	Fitimi i derdhur nga Banka e Shqipërisë	1,398,336.66	1,398,336.66	0
3	Kontribute vullnetare	907,787.83	907,787.83	0
5	Të ardhura nga koncesionet	8,494.08		8,494.08
6	Të ardhura nga shitja e licenc telekomunikacionit	704,753.30	704,753.30	0
9	Të ardhura të tjera	(4,394.71)	98,027.72	(102,422.43)
10	Transferuar në mjete ne ruajtje për shpronësimet	200,000	0	200,000
III	Grand		1,460,589.53	0.00
B(I+II+III)	FINANCIMI, INVESTIMI, TRANSFERTA	188,054,252.34	126,904,304.36	61,149,947.98
I	Financimi në totale	155,278,716.34	91,365,401.34	63,913,315.01
1	Financimi i brendshëm	48,558,061.13	48,558,016.13	0
1.1	Nëpërmjet bonove të thesarit	6,697,273.06	6,697,273.06	0
1.2	Nëpërmjet Obligacioneve	41,860,788.07	41,860,788.07	0
2	Nen/huaja	1,317,002.58	196,767.29	1,120,235.29
2.1	Principiali	1,015,951.02		1,015,951.02
2.2	Interesa	301,051.56		301,051.56
3	Financimi i jashtëm	105,269,541.09	42,604,292.10	62,692,248.98
3.1	M. Buxht IBRD ÷ Gender Equality to Opp. Develop.ö	1,126,395.95		1,126,395.95



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

3.2	Huamarrje e huaj (kredia FMN)	21,909,104		21,909,104
3.3	Huamarrje e huaj Mbështetje buxhetor Asistence Sociale	252,957.13		252,957.13
3.4	Huamarrje e huaj Mbështetje Buxhetore ADISA	504,588.36		504,588.36
3.5	M. Buxh. Kontrata e Reformës Sek të Transp	425,218.34		425,218.34
3.6	M. Buxh Kont. e Ref Sektoriale të BE-së për Drejtësinë	737,819.59		737,819.59
3.7	Kontrës së Ref Sek së Luftës kundër Korrupsionit	297,551.59		297,551.59
3.8	Eurobond	80,042,906.13		80,042,906.13
4	Projekte me thesar të plotë	100,830.73		100,830.73
5	Total interesa Depozita	6,280.82		6,280.82
6	Interesa të depozitës në afat	3,191.78	6,280.82	(3,089.04)
7	Interesa nga depozita Garanci	3,089.04		3,089.04
II	Depozitë& Kredi	(500,000.00)	620,235.29	(1,120,235.29)
I	Depozitë për garanci	(500,000.00)	(500,000.00)	00
1.1	Maturim Depozitë		(22,500,000.00)	
1.2	Interesa depozite me afat		22,000,000.00	
2	Kredi		1,120,235.29	(1,120,235.29)
III	Transferta e të ndryshme	33,275,535.99	34,918,667.73	(1,643,131.73)
1	Gjendje e mbartuar nga viti 2019	33,275,535.99	33,275,535.99	0
2	Diferenca cash e accrual		1,578,270.59	(1,578,270.59)
3	Transferta nga llogari të veçanta		64,861.15	(64,861.15)
	SHPENZIMET, DALJE TE DEPOZITËS	192,583,467.67	503,740,288.71	(311,156,821.04)
I	Shpenzime të Përgjithshme (1+2+3+4)	95,909,160.89	468,328,65.36	(372,419,464.48)
1	Shpenzime sipas bankave të nivelit të dytë		372,619,464.47	(372,619,464.47)
2	Transferta për ISSH-në	79,869,741.99	79,869,741.99	0
3	Transferta për FSDKSH-në	13,612,000	13,612,000	0
4	Transferta për llogaritë e tjera special (4.1+4.2)	2,427,418.90	2,227,418.90	0
4.1	Transferta për kompensimin e pronave	2,227,418.9		2,227,418.90
4.2	Transferta kapitale për Shpronësimet	200,000		200,000
II	Shpenzime për borxhin e brendshëm (1+2)	22,302,961.18	22,301,961.018	0
1	Shpen. interesat e Bonove të Thesarit		3,268,341.98	(3,268,341.98)
2	Shpenzime për interesat e Obligacioneve		19,034,619.20	(19,034,619.20)
III	Shpenzime për borxhin e jashtëm (1+2+3)	73,635,801.72	12,404,142.27	61,231,659.45
1	Interesa të Borxhit të Jashtëm	61,698,303.49	12,404,142.27	49,294,161.22
2	Principiali i Borxhit të Jashtëm	11,334,089.99		11,334,089.99
3	komisioni i borxhit të jashtëm	603,408.24		603,408.24
IV	Shpenzime kapitale	1,628,987.59	1,628,987.59	0
1	Transfertë për ISHP	225,460.71		225,460.71
2	Transfertë për Ministrinë e Mbrojtjes	441,680.00		441,680.00
3	Pagesë Ministria e Mbrojtjes në USD Qershor 2020	335,434.76		335,434.76
4	Transfertë Ministria e Arsimit	179,685.80		179,685.80
5	Pagesë Ministria e Mbrojtjes Gusht 2020	430,351.51		430,351.51
7	Diferenca Kursi i Këmbimit Konvertim Euro USD	16,374.81		16,374.81
V	Gabime, kthime nga bankat e nivelit të dytë	(924,427.69)	(924,427.69)	
	Pagesa inters garanci sovraane	30,983.98		30,983.98
GJ1; (H-D)	GJENDJA E LLOGARISË MË 31.12.2020	20,245,602.61	20,245,602.61	0.00
I	Gjendja e llogarisë në lekë	7,798,905.00	7,798,905.00	0
II	Gjendja në valutë e convert. në lekë më 31.12.2020	12,446,967.61	12,446,697.61	0.00
1	Gjendja në Euro	6,028,702.98	6,724,098.03	0.00
	Interesa Spot For ard (Euro)	116,649.16		
	Fitim/humbje Konvertim projekti Euro	934.62		
	Fitim/humbje nga derdhja dhe kthimi i shumave të derdhura gabim në euro Raiffeizen bank		(0.27)	
	Fitim/humbje derdhje gabim nga BSh		(35.73)	
	Diferenca Kursi i këmbimit blerje valute (Konvertim nga lek në Euro)/ shitje valute (konvertim nga euro në Lek)	111,360		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

	Rivlerësimi i Euros në Dhjetor	466,487.27		
2	Gjendja në dollar amerikan (USD)	60,464.93	64,447.30	(4,012.38)
	Interesa spot for ord për USD			
	Fitim/humbje I konvertimit të projekteve në USD	323.17		
	Rivlerësimi i USD dhjetor 2020	3,689.21		
3	Gjendja në SDR	4,140,204.35	5,658,122.28	(1,517,917.93)
	Interesa Spot for ord për SDR	72,908.99		
	Rivlerësimi i SDR dhjetor 2020	1,445,008.94		

Shënim: Tabela konceptuar nga grupi auditimit me të dhëna të subjektit.

Nga auditimi i regjistrimit të ardhurave dhe shpenzimeve, kaluar nga kjo llogari në të dy institucionet, si dhe gjendja e saj në fund të vitit, rezultoi:

Konfirmimin mujor të informacionit nga Departamenti i Operacioneve Monetare mbi të ardhurat totale dhe shpenzimet totale çdo muaj dhe jo të konfirmuara e të ndara të paktën në 7 grupe të ardhurash dhe shpenzimesh, ndërsa çdo ditë transferojnë me email të gjitha lëvizjet ditore të saj.

Gjendja e llogarisë së Unifikuar të Thesarit (TSA) ÷ Depozitë Qeverie është e njëjtë në të gjitha monedhat që përdoren e kontabilizohen në të dy institucionet (MFE& BoA), por rezultojnë **diferenca në zërat që prekin këtë llogari, për shkak se përdoren sisteme të ndryshme regjistrimi.**

Si rezultat i regjistrimit të ndryshëm të llogarisë së Unifikuar të Thesarit depozitë qeverie në të dy institucionet, për faktin e dizenjimit të sistemeve të ndryshme nga njëri tjetri, të dy grupet e analizuara të shpenzimeve dhe të ardhurave, **rezultoi se nga mbledhja e diferencave të zërave të shpenzimeve dhe të ardhurave, totali rezultoi pa diferencë, pra zero.** Gjithashtu diferencë midis totali të të ardhurave dhe totalit të shpenzimeve sipas Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është në vlerë të njëjta, pra 20,245,602.1 mijë lekë, vlerë e cila paraqet edhe gjendjen e llogarive në fund të vitit 2020 sipas dy institucioneve.

Rezultati financiar nga këmbimi valutë për veprimet (hyrje dalje) në llogarinë e Unifikuar të Thesarit “Depozite Qeverie” për vitin 2020.

Përdorimi i valutës në hyrje dalje të kësaj llogarie, për kryerjen e shpenzimeve të ndryshme, sjell llogaritjen e ÷ interesat spot-for ord gjatë kryerjes së veprimeve gjatë vitit, ndërsa në fund të vitit bëhet ÷ vlerësimi i gjendjes së valutës me monedhat e ndryshme, me kursin e ditës së fundit të vitit. Për vitin 2020, llogaritja e rezultatit nga përdorimi i valutës nga interesat e spot for ordit dhe rivlerësimin e saj në fund të vitit me kursin e ditës së fundit, si dhe krahasimi me 1 vit më parë, është si në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Rezultati nga përdorimi i valutës	Interesa Spot for ord (1)		Dif. kursi me fundin e vitit (2)		Shuma e diferencave (1+2)	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020
Në Euro	91,295	116,649	173,782	466,487	265,077	583,136
Në Dollar amerikan (USD)	0	0	8,085	3,689	8,085	3,689
Në SDR	3,458	72,909	-49,068	1,445,008	-45,610	1,517,917
Shuma	94,753	189,558	132,799	1,915,185	227,552	2,104,742
Rivlerësime e veprime me valuta të ndryshme					85,554	128,993
Totali					313,106	2,233,735

Tabela është përpiluar e sistemuar nga grupi i auditimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Për vitin 2020, totali i rezultatit nga përdorimi i valutës, i cili ngarkon shpenzimet e buxhetit të shtetit dhe shton të ardhurat e BOA, është në shumën 2,104,742 mijë lekë, e duke e krahasuar me vit 840% më i lartë.

Me valuta, rezultati nga përdorimi i valutës është:

-Për Euron për 583,136 mijë lekë, të ndara në interesat e spot Forard për 116,649 mijë lekë dhe rivlerësim i Euros në fund të vitit për 466,487 mijë lekë;

-Për Dollarin Amerikan (USD) për 3,689 mijë lekë dhe e gjithë shuma për òRivlerësimin e dollarit në fund të vitit;

-Për SDR për 1,517,917 mijë lekë, të ndara në interesat e spot Forard për 72,909 mijë lekë dhe òRivlerësim i SDR në fund të vitit, në vlerë 1,445,008 mijë lekë.

Me aktivitete, rezultati nga përdorimi i valutës është:

a. "Interesat Spot-Forward", në vlerë 189,558 mijë lekë, i cili përbën 9% të totalit të rezultatit, ndahet në: Interesa Spot Forard për euron, në vlerë 116,649 mijë lekë; Interesa Spot Forard për SDR për 72,909 mijë lekë.

b. Rivlerësim i valutës me kursin e datës 31.12.2020 për 1,915,185 mijë lekë, i cili përbën 91% të totalit të rezultatit, i ndarë nga:

Rivlerësim i euros, në vlerë 583,136 mijë lekë;

Rivlerësim i dollarit amerikan, në vlerë 3,689 mijë lekë;

Rivlerësim i SDR, në vlerë 1,517,917 mijë lekë.

Mbi zbatimin e ligjshmërisë për arkëtimet dhe pagesat direkte të kryera nëpërmjet llogarisë së Unifikuar të Thesarit "Depozitë e Qeverisë" për vitin 2020:

U audituan me zgjedhje dokumentacioni i kontabilizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të kaluara nga llogaria e unifikuar të thesarit-TSA òDepozitë e Qeverieò, si më poshtë:

a. **TË HYRAT** (të ardhurat), kontabilizuar në llogarinë e Unifikuar të thesarit òDepozitë Qeverieò:

1. **Fitimi i Bankës së Shqipërisë i vitit 2019**, derdhur brenda 4/mujorit të parë të vitit 2020, në vlerë **1,398,336.66 mijë lekë**. Në përputhje me Marrëveshjen Kuadër, ndërmjet Bankës së Shqipërisë me nr.251, datë 16.01.2015 dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, derdhja e Fitimit të Bankës së Shqipërisë i vitit 2019, derdhur dhe kontabilizuar në llogarinë e unifikuar të thesarit (TSA) òDepozitës së Qeverisëò në zërin òFitimi i Bankës së Shqipërisëò i vitit 2019, brenda 4/mujorit të parë të viti 2020 me një transfertë.

2. **Kontributet vullnetare, në shumën 907,787.83 mijë lekë**, nga të cilat shuma 135,445.56 mijë lekë kontribute vullnetare për tërmetin, shuma 67,005.06 mijë lekë kontribute vullnetare për Covid, shuma 672,418.51 mijë lekë grande të huaja për tërmetin e datës 26 Nëntor 2019 si dhe shuma 32,918.70 mijë lekë grande të huaja për Covid-19.

3. **Të adhurua nga koncesionet, në vlerë 8,494.08 mijë lekë**, për koncesionet si në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi i konçensionit	Nr. transfertave		Shuma euro		Kursi këmbimit		vlera	
		2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
1	Tirana Inter Airoport	2	0	19,942.70	0	123.87		2,470.21	
2	Agje Trajt. të Konc "Atrako"	1	1	5000	10,000.00	121.90	123.49	609.50	1,234.90
3	Transportit të Anijeve	12	12	65,035.94	58,709.40	123.11	123.65	8,006.41	7,259.18
	Totali	15	13	89,978.64	68,709.40			11,086.12	8,494.08

Shënim: Tabela është përpiluar nga grupi i auditimit me të dhëna të subjektit

Duke e krahasuar me një vit më parë të ardhurat nga koncesionet janë ulur për vlëren 2,592.04 mije lekë ose 23.4% më pak.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

4. Të ardhura nga licencat, në vlerë **704,753.30 mijë lekë**, në llogarinë e unifikuar të thesarit ÷Depozitë e Qeverie, janë licenca si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i koncesionit	Nr. i transfertave	Shuma euro	Kursi këmbimit	Vlera në mijë lekë
1	Licenca Albtelecom	2	5,483,608.00	128.5	704,753.30
	Totali	32	5,483,608.00		704,753.30

Shënim: Tabela është përpiluar nga grupi i auditimit me të dhëna të subjektit

Shuma e kaluar në këtë llogari më 01.04.2020, është e barabarta me nxjerrjen e evidencës së ardhurave të ÷Depozitës së Qeverisë nga Ministria e Financave dhe te evidenca e Bankës së Shqipërisë ishte e evidentuar tek ÷të ardhura të tjera. Në krahasim me një vit më parë të ardhurat nga licencat janë ulur për vlerën 1,807,261.18 mijë lekë ose 71.95% më pak.

b. DALJET (shpenzimet), kontabilizuar në llogarinë e unifikuar të thesarit (TSA), si më poshtë:
Transferta për kompensimin e pronave, me 6 transferta, në vlerë 2,227,418.90 mijë lekë, janë transferuar me shkresat e mëposhtme këto shuma:

Në mijë lekë

Nr.	Data e transfertës				Shuma në mijë lekë			
	2017	2018	2019	2020	2017	2018	2019	2020
1	04.04.2017	26.01.2018	29.01.2019	22.01.2020	900,000.00	9,769.62	38,216.91	28,959.09
2	28.04.2017	30.04.2018	02.03.2019	04.05.2020	300,000.00	550,000.00	144,961.74	102,143.48
3	23.05.2017	02.08.2017	02.04.2019	08.06.2020	300,000.00	675,000.00	880,000.00	777,000.00
4	25.07.2017	12.11.2018	21.06.2019	25.09.2020	454,594.50	610,754.85	1,080,000.00	382,323.95
5	10.08.2017	14.12.2018	21.06.2019	04.12.2020	63,217.41	700,000.00	300,941.32	530,000.00
6	22.08.2017	28.12.2018	15.10.2019	28.12.2020	50,691.06	162,018.01	199,993.67	414,356.37
7	13.12.2017	28.12.2018	30.10.2019		28,200.00	400,000.00	1,120,000.00	
8		28.12.2018	11.11.2019			175,000.00	52,787.11	
9			10.12.2019				67,108.06	
TOTALI					2,096,702.97	3,282,542.48	3,884,008.80	2,227,418.90

Shënim: Tabela është përpiluar nga grupi i auditimit me të dhëna të subjektit.

Shumat e kaluara me këto shkresa është e barabarta me nxjerrjen e evidencës së ardhurave të ÷Depozitës së Qeverisë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bankës së Shqipërisë po në këtë zë. Duke e krahasuar me një vit më parë, shpenzimet për kompensimin e pronave janë ulur në vlerën 1,656,589.9 mijë lekë ose rreth 42.7% më pak.

Shpenzime për blerje asetesh dhe likuidime të tjera, direkt nga llogaria e unifikuar të thesarit (TSA) ÷Depozitë qeverie në valuta e të konvertuara, në shumën **1,612,612 mijë lekë**. Për pagesa në valuta e në vlera të mëdha, degët e thesarit përdorin Llogarinë e Unifikuar të Thesarit dhe jo Bankat e Nivelit të Dytë, e që për vitin 2020, analitikisht për blerje asetesh dhe likuidime të tjera, si më poshtë:

- **Pagesa për Ministrinë e Mbrojtjes** për procesin e trajnimit të pilotëve dhe për programin e mirëmbajtjes së bashku me pjesët e këmbimit për prokurimin "US Blackhawk Helicopters", në shumën **441,680 mijë lekë**.

Bashkëlidhur praktikës gjenden dokumentet justifikues si:

Shkresa e Ministrisë së Mbrojtjes nr. 8787, datë 17.12.2018.

Shkresa e Ministrisë së Mbrojtjes nr. 1296, datë 27.02.2019.

Memorandumi i Ministrisë së Mbrojtjes, datë 13.01.2020 me subjekt "Transferimi i 4,000,000 USD nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes në llogarinë Albanian FMS (AL-Q-1QB) për prokurimin e US Blackhawk Helicopters".



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Shkresa e Ministrisë së Mbrojtjes nr. 233/1, datë 14.01.2020 me lëndë òDërgim dokumentacioni për vijimi procedurashò.

Shkresa e Ministrisë së Mbrojtjes/ Shtabi i Përgjithshme i Forcave të Armatosura nr. 542, datë 24.01.2020 me lëndë òKërkesë për transferim valute USDò dërguar Degës së Thesarit.

Urdhër shpenzimi nr. 19, datë 24.01.2020, në vlerën 4,000,000 USD, konvertuar në lekë në vlerën 441,680 mijë lekë, me kursin e këmbimit të datës 24.01.2020 (110.42 lekë), në llogarinë 602.

Shkresa e Degës së Thesarit Tiranë nr. 514/3, datë 24.01.2020 òKërkesë për transferim fondiò drejtuar Ministrisë së Financës/ Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, ku është dërguar urdhër shpenzimi nr.19, datë 22.01.2020.

Me shkresën e MFE/DOH nr.1361/2, datë 27.01.2020 òTransfertë për likuidim pageseò, drejtuar Bankës së Shqipërisë/Departamentit të Sistemeve të Pagesave, i Kontabilitetit dhe Financës, për dijeni: Degës së Thesarit Tiranë dhe Ministrisë së Mbrojtjes për pagesën e 4,000,000 USD nga llogaria me IBAN: òDepozita e Qeverisë në USDò në favor të: D....., në Bankën, me nr. Llogarie, Ne York. Për këtë pagesë të përdoret fondi në llogarinë òDepozitë e Qeverisë në Euroò. Rezulton se më datën 27.01.2020 në Depozitën e Qeverisë në USDò janë transferuar 4,000,000 USD pas konvertimit nga llogaria òDepozitë e Qeverisë në Euroò, pasi òDepozitat e Qeverisë në USDò nuk ka pasur fonde të mjaftueshme për të paguar këtë urdhër shpenzimin.

-Pagesë për blerje vakcine nga ISHP, në vlerë 118,275.92 mijë lekë (1,029,112.72 USD me kursin 114.93 lekë) për artikulli 605, në programin buxhetor 07450, kapitulli 1. Kjo pagesë nga llogaria e Unifikuar e Thesarit òDepozitë qeverieò, ka këtë dokumentacion shoqërues:

Shkresën e UNICEF, datë 04.03.2020 Drejtuar Institutit të Shëndetit Publik, për llogaritjen e koston së vaksinave në vlerën 1,029,112.72 USD (Cost Estimate 10021837)

Shkresa e Ministrisë së Shëndetësisë nr. 1898, datë 05.04.2016 me lëndë òProkurimi i vaksinave të programit kombëtar të imunizimitò.

Urdhri i drejtorit të ISHP nr.53, datë 15.04.2020 për kryerjen e pagesës në favor të UNICEF Danimarkë sipas Cost Estimate 10021837, datë 04.03.2020 për vaksinat e kalendarit të Programit Kombëtar të Vaksinimit në shumën 1,029,112.72 USD me kursin e këmbimit të datës 15.04.2020 në vlerën i USD=114.93 lekë.

Urdhër shpenzimi nr.74, datë 15.04.2020, në vlerë 118,275.92 mijë lekë (1,029,112.72 USD me kursin e datës 15.04.2020 për 114.93 lekë).

Shkresa nr. 252/3, datë 15.04.2020 e Institutit të Shëndetit Publik drejtuar Degës së thesarit Tiranë për transferim fondesh.

Shkresa nr.2409/1, datë 15.04.2020 e DPTH/DTH Tiranë, drejtuar MFE, ku është dërguar urdhër shpenzimi nr. 74, datë 15.04.2020 dhe është kërkuar transferimi i fondeve për kryerjen e pagesës.

Me shkresën e MFE/DOH nr.6727/1, datë 16.04.2020 òTransfertë për likuidim pageseò, drejtuar Bankës së Shqipërisë/Departamentit të Sistemeve të Pagesave, i Kontabilitetit dhe Financës, për dijeni: Degës së Thesarit Tiranë dhe Institutit të Shëndetit Publik për pagesën e 1,029,112.72 USD nga llogaria me IBAN: òDepozita e Qeverisë në USDò në favor të: U..., në N... B....., me nr. Llogarie, Copenhagen.

Për këtë pagesë të përdoret fondi në llogarinë òDepozitë e Qeverisë në Euroò. Rezulton se më datën 16.04.2020 në Depozitën e Qeverisë në USDò janë transferuar 1,029,112.72 USD pas konvertimit nga llogaria òDepozitë e Qeverisë në Euroò, pasi òDepozitat e Qeverisë në USDò nuk ka pasur fonde të mjaftueshme për të paguar këtë urdhër shpenzimin.

Nga auditimi rezulton se vlera 55,081.48 USD òContingency bufferò është klasifikuar si shpenzim në llogarinë 605, ndërkohë që referuar kontratës dhe shkresës së dërguar nga UNICEF për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Ilogaritjen e kostos konkretisht në pikës 6, citohet se mbi koston e vlerësuar të furnizimit, aplikohet një tarifë prej 6% e cila përdoret për të mbuluar luhatjet në tregun e mallrave dhe diferencat nga kurset e këmbimit dhe llogaritja e vlerës së ÷contingency bufferö do pasqyrohet në faturë. Pra kjo tarifë duhet të klasifikohet si parapagim nga institucioni përkatës.

-Pagesa për Ministrinë e Mbrojtjes, në shumën 335,434.76 mijë lekë (3,037,808 USD me kursin 110.42 lekë), për likuidim e pagesës për blerjen e “Sistemit të Komunikimit Tokë – Ajër - Tokë”, artikull 231, në programin buxhetor 02120, kapitulli 1. Kjo pagesë nga llogaria e Unifikuar e Thesarit ÷Depozitë qeverieö, ka këtë dokumentacion shoqërues:

LOA ÷Letter of Offer and Acceptanceö AL-B-UBT, datë 06.05.2020 ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe U.S Army Security Assistance Command , SHBA për blerjen e ÷Sistemit të komunikimit Tokë- Ajër- Tokëö.

Shkresa nr. 1694, datë 29.06.2020 e Komandës së Forcës Ajrore, drejtuar Degës së Thesarit Tiranë me lëndë ÷Kërkesë për transferim fondeshö në vlerën 3,037,808 USD me kursin e këmbimit në vlerën 1 USD=110.42 lekë.

Urdhër shpenzimi nr.238, datë 29.06.2020, në vlerë 335,434.76 mijë lekë (3,037,808 USD me kursin e datës 29.06.2020 për 110.42 lekë).

Shkresa nr.3786/1, datë 29.06.2020 e DPTH/DTH Tiranë, drejtuar MFE, ku është dërguar urdhër shpenzimi nr.238, datë 29.06.2020 dhe është kërkuar transferimi i fondeve për kryerjen e pagesës.

Me shkresën e MFE/DOTH nr.12221/1, datë 29.06.2020 ÷Transfertë për likuidim pageseö, drejtuar Bankës së Shqipërisë/Departamentit të Sistemeve të Pagesave, i Kontabilitetit dhe Financës, për dijeni: Degës së Thesarit Tiranë dhe Ministrisë së Mbrojtjes për pagesën e 3,037,808 USD nga llogaria me IBAN: AL.....1U ÷Depozita e Qeverisë në USDö në favor të: D..... United States of America , me nr. Llogarie, USA.

Për këtë pagesë të përdoret fondi në llogarinë ÷Depozitë e Qeverisë në Euroö. Rezulton se më datën 30.06.2020 në Depozitën e Qeverisë në USDö janë transferuar 3,037,808 USD pas konvertimit nga llogaria ÷Depozitë e Qeverisë në Euroö, pasi ÷Depozitat e Qeverisë në USDö nuk ka pasur fonde të mjaftueshme për të paguar këtë urdhër shpenzimin.

Nga auditimi rezulton se vlera 3,037,808 USD është klasifikuar në llogarinë 231 ÷Aktive Kapitale të Trupëzuarö, nga institucioni përkatës. Referuar zërave të koston së llogaritura sipas LOA (Letter of Offer and acceptance) AL-B-UBT rezulton se në vlerën totale të koston së llogaritur është e përfshirë edhe vlera 204,820 USD që i përket trajnimeve që do të zhvillohen, duke mbivlerësuar llogarinë 231 në vlerën 204,820 USD.

-Pagesa për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në shumën 179,685.80 mijë lekë, për likuidim e pagesës mbi pjesëmarrjen në programin kuadër “Horizon 2020- Program për kërkimin dhe Inovacionin”, artikull 605, në programin buxhetor 09770, kapitulli 1 dhe 6. Kjo pagesë nga llogaria e Unifikuar e Thesarit ÷Depozitë qeverieö, ka këtë dokumentacion shoqërues:

Ligji nr.132/2014 ÷Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin kuadër ÷Horizon 2020- Program për Kërkimin dhe Inovacioninö.

Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin kuadër ÷Horizon 2020- Program për Kërkimin dhe Inovacioninö (2014-2020).

Notë Debiti e Komisionit Evropian në vlerën 1,448,028.06 Euro.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Shkresa nr. 3211/1, datë 09.07.2020 e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë drejtuar Degës së thesarit Tiranë me lëndën ÷Kërkesë.

Urdhër shpenzimi nr. 269, datë 09.07.2020.

Shkresa nr.4081/1, datë 29.07.2020 e DPTH/DTH Tiranë, drejtuar MFE, ku është dërguar urdhër shpenzimi nr.238, datë 29.06.2020 dhe është kërkuar transferimi i fondeve për kryerjen e pagesës. Me shkresën e MFE/DOTH nr.13019/1, datë 10.07.2020 ÷Transferti për likuidim pagesë, drejtuar Bankës së Shqipërisë/Departamentit të Sistemeve të Pagesave, i Kontabilitetit dhe Financës, për dijeni: Degës së Thesarit Tiranë dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për pagesën e 1,448,028.06 nga llogaria me IBAN: ÷Depozita e Qeverisë në Euroë në favor të E... C., me nr. Llogarie BE, Brussels.

-Pagesa për Ministrinë e Mbrojtjes, në shumën 430,351.51 mijë lekë (4,085,357 USD me kursin e këmbimit të datës 12.08.2020, 105.34 lekë), për likuidim e pagesës për blerjen e “Pajisjeve të komunikimit taktik në radio”, artikulli 231, në programin buxhetor 02120, kapitulli 1. Kjo pagesë nga llogaria e Unifikuar e Thesarit ÷Depozitë qeverie, ka këtë dokumentacion shoqëruar:

LOR ÷Letter of Request Amendment #2 për rastin AL-B-UBO

LOA ÷Letter of Offer and Acceptance Amendment 2 AL-B-UBO.

Shkresa nr. 3106/2, datë 03.08.2020 e Ministrisë së Mbrojtjes ÷Për vijimin e procedurave për pagesën.

Urdhëri nr. 557, datë 07.08.2020 i Komandantit të Forcave Tokësore ÷Për pagesën e LOA (Letter of Offer and Acceptance) AL-B-UBO.

Shkresa nr. 2568/3, datë 12.08.2020 e Komandës së Forcës Tokësore, drejtuar Degës së Thesarit Tiranë me lëndë ÷Kërkesë për transferim fondesh në vlerën 4,085,357 USD me kursin e këmbimit në vlerën 1 USD=105.34 lekë.

Urdhër shpenzimi nr.476, datë 12.08.2020, në vlerë 430,351.51 mijë lekë.

Shkresa nr.4898/1, datë 12.08.2020 e DPTH/DTH Tiranë, drejtuar MFE, ku është dërguar urdhër shpenzimi nr.476, datë 12.08.2020 dhe është kërkuar transferimi i fondeve për kryerjen e pagesës.

Me shkresën e MFE/DOTH nr.15165/1, datë 12.08.2020 ÷Transferti për likuidim pagesë, drejtuar Bankës së Shqipërisë/Departamentit të Sistemeve të Pagesave, i Kontabilitetit dhe Financës, për dijeni: Degës së Thesarit Tiranë dhe Ministrisë së Mbrojtjes për pagesën e 4,085,357 USD nga llogaria me IBAN: ÷Depozita e Qeverisë në USD në favor të: D..... , me nr. Llogarie, USA.

Për këtë pagesë të përdoret fondi në llogarinë ÷Depozitë e Qeverisë në Euroë. Rezulton se më datën 13.08.2020 në Depozitën e Qeverisë në USD janë transferuar 4,085,357 USD pas konvertimit nga llogaria ÷Depozitë e Qeverisë në Euroë, pasi ÷Depozitat e Qeverisë në USD nuk ka pasur fonde të mjaftueshme për të paguar këtë urdhër shpenzimin.

Nga auditimi rezulton se vlera 4,085,357 USD është klasifikuar në llogarinë 231 ÷Aktive Kapitale të Trupëzuar, nga institucioni përkatës. Referuar zërave të kostos së llogaritura sipas LOA (Letter of Offer and acceptance) AL-B-UBO rezulton se në vlerën totale të kostos së llogaritur është e përfshirë edhe vlera 208,272 USD që i përket trajnimeve që do të zhvillohen, duke mbivlerësuar llogarinë 231 në vlerën 208,272 USD.

-Pagesë për blerje vaksine nga ISHP, në vlerë 107,184.79 mijë lekë (1,016,451.29 USD me kursin 105.45 lekë) për artikulli 605, në programin buxhetor 07450, kapitulli 1. Kjo pagesë nga llogaria e Unifikuar e Thesarit ÷Depozitë qeverie, ka këtë dokumentacion shoqëruar:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Shkresën e UNICEF, datë 01.09.2020 Drejtuar Institutit të Shëndetit Publik, për llogaritjen e kostos së vaksinave në vlerën 1,029,112.72 USD (Cost Estimate 10022907).

Shkresa e Ministrisë së Shëndetësisë nr. 1898, datë 05.04.2016 me lëndë oProkurimi i vaksinave të programit kombëtar të imunizimito.

Urdhri i drejtorit të ISHP nr.172, datë 19.10.2020 për kryerjen e pagesës në favor të UNICEF Danimarkë sipas Cost Estimate 10022907, datë 01.09.2020 për vaksinat e kalendarit të Programit Kombëtar të Vaksinimit në shumën 1,016,451.29 USD me kursin e këmbimit të datës 19.10.2020 në vlerën 1 USD=105.45 lekë.

Urdhër shpenzimi nr.445, datë 19.10.2020, në vlerë 107,184.79 mijë lekë (1,016,451.29 USD me kursin e datës 19.10.2020 për 105.45 lekë).

Shkresa nr. 1137/2, datë 19.10.2020 e Institutit të Shëndetit Publik drejtuar Degës së thesarit Tiranë për transferim fondesh.

Shkresa nr.6191/1, datë 19.10.2020 e DPTH/DTH Tiranë, drejtuar MFE, ku është dërguar urdhër shpenzimi nr. 445, datë 19.10.2020 dhe është kërkuar transferimi i fondeve për kryerjen e pagesës.

Me shkresën e MFE/DOTH nr.19562/1, datë 19.10.2020 oTransferte për likuidim pageseo, drejtuar Bankës së Shqipërisë/Departamentit të Sistemeve të Pagesave, i Kontabilitetit dhe Financës, për dijeni: Degës së Thesarit Tiranë dhe Institutit të Shëndetit Publik për pagesën e 1,016,451.29 USD nga llogaria me IBAN: AL45 oDepozita e Qeverisë në USDö në favor të:, në N..... A/S, me nr. Llogarie Copenhagen.

Për këtë pagesë të përdoret fondi në llogarinë oDepozitë e Qeverisë në Euroö. Rezulton se më datën 20.10.2020 në Depozitën e Qeverisë në USDö janë transferuar 1,016,451.29 USD pas konvertimit nga llogaria oDepozitë e Qeverisë në Euroö, pasi oDepozitat e Qeverisë në USDö nuk ka pasur fonde të mjaftueshme për të paguar këtë urdhër shpenzimin.

Nga auditimi rezulton se vlera 54,357.06 USD oContingency bufferö është klasifikuar si shpenzim në llogarinë 605, ndërkohë që referuar kontratës dhe shkresës së dërguar nga UNICEF për llogaritjen e kostos konkretisht në pikës 6, citohet se mbi koston e vlerësuar të furnizimit, aplikohet një tarifë prej 6% e cila përdoret për të mbuluar luhatjet në tregun e mallrave dhe diferencat nga kurset e këmbimit dhe llogaritja e vlerës së ocontingency bufferö do pasqyrohet në faturë. Pra kjo tarifë duhet të trajtohet si parapagim, nga institucioni përkatës.

Auditimi i konfirmimit të llogarive speciale të qeverisë në Bankën e Shqipërisë, jashtë llogarisë së Unifikuar të Thesarit “Depozitë qeverie”:

Në përputhje me ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 oPër Bankën e Shqipërisëö, i ndryshuar, Banka e Shqipërisë ka të drejtë të veprojë si **agjente fiskale** për llogari të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, sipas kushteve dhe mënyrave të parashikuara në marrëveshje me ministrin e Financave. Gjithashtu Banka e Shqipërisë nëpërmjet sistemit bankar, **kryen funksionet e arkës së buxhetit të shtetit**. Ajo mund të pranojë depozita nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe kryen veprime pagesash deri në kufijtë e këtyre depozitave dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në marrëveshje, mund të autorizojë një bankë sipas gjykimit të saj, ku të kalojnë këto depozitaö. Në mbështetje të udhëzimit nr.46, datë 24.12.2020 oPër procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2020ö, kapitulli III oMarrëdhëniet e Ministrisë së Financave me Bankën e Shqipërisëö në pikën 15 përcaktohet se: Llogaria oDepozitë e qeverisë dhe të gjitha llogaritë speciale të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Bankën e Shqipërisë, në datën e parë të punës në muajin Janar të vitit 2020, do të mbartin tepricën e këtyre llogarive në fund të vitit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Nga auditimi për vitin 2020, sikundër edhe vite të tjera Qeveria Shqiptare, ka të çelura në Bankën e Shqipërisë për llogari të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, përveç Llogarisë së Unifikuar të Thesarit oDepozitë qeverieë edhe disa llogari të tjera speciale të qeverisë. **Llogaritë speciale të qeverisë** të çelura në Bankën e Shqipërisë, gjendje në fund të vitit 2020, por edhe të një viti më parë, të ndara në llogari (lekë, euro e dollarë), janë si në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Nr.	LLOGARITË SPECIALE TË QEVERISË	31.12.2019	31.12.2020
	Llogari Shpronësimesh e të tjera në lekë	4,377,916.69	5,276,195.17
	Fonde rezerve nga llogaritë speciale, në lekë	1,147,573.80	4,430,876.60
	Llogari projektesh në lekë	1,624,076.05	1,336,390.99
1	Shuma e llogarisë në mijë lekë (a+b+c)	7,149,566.54	11,043,462.76
	Llogaritë e tjera të Qeverisë për projektet në Euro	8,027,506.70	12,369,623.51
	Llogari solidariteti për dëmet nga tërmeti	683,037.23	0
	Llogari të Fondit Kombëtar në euro	18,095,920.43	14,675,775.09
	Shuma e llogarive në EURO	26,806,464.36	27,045,398.6
	<i>Kursi këmbimit</i>	<i>121.77</i>	<i>123.7</i>
2	Të konvertuara Eurot në mijë lekë	3,264,223.17	3,345,518.81
	Llogaritë e tjera të Qeverisë për projektet në USD	362,921.60	175,837.84
	llogari solidariteti për dëmet nga tërmeti	200,000	0
	Shuma e llogarive në USD	562,921.60	
	<i>Kursi këmbimit</i>	<i>108.64</i>	<i>100.84</i>
3	Të konvertuara USD në mijë lekë	61,155.80	17,731.49
	Totali i konvertuar në mijë lekë (1+2+3)	10,474,945.51	14,406,713.06

Shënim: Tabela hartuar nga grupi i auditimit. Totali në lekë është i konvertuar me kursin e valutave në datat e fundit të vitit 2019 dhe 2020.

Gjendja e llogarive jashtë TSA në fund të vitit 2020 është në vlerën **14,406,713.06 mijë lekë**, në krahasim me fundin e vitit 2019, gjendja e llogarive jashtë TSA është rritur në vlerën 3,931,767.55 mije lekë ose 37.5%. Duke e krahasuar me gjendjen totale të llogarive të qeverisë që mbahen në Bankën e Shqipërisë, të konvertuar në lekë për vitin 2020, në shumën **34,652,315.67 mijë lekë** (TSA + llogaritë speciale), gjendja e llogarive speciale për këtë vit zë **41.5%** të totalit të gjendjes së llogarive të qeverisë.

1. Llogaritë speciale të qeverisë në lekë, të çelura në BOA, janë gjendje në fund të vitit e të konfirmuara në shumën **11,043,462.76 mijë lekë**, me këto grupe llogarish:

a. Llogaritë e shpronësimeve në 4 llogari, gjendja në fund të vitit konfirmuar në vlerë **5,276,195.17 mijë lekë**. Drejtoria e Operacioneve monetare të Thesarit në MFE me shkresën nr. 396, datë 11.01.2021, ka dërguar për rakordim me Bankën e Shqipërisë, llogaritë jashtë TSA. Llogaritë për shpronësimet, fonde, gjendje në fillim të vitit 2020, hyrjet dhe daljet gjatë vitit, por edhe gjendja në fund të vitit, të ndara me nënlllogari, janë të konfirmuara si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Emërtimi i llogarive	Gjendja 01.01.2020	Hyrje	Dalje	Gjendja 31.12.2020
Fondi i shpronësimeve (2119001L)	125,716,742.76	309,288.5	105,416,027.67	20,610,003.59
Fondi i shpron të ngrira për procedurë (2119003L)	45,004,171.96	3,826,402	3,826,402	45,004,171.96
Fond special i kompensit të Pronave (2119006L)	4,141,551.279	2,227,418,859.29	1,223,032,183.41	5,145,937,990.88
Fond për mbësh dhe rindërt. e gërdecit (2119004L)	64,643,000	0	0	64,643,000
Shuma	4,376,915,193.72	2,231,554,585.79	1,332,274,613.08	5,276,195,166.43

Tabela është përpiluar e sistemuar nga grupi i kontrollit, në bazë të tabelave shoqëruese nga dy institucionet (MFE & BOA).

Për vitin 2020, në llogarinë e shpronësimit kanë hyrë 2,231,665.59 mijë lekë dhe kanë dalë prej tyre 1,332,274.61 mijë lekë. Gjendja në fund të vitit 2020 është 20.6% më shumë se një vit më parë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

b. Depozita të Fondeve Rezervë të (ISSH & ISKSH), me 4 llogari në vlerë 4,430,876.60 mijë lekë. Drejtoria e Operacioneve monetare të Thesarit në MFE me shkresën nr. 396/2, datë 11.01.2021, ka dërguar për rakordim me Bankën e Shqipërisë, llogaritë jashtë TSA. Këto fonde, gjendje në fillim të vitit 2020, hyrjet dhe daljet gjatë vitit, por edhe gjendja në fund të vitit, të ndara me nën llogari, janë të konfirmuara si në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Nr. i llog.	Llogaritë speciale (ISSH& FSDKSH)	Balancat në vlerë	
		Gjendja më 31.12.2019	Gjendja më 31.12.2019
2112002L	Fondi rezervë i FSDKSH	202,568.83	4,000,000
2113002L	Llogaria e FSDKSH	150,685.42	7,180.80
1	Shuma FSDKSH	353,254.25	4,007,180.8
2112001L	Fondi rezervë i ISSH	793,813.00	70,447.26
2111003L	Kontribute të Sig. Shoq. e Shëndetësore	506.55	353,248.54
2	Shuma ISSH	794,319.55	423,695.77
1+2	Shuma FSDKSH+ ISSH	1,147,573.80	4,430,876.57

Tabela është përpiluar e sistemuar nga grupi i kontrollit, në bazë të tabelave shoqëruese nga dy institucionet (MFE & BOA).

Këto llogari janë çelur në Bankën e Shqipërisë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe nga Fondi i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

c. Llogaritë speciale të Qeverisë për projekte, për 9 llogari në lekë, në vlerë 1,336,390.99 mijë lekë. Këto fonde, gjendje në fillim të vitit 2020, hyrjet dhe daljet gjatë vitit, por edhe gjendja në fund të vitit, të ndara me nën llogari, janë të konfirmuara si në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Nr. i llog.	Llogaritë speciale të projekteve	Balancat në vlerë	
		Gjendja më 31.12.2019	Gjendja më 31.12.2020
2117259L	0	34,004.68
2117284L	113,352.39	113,352.39
2117239L	310,942.59	310,942.59
2117439L	702,921.90	0
2117724L	495,736.28	79,141.59
2117683L	1,222.89	1,222.89
2117259L	0	702,921.90
211758AL	..	0	31,506.19
211761AL	..	0	32,200.86
211762AL	...	0	31,197.91
	Shuma	1,624,076.05	1,336,390.99

Tabela është përpiluar e sistemuar nga grupi i kontrollit, në bazë të tabelave shoqëruese nga dy institucionet (MFE & BOA).

2. Llogaritë speciale të Qeverisë në Euro, në fund të vitit 2020, të ndara me nëngrupe si më poshtë:

a. Llogaritë speciale të Qeverisë për projektet në shumën 12,369,623.51 euro: Këto fonde, gjendje në fillim të vitit 2020, të ndara me nën llogari, janë të konfirmuara me llogari si në tabelën e mëposhtme:

Në euro

Nr. i llog.	Llogaritë speciale të projekteve	Gjendja më 31.12.2020
211703AE	P.....	58,762.58
211704AE	S.....	58,747.49
211705AE	G....Z....	69,315.79
211708AE	M...s.....	52,618.03
211712AE	Bl.....	107,133.18



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

2117131E	N.....	523.87
211713AE	R... U	186,311.70
211715AE	P....	45,000.00
2117198E	P.....	4,036,171.10
211724AE	C.....	98,828.00
211725AE	V.....	13,283.00
2117268E	Q.....	71,894.36
211734AE	A.....	13,615.80
211737AE	A.....	15,603.86
211743AE	S.....	21,111.69
2117476E	A.....	44,218.97
211748AE	R.....	27,415.00
211749AE	R.....	23,825.00
2117514E	N.....	1,482.71
2117518E	A..	26,841.76
2117537E	S.....	15,034.92
2117541E	Li....	21,415.16
211754AE	Pl.....	293,625.39
2117550E	B.....	6,647.81
2117561E	J....	1,038
2117573E	F.....	58,138.12
2117590E	E.....	8,149.23
2117626E	S.....	1,326.14
2117630E	P.....	52,246.70
2117639E	B....	3,500,000.00
2117653E	P....	797,182.37
2117657E	H.....	3,794.25
2117662E	E.....	42,926.67
2117664E	M.....	12,437.57
2117670E	A.....	45,229.72
2117674E	Of.....	99,900.80
2117696E	B....	3,656.39
2117704E	E.....	4,120.42
2117705E	I.....	10,191.85
2117712E	S.....	40,759.24
2117716E	L.....	34,337.76
2117717E	C.....	22,441.22
2117729E	E.....	81,741.91
2117730E	Nat.	11,135.62
2117736E	10,531.25
2117737E	A.....	5,506.50
2117741E	E.....	5,093.90
2117775E	C.....	14,476.09
2117776E	C.....	120,172.25
2117780E	C....	16,482.21
2117784E	F.....	41,804.35
2117786E	Projekti U	6,368.96
2117787E	g.....	8,509.89
2117788E	IN.....	1,649.40
2117793E	E.....	5,381.74
2117794E	F.....	50,687.46
2117802E	R.....	18,384.71
2117804E	B.....	4,029.00
2117806E	B.....	167,860.27
2117808E	P.....	4,319.57
2117861E	S.....	179,748.05
2117820E	I....	5,260.69
2117829E	P....	5,192.33
2117836E	Fushë sportive	51,297.18



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE
EKONOMISË

2117837E	b.....	26,123.63
2117839E	H....	3,245.38
2117844E	A.....	12,118.31
2117845E	B....	28,531.89
2117847E	W.....	33,861.93
2117853E	T....	158,589.18
2117865E	N....	54,040.86
2117866E	L...	3,819.92
2117868E	Mi....	12,991.55
2117877E	S.....	47,621.48
2117891E	G.....	31,525.76
2117893E	R.....	42,607.36
2117909E	S.....	3,460.00
2117916E	P.....	19,579.74
2117925E	C..	5,148.45
2117928E	C.	6,175.63
2117933E	...	8,520.52
2117594E	My ...	4,982
2117959E	T....	50,842.91
2117975E	Për	287,369.22
2117978E	B.....	6,267.55
2117979E	T...	49,266.79
2117971E	L...	416,380.20
2117986E	E.....	58,841.59
2117988E	G.....	101,841.59
2217723E	E....	31,095.00
	Të tjera projekte	1,838.12
Shuma në euro		12,369,623.31

Tabela është përpiluar e sistemuar nga grupi i kontrollit, në bazë të tabelave shoqëruese nga dy institucionet.

Gjendja e këtyre llogarive projektsh në euro për vitin 2020, krahasuar me një vit më parë është 54% më e lartë.

b. Në fund të vitit 2020 llogarit solidariteti për dëmet nga tërmeti janë paraqitur në vlerën 0 euro.

c. Llogari të çelura në Bankën e Shqipërisë nga Fondi Kombëtar dhe gjendja e tyre në fund të vitit 2020 është 14,675,775.09 euro. Në Udhëzimin nr.10, datë 09.03.2015 për përcaktimin e procedurave për menaxhimin nëpërmjet fondit kombëtar të bashkëfinancimit të buxhetit të shtetit për projektet IPAö, i ndryshuar me Udhëzimin nr.26, datë 29.12.2016, është bërë ndryshimi i pikës III.2 si më poshtë: ÷Fondet vjetore të bashkëfinancimit të palës shqiptare nga buxheti i shtetit (fondi i planifikuar në strukturën përkatëse të buxhetit vjetor në NJSHQP) transferohen nga llogaria e unifikuar e thesarit ÷Depozitë e qeverisë në Bankën e Shqipërisë (TSA), në llogarinë bankare të dedikuar të Fondit Kombëtar, brenda 15 ditësh nga marrja e kërkesës së Fondit Kombëtar/ZKA-së, drejtuar sekretarëve të përgjithshëm/zyrtarëve autorizues të NJSHQP-ve për kalimin e shumës përkatëse të bashkëfinancimit dhe TVSH-së (në rast se është e aplikueshme). Sekretari i përgjithshëm/zyrtari autorizues i NJSHQP-së, brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja e kërkesës së ZKA-së, e përdor atë si dokument justifikues dhe konfirmon urdhër shpenzimit, duke ia paraqitur atë degës së thesarit për transferimin e fondit nga TSA-ja në llogarinë e dedikuar të Fondit Kombëtar, sipas procedurës ekzistuese të kryerjes së transaksioneve të qeverisjes së përgjithshme nëpërmjet sistemit të thesarit.

Banka e Shqipërisë, i ka konfirmuar MFE/Fondit Kombëtar gjendjen e këtyre llogarive si në tabelën e mëposhtme:

Në euro

Projekti	mon	Nr. i llog.	Gjendja	Lëvizjet gjatë vitit	Gjendja më
----------	-----	-------------	---------	----------------------	------------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

				01.01.2020	hyrje	dalje	31.12.2020
1	Fonde të BE për RSH -IPA 2012	EURO	2122012E	0.00	573,549.52	335,605.40	237,944.12
2	Fonde të BE për RSH -IPA 2013	EURO	2122013E	230,457.67	1,563,893.16	572,480.09	1,221,870.74
3	Fonde të BE për RSH -IPARD II	EURO	2122014E	11,716,512.27	4,996,702.12	8,127,697.44	8,585,516.95
4	Fonde të BE për RSH -IPA 2014	EURO	2122015E	2,765,445.98	2,459,422.45	2,673,868.99	2,550,999.44
5	Fonde të BE për RSH -IPA 2015	EURO	2122016E	1,389,822.34	3,524,426.97	3,918,306.09	995,943.22
6	Fonde të BE për RSH -IPA 2015	EURO	2122017E	500,000			500,000
7	Fonde të BE për RSH -IPA 2017	EURO	2122019E	0.00	1,479,996.70	896,496.08	583,500.62
8	Fonde të BE për RSH -IPA 2018	EURO	2122020E	1,493,682.14	1,500,003.30	2,993,685.44	0
	Shuma në euro			18,095,950.4	16,097,994.12	19,518,139.53	14,675,775.09

Tabela është përpiluar e sistemuar nga grupi i kontrollit, në bazë të tabelave shoqëruese nga dy institucionet (MFE & BOA).

Për të gjitha llogarit e mësipërme bashkëlidhur llogarive gjenden edhe lëvizjet e tyre (hyrje dhe dalje), të cilat **konfirmonin** shumat e tabelës përmbledhëse.

3. Llogaritë e tjera të Qeverisë për projektet në USD: në fund të vitit 2020, shuma prej **175,837.84 dollarë**, nga të cilat **Llogaritë për projekte**, gjendje në fund të vitit 2020, por edhe një vit më parë, të ndara me nën/llogari, janë të konfirmuara për **175,837.84 dollarë**, si në tabelën e mëposhtme:

Në USD

Nr. i llog.	Llogaritë speciale të projekteve	Balancat në vlerë	
		Gjendja 31.12.2019	Gjendja më 31.12.2020
2117684 USD	300,000.00	112,986.24
2117104 USD	o z.....	17,772.05	17,772.05
2117715 USD	o im.....	21,064.96	21,064.96
2117763 USD	N.....	23,250.00	
2117634 USD	n.....	0	23,180
	Të tjera	834.59	834.59
	Shuma	362,921.60	175,837.84

Tabela është përpiluar e sistemuar nga grupi i kontrollit, në bazë të tabelave shoqëruese nga dy institucionet (MFE & BOA).

Nga auditimi i vlerësimit të sistemeve të kontrollit në çeljen dhe konfirmimin e llogarive speciale në Bankën e Shqipërisë, jashtë llogarisë së Unifikuar të Thesarit oDepozitë Qeverie, rezultoi se: për vitin 2020, Depozitat speciale, janë të çelura për çdo projekt të veçantë. Në rastin e kërkesës së informacionit mbi balancat e këtyre llogarive, Ministria e Financës i kërkon informacion Bankës së Shqipërisë dhe më pas balancat i dërgohen audituesit të pavarur, po me vlerat që ka konfirmuar Banka e Shqipërisë.

Titulli i gjetjes	Nga auditimi i Llogarisë së Unifikuar të thesarit “Depozitë qeverie” dhe konfirmimi i saj me Bankën e Shqipërisë, rezulton se vazhdon të mos konfirmohen të grupuara në të paktën 7 grupe kryesore, të ardhurat dhe shpenzimet.
Situata:	Nga auditimi në lidhje me llogarinë oDepozitë e qeverisë dhe rakordimi i saj me Bankën e Shqipërisë u konstatua se për vitin 2020, Banka e Shqipërisë çdo muaj ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë shkresa për konfirmimin e gjendjes së Llogarisë së Unifikuar të Thesarit oDepozitë Qeverie, mbi të ardhurat totale dhe shpenzimet totale, por jo të grupuara në të paktën 7 grupe kryesore si: Të ardhura tatimore; Të ardhura jo tatimore; Shpenzime të përgjithshme; Shpenzime për interesa; Financim i brendshëm nëpërmjet emetimit; Financimi i jashtëm; Instrumentet, duke sjellë vështirësi në auditimin e kësaj llogarie dhe krahasimin e saj me regjistrimin midis dy



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

	<p>institucioneve. Si rezultat i regjistrimit të ndryshëm të llogarisë së Unifikuar të Thesarit dhe Depozitë Qeverie në të dy institucionet, për faktin e dizenjimit të sistemeve të ndryshme nga njëri tjetri, të dy grupet e analizuara të shpenzimeve dhe të ardhurave, rezultoi se nga mbledhja e diferencave të zërave të shpenzimeve dhe të ardhurave, totali nuk reflekton diferenca, pra është zero. Gjithashtu diferenca midis totali të të ardhurave dhe totalit të shpenzimeve sipas Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është në vlerë të njëjtë, për 20,245,602 mijë lekë, vlerë e cila paraqet edhe gjendjen e llogarive në fund të vitit 2020 sipas dy institucioneve.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshua, neni 8; Ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 për Bankën e Shqipërisë, i ndryshuar; UMFE: nr.9, datë për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, i ndryshuar, pika 138; UMFE nr.46, datë 24.12.2020 për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2020; Aneksi 1 i Marrëveshjes kuadër ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për ofrimin e shërbimeve financiare nga Banka e Shqipërisë për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë.</p>
Impakti:	<p>Impakt negativ në konfirmimin e shpejtë të përdorimit të fondeve buxhetore.</p>
Shkaku:	<p>Mos koordinimi i Strukturave drejtuese e menaxhuese të dy institucioneve, duke nënvlerësuar konfirmimet e veprimeve të llogarisë kryesore të thesarit.</p>
Rëndësia:	<p>E mesme.</p>
Rekomandimi:	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe departamentet e Bankës së Shqipërisë si agjentë fiskal të saj, të cilët regjistrojnë dhe konfirmojnë llogarinë e unifikuar të thesarit dhe depozitë qeverie, të përcaktojnë qartë se kush departament duhet të konfirmojë të ndarë në grupe të ardhurat dhe shpenzimet e kësaj llogarie në mbështetje të përcaktimeve ligjore.</p>

Në lidhje me procesin e regjistrimit në SIFQ dhe rakordimit me kreditorët për investimet e huaja Sektori i Llogarisë së Unifikuar të Thesarit sqaron se në zbatim të Udhëzimit nr. 35, datë 21.09.2020 njësitë e zbatimit të projekteve raportojnë periodikisht çdo muaj dhe në zbatim të Udhëzimit nr. 46, datë 24.12.2020 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore", pika 22 NJZP duhet të dorëzonin raportin brenda datës 15.01.2021, afat i cili është zbatuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar. Mbajtja e akt rakordimit të dytë me Sektorin e Llogarisë së Unifikuar të Thesarit pas datës 12.02.2021 është rrjedhojë e raportimit pas kësaj date nga kreditori i projektit "Bypass i Fierit dhe i Vlorës". Përfshirja e këtij disbursimi në treguesit fiskal të vitit 2020 është e kushtëzuar nga rakordimi i të dhënave të borxhit me të dhënat e kreditorëve si edhe nga fakti se përfaqëson shpenzime të kryer gjatë vitit 2020. NJZP i ARRSH ka raportuar brenda datës 15.01.2021 ndërsa kreditori ka raportuar pas këtij afati për dy disbursime të pa raportuara më parë. Pas njoftimit nga Sektori i Regjistrimit dhe Shërbimit të Borxhit. Autoritetit Rrugor Shqiptar ka ridërguara raportimin vjetor dhe vlerat e disbursimeve indirekte dhe shpenzimet indirekte (të barabarta me vlerën e disbursimeve indirekte) të pasqyruar në SIFQ.

Sektori i Llogarisë së Unifikuar të Thesarit në lidhje me paragrafin "... si dhe kostot apo përfitimet nga përdorimi i valutës gjatë vitit", sqaron se referuar Udhëzimit nr. 46, datë 24.12.2020 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit të vitit 2020" Banka e Shqipërisë- Drejtoria e Kontabilitetit dhe Pagesave dërgon çdo ditë me protokoll (të printuar) çdo transaksion në vlera



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

debitorë dhe kreditore të kontabilizuara në sistemin bankar për TSA në ALL, EUR, USD dhe SDR (ku përfshihen edhe transaksionet për këmbimet valutore), krahas ngarkimit elektronik në SIFQ nëpërmjet IT të MFE-së dhe Bankës së Shqipërisë. Për rrjedhojë të dhënat e detajuara të gjeneruara nga SIFQ çdo ditë për rakordimin ditor me të dhënat e protokolluara, të cilat kanë një burim të vetëm Bankën e Shqipërisë, mendojmë se nuk ka vlerë të shtuara, detajimi i kërkuara në akt rakordimin mujor.

Në lidhje me keq klasifikimet e konstatuara për pagesën e Ministrisë së Mbrojtjes në shumën 335,434.75 mijë lekë, Dega e Thesarit Tiranë në komunikim me njësinë shpenzuese sqaron se projekti i Sistemit të komunikimit Tokë-Ajër- Tokë me kod M170508 që përshin edhe trajnimin bazë, ishte buxhetuar për vitin 2020, por me AN, fondet u pakësuan. Me shkresën nr 11972/1, datë 26.06.2020 të MFE u transferua brenda programit buxhetor “Forcat e Luftimit”, vlera 347,000,000 lekë, për kodin e projektin M170508. Për fondet nga 602, kodi i projektit për Forcën Ajrore është 91702AE. Për pasojë nuk mund të ndahet nga projekti dhe të likuidohet me fonde 602. Për pagesën e Ministrisë së Mbrojtjes në shumën 430,351.51 mijë lekë, Dega e Thesarit Tiranë në komunikim me njësinë shpenzuese sqaron se me AN 28, është bërë rishikimi i buxhetit dhe detyrimi i sipër cituar është përcaktuar në artikullin 231 “Investime” në kodin e projektit.

Në lidhje me keq klasifikimet e projekteve me investim të huaj Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit sqaron se nuk është përgjegjësia e saj. Tejkalimi i shpenzimeve nuk është përgjegjësi e thesarit pasi D.P. Thesarit në këtë proces regjistron në SIFQ dhe raporton në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar, por përgjegjësia është e NA dhe NZ të njërive zbatuese. Tejkalimi i shpenzimeve kapitale nga projektet e huaja Grant mbulohet me tejkalimin e disbursimeve të financimeve të huaja grant, për rrjedhojë nuk ndikon në deficit.

Çdo transaksion që regjistrohet në SIFQ duhet të ketë plan buxheti për llogarinë ekonomike përkatëse. Plani i financimit të huaj çelet në SIFQ nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit vetëm në llogarinë 230/231, kështu që shpenzimet regjistrohen në këto llogari. Thesari mban në skedar Excel-i (jashtë SIFQ) detajimin e shpenzimeve sipas llogarive ekonomike përkatëse ku është kryer shpenzimi. Udhëzimi i rishikuar i FH e ka zgjidhur këtë konstatim duke theksuar se njëria e zbatimit të projekteve me financim të huaj duhet të raportojnë

Qëndrimi i Grupi të Auditimit: Grupi i auditimit i qëndron konstatimit se akt rakordimi i dytë midis strukturës përgjegjëse të thesarit dhe strukturës së borxhit është mbajtur jashtë afateve të përcaktuara në pikës 31 të Udhëzimit 46, datë 24.12.2021 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2020”, si pasojë e raportimit me vonësë.

Gjithashtu i qëndron konstatimit se konfirmimi nga Banka e Shqipërisë për të ardhurat dhe shpenzimet e Llogarisë së Unifikuar të Thesarit, duhet të bëhen për të paktën 7 grupe kryesore, si në Aneksin 1 të Marrëveshjes Kuadër midis Bankës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shqipërisë me përfaqësues Ministrinë e Financës.

Për sa i përket keq klasifikimin në pagesat e kryera nga Ministria e Mbrojtjes, grupi i auditimit nuk e pranon observacionin pasi nuk ka dokumentacioni ose bazë ligjore për të pretendimin.

Për sa i përket keq klasifikim të projekteve me financim të huaj, pavarësisht pretendimit se cila Drejtoria brenda Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë e ka përgjegjësinë, grupi i auditimit i qëndroj gjetjes së keq klasifikimeve, për projektet e trajtuara në Raportin e Auditimit.

5. Mbi saktësinë dhe plotësinë e evidentimit të shpenzimeve kapitale me financim të huaj duke përfshirë planifikimin, disbursimet, saktësinë, përdorimin dhe plotësinë e raportimit të tyre.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Në zbatim të pikës nr. 5 të programit të auditimit nr. 514/1, datë 14.05.2020 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe i ndryshuar; nr. 88/2019 òPër buxhetin e viti 2020;

-Akti Normativ nr. 6, datë 21.03.2020 òPër disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019 òPër Buxhetin e Vitit 2020; Akti Normativ nr. 15, datë 15.04.2020; Akti Normativ nr. 28, datë 02.07.2020; Akti Normativ nr. 34, datë 16.12.2020.

-VKM nr. 775, datë 24.09.2010 òPër administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë;

-Udhëzimi nr. 8, datë 17.02.2003 i Ministrisë së Financave òPër evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e Financimeve të Huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj; Udhëzimi nr. 35, datë 21.09.2020 òPër kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare.

-Database e investimeve të huaja, raportimet e njësive zbatuese të projektit, statement të llogarive speciale të hapura në emër të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë pranë Bankës së Shqipërisë, etj.

Financime të huaja, konsiderohen të gjitha fondet nga huat, kreditë dhe grantet që merr Republika e Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave nga shtetet e huaja, organizmat ndërkombëtare, institucionet financiare ndërkombëtare, bankat e huaja, organizatat joqeveritare, etj.

Sipas ligjit të buxhetit të vitit 2018 nr. 109/2017 òPër buxhetin e vitit 2018, ligjit të buxhetit nr. 99, datë 03.12.2018 òPër buxhetin e vitit 2019, ligjit të buxhetit nr. 88/2019 òPër buxhetin e viti 2020, planifikimi total i investimeve të huaja për vitin 2020 paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela: Planifikimi i investimeve të huaja për vitin 2020

Në milion lekë

	Vlera e planifikuara për vitin 2020 në ligjin e buxhetit të viti 2018	Vlera e planifikuara për vitin 2020 në ligjin e buxhetit të viti 2019	Vlera e planifikuara për vitin 2020 në ligjin e buxhetit të viti 2020
Planifikimi i Financim i Huaj për vitin 2020	36,742	34,918	29,318

Për vitin 2020, planifikimi i investimeve me financim të huaj për institucionet qendrore referuar ligjit fillestar të buxhetit për vitin 2018, 2019 dhe 2020 ka pësuar ndryshime. Në ligjin e buxhetit të vitin 2018, investimet me financim të huaj janë planifikuar në vlerën totale 36,742 milion lekë. Në ligjin e buxhetit të vitin 2019, investimet me financim të huaj janë planifikuar në vlerën totale 36,742 milion lekë, duke u ulur për vlerën 1,824 milion lekë krahasuar me vlerën e planifikuar në ligjin e buxhetit të vitit 2018. Ndërsa në ligjin e buxhetit të vitin 2019, investimet me financim të huaj janë planifikuar në vlerën totale 29,318 milion lekë, duke u ulur për vlerën 5,600 milion lekë krahasuar me vlerën e planifikuar në ligjin e buxhetit të vitit 2019.

Sipas projekt ligjit të buxhetit, ligjit për buxhetin e vitit 2020, Aktit Normativ nr 6, datë 21.03.2020, Aktit Normativ nr.15, datë 15.04.2020, Aktit Normativ nr.28, datë 02.07.2020, Aktit Normativ nr. 34, datë 16.12.2020 dhe tabelës fiskale të buxhetit të konsoliduar, planifikimi dhe realizimi i investimeve të huaja për vitin 2020 paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela: Planifikimi dhe realizimi i investimeve të huaja

Në milion lekë

Emërtimi	Fakt 2019	Projekt buxhet	Ligji Buxhetit	AN 6	AN 15	AN 28	AN 34	Fakti 2020
Financim i Huaj	23,462	32,518	29,318	29,318	28,684.3	27,684.3	27,684.3	24,722



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Me projekt ligjin e buxhetit investimet me financim të huaj janë planifikuar në vlerën 32,518 milion lekë, ndërsa me ligjin e buxhetit janë planifikuar në vlerën 29,318 milion lekë duke u ulur për vlerën 3,200 milion lekë. Me Aktin Normativ nr. 6, datë 21.03.2020 planifikimi i investimeve të huaja nuk ka pësuar ndryshime. Me Aktin Normativ nr. 15, datë 15.04.2020 shpenzimet e planifikuar për investime me financim të huaja janë në vlerën 28,684.3 milion lekë, duke u ulur për vlerën 633.7 milion lekë. Ndërsa me Aktin Normativ nr. 28, datë 02.07.2020 dhe Aktin Normativ nr. 34, datë 16.12.2020 investimet me financim të huaj janë planifikuar në vlerën 27,684.3 milion lekë, duke u ulur më tej në krahasim me Aktin Normativ nr.15, datë 15.04.2020 në vlerën 1,000 milion lekë.

Referuar Treguesve Fiskal të Konsoliduar, shpenzimet kapitale me financim të huaj janë realizuar në vlerën 24,722 milion lekë ose në masën 89.3% krahasuar me Aktin Normativ nr.34, datë 16.12.2020 ose me mos realizimi në vlerën 2,962.3 milion lekë krahasuar me planin e ndryshuar. Ndërsa në krahasim me ligjin e buxhetit shpenzimet kapitale me financim të huaj janë realizuar në masën 84.3% ose me mos realizimi në vlerën 4,596 milion lekë. Kundrejt vitit 2019, shpenzimet kapitale me financim të huaj janë realizuar 5,4% më shumë ose realizuar më shumë në vlerën 2,748 milion lekë.

Trendi i shpenzimeve kapitale me financim të huaj referuar Treguesve Fiskalë të Konsoliduar gjatë vitit 2020 ka pësuar rritje në vlerën 1,260 milion në krahasim me vitin 2019. Gjatë vitit 2020 ky zë është rritur me 5.4% krahasuar me vitin 2019.

Në milionë lekë

Emërtimi	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Kapitale Financim i Jashtëm	28,776	26,785	24,926	20,334	22,278	26,210	23,462	24,722
Dif. nga viti i mëparshëm	-5,481	-1,991	-1,859	-4,592	1,944	3,922	-2,748	1,260




Tabela në vijim paraqet ecurinë e investimeve me Financim të Huaj përgjatë vitit buxhetor 2020 sipas Tabelës së Treguesve Fiskal të Konsoliduar.

Në milionë lekë

Viti	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2020	568	1,901	3,255	5,980	6,883	9,753	11,683	13,678	16,908	19,562	20,898	24,722

Bazuar në të dhënat e MFE, investimet e huaja me kredi janë realizuar në vlerën rreth 18,643 milion lekë ose 75.4% e vlerës së investimeve të huaja. Ndërsa investimet e huaja në formën e grantit janë realizuar rreth vlerës 6,079 milion lekë dhe përfaqësojnë 24.6% të investimeve të huaja.

Tabela në vijim paraqet të renditur në rend zbritës 10 institucionit me vlerat më të larta të realizimit të investimeve me financim të huaj me Kredi.

Në mijë lekë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Emri i institucionit	Vlera totale e realizimit
Autoriteti Rrugor Shqiptar	6,169,966
Fondi Shqiptar i Zhvillimit	5,120,386
Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës Kanalizime	2,363,806
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1,755,582
PIU Burimet ujore dhe të ujitjes	1,532,637
Njësia e Koordinimit të Projektit Përmirësimi i Sistemit shëndetësor	505,396
PIU Rehabilitimi i sistemit shëndetësor	275,212
PMU Mbështetje për SME	213,978
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	188,944
MIE	121,412

Tabela në vijim paraqet të renditur në rend zbritës 10 institucionit me vlerat më të larta të realizimit të investimeve me financim të huaj me Grand.

Në mijë lekë

Emri i institucionit	Vlera totale e realizimit
Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural	1,004,150
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	872,803
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	634,909
Autoriteti Rrugor Shqiptar	534,757
Fondi Shqiptar i Zhvillimit	527,127
Ministria e Financës dhe Ekonomisë	484,721
Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës Kanalizimeve	365,148
Ministria e drejtësisë	225,000
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	211,031
Departamenti i Administratës Publike	146,282

Bazuar në bazën e të dhënave të investime me financim të huaj për vitin 2020, rezulton se nuk ka projekte të reja të cilët mund të lidhen me Rindërtimin apo Covid-19.

Sipas raportimit dhe bazës së të dhënave të Drejtorisë së Investimeve, investimet me financim të huaj për vitin 2020 janë realizuar në vlerën 24,494 milion lekë, **duke reflektuar diferencë në vlerën 228 milion lekë me Tabelën e Treguesve Fiskal**. Nga auditimi rezulton se diferenca midis Drejtorisë së Investimeve dhe Tabelës së Treguesve Fiskal vjen si pasojë e raportimeve të Autoritetit Rrugor Shqiptar, për projektin me Kod KM06139 òNdërtimi by Pass i Fierit (Kontratë e re)ò. Autoriteti Rrugor Shqiptar, jashtë afateve kohore, me shkresën nr. 2959, datë 25.03.2020 ka ri dërguar situacionin përfundimtar për raportimin mbi financimin e segmentit òBy Pass i Fierit & Vlorësò, ku vlera e disburimeve dhe realizimi për këtë projekt kanë ndryshuar. Pas raportimit të ARRSH, Drejtoria e Borxhit dhe Thesarit kanë rakorduar përsëri në lidhje me disburimet e projekteve me investim të huaj. Veprimet e mësipërm janë jo në përputhje me pikën 31 të Udhëzimit 46, datë 24.12.2021 òPër procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2020ò, ku përcaktohet se procesi i regjistrimit në SIFQ dhe rakordimit me kreditorët për financimet e huaja midis strukturave përgjegjëse të thesarit, borxhit dhe njësive të qeverisjes së përgjithshme duhet të përfundojë brenda datës 31.02.2021. Gjithashtu mbajtja e akt rakordimit pas datës 31.02.2021 bien në kundërshtim me afatet e përcaktuara në këtë udhëzim.

Rezulton se në bazën e të dhënave të Drejtorisë së Investimeve nuk është reflektuar ky ndryshimi. Nga auditimi me përzgjedhje të projekteve të investimit më Financim të Huaja, u konstatuan problematikat si në vijim:



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

- Nga auditimi i të dhënave të projekteve të Investimeve Kapitale me Financim të Huaj **me Kredi**, u konstatua se, **2 projekte** investimi me në vlerën për **12,769 mijë lekë** janë realizuar **pa pasur një plan buxhetor** të miratuar me Ligjin e Buxhetit apo me Aktet Normative në zbatim të tij. Tabela në vijim paraqet projektet të cilat janë realizuar pa pasur plan buxhetor të miratuar me Ligj.

Në lekë

Min	Program	Institucioni	Llogaria	Kodi	Përshkrimi i projektit	Plan	Fakt	
06	4540	D.P Ujësjetllës Kanalizimeve	231	KM06074	Ndërtimi i Fazës së I dhe II dhe pjesërisht të III të Portit të Vlorës	-	9,309,550	
06	6370	D.P Ujësjetllës Kanalizimeve	230	KM 06091	Menaxhimi mbi mbetjet urbane të Tiranës (faza III), impianti i pastrimit të ujërave të ndotur	-	3,459,310	
TOTALI								12,768,860

Nga auditimi i të dhënave të projekteve të Investimeve Kapitale me Financim të Huaj **me Kredi**, u konstatua se, **12 projekte** investimi janë realizuar në **tejkallim të planit të buxhetit** për vlerën **1,995,290 mijë lekë**, fakt i cili tregon për një monitorim formal nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Tabela në vijim paraqet projektet të cilat janë realizuar në tejkallim të planit buxhetor të miratuar me Ligj.

Në mijë lekë

Min	Progr	Llog	Kodi	Përshkrimi i Projektit	Plani	Fakti	Diferenca
					1	2	3=1-2
05	04240	231	KM05016	Projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitëse (IBRD)	1,528,750	1,532,637	(3,887)
05	04250	230	KM05019	Protokollit Italian Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të ullishtarisë (ZHQSU)	10,000	10,834	(834)
05	04250	231	KM05022	Projekti i Shërbimeve Mjedisore	70,000	121,412	(51,412)
06	04230	231	KM06128	Projekti për rimëkëmbjen në sektorin publik	30,000	45,962	(15,962)
06	04230	231	KM06129	Projekti për mbështetje në sektorin energjetik	1,330,000	1,709,619	(379,619)
06	04520	231	KM06180	Njësia e Implementimit (Konsulentët) RRMSP (Projekti i Bankës Botërore)	20,827	22,397	(1,570)
06	04520	231	KM06139	Ndërtim By Pass i Fierit (Kontrate e Re)	2,375,000	3,559,396	(1,184,396)
13	07330	231	KM13018	Faza e dytë e zbatimit të master planit të QSUT- kredi e CEB-it (përfundimi i dy kateve të sp të ri të ndërtuar dhe rikonstruksioni i 6-katshit)	230,750	275,212	(44,462)
26	04260	230	KM26004	Projekti i Shërbimeve Mjedisore- Kredi IBRD	150,000	188,944	(38,944)
56	06210	231	KM56203	Projekti për Zhvillim të Integruar Urban dhe Turistik (BB)	500,000	500,921	(921)
87	0130	231	KM03002	Asistencë teknike për projektin "Shërbime publike me në qendër qytetarinë"	68,746	119,007	(50,261)
06	06220	231	18BE304	Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Qarkun Vlorë (Kredi)	130,000	403,022	(273,022)
TOTALI					6,444,073	8,489,363	(1,995,290)

- Nga auditimi i të dhënave të projekteve të Investimeve Kapitale me Financim të Huaj **me Grand**, u konstatua se, **48 projekte** investimi janë realizuar në **tejkallim të planit të buxhetit** për vlerën **1,423,373 mijë lekë**. Tabela në vijim paraqet projektet të cilat janë realizuar në tejkallim të planit buxhetor.

Në lekë

Min	Prg	Llog	Kodi	Përshkrimi i Projektit	Plani	Fakti	Diferenca
					1	2	3=1-2
05	04220	231	19AB701	Kontrolli dhe çrënjosja e sëmundjes së tërbimit III (IPA 2017)	38,350,000	44,832,610	(6,482,610)
05	04250	230	18AL303	Përfitues nga Programi IPARD II nga masa 3 (7)	150,000,000	1,004,149,940	(854,149,940)
05	04250	231	GM05051	Projekti i Shërbimeve Mjedisore B	70,000,000	142,035,830	(72,035,830)
06	04320	231	18BI016	Projekti LED-Mënyra kryesore për të përmirësuar e eficienten e energjisë në shkollat publike dhe përhapja e përdorimit të shfrytëzimit të burimeve të rinovuesëje	2,879,000	4,296,120	(1,417,120)
06	04320	231	18BI018	AquaNEX-Ruatja dhe sigurimi i cilësisë të ujërave sipërfaqësor në Shqipëri dhe Greqi duke përdorur teknika të vëzhgimit nga toka	5,689,600	21,738,400	(16,048,800)
06	04520	231	19AC803	Projektet Ports	1,768,000	3,994,650	(2,226,650)
10	01110	231	18BP504	Projekte Grant - IPA	100,000,000	142,229,030	(42,229,030)
10	01110	231	18BR902	ProTax Albania-Implementimi i taksës së pasurisë të bazuar në vlerën tregut	28,000,000	28,816,630	(816,630)
10	01110	231	GM10149	PROSEED	49,993,500	52,792,780	(2,799,280)
10	01140	230	GM10112	Programi Fiscalis 2020	4,000,000	5,713,220	(1,713,220)
10	01150	231	18AE502	Kontrate binjakëzimi IPA 2017 "Mbeshtetja për ADSh në perafirm legjislacioni & procedurash me EU acquis, përgatitje	1,262,000	38,626,030	(37,364,030)



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

				per nderveprimin me sistemin IT (BE) per mallrat e falsifikuara			
11	09450	231	18BD804	Projekti Interreg Med Compose	1,569,517	8,945,843	(7,376,326)
11	09450	231	18BD809	Projekti Erasmus + STEPS UBT	1,879,955	4,844,390	(2,964,435)
11	09450	231	18BD811	Interrg IPA -CBC CULTURE PLUS	1,130,415	1,432,170	(301,755)
11	09450	231	18BD817	Projekti Erasmus + ARISA	1,572,000	6,866,380	(5,294,380)
11	09450	231	18BD818	Projekti Erasmus + ALMARES	2,870,952	7,169,430	(4,298,478)
11	09450	231	18BD823	VALEU-X-Shkembimi virtual i Universiteteve Evropiane dhe Shqiptare.	4,150,100	5,607,310	(1,457,210)
11	09450	231	18BD827	QUADIC	1,208,909	2,000,930	(792,021)
11	09450	231	18BD828	Hight Specialized technicians in Kets (HISTEK)	1,197,348	2,942,370	(1,745,022)
11	09450	231	GM11060	Erasmus + DIMTV	1,565,640	5,116,560	(3,550,920)
11	09450	231	GM11062	Erasmus+ ITG4AU Projekt Univesiteti Dures	657,223	3,155,530	(2,498,307)
11	09450	231	GM11066	ITG4AU Universiteti i Tiranes	1,184,200	1,654,350	(470,150)
11	09450	231	GM11081	Drejt ndergjegjesimit pergjegjesise dhe cilesise se perbashket ne punen sociale Univesiteti i shkodes Luigj Gurakuqi	4,734,265	5,884,770	(1,150,505)
11	09770	231	18CA713	T@SK - UNIVERSITETI I FIRENCES ITALI, Universiteti i Tiranes	4,155,671	5,473,230	(1,317,559)
11	09770	231	18CA718	HarISA-Harmonization and Innovation in PhD Study Programs for Plant Health in Sustainable Agriculture, Univesiteti Korce	700,000	842,300	(142,300)
11	09770	231	18CJ801	Zbatim analizës me kosto optimale për afestisë e dëgjimit dhe të parit tek fëmijët	12,518,471	13,363,560	(845,089)
11	09770	231	18CJ901	Projekti ERASMUS GRADUA UMT	1,025,481	1,443,830	(418,349)
12	08220	230	18CF311	Projekti IPA "SMART-CUL-TOUR"	800,000	1,193,700	(393,700)
15	01150	231	GM15005	Asitencë teknike IPA- CBC Shqipëri -Maqedoni	5,000,000	7,383,050	(2,383,050)
15	01150	231	GM15011	Asitencë teknike IPA- CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi	11,000,000	12,667,080	(1,667,080)
16	01160	230	18CK301	projekti "CULTURAL-LANDS" I impletuar nga Prefektura qarkut Gjirokaster	1,800,000	2,539,294	(739,294)
16	01160	230	18CK401	projekti "POLIPHONIA" i impletuar nga Prefektura qarkut Gjirokaster	3,083,000	3,753,571	(670,571)
16	03140	231	18AU305	Ndërtim /Rikonstrukcion I godines se PKK Qafe -Boti (kap.02)	12,000,000	12,134,330	(134,330)
16	03140	231	GM16044	Programi Policimit ne Komunitet faza e dyte (qeveria suedeze)	84,177,000	95,774,590	(11,597,590)
26	04760	231	18CH001	Zhvillimi i Turizmit Detar dhe Promovimi i Porteve Rajonale REGPORTS	3,000,000	4,146,110	(1,146,110)
26	05320	231	18BG901	Hartë e përgatitur për burimet e mbetjeve të ngurta për prodhuesit industrialë (SËAN)	2,000,000	4,394,430	(2,394,430)
26	05320	231	18BH101	Sistem i ngritur per parandalimin e mbetjeve detare	40,000,000	61,393,420	(21,393,420)
26	05320	231	18CH901	ALL TOUR- Paketa turistike te zhvilluara per turizmin kulturor dhe natyror	2,000,000	3,922,510	(1,922,510)
26	05320	231	GM26033	Rezervati nderkufitar i Prespes	71,000,000	110,368,760	(39,368,760)
26	05320	231	GM26058	Kune-Vain - Grant	20,841,000	22,306,040	(1,465,040)
26	05320	231	GM26064	Mekanizmat financiare - UNDP	35,000,000	35,352,340	(352,340)
26	05320	231	GM26066	Pershtatja me ndryshimet Klimaterike ne fushen e menaxhimit nderkufitar te riskut te permbytjeve ne Ballkanin perendimor-GIZ	10,000,000	115,485,260	(105,485,260)
26	05320	231	GM26070	Ruajtja dhe perdorimi i qendrushem i biodiversitetit ne Liqenin e Prespes, Ohrit dhe Shkodes	70,000,000	81,604,300	(11,604,300)
26	05320	231	GM26071	Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit	21,000,000	156,863,750	(135,863,750)
50	01320	231	GM50009	SALSTAT-Statistika te forta vendore Shqiptare	19,000,000	22,950,920	(3,950,920)
50	01320	230	GM50011	Rritja e kapaciteteve te Inovacionit per ndermarrjet e vogla dhe te mesme	6,200,000	6,614,110	(414,110)
56	06210	231	18BO202	Mbeshtetje per sistemin e fumizimit me Uje ne Zonat Rurale RËS IV Himare-Grant	83,235,330	83,605,260	(369,930)
95	01110	231	19AH601	Rikonstrukcioni i ndërtesës së AIDSSH dhe shërbimeve TIK	8,000,000	16,150,270	(8,150,270)

Veprime e mësipërme janë jo në përputhje me pikën 22 të Udhëzimit Plotësues nr.2, datë 20.01.2020 për zbatimin e buxhetit të vitit 2020 ku citohet se: "Plani i miratuar me ligjin e buxhetit për financimet e huaja, është kufiri i cili duhet të respektohet gjatë procesit të kryerjes së shpenzimeve, si për projektet me skemë të plotë thesari ashtu edhe për projektet me skemë të pjeshme thesari (jashtë TSA-së, në bankat e nivelit të dyte, kodi 00). Në rast të tejkalimit të planit të shpenzimeve njësitë e qeverisjes qendrore do të marrin masa për sistemin e tyre nëpërmjet rialokimeve gjatë vitit dhe gjatë procesit të rishikimit të buxhetit.ö

Referuar të dhënave në SIFQ, konstatohet se, **i njëjti projekt** investimi është çelur në SIFQ, me **më shumë se dy kode**, veprime këto të cilat shtojnë riskun e mos marrjes së informacionit të saktë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

dhe transparent nga SIFQ në lidhje me ecurinë dhe realizimin faktik të këtyre projekteve. Tabela në vijim paraqet projektet e investimit të cilat kanë më shumë se 1 kod projekti në SIFQ.

Në lekë

Ministria	Programi	Llog.	Kodi	Përshkrimi i Projektit	Plan	Realizimi Faktik
05	04220	231	19AB701	Kontrolli dhe çrënjësja e sëmundjes së tërbimit III (IPA 2017)	38,350,000	44,832,610
05	04220	231	19AB702	Kontrolli dhe çrënjësja e sëmundjes së tërbimit III (IPA 2017)	54,512,000	3,953,500
				2 kode të ndryshme		
06	04320	231	KM06128	Projekti për rimëkëmbjen e sektorit energjetik	30,000,000	45,962,440
06	04320	231	KM06129	Projekti për rimëkëmbjen e sektorit energjetik	1,330,000,000	1,709,619,220
				2 kode të ndryshme		
15	01150	231	GM15012	Asistencë teknike IPA-CBC Adrion	5,000,000	0
15	01150	231	GM15013	Asistencë teknike IPA-CBC Projekt Strategjik Adrion	4,000,000	1,278,430
				2 kode të ndryshme		

Referuar të dhënave në SIFQ dhe ecurisë së investimeve sipas muajve, **konstatohen kode projektesh të cilët kanë pasur vlerë realizimi përgjatë një periudhe kohore gjatë vitit 2020**, më pas realizimi për këto kode projektesh në fund të viti 2020, rezulton me vlerë 0 lekë, konkretisht:

- Për projektin me Kod GM 10006 òMbështetje për planifikimin e integruaraò rezulton se gjatë periudhës Janar-Gusht 2020 ky kod projekti ka pasur realizimi, ndërsa përgjatë pjesës tjetër të vitit realizimi i tij është në vlerën 0 Lekë. Tabela në vijim paraqet vlerën e realizimit të këtij kod projekti sipas muajve.

Në mijë lekë

Kod/Realizimi sipas muajve	01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12
GM10006	7,533	90,641	92,806	97,410	99,694	106,618	118,087	118,087	-	-	-	-

- Për projektin me Kod GM 11059 òImplementation of cost optimized childhood visionò rezulton se gjatë periudhës Janar-Gusht 2020 ky kod projekti ka pasur realizimi, ndërsa përgjatë pjesës tjetër të vitit realizimi i tij është në vlerën 0 Lekë. Tabela në vijim paraqet vlerën e realizimit të këtij kod projekti sipas muajve.

Në mijë lekë

Kod/Realizimi sipas muajve	01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12
GM11059	1,224	1,224	4,196	5,223	6,083	6,720	7,254	7,496	-	-	-	-

- Për projektin me Kod KM06066 òNdërtimi i segmentit rrugor Tiranë- Elbasanò rezulton se gjatë periudhës Janar-Shator 2020 ky kod projekti ka pasur realizimi, ndërsa përgjatë pjesës tjetër të vitit realizimi i tij është në vlerën 0 Lekë. Tabela në vijim paraqet vlerën e realizimit të këtij kod projekti sipas muajve.

Në mijë lekë

Kod/Realizimi sipas muajve	01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12
KM06066	233	13,792	13,810	14,222	14,022	13,602	14,079	13,588	18,260	-	-	-

- Për projektin me Kod KM06096 òProjekti i ri i mirëmbajtjes Bankës Botërore për mirëmbajtjen dhe sigurinë rrugoreò rezulton se gjatë periudhës Janar- Tetor 2020 ky kod projekti ka pasur realizimi, ndërsa përgjatë pjesës tjetër të vitit realizimi i tij është në vlerën 0 Lekë. Tabela në vijim paraqet vlerën e realizimit të këtij kod projekti sipas muajve.

Në mijë lekë

Kod/Realizimi sipas muajve	01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12
KM06096	83,876	140,291	204,351	282,020	302,181	411,757	476,867	476,003	691,730	654,841	-	-

- Për projektin me Kod KM13027 òModernizimi i asistencës socialeò rezulton se gjatë periudhës Janar- Nëntor 2020 ky kod projekti ka pasur realizimi, ndërsa në muajin dhjetor realizimi i tij është në vlerën 0 Lekë. Tabela në vijim paraqet vlerën e realizimit të këtij kod projekti sipas muajve.

Në mijë lekë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

Kod/Realizimi sipas muajve	01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12
KM12027	1,403	3,371	7,297	7,882	9,008	10,505	10,732	11,609	16,027	21,601	22,593	-

- Për projektin me Kod KM56200 òProjekti i Alpeve Shqiptare dhe zonave Bregdetareò rezulton se gjatë periudhës Janar - Nëntor 2020 ky kod projekti ka pasur realizimi, ndërsa në muajin dhjetor realizimi i tij është në vlerën 0 Lekë. Tabela në vijim paraqet vlerën e realizimit të këtij kod projekti sipas muajve.

Në mijë lekë

Kod/Realizimi sipas muajve	01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12
KM56200	12,648	12,648	12,648	12,468	12,468	12,468	12,468	12,468	12,468	12,468	12,468	-

- Për projektin me Kod 18BE004 òHISTEK/INTERRE- IPAò rezulton se gjatë periudhës Maj-Gusht 2020 ky kod projekti ka pasur realizimi, ndërsa pas muajit Gusht realizimi i tij është në vlerën 0 Lekë. Tabela në vijim paraqet vlerën e realizimit të këtij kod projekti sipas muajve.

Në mijë lekë

Kod/Realizimi sipas muajve	01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12
18BE004	-	-	-	-	147	324	2,550	2,500	-	-	-	-

- Për projektin me Kod 18CA719 òForcimi i kompetencave të mësimit në Arsimin e Lartë në shkencat e natyrës dhe matematikës, Universiteti i Korçësò rezulton se gjatë periudhës Maj-Gusht 2020 ky kod projekti ka pasur realizimi, ndërsa pas muajit Gusht realizimi i tij është në vlerën 0 Lekë. Tabela në vijim paraqet vlerën e realizimit të këtij kod projekti sipas muajve.

Në mijë lekë

Kod/Realizimi sipas muajve	01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12
18CA719	-	-	-	-	93	93	93	93	-	-	-	-

- Për projektin me Kod KM06079 òNdërtimi By Pass i Vlorësò rezulton se gjatë periudhës Maj-Tetor 2020 ky kod projekti ka pasur realizimi, ndërsa pas muajit Tetor realizimi i tij është në vlerën 0 Lekë. Tabela në vijim paraqet vlerën e realizimit të këtij kod projekti sipas muajve.

Në mijë lekë

Kod/Realizimi sipas muajve	01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12
KM06079	-	-	-	-	139,084	139,433	269,803	269,314	272,708	274,389	-	-

- Për projektin me GM11061 òProjekt Erasmus + TEAVETò rezulton se gjatë periudhës Korrik-Gusht 2020 ky kod projekti ka pasur realizimi, ndërsa pas muajit Gusht realizimi i tij është në vlerën 0 Lekë. Tabela në vijim paraqet vlerën e realizimit të këtij kod projekti sipas muajve.

Në mijë lekë

Kod/Realizimi sipas muajve	01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12
GM11061	-	-	-	-	-	-	38,182	68,908	-	-	-	-

Veprimet e mësipërme kanë ndodhur si pasojë e ndryshimit të kodit të projekteve dhe sistemit të faktit të realizimit të investimit nga një kod tek një kod tjetër, pas raportimeve të kryera nga institucionet përkatëse.

- Nga auditimi konstatohet se **39 projekte** investimesh me financim të huaj në vlerën totale **2,273,373 mijë lekë**, referuar përshkrimit janë keq klasifikuar kryesisht në llogarinë 231 òInvestime për rritjen e aktiveve afatgjata materialeò, si në tabelën në vijim.

Në lekë

Kodi	Përshkrimi i projektit	Llogaria ekonomike	Fakt
19AB701	Kontrolli dhe çrënjosja e sëmundjes së tërbimit III (IPA 2017)	231	44,832,610



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

19AB702	Monitorimi për vaksinimin e sëmundjes së tërbimit III (IPA 2017)	231	3,953,500
GM05054	Dokumenti Sektorial për Sigurinë Ushqimore dhe Veterinarinë (IPA II)	231	150,555,910
18AL303	Përfitues nga Programi IPARD II nga masa 3 (7)	230	1,004,149,940
KM06083	Super vizion dhe Rishikimi i Projektit të Detajuar Segmenti Nr.1, Aksi "Tirane - Elbasan" (Sauk km 0- Hyrje tuneli I Kërrabës km 13)	231	21,200,830
KM06104	Konsulentit i Monitorimit (Supervizori) i kontratave të mirëmbajtjes (Projekti i Bankës Botërore)	231	98,941,790
KM06106	Asistencë Teknike për Sigurinë Rrugore (Projekti i Bankës Botërore)	231	41,350,990
KM06109	Kosto Operacionale - RRMSP (Projekti i Bankës Botërore)	231	3,417,930
18BM301	Studim i Prefisibilitetit për lidhjen hekurudhore Pogradec- Greqi [Kristolopigy]	231	7,486,980
18BR903	Zhvillimi i kontabilitetit në Sektorin Publik	231	14,888,140
GM10104	Mbështetje për ngritjen e kapaciteteve për implementimin e Sistemit të Planifikimit të integruar IPS2(TF 013972(BB))	231	207,435,510
GM10107	Përmirësim i cilësisë së raportimit Financiar (TF 019228)(BB)	231	33,670,600
KM10005	Projekti i Mikrofinanses në Shqipëri, Kredi	231	27,786,770
18AË502	Kontrate binjakëzimi IPA 2017 "Mbështetja për ADSH në përfundim legjislativ & procedurash me EU acquis, përgatitje për ndërveprimin me sistemin IT (BE) për mallrat e falsifikuara	231	38,626,030
KM10010	Mbështetje për SME-te	231	213,957,670
18BS308	P.A.S.T.4.Future	231	1,736,500
18BS309	NEST	231	1,966,618
18BD809	Projekti Erasmus + STEPS UBT	231	4,844,390
18BD817	Projekti Erasmus + ARISA	231	6,866,380
18BD818	Projekti Erasmus + ALMARES	231	7,169,430
GM11052	ERASMUS+ (NETCHEM) UBT	230	1,196,560
GM11062	Erasmus + ITG4AU Universiteti I Durrësit	231	3,155,530
GM11060	Erasmus + DIMTV	231	5,116,560
GM11063	Zhvillimi i kompetencave të mësuesve për një sistem gjithëpërfshirës Universiteti I Shkodrës	231	556,050
GM11073	ERASMUS GRADUA UPT	231	325,870
GM11074	ERASMUS + Drejt ngritjes dhe ndërgjegjësimin	231	1,720,410
GM11077	ERASMUS + GRADUA Universiteti I Arteve all	231	1,796,460
GM11078	ERASMUS + GRADUA Universiteti I Arteve euro	231	3,030
GM11087	ERASMUS GRADUA UBT Ieke	231	2,328,100
GM11088	ERASMUS SMART AL UBT	230	3,777,767
GM15003	Asistencë teknike IPA- CBC Shqipëri -Mal i Zi	231	3,728,550
GM15004	Asistencë teknike IPA- CBC Greqi-Shqipëri	231	17,891,630
GM15005	Asistencë teknike IPA- CBC Shqipëri -Maqedoni	231	7,383,050
GM15006	Asistencë teknike IPA- CBC Shqipëri -Kosovë	231	4,808,850
GM15011	Asistencë teknike IPA- CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi	231	12,667,080
GM15013	Asistencë teknike IPA- CBC Projekti Strategjik Adrion	231	1,278,430
GM16045	Asistencë Teknike për ngritjen e kapaciteteve profesionale të institucioneve ligj zbatuese sipas praktikave me të mira të BE (PAMECA V)	231	123,156,230
18BH301	Raportet performancë të hartuara	231	28,637,410
KM03002	Asistencë teknike për projektin "Shërbime publike me në qendër qytetarin"	231	119,006,790

Në tabelën e mësipërme identifikohen 2 grupe kryesore keq klasifikimesh:

- projekte shërbimi, studimi, asistencë, konsultimi, monitorim të cilat janë klasifikuar si investime për rritjen e aktiveve afatgjata material, ndërkohë që duhet të ishin klasifikuar në llogarinë 230 òinvestime afatgjata jo materialò.

- projekte si IPARD, ERASMUS, P.A.S.T 4 Future, NEST të cilët janë klasifikuar si investime për rritjen e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, por për këto projekte janë angazhuar fonde të planifikuara si investime, për kryerjen e shpenzimeve operative në paga, dieta, sigurime, evente si dhe transfertat ndaj të tretëve, pra nuk janë kryer shpenzime për të krijimin e një aseti të prekshëm ose të paprekshëm dhe rrjedhimisht nuk plotësohen kushtet për njohjen e një aktivi në pasqyrën e pozicionit financiar.

Nga auditimi u konstatua se për **konvertimin e disbursimeve dhe shpenzimeve** të projekteve me financim të huaj nga monedhën origjinale në Lekë, në të gjitha rastet është **përdorur kursi i këmbimit mesatar mujor i Bankës së Shqipërisë** dhe jo kursi i datës në të cilën ka ndodhur transaksioni.

Këto veprime bien ndesh me: Udhëzimin nr.08, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë së qeverisjes së përgjithshme". Funkcionimi kontabël i llogarisë 512 òMjetet monetare në bankëò. Llogaria 512 òMjetet monetare në bankëò vepron kryesisht për institucionet që zbatojnë projekte të huaja. Llogaria bankare



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

mbahet e analizuar në llogari bankare në lekë dhe llogari bankare në valutë. Për regjistrimet e konvertimeve në lekë e valutë mbahet parasysh kursi i ditës, duke bërë sistemimet si të ardhura e shpenzime. Konkretisht: Debitohet llogaria 656 ÷Shpenzime nga këmbimet valutoreë dhe kreditohet llogaria 520 ÷Disponibilitete në thesarö, për humbjet nga kursi i këmbimit Debitohet llogaria 520 dhe kreditohet llogaria 766 ÷Të ardhurat financiare nga këmbimet valutoreë, për fitimet nga konvertimi.

Për sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e tyre ngarkohen me përgjegjësi Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, Drejtoria e Investimeve Publike si dhe NA dhe NZ të Njësive të Zbatimit të Projekteve të trajtuar në material.

Titulli i gjetjes	Nga auditimi i investimeve kapitale me financim të huaj janë konstatuar projekte të realizuar pa pasur plan buxheti, projekte të realizuar në tejkallim të planit të buxhetit si dhe keq klasifikime projektësh kryesisht në llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”.
Situata:	<p>Për vitin 2020, nga auditimi i investimeve kapitale me financim të huaj është konstatuar se, 2 projekte investimi në vlerën 12,769 mijë lekë janë realizuar pa pasur një plan buxhetor të miratuar me Ligjin e Buxhetit apo me Aktet Normative në zbatim të tij. 12 projekte investimesh të huaja me Kredi për vlerën 1,995,290 mijë lekë janë realizuar në tejkallim të planit të buxhetit dhe 48 projekte investimesh të huaja në formën e Grandit për vlerën 1,423,373 mijë lekë janë realizuar në tejkallim të planit të buxhetit. Referuar të dhënave në SIFQ. Është konstatuar se në 3 raste, i njëjti projekt investimi është çelur në SIFQ, me më shumë se dy kode.</p> <p>Gjithashtu për 39 projekte investimi me financim të huaj në vlerën totale 2,273,373 mijë lekë, referuar përshkrimit janë konstatuar keq klasifikuar llogarish ekonomike kryesisht në llogarinë 231 ÷Investime për aktiveve afatgjata materialeö. Nga auditimi janë konstatuar projekte shërbimi, studimi, asistence, konsultimi, monitorim të cilat janë klasifikuar si investime për rritjen e aktiveve afatgjata material, të cilat duhet të ishin klasifikuar në llogarinë 230 ÷Investime afatgjata jo materialö. Gjithashtu janë konstatuar edhe projekte të klasifikuar si investime për rritjen e aktiveve afatgjata materiale ose investime për rritjen e aktiveve afatgjata jo materiale, si IPARD, ERASMUS, P.A.S.T 4 Future, NEST, etj, për të cilët janë angazhuar fonde të planifikuara si investime, për kryerjen e shpenzimeve operative si paga, dieta, sigurime, evente, transfertat ndaj të tretëve. Për këto projekte nuk janë kryer shpenzime për të krijimin e një aseti të prekshëm ose të paprekshëm dhe rrjedhimisht nuk plotësohen kushtet për njohjen e një aktivi në pasqyrën e pozicionit financiar. Sa më sipër Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk ka monitoruar në mënyrë efektive investimet kapitale me financim të huaj.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ÷Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëö i ndryshuar; Udhëzimit Plotësues nr.2, datë 20.01.2020 ÷Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020ö.
Impakti:	Cilësi e ulët e menaxhimit të fondeve publike.
Shkaku:	Mosrespektimi i legjislacionit dhe mosfunksionimi i hallkave të kontrollit.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	<p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për fuqizimin e kontrollit të brendshëm në drejtim të raportimit të saktë dhe të plotë të investimeve publike me financim të huaj, nëpërmjet përfshirjes së tyre në ciklin e menaxhimit të shpenzimeve buxhetore për t'u siguruar për përputhshmërinë me planet vjetore dhe tavanet përkatës buxhetore.</p> <p>-Ministria e Financave dhe Ekonomisë/ Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të marrë masa për fuqizimin e rolit të Drejtorisë së Menaxhimit të Investimeve Publike në MFE, në drejtim të monitorimit të procesit të investimeve publike me financim të huaj me qëllim rritjen e cilësisë së menaxhimit të fondeve publike dhe llogaridhënies së strukturave që kryejnë shpenzime buxhetore.</p>

Në lidhje me konstatimet e grupit të auditimit është dërguar observacioni nr. 8595/13, datë 18.08.2021, protokolluar në KLSH me nr. 514/2, datë 20.08.2021 nga zj. A. B., zj. M.P., zj. A.F., zj. S.S., ku cituar se:

Vlera 24,722 milion lekë në zërin “financim i huaj” të Treguesve Fiskal të Konsoliduar, i referohet vetëm shpenzimeve të projekteve me financim të hua të zbatuar nga institucionet qendrore, përkatësisht 24,714 milion lekë regjistruar nga sektori i TSA-së dhe 7.15 milion lekë regjistruar nga degët e thesarit. Për sa i përket diferencës në vlerën 228 milion lekë Sektori i Llogarisë së Unifikuar të thesarit sqaron se njësitë e zbatimit të projekteve me financim të huaj, raportojnë çdo muaj elektronikisht dhe me shkresë zyrtare. Në zbatim të pikës 22, të udhëzimit për mbylljen e llogarive vjetore, NJZP duhet të raportonin brenda datës 15 Janar, afat i cili është respektuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar. Disburimet dhe shpenzimet e regjistruara pas datës 13.02.2020 për projektin “Bypass i Fierit dhe i Vlorës” janë indirekte dhe informacioni merret vetëm nga kreditori, i cili ka njoftuar jashtë afatit për dy disbursime të pa raportuara më parë. Pas njoftimit nga Drejtoria e Borxhit, ARRSH ka ridërguar raportimin. Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike sqaron se regjistrimi i të dhënave të projekteve realizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit. Ndërsa raporti i monitorimit të investimeve është gjëndëruar në muajin Janar 2021. Ky raport përgatitet për qëllime të brendshme të institucionit dhe nuk publikohet. Në lidhje me konstatimin se 2 projekte investimi janë realizuara pa pasur një plan buxhetor, Sektori i Llogarisë së Unifikuar të Thesarit sqaron se për projektin me kod KM06074 dhe KM06091, regjistrimi i shpenzimeve është bazuar në raportimin e shpenzimeve. Sektori i TSA-së kryen regjistrimin kontabël, ndërsa procedura e planifikimit, regjistrimit dhe monitorimit nuk kryhet nga ky sektor. Në lidhje me konstatimi se për 11 projekte investimesh të huaja me Kredi dhe 49 projekte investimesh kapitalit me Financim të Huaj me Grand, është tejkualuar plani i buxhetit, Sektori i Llogarisë së Unifikuar të Thesarit sqaron se regjistrimet shpenzimeve është kryer sipas raportimeve të Njërive të Zbatimit të Projekteve. Ndërsa Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike të Buxhetit sqaron se, plani është tejkualuar në nivel produkti, por jo në nivel programi dhe institucioni. Në listën e projekteve me financim të huaj më Grand, është përfshirë një projekt me financim të huaj kredi, Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Qarkun e Vlorës (kredi). Në lidhje me konstatimin se i njëjti projekt investimesh është çelur me më shumë se dy kode, Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike të Buxhetit sqaron se kjo problematikë vjen si rezultat i mungesës së rakordimit ndërmjet drejtorive të ministrisë së linjës dhe drejtorisë së projektit. Në lidhje me konstatimin e kodeve të projekteve të cilët kanë pasur realizimin përgjatë një periudhe kohe e në fund të viti realizimi i tyre është 0 lekë, Sektori i Llogarisë së Unifikuar të Thesarit sqaron se në kuadër të rakordimit me institucionet zbatuese të projekteve me financim të huaj, janë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

konstatuar dy kode projekti për të njëjtin projekt ose një projekt i lidhur me disa kode produkti e për rrjedhojë është kryer sistemimi i kodit të produktit në përputhje me stacionin e raportimit të projektit. Realizimi faktit është sistemuar si në vijim projekti me kod GM10006 tek kod GM10104, projekti me kod KM06066 te kod KM06083, projekti me kod KM 06096 është detajuar në kode KM06014, KM06106, KM06088, KM06108, KM06109, KM06100, KM06101, KM06102, KM06103, projekti me kod KM13027 është sistemuar të kodit 18BC201, projekti me kod Km56200 është sistemuar tek projekti me kod KM56196, projekti me kod 18BE004 është sistemuar te projekti me kod 18BD828, projekti me kod 18CA719 është sistemuar te projekti me kod 18BD826, projekti me kod KM06079 është sistemuar te projekti “Ndërtimi BY PASS i Vlorës (Kontratë e re)”, projekti me kod GM11061 është sistemuar te projekti me kod 18CA703. Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve sqaron se me çeljen e një projekti (grant ose kredi) është e përcaktuar dhe llogaria ekonomike, e cila mund të jetë 230 ose 231. Në varësi të llogarisë ekonomike të përcaktuar që në fillim, kryhen dhe veprimet përkatëse për shpenzime. Nëse projekti është çelur në llogarinë ekonomike 231 dhe emërtimi i një produkti është “Hartim projekti”, likuidimi i shpenzimeve për këtë produkt do të bëhet në llogarinë 231, sepse është llogaria e vetme që ka projekti. Në lidhje me konstatimin se konvertimi i disbursimeve dhe shpenzimeve të projekteve me financim të huaj nga monedha origjinale në Lek është bërë duke përdorur kursi mesatar mujor i Bankës së Shqipërisë, dhe jo kursi i këmbimit të datës kur ka ndodhur transaksioni, sqaron se me miratimin e Udhëzimit të rishikuar nr.35, datë 21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikim e fondeve për financimet e huaja në kuadër të marrëveshjes ndërkombëtare”, gjatë vitit 2021 e në vijim NJZP do të paraqesin të dhënat e raportimit për disbursime dhe shpenzime në monedhën e huaj dhe në monedhën vendase sipas informacionit bankar të rakorduar. Theksojmë se realizimi i investimeve kapitale me financim të huaj pa pasur fonde buxhetore të disponueshme dhe vendosja e kodeve të sakta të projektit në raportimin mujor të paraqitura në Thesar janë në përgjegjësi të NA dhe NZ të NJZP. Thesari ka funksionin e kontabilizimit të të dhënave në SIFQ dhe nuk mund të parandalojë kryerjen e shpenzimeve pa plan pasi i paraqiten vetëm informacioni i pagesave.

Qëndrimi i audituesit: Pas shqyrtimit të observacionit dhe dokumentacionit bashkëlidhur, grupi i auditimit e ka marrë në konsideratë atë, në lidhje me përfshirjen e projektit “Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Qarkun e Vlorës (kredi)” në listën e projekteve me financim të huaj me Grand të cilët kanë tejkaluar planin e buxhetit, duke e hequr nga kjo listë dhe duke e zhvendosur te lista e projekteve me financim të huaj me Kredi të cilët kanë tejkaluar planin e buxhetit. Për sa i përket çështjeve të tjera të trajtuara, gjykojmë që edhe në observacionin nuk kundërshtohen konstatimet e trajtuara në Akt Konstatimet, por trajtohen përgjegjësitë apo detyrat funksionale që ka Sektori i Llogarisë së Unifikuar të Thesarit dhe Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike të Buxhetit në lidhje me investimet e huaja. Sa më sipër grupi i auditimit i qëndron konstatimeve të trajtuara.

6: Mbi procesin e menaxhimit të financave publike në nivel vendor në bazë të ligjit nr.68, datë 27.04.2018 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Planifikimi dhe transferimi i transfertës së pakushtëzuar. Monitorimi dhe analiza e treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit vendor.

Misioni i Drejtorisë së Financave Vendore është menaxhimi dhe monitorimi i procesit të hartimit dhe zbatimit të Buxhetit Vendor, për të siguruar përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe me ekonomi të burimeve buxhetore. Të llogarisë dhe të transferojë me drejtësi, transparencë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

transfertat e buxhetit të shtetit për pushtetin vendor, të mbështesë dhe të plotësojë me aktet e nevojshme ligjore për decentralizimin fiskal, duke synuar rritjen e të ardhurave, rritjen e efijences së përdorimit të fondeve publike për pushtetin vendor.

Mbi të ardhurat e pushtetit vendor

Të ardhurat e Pushtetit Vendor, ndahen në:

- 1- Grandi nga Buxheti i Shtetit (Transferta të pakushtëzuara dhe specifike)
- 2-Të ardhura nga burimet e veta vendore ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore, tarifat, huamarrje vendore, tatimi mbi pasurinë, tatimi mbi fitimin e bizneseve të vogla dhe të tjera.
- 3-Taksa të ndara sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendore;
- 4-Transferta të kushtëzuara nga ministrinë e linjës për funksione të deleguara.

Tre kategoritë e para janë klasifikuar si burime financiare të disponueshme, burime mbi të cilat bashkitë kanë të drejta vendimmarrje relative në lidhje me mënyrën e përdorimit. Ndërsa, mbi kategorinë e transfertave të kushtëzuara bashkitë nuk kanë autoritet vendimmarrje në lidhje me sasinë apo mënyrën e përdorimit të këtyre fondeve; pra, ato shpenzohen sipas përcaktimeve të ministrive të linjës.

Sipas projekt buxhetit, ligjit për Buxhetin e vitit 2020, ndryshimet e ndodhura gjatë vitit me Aktet Normative përkatëse, Akti Normativ nr. 6, datë 21.03.2020, Akti Normativ nr. 15, datë 15.04.2020, Akti Normativ nr. 28, datë 02.07.2020, Akti Normativ nr. 34, datë 16.12.2020 dhe krahasuar me realizimin faktik bazuar në tabelën fiskale të buxhetit të konsoliduar, vlera e të ardhurave të pushteti vendor (të ardhurat nga tarifat dhe taksat vendore) paraqitet si në tabelën në vijim. Këto të ardhura përbehen nga të ardhurat nga taksat lokale, të ardhurat nga tatimi mbi pasurinë dhe të ardhurat nga tatimi mbi fitimin e biznesin të vogël.

Tabela: Procesi i planifikimit të ardhurave nga pushteti lokal nga faza e projekt buxhetit deri në AN nr.34 si dhe realizimi.

Në milion lekë

Emërtimi	Projekt Buxhet	Buxhet 2020	AN6	AN15	AN28	AN34	Fakt 2020	Dif.	%	Dif.	%
	1	2	3	4	5	6	7	7-6	7/6	7-3	7/3
Të ardhura nga Pushteti Vendor	26,944	26,944	26,944	26,944	23,045	23,045	21,975	-1,070	95	-4,969	82
Taksa Lokale	21,222	21,222	21,222	21,222	18,422	18,422	16,468	-1,954	89	-4,754	77.6
Tatimi mbi Pasurinë	5,354	5,354	5,354	5,354	4,254	4,254	5,124	870	120	-230	95.7
Tatimi mbi fitimin e biznesit të vogël	369	369	369	369	369	369	384	15	104	15	104

Me ligjin fillestar të buxhetit të ardhurat nga pushteti vendor janë planifikuar në vlerën 36,944 milion lekë. Pas miratimit të Aktit Normativ nr.6, datë 21.03.2021 dhe Aktit Normativ nr. 15.04.2020, të ardhurat nuk kanë pësuar ndryshime. Ndërsa Aktin Normativ nr. 28 dhe me Aktin Normativ nr.34, të ardhurat nga pushteti vendor janë planifikuar në vlerën 23,045 milion lekë, duke u ulur për vlerën janë ulur për vlerën 3,899 milion lekë, krahasuar me planifikimin fillestar.

Për vitin 2020, referuar tabelës së Treguesve Fiskal të Konsoliduar të ardhurat nga pushteti vendor janë realizuar në vlerën 21,975 milion lekë, kundrejt 23,045 milion lekë të planifikuara me planin fillestar ose në masën 95%, me mos realizimin në vlerën 1,070 milion lekë. Në krahasim me planin e ndryshuar (AN34), të ardhurat nga pushteti vendor janë realizuar në masën 82% me mos realizimin në vlerën 4,969 milion lekë.

Tabela në vijim paraqet trendin e realizimit të ardhurave nga taksat dhe tarifat e pushtetit vendor nga viti 2013 deri në vitin 2020.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË


Tabela: Trendi i realizimit të ardhurave nga pushteti vendor.

Në milion lekë

Emërtimi	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Të ardhurat e pushtetit vendor	10,825	12,447	11,700	14,951	18,447	21,863	23,102	21,975
Dif. nga viti i mëparshëm		1,622	-747	3,251	3,496	3,416	1,239	-1,127
Në % nga viti mëparshëm		115%	94%	128%	123%	119%	106%	95.1%

Në mënyrë grafike, trendi i realizimit të Ardhurave nga Pushteti Vendor si dhe të ardhurat vendore në raport me totalin e të ardhurave publike dhe Produktit të Brendshëm Bruto paraqiten si më poshtë:

Grafiku: Të ardhurat vendore në raport me totalin e të ardhurave publike dhe PBB.



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Të ardhurat e pushtetit vendor për vitin 2020, janë ulur në vlerën 1,127 milion lekë ose 5% më pak krahasuar me vitin 2019, ku të ardhurat e pushtet vendor janë realizuar në vlerën 23,102 milion lekë.

Për vitin 2020, **taksat lokale** janë realizuar për vlerën 16,452 milion lekë, kundrejt 18,422 milion lekë të planifikuara me Aktit Normativ rr.34, realizuar në masën 95%, me mosrealizimin në vlerën 1,975 milion lekë. Në krahasim me planin fillestar, taksat lokale janë realizuar në masën 81%, me mos realizimin në vlerën 4,754 milion lekë.

Tatimi mbi Pasurinë (ndërtesat), për vitin 2020 është realizuar për vlerën 5,124 milion lekë, kundrejt 4,254 milion lekë të planifikuar me Aktit Normativ nr.34, realizuar në masën 120%, ose realizuar më shumë për vlerën 870 milion lekë. Në krahasim me planin fillestar, të ardhurat e pushtetit vendor nga tatimi mbi pasurinë janë realizuar në masën 98.7%, ose me mos realizimin për vlerën 230 milion lekë.

Tatimi mbi Biznesin e vogël, për vitin 2020 është realizuar për vlerën 384 milion lekë, kundrejt 369 milion lekë të planifikuar me ligjin e buxhetit dhe Aktit Normativ nr.34, realizuar në masën 104%, ose realizuar më shumë për vlerën 15 milion lekë.

Referuar bazës së të dhënave të Drejtorisë së Financave Vendore, të ardhurat e pushtetit vendore në total janë në vlerën 24,205 milion lekë kundrejt 21,975 milion lekë të raportuar nga Drejtoria e Thesarit në Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar të Shtetit, pra me një diferencë në vlerën 2,230 milion lekë, nga e cila, vlera 2,246 milion lekë përfaqëson oTë ardhurat jo tatimore të pushtetit vendor, të cilat realisht janë përfituar dhe realizuar nga pushteti vendor por për efekt të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

raportimit të Treguesve Fiskalë të Konsoliduar këto të ardhura raportohen në zërin 0Të ardhura jo Tatimore si dhe vlera 16 milion e cila përfaqëson arkëtimet e llogarisë 7035033 0Taksë vendore e ndikimit në infrastrukturës nga ndërtimet e reja dhe legalizimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të cilat arkëtohen nga kjo ministri dhe më pas u transferohen njësisive të qeverisjes vendore. Drejtoria e Financave Vendore, në raportin vjetor 0Financat Publike Vendore 2020, ka raportuar se të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore janë në vlerën 21,975 milion lekë, ndërsa në bazën e të dhënave të po kësaj Drejtori të ardhurat nga taksat dhe tarifatat rezultojnë në vlerën 21,959 milion lekë, me diferencë në vlerën 16 milion lekë e cila përfaqëson arkëtimet e 0Taksë vendore e ndikimit në infrastrukturës nga ndërtimet e reja dhe legalizimi, të trajtuar më sipër. Drejtoria e Financave Vendore pavarësisht së në raportin vjetor ka raportuar se të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore janë në vlerën 21,975 milion lekë, nuk disponon informacion se cila njësi të qeverisjes vendore kanë përfituar të ardhura nga transferimi i takës vendore nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë tek njësitë e qeverisjes vendore.

Shpenzimet e buxhetit vendor

Për vitin 2020, sipas tabelës së treguesve fiskalë të konsoliduar janë raportuar shpenzime të realizuara nga buxhetin vendor në shumën 51,627 milion lekë nga 53,285 milion lekë të planifikuara me Aktin Normativ nr.34, datë 16.12.2020, ose realizuar në masën 97%, me mos realizim në vlerën 1,658 milion lekë kundrejt planit të ndryshuar. Në krahasim me planin fillestar, shpenzimet e realizuara nga buxhetin vendor janë realizuar në masën 90%, me mos realizimin në vlerën 5,927 milion lekë.

Tabela: Planifikimi i shpenzimeve për buxhetin vendor dhe realizimi sipas tabelës së treguesve fiskal.

milion lekë

Emërtimi	Projekt Buxheti	Buxheti 2020	AN6	AN15	AN28	AN32	Fakt 2020	Dif.	%	Dif.	%
	1	2	3	4	5	6	7	7-6	7/9	7-2	7/2
II Shpenzime për Buxhetin Vendor	57,128	57,554	57,544	57,544	53,485	53,285	51,627	-1,658	97	-5,927	90
Granti nga buxheti i shtetit	25,614	26,040	26,040	26,040	26,040	26,110					
Fond i pakushtëzuar	18,000	18,200	18,200	18,200	18,200	18,270	33,386	7,276	127	7,346	128
Grant Specifik	7,614	7,840	7,840	7,840	7,840	7,840					
Shpenzime me financim të huaj	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000	530	279	251	53	470	53
Buxheti vendor (të ardhurat e veta tatimore)	26,944	26,944	26,944	26,944	23,045	23,045					
Buxheti vendor (nga të ardhurat jo-tatimore)	2,900	2,900	2,900	2,900	2,800	2,800	27,409	1,034	96.2	3,105	90
Taksa të ndara	670	670	670	670	600	530					

Nga auditimi rezulton se pavarësisht se totali i shpenzimeve për buxhetin vendor është deklaruar në vlerën 51,267 milion lekë, referuar tabelës së treguesve fiskal për muajin dhjetor, totali i zërave që përbejnë shpenzimet e buxhetit vendor rezulton në vlerën 61,074 milion lekë, duke reflektuar diferencë në vlerën 9,447 milion lekë, vlerë e cila përfaqëson shpenzimet e realizuar nga buxheti vendor për Fondin e Rindërtimit. Rezulton se në tabelat mujore të treguesve Fiskal për periudhën Janar 2020 - Nëntor 2020 tek vlera totale e shpenzimeve të realizuara nga buxheti vendor është përfshirë edhe vlera e shpenzimeve të kryera nga Fondin i Rindërtimit. Vetëm në tabelën e treguesve fiskal përfundimtar (Dhjetor 2020), realizimet e shpenzimeve të kryera nga Fondi i Rindërtimit dalin si zë më vete në Tabelën e Treguesve Fiskal. Përfshirja e shpenzimeve të realizuar nga Fondi i Rindërtimit në një zë me shpenzimet e tjera, është jo në përputhje me Tabelën nr. 4 0Treguesit fiskalë, bashkëlidhur ligjit nr. 88/2019 0Për buxhetin e vitit 2020, i ndryshuar.


Trendi i realizimit të shpenzimeve të pushtetit vendor për 7 vjet rezulton si vijon: *Në milion lekë*

Emërtimi	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Shpenzime të pushtetit vendor	32,985	34,066	43,559	46,487	49,615	56,227	51,627
Dif. nga viti i mëparshëm	3,198	1,081	9,493	2,928	3,128	6,612	-4,600
Dif. në % nga një vit më parë	110.70%	103.28%	128%	106.72%	106.73%	113%	92%



KONTROLLI I LARTË I SHPETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Në mënyrë grafike, trendi i realizimit të shpenzimeve nga Pushteti Vendor paraqitet:



Shpenzimet e pushtetit vendor për vitin 2020, janë ulur në vlerën 4,600 milion lekë ose 5% më pak krahasuar me vitin 2019, vit në të cilin shpenzimet e pushtetit vendor janë realizuar në vlerën 56,227 milion lekë.

Tabela në vijim paraqet shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik ndër vite.

Në milion lekë

Shpenzimet e buxhetit vendor	Realizimi 2015	Realizimi 2016	Realizimi 2017	Realizimi 2018	Realizimi 2019	Realizimi 2020
Shpenzime Korrente	20,858	26,740	30,204	35,364	38,340	38,714
Personeli	10,870	15,906	19,118	20,730	21,835	22,390
Shpenzime operative dhe te mirëmbajtjes	9,277	9,988	10,132	13,486	14,966	15,168
Subvencione	126	106	142	127	180	152
Te tjera	585	740	812	1,021	1,359	1,001
Shpenzime Kapitale	13,208	16,819	16,283	14,251	17,887	12,912
Totali	34,066	43,559	46,487	49,615	56,227	51,626

Për vitin 2020, shpenzimet korrent të buxhetit vendor janë realizuar në vlerën 38,714 milion lekë ndërsa shpenzimet kapitale janë realizuar në vlerën 12,912 milion lekë. Peshën më të madhe të shpenzimeve vendore gjatë vitit 2020 e zënë shpenzimet për paga dhe sigurime në vlerën 22,390 milion lekë ose 43% e totalit. Në raport me një vit më parë konstatohet që shpenzimet për investime kanë një rënie në vlerën 4,975 milion lekë ose në masën 28% ndërkohë që shpenzimet e personelit dhe ato operative kanë një rritje të lehtë përkatësisht me 555 milionë lekë dhe 202 milionë lekë krahasuar me shpenzimet e vitit 2019.

Mbi transfertat e pakushtëzuara

Transferta e pakushtëzuar janë fonde që ju jepen njësisive të vetëqeverisjes vendore nga Buxheti i Shtetit për financimin e ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj. Transferta e pakushtëzuar ndahet ndërmjet bashkive dhe qarqeve ndahet sipas formulës që i bashkëlidhet si aneks ligjit të buxhetit vjetor.

Referuar tabelës 3 të ligjit nr. 88/2019 òPër buxhetin e vitit 2020 si dhe shkresës nr. 24139, datë 26.12.2019 òDërgohet transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2020, vlera totale e transfertave të pakushtëzuar është 25,940 milion lekë nga të cilat transferat e pakushtëzuar për bashkitë është në vlerën 25,390 milion lekë dhe vlera e transfertave për qarqet është 500 milion lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Në nenin 7 të ligjit nr. 88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020" përcaktohet se Fondi i Rindërtimit, i cili do përdoret për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019, shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi. Me aktin Normativ nr. 6, datë 21.03.2020 është ndryshuar neni 7 i ligjit të buxhetit të vitit 2020 dhe fondi i rindërtimi përveç se shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi do të shtojë edhe kufijtë e transfertës së pakushtëzuar të miratuar në tabelën 3.

Rezulton se në fund të vitit 2020, bashkive u janë shtuar fonde në vlerën 14,909 milion lekë në formën e transfertave të pakushtëzuara për Fondin e Rindërtimit. Konkretisht Bashkisë Tiranë i janë shtuar fonde për Rindërtimin në formën e transfertës së pakushtëzuar në vlerën 5,920 milion lekë, bashkisë Shijak në vlerën 1,156 milion lekë, bashkisë Kavajë në vlerën 18 milion lekë, bashkisë Krujë në vlerën 1,056 milion lekë, bashkia Durrës në vlerën 4,950 milion lekë, bashkisë Lezhë në vlerën 542 milion lekë, bashkisë Kamëz në vlerën 18 milion lekë dhe bashkisë Kurbin në vlerën 1,249 milion lekë.

Mbi problematikat e konstatuara në raportimin e të ardhurave të pa përdorura nga njësitë e qeverisjes vendore të cilat trashëgohen në vitin buxhetor pasardhës.

- Në vitin 2020, janë trashëguar fonde të papërdorura në vitin 2019, në vlerën **11,038 milion lekë** nga të cilat 10,758 milion i përkasin bashkive dhe 280 milion qarqeve, konkretisht:

- Në kapitullin 1, "Çelje nga buxheti", janë trashëguar fonde në vlerën 3,601 milion lekë, nga të cilat 3,395 milion lekë i përkasin bashkive dhe 206 milion qarqeve.

- Në kapitullin 5 dhe 6 "Të ardhurat e veta", janë trashëguar fonde në vlerën 7,433 milion lekë, nga të cilat 7,359 milion lekë i përkasin bashkive dhe 74 milion lekë qarqeve.

- Në kapitullin 2 janë trashëguar fonde në vlerën për 4 milion lekë nga të cilat 4 milion lekë i përkasin bashkive.

- Të ardhurat e pa përdorura dhe të trashëguara për vitin 2021 për njësitë e vetëqeverisjes vendore, në total janë 19,910 milion lekë, të cilat përfaqësojnë 39% të të ardhurave totale faktike të vitit 2020 dhe konkretisht:

- Në kapitullin 01, "Çelje nga buxheti", janë trashëguar fonde në vlerën 11,226 milion lekë, nga të cilat vlera 10,984 milion lekë i përket bashkive dhe 242 milion lekë qarqeve.

- Në kapitullin 5 dhe 6 "Të ardhurat e veta", janë trashëguar fonde në vlerën 8,662 milion lekë, nga të cilat 8,561 milion lekë i përkasin bashkive dhe 101 milion lekë qarqeve.

- Në kapitullin 2 janë trashëguar fonde në vlerën për 23 milion lekë nga të cilat vlera 19.5 milion lekë i përket bashkive dhe 3.4 milion lekë qarqeve.

- Rezulton në totalin e fondeve 19,910 të trashëguara për vitin 2021, është e përfshirë edhe **vlera 6,524 milion lekë e cila i përket fondeve të papërdorura për rindërtimin**. Konkretisht Bashkia Tiranë ka trashëguar 3,766 milion lekë fonde për rindërtimin, Bashkia Durrës 1,242 milion lekë, Bashkia Kavajë 18 milion lekë, Bashkia Krujë 301 milion lekë, Bashkia Laç 674 milion lekë dhe Bashkia Shijak ka trashëguar 357 milion lekë fonde të papërdorura për rindërtimin.

Grupi i auditimit bazuar në të dhënat e dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka testuar vlerën totale të të ardhurave që janë trashëguar për vitin 2021. Nga testimi i kryer rezulton se të ardhurat e trashëguara për vitin 2021 kanë diferencë me vlerën që duhet të ishte trashëguar realisht.

Tabela: Të ardhurat e papërdorura të trashëguara në vitin buxhetor 2021



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

në mijë lekë

Njësitë e qeverisjes vendore	Të ardhura të Trashëguara nga 2019	Total të Ardhura (përfshirë edhe të ardhurat nga fondi i rindërtimit)	Total Shpenzime (përfshirë edhe shpenzimet nga fondi i rindërtimit)	Të ardhura të trashëguara për vitin 2021	Të ardhura që duhet trashëgohehin për 2021	Diferenca
	1	2	3	4	5=1+2-3	6=4-5
61 Bashki + 12 Qarqe	11,038,785	60,069,729	60,011,543	19,910,368	16,096,971	3,813,397

Në total për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore janë trashëguar 19,910 milion lekë fonde për vitin 2021, ndërkohë sipas testimeve të kryera nga grupi i auditimi për vitin 2021 duhet të ishin trashëguar 16,097 milion lekë, pra me diferencë në vlerën 3,813 milion lekë.

Në tabelën në vijim paraqiten njësitë e qeverisjes vendore të cilat kanë rezultojnë me diferencë me të madhe se 16,000 mijë lekë midis të ardhurave të trashëguara për vitin 2021 dhe të ardhurave të cilave duhet të ishin trashëguar. Nga grupi i auditimit është vendosur kufiri 16,000 mijë, sa totali i taksës vendore të ndikimit në infrastrukturës nga ndërtimet e reja dhe legalizimi, të cilat janë arkëtuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe më pas i janë transferuar njësisë të qeverisjes vendore, pasi Drejtoria e Financave Vendore nuk disponon të dhëna analitike për këto të ardhura.

Tabela: Diferenca midis të ardhurave të trashëguara dhe të ardhurat që duhet të ishin trashëguar *në mijë lekë*

Njësitë e qeverisjes vendore	Të ardhura të Trashëguara nga 2019	Total të Ardhura (përfshirë edhe të ardhurat nga fondi i rindërtimit)	Total Shpenzime (përfshirë edhe shpenzimet nga fondi i rindërtimit)	Të ardhura të trashëguara për vitin 2021	Të ardhura që duhet trashëgohehin për 2021	Diferenca
Bashkia Berat	69,105	837,794	837,964	123,204	68,934	54,270
Bashkia Bulqize	76,203	428,147	465,295	71,245	39,055	32,190
Bashkia Diber	64,780	721,582	729,750	89,281	56,612	32,669
Bashkia Divjake	60,647	402,281	442,204	47,203	20,724	26,479
Bashkia Dures	575,551	7,092,351	6,139,248	1,841,682	1,528,655	313,027
Bashkia Fier	342,174	1,549,537	1,598,302	410,293	293,409	116,884
Bashkia Gjirokaster	69,078	536,081	522,894	107,475	82,265	25,210
Bashkia Has	5,525	231,045	247,454	7,884	(10,883)	18,767
Bashkia Kamez	50,355	1,186,677	1,282,221	69,924	(45,188)	115,112
Bashkia Kavaja	202,072	704,073	709,819	315,836	196,326	119,510
Bashkia Korçe	154,039	1,273,015	1,309,600	135,673	117,454	18,219
Bashkia Kruje	198,389	1,743,818	1,373,952	680,291	568,255	112,036
Bashkia Kucove	32,144	368,915	371,875	46,827	29,184	17,643
Bashkia Kukes	94,128	695,856	649,245	183,165	140,738	42,427
Bashkia Kurbin	59,521	1,662,649	989,442	1,074,616	732,727	341,889
Bashkia Lezhe	112,236	1,356,094	1,265,692	682,530	202,637	479,893
Bashkia Lushnje	61,097	1,017,856	1,070,272	72,006	8,681	63,325
Bashkia Maliq	41,517	533,997	556,927	41,690	18,587	23,103
Bashkia Mallakaster	89,185	371,491	382,622	100,883	78,054	22,829
Bashkia Mat	55,676	408,091	443,957	45,255	19,810	25,445
Bashkia Mirdite	24,902	392,155	413,161	26,255	3,897	22,358
Bashkia Patos	110,836	386,866	385,721	172,121	111,980	60,141
Bashkia Permet	56,543	224,071	238,349	59,978	42,265	17,713
Bashkia Pogradec	185,583	840,898	871,800	184,528	154,681	29,847
Bashkia Roskovec	15,582	337,868	370,336	41,872	(16,887)	58,759
Bashkia Sarande	229,878	631,238	643,461	248,674	172,656	31,018
Bashkia Shijak	84,265	1,491,251	1,146,804	558,901	428,712	130,189
Bashkia Skrapar	40,465	266,448	332,600	10,193	(25,687)	35,880
Bashkia Tepelene	907	188,529	199,299	63,017	(9,864)	72,881
Bashkia Tirana	4,977,346	23,409,408	20,374,410	8,954,898	8,012,345	942,553
Bashkia Tropoje	18,495	329,937	275,433	95,426	72,999	22,427
Bashkia Ura Vajgurore	44,081	343,990	372,693	42,395	15,378	27,017
Bashkia Vlore	178,189	1,587,079	1,657,248	186,776	108,021	78,755
Bashkia Vore	7,638	466,863	343,703	176,391	130,798	45,593
Qarku Dures-Dures	6,396	36,125	64,925	31,700	(22,404)	54,104
Qarku Elbasan-Elbasan	35,702	61,415	82,051	32,710	15,066	17,644



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Qarku Korce	67,227	58,096	79,788	64,080	45,535	18,545
Qarku Vlore	61,931	44,424	69,329	60,887	37,027	23,860

Nga analiza e të dhënave të paraqitura nga MFE mbi tepricën fillestare të vitit të të ardhurave të trashëguara dhe të ardhurat dhe shpenzimet e vitit sipas burimeve të financimit, konstatohet se nuk është paraqitur si burim financimi i vitit në ligjin fillestar të buxhetit, financimi i huaj për pushtetin vendor.

Mbi raportimin e Detyrimeve të Prapambetura të pushtetit vendor.

Në fund të vitit 2020, referuar raportit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale si dhe raportit vjetor të financat publike vendore, 2020, stoku i detyrimeve të prapambetura për njësitë e vetëqeverisjes vendore në fund të muajit dhjetor 2020, është vlerësuar rreth 6,931 milion lekë. Sipas të dhënave të dërguara nga Drejtoria e Financave Vendore dhe tabelave bashkëlidhur raporteve të mësipërme stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2020, për 61 bashki dhe 12 qarqe rezultojnë të jetë **rreth 7,059 milion lekë**. Stokun më të lartë të detyrimeve e ka bashkia Tiranë në vlerën rreth 762 milion lekë ose në masën 11% të totalit të detyrimeve, bashkia Kavajë në vlerën rreth 728 milion lekë ose në masën 0.5% të totalit të detyrimeve, bashkia Vorë në vlerën rreth 703 milion lekë ose në masën 10.1% të totalit të detyrimeve dhe bashkia Pogradec në vlerën rreth 339 milion lekë ose në masën 4.9% të totalit të detyrimeve. Sa u përket qarqeve, stokun më të lartë të detyrimit e ka qarku Durrës në vlerën 63 milion lekë ose në masën 49.2% të totalit të detyrimeve të qarqeve, qarku Berat në vlerën 42 milion lekë ose në masën 32.9% dhe qarku Gjirokastrë në vlerën rreth 19 milion lekë ose në masën 14.6% të totalit të detyrimeve të qarqeve.

Në zbatim të Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, Udhëzimit nr.5, datë 27.02.2014 për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, Udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2020 për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të Njësive të Qeverisjes Vendore si dhe Manualin udhëzues mbi regjistrimin, ngarkimi dhe postimin në sistem të detyrimeve të prapambetura, detyrimi duhet të regjistrohet *dogjatë gjithë vitit financiar, menjëherë sapo institucioni buxhetor evidenton krijimin e një detyrimi të prapambetur*, në llogarinë 4864 detajuar sipas natyrës së detyrimit (investime, mallra etj). Në momentin e pagesës me dërgimin e dokumentacionit në Thesar, veprimi i parë i regjistruar në llogarinë 4864 stornohet, fatura regjistrohet për herë të parë si transaksion shpenzimi dhe më pas paguhet. Me qëllim vlerësimit të totalit të detyrimeve të prapambetura të regjistruara në këtë llogari për njësitë e vetëqeverisjes vendore, grupit të auditimit i është vënë në dispozicion nga Drejtoria e Thesarit llogaria 4864. Sipas të dhënave të thesarit në llogarinë 4864, totali i detyrimeve të prapambetura për njësitë e qeverisjes vendore është **7,212 milion lekë**, duke reflektuar **diferencë në vlerën 153 milion lekë** me vlerën totale të detyrimeve të njësive të qeverisjes vendore të raportuar dhe publikuar nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë.

Tabela: Detyrimet e prapambetura të njësive të qeverisjes vendore

Në lekë

Nr.	Njësia e qeverisjes vendore	Detyrimi i raportuar	Gjendja e detyrimeve të prapambetura sipas llogarisë 486	Diferenca
1	Bashkia Belsh	128,223,586	128,223,586	-
2	Bashkia Berat	143,347,084	143,347,084	-
3	Bashkia Bulqizë	28,307,781	28,307,781	-
4	Bashkia Cërrik	111,807,712	111,807,712	-
5	Bashkia Delvinë	51,791,304	51,791,304	-
6	Bashkia Devoll	57,268,449	57,268,449	-
7	Bashkia Dibër	174,616,953	174,616,953	-
8	Bashkia Divjakë	130,213,660	130,213,660	-



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

9	Bashkia Dropull	-	-	-
10	Bashkia Durrës	185,428,873	185,428,873	-
11	Bashkia Elbasan	153,924,425	153,924,425	-
12	Bashkia Fier	88,453,666	88,453,666	-
13	Bashkia Finiq	50,105,541	49,605,541	500,000
14	Bashkia Fushë-Arrëz	8,017,270	8,017,270	-
15	Bashkia Gjirokastër	3,316,775	3,316,775	-
16	Bashkia Gramsh	19,677,446	19,677,446	-
17	Bashkia Has	27,523,238	27,523,238	-
18	Bashkia Himarë	75,170,102	75,170,102	-
19	Bashkia Kamëz	265,387,540	265,387,540	-
20	Bashkia Kavajë	727,778,732	727,778,732	-
21	Bashkia Këlcyrë	-	-	-
22	Bashkia Klos	58,368,920	58,368,920	-
23	Bashkia Kolonjë	12,181,890	12,181,890	-
24	Bashkia Konispol	13,578,979	13,578,979	-
25	Bashkia Korçë	53,283,801	53,283,801	-
26	Bashkia Krujë	50,030,364	203,044,407	(153,014,043)
27	Bashkia Kuçovë	156,296,332	156,296,332	-
28	Bashkia Kukës	72,669,144	72,622,344	46,800
29	Bashkia Kurbin	15,797,046	15,797,046	-
30	Bashkia Lezhë	308,363,718	308,363,718	-
31	Bashkia Libohovë	8,031,744	8,031,744	-
32	Bashkia Librazhd	55,842,835	55,842,835	-
33	Bashkia Lushnjë	134,782,276	134,782,276	-
34	Bashkia Malësi e Madhe	223,903,558	223,903,558	-
35	Bashkia Maliq	14,120,544	14,120,544	-
36	Bashkia Mallakastër	10,634,793	10,634,793	-
37	Bashkia Mat	19,924,791	19,924,791	-
38	Bashkia Memaliaj	24,289,514	24,289,514	-
39	Bashkia Mirditë	66,946,220	67,856,445	(910,225)
40	Bashkia Patos	-	-	-
41	Bashkia Peqin	32,329,740	32,329,740	-
42	Bashkia Përmet	6,264,101	6,264,101	-
43	Bashkia Pogradec	338,732,136	338,732,136	-
44	Bashkia Poliçan	102,706,062	102,281,203	424,859
45	Bashkia Prrenjas	16,204,679	16,204,679	-
46	Bashkia Pukë	59,250,683	59,250,683	-
47	Bashkia Pustec	1,437,029	1,437,029	-
48	Bashkia Roskovec	302,205,765	302,205,765	-
49	Bashkia Rrogozhinë	113,155,046	113,155,046	-
50	Bashkia Sarandë	57,200,636	57,200,636	-
51	Bashkia Selenicë	98,988,441	98,988,441	-
52	Bashkia Shijak	9,593,912	9,593,912	-
53	Bashkia Shkodër	3,199,930	3,199,930	-
54	Bashkia Skrapar	29,593,578	29,593,578	-
55	Bashkia Tepelenë	58,056,725	58,056,725	-
56	Bashkia Tiranë	761,791,637	761,791,637	-
57	Bashkia Tropojë	119,330,457	119,330,457	-
58	Bashkia Ura Vajgurore	124,121,418	124,121,418	-
59	Bashkia Vau i Dejës	7,842,860	7,842,860	-
60	Bashkia Vlorë	256,613,638	256,613,638	-
61	Bashkia Vorë	702,614,675	702,614,675	-
62	Qarku Berat	42,203,217	42,203,217	-
63	Qarku Dibër	-	-	-
64	Qarku Durrës	63,105,482	63,105,482	-
65	Qarku Elbasan	-	-	-
66	Qarku Fier	-	-	-
67	Qarku Gjirokastër	18,738,568	18,738,568	-
68	Qarku Korçë	2,982,567	2,982,567	-
69	Qarku Kukës	-	-	-
70	Qarku Lezhë	-	-	-
71	Qarku Shkodër	-	-	-
72	Qarku Tiranë	-	-	-
73	Qarku Vlorë	1,274,000	1,274,000	-
Totali		7,058,943,589	7,211,896,198	(152,952,609)

Referuar tabelës së mësipërme konstatohet se 5 bashki rezultojnë me diferencat midis detyrimeve të prapambetura të raportuar dhe llogarisë 486 të thesarit, konkretisht: Për bashkinë Krujë janë raportuar 50,030,364 lekë detyrime të prapambetura, ndërsa në llogarinë 486 janë regjistruar detyrime të prapambetura në vlerën 203,044,407 lekë, me një diferencë në vlerën 153,014,043 lekë në krahasim me detyrime e raportuara. Nga testimet e kryera nga grupi i auditimit rezulton se diferenca në raportimin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

krijohen nga detyrimet e prapambetura të Ujësjiellës- Kanalizime Krujë në vlerën 153,014,043 lekë. Për bashkinë Mirditë janë raportuar 66,946,220 lekë detyrime të prapambetura, ndërsa në llogarinë 486 janë regjistruar detyrime të prapambetura në vlerën 67,856,445 lekë, me një diferencë në vlerën 910,225 lekë në krahasim me detyrime e raportuara. Rezulton se diferenca në raportimin krijohen nga detyrimet e prapambetura të Ujësjiellës-Kanalizime Rrëshen në vlerën 910,225 lekë. Ndërsa për bashkitë Finiq, Kuçovë dhe Poliçan janë deklarua më shumë detyrime të prapambetura se detyrimet e regjistruara në llogarinë e thesarit.

Mbi analizën e stokut të detyrimeve dhe të ardhurave të papërdorura të bashkive dhe qarqeve.

Nëse do të vlerësonim situatën e stokut të detyrimeve të bashkive (6,931 milion lekë), përkundrejt të ardhurave të pa përdorura të cilat trashëgohen në vitin buxhetor pasardhës, të cilat referuar të dhënave të MFE-së janë në vlerën 19,562 milion lekë, konstatohet se, vlera e të ardhurave të pa përdorura të cilat trashëgohen, është afërisht tre herë me e madhe se vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura të deklaruar.

Tabela: Detyrimet e prapambetura dhe të ardhurat e trashëguara për bashkitë

Në lekë

Nr.	Bashkia	Të ardhura të trashëguara	Detyrimet e prapambetura të deklaruar	Diferenca (Të ardhura- Detyrime)	% e të ardhurave të trashëguar/detyrimet e prapambetura
1	Bashkia Vorë	176,391,691	702,614,675	(526,222,984)	25
2	Bashkia Kavajë	315,836,155	727,778,732	(411,942,577)	43
3	Bashkia Roskovec	27,286,687	302,205,765	(274,919,079)	9
4	Bashkia Kamëz	69,924,127	265,387,540	(195,463,413)	26
5	Bashkia Pogradec	184,527,574	338,732,136	(154,204,563)	54
6	Bashkia Kuçovë	46,827,201	156,296,332	(109,469,131)	30
7	Bashkia Poliçan	11,960,850	102,706,062	(90,745,212)	12
8	Bashkia Dibër	89,281,105	174,616,953	(85,335,848)	51
9	Bashkia Divjakë	47,203,680	130,213,660	(83,009,981)	36
10	Bashkia Belsh	45,911,604	128,223,586	(82,311,982)	36
11	Bashkia Ura Vajgurore	42,394,596	124,121,418	(81,726,822)	34
12	Bashkia Malësi e Madhe	147,697,080	223,903,558	(76,206,479)	66
13	Bashkia Cërrik	38,119,107	111,807,712	(73,688,605)	34
14	Bashkia Rrogozhinë	41,872,298	113,155,046	(71,282,748)	37
15	Bashkia Vlorë	186,775,756	256,613,638	(69,837,882)	73
16	Bashkia Lushnjë	72,006,393	134,782,276	(62,775,884)	53
17	Bashkia Selenicë	50,342,147	98,988,441	(48,646,294)	51
18	Bashkia Finiq	4,786,871	50,105,541	(45,318,670)	10
19	Bashkia Mirditë	26,254,593	66,946,220	(40,691,627)	39
20	Bashkia Delvinë	25,617,953	51,791,304	(26,173,351)	49
21	Bashkia Tropojë	95,426,018	119,330,457	(23,904,439)	80
22	Bashkia Memaliaj	2,353,360	24,289,514	(21,936,154)	10
23	Bashkia Berat	123,204,259	143,347,084	(20,142,825)	86
24	Bashkia Has	7,883,867	27,523,238	(19,639,371)	29
25	Bashkia Skrapar	10,192,759	29,593,578	(19,400,819)	34
26	Bashkia Peqin	18,647,510	32,329,740	(13,682,230)	58
27	Bashkia Konispol	3,255,024	13,578,979	(10,323,955)	24
28	Bashkia Klos	55,820,804	58,368,920	(2,548,116)	96
29	Bashkia Pukë	58,772,105	59,250,683	(478,578)	99
30	Bashkia Tepelenë	63,017,284	58,056,725	4,960,559	109
31	Bashkia Këlcyrë	8,576,812	0	8,576,812	0
32	Bashkia Libohovë	33,277,797	8,031,744	25,246,053	414
33	Bashkia Mat	45,255,316	19,924,791	25,330,525	227
34	Bashkia Pustec	27,405,485	1,437,029	25,968,456	1907
35	Bashkia Kolonjë	38,803,976	12,181,890	26,622,086	319
36	Bashkia Maliq	41,690,135	14,120,544	27,569,591	295
37	Bashkia Bulqizë	71,244,770	28,307,781	42,936,989	252
38	Bashkia Gramsh	63,449,538	19,677,446	43,772,092	322
39	Bashkia Dropull	46,421,697	0	46,421,697	0
40	Bashkia Librazhd	107,251,043	55,842,835	51,408,208	192
41	Bashkia Përmet	59,978,429	6,264,101	53,714,328	957
42	Bashkia Fushë-Arrëz	71,039,898	8,017,270	63,022,628	886
43	Bashkia Devoll	133,099,978	57,268,449	75,831,529	232
44	Bashkia Korçë	135,673,089	53,283,801	82,389,288	255



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

45	Bashkia Mallakastër	100,822,596	10,634,793	90,187,803	948
46	Bashkia Gjirokastrë	107,475,306	3,316,775	104,158,531	3240
47	Bashkia Kukës	183,165,158	72,669,144	110,496,014	252
48	Bashkia Elbasan	267,552,938	153,924,425	113,628,513	174
49	Bashkia Prrenjas	133,705,353	16,204,679	117,500,674	825
50	Bashkia Vau i Dejës	148,916,263	7,842,860	141,073,403	1899
51	Bashkia Patos	172,121,440	0	172,121,440	0
52	Bashkia Sarandë	248,673,663	57,200,636	191,473,027	435
53	Bashkia Himarë	297,396,194	75,170,102	222,226,092	396
54	Bashkia Fier	410,292,606	88,453,666	321,838,940	464
55	Bashkia Lezhë	682,530,407	308,363,718	374,166,689	221
56	Bashkia Shijak	558,901,499	9,593,912	549,307,587	5826
57	Bashkia Krujë	680,290,552	50,030,364	630,260,188	1360
58	Bashkia Shkodër	726,681,251	3,199,930	723,481,321	22709
59	Bashkia Kurbin	1,074,615,585	15,797,046	1,058,818,539	6803
60	Bashkia Durrës	1,841,681,871	185,428,873	1,656,252,998	993
61	Bashkia Tiranë	8,954,898,072	761,791,637	8,193,106,434	1176
Totali		19,562,479,175	6,930,639,755	12,631,839,419	282

Referuar tabelës së mësipërme konstatohet se për 32 bashki, vlerat e të ardhurave të papërdorura në fund të vitit 2020 dhe të trashëguara për vitin pasardhës rezultojnë më të larta se stoku i detyrimeve të prapambetura për këto bashki në fund të vitit 2020. Gjithashtu n.q.s. bashkitë të cilat në Raportin e Drejtorisë së Financave Vendore janë klasifikuar si bashki me probleme financiare dhe në vështirës financiare, do të kishin mundësi të përdorin të ardhurat e trashëguara për vitin 2021, stoku i detyrimeve të prapambetura do të ullej dhe mund të përmirësohej gjendja dhe statusi financiar i njësisve të qeverisjes vendore.

Nëse do të vlerësonim situatën e stokut të detyrimeve të qarqeve (128 milion lekë), përkundrejt të ardhurave të pa përdorura të cilat trashëgohen në vitin buxhetor pasardhës, të cilat referuar të dhënave të MFE-së janë në vlerën 348 milion lekë, konstatohet se, vlera e të ardhurave të pa përdorura të cilat trashëgohen, është afërsisht 2.7 herë më e madhe se vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura të deklaruara.

Nr.	Emërtimi	Të ardhura të trashëguara	Detyrimi i mbetur deri në dhjetor 2020	Diferenca
1	Qarku Berat	11,934,894.77	42,203,217.00	(30,268,322.23)
2	Qarku Dibër	32,898,273.00	-	-
3	Qarku Durrës	31,699,624.77	63,105,482.30	(31,405,857.53)
4	Qarku Elbasan	32,709,622.20	-	-
5	Qarku Fier	32,492,513.31	-	-
6	Qarku Gjirokastrë	15,522,959.58	18,738,568.00	(3,215,608.42)
7	Qarku Korçë	64,080,105.09	2,982,567.00	61,097,538.09
8	Qarku Kukës	12,134,005.00	-	-
9	Qarku Lezhë	9,803,532.00	-	-
10	Qarku Shkodër	35,721,339.16	-	-
11	Qarku Tiranë	8,004,388.00	-	-
12	Qarku Vlorë	60,887,512.12	1,274,000.00	59,613,512.12
Totali		347,888,769	128,303,834	

Referuar tabelës së mësipërme konstatohet se për 2 qarqe konkretisht qarkun Korçë dhe Vlorë, vlerat e të ardhurave të papërdorura në fund të vitit 2020 dhe të trashëguara për vitin pasardhës rezultojnë më të larta se stoku i detyrimeve të prapambetura për këto dy qarqe në fund të vitit 2020.

Ligji për vetëqeverisjen vendore përcakton detyrimin për shpërndarjen e buxhetit për qeverisjen vendore në nivelin e 1 % të PBB. Nga ana tjetër në LOB dhe në Ligjin për vetëqeverisjen vendore përcaktohet e drejta e njësisve të vetëqeverisjes vendore për mbartjen e fondeve të transfertës së pakushtëzuar së papërdorur në fund të vitit si dhe të fondeve të siguruar nga të ardhurat e veta të papërdorura në fund të vitit. Në këtë mënyrë, në çeljen e planit fillestar me ligjin e buxhetit të vitit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

rezulton se plani i detajuar për buxhetin vendor është në nivelin e 1% të PBB për pjesën e transfertës së pakushtëzuar. Referuar analizës mbi të drejtën për të shpenzuar fondet e trashëguara, dhe nivelit të shpenzimeve të planifikuara për buxhetin vendor konstatohet se, edhe për këtë vit, nuk janë respektuar kërkesat e LOB dhe Ligjit për Vetëqeverisjen Vendore në lidhje me të drejtën e pushtetit vendor për të shpenzuar. Nga auditimi konstatohet se pjesa e transfertës së pakushtëzuar e papërdorur dhe pjesa e të ardhurave të veta të papërdorura në fund të vitit nuk janë të detajuara me ligjin fillestar të buxhetit. Kjo krijon kushtet që duke mos paraqitur planin përkatës ti rezervohet njësitë të vetëqeverisjes vendore e drejta për të shpenzuar. Në disa rast ky argument është i mbështetur edhe në faktin që shuma e mbartur e këtyre dy burimeve të financimit është e mjaftueshme jo vetëm për shlyerjen e detyrimeve, por edhe të ndërmarrjes së shpenzimeve të tjera. Mosrespektimi i përcaktimeve të bëra në ligjin integral të buxhetit dhe ligjin për njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të sjellë alokimin e buxhetit drejt zërave të tjerë buxhetorë dhe në kompetencë përdorimi të autoriteteve të tjera vendimmarrëse të ndryshme nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Këto shpërndarje në thelb, jo vetëm krijojnë detyrime të prapambetura, por nga ana tjetër cenojnë parimet e autonomisë së pushtetit vendor. Rrjedhimisht edhe parimet mbi të cilat ngrihet sistemi buxhetor rezulton të mos jenë respektuar për këtë pjesë në buxhetin e shpërndarë për vitin 2020, duke siguruar më pak ndarje të barabartë të burimeve ndërmjet njësitë të qeverisjes vendore si pjesë e transfertës së pakushtëzuar të papërdorur apo të të ardhurave të veta të papërdorura.

Huamarrja Vendore

Me qëllim mbulimin e nevojave për likuiditet për financimin e shpenzimeve kapitale, bashkitë ligjërisht mund të marrin hua afatshkurtër. Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2020, asnjë bashki nuk rezulton të ketë marrë hua. Bazuar në të dhënat e publikuara në regjistrin e borxhit në fund të vitit 2020, rezulton se bashkitë Korçë, Pogradec, Vlorë, Elbasan dhe bashkia Lezhë kanë përfutur hua. Të gjitha hua-të e lartpërmendura janë kontraktuar në vitin 2010 dhe vitin 2014, me qëllim financimin e projekteve infrastrukturore. Në total, stoku i borxhit të qeverisjes vendore në fund të vitit 2020 rezulton të jetë rreth 432.1 milion lekë.

Tabela: Borxhi i pushtetit vendor

Në milion lekë

Huamarrësi	Huadhënësi	Shuma	Fillon	Mbaron	Stoku në fund 2020
Bashkia Korçë	Pro Credit	100	2010	2020	5.95
Bashkia Korçë	ISBA	200	2014	2024	98.97
Bashkia Pogradec	Pro Credit	113	2010	2020	0.56
Bashkia Vlorë	BKT	420	2010	2020	20.29
Bashkia Elbasan	BKT	800	2010	2020	277.45
Bashkia Lezhë	ISBA	107	2014	2023	28.90
Totali		1,755			432.1

Mbi statusin e gjendjes financiare të njësitë të vetëqeverisjes vendore.

Referuar ligjit nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendore, evidentohen katër nivele të ndryshme të rasteve të vështirësive financiare të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet **me probleme financiare** kur në një muaj të caktuar të vitit buxhetor konstatohen vonesa prej më shumë se 30 ditësh në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta dhe kur detyrimet e konstatuara dhe të papaguara përbëjnë **15 për qind të shpenzimeve vjetore të miratuara**.

2. Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet në **vështirësi financiare** kur vonesat në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta konstatohen edhe në muajin pasues të muajit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 55, të këtij ligji, dhe vlera e stokut të detyrimeve të papaguara ndaj



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

palëve të treta rritet progresivisht mbi nivelin prej 25 për qind të shpenzimeve vjetore të miratuara.

3.Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet në vështirësi serioze financiare kur borxhet afatgjata dhe detyrimet e papaguara ndaj palëve të treta përbëjnë mbi 80 për qind të shpenzimeve vjetore të miratuara, konstatimin e situatës së vështirësisë serioze financiare, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore njofton menjëherë këshillin e njësisë dhe Ministrinë e Financave.

4.Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet në situatën e paaftësisë paguesve nëse nuk arrin të zbatojë planin e rehabilitimit financiar dhe/ose nëse raporti i borxheve afatgjata dhe detyrimeve të papaguara ndaj shpenzimeve vjetore të miratuara është më i lartë sesa 1.3.

Drejtoria e Financave Vendore në lidhje me statusin e gjendjes financiare të njësive të qeverisjes vendore ka hartuar Raportin mbi statusin e vështirësive financiare, ku është analizuar gjendja financiare e 58 bashkive, duke u bazuar në vetë deklarin e tyre. Ndërsa gjendja financiare e 5 bashkive, konkretisht bashkia Dropull, Konispol, Patos, Pustec dhe Rogozhinë nuk është analizuar pasi këto bashki nuk kanë vetë deklaruar statusin e tyre pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Sipas raportit të Drejtorisë të Financave Vendore 37 bashki klasifikohet pa probleme financiare, 11 bashkia klasifikohen me probleme financiare dhe 10 bashki klasifikohen në vështirësi financiare. Sipas këtij raporti bashkitë të cilat nuk kanë probleme financiar janë bashkia Shkodër, Gjirokastrë, Maliq, Shijak, Gramsh, Mallakastër, Vau i Dejës, Elbasan, Tiranë, Prrrenjas, Kolonjë, Fier, Fushë Arrëz, Durrës, Mat, Përmet, Bulqizë, Krujë, Libohovë, Sarandë, Librazhd, Memaliaj, Skrapar, Malësi e Madhe, Devoll, Lushnjë, Pukë, Himarë, Vlorë, Has, Peqin, Berat, Korçë, Mirditë dhe Bashkia Kurbin. Në statusin me probleme financiare klasifikohen bashkitë Kamëz, Divjakë, Klos, Cërrik, Selenicë, Finiq, Tropojë, Delvinë, Kukës, Dimal dhe bashkia Dibër. Ndërsa sipas këtij raporti bashkitë në statusin vështirësi financiare klasifikohen bashkia Roskovec, Lezhë, Tepelenë, Këlcyrë, Besh, Pogradec, Kuçovë, Poliçan, Kavajë dhe bashkia Vorë.

Duke ju referuar kërkesave të Ligjit, dhe udhëzimit nr. 26, datë 27.09.2019 oProcedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore o grupi i auditimit ka vlerësuar situatën financiare të Bashkive nga ku rezulton se stoku i detyrimeve (të prapambetura dhe afatshkurtra) deri në dhjetor të vitit 2020 për njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas vlerësimit të KLSH-së dhe të dhënave të llogarisë 486 të thesarit është 7,084 milion lekë. Stoku i borxhit të qeverisjes vendore në fund të vitit 2020 rezulton të jetë rreth 432.1 milion lekë. Sipas të dhënave të MFE-së, totali i shpenzimeve të miratuara është në vlerën 68,955 milion lekë ndërsa totali i shpenzimeve faktike të njësive të qeverisjes vendore rezulton të jetë 50,991 milion lekë. Kundrejt totalit të shpenzimeve faktike të 61 bashkive, stoku i detyrimeve paraqitet në masën 14.7 % të totalit, ndërsa kundrejt shpenzimeve të miratuar stoku i detyrimeve është në masën 10.3%. Në vijim paraqitet gjendja financiare dhe statusi i vështirësive financiare sipas përcaktimeve të neneve 55, 56 dhe 57 të Ligjit nr. 68/2017 oPër financat e vetëqeverisjes vendore sipas metodologjisë të vlerësuar nga grupi i auditimit.

Tabela: Statusi financiar i bashkive

Në lekë

Bashkia	Statusi i Vështirësisë	Shpenzime miratuara 2020	Stoku i detyrimeve sipas llogarisë 486	Borxhi afatgjata	Borxhi dhe Stoku 2020	Borxhi dhe Stoku/ Shp	%
		1	2	3	4=2+3	5=4/1	
Dropull		166 741 146			-	0,0	0%
Kelcyrë		153 300 000	-		-	0,0	0%
Patos		385 721 190			-	0,000	0%
Shkodër		1 665 522 218	3 199 930		3 199 930	0,002	0,20%



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

Gjirokastrë		658 486 000	3 316 775		3 316 775	0,005	0,50%
Maliq		1 023 879 451	14 120 544		14 120 544	0,014	1,40%
Shijak		632 032 260	9 593 912		9 593 912	0,015	1,50%
Vau Dejës		504 793 235	7 842 860		7 842 860	0,016	1,60%
Gramsh		1 083 042 013	19 677 446		19 677 446	0,018	1,80%
Mallakastër		544 291 873	10 634 793		10 634 793	0,020	2%
Permet		315 618 000	6 264 101		6 264 101	0,020	2%
Pustec		66 282 638	1 437 029		1 437 029	0,022	2,20%
Kurbin		648 320 391	15 797 046		15 797 046	0,024	2,40%
Fushe-Arrëz		265 531 000	8 017 270		8 017 270	0,030	3%
Tiranë		23 635 768 506	761 791 637		761 791 637	0,032	2,20%
Prenjas		464 490 772	16 204 679		16 204 679	0,035	3,50%
Kolonjë		345 191 753	12 181 890		12 181 890	0,035	3,50%
Fier		2 158 156 740	88 453 666		88 453 666	0,041	4,10%
Mat		469 303 692	19 924 791		19 924 791	0,042	4,20%
Bulqizë		550 210 000	28 307 781		28 307 781	0,051	5,10%
Durrës		3 576 968 000	185 428 873		185 428 873	0,052	5,20%
Libohovë		124 637 991	8 031 744		8 031 744	0,064	6,40%
Sarandë		879 725 000	57 200 636		57 200 636	0,065	6,50%
Skrapar		389 541 000	29 593 578		29 593 578	0,076	7,60%
Librazhd		672 505 422	55 842 835		55 842 835	0,083	8,30%
Korcë		1 902 145 665	53 283 801	104 924 815	158 208 616	0,083	8,30%
Memaliaj		264 834 000	24 289 514		24 289 514	0,092	9,20%
Peqin		351 989 870	32 329 740		32 329 740	0,092	9,20%
Konispol		144 810 283	13 578 979		13 578 979	0,094	9,40%
Devoll		599 177 683	57 268 449		57 268 449	0,096	9,60%
Kukës		748 534 719	72 622 344		72 622 344	0,097	9,70%
Roskovec		1 117 884 174	113 155 046		113 155 046	0,101	10,10%
Lushnjë		1 319 017 000	134 782 276		134 782 276	0,102	10,32%
Has		249 428 000	27 523 238		27 523 238	0,110	11%
Himarrë		620 360 000	75 170 102		75 170 102	0,121	12,10%
Berat		1 134 802 740	143 347 084		143 347 084	0,126	12,60%
Vlorë		2 181 644 000	256 613 638	20 288 927	276 902 565	0,127	12,70%
Mirditë		464 581 289	67 856 445		67 856 445	0,146	14,60%
Elbasan		2 758 882 651	153 924 425	277 445 838	431 370 263	0,156	15,60%
Kamëz		1 652 289 531	265 387 540		265 387 540	0,161	16,10%
Klos		346 983 212	58 368 920		58 368 920	0,168	16,80%
Pukë		333 167 000	59 250 683		59 250 683	0,178	17,80%
Finiq		272 709 871	49 605 541		49 605 541	0,182	18,20%
Selenicë		534 915 435	98 988 441		98 988 441	0,185	18,50%
Divjakë		674 512 000	130 213 660		130 213 660	0,193	19,30%
Krujë		965 385 116	203 044 407		203 044 407	0,210	21%
Delvinë		229 862 870	51 791 304		51 791 304	0,225	22,50%
UraVajgurore		526 938 670	124 121 418		124 121 418	0,236	23,60%
Cërrik		431 319 107	111 807 712		111 807 712	0,259	25,90%
Lezhë		1 288 080 500	308 363 718	28 904 870	337 268 588	0,262	26,20%
Pogradec		1 232 115 369	338 732 136	561 349	339 293 485	0,275	27,50%
Tepelene		207 403 000	58 056 725		58 056 725	0,280	28%
Kucovë		511 012 291	156 296 332		156 296 332	0,306	30,60%
Dibër		526 938 670	174 616 953		174 616 953	0,331	33,10%
Tropojë		337 647 000	119 330 457		119 330 457	0,353	35,30%
Malesi e Madhe		602 440 194	223 903 558		223 903 558	0,372	37,20%
Belsh		329 295 670	128 223 586		128 223 586	0,389	38,90%
Polican		217 145 807	102 281 203		102 281 203	0,471	47,10%
Kavajë		1 100 850 732	727 778 732		727 778 732	0,661	66,10%
Rogozhinë		455 574 097	302 205 765		302 205 765	0,663	66,30%
Vorë		939 859 324	702 614 675		702 614 675	0,748	74,80%

Në statusin òPa probleme Financiareò, stoku i detyrimeve sipas vlerësimit të KLSH-së dhe borxhit afatgjatë përfaqëson nën 15% të shpenzimeve të miratuar, në të cilin përfshihen 38 bashki.

Në statusin òProbleme Financiareò, stoku i detyrimeve sipas vlerësimit të KLSH-së dhe borxhi afatgjatë përfaqëson mbi 15% deri në 25% të shpenzimeve të miratuara, në të cilin përfshihen 10 bashki.

Në statusin òVështirësi financiareò, stoku i detyrimeve sipas vlerësimeve të KLSH, llogarisë 486 të thesarit dhe borxhit afatgjatë përfaqëson mbi 25% deri më 80% të shpenzimeve të miratuara, në të cilin përfshihen 13 bashki.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

Nga auditimi rezulton se në Raportin e hartuar nga Drejtoria e Financave Vendore për statusin e vështirësive të financave vendore, nuk është analizuar gjendja financiare për 61 bashki por për 58 bashki. Nuk është përfshirë në llogaritjen e gjendjes financiare vlera e borxhit afatgjatë që kanë bashkitë. Në llogaritjen e gjendjes financiare raporti është hartuar duke u bazuar në vetë deklarinimin e bashkive në lidhje me detyrimet e prapambetura dhe jo në vlerën e detyrimeve të kontabilizuara dhe të raportuar në llogarinë 486 të thesari. Edhe këtë vit konstatohet se ka diferenca midis detyrimeve të prapambetura të vetë deklaruara dhe detyrimeve të prapambetura të kontabilizuara dhe të raportuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Grupi i auditimit, bazuar në testimet e kryera konstaton se më problematike paraqitet gjendja dhe situata financiare për bashkinë Kavajë dhe për bashkinë Vorë. Bashkia Kavajë gjatë vitit 2020 ka planifikuar të shpenzojë 1,110,851 mijë lekë, ndërkohë që realizimi faktik është në vlerën 709,819 mijë lekë ose **64%** dhe detyrimet e prapambetura vlerësohen të jenë të paktën 767,705 mijë lekë. N.q.s. gjendja financiare e Bashkisë Kavajë do të vlerësohej mbi bazën e shpenzimeve faktike të realizuara, raporti i detyrimeve të prapambetura me shpenzimet faktike do të ishte rreth 120,5% dhe kjo bashki do të klasifikohet me probleme serioze financiare.

Gjithashtu, Bashkia Vorë gjatë vitit 2020 ka planifikuar të shpenzojë 939,859 mijë lekë, ndërkohë që realizimi faktik është në vlerën 343,703 mijë lekë ose **37%** dhe detyrimet e prapambetura vlerësohen të jenë të paktën 702,600 mijë lekë. N.q.s. gjendja financiare e Bashkisë Vorë do të vlerësohej mbi bazën e shpenzimeve faktike të realizuara, raporti i detyrimeve të prapambetura me shpenzimet faktike do të ishte rreth 204% dhe kjo bashki do të klasifikohet pa aftësi paguesve.

Sa më sipër për veprime dhe mosveprime ngarkohen me strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Buxhetit Vendor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si strukturat përgjegjëse për hartimin e planeve sipas ligjit të buxhetit të vitit dhe akteve normative në zbatim të tij përkatëse.

Gjetja:	Nga auditimi mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Financave Vendore në lidhje me menaxhimin dhe monitormin e procesit të hartimit dhe zbatimit të Buxhetit Vendor, u konstatua se, edhe për këtë vit nuk janë respektuar kërkesat e Ligjit Organik të Buxhetit dhe Ligjit për Vetëqeverisjen Vendore në lidhje me të drejtën e pushtetit vendor për të shpenzuar.
Situata:	Nga auditimi në lidhje me procesin e menaxhimit të financave publike në nivel vendor u konstatua se në fillim të vitit 2020, njësitë e qeverisjes vendore kanë trashëguar fonde të papërdorura në vitin 2019, në vlerën 11,038 milionë lekë nga të cilat 10,758 milion lekë i përkasin bashkive dhe 280 milionë lekë qarqeve. Në mbyllje të vitit 2020, të ardhurat e pa përdorura dhe të trashëguara për vitin 2021, në total janë 19,910 milionë lekë, të cilat përfaqësojnë 39% të të ardhurave totale faktike të vitit 2020. Në totalin e fondeve të trashëguara për vitin 2021, janë të përfshira edhe fondet e papërdorura të akorduara për rindërtimin në vlerën 6,524 milionë lekë . Nga auditimi rezulton se të ardhurat e trashëguara për vitin 2021 kanë diferencë prej 3,813 milionë lekë me vlerën e të ardhurave që duhet të ishte trashëguar realisht. Në total për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore raportohet se janë trashëguar 19,910 milion lekë, ndërkohë sipas testeve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE
EKONOMISË

	<p>të kryera nga grupi i auditimit duhet të ishin trashëguar 16,097 milion lekë. Për sa i përket raportimit të detyrimeve të prapambetura, në fund të vitit 2020, referuar raportit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale si dhe raportit vjetor për financat publike vendore 2020, stoku i detyrimeve të prapambetura për njësitë e vetëqeverisjes vendore në fund të muajit dhjetor 2020, raportohet rreth 6,931 milionë lekë. Sipas të dhënave të dërguara nga Drejtoria e Financave Vendore dhe tabelave bashkëlidhur raporteve të mësipërme stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2020, për 61 bashki dhe 12 qarqe rezultojnë të jetë rreth 7,059 milion lekë. Sipas të dhënave të thesarit në llogarinë 4864, totali i detyrimeve të prapambetura për njësitë e qeverisjes vendore është 7,212 milion lekë, duke reflektuar diferencë në vlerën 153 milion lekë me vlerën totale të detyrimeve të njësisve të qeverisjes vendore të raportuar dhe publikuar nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Rezultoni se diferenca në raportim krijohet kryesisht nga detyrimet e prapambetura të Ujësjellës-Kanalizime Krujë dhe Ujësjellës-Kanalizime Rrëshen.</p> <p>Nëse do të vlerësohej situata e stokut të detyrimeve të bashkive (6,931 milion lekë), përkundrajt të ardhurave të pa përdorura të cilat trashëgohen në vitin buxhetor pasardhës prej 19,562 milion lekë referuar të dhënave të MFE-së, kjo vlerë është afërsisht tre herë më e madhe se vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura të deklaruara dhe që nëpërmjet një planifikimi të drejtë do të përdoret për uljen e këtij stoku dhe përmirësimin e gjendjes financiare të qeverisjes vendore.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë; Ligji nr. 139/2015 për vetëqeverisjen vendore, Udhëzimi nr. 26, datë 27.09.2019 për procedurën për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore.
Impakti:	Krijimi i detyrimeve të prapambetura dhe vështirësi financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore.
Shkaku:	Mosrespektimi i legjislacionit dhe mosfunksionimi i hallkave të kontrollit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë-Drejtoria e Financave Vendore, në rolin e mbikëqyrësit financiar të veprimtarisë të njësisve të qeverisjes vendore, duhet të marrë të gjithë masat e nevojshme për monitorimin e shpërndarjes së planit buxhetor të njësisve të qeverisjes vendore sipas prioritetëve me qëllim shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja, duke përfshirë planifikimin sipas prioritetëve si të fondeve të trashëguara nga transfertat e pakushtëzuar edhe të fondeve të veta.
Gjetja:	Në Raportin e hartuar nga Drejtoria e Financave Vendore për statusin e vështirësive të financave vendore, nuk është analizuar gjendja financiare për 61 bashki por për 56 bashki. Nuk është përfshirë në llogaritjen e gjendjes financiare vlera e borxhit afatgjatë si dhe për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCIVE DHE
EKONOMISË

	<p>Ilogaritjen e gjendjes financiare, raporti është hartuar duke u bazuar në vetë deklarin e bashkive në lidhje me detyrimet e prapambetura dhe jo në vlerën e detyrimeve të kontabilizuara dhe të raportuar në llogarinë 486 të thesari</p>
Situata:	<p>Drejtoria e Financave Vendore, në lidhje me statusin e gjendjes financiare të njësisve të qeverisjes vendore ka hartuar Raportin mbi statusin e vështirësive financiare, ku është analizuar gjendja financiare e 58 bashkive, duke u bazuar në vetë deklarin e tyre. Sipas këtij raporti, 37 bashki janë klasifikuar òpa probleme financiare, 11 bashkia janë klasifikuar òme probleme financiare dhe 10 bashki janë klasifikuar ònë vështirësi financiare. Rezulton se në Raportin e hartuar nga Drejtoria e Financave Vendore për statusin e vështirësive të financave vendore, nuk është analizuar gjendja financiare për 61 bashki por për 58 bashki. Gjithashtu, konstatohet se llogaritja e gjendjes financiare të paraqitura në këtë raport është hartuar duke u bazuar në vetë deklarin e bashkive në lidhje me vlerën e detyrimeve të prapambetura dhe jo në vlerën e detyrimeve të kontabilizuar dhe të raportuar në llogarinë 486 të thesari për çdo bashki, si dhe nuk është përfshirë vlera e borxhit afatgjatë për njësitë e qeverisjes vendore.</p> <p>Nga auditimi i të dhënave të Drejtorisë së Financave Vendore për vlerën totale të shpenzimeve të miratuara, të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik për borxhin afatgjatë të bashkive si dhe në të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit për detyrimet e prapambetura, grupi i auditimit ka vlerësuar situatën financiare të njësisve të qeverisjes vendore në përputhje me kërkesat e neneve 55, 56, 57 të Ligjit nr. 68/2017 òPër financat e qeverisjes vendore si dhe në kërkesat e udhëzimit nr. 26, datë 27.09.2019 òProcedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Kështu, nga auditimi rezulton se 38 bashki klasifikohen òpa probleme Financiare, 10 bashki me òProbleme Financiare dhe 13 bashki klasifikohen me òVështirësi financiare.</p> <p>Referuar metodologjisë së përcaktuar në bazën ligjore të mësipërme, gjendja financiare e njësisve të qeverisjes vendore llogaritet përkundrejt shpenzimeve të miratuara. Nga auditimi ka rezultuar se njësitë e qeverisjes vendore të cilat paraqiten me probleme financiare kanë realizim faktik të shpenzimeve shumë më të ulët krahasuar me shpenzimet e miratuara. Konkretisht, nga auditimi rezulton se më problematike paraqitet gjendja dhe situata financiare për bashkinë Kavajë dhe për bashkinë Vorë. Bashkia Kavajë gjatë vitit 2020 ka planifikuar të shpenzojë 1,110,851 mijë lekë, ndërkohë që realizimi faktik është në vlerën 709,819 mijë lekë ose 64%. N.q.s. gjendja financiare e bashkisë Kavajë do të vlerësohej mbi bazën e shpenzimeve faktike të realizuara, raporti i detyrimeve të prapambetura me shpenzimet faktike do të ishte rreth 120.5% dhe kjo bashki do të klasifikohet me probleme serioze financiare. Gjithashtu, bashkia Vorë gjatë vitit 2020 ka planifikuar të shpenzojë 939,859 mijë lekë, ndërkohë që realizimi faktik është në vlerën 343,703 mijë lekë ose 37%. N.q.s. gjendja financiare e bashkisë Vorë do të vlerësohej mbi bazën e shpenzimeve</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCIVE DHE
EKONOMISË

	<p>faktike të realizuara, raporti i detyrimeve të prapambetura me shpenzimet faktike do të ishte rreth 204% dhe kjo bashki do të klasifikohet pa aftësi paguesve.</p> <p>Sipas të dhënave të MFE-së, totali i shpenzimeve të miratuara është në vlerën 68,955 milion lekë ndërsa totali i shpenzimeve faktike të njësisve të qeverisjes vendore rezulton të jetë 50,991 milion lekë. Kundrejt totalit të shpenzimeve faktike të 61 bashkive, stoku i detyrimeve paraqitet në masën 14.7% të totalit, ndërsa kundrejt shpenzimeve të miratuar stoku i detyrimeve është në masën 10.3%. Vlerat e ulëta të realizimit faktik të shpenzimeve, tregojnë jo vetëm për një planifikimin të dobët nga ana e njësisve të qeverisjes vendore por këto vlera ndikojnë edhe në mos paraqitjen e drejtë të gjendjes financiare reale të njësisve të qeverisjes vendore.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ÷Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë; Ligji nr. 139/2015 ÷Për vetëqeverisjen vendore; Udhëzimi nr. 26, datë 27.09.2019 ÷Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore.
Impakti:	Vështirësi financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore.
Shkaku:	Planifikim buxhetor i dobët, krijimi i detyrimeve të reja si dhe nivel i lartë i stokut të detyrimeve të prapambetura.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në rolin e mbikëqyrësit financiar të veprimtarisë të njësisve të qeverisjes vendore, të analizojë situatën për të gjitha ato bashki të cilat paraqiten në ÷vështirësi financiare dhe ÷vështirësi serioze financiare me qëllim hartimin e një plani veprimi për daljen nga situata e krijuar.

Në lidhje me konstatimet e grupit të auditimit është dërguar observacioni nr. 8595/33, datë 30.09.2021, protokolluar në KLSH me nr. 514/21, datë 01.10.2021 nga Drejtoria e Financave Vendore, ku cituar se:

Përsa i përket problematikave të konstatuar në lidhje me raportimin e të ardhurave të papërdorura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat trashëgohen në vitin buxhetor pasardhës, ju kemi sqaruar dhe më parë që duhet të konstatohen më Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit. Informacioni i paraqitur mbi trashëgimin nga SIFQ vjen si rrjedhim i akt rakordimeve zyrtare në fund vit ndërmjet degëve të thesarit përkatës dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore. Evidentimi i vlerave të sakta të fondeve të trashëguara nga një vit më parë është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e njësisve të qeverisjes vendore dhe degëve të thesarit.

Në lidhje me diferencën në vlerën 16 milion lekë, sqarojmë se Drejtoria e Financave Vendore ka përdorur informacionin e dërguar nga njësitë vendore për hartimin e raportit të gjendjes financiare, ju bëjmë me dije se udhëzimi i ri është miratuar në muajin tetor 2020. Përgjatë vitit 2020 njësitë kanë raportuar mbi formatet e përcaktuara në udhëzimin vjetor të zbatimit të buxhetit. Për këtë arsye deri në konsolidimin e plotë të të dhënave për detyrimet nga sistemi i thesarit, raporti i gjendjes financiare për vitin 2020, është realizuar duke u bazuar te raportimet e dërguara nga njësitë vendore. Në vijim për të vlerësuar gjendjen financiare të njësisve të qeverisjes vendore datë përdoren të dhënat e konsoliduar të gjeneruara nga sistemi i thesarit. Në tabelën 4 të treguesve fiskal si pjesë e shpenzimeve për pushtetin vendor është planifikuar edhe zëri financim i



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCIVE DHE EKONOMISË

huaj në vlerën 1,000 milion lekë. Ndërkohë në raportin e të ardhurave të trashëguara të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, financimi i huaj evidentohet në kapitullin 02.

Në lidhjen me situatën financiare të bashkive dhe metodologjinë e përdorur, sqarojmë se metodologjia e përcaktimit nëse një njësi ka probleme financiare është e përcaktuara në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore” dhe udhëzimin nr. 26, datë 27.09.2019 “Procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e qeverisjes vendore”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi shqyrtoi observacionin arsyeton se, në lidhje me diferencën në vlerën 16 milion lekë, ashtu si është trajtuar edhe në projekt raport vjen si pasojë “Taksës vendore e ndikimit të infrastrukturës” e cila mbledhet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për të cilat Drejtoria e Financave Vendore nuk disponon informacion se cilat prej bashkive kanë përfituar dhe në çfarë vlere. Për sa i përket konstatimi të diferenca midis të ardhura të trashëguara dhe atyre që duhet të ishin trashëguar, në observacion nuk sillen fakte apo dokumentacion për të kundërshtuar konstatimin. Për sa i përket pretendimit se ka një metodologji për përcaktimin nëse një njësi është në vështirësi financiare, sqarojmë se grupi i auditimit në përlllogaritjet e kryera është bazuar po në këtë metodologji që ju citonin, konkretisht në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore” dhe udhëzimin nr. 26, datë 27.09.2019 “Procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e qeverisjes vendore”.

7. Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit të shtetit. Monitorimi dhe analiza e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, dhënia e rekomandimeve, për të gjithë strukturën programore të çdo ministrie linje/institucion qendror.

7.1 Vlerësimi i projekteve të investimeve, monitorimi dhe raportimi i tyre me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura.

Investimet kapitale për vitin 2020 sipas raportimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në treguesit fiskalë të konsoliduar, janë realizuar në shumën 85,309 milion lekë (pa përfshirë fondin e shpronësimeve të realizuar në shumën 200 milion lekë) nga 89,337 milion lekë të planifikuara sipas Aktit Normativ nr. 34 datë 16.12.2020, duke u paraqitur me një mosrealizim në shumën 4,028 milion lekë ndikuar kryesisht nga mos realizimi i financimit të huaj me 2,962 milion lekë dhe mos realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm 1,106 milion lekë. Planifikimi fillestar, ndryshimet gjatë vitit dhe realizimi faktik paraqiten në tabelën e mëposhtme:

EMERTIMI	Projekt Buxheti 2020	Ligji nr.88/2019	A.N.6	A.N.15	A.N.28	A.N.34	Fakt
Shpenzime Kapitale	83,841	81,639	80,839	75,950	87,837	89,337	85,309
Financimi Brendshëm	50,123	51,321	50,521	46,266	59,153	60,653	59,547
Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë	1,200	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000	1,040
Financimi Huaj	32,518	29,318	29,318	28,684	27,684	27,684	24,722

Krahasuar me planin fillestar të miratuar me ligjin nr.88/2019, shpenzimet kapitale janë realizuar më shumë për 3,670 milion lekë, duke qenë se gjatë vitit 2020 është rritur vlera e shpenzimeve kapitale me efektin më të madh sipas shtesës së planit të bërë me aktin normativ nr. 28/2020 ku plani është shtuar me 11,887 milion lekë. Krahasuar me një vit më parë, këto investime janë rritur me 10,316 milion lekë, sipas realizimit faktik në shumën 74,993 milion lekë për vitin 2019 dhe 85,309 milion lekë për vitin 2020.




KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm raportohet në shumën 59,547 milion lekë nga 60,653 milion lekë të planifikuara sipas Aktit Normativ nr. 34 datë 16.12.2020 dhe investimet kapitale me burim financimi të ardhurat e veta të arsimit të lartë raportohen në shumën 1,040 milion lekë nga 1,000 lekë sipas planit të paraqitur më Aktin Normativ nr. 34 datë 16.12.2020. Realizimi faktik i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm duke përfshirë edhe ato me burim financimi të ardhurat nga arsimit të lartë paraqitet në shumën 60,587 milion lekë, krahasuar me vitet e kaluara në tabelën e mëposhtme:

Emërtimi	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Kapitale Financim i brendshëm	38,133	39,118	46,177	52,225	51,531	60,587
Dif. nga viti i mëparshëm		985	7,059	6,048	-694	9,056
Dif. në % nga një vit më parë		2.58%	18.05%	13.10%	-1.33%	17.57%

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm është përqëndruar kryesisht në muajin dhjetor ku janë realizuar rreth 29% e shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, paraqitur në grafikun e mëposhtëm:



A.1. Nga auditimi i investimeve kapitale me financim të brendshëm të realizuara nga të ardhurat dytësore, për vitin 2020 të regjistruara në SIFQ, konstatohet se janë realizuar investime kapitale me financim të brendshëm në vlerën 309,151,847 lekë, nga të ardhurat dytësore (kapitulli 6), të cilat nuk kanë plan buxheti të miratuar, ndërkohë që në Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar realizimi i tyre konsiderohet si një realizim ndaj planit të buxhetit. Tabela në vijim paraqet vlerën e investimeve kapitale me financim të brendshëm të realizuara nga të ardhurat dytësore të institucioneve buxhetore për të cilat nuk ka plan buxhetor të miratuar:

Në lekë

Insitucioni	Programi buxhetor	Vlera e realizuar
Ministria e Infrastruktues dhe Energjise	Mbeshtetje per Burimet Natyrore	2,391,301
Ministria e Financave dhe Ekonomise	Menaxhimi i te Ardhurave Doganore	3,395,212
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	510,000
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	1,351,860
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise	Fonde per Shkencen	21,048,247
Ministria e Kultures	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	387,223
Ministria e Kultures	Trashegimia Kulturore dhe Muzete	950,159
Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	7,264,472
Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale	Sherbimet e Kujdesit Dytesor	210,972,684
Ministria e Drejtises	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	393,600
Ministria e Brendshme	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	3,275,740
Ministria e Brendshme	Policia e Shtetit	248,640
Ministria e Mbrojtjes	Forca e Luftimit	860,000
Ministria e Mbrojtjes	Mbeshtetja e Luftimit	20,761,320
Ministria e Mbrojtjes	Mbeshtetje per Shendetesine	3,944,402
Këshilli I Lartë I Gjyqësor	Buxheti Gjyqësor	3,320,339
Instituti Statistikes	Veprimtaria Statistikore	21,347,543



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Avokati i Popullit	Sherbimi i Avokatise	380,400
Institucione te tjera Qeveritare	Sherbimi per Diasporen	5,449,306
Komisioneri për te Drejten e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	899,400
Totali		309,151,847

A.2. Investimet kapitale me financim të brendshëm me burim financimi të ardhurat nga arsimit i lartë, referuar tabelës së treguesve të konsoliduar fiskalë janë realizuar në masën 1,040 milion lekë. Nga auditimi u konstatua se, këto investime janë kategorizuar në llogarinë 230 ÷Investime Kapitale Të Pa Trupëzuara÷ në vlerën për 8,963,762 lekë dhe në llogarinë 231 ÷Investime Kapitale Të Trupëzuara÷ në vlerën për 1,031,349,524 lekë. Nga auditimi u konstatua se janë kontabilizuar në llogarinë 231 **“Investime Kapitale Të Trupëzuara” 13 projekte** investimi me vlerë **192,670,185 lekë** me përshkrimin ÷Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve÷ dhe 1 projekt investimi në shumën 976,920 lekë me përshkrimin ÷IAL dhe programe studimi të akredituara. Gjithashtu konstatohet se në investimet e realizuara nga të ardhurat e veta të arsimit të lartë është përdorur i njëjti kod projekti investimi për disa insitucione të arsimit të latë, duke mos identifikuar specifikisht investimet e kryera nga në nivel produkti. Të paraqitura në mënyrë të përmbledhur, këto grupime të investimeve pavarësisht institucionit të arsimit të lartë që i ka ekzekutuar paraqiten në lekë:

Kod projekti	Pershkrimi I projekt investimit	Shuma
A000001	Orendi, Pajisje te ndryshme (Kap.6)	237,363,180
A000002	Trajnime dhe Studim/Projektme(kap.6)	9,808,406
A000003	Rikonstruksione(kap.6)	536,181,046
A000005	Mallra e sherbime(kap.6)	791,900
A000007	Ndertime(kap.6)	4,842,389
Totali		788,986,921

A.3. Nga auditimi në lidhje me kontratat e nënshkruara për investimet përgjatë vitit 2020, sipas modulit të kontratave në SIFQ konstatohet se janë nënshkruar kontrata pas datës 15 Tetor për investimet publike, duke qenë jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 ÷Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ku citohet *“Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndër marrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor”*. Institucionet më përfaqësuese në nivel ministri linje sipas klasifikimit në modulën e kontratave në SIFQ paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Institucioni	Shuma e kontraktuar per 2020	Shuma e kontraktuar ne total
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	1,906,074,503	10,179,658,722
Ministria e Infrastruktures dhe Energjise	1,561,825,885	7,819,806,479
Ministria e Kultures	149,225,595	1,361,443,831
Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	348,140,150	1,144,662,502
Institucione te tjera Qeveritare	114,918,648	983,946,315
Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale	315,815,046	435,418,245
Ministria e Financave dhe Ekonomise	145,946,224	275,548,517
Ministria e Brendshme	147,887,550	236,760,946
Prokuroria e Pergjithshme	65,404,982	197,844,695
Totali	4,755,238,583	22,635,090,252

A.4. Nga auditimi mbi detajimin e fondeve për investimeve publike me financim të brendshëm të miratuara me ligjin nr.88/2019 ÷Për buxhetin e vitit 2020÷, të ndryshuar, konstatohen **19 projekte investimi me vlerë 683,809 mijë lekë** të cilat kanë përshkrimin **÷Fond i ngrirë÷**. Tabela në vijim paraqet vlerën e investimeve kapitale të detajuara me përshkrimin **÷Fond i Ngrirë÷**, për cdo institucion buxhetor sipas programit buxhetor përkatës.

Institucioni	Programi	Shuma e buxhetuar
Aparati Ministrise se Bujqesise	Planifikimi, Menaxhimi d	21,000,000
Aparati Ministrise se Bujqesise	Menaxhimi i infrastruktu	137,408,636
Aparati Ministrise se Bujqesise	Mbeshtetje per Peshkimin	90,000,000



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Agjensia Kombetare e duhaneve (3)	Zhvillimi Rural duke mbe	200,000
Instituti I Sigurise Ushqimore d	Siguria ushqimore dhe mb	86,800,000
Aparati i Ministrise se Infrastr	Mbeshtetje per Energjine	8,800,000
Autoriteti Rrugor Shqiptar (3535)	Transporti Rrugor	156,640,000
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit	Mbeshtetje e zhvillimit	500,000
Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)	Mbeshtetje e zhvillimit	2,960,000
Inspektoriati Shtetëror i Mbikqy	Mbeshtetje per Mbikqyrje	1,000,000
Aparati Ministrise Arsimit e Shk	Arsimi Baze (perfshire p	20,000,000
Aparati Ministrise Arsimit e Shk	Arsimi i mesem (i pergji	20,000,000
Perfaqsite Diplomatike (3535)	Sherbime te Pergj. Publi	3,000,000
Aparati prokurorise se pergjithe	Planifikimi, Menaxhimi d	58,712,600
Prokuroria e Posaçme Kundër Korr	Veprimtaria e SPAK	19,400,000
Fondi i Zhvillimit Shqiptar (353)	Programe Zhvillimi	20,000,000
Autoriteti Shtetëror per Informa	Sherbime te Pergjithshme	7,800,000
Bashkia Tirana (3535)	Arsimi Baze (perfshire p	28,000,000
Bashkia Korce (1515)	Arsimi Baze (perfshire p	1,588,143
Totali		683,809,379

Detajimi i këtyre fondeve të ngrira për investime kapitale nuk është në përputhje me përcaktimet e bëra për përkufizimin e projektit të investimit publik ku citohet se *“Projekt investimi” është një seri punimesh, aktivitetesh apo shërbimesh, që synojnë të përmbushin një objektiv të pandashëm të një natyre specifike ekonomike apo teknike, me qëllime gartësisht të identifikuar.* Rezervimi i fondeve të këtyre investimeve sipas detajimit fillestar nuk krijon mundësinë e zhvillimit të procedurave për prokurimin përgjatë vitit apo kryerjen e pagesave në rast të detyrimeve të mbartura dhe në vijim kryhen rishpërndarje ndërmjet projekteve për çdo njësi shpenzuese. Në fund të vitit, sipas planit përfundimtar, vlera e këtyre projekteve paraqitet në shumën 10,448 mijë lekë. Detajimi i këtyre fondeve pa projekt specifik në çeljen fillestare në shumën 683,809,379 lekë nuk është në përputhje me kërkesat e udhëzimit plotësues nr. 2 datë 20.01.2020 të MFE, pika 19, ku janë të parashikuara kriteret dhe përparësitë në financimin e projekteve dhe nuk parashikohet celja e fondeve të ngrira për investimet kapitale të miratuara.

A.5 Referuar të dhënave të SIFQ, konstatohet se, janë paguar **detyrime të prapambetura** në vlerën **6,395,945 mijë lekë** të cilat përfaqësojnë **11%** të **Investimeve Kapitale me Financim të Brendshëm të realizuara** për vitin 2020. Tabela në vijim paraqet vlerën e detyrimeve të prapambetura të ndara sipas institucioneve dhe viteve të krijuara.

Insitucioni	Shuma e paguar
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	661,607,565
Institucione te tjera Qeveritare	696,872,236
Instituti Statistikes	838,315
Kuvendi	37,153,500
Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinise	612,671,928
Ministria e Brendshme	16,720,297
Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	90,047,520
Ministria e Drejtësisë	154,852,129
Ministria e Financave dhe Ekonomise	69,946,255
Ministria e Infrastruktures dhe Energjise	3,818,542,206
Ministria e Kultures	266,957
Ministria e Mbrojtjes	91,760,492
Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale	126,656,510
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	18,009,448
Totali	6,395,945,358

A.6. Nga auditimi i realizimit të investimeve me financim të brendshëm konstatohet se raportohet **si investim i realizuar** në vitin 2020, projekti i investimit me kod M062991 me përshkrim *“Vendime gjyqësore në proces”* me vlerë për **446,613,713 lekë** i **Autoritetit Rrugor Shqiptar**. Nga auditimi konstatohet se, vlera për **396,907,038 lekë**, përfaqëson **detyrime të prapambetura** të periudhave 2014-2019 sipas datës së paraqitur në sistemin informatik financiar të qeverisë:

Viti I detyrimit	Shuma
2014	7,158,680
2015	41,379
2016	8,048,173
2017	6,480,297



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

2018	280,556,404
2019	94,622,105
2020	49,706,675
Totali	446,613,713

B. Mbi problematikat e konstatuara në detajimin, rialokimet, faktin dhe monitorimin e investimeve kapitale me financim të brendshëm.

B.1. Nga auditimi konstatohet se në listën e investimeve të derguar nga Drejtoria e Investimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit është paraqitur i planifikuar dhe realizuar në shumën 198,000,000 lekë projekti 18AV703 “Pagesa ndërkombëtare në institucione financiare të tjera”, në programin 1130 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Nga paraqitja e këtij investimi në databazën e pagesave në SIFQ konstatohet se janë kryer pagesa duke përdorur llogarinë e lëshimit të garancive me përfitues Korporatën Shqiptare të Investimeve me kod llogarie ekonomike 466213 “Garanci te vitit vazhdim per sigurimin e kontrates, te dala” me datë furnitori 31.12.2020 me përshkrimin “Min.Fin.Kalim fond.Ngurtes.llogarine e shoq.Korpor.Invest.Shqiptare,Urdher nr. 174/1, dt. 31.12.20, nr. 13617/1 prot, rrit. autoriz. D.Thesar Tirane nr. 777, dt. 31.12.2020, urdh nr. 174, dt. 16.07.20, nr. 13617 prot, status I shoqerise.”. Kjo pagesë është kryer me kod projekti A000005 òMallra e shërbime(kap.6)ö, në shumën 197,802,262 lekë ndërkohë që pjesa tjetër është kryer me kod projekt 18AV703 òPagesa nderkombetare ne institucione financiare te tjeraö në shumën 197,738 lekë. Konstatohet se për kryerjen e kësaj pagese janë përdorur llogaritë e garancisë së vitit në vazhdim, ndërkohë që sipas informacioneve mbi investimet kapitale të dërguara nga Drejtoria e Investimeve kjo pagesë rezultojnë të planifikuar dhe realizuar nga llogaritë e investimeve. Për këtë arsye, vlera prej 197,802,262 lekë nuk rezultojnë të jetë e pasqyruar në treguesit fiskalë në investimet kapitale sipas miratimit të saj nga drejtoria e investimeve, duke nënvlersuar këtë tregues në publikim.

B.2. Mbi marrjen e angazhimeve buxhetore, rishpërndarjet e fondeve të investimit dhe realizimin për programet buxhetore të audituara:

Nga audimi mbi detajimin dhe rishpërndarjen e fondeve të investimeve në projekte investimi përgjatë vitit janë konstatuar problematika që përfshijnë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore në dispozicion, detajimin e projekteve të investimeve publike me akt normativ pa kaluar në PBA 2020-2022, detajimin e fondeve të investimeve për vetëm vlerën e 20% të kostos së projektit pa buxhet në vitet pasardhëse buxhetore, detajimin e planit buxhetor në 3 vite për investime që përfshijnë periudhë faturimi për kontrata që parashikojnë periudhë faturimi më të vogël se një vit, shkurtimin e fondeve të investimit në momentin e lidhjes së kontratës dhe rialokimin e këtyre fondeve drejt projekteve të tjera të investimit publik detyrime të prapambetura apo në proces nga vitet e kaluara, mosregjistrimin e kontratave dhe rrjedhimisht mos regjistrimin e obligimit në SIFQ duke lejuar ndërmarrjen e angazhimeve buxhetore dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura. Këto veprime janë legjimituar nga miratimi i dhënë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në detajimin fillestar të fondeve të investimit apo rialokimet e kryera përgjatë vitit. Të analizuara sipas programeve buxhetore dhe institucioneve përkatëse ku janë konstatuar problematikat paraqiten:

B.2.1. Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Kodi 56, Programi buxhetor 6210 òPrograme Zhvillimiö dhe Programi buxhetor 4230 òProgrami 100 fshatrato.

Planifikimi me ligjin nr. 88/2019 òPër buxhetin e vitit 2020ö dhe ndryshimet përgatë vitit të planit të investimeve me financim të brendshëm paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Kodi	Emertimi i Programit	Ligji 88/2019	A.N.6	A.N.15	A.N.28	A.N.34
		Financim i Brendshem	Financim i Brendshem	Financim i Brendshem	Financim i Brendshem	Financim i Brendshem



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

06210	Programe Zhvillimi	4,496,000	4,496,000	4,496,000	7,496,000	6,196,000
-------	--------------------	-----------	-----------	-----------	-----------	-----------

Nga auditimi konstatohet se ky program buxhetor me Aktin Normativ nr. 28/2020 ka pësuar ndryshim në rritje në shumën 3 miliard lekë ndërkohë që me Aktin Normativ nr. 34/2020 fondet e investimeve në këtë program janë ulur me 1.3 miliard lekë. Sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 88/2019 të ndryshuar, ky program buxhetor është përdorur gjatë vitit 2020 për planifikimin dhe realizimin e investimeve për procesin e rindërtimit, ku rast pas rasti me Vendim të Këshillit të Ministrave janë detajuar fonde për Fondin Shqiptar të Zhvillimit për rindërtimin e objekteve të dëmtuara nga tërmeti. Efekti i VKM-ve të dala në funksion të procesit të rindërtimit me përfitues FSHZH nuk është pasqyruar në tabelën nr.1 të ligjit të buxhetit ku pasqyrohet buxheti i miratuar me programe sipas institucioneve, sipas miratimit të kryer nga parlamenti. Analiza mbi projektet e investimit të audituara për këtë program në vijim paraqitet e ndarë për projekte rindërtimi dhe projekte të tjera jo rindërtimit.

B.2.1.1. Mbi investimet nga programi buxhetor 6210 jo për rindërtimin.

Nga auditimi konstatohet se me Aktin Normativ 28/2020, fondet e shtuara për investimet kapitale me financim të brendshëm kanë shkuar për hapjen e 21 projekteve të reja investimi të cilët nuk kanë kaluar ciklin e menaxhimit të investimeve publike në PBA 2020-2022 dhe për këto projekte është detajuar vetëm vlera e parashikuar për vitin 2020 në fillim në shumën 3 miliard lekë shtesë. Sipas shkresës së MFE nr. 12507/97 datë 03.08.2020 është miratuar transferimi i fondeve sipas kërkesës së FSHZH me nr. 1453/3 datë 27.07.2020, duke miratuar 21 projektet e reja të investimit në shumën 3 miliardë financim për vitin 2020. Nga auditimi konstatohet se buxheti për vitin 2021 për këto projekte paraqitet në shumën 6,993,522,273 lekë sipas shkresë nr. 3272 datë 17.12.2020 të FSHZH e cila është miratuar nga MFE, si pasojë e diferencës ndërmjet vlerës së plotë të projektit me financimin për vitin 2020. Miratimi i këtyre projekteve me akt normativ është në kundërshtim me ligjin nr. 88/2019 për buxhetin e vitit 2020, i ndryshuar, ku plani i investimeve me financim të brendshëm për vitin pasardhës është në shumën 3.8 miliard lekë ndërkohë që vetëm efekti i projekteve të reja (pa marrë në konsideratë kontrata në vazhdim për investime) paraqitet në shumën 6,993,522,273 lekë, duke lejuar ndërmarrjen e angazhimeve përtej kufirit të miratuar nga parlamenti. Në mënyrë të detajuar, parregullsitë për këto projekte se bashku me ndryshimet e ndodhura përgjatë vitit trajtohen në vijim në lidhje me angazhimet e ndërmarrja.

Kod projekti	Emertimi	Korrik	Dhjetor	Fakti	Vlera e kontrates
18BN124	Riveshje Aksi Rrugor Cermë - Divjakë si dhe degëzimet për fshatrat: Grabian, Çermë, Shkumbin ç Bishçukas, Dushkucan - Hallvaxhias - Gërmenj i Madh	130,500,000	30,000,000	29,124,600	219,728,336
18BN125	Ndërtim , Asfaltim, Rrjeti inxhinierik, Rruga Nr.1, Lëkurës, Lot 1+2	138,740,033	60,405,692	54,978,960	228,123,179
18BN126	Rikonstruksion i Rrugës Miras-Arrëz	134,700,000	26,373,898	26,000,028	263,738,980
18BN127	Rikonstruksioni i Rrugës Camëria dhe i Unazës së qytetit, Kavajë	124,200,000	34,200,000	34,200,000	215,432,400
18BN128	Përmirësimi i shtresave asfaltike për rrugët në Rajonet 1,2 (Marrëveshje Kuadër)	210,000,000	53,399,549	48,224,556	387,876,000
18BN129	Përmirësimi i shtresave asfaltike për rrugët në Rajonet 3,4 (Marrëveshje Kuadër)	210,000,000	112,845,886	112,845,886	397,200,000
18BN130	Rehabilitimi i Rrugës Nivicë-Salari	75,000,000	50,000,000	50,000,000	138,161,510
18BN131	Rikonstruksioni i Rrugës nga kryqëzimi Dardhë-Arrëz deri në fshatin Nikolicë	90,000,000	30,000,000	29,526,420	150,817,032
18BN132	Asfaltim, Rruga Labinot-Fushë/Qafë Renas si dhe Rruga e re e varrezave Elbasan dhe ndërtimi i mbikalimit hekurudhor në kryqëzimin e Rrugës Nacionale Elbasan-Librazhd, me rrugën "Borodin Mitarja"	183,000,000	33,207,817	33,207,817	316,039,085
18BN133	Mbështetje për programin (Oponencë, Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh)	35,761,169	10,493,269	10,493,269	30,633,550
18BN225	Rehabilitimi i Lagjeve 4,5 dhe 6 të bashkisë Kukës	131,400,000	51,600,000	51,593,928	276,031,718
18BN226	Sistemi i Përrroit të Llixhave, Segmenti Ura e Pazarit-Llixha dhe Rikualifikim urban i zonës	82,200,000	20,117,950	20,004,382	150,281,750
18BN229	Rehabilitimi i Rrugëve, Shesheve dhe fasadave, Blloku tek Lagjia Nr.2, Pogradec	86,400,000	25,000,000	1,049,362	146,787,359



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

18BN230	Rikualifikimi Urban i Unazës së Re, Berat	240,000,000	67,000,000	66,999,992	408,044,036
18BN231	Rikonstruksioni i Fasadave të objekteve përgjatë Lumit Drin në qytetin e Lezhës, Blloku Nr.1 dhe Rruga Lalmiri, Naim Frashëri	81,000,000	14,806,701	14,806,701	148,067,013
18BN232	Rikualifikim urban i qendrës së qytetit dhe krijimi i hapësirës rekreative në zonën e liqenit artificial, Ballsh	91,200,000	28,612,384	27,999,960	177,985,249
18BN233	Rikualifikimi dhe sistemimi i Lumit Gjanica, Loti II, Fier	225,000,000	83,057,756	83,057,756	630,577,556
18BN234	Rikualifikimi urban pranë qendrës së qytetit Vlorë, Zona A drejtimi i kullës së Sahatit, Kulla e Sahatit dhe Sheshi i Flamurit	327,000,000	81,805,010	81,805,010	818,050,097
18BN235	Rikualifikim urban i zonës turistike, Golem	240,000,000	66,732,374	66,732,374	667,323,740
18BN227	Rikualifikim urban i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe Parkut për pushuesit	68,100,000	N/A	N/A	-
18BN228	Rikualifikim i qendrës së Corovodës (Faza II)	95,798,798	N/A	N/A	180,307,722
Totali		3,000,000,000	879,658,286	842,651,001	5,951,206,312

Në vijim për këto projekte, sipas kontratave të regjistruara në SIFQ, konstatohet se janë ndërmarrë angazhime në shumën 5,951 milion lekë për 20 prej tyre, megjithëse fondet në dispozicion në muajin dhjetor 2020 paraqiten në shumën 880 milion lekë, duke qenë se në muajin dhjetor janë shkurtuar fondet për këto projekte. Të analizuara disa nga projektet e audituara për të cilat jën paraqitur problematika përfshijnë:

- Projekti 18BN124 òRiveshje Aksi Rrugor Cermë - Divjakë si dhe degëzimet për fshatrat: Grabian, Çermë, Shkumbin, Bishçukas, Dushkucan - Hallvaxhias - Gërmenj i Madhë. Ky investim është detajuar në zbatim të Aktit Normativ nr. 28/2020 në shumën 130,500 mijë lekë dhe për vitin 2021 në shumën 304,500 mijë lekë, në total në shumën 435,000 mijë lekë. Fondet për këtë projekt investimi janë ulur në shumën 87 milion lekë në tetor dhe në shumën 30 milion lekë në Dhjetor 2020. Nga analiza e kontratave të regjistruara në SIFQ dhe në njoftimet e shpallura në Buletinin e Njofitmeve Publike konstatohet se kontrata është nënshkruar në shumën 219,728,336 lekë nga FSHZH, në 21.10.2020 me afat ekzekutimi 12 muaj. Nga auditimi konstatohet se angazhimi është ndërmarrë përtej afatit të datës 15 Tetor për ndërmarrjen e angazhimeve buxhetore sipas përcaktimit të bërë në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor, ndërkohë që plani i buxhetit sipas projektit buxhetit të vitit 2021 paraqitet në mijë lekë:

Viti i Fillimit	Viti përfundimit të financimit	Vlera Totale e projektit	Buxheti 2020 - PLAN	Propozim MFE 2021	Parashikimi për v.2022	Parashikimi për v.2023	Per tu paguar pas vitit 2023
2020	2023	392,300	130,500	60,900	40,000	100,000	174,000

Për këto arsye, miratimi i investimit dhe ndërmarrja e angazhimit është përtej kufijve të miratuar të financimit duke parashikuar mos shlyerjen e tij edhe brenda 3 viteve të zgjatjes së tij megjithëse kohëzgjatja e punimeve është vetëm 12 muaj.

-Projekti 18BN125 òNderetim , Asfaltim, Rrjeti inxhinierik, Rruga Nr.1, Lëkurës, Lot 1+2ö. Ky investim është detajuar në zbatim të Aktit Normativ nr. 28/2020 në shumën 138,740,033 lekë ndërkohë që për vitin 2021 në shumën 323,726,743 lekë, në total në shumën 462,466,776 lekë. Fondet për këtë projekt investimi janë ulur në shumën 92,493,355 lekë në tetor dhe në shumën 54,978,960 lekë në Dhjetor 2020. Nga analiza e kontratave të regjistruara në SIFQ dhe në njoftimet e shpallura në Buletinin e Njofitmeve Publike konstatohet se kontrata është nënshkruar në shumën 228,123,179 lekë nga FSHZH, në 19.11.2020 me afat ekzekutimi 12 muaj. Nga auditimi konstatohet se angazhimi është ndërmarrë përtej afatit të datës 15 Tetor për ndërmarrjen e angazhimeve buxhetore sipas përcaktimit të bërë në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor, ndërkohë që plani i buxhetit sipas projektit buxhetit të vitit 2021 paraqitet në mijë lekë:

Viti i Fillimit	Viti përfundimit të financimit	Vlera Totale e projektit	Buxheti 2020 - PLAN	Propozim MFE 2021	Parashikimi për v.2022	Parashikimi për v.2023	Per tu paguar pas vitit 2023
2020	2023	418,230	138,740	64,745	50,000	100,000	258,982

Për këto arsye, miratimi i investimit dhe ndërmarrja e angazhimit është përtej kufijve të miratuar të financimit duke parashikuar mos shlyerjen e tij edhe brenda 3 viteve të zgjatjes së tij megjithëse kohëzgjatja e punimeve është vetëm 12 muaj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

-Projekti 18BN126 òRikonstruksion i rrugës Miras Arrëzò. Ky investim është detajuar në zbatim të Aktit Normativ nr. 28/2020 në shumën 134,700,000 lekë ndërkohë që për vitin 2021 në shumën 314,700,000 lekë, në total në shumën 449,400,000 lekë. Fondet për këtë projekt investimi janë ulur në shumën 54,978,960 lekë në Dhjetor 2020. Nga analiza e kontratave të regjistruara në SIFQ dhe në njoftimet e shpallura në Buletinin e Njofitmeve Publike konstatohet se kontrata është nënshkruar në shumën 263,738,980 lekë, në 05.11.2020 me afat ekzekutimi 12 muaj. Nga auditimi konstatohet se angazhimi është ndërmarrë përtej afatit të datës 15 Tetor për ndërmarrjen e angazhimeve buxhetore sipas përcaktimit të bërë në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor, ndërkohë që plani i buxhetit sipas projektit buxhetit të vitit 2021 paraqitet në mijë lekë:

Viti i Fillimit	Viti përfundimit të financimit	Vlera Totale e projektit	Buxheti 2020 - PLAN	Propozim MFE 2021	Parashikimi për v.2022	Parashikimi për v.2023	Per tu paguar pas vitit 2023
2020	2023	410,708	134,700	62,860	50,288	100,000	251,440

Miratimi i investimit dhe ndërmarrja e angazhimit është përtej kufijve të miratuar të financimit duke parashikuar mos shlyerjen e tij edhe brenda 3 viteve të zgjatjes së tij megjithëse kohëzgjatja e punimeve është vetëm 12 muaj.

-Përveç projekteve të mësipërme të detajuara me aktin normativ nr.28/2020, në muajt Shtator dhe Tetor 2020, është miratuar rialokimi i projekteve të reja të investimit publik në programin 6210 të FSHZH, duke detajuar vetëm vlerën e 20% të projektit të investimit në vitin e parë dhe duke transferuar detyrimin për këto projekte në vitet e ardhshme buxhetore. Miratimi i këtyre investimeve të reja në këtë periudhë të vitit vetëm për vlerën prej 20% nuk është e mundur të realizohet duke qenë se koha është e shkurtër për prokurimin dhe kontraktimin e tyre dhe rrjedhimisht nuk përdoret vlera prej 20% në vitin e parë të kontraktimit, ndërkohë që edhe periudha e kohëzgjatjes së projektit nuk përputhet me periudhën në buxhetit të alokuar sipas viteve. Në mënyrë të detajuar, këto projekte paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Kod projekt i	Emertim projekti	Data kontrates	Kohëzgjatja e kontrates	Shtator	Tetor	Dhjetor	Kontrata
18BN134	Ndërtimi i By Pass-it të Gjirokastrës	24.11.2020	12 muaj	160,000,000	160,000,000	39,664,681	396,646,812
18BN135	Ndërtimi i Rrugës Burrel-Sheshaj	04.12.2020	9 muaj	52,000,000	52,000,000	13,353,913	133,539,133
18BN136	Rruga e Vendit të Shenjtë Mali i Tomorit, Loti 2	23.11.2020	12 muaj	160,000,000	160,000,000	131,657,369	369,662,630
18BN137	Rikualifikimi Urban dhe ndërtimi argjaturës për mbrojtjen nga Vjosa, Nj.A.Novoselë	04.12.2020	8 muaj	#N/A	171,062,819	53,067,008	530,670,803
Totali				372,000,000	543,062,819	237,743,043	1,430,519,378

Për këto projekte konstatohet se janë lidhur në kundërshtim me afatin e ndërmarrjes së angazhimeve në vitin buxhetor prej 15 tetorit, duke qenë se janë nënshkruar ndërmjet 23 Nëntor-04 Dhjetor. Pas nënshkrimit të kontratave, vlera e përcaktuar si buxhet 20% në vitin e parë është shkurtuar duke qenë se nuk ka mundësi reale për realizimin e saj për kohën e mbetur të vitit buxhetor përkatës, dhe në këtë mënyrë nuk respektohet as përcaktimi i bërë për pjesën e 20% të projektit në vitin e parë të ekzekutimit të tij.

Problematika për këto kontrata reflektohet edhe në projekt buxhetin e vitit 2021 në listën e investimeve publike, ku mungesa e përbalimit të angazhimeve të ndërmarrja/në proces ka sjellë përfshirjen e planit të buxhetit të tyre pas vitit 2023, jashtë periudhës në të cilën buxheti miratohet nga parlamenti. Në mënyrë të detajuar lista e këtyre projekteve me këtë problematikë, e evidentuar edhe më sipër sipas kontratave të nënshkruara paraqitet:

Emërtimi i Projektit	Vlera Totale e	Buxheti 2020 -	Propozim	Parashikimi për	Parashikimi për	Per tu
----------------------	----------------	----------------	----------	-----------------	-----------------	--------



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCËVE DHE EKONOMISË

	projektit	PLAN	MFE 2021	v.2022	v.2023	paguar pas vitit 2023
Sistemim, asfaltim i rruges Permet - Carshove	1,150,000	230,000	100,000	100,000	404,867	315,133
Nderhyrje e integruar per permiresimin e aksesit, sherbimeve dhe rikualifikimit urban ne Zonen e Plazhit-Divjake	500,000	99,847	40,000	30,000	200,000	130,153
Nderhyrje e integruar per permiresimin e aksesit, sherbimeve dhe rikualifikimit urban ne Zonen e Plazhit-Palase-Dryhmade	400,000	79,878	40,000	30,000	200,000	50,122
Nderhyrje e Integruar per permiresimin e aksesit, sherbimeve dhe atraksionit turistik ne zonën e Alpeve Shqiptare.	600,000	119,816	40,000	30,000	300,000	110,184
Nderhyrje e Integruar per permiresimin e aksesit, sherbimeve dhe atraksionit turistik ne zonën e Syrit te kalter	400,000	79,878	40,000	30,000	150,000	100,122
Rikualifikim urban i Bllokut ne qender te Kamzes	260,000	165,565	40,000	54,408	0	54,408
Rivitalizimi i rruges Andon Pofka dhe hapësirave perreth saj, Bashkia Fier	150,000	29,952	30,000	24,609	0	24,609
Rehabilitimi i sheshit Ahmet Zogu dhe parkut Geraldine ne Qytetin e Burrelit	81,957	41,824	30,000	10,132	0	10,132
Nderhyrje e integruar per permiresimin e konektivitetit dhe rikualifiim urban ne Bashkine e Kavajes	114,194	43,935	40,000	30,259	0	30,257
Rehabilitimi i Lagjeve 4,5 dhe 6 të bashkisë Kukës	399,040	131,400	61,320	45,000	100,000	245,280
Sistemim i Përroit të Llixhave, Segmenti Ura e Pazarit-Llixha dhe Rikualifikim urban i zonës	282,200	82,200	35,000	30,000	100,000	156,800
Rikualifikim urban i hyrjes së qytetit te Shkodrës dhe Parkut për pushuesit	225,446	38,100	31,173	25,000	100,000	127,728
Rikualifikim i qendrës së Corovodës (Faza II)	315,211	95,799	44,706	30,000	100,000	178,824
Rehabilitimi i Rrugëve, Shesheve dhe fasadave, Blloku tek Lagjia Nr.2, Pogradec	299,040	86,400	40,320	32,000	100,000	161,280
Rikualifikimi Urban i Unazës së Re, Berat	710,000	240,000	100,000	70,000	200,000	460,000
Riveshje Aksi Rrugor Cermë - Divjakë si dhe degëzimet për fshatrat: Grabian, Çermë, Shkumbin ó Bishçukas,Dushkucan - Hallvaxhias - Gërmenj i Madh	392,300	130,500	60,900	40,000	100,000	174,000
Rikonstruksioni i Fasadave të objekteve përgjatë Lumit Drin në qytetin e Lezhës, Blloku Nr.1 dhe Rruga Lalmiri, Naim Frashëri	286,600	81,000	37,800	30,000	100,000	151,200
Rikualifikim urban i qendrës së qytetit dhe krijimi i hapësirës rekreative në zonën e liqenit artificial, Ballsh	306,320	91,200	42,560	30,000	100,000	170,240
Ndërtim , Asfaltim, Rrjeti inxhinierik, Rruga Nr.1, Lëkurës, Lot 1+2	418,230	138,740	64,745	50,000	100,000	258,982
Rikualifikimi dhe sistemimi i Lumit Gjanica, Loti II, Fier	575,000	225,000	100,000	50,000	100,000	425,000
Rikualifikimi urban pranë qendrës së qytetit Vlorë, Zona A drejtimi i kullës së Sahatit, Kulla e Sahatit dhe Sheshi i Flamurit	727,000	327,000	100,000	100,000	100,000	663,000
Rikualifikim urban i zonës turistike, Golem	815,000	240,000	100,000	75,000	300,000	460,000
Rikonstruksion i Rrugës Miras-Arrëz	410,708	134,700	62,860	50,288	100,000	251,440
Rikonstruksioni i Rrugës Camëria dhe i Unazës së qytetit, Kavajë	385,120	124,200	57,960	45,000	100,000	231,840
Përmirësimi i shtresave asfaltike për rrugët në Rajonet 1,2 (Marrëveshje Kuadër)	676,000	210,000	98,000	70,000	200,000	392,000
Përmirësimi i shtresave asfaltike për rrugët në Rajonet 3,4 (Marrëveshje Kuadër)	684,400	210,000	98,000	78,400	200,000	392,000
Rehabilitimi i Rrugës Nivicë-Salari	273,000	75,000	35,000	28,000	100,000	140,000
Rikonstruksioni i Rrugës nga kryqëzimi Dardhë-Arrëz deri në fshatin Nikolicë	304,194	90,000	42,000	30,194	100,000	168,000
Asfaltim, Rruga Labinot-Fushë/Qafë Renas si dhe Rruga e re e varrezave Elbasan dhe ndërtimi i mbikalimit hekurudhor në kryqëzimin e Rrugës Nacionale Elbasan-Librazhd, me rrugën "Borodin Mitarja"	436,720	183,000	85,400	68,320	100,000	341,600

Për këto arsye konstatohet se janë ndërmarrë angazhime pa fonde buxhetore dhe miratimi i ndryshimeve në buxhet është kryer duke mos marrë në konsideratë menaxhimin trevjeçar të tyre, megjithëse shumica e kontratave të financuara parashikojnë kryerjen e punimeve brenda 12 muajve ndërkohë që plani i buxhetit shtrihet mbi tre vite, duke krijuar detyrime të prapambetura.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Mbi projektin e investimit për blerjen e godinës Poli i Drejtësisë.

-Projekti 19AF001 òBlerja e godinës Poli Drejtësisë. Nga auditimi konstatohet se për këtë projekt janë realizuar pagesa nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit në shumën 790,200,000 lekë me përfitues Ndërmarrja Industriale nr.1. Ky projekt nuk rezulton të jetë i planifikuar në investimet kapitale të miratuara në programin buxhetor 4230 òProgrami 100 fshatratò dhe programin buxhetor 6210 òPrograme zhvillimiò në Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Rishikimet e buxhetit në rritje për këto projekte janë realizuar në muajin Korrik duke rritur vlerën e buxhetit me 200 milion lekë në programin 4230 dhe 420.2 milion lekë në programin 6210 sipas VKM nr. 356 datë 26.02.2020, ndërkohë që në muajin Dhjetor 2020 është përdorur fondi rezervë i buxhetit të shtetit në shumën 170 milion lekë, veprim i pasqyruar në sistemin informatik financiar të qeverisë në 11.01.2021, sipas VKM nr. 1127 datë 30.12.2020. Konstatohet se çelja e fondeve buxhetore është kryer me rishikime ndërkohë që vlera e plotë e kontratës nuk është regjistruar në modulën e kontratave të vendosura në dispozicion nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Ky projekt investimi nuk rezulton të jetë i parashikuar në PBA 2020-2022 të Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe është lidhur kontrata e shitjes sipas përshkrimit të pagesës me nr. 180 Rep 75 kol dt 08.06.2020. Pra kontrata është lidhur përpara se të miratohej fondi përkatës për financimin e saj, pasi në VKM nr. 356 datë 26.02.2020 është përcaktuar vetëm pagesa e kështit nga dy programe të FSHZH pa specifikuar vlerën e buxhetuar.

B.2.1.2. Mbi investimet nga programi buxhetor 6210 për rindërtimin.

Sipas informacioneve të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Investimeve në lidhje me përdorimin e fondit të rindërtimit konstatohet se përdorimi i fondit të rindërtimit përgjatë vitit me destinacion kryerjen e investimeve paraqitet në shumën 10,451,538,347 lekë dhe realizim në shumën 7,120,407,518 lekë. Nga auditimi mbi të dhënat e publikuara në treguesit fiskalë të konsoliduar mbi investimet nga buxheti qendror me burim financimi fondin e rindërtimit, konstatohet se vlera e planit përfundimtar paraqitet në shumën 10,149,495,351 lekë ndërkohë që realizimi faktik paraqitet në shumën 6,818,364,522 lekë, duke paraqitur me diferenca paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Fondi i rindërtimit	Nga drejtoria e investimeve		Publikuar ne treguesit fiskale		
	Institucioni	Plani përfundimtar	Realizimi faktik	Plani përfundimtar	Realizimi faktik
Agjencia Kombetare e Planifikimit te Territorit		137,420,000	89,467,590	137,420,000	89,467,590
Agjencia Kombetare e Shoqerise se Informacionit		18,360,360	16,501,200	18,360,360	16,501,200
Autoriteti Rrugor Shqiptar		151,539,896	-	151,539,896	-
Fondi i Zhvillimit Shqiptar		9,907,591,022	6,824,263,928	9,605,548,026	6,522,220,932
Instituti Kombetar i Trashegimise Kulturore Tirane		236,627,069	190,174,800	236,627,069	190,174,800
Totali I investimeve me financim te brendshem		10,451,538,347	7,120,407,518	10,149,495,351	6,818,364,522

Nga përpunimi i të dhënave të vendosura në dispozicion konstatohet se diferenca vjen prej projektit M560322 òProjekti i rrugëve dytësore dhe lokale (kosto lokale)ò, i planifikuar dhe realizuar në shumën 302,042,996 lekë. Sipas shpjegimeve të Drejtorisë së Investimeve, ky projekt përbën koston e menaxhimit të projektit nga ana e FSHZH në nivelin e 3% të fondeve të investimeve që administrojnë për shkak të procesit të rindërtimit, megjithëse nuk është detajuar në një projekt investimi më vete, por është paraqitur në projekt investimi tjetër për rrugët dytësore. Nga totali i fondeve të investimeve në dispozicion sipas tabelës së mësipërme, vlerën më të lartë të buxhetuar dhe realizuar përgjatë vitit e ka FSHZH i cili në zbatim të VKM-ve respektive ka planifikuar dhe realizuar projektet e mëposhtme:

Kodi i projektit	Emertimi I Projektit	Plani përfundimtar	Realizimi faktik
19AD201	Rindërtimi i banesave individuale	5,137,671,726	3,267,506,730
19AD203	Rindërtimi i Objekteve Arsimore në zonat e prekura nga Termeti, Qarku Lezhë (Bashkia Kurbin dhe Lezhë)	444,865,289	309,706,000
19AD204	Rindërtimi i Objekteve Arsimore në zonat e prekura nga Termeti, Qarku Krujë(Bashkia Krujë)	442,297,664	215,429,547



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

19AD205	Rindërtimi i Objekteve Arsimore në zonat e prekura nga Termeti, Qarku Durrës(Bashkia Durrës1)	845,723,696	695,099,636
19AD206	Rindërtimi i Objekteve Arsimore në zonat e prekura nga Termeti, Qarku Durrës (Bashkia Durrës2)	850,692,969	631,596,146
19AD207	Rindërtimi i Objekteve Arsimore në zonat e prekura nga Termeti, Qarku Tiranë (Bashkia Kavajë, Bashkia Rrogzhinë)	462,882,154	367,803,511
19AD208	Rindërtimi i Objekteve Arsimore në zonat e prekura nga Termeti, Qarku Tiranë (Bashkia Kamëz)	621,757,340	471,578,998
19AD209	Rindërtimi i Objekteve Arsimore në zonat e prekura nga Termeti, Qarku Tiranë (Bashkia Vorë) Qarku Durrës, (Bashkia Shijak)	506,998,739	408,094,074
19AD210	Mbeshetje per programin "Sherbime mbikqyrjeje dhe kolaudim per Objektet Arsimore"	45,901,781	23,066,879
19AD211	Hartimi i projekteve per banesa individuale	246,756,668	132,339,501
M560322	Projekti i Rrugëve Dytësore dhe Lokale (Kosto Lokale)	302,042,996	302,042,996
Totali		9,907,591,022	6,824,263,928

Auditimi në lidhje me secilin projekt të investimit paraqitet:

-Projekti 19AD201 "Rindërtimi i banesave individuale".

Ky projekt investimi sipas tabelës së përdorimit të fondit të rindërtimit dhe shpjegimeve të dhëna nga Drejtoria e Investimeve paraqet fondet e shpërndara sipas VKM për ndërtimin e banesave individuale, ndërtimin e banesave pallat dhe infrastrukturën publike si më poshtë:

VKM	Vlera sipas VKM fillestare		Vlera sipas VKM se ndryshuar	
	Buxheti total planifikuar	Buxheti për vitin 2020	Buxheti total planifikuar	Buxheti për vitin 2020
VKM nr. 202 date 05.03.2020, I ndryshuar	6,528,564,252	6,528,564,252	6,465,467,211	2,492,978,390
VKM nr. 307 date 16.04.2020, I ndryshuar	5,000,398,852	1,088,094,042	3,975,401,851	1,363,461,542
VKM nr. 587 date 22.07.2020, I ndryshuar	3,239,666,018	3,239,666,018	16,198,330,089	1,671,284,846
Totali	14,768,629,122	10,856,324,312	26,639,199,151	5,527,724,778

Në total plani përfundimtar për këto investime nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit paraqitet në shumën 5,527,724,778 lekë, ndërkohë që referuar të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Investimeve në lidhje me këtë projekt konstatohet se plani paraqitet në shumën 5,137,671,726 lekë, duke mos reflektuar ndryshimet e VKM në vlerën e saktë dhe paraqitet më një diferencë në shumën 390,053,053 lekë në plani e paraqitur në SIFQ. Mos reflektimi i saktë i ndryshimeve të VKM tregon për mosndjekje të fondeve të investimeve të lëvruara për procesin e rindërtimit, mungesë saktësie dhe konsistence në raportimet e kryera me efekt në mungesën e monitorimit të këtij procesi. Gjithashtu konstatohet se këto fonde janë përmbledhur në një projekt të vetëm investimi ndërkohë që për nga natyra, projektet e investimit përfshijnë infrastrukturë publike, banesa individuale dhe ndërtesa pallat në rajone të ndryshme gjeografike si dhe për të cilat përfshihen kontrata të ndryshme në zbatim të procedurave të parashikuara nga akti normativ për procesin e rindërtimit. Përcaktimi i një kodi të vetëm investimi për një vlerë investimi që përbën gati gjysmën e shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, nuk është në përputhje me përcaktimin e bërë në ligjin e buxhetit për përkufizimin e investimit kapital, me mënyrën e funksionimit të ecurisë së rasteve të tjerë të projekteve të investimit, krijon pamundësi monitorimi dhe ndjekje në vazhdimësi për respektimin e parimeve mbi të cilat funksionin sistemi buxhetor si dhe ka krijuar kushtet për problematikat e trajtuara në vijim për këto investime. Mungesa e detajimit në kodifikime për projekte specifike sikurse janë prokuruar nuk mundëson ndjekjen e planit dhe ndërmarrjen e angazhimeve për këto projekte në raport me fondet në dispozicion për secilin investim. Të analizuara sipas VKM përkatëse, angazhimet e ndërmarra në lidhje me këto fonde investimi sipas kontratave të regjistruara përfshijnë:

VKM	Objekti	Buxheti total	Buxheti 2020	Vlera kontraktuar e	Realizimi faktik
VKM nr. 202 date 05.03.2020, I ndryshuar	Banesat individuale	6,465,467,211	2,492,978,390	5,684,429,000	3,267,506,730
VKM nr. 307 date 16.04.2020, I ndryshuar	Infrastruktura publike	3,975,401,851	1,363,461,542	2,684,840,796	
VKM nr. 587 date 22.07.2020, I ndryshuar	Banesat pallat	16,198,330,089	1,671,284,846	8,173,312,695	
Totali		26,639,199,151	5,527,724,778	16,542,582,491	3,267,506,730

- *Rindërtimi i banesave individuale* është financuar sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 202, datë 5.03.2020, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të këtyre banesave", i ndryshuar. Nga analiza e të dhënave të vendosura në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

18BQ399	Bashkia Kamez (3535)	Supervizion punimesh :Ndertim rrjeti I ujesjellsit &Ndertim KUN,Demokracia-Bashkim Gazidede-Frutikulture,"Shkendija -Shebeniku"	200,000
18BQ442	Bashkia Ura Vajguore (0202)	Supervizion punimesh per objekti:"Rrjeti shperdarës I Urës Vajguore"	200,000
18BQ648	Bashkia Pogradec (1529)	Supervizion punimesh per objektin:Mbulimi me rrjet Kanalizimi per fshatin e Gurrasit dhe zona e Drilonit, Pogradec	200,000
19AG704	Bashkia Himare (3737)	Supervizion punimesh per objektin:Permirësimi I sistemit te furnizimit me uje te zonave Dhermi,Faza II,Gjilek,Kondraq dhe Palasë,bashkia Himare	200,000
18BQ358	Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Durr	Supervizion punimesh per objektin:"Sistemimi i furnizimit me uje te zones turistike Hamallaj , faza e I" Njesia administrative Sukth,Bashkia Durres.	185,674
18BQ380	Bashkia Koplík (3323)	Supervizion punimesh per objektin:Furnizimi me ujë i fshatrave Gradec dhe Pjetërshan,bashkia Malësia e Madhe	100,000
18BQ462	Bashkia Corovode (0232)	Supervizion punimesh per objektin:"Rehabilitimi i ujesjellesit te qytetit te Çorovodes dhe fshatrave Çerenisht dhe Sharove"	100,000
18CG107	Sh.A. Ujesjelles-Kanalizime Durr	Supervizion punimesh per objektin "Projekt per vendosje matesash ne pallatet me kollone te brendshme, Loti II,Qytet Durres	81,472
18BQ386	Bashkia Rreshen (2026)	Supervizion punimesh per objektin:Ndërtim ujesjellesi për qytetin Rubik	49,521
18BQ604	Drejtoria e Pergjithshme e Ujesj	Supervizion punimesh per objektin:"Përmirësimi i infrastruktures se ujrave te zeza ne zonën bregdetare Vlorë"	37,340
Totali			638,292,733



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Gjatë vitit në këtë program buxhetor, nuk janë financuar në vlerën e plotë kontratat në vazhdim, sipas kohëzgjatjes përkatëse, janë hapur projekte të reja investimi me akt normativ dhe rishpërndarje përgjatë vitit, të cilat kanë detyruar akomodimin e efekteve të detyrimeve të marra përtej kufijve të fondeve të miratuara për këtë program me Aktin Normativ nr.34 datë 16.12.2020 duke shtuar financimin me 3.1 miliard lekë. Në mënyrë të detajuar, problematikat e konstatuara nga auditimi në lidhje me disa projekte paraqitet si në vijim:

-Produkti 18BQ445 “Rikonstruksion magjistrali kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit qytetit Patos Loti I”. Në PBA faza II 2020-2022 dhe Projekt Buxhetin e vitit 2020, ky investim është parashikuar në shumën 541,844 mijë lekë lekë, paraqitur si në tabelën e mëposhtme:

Dokumenti	2019	2020	2021	2022	Totali
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi	
PBA 2020-2022	105,030	40,000	100,000	296,814	541,844
Projekt buxhet 2020	105,030	40,000	100,000	296,814	541,844

Nga auditimi konstatohet se ky investim është kontraktuar nga Bashkia Patos e cila ka lidhur kontratën me datë 31.03.2020 në shumën 532,867,612.8 lekë me afat zbatimi 18 muaj. Kontrata rezulton e regjistruar në modulën e kontratave në SIFQ në datë 07.04.2020, në kundërshtim me afatin kohor të përcaktuar në USZB për regjistrimin e kontratës. Sipas informacionit të përcjellë nga ana e Drejtorisë së Investimeve dhe të dhënat e SIFQ në lidhje me fondet e planifikuara për këtë investim konstatohet si në tabelën e mëposhtme:

Kod produkti	Produkti	Janar	Nëntor	Dhjetor
18BQ445	Rikonstruksion magjistrali kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit qytetit Patos Loti I	10,000,000	95,000,000	165,000,000

Kontrata e lidhur është lidhur në kushtet e mungesës së fondeve të nevojshme duke qenë se në momentin e lidhjes së saj janë të celura në SIFQ fonde në vitin e parë në shumën 10 milion lekë dhe konstatohet se janë kontraktuar në shumën 532,867,612.8 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar në të cilin është përcaktuar që “Për angazhimet buxhetore shumëvjeçare, që lidhen me projekte të reja investimesh publike, gjatë vitit të parë të zbatimit të tyre nuk lejohet që në buxhetin e njësisë përkatëse të qeverisjes së përgjithshme të shpërndahen më pak se 20 për qind e vlerës së plotë të projektit përkatës.”

Gjithashtu konstatohet se afati i zbatimit të kontratës dhe zhvillimit të punimeve paraqitet 18 muaj ndërkohë që plani i buxhetit për këtë projekt është i shtrirë në 4 vite, duke krijuar nëpërmjet keqplanifikimit efektin e krijimit të detyrimeve të prapambetura duke qenë se plani i pagesës nuk përputhet me afatin e faturimit për këtë investim. Plan i buxhetit për këtë projekt sipas informacionit të vendosur në dispozicion nga ana e Drejtorisë së Investimeve për vitin 2021 është në shumën 10 milion lekë dhe për vitin 2022 në shumën 20 milion lekë, duke e transferuar detyrimin përtej buxhetit 3 vjeçar. Ndërmarrja e këtyre angazhimeve jashtë fondeve të miratuara legjistikohet në vijim nga rishpërndarjet e kryera ku përgjatë vitit paraqiten 2 rishikime në muajin nëntor dhe dhjetor 2020 që kanë rritur buxhetin nga 10 milion lekë në 165 milion lekë përgjatë vitit 2020.

-Produkti M064166 “Rikonstruksion magjistrali kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit qytetit Patos Loti II”. Në PBA faza II 2020-2022 dhe Projekt Buxhetin e vitit 2020, ky investim nuk është parashikuar fare. Fondet për këtë projekt investimi janë detajuar në muajin Qershor dhe në vijim janë rishikuar në ulje sipas tabelës së mëposhtme:

Kod produkti	Produkti	Qershor	Nëntor	Dhjetor
M064166	Rikonstruksion magjistrali kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit qytetit Patos Loti II	144,095,000	9,095,000	9,095,000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Konstatohet se ky projekt është detajuar megjithëse nuk është parashikuar në PBA 2020-2022 të publikuar dhe detajimi i tij nuk ka ndjekur procedurat për menaxhimin e investimeve publike. Nga auditimi konstatohet se ky investim është kontraktuar nga Bashkia Patos e cila ka lidhur kontratën me datë 10.12.2020 në shumën 705,415,837 lekë me afat zbatimi 24 muaj. Kontrata rezultoi e regjistruar në modulën e kontratave në SIFQ në datë 11.12.2020. Kontrata është lidhur në kushtet e mungesës së fondeve të nevojshme duke qenë se në momentin e lidhjes së saj janë të celura në SIFQ fonde në vitin e parë në shumën 9,095,000 lekë dhe konstatohet se janë kontraktuar në shumën 705,415,837 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar në të cilin është përcaktuar që *“Për angazhimet buxhetore shumëvjeçare, që lidhen me projekte të reja investimesh publike, gjatë vitit të parë të zbatimit të tyre nuk lejohet që në buxhetin e njësisë përkatëse të qeverisjes së përgjithshme të shpërndahen më pak se 20 për qind e vlerës së plotë të projektit përkatës. Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor...”*

Gjithashtu konstatohet se regjistrimi i planit të buxhetit për këtë investim është kryer duke e transferuar detyrimin në vite, ndërkohë që periudha e zbatimit të kontratës është 24 muaj, që përkon me periudhën e faturimit. Kjo argumentohet edhe nga keqplanifikimi i konstatuar edhe në paraqitjen në dokumenta të tjerë në vijimësi të këtij investimi, përkatësisht në PBA 2021-2023 dhe Projekt Buxhetin 2021 si më poshtë:

Dokumenti	2019	2020	2021	2022	2023	Mbetur pas vitit 2023	Kosto totale e projektit
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi		
PBA 2021-2023 faza II	0	100,000	40,000	50,000	0	0	190,000
Projekt buxhet 2021	20,000	144,095	100,000	40,000	50,000	366,380	720,475

Vlera e investimit ndryshon në të dy dokumentat zyrtarë të paraqitur që rrjedhin nga kërkesat e ligjit të buxhetit si dhe shpërndarja e buxhetit sipas muajve nuk i përshtatet vitit të fillimit të investimit, vlerës së parashikuar sipas periudhës së faturimit në bazë të afatit të zbatimit sipas kontratës, duke krijuar detyrime të prapabitura. Këto veprime lejojnë copëzimin e fondeve sipas viteve, me qëllim shtimin e investimeve dhe krijojnë kushtet për ndërmarrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore.

-Projekti 19AF206 “Ndërtim ujësjellësi për furnizimin me ujë të qytetit Burrel të fshatrave të njësisë administrative Derjan dhe Rukaj –Loti I”. Në PBA faza II 2020-2022 dhe Projekt Buxhetin e vitit 2020, ky investim nuk është parashikuar fare. Fondet për këtë projekt investimi janë detajuar në muajin Korrik në shumën 134,724,971 lekë për vitin 2020 dhe nuk kanë pësuar rishikim gjatë vitit. Nga auditimi konstatohet se ky investim është kontraktuar nga Bashkia Mat e cila ka lidhur kontratën me datë 09.10.2020 në shumën 669,056,344 lekë me afat zbatimi 12 muaj. Nga auditimi konstatohet se sipas formularit të njoftimit të fituesit dhe fondet e regjistruara në SIQ sipas viteve, shpërndarja e buxhetit sipas viteve nuk përputhet me afatin kohor të zbatimit të punimeve prej 12 muaj duke krijuar detyrime të prapambitura për vitet në vijim pasi shpërndarja e fondeve të investimeve është përtej periudhës së faturimit të punimeve. Kjo argumentohet edhe nga keqplanifikimi i konstatuar edhe në paraqitjen në dokumenta të tjerë në vijimësi të këtij investimi, përkatësisht në PBA 2021-2023 dhe Projekt Buxhetin 2021 si më poshtë:

	2020. Buxheti	2021. Parashikimi	2022. Parashikimi	2023. Parashikimi	Mbetur pas vitit 2023	Kosto totale e projektit
PBA 2021-2023	134,725	20,000	20,000	50,000	-	224,725
Projekt buxhet 2021	134,725	20,000	20,000	50,000	448,900	673,625



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Vlera e investimit ndryshon në të dy dokumentat zyrtarë të paraqitur që rrjedhin nga kërkesat e ligjit të buxhetit si dhe shpërndarja e buxhetit sipas muajve nuk i përshtatet vitit të fillimit të investimit, vlerës së parashikuar sipas periudhës së faturimit në bazë të afatit të zbatimit sipas kontratës, duke krijuar detyrime të prapabetura.

-Projekti 18CG001 “Linja kryesore per furnizimin me uje dhe rrjeti shperndares I ujesjellesit per qytetin e Belshit, Faza II” dhe Projekti 18CG003 “Linja Kryesore per furnizimin me ujë dhe rrjeti shperndares i ujesjellesit për qytetin e Belshit, Faza III”. Në PBA faza II 2020-2022 dhe Projekt Buxhetin e vitit 2020, ky investim është parashikuar në vlera të ndryshme, referuar dy dokumentave zyrtare të kërkuara nga ligji për buxhetin, paraqitur si në tabelën e mëposhtme:

Linja Kryesore per furnizimin me ujë dhe rrjeti shperndares i ujesjellesit për qytetin e Belshit" Faza II & Faza III							
		I RI					
		2019	2020	2021	2022	Per tu financuar pas 2022	Kosto totale
PBA	2020-2022	-	218,074	98,000	100,000	-	416,074
Projekt Buxhet	2020	-	218,748	98,000	100,000	-	1,090,371

Paraqitja në projekt buxhet nuk është e saktë përse i përket koston totale të investimit pasi shuma e buxhetit të shpërndarë sipas viteve prej 416,074 mijë lekë nuk rakordon me koston totale të projektit në shumën e paraqitur prej 1,090,371 mijë lekë.

Ky investim i parashikuar në PBA 2020-2022 në një produkt të vetëm që përfshin fazën II dhe fazën III në vijim është ndarë në dy produkte të ndryshme investimi. Nga auditimi konstatohet se prokurimi dhe lidhja e kontratave janë kryer nga Bashkia Belsh si në vijim:

-Kontrata “Linja kryesore per furnizimin me uje dhe rrjeti shperndares i ujesjellesit per qytetin e Belshit Faza II”, nënshkruar në 03.02.2020 në shumën 479,819,068.8 lekë me TVSH me afat kontrate 4 muaj.

-Kontrata “Linja Kryesore per furnizimin me ujë dhe rrjeti shperndares i ujesjellesit për qytetin e Belshit, Faza III” nënshkruar në 02.06.2020 në shumën 474,517,615 lekë me tvsh me afat kontrate 4 muaj.

Në total fondet buxhetore të kontraktuara për këto dy kontrata janë në shumën 954,336,684 lekë, të ekzekutueshme brenda vitit 2020, duke qenë se për të dyja kontratat, kohëzgjatja e kontratës është 4 muaj nga ata e lidhjes. Fondet në dispozicion për këto sipas detajimit fillestar dhe ndryshimeve përgjatë vitit paraqiten si në tabelën e mëposhtme:

Kod produkti	Produkti	Janar	Qershor	Dhjetor
18CG001	Linja kryesore per furnizimin me uje dhe rrjeti shperndares I ujesjellesit per qytetin e Belshit, Faza II	20,000,000	20,000,000	100,000,000
18CG003	Linja Kryesore per furnizimin me ujë dhe rrjeti shperndares i ujesjellesit për qytetin e Belshit, Faza III	115,466,905	45,466,905	45,466,905

Për rrjedhojë konstatohet se janë ndërmarrë angazhime pa fonde buxhetore duke qenë se fondet në dispozicion për këto investime në momentin e lidhjes së kontratës së ekzekutueshme brenda vitit 2020 paraqiten në shumën 135,466,905 lekë, ndërkohë që vlera e përgjithshme e kontraktuar paraqitet në shumën 954,336,684 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar në të cilin është përcaktuar që “Për angazhimet buxhetore shumëvjeçare, që lidhen me projekte të reja investimesh publike, gjatë vitit të parë të zbatimit të tyre nuk lejohet që në buxhetin e njësisë përkatëse të qeverisjes së përgjithshme të shpërndahen më pak se 20 për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

qind e vlerës së plotë të projektit përkatës. ... Nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes së përgjithshme mbajnë të dhëna për angazhimet financiare dhe nuk lejojnë ndërmarrjen e angazhimeve të reja, përtej kufirit të fondeve buxhetore të shpërndara.ö

Nga auditimi konstatohet se sipas formularit të njoftimit të fituesit dhe fondet e regjistruara në SIQ sipas viteve, e shpërndarja e buxhetit sipas viteve nuk përputhet me afatin kohor të zbatimit të punimeve prej 12 muaj duke krijuar detyrime të prapambetura për vitet në vijim pasi shpërndarja e fondeve të investimeve është përtej periudhës së faturimit të punimeve. Kjo argumentohet edhe nga keqplanifikimi i konstatuar edhe në paraqitjen në dokumenta të tjerë në vijimësi të këtij investimi, përkatësisht në PBA 2021-2023 dhe Projekt Buxhetin 2021 si më poshtë:

Produkti	18CG001 - Linja kryesore per furnizimin me uje dhe rrjeti shperndares i ujesjellesit per qytetin e Belshit, Faza II						Totali
	2019.	2020.	2021.	2022.	2023.	Mbetur pas vitit 2023	
PBA 2021-2023	-	-	58,533	50,000	200,000	-	308,533
Projekt buxhet 2021	8,000	20,000	58,533	50,000	200,000	143,286	479,819
Produkti	18CG003 - Linja Kryesore per furnizimin me uje dhe rrjeti shperndares i ujesjellesit per qytetin e Belshit, Faza III						Totali
PBA 2021-2023	-	45,467	50,000	100,000	-	-	
Projekt buxhet 2021	-	45,467	45,467	50,000	100,000	328,487	569,421

-Projekti 18BQ469 “Rikonstruksioni i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut”. Në PBA faza II 2020-2022 dhe Projekt Buxhetin e vitit 2020, ky investim është parashikuar në vlera të ndryshme, referuar dy dokumentave zyrtare të kërkuara nga ligji për buxhetin, paraqitur si në tabelën e mëposhtme:

Rikonstruksioni I rrjetit te brendshem dhe te jashtem te furnizimit me uje te qytetit te Leskovikut						
Produkti 24	I RI 2020					Totali
	2019	2020	2021	2022	2023	
PBA 2020-2022	0	90,000	68,137	144,951		303,088
Projekt buxhet 2020		90,147	68,137	144,951		450,000

Nga auditimi konstatohet se ky investim është kontraktuar nga Bashkia Kolonjë e cila ka zhvilluar procedurën e prokurimit nga e cila ka rezultuar fitues BOE dhe është lidhur kontrata me datë 08.06.2020 në shumën 274,456,182 lekë me afat zbatimi 12 muaj. Nga auditimi konstatohet se sipas formularit të njoftimit të fituesit dhe fondet e regjistruara në SIFQ sipas viteve, shpërndarja e buxhetit sipas viteve nuk përputhet me afatin kohor të zbatimit të punimeve prej 12 muaj duke krijuar detyrime të prapambetura për vitet në vijim pasi shpërndarja e fondeve të investimeve është përtej periudhës së faturimit të punimeve. Fondet e detajuara për këtë projekt investimi dhe ndryshimi në muajin dhjetor të vitit 2020 në rritje paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Kod Projekti	Projekti	Janar	Dhjetor
18BQ469	Rikonstruksioni i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut	55,226,741	105,226,741

Kjo argumentohet edhe nga keqplanifikimi i konstatuar edhe në paraqitjen në dokumenta të tjerë në vijimësi të këtij investimi, përkatësisht në PBA 2021-2023 dhe Projekt Buxhetin 2021 si më poshtë:

Produkti	18BQ469 - Rikonstruksioni i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut				
	2020.	2021.	2022.	2023.	Kosto totale
PBA 2021-2023	-	55,227	30,000	134,003	219,230
Projekt buxhet 2021	55,227	55,227	30,000	134,003	274,456

-Projekti 19AF901 “Ndertim ujesjellesi per qytetin Ersekë dhe fshatrat, Faza e II-të nga Burimet e Kozelit”. Ky projekt nuk rezulton i parashikuar në PBA 2020-2022. Nga auditimi konstatohet se ky investim është kontraktuar nga Bashkia Kolonjë e cila ka zhvilluar procedurën e prokurimit nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

e cila ka lidhur kontratën me datë 29.10.2020 në shumën 497,280,095 lekë me afat zbatimi 24 muaj. Nga auditimi konstatohet se sipas formularit të njoftimit të fituesit dhe fondet e regjistruara në SIFQ sipas viteve, shpërndarja e buxhetit sipas viteve nuk përputhet me afatin kohor të zbatimit të punimeve prej 24 muaj duke krijuar detyrime të prapambetura për vitet në vijim pasi shpërndarja e fondeve të investimeve është përtej periudhës së faturimit të punimeve. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar në të cilin është përcaktuar që “Nëpunësi autorizues i njësies së qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor...”. Fondet e detajuara për këtë projekt investimi në muajin Korrik 2020 të vitit 2020 të cilat kanë mbetur të pa ndryshuara paraqiten si në tabelën e mëposhtme:

Kod Projekti	Projekti	Korrik	Dhjetor
19AF901	Ndertim ujesjellesi per qytetin Ersekë dhe fshatrat, Faza e II-të nga Burimet e Kozelit	99,600,000	99,600,000

Plani 3-vjeçar i projektit i regjistruar në SIFQ paraqitet për 3 vite ndërkohë që kohëzgjatja e kontratës është 24 muaj nga data e lidhjes. Kjo faktohet edhe nga analiza e PBA 2021-2023 dhe projekt buxheti 2023 si në vijim:

Produkti	19AF901 - Ndertim ujesjellesi per qytetin Ersekë dhe fshatrat, Faza e II-të nga Burimet e Kozelit					
	2020.	2021.	2022.	2023.	Per tu paguar pas 2023	Kostot totale
PBA 2021-2023	99,600	20,000	20,000	50,000	-	189,600
Projekt buxhet 2021	99,600	20,000	20,000	50,000	308,400	498,000

-Projekti 19AF201 “Furnizimi me ujë nga burimi i Grames per ujesjellesin e Peshkopise”. Ky projekt nuk rezultoi i parashikuar në PBA 2020-2022 si dhe as në Projekt Buxhetin e vitit 2020 në listën e investimeve publike në programin 06370. Nga auditimi konstatohet se ky investim është kontraktuar nga Bashkia Dibër e cila ka zhvilluar procedurën e prokurimit nga e cila është lidhur kontrata me datë 15.09.2020 në shumën 737,095,235 lekë me afat zbatimi 14 muaj. Nga auditimi konstatohet se sipas formularit të njoftimit të fituesit dhe fondet e regjistruara në SIQ sipas viteve, e shpërndarja e buxhetit sipas viteve nuk përputhet me afatin kohor të zbatimit të punimeve prej 14 muaj duke krijuar detyrime të prapambetura për vitet në vijim pasi shpërndarja e fondeve të investimeve është përtej periudhës së faturimit të punimeve. Fondet e detajuara për këtë projekt investimi në muajin Korrik 2020 të vitit 2020 të cilat kanë ndryshuar në muajin Dhjetor 2020 me shtesë prej 70 milion lekë paraqiten si në tabelën e mëposhtme:

Kod	Emertim projekti	Qershor	Dhjetor
19AF201	Furnizimi me ujë nga burimi i Grames per ujesjellesin e Peshkopise	156,000,000	226,000,000

Në SIFQ kjo kontratë është regjistruar në 24.09.2020 duke e shpërndarë planin e shlyerjes për 3 vite, përtej afatit prej 14 muajsh për kryerjen e punimeve mbi bazën e të cilës kryhet edhe faturimi përkatës. Kjo faktohet edhe nga analiza e PBA 2021-2023 dhe projekt buxheti 2023 si në vijim:

Produkti	19AF201 “Furnizimi me ujë nga burimi i Grames per ujesjellesin e Peshkopise”					
	2020	2021	2022	2023	Per tu paguar pas 2023	Kostot totale
PBA 2021-2023		50,000	40,000	50,000	-	140,000
Projekt buxhet 2021	156,000	50,000	40,000	50,000	484,000	780,000

Nga auditimi konstatohet se detajimi i fondeve për këtë projekt është realizuar në muajin Qershor 2020 vetëm për vlerën e 20% të koston së projektit, pa kaluar në PBA 2020-2022, por duke u përfshirë në PBA 2021-2023, me kosto projekti më të ulët se kostoja reale e tij. Buxheti i shlyerjes së këtij investimi përtej periudhës 3 vjeçare sipas së cilës miratohet Buxheti i Shtetit nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Parlamenti, dhe përtej periudhës së përcaktuar për realizimin dhe faturimin e tij sjell krijimin e detyrimeve të prapambetura.

-Projekti 18BQ616 "Ujesjellesi -Zona e ujit te ftohte dhe lungomares Rrapi Uji I Ftohte - Shkolla e Marines". Në PBA faza II 2020-2022 dhe Projekt Buxhetin e vitit 2020, ky investim është parashikuar në shumën 541,844 mijë lekë lekë, paraqitur si në tabelën e mëposhtme:

Dokumenti	2020	2021	2022	Per tu paguar pas vitit 2022	Totali
	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi		
PBA 2020-2022	140,137	70,000	237,176		447,313
Projekt buxhet 2020	140,390	70,000	237,176	-	700,683

Nga analiza e këtyre dy dokumentave kostatohet se ky investim është paraqitur në dy vlera të ndryshme në dy dokumenta buxhetorë të ndryshëm. Fondet e parashikuara për vitet 2020-2022 janë të njejta sipas viteve, por vlera e investimit ndryshon në total, duke qenë se në listën shoqëruese të investimeve paraqitur në projekt buxhetin e vitit 2020, totali nuk është i barabartë me totalin sipas vlerës së buxhetuar sipas viteve.

Nga auditimi konstatohet se për këtë investim është nënshkruar kontrata në shumën 629,922,040 lekë me datë kontrate 25.09.2020, e regjistruar në SIFQ në 24.12.2020 nga Bashkia Vlorë me afat kontrate 12 muaj. Fondet e detajuara për këtë projekt investimi në muajin Prill 2020 të cilat kaë ndryshuar në ulje në muajin Tetor dhe Nëntor paraqiten si në tabelën e mëposhtme:

Kod	Emertim projekti	Prill	Tetor	Nëntor
19AF201	Furnizimi me ujë nga burimi i Grames per ujesjellesin e Peshkopise	128,402,622	79,402,622	30,402,622

Lidhja e kontratës përtej vlerës së parashikuar në PBA 2020-2022 është angazhim pa fonde buxhetore duke qenë se kostoja e investimit (vlera e kontraktuar) është më e madhe se vlera e buxhetuar sipas PBA 2020-2022. Ndërkohë plani i pagesës sipas regjistrimit në SIFQ në modulin e kontratave rezulton përtej afatit 12 mujor të ekzekutimit të kontratës që përkon edhe me periudhën e faturimit të investimit duke sjellë krijimin e detyrimeve të prapambetura. Kjo faktohet edhe nga analiza e PBA 201-2023 dhe projekt buxheti 2021 si në vijim:

Produkti	Projekti 18BQ616 "Ujesjellesi -Zona e ujit te ftohte dhe lungomares Rrapi Uji I Ftohte - Shkolla e Marines"					Per tu paguar pas 2023	Kostot totale
	2020	2021	2022	2023	2023		
PBA 2021-2023		50,000	50,000	0			100,000
Projekt buxhet 2021	128,403	50,000	50,000	0		413,610	642,013

Nga auditimi konstatohet se detajimi i fondeve për këtë projekt është realizuar në muajin Prill 2020 vetëm për vlerën e 20% të koston së projektit, me kosto projekti më të ulët se kostoja reale e tij. Buxhetimi i shyerjes së këtij investimi përtej periudhës 3 vjeçarë sipas së cilës miratohet Buxheti i Shtetit dhe përtej periudhës së përcaktuar për realizimin dhe faturimin e tij sjell krijimin e detyrimeve të prapambetura.

-Projekti 18BQ394 "Ndërtim linjë transmetimi nga puseta Yzberisht deri në Depo Katund, Katund i Ri &Ndërtim linjë transmetimi nga puseta Yzberisht deri në Depo Oytet Nxënësve, bashkia Tiranë". Ky projekt nuk rezulton i parashikuar në PBA 2020-2022 si dhe as në Projekt Buxhetin e vitit 2020 në listën e investimeve publike në programin 06370. Nga auditimi konstatohet se ky investim është kontraktuar nga Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Tiranë e cila ka zhvilluar procedurën e prokurimit nga e cila është lidhur kontrata me datë 02.07.2020 në shumën 458,173,808.43 lekë me tvsh me afat zbatimi 4 muaj. Nga auditimi konstatohet se sipas formularit të njoftimit të fituesit dhe fondet e regjistruara në SIQ sipas viteve, shpërndarja e buxhetit sipas viteve nuk përputhet me afatin kohor të zbatimit të punimeve prej 4 muaj duke krijuar detyrime të prapambetura për vitet në vijim pasi shpërndarja e fondeve të investimeve është përtej periudhës së faturimit të punimeve, të cilat përfundojnë përgjatë vitit 2020. Fondet e detajuara për këtë projekt investimi në muajin janar



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCIVE DHE EKONOMISË

2020 të vitit 2020 të cilat kanë ndryshuar në muajin qershor 2020 në ulje paraqiten si në tabelën e mëposhtme:

Kod	Emertim projekti	Janar	Qershor
<i>18B</i> <i>Q39</i> <i>4</i>	<i>“Ndërtim linjë transmetimi nga puseta Yzberisht deri në Depo Katund, Katund i Ri &Ndërtim linjë transmetimi nga puseta Yzberisht deri në Depo Qytet Nxënësve, bashkia Tiranë”</i>	97,401, 978	60,401, 978

Ndërkohë plani i pagesës sipas regjistrimit në SIFQ në modulën e kontratave rezultojnë përtej afatit 4 mujor të ekzekutimit të kontratës që përkon edhe me periudhën e faturimit të investimit duke sjellë krijimin e detyrimeve të prapambetura. Kjo faktohet edhe nga analiza e PBA 201-2023 dhe projekt buxheti 2021 si në vijim:

Produkti	18BQ394 - Ndërtim linjë transmetimi nga puseta Yzberisht deri në Depo Katund, Katund i Ri &Ndërtim linjë transmetimi nga puseta Yzberisht deri në Depo Qytet Nxënësve, bashkia Tiranë					
	2020	2021	2022	2023	Per tu paguar pas 2023	Kostot totale
PBA 2021-2023		25,238	25,238			50,476
Projekt buxhet 2021	60,402	25,238	25,238	0	376,131	487,010

Nga auditimi konstatohet se detajimi i fondeve për këtë projekt është realizuar në muajin Janar 2020 vetëm për vlerën e 20% të kostos së projektit duke u ulur në muajt në vijim si dhe me kosto projekt merr më të ulët se kostoja reale e tij. Buxheti i shyerjes së këtij investimi përtej periudhës 3 vjeçare sipas së cilës miratohet Buxheti i Shtetit nga Parlamenti, dhe përtej periudhës së përcaktuar për realizimin dhe faturimin e tij sjell krijimin e detyrimeve të prapambetura nëpërmjet tejkalimit të kufijve për fondet e investimit të planifikuar për vitet pas vitit aktual buxhetor, ndërkohë që kohëzgjatja e kontratës është vetëm 4 muaj.

Problematika për disa nga këto kontrata reflektohet edhe në projekt buxhetin e vitit 2021 në listën e investimeve publike, ku mungesa e përbalimit të angazhimeve të ndërmarra/në proces ka sjellë përfshirjen e planit të buxhetit të tyre pas vitit 2023, jashtë periudhës në të cilën buxheti miratohet nga parlamenti. Në mënyrë të detajuar lista e këtyre projekteve me këtë problematikë, e evidentuar edhe më sipër sipas kontratave të nënshkruara paraqiten:

Emërtimi i Projektit	Vlera Totale e projektit	Financimi deri në 31.12.2019	Buxheti 2020 - PLAN	Propozim MFE 2021	Parashikimi për v.2022	Parashikimi për v.2023	Per tu paguar pas vitit 2023
Furnizimi me ujë i qytetit Koplik	436,386	50,300	30,000	20,000	49,962	100,000	186,124
"Rikonstruksion magjistrali kryesor dhe rrjetit të brëndshëm të ujësjellësit qytetit Patos Loti I"	532,868	20,000	10,000	20,000	41,436	100,000	341,432
" Linja Kryesore per furnizimin me ujë dhe rrjeti shperndares i ujesjellesit për qytetin e Belshit" Faza II	479,819	8,000	20,000	58,533	50,000	200,000	143,286
Rikonstruksion i ujësjellësit të fshatit Rodenj-Fshati i Ri	33,000	0	6,600	12,800	0	0	13,600
Projekt per vendosje matesash ne pallatet me kollone te brendshme, Loti II,Qytet Durres	43,828	0	8,766	20,125	0	0	14,938
Projekt per vendosje matesash ne pallatet me kollone te brendshme,Qytet Shkodër	53,573	0	10,715	5,716	0	0	37,142
Rikonstruksion i rrjetit shperndares per furnizimin me uje te qytetin Kavaje dhe ndertimi i depo uji te re „Faza e II	789,942	0	158,283	100,000	100,000	100,000	331,659
Rehabilitimi i puseve eksiztuese dhe ndertimi i ri i linjes se transmetimit dhe shperndarjes se ujesjellesit Fushë-Krujë	587,215	0	117,774	117,774	100,000	100,000	151,667
" Linja Kryesore per furnizimin me ujë dhe rrjeti shperndares i ujesjellesit për qytetin e Belshit" Faza III	569,421	0	45,467	45,467	50,000	100,000	328,487



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Ujësjetësi rajonal i Finiqit (Linja e jashtme)- Burimet e Merkos	555,177	0	111,625	16,062	50,000	100,000	277,489
Ndërtimi i Ujësjetësit Rajonal për njesinë administrative Golaj, Për fshatrat Dobrunë, Qarr i vogël, Golaj, Nikoliq dhe Vlahen, Bashkia Has	300,000	0	60,000	50,000	39,164	50,000	100,836
Ndërtim i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të qytetit Lac, faza II	436,432	0	87,767	100,000	50,000	50,000	148,664
Rikonstruksion të rrjetit të ujësjetësit :Rruga Kongresi i Permetit,(NSHU), J.Dyli, Haxhire, Elbasan; Linja kryesore STP - Byshek -depo Mlize, Shushice; Linja kryesore stp Bujqes- depo Mjekes dhe ndërtim pjesor rrjeti shpërndarës lagjia Kotor, fshati Bujqes+F.V makineri Paisje	296,849	0	33,987	24,807	24,747	0	213,309
Ndërtimi i linjës së furnizimit me ujë të pijshëm Gurra e Eperme -Luzni-Peshkopi,	250,000	0	50,000	150,000	20,000	0	30,000
Ndërtim i rrjetit të ujësjetësit për qytetin e Shijakut	331,620	0	70,000	50,000	50,000	50,000	111,620
Ndërtim i linjës kryesore dhe shpërndarëse të furnizimit me ujë të njesisë administrative Velabisht, bashkia Berat	157,074	0	31,415	94,244	11,415	0	20,000
Ndërtim linjë transmetimi nga puseta Yzberisht deri në Depo Katund, Katund i Ri & Ndërtim linjë transmetimi nga puseta Yzberisht deri në Depo Qytet Nxënësve, bashkia Tiranë	487,010	0	60,402	25,238	25,238	0	376,131
Implant i Trajtimi i Ujërave të Ndotura dhe sistemi KUZ, Drimadhe, Dhërmi	400,305	0	81,693	50,000	50,000	60,553	158,059
Ujësjetësi -Zona e ujit të ftohtë dhe lungomares Rrapi Uji i Ftohtë - Shkolla e Marines	642,013	0	128,403	50,000	50,000	0	413,610
Rikonstruksion i rrjetit shpërndarës të qytetit Ballsh	504,702	0	100,940	50,000	50,000	0	303,762
Ujësjetësi në DMA 6 dhe ujësjetësi i zonës Afrimi I Ri-shkolla Bujqesore, Fier	478,935	0	95,966	71,467	57,931	50,000	203,572
Ujësjetësi i fshatit Terbaç, Himarë	98,769	0	19,754	19,754	59,261	0	
Furnizimi me ujë i zonave turistike Drimadhes, Dhermi dhe permiresimi i rrjetit të ujësjetësit të fshatit Dhermi	271,191	0	56,260	50,000	50,000	50,000	64,931
Ndërtim rrjeti i ujësjetësit & Ndërtim KUN, Demokracia-Bashkim Gazidede-Frutikulture, "Shkendija -Shebeniku"	484,000	0	96,800	68,704	147,086	50,000	121,410
Furnizimi me ujë nga burimi i Grames për ujësjetësin e Peshkopisë	780,000	0	156,000	50,000	40,000	50,000	484,000
"Rikonstruksion magjistrali kryesor dhe rrjeti të brendshëm të ujësjetësit qytetit Patos Loti II	720,475	20,000	144,095	100,000	40,000	50,000	366,380
Rrjeti jashtëm dhe brendshëm, njesia administrative Cukalat, Bashkia Ura Vajgurore	241,705		48,341	20,000	20,000	50,000	103,364
Ndërtim ujësjetësi për furnizimin me ujë i qytetit Burrel të fshatrave të njesisë administrative Derjan dhe Rukaj -Loti I	673,625		134,725	20,000	20,000	50,000	448,900
"Ndërtim Ujësjetësi për fshatrat Linas, Kamunah, Mollas dhe Desar, Njesia Administrative Mollas, Bashkia Cerrik	337,283		67,457	20,000	20,000	50,000	179,826
Ndërtim ujësjetësi i qytetit Ersekë dhe të fshatrave, Faza e II-të nga Burimet e Kozelit	498,000		99,600	20,000	20,000	50,000	308,400
Ndërtimi i ujësjetësit Macurisht-Plase, Bashkia Maliq	213,309		42,662	20,000	20,000	50,000	80,647
Ujësjetësi i Mokres Faza e I, Bashkia Pogradec	150,000		30,000	20,000	20,000	50,000	30,000
Ujësjetësi i Jashtëm dhe i brendshëm fshati Sinice, Cete, Miras, Qyteze Njesia administrative Miras, Bashkia Devoll	180,000		36,000	20,000	20,000	50,000	54,000
Furnizimi me Ujë zones Mjede dhe Shelqet ,Bashkia Vau i Dejes, Bashkia Vau i Dejes	179,182		35,836	20,000	20,000	50,000	53,346
Ndërtimi i ujësjetësit në rrugën transballkanike Vlore, Bashkia Vlore	180,000		36,000	20,000	20,000	50,000	54,000
Permiresimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhermi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe Palasë, bashkia Himarë	200,000		40,000	20,000	20,000	50,000	70,000
Ndërtim i ujësjetësit Bajze, Bashkia Malesi e	387,446		77,489	20,000	20,000	50,000	219,957



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Madhe							
Ngritja e sistemit te qenderzuar te faturave e shoqerive te Ujesjelles Kanalizime	180,000		36,000	20,000	20,000	50,000	54,000
Ndertim Rrjeti shperndares I fshatrave Gjorice si dhe ndertim depo Uji-faza e II	230,000		46,000	20,000	20,000	50,000	94,000

Nga auditimi konstatohet se angazhimet e ndërmarrja janë duke u shtrirë pas vitit 2023 për projekte të reja të iniciuara duke krijuar mundësinë për detyrime të prapambetura, si pasojë e hapjes së shumë projekte të investimit publik dhe copëzimit të buxhetit për kontratat e nënshkruara apo angazhimet në proces. Këto krijojnë kushte për detyrime të prapambetura dhe presion rritës për nivelin e borxhit publik si pasojë e nevojës për financim në përputhje me ecurinë e faturimit për kontratat përkatëse.

B.2.3- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Programi 01110

Planifikimi i fondeve për investime kapitale me financim të brendshëm përgjatë vitit 2020 në këtë program buxhetor dhe ndryshimet përgjatë vitit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Programi	Pershkrimi	Ligji 88/2019	A.N.6	A.N.15	A.N.28	A.N.34
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	4,128	4,128	4,128	4,128	4,128

Me **Aktin Normativ nr. 6** datë 21.03.2020, ndër të tjera është vendosur kryerja e një ndryshimi në nenin 5 të ligjit nr. 88/2019 për buxhetin e vitit 2020, duke shtuar transferimet nga buxheti i shtetit për sigurimet shëndetësore me vlerën **1,200 milion lekë**. Në këtë akt, është parashikuar që fondi anti-Covid-19 prej 2,500 milion të detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave. Në zbatim të kësaj pike, me VKM nr. 249/2020 nga fondi prej **2.5 miliardë lekë** është përcaktuar se do të përdoren 1,000 milionë lekë, në programin "Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi", si shpenzime kapitale. Nga auditimi konstatohet se efekti i fondeve të alokuara me këtë VKM nuk është reflektuar në aktet normative pasardhëse në buxhetin e investimeve për programin 01110 të MSHMS. Përgjatë vitit janë detajuar dhe kryer ndryshime ndryshime në projekte e investimit në lidhje me këtë program, duke pakësuar fondet në disa prej projekteve të planifikuara fillimisht, si dhe duke alokuar fonde në projekte të tjera. Më hollësisht:

Projekti	Emërtimi	Plani fillestar	Plani i rishikuar
19AD302	F.V monitore per spitalet	102,613,000	65,886,000
19AD303	Pajisje mjekesore per spitalet	50,000,000	50,000,000
19AD304	Rehabilitimi i shërbimit të Urologjisë dhe Klinikës së Tretë Kirurgjikale për kthimin e tyre në Kovaleshencë dhe Terapi Intensive në QSUT	13,717,119	0
19AD305	F.V pajisje per linjat e gazrave mjekesore në QSUT, SU òShefqet Ndroqiò, SUOGJ òMbretëresha Geraldinëò dhe Spitali i Kavajësò, për përballimin e situatës COVID-19	88,632,660	87,571,975
19AD306	Berje autoambulancash per spitalet	300,000,000	240,000,000
19AD307	Rikonstruksion i pediatrie infektive ne QSUT	40,000,000	40,000,000
19AD308	Supervizion per rikonstruksionin e pediatrie infektive ne QSUT	740,000	740,000
19AD309	kolaudim per rikonstruksionin e pediatrie infektive ne QSUT	45,333	45,333
19AD310	F.V pajisje mobilim per sherbimin e reanimacionit te sp.Vlores	5,000,000	5,000,000
19AD311	Rikonstruksion i sherbimit te reanimacionit te sp.Vlore	50,000,000	51,788,668
19AD312	Superv per rikonstruksionin e sherbimit te reanimacionit te sp.Vlore	900,000	900,000
19AD313	kolaudim per rikonstruksionin e sherbimit te reanimacionit te sp.Vlore	50,000	50,000
19AD314	TVSH per projektin per furnizimin me pajisje mjekesore te specializuara per mbrojtje/trajtim te covid-19, ne kuader te marrevshjes grant te BE ku perfituesi eshte MSHMS	88,560,000	86,485,981
19AD315	F.V pajisje mjekesore per covid 19	259,741,888	0
19AD317	F.V pajisje mjekesore CT Scanner	0	172,935,000
19AD318	F.V pajisje mjekesore Rezonance magnetike MRI	0	167,573,888
19AD316	Pagese TVSH per pajisjet e furnizuara donacion nga PNUDI ne kuader te Covid-19	0	14,272,017
18BA301	Pajisje kompiuterike (13-01110)	0	960,000
18BA502	Rikonstruksione ne disa ambiente te godines se MSHMS	0	9,194,988
18BA503	Superv+kolaud per rikonstruksionin e disa ambiente te godines se MSHMS	0	96,150
18BA506	Hartim i projekt preventiv te zbatimit per ndertimin e Qendres se re te Biosimulimit Klinik dhe edukimit ne vazhdim per Universitetin e Mjekesise Tirane, ne kuader te paktit per universitetin	0	6,500,000
TOTALI		1,000,000,000	1,000,000,000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Sikurse paraqitet edhe nga tabela e mësipërme, 3 projekte me përfitues MSHMS nuk lidhen me situatën e pandemisë, janë projekte të celura për t'u realizuar me **burim financimi nga fondi i Covid** janë likuiduar fatura të kontratave të lidhura një vit më parë: òRikonstruksione ne disa ambiente te godines se MSHMSò sipas përshkrimit të faturës së likuiduar rezultojnë me urdhër prokurimi nr 685 dt 08.10.19, kontratë nr 4805.10 datë 05.12.2019; òProjekti Hartim i projekt preventivit te zbatimit per ndertimin e Qendres se re te Biosimulimit Klinik dhe edukimit ne vazhdim per Universitetin e Mjekesise Tirane, ne kuader te paktit per universitetinò me urdhër prokurimi nr 626 dt 29.08.2019, kontrata nr 4254.21 datë 10.12.2019. Këto kontrata janë angazhime pa fonde buxhetore të vitit të kaluar duke qenë se janë lidhur pas datë 15 Tetor si afat për ndërmarrjen e angazhimeve të reja buxhetore dhe efekti i lidhjes së tyre është akomoduar duke përdorur fondin anti covid si burim financimi.

B.2.4- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Fondet për investime kapitale me financim të brendshëm për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të sipas miratimit me ligjin nr.88/2019 dhe ndryshimet me akt normativ përgjatë vitit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Programi	Pershkrimi	Ligji 88/2019	A.N.6	A.N.15	A.N.28	A.N.34
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	500	500	500	500	673,500
01610	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	500	500	500	500	673,500

Nga auditimi konstatohet se me aktin normativ nr. 34/2020 është rritur financimi për investimet kapitale me financim të brendshëm në shumën 673 milion lekë. Këto fonde konstatohet se janë detajuar në projektet e investimit të mëposhtëm:

20AA301	Projekti i Identifikimit Elektronik te Zgjedhesve	423,000,000.00
20AA302	Projekti pilot i Votimit dhe Numerimit Elektronik	250,000,000.00

Realizimi i këtyre fondeve të detajuara me AN 34/2020 rezultojnë në shumën 0 lekë duke qenë se nuk ka asnjë mundësi ligjore për prokurimin, lidhjen e kontratës dhe përdorimin e tyre përgjatë vitit buxhetor 2020. Detajimi i tyre është bërë me qëllim lejimin e procedurave të prokurimit për projektet e mësipërm dhe është kryer në masën 20% të vlerës së investimit. Një gjë e tillë konkludohet edhe nga kryqëzimi i të dhënave me databazën e prokurimit publik ku evidentohet hapja e procedurës së prokurimit në datën 23.12.2020 me procedurë negociim pa shpallje me fond limit në shumën 2,112,304,484 lekë dhe vlerë kontratë në shumën 2,419,625,554 lekë, me datë publikimi të njoftimit të fituesit në 18.01.2021. Konstatohet se lejimi i detajimit të këtyre fondeve me akt normativ, bëhet shkak për krijimin e detyrimeve të prapambetura duke qenë se detyron uljen e financimit për projekte të tjera të kaluara në projekt buxhet ndërkohë që lidhet një kontratë për të cilën nuk ka kaluar në asnjë fazë të ciklit buxhetor dhe është mbi tavanet e miratuara për vitet pasardhëse buxhetore.

B.2.5- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Nga auditimi mbi investimet e realizuara në programin 4250 òZhvillimi ruralò konstatohet se janë raportuar investime kapitale me kod projekt 18AL301 òPërfitues nga Programi IPARD II nga masa 1ò në shumën 449,298,778 lekë. Ky projekt investimi është raportuar nga kapitulli 3 òkosto lokaleò. Në bazën e të dhënave të pagesave të realizuara në SIFQ konstatohet se njësi shpenzuese është AZHBR me përfitues Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me përshkrimin Fondi Kombëtar IPARD II, kosto lokale dhe sipas pagesës së listave përkatëse. Këto pagesa kryhen në kuadër të bashkëfinancimit të fondeve të BE për mbështetjen e fermerëve/agroturizimit në kryerjen e investimeve nga ana e investitorëve. Pjesa e buxhetit të shtetit në kuadër të bashkëfinancimit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

është në masën 25%, ndërkohë që konstatohet se për nga natyra, nuk kemi të bëjmë me investim kapital, por me grant të dhënë të tretëve. Në këtë mënyrë, treguesit e investimeve publike janë të mbivlerësuar si pasojë e raportimit të realizimit të këtij projekti, pasi nuk kemi të bëjmë me kryerjen e investimeve publike ku pronar është shteti, por dhënien e grantit drejt përfituesve të ndryshëm për kryerjen e investimeve nga ana e tyre.

Në konkluzion, nisja e procedurave të prokurimit pa marrë më parë miratimin nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, marrja e angazhimeve buxhetore pa patur fonde të disponueshme, miratimi i fondeve buxhetore vetëm me qëllimin e lidhjes së kontratës dhe më pas shkurtimi i tyre, celja e projekteve të investimeve në proces me Akte Normative, mbyllja e investimeve në proces dhe celja e investimeve publike pa kaluar procedurat e menaxhimit të investimeve publike, celja e investimeve pa përshkrimin e projektit tregojnë për veprime në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi, për një planifikim të dobët të investimeve publike nga ana e institucioneve qendrore dhe vendore dhe një monitorim formal nga ana e instancave drejtuese të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me qëllim dhënien e një sigurie në menaxhimin eficient dhe transparent të fondeve publike. Këto veprime krijojnë kushtet për krijimin e detyrimeve të prapambetura me efekt në rritjen e presionit për rritjen e borxhit publik si pasojë e mosrespektimit të kufijve të miratuar për shpenzime në vitin buxhetor aktual dhe kufijtë e miratuar për vitet e ardhshme buxhetore. Celja e projekteve në infrastrukturën publike, ujësjellës kanalizime, infrastrukturë rrugore dhe programi zhvillimi përgjatë vitit buxhetor me akte normative, pa kaluar procedurat e PBA dhe vetëm për vlerën e 20% të projektit në vitin aktual, ka krijuar marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore disponibël, lidhjen e kontratave përtej afatit për marrjen e angazhimeve apo në mungesë të fondit prej 20% në momentin e ndërmarrjes së angazhimit. Këto projekte kanë rritur nevojën për financim për vitet pasardhëse buxhetore ku implementohet edhe pjesa e mbetur e tyre sipas kontratave afatshkurtra që nuk përputhen me buxhetin e parashikuar për shlyerjen e tyre, duke krijuar detyrime për tu paguar edhe pas vitit 2023. Referuar më lart, në lidhje me Investimet Kapitale me Financim të Brendshëm konstatohet se,

a) nuk janë respektuar Parimet e Funkcionimit të Sistemit Buxhetor dhe konkretish pika dh, neni 4 ku citohet: Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor janë:...dh) respektimi me rreptësi i tërësisë së procesit.

b) Marrja e angazhimeve pa patur në dispozicion fonde buxhetore paraqet një risk të shtuar në cënimin e qëndrueshmërisë së borxhit publik pasi përcaktimi i limiteve trevjeçare të angazhimeve për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme bëhet në përputhje me parimin e qëndrueshmërisë së borxhit publik, në kuadër të:

-neneve përktaëse 40-51 të LMSB ku ndër të tjera përcaktohet:

“Ministri i Financave përcakton një sistem rregullash dhe procedurash për të kontrolluar që angazhimet shumëvjeçare të jenë brenda tavanëve trevjeçare, të miratuara në ligjin vjetor të buxhetit. Për angazhimet buxhetore shumëvjeçare, që lidhen me projekte të reja investimesh publike, gjatë vitit të parë të zbatimit të tyre nuk lejohet që në buxhetin e njësisë përkatëse të qeverisjes së përgjithshme të shpërndahen më pak se 20 për qind e vlerës së plotë të projektit përkatës. Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme është e detyruar që, përpara fillimit të një procedure prokurimi, një apo shumëvjeçare, të marrë një konfirmim nga Ministria e Financave që fondet, të cilat synohen të prokurohen, janë brenda limitit të miratuar për angazhime. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, që operojnë direkt në sistemin informatik financiar të Qeverisë, për ekzekutimin e buxhetit të tyre dhe raportimin financiar regjistrojnë në këtë sistem angazhimin, brenda pesë ditëve pune nga data e nënshkrimit të tij, kundrejt urdhrat të prokurimit. Përcaktimi i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

limiteve trevjeçare të angazhimeve për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme bëhet në përputhje me parimin e qëndrueshmërisë së borxhit publik. Limiti i angazhimeve për njësitë e qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të këshillit të njësisë vendore dhe regjistrohet në sistemin informatik financiar të Qeverisë.

.. Nëpunësi i parë autorizues miraton detajimin e fondeve buxhetore, të shpërndara për çdo njësi shpenzuese dhe është përgjegjës që kjo të reflektohet në kohë në sistemin e thesarit. Pas miratimit të detajimit të fondeve buxhetore, të shpërndara për çdo njësi shpenzuese, nëpunësit autorizues të njësisë të qeverisjes së përgjithshme marrin angazhime dhe bëjnë pagesa, brenda limiteve dhe afateve të përcaktuara....

... E drejta e njësisë të qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve, të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri në datën 15 nëntor të çdo viti buxhetor....

... Ministri i Financave miraton udhëzime për nëpunësit autorizues për procedurat e regjistrimit të angazhimeve. Nëpunësit autorizues të njësisë të qeverisjes së përgjithshme mbajnë të dhëna për angazhimet financiare dhe nuk lejojnë ndërmarrjen e angazhimeve të reja, përtej kufirit të fondeve buxhetore të shpërndara.

... Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor. Angazhimet e ndërmarra nga njësitë shpenzuese jashtë fondeve të parashikuara në ligjin e buxhetit vjetor dhe në vendimin e këshillit të njësisë së qeverisjes vendore për buxhetin ose në kundërshtim me këtë akt ose akte të tjera ligjore, nuk përfshihen si pjesë e detyrimeve financiare të qeverisjes së përgjithshme. Kur nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme merr përsipër angazhime jashtë fondeve të parashikuara në buxhet ose në kundërshtim me këtë akt apo akte të tjera ligjore është përgjegjës për shlyerjen e detyrimit....”

-Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018 oPër procedurat standarde në zbatimin e buxhetit ku përcaktohet:

neni 63 citohet: oPlani i investimeve i detajuar nga nësitë e qeverisjes qendrore në nivel projekti mban parasysh këtë rradhë prioritare:

a- investimet në proces nga viti i kaluar,

b- objektet e paraqitura në Kuvend gjatë shqyrtimit të projekt buxhetit

neni 64 citohet: oNëse në listën e investimeve të detajuara nga njësitë e qeverisjes qendrore ka objekte të reja nga lista e paraqitur në momentin e miratimit të projekt buxhetit të vitit, NPA e përfshin në listën përfundimtare vetëm kur objekti ka kaluar në procedurat e miratimit të investimeve të publikuara. Dhe ja paraqet për miratim përfundimtar Ministrin përgjegjës për Financat.

Neni 157. Nëpunësi zbatues i njësisë respektive regjistron kontratën ose urdhrin e prokurimit për blerjet e vogla, sipas rastit, në kontabilitetin e menaxhimit, përpilon dokumentin e afateve të pagesave, dhe paraqet dokumentacionin si më sipër në gjuhën shqipe (në rastin e kontratave të lidhura në gjuhë të huaj) me njoftimin përfundimtar zyrtar për shpalljen e fituesit, në strukturën përgjegjëse për thesarin në degë brenda tre ditëve pune nga nënshkrimi i tyre. Mos zbatimi i afatit të mësipërm mund të shkaktojë vonesa në likuidimin e pagesës nga sistemi I thesarit. Penalitetet kontraktuale të shkaktuara nga kjo vonesë janë në ngarkim të njësisë respektive.

c) Nga ana e MFE, nuk janë respektuar rregullat e përgjithshme të monitorimit të investimeve publike , referuar VKM 185, datë 29.03.2018.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Monitorimi është procesi përmes të cilit institucionet buxhetore, përgjegjëse për zbatimin e projekteve të investimeve publike, sigurojnë që realizimi financiar i projekteve dhe aktivitetet që ato po zbatojnë në këtë kuadër, janë në përputhje me planet vjetore të miratuara në nivel projekti.

Objektivat e monitorimit të projekteve të investimeve publike

Të përmirësojë eficiencën e sistemit aktual të monitorimit të investimeve publike: Sistemi i monitorimit synon një raportim efikas dhe realist që identifikon në kohë dhe i paraprin akumulimit të problemeve, duke vënë në dijeni strukturat vendimmarrëse me qëllim zgjidhjen në kohë të tyre.

Të përmirësojë procesin e planifikimit vjetor dhe afatmesëm në nivel programi dhe projekti: Gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të monitorimit do të ndihmojnë ministrinë të përmirësojnë mënyrën e planifikimit të projekteve, duke mundësuar një përjasje më të mirë në raport me arritjen e objektivave sektoriale, rishikimin e politikave dhe buxhetimin e programeve.

Të përmirësojë kuadrin institucional të monitorimit e raportimit si dhe përgjegjësitë në procesin e planifikimit

d) Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike, nuk ka përmbushur misionin e saj i cili është të mbështesë zhvillimin ekonomik dhe social të vendit dhe zbatimin e politikave ekonomike të Qeverisë, duke siguruar një menaxhim eficient të burimeve për investime të financuara nga buxheti i shtetit si dhe detyrat e saj:

-Identifikimi, vlerësimi dhe miratimi i projekteve të investimeve publike të paraqitura nga institucionet buxhetore

-Siguron procesin e përfshirjes së projekteve të investimeve të përzgjedhura në PBA dhe Buxhetin Vjetor

Për problematikat e mësipërme të përshkruara në këtë akt mbajnë përgjegjësi strukturat NA dhe NZ të njërive të qeverisjes së përgjithshme sipas trajtimit për çdo institucion dhe në të njëjtën kohë MFE sipas miratimit të dhënë për detajimet apo rishpërndarjet gjatë vitit.

Gjetja:	Investimet kapitale me financim të brendshëm janë realizuar me burim financimi të ardhurat dytësore në shumën 309 milion lekë pa u shoqëruar me planin përkatës buxhetor dhe raportimi i investimeve me burim financimi të ardhurat e arsimit të lartë kryhet në projekte investimi të sintetizuara për disa njësi shpenzuese.
Situata:	Nga auditimi mbi investimet kapitale me financim të brendshëm të realizuara nga të ardhurat dytësore, për vitin 2020 të regjistruara në SIFQ, konstatohet se janë realizuar investime kapitale me financim të brendshëm në vlerën për 309,152 mijë lekë. Këto investime nuk kanë plan buxheti të miratuar, ndërkohë që në Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar janë raportuar të realizuara ndaj planit të buxhetit. Sipas të dhënave të raportuara në investimet e realizuara për vitin 2020, këto investime janë realizuar në pjesën më të madhe nga të ardhurat e veta të njërive buxhetore në programin e shërbimeve të kujdesit dytësor të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në shumën 210,973 mijë lekë. Nga auditimi mbi investimet kapitale me financim të brendshëm të realizuara me burim financimi të ardhurat e arsimit të lartë konstatohet se janë kontabilizuar në llogarinë 231 ÷Investime Kapitale Të Trupëzuara÷ 13 projekte investimi me vlerë 192,670 mijë lekë me përshkrimin investimi ÷Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve÷ dhe 1 projekt investimi në shumën 977 mijë lekë me përshkrimin ÷IAL dhe programe studimi të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

	akredituar, në disa njësi shpenzuese të ndryshme. Gjithashtu konstatohet se për këto investime është përdorur i njëjti kod projekti investimi për disa institucione të arsimit të lartë, duke mos identifikuar specifikisht investimet e kryera në nivel produkti investimi me impakt në cilësinë e informacionit të raportuar dhe vështirësi në ndjekjen e ecurisë së tyre.
Impakti:	Mungesë ndjekje të investimeve në nivel produkt investimi dhe lejimi i planifikimit të investimeve të tjera
Shkaku:	Mos detajimi i planit dhe përdorimi i projekte të investimit të njëjta
Rëndësia:	E mesme
Kriteri:	Përkufizimi i investimit publik në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor
Rekomandimi:	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të reflektohet në treguesit fiskalë të konsoliduar, sipas tabelës 4 të ligjit të buxhetit të vitit, plani buxhetor për të gjitha investimet kapitale të brendshme me burim financimi të ardhurat e veta sikurse parashikohen për investimet nga të ardhurat e arsimit të lartë. Në të njëjtën kohë, të detajohen në nivel analitik investimet e realizuara nga të ardhurat e veta të arsimit të lartë dhe të shmanget çelja e projekteve të investimit në një kod të përgjithshëm ndërkohë që projektet zbatohen nga njësi shpenzuese të ndryshme.

Gjetja:	Ndërmarrja e angazhimeve të reja jashtë afatit dhe përdorimi i buxhetit të vitit 2020 për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura
Situata:	<p>Nga auditimi i të dhënave në lidhje me kontratat e nënshkruara për investimet përgjatë vitit 2020, sipas modulit të kontratave në SIFQ konstatohet se janë nënshkruar kontrata pas datës 15 Tetor për investimet publike, duke qenë jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 <i>“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ku citohet “Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor”.</i> Institucionet më përfaqësuese të cilat nuk respektojnë këtë përcaktim të ligjit përfshijnë Fondin Shqiptar të Zhvillimit me vlerë të kontraktuar 10,180 milion lekë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me vlerë të kontraktuar në shumën 7,820 milion lekë. Lidhja e kontratave pas kësaj datë krijon kushtet për lindjen e detyrimeve të prapambetura dhe në të njëjtën kohë për përdorim pa efikasitet të fondeve buxhetore në nivelin e 20% të kostos së projektit në vitin e parë të zbatimit të tij, pasi koha e mbetur për përdorimin e këtij fondi deri në fund të vitit buxhetor është shumë e shkurtër.</p> <p>Nga auditimi mbi pagesat e realizuara gjatë vitit 2020, konstatohet se, janë paguar detyrime të prapambetura në verën 6,395,945 mijë lekë të cilat përfaqësojnë rreth 11% të Investimeve Kapitale me Financim të Brendshëm të realizuara për vitin 2020. Institucionet më përfaqësuese të cilat kanë paguar detyrime të prapambetura përfshijnë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Fondin Shqiptar të Zhvillimit, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe grupin e institucioneve të tjera qeveritare</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

	me përfaqësues Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Pagesa e këtyre detyrimeve të cilat janë raportuar si investime të vitit 2020, nuk është në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor ku përcaktohet se metoda e njohjes së shpenzimeve është në momentin e ndodhjes së tyre, pavarësisht momentit të pagesës. Për këtë arsye, treguesit e realizimit të investimeve publike janë të mbivlerësuara për këtë nivel, duke paraqitur si investime të vitit, investime, faturat e të cilave datojnë që nga viti 2013.
Impakti:	Krijim detyrimesh të prapambetura, mbivlerësim treguesish të investimeve
Shkaku:	Lidhja e kontratave dhe mos raportimi në kohë i faturave të investimit
Rëndësia:	E lartë
Kriteri:	Neni 52 dhe 61 i ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar

Gjetja:	Në detajimin fillestar të investimeve çelen projekte me përshkrimin fond i ngrirë
Situata:	Nga auditimi mbi detajimin e fondeve për investimeve publike me financim të brendshëm të miratuara me ligjin nr.88/2019 për buxhetin e vitit 2020, të ndryshuar, konstatohet se janë detajuar në institucione të ndryshme 19 Projekte Investimi me vlerë 683,809 mijë lekë me përshkrimin “Fond i ngrirë” . Institucionet më përfaqësuese ku janë detajuar këto fonde përgjatë vitit përfshijnë Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe Autoritetin Rrugor Shqiptar. Detajimi i këtyre fondeve të ngrira për investime kapitale nuk është në përputhje me përkufizimin e projektit të investimit publik ku citohet se <i>“Projekt investimi” është një seri punimesh, aktivitësh apo shërbimesh, që synojnë të përmbushin një objektiv të pandashëm të një natyre specifike ekonomike apo teknike, me qëllime qartësisht të identifikuar</i> . Rezervimi i fondeve të këtyre investimeve sipas detajimit fillestar nuk krijon mundësinë e zhvillimit të procedurave për prokurimin përgjatë vitit apo kryerjen e pagesave në rast të detyrimeve të mbartura dhe në vijim kryhen rishpërndarje ndërmjet projekteve për çdo njësi shpenzuese. Në fund të vitit, sipas planit përfundimtar, vlera e këtyre projekteve paraqitet në shumën 10,448 mijë lekë. Detajimi i këtyre fondeve pa projekt specifik në çeljen fillestare në shumën 683,809 mijë lekë nuk është në përputhje me kërkesat e udhëzimit plotësues nr. 2 datë 20.01.2020 të MFE, pika 19, ku janë të parashikuara kriteret dhe përparësitë në financimin e projekteve dhe nuk parashikohet çelja e fondeve të ngrira për investimet kapitale të miratuara.
Impakti:	Mos përdorim në kohë i fondeve buxhetore
Shkaku:	Mos detajimi i investimeve
Rëndësia:	E mesme
Kriteri:	Përkufizimi i investimit publik në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor
Rekomandimi:	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të shmanget praktika e detajimit të fondeve të investimeve në projekte me përshkrim “Fond i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

	ngrirëo dhe të alokohen fondet e investimit në projekte specifike për të krijuar mundësinë e përdorimit të fondeve buxhetore të miratuara.
--	--

Gjetja:	Përdorimi i fondeve buxhetore të miratuara për investime në shpenzime operative referuar natyrës së transaksioneve të kryera
Situata:	<p>Nga auditimi mbi planifikimin, realizimin dhe raportimin e investimeve kapitale me financim të brendshëm konstatohet se janë raportuar si investime kapitale shpenzime të kryera për aktivitetin korent të institucioneve buxhetore në shumën 1,197,956 mijë lekë, të cilat duhet të ishin planifikuar dhe realizuar në zërin e shpenzimeve korente sipas klasifikimit të bërë në tabelën 4 të ligjit të buxhetit të vitit. Rastet në të cilat janë konstatuar këto problematika përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none">-Në Autoritetin Rrugor Shqiptar , konstatohet se raportohet si investim i realizuar në vitin 2020, projekti i investimit me kod M062991 me përshkrim òVendime gjyqësore në procesò me vlerë për 446,614 mijë lekë, buxhetuar dhe realizuar nga ky institucion, nga të cilat 396,907 mijë lekë për vendime gjyqësore të viteve 2014-2019 sipas datës së paraqitur në sistemin informatik financiar të qeverisë, ndërkohë që për planifikimin dhe realizimin e këtyre shpenzimeve duhet të ishin përdorur llogaritë e shpenzimeve operative në nënndarjen e shpenzimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.-Në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në programin buxhetor 6210 òPrograme zhvillimiò raportohet si investim i realizuar kosto lokale e menaxhimit të projekteve të investimit në shumën 302,043 mijë lekë, me kod projekti òM560322ò Projekti i rrugëve dytësore dhe lokaleò, me përfitues Fondin Shqiptar të Zhvillimit, ndërkohë që këto fonde përdoren në llogari bankare të nivelit të dytë nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për aktivitetin e shpenzimeve korente të institucionit.-Në AZHBR, nga auditimi mbi investimet e realizuara në programin 4250 òZhvillimi ruralò konstatohet se janë raportuar investime kapitale me kod projekt 18AL301 òPërfitues nga Programi IPARD II nga masa 1ò në shumën 449,299 mijë lekë, nga kapitulli 3 òkosto lokaleò. Në bazën e të dhënave të pagesave të realizuara në SIFQ konstatohet se njësi shpenzuese është AZHBR me përfitues Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me përshkrimin Fondi Kombëtar IPARD II, kosto lokale dhe sipas pagesës së listave përkatëse. Këto pagesa kryhen në kuadër të bashkëfinancimit të fondeve të BE për mbështetjen e fermerëve/agroturizimit në kryerjen e investimeve nga ana e investitorëve. Pjesa e buxhetit të shtetit në kuadër të bashkëfinancimit është në masën 25%, ndërkohë që konstatohet se për nga natyra, nuk kemi të bëjmë me investim kapital, por me grant të dhënë të tretëve. Në këtë mënyrë, treguesit e investimeve publike janë të mbivlerësuar si pasojë e raportimit të realizimit të këtij projekti, pasi nuk kemi të bëjmë me kryerjen e investimeve publike ku pronar është shteti, por dhënien e grantit drejt përfituesve të ndryshëm për kryerjen e investimeve nga ana e tyre.
Impakti:	Mbi vlerësim i treguesve të investimeve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE
EKONOMISË

Shkaku:	Planifikimi dhe raportimi i gabuar i fondeve
Rëndësia:	E lartë
Kriteri:	Ligji nr.88/2019 i ndryshuar për nivelin e miratuar të fondeve, sipas tabelës 1 dhe 4 të tij.
Rekomandimi:	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë gjatë fazës së diskutimit të kërkesave buxhetore dhe në vijim të detajimit të fondeve sipas kërkesave të institucioneve buxhetore të zhvillohet një analizë mbi natyrën ekonomike të fondeve të kërkuara me qëllim klasifikimin dhe raportimin e drejtë të shpenzimeve sipas natyrës dhe destinacionit.

Gjetja:	Janë paguar investime të planifikuara nga llogaritë e garancive të vitit.
Situata:	Nga auditimi konstatohet se në listën e investimeve publike të planifikuara dhe realizuara, vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Investimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, është paraqitur i planifikuar dhe realizuar në shumën 198,000 mijë lekë projekti 18AV703 “Pagesa ndërkombëtare në institucione financiare të tjera”, në programin 1130 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Ndërkohë, nga auditimi i databazës së pagesave në SIFQ konstatohet se janë kryer pagesa duke përdorur llogarinë e lëshimit të garancive me përfitues Korporatën Shqiptare të Investimeve me numër llogarie 466213 “Garanci te vitit vazhdim për sigurimin e kontratës, të dala” me datë furnitori 31.12.2020 me përshkrimin “Min.Fin.Kalim fond. Ngurtës. llogarinë e shoq.Korpor.Invest.Shqiptare,Urdher nr. 174/1, dt. 31.12.20, nr. 13617/1 prot, rrit. autoriz. D.Thesar Tirane nr. 777, dt. 31.12.2020, urdh nr. 174, dt. 16.07.20, nr. 13617 prot, status I shoqërisë.”. Kjo pagesë është kryer me kod projekti A000005 “Mallra e shërbime(kap.6)”, në shumën 197,802 mijë lekë ndërkohë që pjesa tjetër është kryer me kod projekt 18AV703 “Pagesa ndërkombëtare ne institucione financiare te tjera” në shumën 197,738 lekë. Pra, për kryerjen e kësaj pagese janë përdorur llogaritë e garancisë së vitit në vazhdim, ndërkohë që sipas informacioneve mbi investimet kapitale të dërguara nga Drejtoria e Investimeve kjo pagesë rezulton e planifikuar dhe realizuar nga llogaritë e investimeve. Për këtë arsye, vlera prej 197,802 mijë lekë nuk rezulton të jetë e pasqyruar në treguesit fiskalë në zërin e investimeve kapitale, duke nënvlerësuar këtë tregues në publikim.
Impakti:	Nënvlerësim i treguesve të investimeve
Shkaku:	Përdorimi i llogarisë së garancive për pagesën
Rëndësia:	E mesme
Kriteri:	Ligji nr.99/2018, i ndryshuar
Rekomandimi:	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të reflektohen në treguesit fiskal efekti i pagesës së kryer për projektin 18AV703 sipas fondeve të miratuara për këtë qëllim dhe të shmangët praktika e pagesës së detyrimeve që nuk kanë lidhje me përdorimin e llogarive të garancive të cilat përdoren sipas rezervimit fillestar të krijuar për to dhe jo vetëm.

Gjetja:	Janë lidhur kontrata për të cilat nuk ka pasur fonde të çelura në SIFQ
----------------	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

	në momentin e kontraktimi dhe nuk janë regjistruar angazhimet në kohë duke përdorur dhe fondin rezervë të buxhetit për ngjarje jo të paparashikuara
Situata:	Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e investimeve kapitale me financim të brendshëm konstatohet se janë realizuar pagesa nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për projektin 19AF001 “Blerja e godinës Poli Drejtësisë” në shumën 790.2 milion lekë me përfitues Ndërmarrja Industriale nr.1. Ky projekt nuk rezulton të jetë i planifikuar në PBA në investimet kapitale të miratuara në programin buxhetor 4230 òProgrami 100 fshatratò dhe programin buxhetor 6210 òPrograme zhvillimiò në Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Rishikimet e buxhetit në rritje për këto projekte janë bërë në muajin Korrik duke rritur vlerën e buxhetit me 200 milion lekë në programin 4230 dhe 420.2 milion lekë në programin 6210 në zbatim të VKM nr. 356 datë 26.02.2020, ndërkohë që në muajin Dhjetor 2020 është përdorur fondi rezervë i buxhetit të shtetit në shumën 170 milion lekë, veprim i pasqyruar në sistemin informatik financiar të qeverisë në 11.01.2021, sipas VKM nr. 1127 datë 30.12.2020. Konstatohet se detajimi për herë të parë i fondeve është kryer nëpërmjet rishikimit buxhetor përgjatë vitit ndërkohë që vlera e plotë e kontratës nuk është regjistruar në modulën e kontratave të vendosura në dispozicion nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Ky projekt investimi nuk rezulton të jetë i parashikuar në PBA 2020-2022 të Fondit Shqiptar të Zhvillimit ndërkohë që është lidhur kontrata e shitjes sipas përshkrimit të pagesës me nr. 180 Rep 75 kol dt 08.06.2020.
Impakti:	Marrja e angazhimeve pa fondet e mjaftueshme për projekte të reja
Shkaku:	Mos detajimi i fondeve në SIFQ për projekte për të cilat është lidhur kontrata
Rëndësia:	E lartë
Kriteri:	Ligji nr.88/2019 i ndryshuar dhe ligji nr. 9936 datë 26.06.2008, i ndryshuar

Gjetja:	Nga audimi mbi detajimin dhe rishpërndarjen e fondeve të investimeve në projekte investimi përgjatë vitit janë konstatuar problematika që përfshijnë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore në dispozicion, detajimin e projekteve të investimeve publike me akt normativ pa kaluar në PBA 2020-2022, detajimin e fondeve të investimeve për vetëm vlerën e 20% të kostos së projektit pa buxhet në vitet pasardhëse buxhetore, detajimin e planit buxhetor në 3 vite për investime që përfshijnë periudhë faturimi për kontrata që parashikojnë periudhë faturimi më të vogël se një vit, shkurtimin e fondeve të investimit në momentin e lidhjes së kontratës dhe rialokimin e këtyre fondeve drejt projekteve të tjera të investimit publik detyrime të prapambetura apo në proces nga vitet e kaluara, mosregjistrimin e kontratave dhe rrjedhimisht mos regjistrimin e obligimit në SIFQ duke lejuar ndërmarrjen e angazhimeve buxhetore dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura.
----------------	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

Situata:	<p>Nga audimi mbi detajimin dhe rishpërndarjen e fondeve të investimeve përgjatë vitit 2020 janë konstatuar problematika që përfshijnë marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore në dispozicion, detajimin e projekteve të investimeve publike me akt normativ pa kaluar në PBA 2020-2022, detajimin e fondeve të investimeve për vetëm vlerën e 20% të kostos së projektit pa buxhet në vitet pasardhëse buxhetore, detajimin e planit buxhetor në 3 vite për kontrata që parashikojnë periudhë faturimi më të vogël se një vit, shkurtimin e fondeve të investimit në momentin e lidhjes së kontratës dhe rialokimin drejt projekteve të tjera të investimit publik detyrime të prapambetura apo në proces nga vitet e kaluara, mos regjistrimin e kontratave dhe obligimit në SIFQ duke krijuar detyrime të prapambetura. Këto parregullsi të identifikuara janë mundësuar edhe nga miratimi i dhënë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në detajimin fillestar të fondeve të investimit apo rialokimet e kryera përgjatë vitit. Të analizuar sipas programeve buxhetore dhe institucioneve përkatëse ku janë konstatuar problematikat paraqiten:</p> <p>-Programi buxhetor 6210 “Programe zhvillimi” nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Nga auditimi konstatohet se ky program buxhetor me Aktin Normativ nr. 28 datë 02.07.2020 është rritur me 3 miliard lekë ndërsa me Aktin Normativ nr. 34 datë 16.12.2020 është ulur me 1.3 miliard lekë. Fillimisht, me Aktin Normativ 28/2020, fondet e shtuara për investimet kapitale me financim të brendshëm kanë shkuar për hapjen e 21 projekteve të reja investimi të cilët nuk kanë kaluar ciklin e menaxhimit të investimeve publike në PBA 2020-2022 dhe për të cilat është detajuar vetëm vlera e parashikuar për vitin 2020 në shumën 3 miliard lekë referuar shkresës së MFE nr. 12507/97 datë 03.08.2020 për miratimin e rialokimit të fondeve me kërkesën e FSHZH me nr. 1453/3 datë 27.07.2020. Nga auditimi konstatohet se buxheti i kërkuar për vitin 2021 për këto 21 projekte paraqitet në shumën 6,993,522 mijë lekë ndërkohë që sipas ligjit nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, i ndryshuar plani i investimeve me financim të brendshëm për vitin 2021 është në shumën 3.8 miliard lekë duke lejuar ndërmarrjen e angazhimeve përtej kufirit të miratuar të <u>investimeve në këtë program</u>. Për këto projekte, sipas kontratave, konstatohet se janë ndërmarrë angazhime në shumën 5,951 milion lekë për 20 prej tyre, megjithëse fondet në dispozicion në muajin dhjetor 2020 paraqiten në shumën 880 milion lekë, duke qenë se në muajin dhjetor janë shkurtuar fondet për këto projekte.</p> <p>Përveç projekteve të mësipërme, në muajt Shtator dhe Tetor 2020, është miratuar rialokimi i projekteve të reja, duke detajuar vetëm vlerën e 20% të projektit të investimit në vitin e parë dhe duke e transferuar detyrimin për këto projekte në vitet e ardhshme buxhetore. Vlera e buxhetuar për vitin 2020 për këto projekte është në shumën 543,063 mijë lekë, ndërkohë që konstatohet se janë lidhur 4 kontrata me afat 8-12 muaj në shumën 1,430,519 mijë lekë. Periudha e kohëzgjatjes së projektit nuk përputhet me periudhën e buxhetit të alokuar sipas viteve. Për këto projekte konstatohet se janë lidhur në kundërshtim me afatin e ndërmarrjes së angazhimeve në</p>
-----------------	---



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

vitin buxhetor prej 15 tetorit, duke qenë se janë nënshkruar ndërmjet 23 Nëntor-04 Dhjetor 2020. Pas nënshkrimit të kontratave vlere e përcaktuar si buxhet 20% në vitin e parë është shkurtuar në shumën 237,743 mijë lekë, duke mos respektuar këtë kusht gjatë gjithë vitit të parë të projektit sipas kohëzgjatjes së kontratës. Problematika për këto kontrata reflektohet edhe në projekt buxhetin e vitit 2021 në listën e investimeve publike, ku mungesa e përballimit të angazhimeve të ndërmarrja/në proces ka sjellë përfshirjen e planit të buxhetit të tyre pas vitit 2023, jashtë periudhës 3 vjeçare në të cilën miratohet buxheti pasi janë ndërmarrë angazhime pa fonde buxhetore dhe miratimi i ndryshimeve në buxhet është kryer duke mos marrë në konsideratë menaxhimin trevjeçar të tyre duke mbartur problematikat në vitet e ardhshme buxhetore.

-Programi buxhetor 4520 “Transporti rrugor”, MIE dhe ARRSH. Programi buxhetor “Transporti rrugor” për investimet me financim të brendshëm është planifikuar me ligjin e buxhetit të vitit në shumën 14,495,800 mijë lekë. Me Aktin Normativ nr.6 datë 21.03.2020 është ulur financimi i këtij programi me 500 milion lekë, në projektet e studim projekteve në fushën e infrastrukturës, supervizionit të punimeve dhe një kontratë koncesionare. Me aktin Normativ nr. 15 datë 15.04.2020 vlere e investimeve është ulur me 1 miliard lekë, reflektuar në planin e kontratës koncesionare të rrugës së Arbrit. Me aktin Normativ nr. 28 datë 28/2020 vlere e financimit është rritur me 7,196,336 mijë lekë. Në muajin Gusht është kryer rialokim ndërmjet projekteve, ku fondi i ngrirë është detajuar në projektin 18BS609 “Ndërtim mbikalimi Teg dhe rrugët lidhëse të tij”. Në muajin Tetor 2020 janë kryer përsëri rialokime duke shtuar projektet 18BA201 “Kontrata e Koncesionit/PPP për përmirësimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e rrugës së Arbrit” në shumën 370 milion lekë (ulja e mëparshme 1 miliard lekë) dhe duke shtuar projektin 18BS612 “Ndërtim rruga Palasë Dhërmi” në shumën 440 milion lekë (përballuar nga ulja “Ndërtim rruga Kardhiq - Delvine Loti 7”, projekt në vazhdim nga viti 2019 dhe projekti i shpronësimeve). Në muajin Nëntor është ulur përsëri vlere e shpronësimeve të planifikuara dhe janë shtuar dy projekte të reja të investimeve, konkretisht projekti 18BS532 “Rikonstrukcion i rrugës Dukaj - Sinanaj, Tepelenë” në shumën 100 milion lekë dhe projekti 18BS533 “Ndërtim i rrugës, lidhja e Autostrades Milot - Morine me Aeroportin e Kukësit” në shumën 144 milion lekë. Konstatohet se rialokimet ndërmjet projekteve shtojnë vlerat për projekte të reja, ndërkohë që ndërpresin financimin për projekte në vazhdim, projektin koncesionar dhe kontrata të vitit 2019, me efekt në krijimin e detyrimeve në prapambetura. Me aktin Normativ nr. 34/2020 janë kryer rishikime që konsistojnë në uljen e buxhetit nga projektet në prokurim/kontrata të lidhura rishtazi, në projekte investimi në vazhdim. Kryerja e rishikimeve pas 15 Nëntorit është në kundërshtim me afatin e parashikuar në ligjin e buxhetit për rishpërndarjen e fondeve buxhetore si dhe akomodon efektet e detyrimeve të pa financuara si pasojë e alokimit të buxhetit në projekte infrastrukturore në masën 20 % të çelura me akt normativ në Korrik 2020,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

pa kaluar në PBA 2020-2022. Projektet e evidentuara me problematika nga auditimi në këtë program buxhetor përfshijnë:

-Projekti 18BS612 “Ndërtim rruga Palasë – Dhërmi”, është detajuar në muajin Tetor 2020 me vlerë të buxhetuar për vitin 2020 në shumën 440 milion lekë, e cila në Dhjetor 2020 është rishikuar me plan përfundimtar 1,000 lekë. Ky projekt nuk ka qenë pjesë e PBA 2020-2022, ndërkohë që paraqitet në PBA 2021-2023 në shumën 850 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se për këtë projekt janë filluar procedurat e prokurimit në datë 22.10.2020 është lidhur kontrata në shumën 1,875,366,221 lekë me TVSH në vitin 2021. Konstatohet se procedura e prokurimit ka vazhduar megjithëse nuk ka pasur fonde dhe vlera e angazhuar në total nuk përputhet me koston e këtij projekti në PBA 2021-2023 në shumën 850 milion lekë, **duke ndërmarrë angazhime përtej buxhetit të miratuar në shumën 1,025,366, mijë lekë** me efekt në krijimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe ky projekt nuk është parashikuar të financohet në Projekt Buxhetin 2021.

-Projekti 18BS609 “Ndërtim mbikalimi TEG dhe rrugët lidhëse të tij”, është detajuar në muajin Gusht 2020 me vlerë të buxhetuar për vitin 2020 në shumën 340 milion lekë, e cila në Dhjetor 2020 është rishikuar me plan përfundimtar 1,000 lekë. Ky projekt nuk ka qenë pjesë e PBA 2020-2022, ndërkohë që paraqitet në PBA 2021-2023 në shumën 889 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se për këtë projekt janë filluar procedurat e prokurimit në datë 15.10.2020 dhe është lidhur kontrata në shumën 1,683,183 mijë lekë me TVSH në vitin 2021. Konstatohet se procedura e prokurimit ka vazhduar megjithëse për këtë projekt investimi nuk ka pasur fonde në dispozicion dhe vlera e angazhuar në total nuk përputhet me koston e këtij projekti në PBA 2021-2023 në shumën 889 milion lekë, **duke ndërmarrë angazhime përtej buxhetit të miratuar në shumën 794,183 mijë lekë** me efekt në krijimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe ky projekt nuk është parashikuar që të financohet në Projekt Buxhetin 2021.

-Projekti 18BS532 “Rikonstruksion i rrugës Dukaj –Sinanaj Tepelenë”, është detajuar në muajin Nëntor 2020 me vlerë të buxhetuar për vitin 2020 në shumën 100 milion lekë, e cila në Dhjetor 2020 është rishikuar me plan përfundimtar 1,000 lekë. Ky projekt nuk ka qenë pjesë e PBA 2020-2022, ndërkohë që nuk paraqitet as në PBA 2021-2023 dhe as në listën e investimeve paraqitur me Projekt Buxhetin 2021. Nga auditimi konstatohet se për këtë projekt janë filluar procedurat e prokurimit në datë 19.10.2020 dhe është lidhur kontrata në 21.12.2020 në shumën 456,682 mijë lekë. Konstatohet se procedurat e prokurimit kanë filluar përpara se të detajohen fondet në SIFQ, pra pa pasur fondet në dispozicion dhe **vlera e angazhuar në total në shumën 456,682 mijë lekë** është përtej buxhetit të miratuar me efekt në krijimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe ky projekt nuk është parashikuar që të financohet në Projekt Buxhetin 2021.

-Projekti 18BS533 “Ndërtim i rrugës, lidhja e Autostradës Milot - Morine me Aeroportin e Kukesit”, është detajuar në muajin Nëntor 2020 me vlerë të buxhetuar për vitin 2020 në shumën 144 milion lekë, e cila në Dhjetor



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

2020 është rishikuar me plan përfundimtar 1,000 lekë. Ky projekt nuk ka qenë pjesë e PBA 2020-2022, ndërkohë që nuk paraqitet as në PBA 2021-2023 dhe as në listën e investimeve paraqitur me Projekt Buxhetin 2021. Nga auditimi konstatohet se për këtë projekt janë filluar procedurat e prokurimit në datë 19.10.2020 dhe është lidhur kontrata në 24.12.2020 në shumën 681,263 mijë lekë. Konstatohet se procedurat e prokurimit kanë filluar pa pasur fondet në dispozicion dhe vlera e **angazhuar në shumën 681,263 mijë lekë është përtej buxhetit të miratuar me efekt në krijimin e detyrimeve të prapambetura**, si dhe ky projekt nuk është parashikuar që të në Projekt Buxhetin 2021.

*-Projekti 18BS529 “Ndërtim rruga Korçë Ersekë Loti 2 (pjesa e parë), është parashikuar në PBA 2020-2022 me plan buxheti në total për tre vite në shumën 1.2 miliard lekë. Detajimi i këtij investimi është kryer me Aktin Normativ nr.28/2020 në shumën 576 milion lekë në muajin Korrik dhe është rishikuar në rritje në Dhjetor 2020 duke paraqitur një plan përfundimtar në shumën 606,828 mijë lekë. Nga auditimi konstatohet se për këtë projekt është lidhur kontrata në shumën 2,822,415 mijë lekë me TVSH me afat 24 muaj, duke angazhuar fonde përtej atyre të planifikuara në PBA 2020-2022 (në vlerën 1.2 miliard lekë) me datë kontrate 08.10.2020, regjistruar në SIFQ në datë 12.10.2020. **Ndërmarrja e angazhimit është përtej fondeve në dispozicion për diferencën në shumën 1,622,415 mijë lekë** dhe miratimi i këtij investimi duke çelur vlerën e vetëm 20% të kostos së projektit kanë mundur detyrimet e prapambetura duke qenë se periudha e kohëzgjatjes së punimeve nuk përputhet me periudhën e buxhetuar për shlyerjen e këtij investimi.*

Problematika për disa nga këto kontrata reflektohet edhe në projekt buxhetin e vitit 2021 në listën e investimeve publike, ku mungesa e përbalimit të angazhimeve të ndërmarrja/në proces ka sjellë përfshirjen e planit të buxhetit të tyre pas vitit 2023, jashtë periudhës në të cilën buxheti miratohet nga parlamenti. Nga auditimi konstatohet se angazhimet e ndërmarrja janë duke u shtrirë pas vitit 2023 për projekte të reja të iniciuara duke krijuar mundësinë për detyrime të prapambetura, si pasojë e hapjes së shumë projekte të investimit publik dhe copëzimit të buxhetit për kontratat e nënshkruara apo angazhimet në proces. Këto krijojnë kushte për detyrime të prapambetura dhe presion rritës për nivelin e borxhit publik si pasojë e nevojës për financim në përputhje me ecurinë e faturimit për kontratat përkatëse.

- Programi buxhetor 6370 “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”

Programi buxhetor “Furnizimi me ujë dhe kanalizime” është planifikuar me ligjin e buxhetit të vitit në shumën 3,970 mijë lekë. Me aktin normativ nr. 28/2020 është rritur financimi me 1.5 miliard lekë, dhe me aktin normativ nr. 34/2020 është rritur financimi me 3.1 miliard lekë. Shtesa e projekteve të investimeve në këtë program është kryer duke çelur projekte të reja për vetëm 20% të vlerës në vitin e parë të projektit ndërkohë që për vitet e tjera nuk është mbuluar me buxhet vlera e kontraktuar. Nga auditimi konstatohet se me shkresën nr.12507/74 date 21.07.2020 të MFE është



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

miratuar kërkesa e MIE me nr. 5098/9 date 13.07.2020 për detajimin e fondeve për investime në vijim të aktit normativ nr. 28 datë 02.07.2020 ku janë shtuar objekte të reja investimi në buxhetin e vitit 2020 ndërkohë që vlera e parashikuar për buxhetin e vitit 2021 dhe 2022 është 0 lekë. Nga auditimi konstatohet se për projektet e mësipërme, është detajuar vlera prej 825,704 mijë lekë me njësi zbatuese njësi të vetëqeverisjes vendore apo njësi varësie të tyre. Vlera e kontratave të regjistruara në SIFQ në modulën e kontratave rezultojnë në shumën 3,919,780 mijë lekë, duke marrë angazhime mbi fondet në dispozicion të vendosura nëpërmjet aktit normativ 28, ku janë detajuar për herë të parë. Për rrjedhojë **diferenca prej 3,094,076 mijë lekë rezultojnë angazhim pa fonde buxhetore për 23 projekte ku ndër të tjera disa prej tyre nuk plotësojnë as vlerën prej 20% të kostos së projektit në vitin e parë të zbatimit, në krahasim me shumën e kontraktuar, duke qenë në kundërshtim me parashikimet e bëra në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.**

Vlerat e detajuara për projektet e investimeve dhe rishikimet e buxhetit përgjatë vitit nuk kanë shkuar për financimin e projekteve ekzistues, por për hapjen e projekteve të reja, duke lejuar krijimin e detyrimeve të prapambetura në këtë program buxhetor. Nga auditimi konstatohet se, edhe shtesa e fondeve buxhetore në shumën 3.1 miliard lekë me Aktin Normativ nr.34 datë 16.12.2020 nuk ka mundur mbulimin e efektit të ndërmarrjes së angazhimeve pa fonde buxhetore, duke qenë se janë krijuar detyrime të prapambetura të tjera të cilat nuk janë financuar brenda vitit buxhetor 2020, ku konstatohen detyrime në shumën 638,293 mijë lekë. Në mënyrë të detajuar, problematikat e konstatuara nga auditimi në lidhje me disa projekte paraqitet si në vijim:

-Produkti 18BQ445 “Rikonstrukcion magjistrali kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit qytetit Patos Loti I”. Në PBA faza II 2020-2022 dhe Projekt Buxhetin e vitit 2020, ky investim është parashikuar në shumën 541,844 mijë lekë. Nga auditimi konstatohet se ky investim është kontraktuar nga Bashkia Patos në shumën 532,867 mijë lekë me afat zbatimi 18 muaj. Kontrata e lidhur është lidhur në kushtet e mungesës së fondeve të nevojshme duke qenë se në momentin e lidhjes së saj janë të çelura në SIFQ fonde në vitin e parë në shumën 10 milion lekë. Gjithashtu konstatohet se plani i buxhetit për këtë projekt është i shtrirë në 4 vite, duke krijuar detyrime të prapambetura pasi plani i pagesës nuk përputhet me afatin e faturimit. Planin e buxhetit për këtë projekt për vitin 2021 është në shumën 10 milion lekë dhe për vitin 2022 në shumën 20 milionë lekë, duke e transferuar detyrimin përtej buxhetit 3 vjeçar të miratuar me ligj. **Në total angazhimi pa fonde buxhetore në momentin e kontraktimit vlerësohet në shumën 523 milionë lekë.**

-Produkti M064166 “Rikonstrukcion magjistrali kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Patos Loti II”. Në PBA faza II 2020-2022 dhe Projekt Buxhetin e vitit 2020, ky investim nuk është parashikuar fare. Fondet për këtë projekt investimi janë detajuar në muajin Qershor në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

shumën 144 milion lekë dhe janë ulur në Nëntor në shumën 9 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se ky investim është kontraktuar nga Bashkia Patos në shumën 705 milion lekë me afat zbatimi 24 muaj. Kontrata e lidhur është lidhur në kushtet e mungesës së fondeve të nevojshme duke qenë se në momentin e lidhjes së saj janë të çelura në SIFQ fonde në vitin e parë në shumën 9 milion lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. Në PBA 2021-2023 kosto totale e projektit është në shumën 190 milion lekë ndërkohë që në projekt buxhet 2021 është në shumën 720 milion. Vlera e investimit ndryshon në të dy dokumentet buxhetore dhe shpërndarja e buxhetit sipas viteve nuk përputhet me periudhën e faturimit në bazë të afatit të zbatimit sipas kontratës, duke krijuar detyrime të prapambetura. **Këto veprime lejojnë copëzimin e fondeve sipas viteve, me qëllim shtimin e investimeve dhe krijojnë kushtet për ndërmarrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore në shumën 696 milion lekë.**

-Projekti 19AF206 “Ndërtim ujësjellësi për furnizimin me ujë të qytetit Burrel të fshatrave të njësisë administrative Derjan dhe Rukaj –Loti I”. Në PBA faza II 2020-2022 dhe Projekt Buxhetin e vitit 2020, ky investim nuk është parashikuar fare. Fondet për këtë projekt investimi janë detajuar në muajin Korrik në shumën 135 milion lekë për vitin. Nga auditimi konstatohet se ky investim është kontraktuar nga Bashkia Mat me datë 09.10.2020 në shumën 669 milion lekë me afat zbatimi 12 muaj. Nga auditimi konstatohet se shpërndarja e buxhetit sipas viteve nuk përputhet me afatin kohor të zbatimit të punimeve duke krijuar detyrime të prapambetura. Kosto totale e projektit Në PBA 2021-2023 dhe Projekt Buxhetin 2021 është respektivisht 225 milion lekë dhe 674 milion mijë lekë.

-Projekti 18CG001 “Linja kryesore për furnizimin me ujë dhe rrjeti shpërndarës i ujësjellësit për qytetin e Belshit, Faza II” dhe Projekti 18CG003 “Linja Kryesore për furnizimin me ujë dhe rrjeti shpërndarës i ujësjellësit për qytetin e Belshit, Faza III”. Në PBA faza II 2020-2022 dhe Projekt Buxhetin e vitit 2020, investimet janë parashikuar në vlera të ndryshme respektivisht 416 milion lekë dhe 1,090 milion lekë. Paraqitja në projekt buxhet nuk është e saktë për sa i përket koston totale të investimit pasi shuma e buxhetit të shpërndarë sipas viteve prej 416,074 mijë lekë nuk rakordon me koston totale të projektit në shumën e paraqitur prej 1,090,371 mijë lekë. Ky investim i parashikuar në PBA 2020-2022 në një produkt të vetëm që përfshin fazën II dhe fazën III në vijim është ndarë në dy produkte të ndryshme investimi. Nga auditimi konstatohet se nga Bashkia Belsh, janë nënshkruar dy kontrata në shumën 954,337 mijë lekë, të ekzekutueshme brenda vitit 2020, duke qenë se kohëzgjatja e kontratës është 4 muaj nga data e lidhjes. Fondet në dispozicion sipas detajimit fillestar paraqiten në shumën 135 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se shpërndarja e buxhetit sipas viteve nuk përputhet me afatin kohor të zbatimit të punimeve prej 4 muaj duke krijuar detyrime të prapambetura



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

dhe janë ndërmarrë angazhime pa fonde në shumën 819 milion lekë.

-Projekti 18BQ469 “Rikonstruksioni i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut”. Në PBA faza II 2020-2022 dhe Projekt Buxhetin e vitit 2020, ky investim është parashikuar në vlera të ndryshme respektivisht 303 milion lekë dhe 450 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se ky investim është kontraktuar nga Bashkia Kolonjë në shumën 274 milion lekë me afat zbatimi 12 muaj. Shpërndarja e buxhetit sipas viteve nuk përputhet me afatin kohor të zbatimit të punimeve prej 12 muaj duke krijuar detyrime të prapambetura.

-Projekti 19AF901 “Ndërtim ujësjellësi për qytetin Ersekë dhe fshatrat, Faza e II-të nga Burimet e Kozelit, nuk rezulton i parashikuar në PBA 2020-2022 dhe është kontraktuar nga Bashkia Kolonjë në shumën 497 milion lekë me afat zbatimi 24 muaj. Nga auditimi konstatohet se shpërndarja e buxhetit sipas viteve nuk përputhet me afatin kohor të zbatimit të punimeve prej 24 muaj. Fondet e detajuara për këtë projekt investimi në muajin Korrik 2020 të vitit 2020 paraqiten në shumën 99.6 milion lekë dhe në PBA 2021-2023 vlera totale e parashikuar për tu financuar paraqitet në shumën 189.6 milion lekë. **Për rrjedhojë diferenca paraqitet angazhim pa fonde buxhetore në shumën 307.7 milion lekë.**

-Projekti 19AF201 “Furnizimi me ujë nga burimi i Gramës për ujësjellësin e Peshkopisë”, nuk rezulton i parashikuar në PBA 2020-2022 dhe është kontraktuar nga Bashkia Dibër në shumën 737 milion lekë me afat zbatimi 14 muaj. Nga auditimi konstatohet se shpërndarja e buxhetit sipas viteve nuk përputhet me afatin kohor të zbatimit të punimeve prej 14 muaj duke krijuar detyrime të prapambetura. Nga auditimi konstatohet se detajimi i fondeve për këtë projekt është realizuar në muajin Qershor 2020 vetëm për vlerën e 20% të koston së projektit, pa kaluar në PBA 2020-2022, por duke u përfshirë në PBA 2021-2023, me kosto projekti më të ulët se kostoja reale e tij në shumën 140 milion lekë. Buxhetimi i shlyerjes së këtij investimi përtej periudhës 3 vjeçare dhe përtej periudhës së përcaktuar për realizimin dhe faturimin e tij sjell krijimin e detyrimeve të prapambetura **dhe ndërmarrjen e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde disponibël në shumën 581 milion lekë.**

-Projekti 18BQ616 “Ujësjellësi -Zona e ujit te ftohte dhe lungomares Rrapi Uji I Ftohte - Shkolla e Marinës”. Në PBA faza II 2020-2022 dhe Projekt Buxhetin e vitit 2020, ky investim është parashikuar respektivisht në shumën 447 milion lekë dhe 701 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se për këtë investim është nënshkruar kontrata në shumën 630 milion lekë me afat kontrate 12 muaj. Fondet e detajuara për këtë projekt investimi në muajin Prill 2020 në shumën 128 milion lekë kanë ndryshuar në ulje në muajin Tetor dhe Nëntor me plan përfundimtar në shumën 30 milion lekë. **Lidhja e kontratës përtej vlerës së parashikuar në PBA 2020-2022 është angazhim pa fonde buxhetore duke qenë se kostoja e investimit (vlera e kontraktuar) është më e madhe se vlera e buxhetuar sipas PBA 2020-2022 llogaritur në shumën 182 milion lekë.**

-Projekti 18BQ394 “Ndërtim linjë transmetimi nga puseta Yzberisht deri



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

në Depo Katund, Katund i Ri & Ndërtim linjë transmetimi nga puseta Yzberisht deri në Depo Qytet Nxënësve, Bashkia Tiranë”, nuk rezulton i parashikuar në PBA 2020-2022 dhe është kontraktuar nga Sh.a Ujësjetllës Kanalizime Tiranë në shumën 458 milion lekë me TVSh me afat zbatimi 4 muaj. Nga auditimi konstatohet se shpërndarja e buxhetit sipas viteve nuk përputhet me afatin kohor të zbatimit të punimeve duke krijuar detyrime të. Fondet e detajuara në muajin Janar 2020 në shumën 97 milion lekë kanë ndryshuar në ulje duke u paraqitur me plan përfundimtar në shumën 60 milion lekë. Buxheti i shlyerjes së këtij investimi përtej periudhës 3 vjeçare dhe përtej periudhës së përcaktuar për realizimin dhe faturimin e tij sjell krijimin e detyrimeve të prapambetura nëpërmjet tejkalimit të kufijve për fondet e investimit të planifikuar.

Problematika për disa nga këto kontrata reflektohet edhe në projekt buxhetin e vitit 2021 në listën e investimeve publike, ku mungesa e përballimit të angazhimeve të ndërmarrja/në proces ka sjellë përfshirjen e planit të buxhetit të tyre pas vitit 2023, jashtë periudhës në të cilën buxheti miratohet me ligj.

Programi buxhetor 01110 “Planifikimi menaxhimi dhe administrimi”, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Fondet e investimit të parashikuara për programin 0110 të MSHMS në ligjin nr.88/2019 të ndryshuar paraqiten në shumën 4,128 mijë lekë, ndërkohë që me VKM nr. 249 datë 27.03.2020 është përcaktuar se do të përdoren 1,000 milionë lekë si shpenzime kapitale në këtë program. Efekti i miratimit të këtyre fondeve nuk është reflektuar në tabelën 1 të ligjit nr.88/2019 të ndryshuar me aktet normative përgjatë vitit 2020. Nga auditimi konstatohen se 3 projekte me përfitues MSHMS që nuk lidhen me situatën e pandemisë ku janë paguar fatura të kontratave të lidhura një vit më pare. Këto kontrata janë angazhime pa fonde buxhetore të vitit të kaluar duke qenë se janë lidhur pas datë 15 Tetor dhe efekti i lidhjes së tyre është akomoduar duke përdorur fondin anti COVID-19 si burim financimi.

Programi 01610 “Planifikimi menaxhimi dhe administrimi”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve 73. Nga auditimi konstatohet se me aktin normativ nr. 34/2020 është rritur financimi për investimet kapitale me financim të brendshëm në shumën 673 milion lekë në këtë program. Realizimi i këtyre fondeve të detajuara me AN 34/2020 rezulton në shumën 0 lekë duke qenë se nuk ka asnjë mundësi ligjore për prokurimin, lidhjen e kontratës dhe përdorimin e tyre përgjatë vitit buxhetor 2020. Detajimi i tyre është bërë me qëllim lejimin e procedurave të prokurimit për projektet e mësipërm dhe është kryer në masën 20% të vlerës së investimit. Nga evidencat e prokurimeve konstatohet se hapja e procedurës së prokurimit në datën 23.12.2020 me procedurë negociim pa shpallje me fond limit në shumën 2,112,304 mijë lekë dhe vlerë kontratë në shumën 2,419,625 mijë lekë. Konstatohet se detajimi i këtyre fondeve me akt normativ, bëhet shkak për krijimin e detyrimeve të prapambetura duke qenë se detyron uljen e financimit për projekte të tjera të kaluara në projekt



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

	buxhet ndërkohë që lidhet një kontratë për të cilën nuk ka kaluar në asnjë fazë të ciklit buxhetor dhe është mbi tavanet e miratuara për vitet pasardhëse buxhetore.
Impakti:	Krijimi i detyrimeve të prapambetura, presion rritës për rritjen e borxhit publik, etj.
Shkaku:	mos respektim i kufijve disponibël për ndërmarrjen e angazhimeve, lidhja e kontratave pas 15 tetorit, çelja e projekteve të reja gjatë vitit, etj.
Rëndësia:	E lartë
Kriteri:	Neni 40-51 i ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.
Rekomandimi:	<p>Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të ndërmerren inspektime financiare dhe masa administrative përkatëse për të gjitha rastet problematike të identifikuara sipas përgjegjësive përkatëse; të kryejë përputhjen e kostos së plotë të projekteve të investimeve publike me vlerën e përcaktuar në PBA; të shmangët praktika e shtyrjes së planit buxhetor përtej periudhës së parashikuar për kohëzgjatjen e kontratave; të merren masa për regjistrimin në kohë të fondeve të obliguara në SIFQ, duke koordinuar edhe me Agjencinë e Prokurimit Publik si dhe integrimin e sistemit elektronik të prokurimit publik me sistemin informatik financiar të qeverisë.</p> <p>-Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të reflektohet efekti i VKM të dala gjatë vitit në tabelën e ligjit të buxhetit të vitit në të cilën miratohen fondet në nivel programi për çdo institucion.</p> <p>-Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të shmangët detajimi i projekteve të reja të investimit publik me akte normative gjatë si dhe në përfundim të vitit buxhetor, të cilat nuk krijojnë mundësinë e përdorimit të buxhetit prej 20% të kërkuar në vitin e parë të zbatimit të tij.</p>

Titulli i Gjetjes:	Gjatë vitit 2020 është konstatuar se nuk është realizuar saktësisht ndjekja e procesit të rindërtimit për investimet kapitale duke konstatuar mosrakordim të planit në SIFQ me planin e miratuar me VKM, mosregjistrim të obligimeve në lidhje me kontratat e nënshkruara, kontraktimin e projekteve në fund të vitit buxhetor si dhe realizimin e procesit të rindërtimit të banesave individuale, banesave pallat dhe infrastrukturës publike në një projekt të vetëm investimi publik.
Situata:	Sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 88/2019 të ndryshuar, programi buxhetor 6210 òPrograme zhvillimi është përdorur për procesin e rindërtimit, ku rast pas rasti me Vendim të Këshillit të Ministrave janë detajuar fonde për Fondin Shqiptar të Zhvillimit për rindërtimin e objekteve të dëmtuara nga tërmeti. Efekti i VKM-ve të dala në funksion të procesit të rindërtimit me përfitues FSHZH nuk është pasqyruar në tabelën nr.1 të ligjit të buxhetit ku pasqyrohet buxheti i miratuar me programe sipas institucioneve. Nga auditimi mbi fondin e rindërtimit konstatohet se buxheti i investimeve për rindërtimin paraqitet në shumën 10,451,538



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

mijë lekë dhe realizimi faktik në shumën 7,120,407 mijë lekë sipas të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Buxhetit. Nga auditimi mbi të dhënat e publikuara në treguesit fiskalë të konsoliduar mbi investimet nga buxheti qendror me burim financimi fondin e rindërtimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, konstatohet se vlera e buxhetit paraqitet në shumën 10,149,495 mijë lekë ndërkohë që realizimi faktik paraqitet në shumën 6,818,365 mijë lekë, duke paraqitur diferencë në krahasim me raportimin e Drejtorisë së Buxhetit. Nga përpunimi i të dhënave të vendosura në dispozicion konstatohet se diferencë rezultojnë prej projektit M560322 "Projekti i rrugëve dytësore dhe lokale kosto lokale, planifikuar dhe realizuar në shumën 302,043 mijë lekë, në të cilin janë reflektuar kostot e menaxhimit të projektit me përfitues FSHZH.

Mbi projektin e investimit për rindërtimin e banesave individuale, kod projekti 19AD201

Ky projekt investimi paraqet fondet e shpërndara sipas VKM (nr.202 datë 05.03.2020 e ndryshuar, 307 datë 16.04.2020 e ndryshuar dhe 587 datë 22.07.2020 e ndryshuar) për ndërtimin e banesave individuale, ndërtimin e banesave pallat dhe infrastrukturën publike. Plani përfundimtar për këto investime nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për vitin 2020 paraqitet në shumën 5,527,725 mijë lekë, ndërkohë që referuar të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Investimeve plani për vitin 2020 paraqitet në shumën 5,137,672 mijë lekë, duke mos reflektuar ndryshimet e VKM në vlerën e saktë, me një diferencë në shumën 390,053 mijë lekë në krahasim me planin e paraqitur në SIFQ. Mos reflektimi i saktë i ndryshimeve të VKM tregon për mosndjekje të fondeve të investimeve të lëvruara për procesin e rindërtimit, mungesë saktësie dhe konsistence në raportimet e kryera. Gjithashtu konstatohet se këto fonde janë përmbledhur në një projekt të vetëm investimi ndërkohë që për nga natyra, projektet e investimit përfshijnë infrastrukturë publike, banesa individuale dhe ndërtesa pallat në rajone të ndryshme gjeografike si dhe për të cilat përfshihen kontrata të ndryshme në zbatim të procedurave të parashikuara nga akti normativ për procesin e rindërtimit. Këto veprime nuk janë në përputhje me përcaktimin e bërë në ligjin e buxhetit për përkufizimin e investimit kapital, me mënyrën e funksionimit të ecurisë së rasteve të tjerë të projekteve të investimit, krijon pamundësi monitorimi dhe ndjekje në vazhdimësi për respektimin e parimeve mbi të cilat funksionin sistemi buxhetor. Mungesa e detajimit në kodifikime për projekte specifike sikurse janë prokuruar nuk mundëson ndjekjen e planit dhe ndërmarrjen e angazhimeve për këto projekte në raport me fondet në dispozicion për secilin investim.

Nga auditimi konstatohet se buxheti i akorduar në total për FSHZH në programin buxhetor 6210 për rindërtimin e banesave individuale, infrastrukturën publike dhe banesat pallat sipas VKM-ve përkatëse dhe ndryshimeve deri në 31.12.2020 rezultojnë në shumën 26,639,199 mijë lekë, nga të cilat 6,465,467 mijë lekë për banesat individuale, 3,975,402 mijë lekë për infrastrukturën publike dhe 16,198,330 mijë lekë për banesat



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

pallat. Nga kjo vlerë totale e buxhetuar janë kontraktuar punime deri në 31.12.2020 në shumën 16,542,582 mijë lekë në total, nga të cilat 5,684,429 mijë lekë për banesa individuale, 2,684,841 mijë lekë për infrastrukturën publike dhe 8,173,313 mijë lekë për banesa pallat. Realizimi faktik i punimeve deri në 31.12.2020 sipas regjistrimeve në SIFQ rezulton për kod projekti 19AD201 rezulton në shumën 3,267,507 mijë lekë, duke mos detajuar se për cilën komponent të rindërtimit janë realizuar duke qenë se janë përmbledhur të gjithë në një kod projekti dhe bërë të pamundur ndjekjen e secilit komponent të rindërtimit.

Nga auditimi mbi rindërtimin e banesave individuale sipas VKM nr. 202, dt 5.03.2020, "*Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të këtyre banesave*", i ndryshuar konstatohet se kontratat janë lidhur në periudhën gusht-dhjetor 2020, ndërkohë që regjistrimi i tyre është kryer në dhjetor-prill 2021. Gjithashtu në një rast, konstatohet se nuk është regjistruar kontrata e lidhur sipas minikonkursit 3 në shumën 629,305 mijë lekë në SIFQ deri në 30.06.2021, duke mos regjistruar obligimet që rrjedhin nga kjo kontratë në sistem. Mos regjistrimi i obligimeve dhe lidhja e kontratave në muajin Nëntor dhe Dhjetor pa asnjë mundësi për realizimin e fondeve të buxhetuara për vitin 2020 krijon presion për rritjen e kërkesës për financim në vitin pasardhës buxhetor.

Nga auditimi mbi rindërtimin e infrastrukturës publike sipas VKM nr. 307 datë 16.04.2020 "*Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike, në zonat e reja të shpallura për zhvillim të detyruar*", i ndryshuar konstatohet se kontratat janë lidhur në periudhën qershor-dhjetor 2020, ndërkohë që regjistrimi i tyre në SIFQ është kryer në periudhën gusht 2020-prill 2021. Gjithashtu në një rast, konstatohet se nuk është regjistruar kontrata e lidhur sipas minikonkursit 7 në shumën 236,836 mijë lekë.

Nga auditimi mbi rindërtimin e banesave pallat sipas VKM nr. 587 datë 22.07.2020 "*Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njërive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar*", i ndryshuar konstatohet se kontratat janë lidhur më së shumti në muajin dhjetor 2020 ndërkohë që regjistrimi i tyre në SIFQ është kryer në periudhën janar qershor 2021. Janë konstatuar 3 raste në të cilat kontratat e lidhura në 16.12.2020 në shumën 692,291 mijë lekë, në 18.12.2020 në shumën 519,000 mijë lekë dhe në 28.12.2020 në shumën 508,000 mijë lekë nuk janë regjistruar në SIFQ deri në 30.06.2021.

Mbi projektet e investimit për rindërtimin e objekteve arsimore. Procesi i rindërtimit të projekteve arsimore nga buxheti i shtetit me njësi zbatuese FSHZH është përcaktuar në VKM nr.212 datë 11.03.2020 për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore, të ndryshuar, në të cilën është parashikuar kosto totale e investimit në shumën 4,347,753 mijë lekë, nga të cilat buxhetuar për vitin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

2020 në shumën 4,125,707 mijë lekë, sipas VKM të përditësuar deri në 31.12.2020. Detajimi i projekteve të investimit është kryer në muajin Qershor 2020 për çdo rajon gjeografik të kryerjes së investimit dhe jo sipas objektit të investimit në shkollën përkatëse duke përfshirë:

-Projekti 19AD203 “Rindërtimi i Objekteve Arsimore Qarku Lezhë (Bashkia Kurbini dhe Lezhë)”. Vlera fillestare e buxhetuar në shumën 127,851 mijë lekë, plani përfundimtar për vitin 2020 në shumën 444,865 mijë lekë, lidhur 2 kontrata në shumën 397,492 mijë lekë dhe realizuar gjithsej deri në 31.12.2020 në shumën 309,706,000 lekë.

-Projekti 19AD204 “Rindërtimi i Objekteve Arsimore Qarku Krujë (Bashkia Krujë)”. Vlera fillestare e buxhetuar në shumën 122,603 mijë lekë, plani përfundimtar për vitin 2020 në shumën 442,297,664 lekë, lidhur 3 kontrata në shumën 462,069 mijë lekë, nga të cilat një kontratë me objekt të rindërtimit të objektit 1-2 kate të shkollës së mesme të bashkuar Selman Daci nuk është regjistruar fare në SIFQ në shumën 122,510 mijë lekë dhe realizuar gjithsej deri në 31.12.2020 në shumën 215,429 mijë lekë.

-Projekti 19AD205 “Rindërtimi i Objekteve Arsimore Qarku Durrës (Bashkia Durrës1)”. Vlera fillestare e buxhetuar në shumën 211,431 mijë lekë, plani përfundimtar për vitin 2020 në shumën 845,724 mijë lekë, lidhur 4 kontrata në shumën 817,571 mijë lekë dhe realizuar gjithsej deri në 31.12.2020 në shumën 695,099,636 lekë.

-Projekti 19AD206 “Rindërtimi i Objekteve Arsimore Qarku Durrës (Bashkia Durrës2)”. Vlera fillestare e buxhetuar në shumën 212,673 mijë lekë, plani përfundimtar për vitin 2020 në shumën 850,693 mijë lekë, lidhur 3 kontrata në shumën 701,773 mijë lekë dhe realizuar gjithsej deri në 31.12.2020 në shumën 631,596 mijë lekë.

-Projekti 19AD207 “Rindërtimi i Objekteve Arsimore Qarku Tiranë (Bashkia Kavajë, Bashkia Rrogozhinë)”. Vlera fillestare e buxhetuar në shumën 103,692 mijë lekë, plani përfundimtar për vitin 2020 në shumën 462,882 mijë lekë, lidhur 4 kontrata në shumën 462,882 mijë lekë dhe realizuar gjithsej deri në 31.12.2020 në shumën 367,804 mijë lekë.

-Projekti 19AD208 “Rindërtimi i Objekteve Arsimore Qarku Tiranë (Bashkia Kamëz)”. Vlera fillestare e buxhetuar në shumën 155,439 mijë lekë, plani përfundimtar për vitin 2020 në shumën 621,757 mijë lekë, lidhur 3 kontrata në shumën 523,977 mijë lekë dhe realizuar gjithsej deri në 31.12.2020 në shumën 471,579 mijë lekë.

-Projekti 19AD209 “Rindërtimi i Objekteve Arsimore, Qarku Tiranë (Bashkia Vorë) Qarku Durrës, (Bashkia Shijak)”. Vlera fillestare e buxhetuar në shumën 110,115 mijë lekë, plani përfundimtar për vitin 2020 në shumën 506,999 mijë lekë, lidhur 4 kontrata në shumën 607,499 mijë lekë dhe realizuar gjithsej deri në 31.12.2020 në shumën 408,094 mijë lekë.

Nga auditimi konstatohet se për projektin e investimit 19AD204 nuk është regjistruar kontrata në SIFQ në shumën 122,510 mijë lekë megjithëse rezultoni e nënshkruar që në 09.06.2020, duke mos regjistruar obligimin përkatës. Në të njëjtën kohë, detajimi i projekteve të investimit nuk është



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

	kryer sipas objektit të investimit në infrastrukturën arsimore përkatëse por është kryer sipas grupimit në rajone gjeografike të rindërtimit të infrastrukturës arsimore. Përveç problematikave në lidhje me parimet e funksionimit të sistemit buxhetor, kjo problematikë krijon edhe pamundësinë e ndjekjes së historikut të investimit në asetet publike.
Impakti:	Mungesë e transparencës në lidhje me planifikimin, angazhimin dhe realizimin e fondit të rindërtimit.
Shkaku:	Mos regjistrim i obligimeve, përdorimi i një kodi të vetëm të investimit për të gjitha projektet, etj.
Rëndësia:	E lartë
Kriteri:	Ligji nr. 88/2019, i ndryshuar dhe ligji nr.9936 datë 26.06.2008, i ndryshuar.
Rekomandimi:	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masa për regjistrimin e të gjitha kontratave të nënshkruara përgjatë periudhës objekt auditimi dhe ato të kontraktuara gjatë vitit pasardhës në sistemin informatik financiar të qeverisë nga njësitë përkatëse. Nga ana e Ministrisë së Financave të bëhet detajimi në nivel analitik sipas objektit të infrastrukturës, banesave, ndërtesave pallat në të cilin është realizuar investimi publik, në mënyrë që të merret në kontroll procesi i rindërtimit sipas VKM-ve respektive, duke qenë se shumë nga këto asetet publike janë objekt edhe i transferimit kapital pas përfundimit të punimeve drejt përfituesve të procesit të rindërtimit.

Në lidhje me këto çështje, nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë janë dërguar observacione mbi projekt raportin e auditimit me shkresën nr. 8595/33 datë 30.09.2021 në të cilën është parashtruar ndër të tjera:

..Përsa i përket zërit “Fond i ngrirë”, sqarojmë se gjatë detajimit të buxhetit koncepti i projekteve me emërtimit “Fond i ngrirë” ka të bëjë kryesisht me projekte në zbatim të pikës 20 të Udhëzimit Plotësues nr. 2 datë 20.01.2020 për zbatimin e buxhetit 2020: “Fondet për projektet e reja të investimeve për blerjen e paisjeve elektronike/informatike që lidhen me teknologjinë e informacionit bëhen efektive vetëm pas konfirmimit nga AKSHI. Si dhe projekte që nuk kanë qenë pjesë e listës së ciklit të PBA-së ose nuk kanë pasur mjaftueshëm, DMIP i çel si fonde të ngrira të cilat nuk mund të përdoren dhe cngurtësohen kur plotësohen kërkesat e mësipërme. Ndërkohë që nëqoftëse kërkohen për qëllime auditimi apo për informacione nga titullarët, sigurisht që zëri “Fond i ngrirë” është i shoqëruar me përshkrimin përkatës dhe kjo është e identifikueshme. Gjithashtu mund të jenë dhe projekte të cilat nuk kanë arritur të implementohen deri në muajt e fundit të përfundimit të vitit buxhetor dhe si të tilla për një menaxhim sa më efektiv të përdorimit të fondeve për shpenzime kapitale, këto projekte kalojnë nën zërin “Fond i ngrirë”.

.....Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, programi transporti rrugor, në lidhje me këtë program rialokimet e bëra janë:

-të kërkuara nga MIE të cilat janë dërguar brenda afatit ligjor që është data 15 tetor për angazhimet e reja buxhetor dhe 15 nëntor për projektet ekzistuese

-në kuadër të aktit normativ i cili nuk ka afat për datën e rialokimeve

Për të gjitha projektet e cituara, si dhe për projektin 18BS612 “Ndërtim rruga Palasë Dhërmi”, është respektuar dispozita ligjore (neni 40 i ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”), për planifikimin e 20% të vlerës së plotë të projektit përkatës. Vlera e plotë e projektit krahasuar me vlerën e PBA ka ndryshuar pasi u rishikua projekti çka solli si rrjedhojë edhe ndryshimin e vlerës së plotë të tij. Në çdo rast që janë bërë ndryshime për këtë projekt është respektuar vlera 20% e vlerës totale të projektit nga ana jonë.

.....Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, programi furnizimi me ujë dhe kanalizime. Përsa u përket projekteve të këtij programi të gjitha projektet që janë planifikuar plotësojnë vlerën e 20% të vlerës totale të financimit në vitin e parë sipas ligjit organik të buxhetit. Çelja e projekteve të reja ka sjellë riskun e krijimit të detyrimeve të prapambetura por nga ana jonë është ndërhyrë për rritjen e taveve buxhetore nëpërmjet akteve normative por edhe PBA 2022-2024.

...Lidhur me respektimin e procedurave të ciklit të PBA, sjellim në vëmendje se viti 2020 rezultoi një vit atipik sa i takon zbatimit të tyre. Kjo sa kohë që vitit 2020 reflektoi në shkallë të gjërë impaktin negativ të pasojave të pandemisë Covid-19, si nga pikëpamja e kufizimeve lidhur me burimet njerëzore ashtu edhe nga këndvështrimi i vështirësisë objektive në komunikimet zyrtare e më gjërë.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se lidhja e kontratave pas 15 tetorit është në përgjegjësi direkte të autoriteteve kontraktore dhe jo e DMIP.

Çelja e projekteve të reja në programet e infrastrukturës (transporti rrugor, furnizimi me ujë dhe kanalizime dhe FSHZH) ka sjellë riskun e krijimit të detyrimeve të prapambetura por nga ana jonë është ndërhyrë për rritjen e taveve buxhetor nëpërmjet akteve normative por edhe PBA 2022-2024.

Në përgjigje të këtyre observacioneve sqarojmë se së pari terminologjia fond i ngrirë nuk njihet në ligjin organik të buxhetit i cili ka parashikuar një proces normal të detajimit të buxhetit dhe bërjen e tij të vlefshëm në SIFQ. Së dyti, nga auditimi është konstatuar se një pjesë e konsiderueshme e projekteve me përshkrim fond i ngrirë lidhen edhe me projektet që kanë ekzekutuar detyrime të prapambetura të viteve të kaluara, të trajtuara përgjatë materialit, të cilat nuk janë të përfshira në udhëzimin e mësipërm. Përsa i përket pretendimeve në lidhje me marrjen e masave nëpërmjet rritjes së taveve buxhetore apo PBA 2022-2024 sqarojmë se janë në të njëjtën linjë me konstatimin e grupit të auditimit që ka konstatuar tejkalimin e taveve ligjore të miratuar me ligjin nr.88/2019 òPër buxhetin e vitit 2020, i ndryshuar, si dhe kanë sjellë presione negative për investimet kapitale si pasojë e veprimtarisë të konstatuar në shkelje përgjatë vitit 2020. Për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

7.2 Raportimi i treguesve fiskalë të realizuar dhe monitorimi i tyre.

Mbi Treguesit Fiskalë të Buxhetit të Konsoliduar dhe Raportin e Zbatimit të Buxhetit për vitin 2019.

Baza Ligjore:

Ligjet nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ndryshuar me Ligjin nr. 57/2016, datë 02/06/2016,;

-nr.10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar;

-nr.88/2019 òPër buxhetin e vitit 2020.

-nr.139/2015 òPër vetëqeverisjen vendoreò

-nr. 9632 datë 30.10.2006, òPër sistemin e taksave vendoreò i ndryshuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

-nr.68 /2017 Për financat e vetëqeverisjes vendore

Udhëzimet e Ministrisë Financave

-nr.9, datë 20.07.2018 Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit;

-nr.22, datë 17.11.2016 Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ;

-nr.08, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë së qeverisjes së përgjithshme "

I. MBI REALIZIMIN E TË ARDHURAVE TË BUXHETIT TË VITIT 2020.

Të ardhurat totale të buxhetit të konsoliduar për vitin 2020 sipas raportimit të MFE rezultojnë në shumën 425.9 miliardë lekë me një mos realizim në shumën 20,666 milion lekë nga plani përfundimtar prej 510 miliardë lekë ose 5%, Plani fillestar i të ardhurave i miratuar me ligjin nr.88/2019 ka parashikuar një rritje prej 9% ndërkohë që në krahasim me një vit më parë konstatohet një mos realizim në shumën 34.4 miliardë lekë (-7.5%) më pak se një vit më parë. Këto të ardhura rezultojnë rezultojnë 26.5% të PBB-së (nga 27.4% në 2019). Mos realizimi i të ardhurave është i lidhur kryesisht me efektet e shkaktuara nga pandemia Covid-19 si rezultat i ngadalësimit të aktivitetit ekonomik nga kufizimet apo elementët e lehtësimit fiskalë nëpërmjet faljes apo shtyrjes në kohë të detyrimeve tatimore për tatimpaguesit. Realizimi i të ardhurave të përgjithshme prej 425,905 milion lekë sipas grupeve kryesore përfshin:

-Të ardhura nga ndihmat realizuar në shumën 8,294 milion lekë.

- Të ardhurat tatimore nga tatimet dhe doganat realizuar në shumën 398,658 milion lekë

- Të ardhurat jo tatimore realizuar në shumën 18,953 milion lekë.

Realizimi i të ardhurave përgjatë viteve krahasuar me planin fillestar dhe ndryshimet përgjatë vitit 2020 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	EMERTIMI	Faktik 2019	Projekt Buxheti 2020	Buxheti 2020	AN nr.6	AN nr. 15	AN nr. 28	AN nr. 34	Faktik 2020
	TOTALI TE ARDHURAVE	460,319	502,675	509,675	489,675	489,675	446,570	446,570	425,905
I.	Te ardhura nga ndihmat	8,781	16,000	23,000	23,000	23,000	18,000	16,000	8,294
II.	Te ardhura tatimore	426,271	465,090	465,090	445,090	445,090	408,045	410,045	398,658
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	304,758	334,121	334,121	314,121	314,121	290,000	290,000	278,984
II.2	Te ardhura nga Pushteti Vendor	23,102	26,944	26,944	26,944	26,944	23,045	23,045	21,975
II.3	Te ardhurat nga Fondet Speciale	98,411	104,025	104,025	104,025	104,025	95,000	97,000	97,699
III.	Te ardhura Jotatimore	25,267	21,585	21,585	21,585	21,585	20,525	20,525	18,953

I.1. Të ardhurat nga ndihmat

Të ardhurat nga ndihmat janë realizuar në masën 8,294 milion lekë kundrejt 23,000 milion lekë të planifikuara në fillim të vitit dhe 16,000 me planin e ndryshuar me aktin normative të fund vitit. Këto të ardhura janë realizuar në masën 51.8% ndaj Aktit Normativ nr. 34 ose 36.06 % ndaj planit fillestar dhe paraqiten në të njëjtat nivele me realizimin faktik të një viti më parë.


I.2. Të ardhurat tatimore

Të ardhurat tatimore për vitin 2020 janë realizuar në shumën 398,658 milion lekë duke zënë peshën kryesore të të gjithë të ardhurave të realizuara (93.6%) dhe paraqiten të realizuara në masën 97.2% të planit të ndryshuar ose 85.71% të planit fillestar. Krahasuar me realizimin faktik të vitit 2019 këto të ardhura paraqiten në ulje me 27,613 milion lekë dhe realizimi i këtyre të ardhurave përgjatë viteve paraqitet:

Emërtimi	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Të ardhurave tatimore	342,308	369,884	398,629	419,333	426,271	398,658
Dif. nga viti i mëparshëm	6,440	27,576	28,745	20,704	6,938	-27,613
Rritje/Ulje ne %		8.1%	7.8%	5.2%	1.7%	-6.5%




KONTROLLI I LARTË I SHITETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË



Të ardhurat tatimore përbëhen nga:

I.2.1. Të ardhurat nga tatimet dhe doganat janë realizuar në masën 278,984 milion lekë ose 65.5% e totalit të të ardhurave të përgjithshme dhe realizimi i tyre sipas llojit të tatimit të arkëtuar nga administrata tatimore dhe doganore përgjatë vitit 2020 paraqitet:



Krahasuar më një vit më parë këto të ardhura paraqiten me një realizim më të ulët me 25,774 milion lekë, me efektin më të madh në mosrealizim në krahasim me vitin e kaluar në tatimin mbi të ardhurat personale në shumën 12,467 milion lekë dhe tatimi mbi fitimin në shumën 8,193 milion lekë. Të analizuar sipas llojit të tatimit dhe institucionit përgjegjës për arkëtimin e tyre, të ardhurat tatimore nga tatimet dhe doganat paraqiten:

E M Ë R T I M I	Nga doganat		Nga tatimet		TOTALI	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
	2020	2020	2020	2020	2020	2020
Taksë doganore	6,460	6,241			6,460	6,241
TVSH neto	101,100	100,850	29,660	29,504	130,760	130,354
Akcizë	45,300	44,521			45,300	44,521
Të tjera (Renta)	2,561	1,795			2,561	1,795
Tatim mbi fitimin			30,390	28,381	30,390	28,381
Tatimi mbi të ardhurat personale			41,080	33,658	41,080	33,658
Taksa nacionale			33,450	34,034	33,450	34,034
TOTALI	155,420	153,407	134,581	125,577	290,001	278,984

Vlera e të ardhurave tatimore nga TVSH është raportuar në bazë neto, ndërkohë që vlera e TVSH në terma bruto dhe rimbursimi i TVSH përgjatë vitit 2020 i realizuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Realizimi i TVSH	Viti 2019	Viti 2020	Diferenca %
TVSH BRUTO			
nga Tatimet	155,921	146,866	-5.8
nga Doganat	48,761	46,016	-5.6
	107,160	100,850	-5.9
RIMBURSIM	23,509	16,512	-29.8



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

nga Tatimet	23,509	16,512	-29.8
nga Doganat	0.0	0.0	0.0
TVSH NETO	132,412	130,354	-1.6
nga Tatimet	25,252	29,504	16.8
nga Doganat	107,160	100,850	-5.9

I.2.2. Të ardhura nga pushteti vendor janë realizuar në shumën 21,975 milion lekë ose 5.16% të totalit të të ardhurave. Këto të ardhura janë të përbëra nga taksat dhe tatimet e mëposhtme:

Lloji I të ardhurave	Buxheti 2020	AN nr.6	AN nr. 15	AN nr. 28	AN nr. 34	Faktik 2020
Te ardhura nga Pushteti Vendor	26,944	26,944	26,944	23,045	23,045	21,975
Taksa Lokale	21,222	21,222	21,222	18,422	18,422	16,468
Tatimi mbi Pasurine (ndertesat)	5,354	5,354	5,354	4,254	4,254	5,124
Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel	369	369	369	369	369	384

Taksa lokale janë realizuar në shumën 21,975 milion lekë, kundrejt 18,422 milion lekë sipas planit të ndryshuar dhe 21,222 milion lekë të planit fillestar. Konstatohet një mos realizim në shumën 1,954 milion lekë kundrejt planit përfundimtar dhe 4,754 milion lekë kundrejt planit fillestar.

Taksa mbi pasurinë është realizuar në shumën 5,124 milion lekë, me një realizim më tepër për 870 milion lekë se plani i ndryshuar prej 4,254 milion lekë, ndërkohë që krahasuar me planin fillestar prej 5,354 milion lekë konstatohet një mosrealizim në shumën 230 milion lekë.

Tatimi i thjeshtuar mbi biznesin e vogël është realizuar në shumën 384 milion lekë, me një mosrealizim në shumën 15 milion lekë krahasuar me planin prej 369 milion lekë.

I.2.3. Të ardhura nga fonde speciale janë realizuar në shumën 97,699 milion lekë ose 22.94% e të ardhurave të përgjithshme buxhetore. Krahasuar me planin fillestar prej 104,025 milion lekë, këto të ardhura paraqiten me një mos realizim në shumën 6,326 milion lekë, ndërkohë që krahasuar me planin e ndryshuar, mos realizimi paraqitet në shumën 699 milion lekë dhe efektet e ndryshimeve të planit përgjatë vitit si dhe realizimi faktik paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lloji I të ardhurave	Buxheti 2020	AN nr.6	AN nr. 15	AN nr. 28	AN nr. 34	Faktik 2020
Te ardhurat nga Fondet Speciale	104,025	104,025	104,025	95,000	97,000	97,699
Sigurimi Shoqëror	88,609	88,609	88,609	80,840	82,540	83,515
Sigurimi Shendetësor	14,416	14,416	14,416	13,160	13,460	13,023
Te ardhurat per kompensimin ne vlere te pronareve	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000	1,161

Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore janë realizuar në shumën 83,515 milion lekë me mbi realizim në shumën 975 milion lekë nga plani i ndryshuar prej 82,540 milion lekë dhe me një mos realizim në shumën 5,094 milion lekë nga plani fillestar prej 88,609 milion lekë.

Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shëndetësore janë realizuar në shumën 13,023 milion lekë me mos realizim në shumën 437 milion lekë nga plani i ndryshuar dhe mos realizim në shumën 1,393 milion lekë nga plani fillestar.

Të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve janë realizuar në shumën 1,161 milion lekë duke u realizuar me shumën prë 161 milion lekë nga plani prej 1,000 milion lekë.

Realizimi faktik përgjatë vitit 2020 i të ardhurave nga fondet speciale, krahasuar me vitet e kaluara paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Emërtimi	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Të ardhurat nga Fondet speciale	71,726	79,153	86,796	93,153	98,411	97,699
Dif. nga viti i mëparshëm		7,427	7,643	6,357	5,258	-712
Në % nga viti mëparshëm		10.35%	9.66%	7.32%	5.64%	-0.72%



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË


Konstatohet se përgjatë vitit 2020 rezulton një ulje e të ardhurave nga fondet speciale në 0.72% në krahasim me vitin 2019, në ndryshim nga vitet e kaluara ku rritja vjetore ka rezultuar ndërmjet 5-10%.

I.3. Të ardhurat jotatimore

Të ardhurat jotatimore janë realizuar në shumën 18,953 milion lekë ose 4.45% e të ardhurave të përgjithshme buxhetore, duke u paraqitur me një mos realizim në shumën 1,572 milion lekë nga plani i rishikuar me aktin normativ të fundit të vitit. Krahasuar me realizimin faktik të vitit 2019 këto të ardhura paraqiten në ulje me 6,314 milion lekë dhe realizimi i këtyre të ardhurave përgjatë viteve paraqitet:

Emërtimi	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Të ardhura jo tatimore	25,683	22,498	20,778	22,412	25,267	18,953
Dif. nga viti i mëparshëm		-3,185	-1,720	1,634	2,855	-6,314
Rritje/Ulje ne %		-12.4%	-7.6%	7.9%	12.7%	-25.0%

Sipas llojit të të ardhurave jotatimore realizimi për vitin 2020 realizimi paraqitet si më poshtë:



II. REALIZIMI I SHPENZIMEVE TË BUXHETIT TË VITIT 2020.

Shpenzime të përgjithshme buxhetore për vitin 2020 sipas raportimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë rezultojnë në shumën 536,508 milion lekë, nga 579,535 milion lekë sipas planit përfundimtar të aktit normativ nr. 34, me një mos realizim në shumën 43,027 milion lekë ose 7.5 % ndërkohë që krahasuar me planin fillestar, prej 549,374 milion lekë mosrealizimi llogaritet në rreth 12,866 milion lekë. Krahasuar me një vit më parë, shpenzimet e përgjithshme janë rritur me 44,611 milion lekë, ose 9% më shumë, ndërkohë që krahasimi me krahasim i shpenzimeve të përgjithshme ndër vite paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Emërtimi	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Shpenzimet e përgjithshme	437,408	433,697	461,410	476,147	491,897	536,508
Dif. nga viti i mëparshëm		-3,711	27,637	14,737	15,750	44,611
Në % nga viti mëparshëm		-0.83%	6.37%	3.19%	3.31%	9.07%

Të analizuara përkundrejt projekt buxhetit, planit fillestar të miratuar me ligjin nr. 88/2019, ndryshimet me akte normative përgjatë vitit dhe realizimit faktik për vitin 2020 sipas llojit natyrës së shpenzimeve paraqiten në tabelën e mëposhtme:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

Nr.	E M E R T I M I	Projekt Buxheti 2020	Ligji nr.88/2019	A.N.6	A.N.15	A.N.28	A.N.34	Fakt
	TOTALI I SHPENZIMEVE	531,974	549,374	558,374	558,374	579,535	579,535	536,508
I.	Shpenzime Korrente	446,433	446,035	448,335	446,223	441,498	441,998	421,367
1	Personeli	83,856	83,203	83,023	82,152	81,884	81,134	76,895
2	Interesat	40,950	40,950	41,450	41,450	40,300	39,160	34,393
3	Shpenzime Operative Mirembajtje	50,021	49,846	50,626	49,336	51,117	51,287	48,906
4	Subvencionet	1,290	1,290	1,290	1,340	1,540	1,960	1,478
5	Shpenzime per Fondet Speciale	188,588	188,592	189,792	189,792	188,372	189,372	179,365
6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	57,128	57,554	57,554	57,554	53,485	53,285	51,627
7	Shpenzime te tjera	24,600	24,600	24,600	24,600	24,800	25,800	28,703
II.	Transferime kapitale							988
III.	Fondi Rezerve	1,700	1,700	9,200	16,200	16,200	16,200	12,052
IV.	Shpenzime Kapitale	83,841	81,639	80,839	75,950	87,837	89,337	85,309
V.	Fond Shpronosimi							200
VI.	Fondi I Rindertimit		20,000	20,000	20,000	34,000	32,000	16,591

II.1. Shpenzimet korrente janë realizuar në shumën 421,367 milion lekë, nga 441,998 milion lekë sipas planit të ndryshuar, me një mos realizim në shumën 20,631 milion lekë.

II.1.1 Shpenzimet për personelin janë realizuar në shumën 76,895 milion lekë përkundrejt planit përfundimtar sipas aktit normativ nr. 34 në shumën 81,134 milion lekë, me një mos realizim në shumën 4,239 milion lekë. Të analizuara sipas llojit të shpenzimit për vitin 2020 këto shpenzime paraqiten:

E M E R T I M I	Projekt Buxheti 2020	Ligji nr.88/2019	A.N.6	A.N.15	A.N.28	A.N.34	Fakt
Personeli	83,856	83,203	83,023	82,152	81,884	81,134	76,895
Paga	70,994	70,414	70,254	69,472	69,508	68,847	65,800
Kontributi per Sigurime Shoqerore	11,562	11,488	11,469	11,380	11,356	11,267	10,563
Fondi i vecante i pagave	300	300	300	300	240	240	0
Arsimi i Larte nga te ardhurat e veta	1,000	1,000	1,000	1,000	780	780	532

Shpenzimet për paga janë realizuar në shumën 65,800 milion lekë, me një mos realizim në shumën 3,047 milion përkundrejt planit të ndryshuar prej 68,847 milion lekë ose në masën 4.43%. Shpenzimet për kontribute për sigurime janë realizuar në shumën 10,563 milion lekë përkundrejt planit të ndryshuar prej 11,267 milion lekë, ndërkohë që shpenzimet për personelin nga të ardhurat nga arsimi i lartë janë realizuar në shumën 532 milion lekë nga 780 milion lekë sipas planit të ndryshuar.

II.1.2. Shpenzimet për interesat janë realizuar në shumën 34,393 milion lekë nga 39,160 milion lekë të planifikuara me aktin normativ nr.34, me një mos realizim në shumën 4,767 milion lekë, ndikuar nga mos realizimi i fondit të kontigjencës për risqet e borxhit sipas tabelës bashkëngjitur:

E M E R T I M I	Projekt Buxheti 2020	Ligji nr.88/2019	A.N.6	A.N.15	A.N.28	A.N.34	Fakt
Interesat	40,950	40,950	41,450	41,450	40,300	39,160	34,393
Te Brendshme	23,500	23,500	24,000	24,000	23,200	22,610	22,351
Te Huaja	13,450	13,450	13,450	13,450	13,000	12,450	12,042
Kontingjencë për risqet e borxhit	4,000	4,000	4,000	4,000	4,100	4,100	



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

II.1.3. Shpenzimet operative dhe mirëmbajtje janë realizuar në shumën 48,906 milion lekë, nga 51,287 milion lekë sipas planit përfundimtar të miratuar me aktin normativ nr. 34, duke paraqitur një mosrealizim në shumën 2,381 milion lekë.

II.1.4. Shpenzimet për subvencione janë realizuar në shumën 1,478 milion lekë nga 1,960 milion lekë sipas planit përfundimtar dhe planit fillestar prej 1,290 milion lekë.

II.1.5. Shpenzime për fondet speciale janë realizuar në shumën 179,365 milion lekë, nga 189,372 milion lekë sipas planit të ndryshuar dhe planit fillestar në shumën 188,592 milion lekë. Mosrealizimi paraqitet në shumën 10,007 milion lekë në krahasim me planin e ndryshuar, ndikuar kryesisht nga mos realizimi nga sigurimet shoqërore në rreth 4,517 milion lekë dhe mos realizimi nga sigurimet shëndetësore në rreth 2,415 milion lekë, paraqitur në tabelën e mëposhtme:

E M E R T I M I	Projekt Buxhet i 2020	Ligji nr.88/2019	A.N.6	A.N.15	A.N.28	A.N.34	Fakt
Shpenzime per Fondet Speciale	188,588	188,592	189,792	189,792	188,372	189,372	179,365
Sigurime Shoqerore	137,468	137,468	137,468	137,468	136,968	138,668	134,152
Politika te reja pensionesh	2,520	2,520	2,520	2,520	2,100	2,100	0
Sigurime Shendetesore	44,100	44,104	45,304	45,304	45,304	45,704	43,289
Shpenzime per Kompensimin ne Vlere te Pronareve	4,500	4,500	4,500	4,500	4,000	2,900	1,924

Për sigurimet shoqërore janë kryer shpenzime në shumën 134,152 milion lekë, duke përfshirë edhe fondin prej 3,400 milion lekë për shpërblimin e pensionistëve në fund të vitit, alokuara më aktin normativ nr. 34. Për sigurimet shëndetësore janë kryer shpenzime në shumën 43,289 milion lekë nga 45,704 milion lekë të planifikuara sipas planit të ndryshuar dhe 44,104 sipas planit fillestar. Shpenzimet për kompensimin në vlerë të pronarëve janë realizuar në shumën 1,924 milion lekë, nga 2,900 milion lekë sipas planit të ndryshuar dhe 4,500 milion lekë sipas planit fillestar.

II.1.6. Shpenzimet për buxhetin vendor janë realizuar në shumën 51,626 milion lekë sipas raportimit të MFE, përkundrejt planit të rishikuar prej 53,285 milion lekë, me burim financimi transfertat nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e veta të pushtetit vendor si dhe financimin e huaj. Krahasuar me planin fillestar mos realizimi paraqitet në shumën 5,927 milion lekë ndërkohë që krahasuar me planin e ndryshuar mos realizimi paraqitet në shumën 1,658 milion lekë.

II.1.7 Shpenzimet të tjera sociale janë realizuar në shumën 28,703 milion lekë, përkundrejt 25,800 milion lekë sipas planit të ndryshuar dhe 24,600 milion lekë sipas planit fillestar, duke u paraqitur me mbi realizim. Të krahasuar sipas llojit të pagesave të realizuara paraqiten në tabelën e mëposhtme:

E M E R T I M I	Projekt Buxheti 2020	Ligji nr.88/2019	A.N.6	A.N.15	A.N.28	A.N.34	Fakt
Shpenzime te tjera	24,600	24,600	24,600	24,600	24,800	25,800	28,703
Pagesa e Papunesise	600	600	600	600	800	800	888
Ndihma Ekonomike dhe Paaftesia	21,000	21,000	21,000	21,000	21,000	22,000	23,996
Kompensim per ish te perndjekurit politike	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000
Bonusi i lindjeve	2,000	2,000	2,000	2,000	2,000	2,000	2,820

Pagesa e papunesisë është realizuar në shumën 888 milion lekë nga 800 milion lekë të planifikuara me aktin normativ nr. 34. Mbi realizimi më i madh konstatohet në ndihmën ekonomike dhe paaftësinë në shumën 23,996 milion të realizuar përkundrejt 22,000 milion lekë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

sipas planit të ndryshuar. Realizmi i shpenzimeve për kompensim për të përndjekurit politikë paraqitet në shumën 1,000 milion lekë, në të njëjtin nivel me planin e ndryshuar, ndërkohë që edhe për vitin 2020 me mbi realizim paraqiten pagesat për bonusin e lindjes në shumën 2,820 milion lekë përkundrejt 2,000 milion lekë të planifikuara.

II.2 Shpenzimet nga fondi rezervë sipas raportimit nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë janë realizuar në shumën 12,052 milion lekë, ku përfshihet vetëm realizimi i kontigjencës për paketat sociale anti-covid si në tabelën e mëposhtme:

E M E R T I M I	Projekt Buxheti 2020	Ligji nr. 88/2019	A.N.6	A.N.15	A.N.28	A.N.34	Fakt
Fondi Rezerve	1,700	1,700	9,200	16,200	16,200	16,200	12,052
Fondi Rezerve	1,700	1,700	2,700	2,700	2,700	2,700	
Kontigjenca per paketen sociale anti-COVID			6,500	13,500	13,500	13,500	12,052

Me aktin normativ nr. 6 është miratuar fondi prej 6,500 milion lekë për mbështetjen e pagave ndaj biznesit të prekur nga efektet e kufizimit të aktivitetit si pasojë e pandemisë dhe kjo mbështetje është shtuar me 6,000 milion lekë me aktin normativ nr. 15.

II.3 Shpenzimet kapitale sipas raportimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në treguesit e konsoliduar fiskalë janë realizuar në shumën 85,309 milion lekë nga 89,337 milion sipas palnit përfundimtar të miratuar me aktin normativ nr. 34 me një mos realizim në shumën 4,028 milion lekë, ndikuar kryesisht nga mos realizimi i financimit të huaj me 2,962 milion lekë dhe mos realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm 1,106 milion lekë. Planifikimi fillestar, ndryshimet gjatë vitit dhe realizimi faktik paraqiten në tabelën e mëposhtme:

E M E R T I M I	Projekt Buxheti 2020	Ligji nr.88/2019	A.N.6	A.N.15	A.N.28	A.N.34	Fakt
Shpenzime Kapitale	83,841	81,639	80,839	75,950	87,837	89,337	85,309
Financimi Brendshem	50,123	51,321	50,521	46,266	59,153	60,653	59,547
Investime nga te ardhurat e Arsimit te Larte	1,200	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000	1,040
Financimi Huaj	32,518	29,318	29,318	28,684	27,684	27,684	24,722

Krahasuar me planin fillestar të miratuar me ligjin nr.88/2019, shpenzimet kapitale janë realizuar më shumë për 3,670 milion lekë, duke qenë se gjatë vitit 2020 është rritur vlera e shpenzimeve kapitale me efektin më të madh sipas shtesës së planit të bërë me aktin normativ nr. 28 ku plani është shtuar me 11,887 milion lekë.

II.3.1 Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë realizuar në shumën 60,587 milion lekë, nga 51,531 milion lekë të realizuar një vit më parë, me një rritje në masën 17,57%, ndërkohë që rritja vit pas viti paraqitet si në tabelën e mëposhtme:


Emërtimi	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Kapitale Financim i brendshëm	38,133	39,118	46,177	52,225	51,531	60,587
Dif. nga viti i mëparshëm		985	7,059	6,048	-694	9,056
Dif. në % nga një vit më parë		2.58%	18.05%	13.10%	-1.33%	17.57%

Realizimi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm është përqënruar kryesisht në muajin dhjetor, ose rreth 29% e shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, paraqitur në grafikun e mëposhtëm:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË



II.3.2. Shpenzimet kapitale me financim të huaj, janë realizuar në shumën 24,722 milion lekë sipas raportimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në treguesit e konsoliduar fiskalë, përkundrajt planit përfundimtar prej 27,684 milion lekë, me një mos realizim në masën 10%.

II.4.Fondi i rindërtimit

Në ligjin nr.88/2019 është parashikuar një fond rindërtimi për shkak të fatkeqësisë natyrore të tërmetit të ndodhur në vitin 2019. Miratimi i tij në ligjin fillestar, ndryshimet e ndodhura në plan përgjatë vitit si dhe realizimi faktik përgjatë vitit 2020 paraqiten si më poshtë:

E M E R T I M I	Projekt Buxheti 2020	Ligji nr.88/2019	A.N.6	A.N.15	A.N.28	A.N.34	Fakt
Fondi I Rindertimit		20,000	20,000	20,000	34,000	32,000	16,591
<i>Grante</i>					3,000	3,000	
<i>Shpenzime</i>					31,000	29,000	16,591
<i>nga te cilat : Qeverisja Qendrore (kap 1)</i>							7,144
<i>Qeverisja Vendore</i>							9,447
<i>nga te cilat: kapitull 1</i>							8,386
<i>kapitull 6</i>							1,061

Fondet për procesin e rindërtimit janë realizuar në shumën 16,591 milion lekë, nga 32,000 milion lekë të planifikuara sipas aktit normativ nr. 34, me një mos realizim në shumën 15,409 milion lekë, ose 48.15%. Në pjesën më të madhe këto fonde janë realizuar në qeverisjen vendore në shumën 9,447 milion lekë, nga të cilat në me burim financimi transfertën e pakushtëzuar në shumën 8,386 milion lekë dhe me burim financimi të ardhurat e veta në shumën 1,061 milion lekë. Shpenzimet nga fondi i rindërtimit të kryera nga ana e qeverisjes qendrore rezultojnë në shumën 7,144 milion lekë sipas raportimit në treguesit e konsoliduar fiskalë.

Referuar përcaktimeve të bëra në ligjin nr.88/2019 për fondin e rindërtimit është cituar në nenin 7 të tij që *“Fondi i Rindërtimit prej 20 miliardë lekë, i cili përdoret për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019, përbëhet nga:*

- *Grante 7 miliardë lekë*
- *Shpenzime të buxhetit të shtetit 13 miliardë lekë*

Fondi prej 20 miliardë lekë, shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi, të miratuar në tabelën 1, të nenit 11 të këtij ligji.

Çdo e ardhur në formë granti me destinacion përballimin e pasojave të tërmetit, mbi tavanin prej 7 miliardë lekë, rrit në të njëjtën masë të ardhurat dhe shpenzimet e Fondit të Rindërtimit, duke



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

shtuar kufijtë e përcaktuar në nenin 1, 2, 8 dhe 11, si dhe kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4, të nenit 11, të këtij ligji.

Në fund të vitit buxhetor, fondet e pashpenzuara trashëgoohen në vitin pasardhës dhe përdoren për të njëjtin qëllim.

Mënyra e përdorimit të Fondit të Rindërtimit, programet buxhetore ku do alokohet fondi si dhe institucionet dhe agjencitë, zbatuese të tij, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave. ”. Ky fond i parashikuar për tu trashëguar edhe në vitet e ardhshme buxhetore është planifikuar vetëm për vitin 2020, duke mos parashikuar buxhet për vitet 2021 dhe 2022 sipas tabelës së mëposhtme, marrë nga tabela 4 e ligjit të buxhetit.

Nr.	E M E R T I M I	Buxheti 2020	Buxheti 2021	Buxheti 2022
VII	Fondi I Rindërtimit	20,000		

Me aktin normativ nr. 6 datë 21.03.2020, paragrafi i tretë i neni 7 është riformuluar duke përcaktuar përdorimin e fondit të rindërtimit edhe në formën e transfertës së pakushtëzuar që shton kufijtë e tabelës 3 të ligjit duke cituar “Fondi prej 20 miliardë lekë, shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi, të miratuar në tabelën 1, të nenit 11 të këtij ligji, si dhe kufijtë e transfertës së pakushtëzuar të miratuar në tabelën 3, të nenit 15 të këtij ligji.ö, pra pa ndryshuar vlerën për vitin buxhetor 2020 dhe as për vitet e ardhshme buxhetore.

Me aktin normativ nr. 28 datë 02.07.2020, neni 7 i ligjit të buxhetit është ndryshuar përsëri duke përcaktuar fondin e rindërtimit në shumën 34 miliardë lekë, ndarë në shumën 3 miliardë lekë grante dhe shpenzime të buxhetit të shtetit 31 miliardë lekë. Pra fondi i rindërtimit është rritur me 14 miliard lekë në total dhe njëkohësisht është ndryshuar klasifikimi i burimit të financimit duke ulur shumën e granteve të planifikuara dhe duke rritur shpenzimet e buxhetit të shtetit. Edhe në këtë akt normativ, është ndryshuar vetëm vlera e buxhetit për vitin 2020, duke parashikuar 0 lekë për vitet 2021 dhe 2022 dhe njëkohësisht mundësinë e trashëgimit të tij në vitet pasardhëse.

Me Aktin normativ nr. 34 dat 16.12.2020, neni 7 i ligjit të buxhetit është ndryshuar duke përcaktuar fondin e rindërtimit në shumën 32 miliardë lekë, ndarë në shumën 3 miliardë lekë grante dhe shpenzime të buxhetit të shtetit 29 miliardë lekë. Pra fondi i rindërtimit është ulur me 2 miliard lekë e reflektuar në uljen e shpenzimeve të buxhetit të shtetit. Edhe në këtë akt normativ, është ndryshuar vetëm vlera e buxhetit për vitin 2020, duke parashikuar 0 lekë për vitet 2021 dhe 2022 dhe njëkohësisht mundësinë e trashëgimit të tij në vitet pasardhëse.

Nga auditimi sipas informacioneve të vendosura në dispozicion nga Minsitria e Financave dhe Ekonomisë, për detajimin e përdorimit të fondit të rindërtimit konstatohet se përdorimi i tij përgjatë vitit me VKM përkatëse është kryer si në vijim:

Emertimi	Grante donacione	Pushteti Qendor	Pushteti Vendor	Totali
Plani I përditësuar I detajuar për vitin 2020	2,311,737,866	10,857,507,938	14,908,746,913	28,077,992,717
Plani total I përditësuar sipas VKM	3,610,630,078	32,191,028,656	42,669,062,760	78,470,721,494

Shpërndarja e fondeve me VKM nuk është shoqëruar me ndryshim të vlerës së fondit të rindërtimit në vitet pasardhëse buxhetore, duke qenë se plani paraqitet në shumën 0 lekë për vitet 2021 dhe 2022 siaps parashikimeve të bëra në ligjin nr. 88/2019 öPër buxhetin e vitit 2020ö, të ndryshuar. Kjo konsiderohet e domosdoshme duke qenë se në shumicën e rasteve fondet e shpërndara me VKM paraqiten sipas ndryshimeve në fund të vitit buxhetor vetëm në vlerën e 20% të kërkuar në vitin e parë ndërkohë që janë lidhur kontrata në mënyrë të vazhdueshme.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT


RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

III. DEFICITI BUXHETOR 2020

Deficiti buxhetor për vitin 2020 është realizuar në shumën 110,602 milion lekë, nga 132,965 milion lekë të planifikuara sipas Aktit Normativ nr.34, me një realizim më të ulët në shumën 22,364 milion lekë. Planifikimi sipas projekt buxhetit, miratimi me ligjin vjetor të buxhetit, ndryshimet përgjatë vitit me aktet normative dhe realizimi faktik i deficitit për vitin 2020 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

E M E R T I M I	Projekt Buxheti 2020	Ligji nr.88/2019	A.N.6	A.N.15	A.N.28	A.N.34	Fakti
DEFIÇITI	-29,299	-39,699	-68,699	-68,699	-132,965	-132,965	-110,602
FINANCIMI DEFIÇITIT	29,299	39,699	68,699	68,699	132,965	132,965	110,602
Brendshem	15,105	25,204	35,754	35,754	50,371	50,371	49,426
Te ardhura nga privatizimi							228
Hua-marrje e brendshme	22,900	29,900	39,900	39,900	49,900	49,900	48,380
Te tjera	-7,795	-4,696	-4,146	-4,146	471	471	818
I Huaj	14,194	14,494	32,945	32,945	82,594	82,594	61,176
Hua afatgjate (e marre)	80,745	77,545	95,995	95,995	95,361	97,361	97,695
Ndryshimi i gjendjes se arkes		0	0	0	0	0	1,386
Ripagesat	-66,550	-66,550	-66,550	-66,550	-62,600	-62,600	-61,698
Mbeshtetje buxhetore		3,500	3,500	3,500	49,833	47,833	23,793

Krahasuar me vitin 2019 ku deficiti rezultoi në shumën 31,548 milion lekë, deficiti buxhetor për vitin 2020 është rritur me 79,054 milion lekë. Realizimi mujor i deficitit, në bazë të realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Deficiti fillesar është planifikuar në rreth 29.3 miliard lekë, ndërkohë që me ligjin nr.99/2018 është miratuar deficiti në shumën 39.7 miliard lekë i parashikuar të financohet nga burime të brendshme në shumën 25.2 miliard lekë dhe burime të jashtme në shumën 14.5 miliard lekë. Me aktin normativ nr.6 deficiti i planifikuar është rritur me 29 miliard lekë, duke rritur parashikimin nga huamarrja e brendshme me rreth 10 miliard lekë dhe 18 miliard lekë nëpërmjet huasë së marrë për projekte specifike. Në vijim me aktin normativ nr. 28 është programuar rritja e deficitit me rreth 64 miliard lekë, e programuar për tu financuar 14 miliard lekë shtesë nëpërmjet rritjes së huamarrjes



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

së brendshme dhe rreth 46 miliard lekë nëpërmjet rritjes së mbështetjes buxhetore në financimin e huaj. Realizimi faktik është realizuar përgjithësisht sipas planifikimit me përjashtim të mos realizimit me rreth 24 miliard lekë të mbështetjes buxhetore të planifikuar.

Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.514/10 datë 25.08.2021 prot. KLSH janë paraqitur observacione ku është parashtruar që:

Lidhur me analizën e shpenzimeve buxhetore për vitin 2020 saktësojmë se:

- Në tabelën përmbledhëse mbi krahasimin e shpenzimeve të përgjithshme ndër vite duhet saktësuar vlera e shpenzimeve për vitin 2016, konkretisht 433,697 milion lekë (433,773 milion lekë paraqitur në raportin tuaj);

- Shpenzimet për kontribute për sigurime shoqërore janë realizuar në shumën 10,563 milion lekë përkundrejt planit të ndryshuar prej 11,267 milion lekë dhe jo 11,356 milion lekë siç është paraqitur në raportin tuaj;

- Shpenzimet për buxhetin vendor janë realizuar në shumën 51,627 milion lekë përkundrejt planit të rishikuar prej 53,285 milion lekë. Krahasuar me planin fillestar mosrealizimi paraqitet në shumën 5,927 milion lekë, ndërkohë që krahasuar me planin e ndryshuar mosrealizimi paraqitet në shumën 1,658 milion lekë. Në raportin tuaj është shprehur e kundërta lidhur me mosrealizimin krahasuar me planin fillestar dhe planin e ndryshuar;

- Me aktin normativ nr.6 deficiti i planifikuar është rritur me rreth 29 miliard lekë, vlera në raportin tuaj 28 milion lekë;

- Lidhur me shifrat e paraqitura për fondin e rindërtimit në tabelën në fund të faqes 46 jemi dakort me shumat e paraqitura në rreshtin òPlani i përditësuar i detajuar për vitin 2020. Ndërsa nuk jemi të qartë se çfarë përfshihet në shumat e paraqitura në rreshtin òPlani total i përditësuar sipas VKMö.

Në përgjigje të komenteve të mësipërme merren në konsideratë rregullimet e propozuara në vlerat e reflektuara në material. Përsa i përket planit total të përditësuar me VKM sqarojmë se rezulton si total i vlerës së shpërndarë me VKM të dala gjatë vitit 2020, sipas secilës VKM e cila është referuar në raportin e dërguar nga DMB mbi tabelën e përdorimit të fondit të rindërtimit përgjatë vitit 2020.

Gjetja:	Përdorimi i fondit të rindërtimit gjatë vitit me VKM nuk është shoqëruar me reflektimin e planit në tabelën 4 të ligjit nr.88/2019 të ndryshuar për reflektimin e planit në vitet pasardhëse buxhetore, sipas angazhimeve të ndërmarra.
Situata:	Në ligjin nr.88/2019 është parashikuar fondi i rindërtimit për shkak të fatkeqësisë natyrore të tërmetit të ndodhur në vitin 2019 në shumën 20 miliard lekë. Përgjatë vitit 2020, ky fond është rishikuar në rritje me Aktin Normativ nr. 28 datë 02.07.2020 në shumën 34 miliard lekë dhe më pas është rishikuar në ulje me Aktin Normativ nr.34 datë 16.12.2020 në shumën 32 miliard lekë, nga të cilat 3 miliard lekë grante dhe 29 miliard lekë financim nga buxheti qendror. Fondet për procesin e rindërtimit janë realizuar në shumën 16,591 milion lekë, nga 32,000 milion lekë të planifikuara sipas Aktit Normativ nr.34, ose 51.8% me një mos realizim në shumën 15,409 milion lekë. Referuar tabelës 4 òTreguesit Fiskal të konsoliduarö të ligjit nr.88/2019, konstatohet se vlera e parashikuar për fondin e rindërtimit për vitet 2021 dhe 2022 është 0 lekë, ndërkohë që



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

	<p>është parashikuar që fondi i rindërtimit i papërdorur në vitin 2020 trashëgohet në vitin pasardhës buxhetor. Gjithashtu, në ligjin nr.88/2019 të ndryshuar është përcaktuar që mënyra e përdorimit të Fondit të Rindërtimit, programet buxhetore ku do alokohet fondi si dhe institucionet dhe agjencitë zbatuese të tij, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave. Sipas informacioneve të vendosura në dispozicion nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë mbi përdorimin e fondit të rindërtimit përgjatë vitit 2020, në bazë të VKM-ve përkatëse, konstatohet se janë shpërndarë në total fonde për rindërtimin në shumën 78,470,721 mijë lekë, nga të cilat detajuar për vitin 2020 në shumën 28,077,992 mijë lekë. Nga auditimi konstatohet se vlera e fondeve të shpërndara me VKM deri në 31.12.2020 prej 78,470,721 mijë lekë është mbi vlerën e përcaktuar në ligjin e buxhetit për fondet e parashikuara të rindërtimit prej 32 miliard lekë (shumë kjo e përcaktuar vetëm për vitin 2020). Kështu, shpërndarja e fondeve me VKM nuk është shoqëruar me ndryshim të vlerës së fondit të rindërtimit në vitet pasardhëse buxhetore, duke qenë se plani vijon të paraqitet në shumën 0 lekë për vitet 2021 dhe 2022 tabelat shoqëruese të ligjit nr. 88/2019 òPër buxhetin e vitit 2020ö, të ndryshuar. Nga auditimi konstatohet pjesa më e madhe e fondeve të shpërndara me VKM të cilat janë ndryshuar në fund të vitit buxhetor, detajojnë vetëm vlerën prej 20% të investimit në vitin e parë, ndërkohë që janë lidhur kontrata në mënyrë të vazhdueshme po në këtë periudhë të pa regjistruara në SIFQ, efekti i të cilave pritet të reflektohet në vitet e ardhshme buxhetore ndërkohë që referuar projekt buxhetit 2021 financimi për fondin e rindërtimit paraqitet 28 miliard lekë për vitin 2021, 6 miliard lekë për vitin 2022 dhe 0 lekë për vitin 2023.</p>
Impakti:	Presion rritës në kërkesën për financim në vitet pasardhëse buxhetore
Shkaku:	Mungesa e reflektimit të planit në tabelën 4 të ligjit nr.88/2019 të ndryshuar
Rëndësia:	E lartë
Kriteri:	Ligji nr.88/2019
Rekomandimi:	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të reflektohet në vitet pasardhëse buxhetore për secilin komponent të treguesve fiskalë të buxhetit të konsoliduar, referuar tabelave shoqëruese të ligjit të buxhetit të vitit, efekti i fondeve të shpërndara me VKM në mënyrë që të realizohet programimi i saktë i shpenzimeve buxhetore brenda limiteve buxhetore të miratuara në këtë ligj.

8. Mbi auditimin e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, programi, monitorimi dhe zbatimi i programeve rajonale dhe vendore.

Në zbatim të pikës 8 të Programit të Auditimit ò*Auditim përputhshmërie në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit*”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Raporti i Buxhetit Faktik për vitin 2020;
- Ligji nr.88/2019 òPër buxhetin e vitit 2020ö, i ndryshuar dhe tabelat e anekset përbërëse të tij dhe ndryshimeve përkatëse;
- Shkresat e miratimit të detajimit të planit buxhetor si dhe ndryshimet përgjatë vitit;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

- Bazat e të dhënave në lidhje me pagesat, kontratat si dhe rishikimet në SIFQ;
- Buletini i Njoftimeve Publike/të Posacëm sipas rasteve;
- Regjistri i realizimit të prokurimit publik;
- PBA sipas fazave të ndryshme si dhe projekt buxheti për vitet përkatëse;
- VKM të dala përgjatë vitit në funksion të vitit buxhetor 2020;
- Relacione, komente, memo sipas trajimit përkatës;
- Raportet e monitorimit;
- Raportet e publikuar mbi treguesit fiskalë të konsoliduar analitikë dhe përmbledhës;
- Raporte specifike nga SIFQ mbi detajimin dhe faktin e treguesve fiskalë mujorë, etj

Sipas ligjit të miratuar nr. 88/2019 datë 18.12.2019 ðPër buxhetin e vitit 2020, është përcaktuar që “Fondi për Zhvillimin e Rajoneve dhe programi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale përdoren sipas aneksit 3, që i bashkëlidhet këtij ligji.”. Në Aneksin 3 të ligjit është parashikuar fondi për zhvillimin e rajoneve dhe programi për infrastrukturën vendore dhe rajonale si dhe programi buxhetor për infrastrukturën vendore dhe rajonale në Fondin Shqiptar të Zhvillimit.

8.1. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit

Për vitin 2020, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga granti konkurses për arsimin. Në aneksin 3 të ligjit nr. 88/2019 datë 18.12.2019 ðPër Buxhetin e vitit 2020 është përcaktuar që shpërndarja e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve sipas projekteve kryhet nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces. Subjektet aplikuese dhe zbatuese janë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Nga auditimi konstatohet se përgjatë vitit 2020, nuk janë marrë vendime nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve për shpërndarjen e projekteve të reja. Në këtë mënyrë, përgjatë këtij viti janë financuar projektet në vazhdim nga vitet e kaluara.

8.1.1. Programi buxhetor 9120 “Arsimi bazë”

Në listën shoqëuese të investimeve publike në projekt buxhetin për vitin 2020, fondet e investimeve për zhvillimin e rajoneve dhe totali i fondeve të investimeve të parashikuara në programin e arsimit bazë paraqiten në tabelën në vijim:

Njësia përfituese	Emertimi I projekteve te parashikuar	Shuma e buxhetuar 2020
Aparati i Ministrisë	Fondi per Zhvillimin e Rajoneve ne vazhdim	967,258
Aparati i Ministrisë	Fondi per Zhvillimin e Rajoneve te reja	468,000
Bashkia Sarande	EKO Kampus Saranda	40,057
Bashkia Diber	Shkolle e re, fshati Kercisht, B. Diber	27,030
Bashkia Kavaje	Rindertim i shkolles-9 vjecare+ambjente sportive+kopesht,Qerret, Kavaje	12,985
Bashkia Rroskovec	Rikonstruksion I shkolles 9-vjecare Velmisht	31,670
Totali		1,547,000
Aparati i Ministrisë	Projekte te tjera ne program jo FZHR	190,000
Totali i programit		1,737,000

Nga auditimi konstatohet se në listën shoqëuese të investimeve publike në projekt buxhet, projektet e miratuara me vendimet e KZHR në vitin 2019, nuk paraqiten me vlerat e miratuara përgjatë të gjitha viteve, duke paraqitur si vit fillimi dhe vit mbarimi vitin 2019, dhe rrjedhimisht duke mos parashikuar fonde për vitin 2020 e në vazhdim. Parashikimi i fondeve për këto projekte është kryer në një projekt të vetëm investimi me miratimin “Fondi për Zhvillimin e Rajoneve në vazhdim”, me institucion Aparatin e Ministrisë, ndërkohë që këto fonde, janë të miratuara me vendim të KZHR përkatëse për projekte me përfitues njësitë e vetëqeverisjes vendore. Fondet e miratuara janë në të njëjtën shumë me fondet e parashikuara për investime me financim të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

brendshëm në këtë program dhe gjatë vitit ka pasur ndryshime me akte normative si në tabelën e mëposhtme:

Programi buxhetor	Ligji	A.N 6	A.N 15	A.N 28	A.N 34
Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	1,737,000	1,737,000	1,117,000	1,117,000	1,071,700

Ndryshimet kryesore përfshijnë uljen me Aktin Normativ nr. 15/2020 në shumën 620,000 milion lekë dhe ulje me Aktin Normativ 34/2020 në shumën 45,300 milion lekë. Me Aktin Normativ nr. 34 janë shtuar gjithashtu 2 milion lekë shpenzimet kapitale me financim të huaj. Në detajimin fillestar të projekteve të investimeve sipas informacionit të vendosur në dispozicion konstatohet se janë detajuar projektet e përmbledhura si më poshtë:

Institucioni	Projektet	Shuma e Detajuar
Aparati Ministrise Arsimit e Shk	Pajisje laboratorike, Fizike-Kimi _Bilogji	40,000,000.00
Aparati Ministrise Arsimit e Shk	Fondi per Zhvillimin e Rajoneve 2017-2018	834,831,754.00
Aparati Ministrise Arsimit e Shk	Pajisje/Mjete mesimore - didaktike - arsim	30,000,000.00
Aparati Ministrise Arsimit e Shk	Pajisje mobileri arsimit baze	100,000,000.00
Aparati Ministrise Arsimit e Shk	Blerje pajisje elektronike, kompjutera per	58,625,000.00
Drejtoria Arsimore Korce (1515)	Krijim fond bibliotekash per shkollat e ar	725,000.00
Drejtoria Arsimore Lezhe (2020)	Krijim fond bibliotekash per shkollat e ar	2,129,484.00
Drejtoria e Përgjithshme e Arsim	Krijim fond bibliotekash per shkollat e ar	10,000,000.00
Aparati Ministrise Arsimit e Shk	Fond i ngrire	20,000,000.00
Bashkia Tirana (3535)	Fond i ngrire	28,000,000.00
Bashkia Korce (1515)	Fond i ngrire	1,588,143.00
Projekte te FZHR Bashkite	Shkolla te ndryshme	611,100,619.00
Totali		1,737,000,000.00

Nga auditimi konstatohet se në detajimin fillestar, janë paraqitur projekte investimi fond i ngrirë, duke mos pasur një projekt specifik dhe duke detajuar fonde pa projekt edhe për krijimin e fondit të bibliotekave për institucione, të tjera nga ato të paraqitur në projekt buxhet. Gjithashtu, fondi për projekte të tjera jo FZHR për aparatin e ministrisë për pajisje laboratorike/elektronike/mobileri është detajuar në shumën 228,625,000 lekë nga 190,000,000 milion lekë të detajuara në projektbuxhet. Gjatë vitit 2020 kanë ndodhur rishikimet e mëposhtme:

-Në muajin prill 2020 janë ulur fondet në total me 620 milion lekë si pasojë e Aktit Normativ nr. 15, duke ulur fondin e zhvillimit të rajoneve me 600 milion lekë dhe fondin e ngrirë me 20 milion lekë.

-Në muajin qershor 2020 është kryer rishpërndarje fondesh duke:

1.Ulur vlerën e projektit për FZHR dhe duke rritur vlerën e një projekti të ri me kod 18BC704 ÷blerje pajisje elektronike, kompjutera për arsimin baze. Në këtë rast konstatohet se është përdorur fondi i zhvillimit të rajoneve për projekte të cilat nuk financohen nga FZHR, pasi nuk ka pasur vendime të KZHR për periudhën objekt auditimi, në shumën 4,449,271 lekë dhe kjo ka rritur vlerën e projektit që zhvillohet nga aparati i ministrisë.

2.Ulur vlera e fondeve të ngrira dhe rritja e vlerave të projekteve ÷M1124010 dhe ÷M1122790 për Bashkinë Korçë dhe Bashkinë Tiranë për rikonstrukcion dhe ndërtim shkollash. Këto projekte rezulojnë si detyrime të prapambetura referuar datës së faturës në pagesën tyre dhe është realizuar futja e tyre si projekte të rinj për fatura të viteve 2013, ndërkohë që procesi i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për këto obligime ka përfunduar sipas VKM përkatëse.

-Në muajin Korrik 2020 është ulur vlera e projektit për fondin e FZHR në shumën 230,382,229 lekë duke çelur projekte të tjera si në vijim:

Kod projekti	Pershkrimi	Shuma
18BC705	Blerje Pajisje mobilerie për shkollat e rindërtuara të arsimit bazë, të dëmtuara nga tërmeti	180,000,000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

18BC706	Blerje Pajisje mesimore didaktike (Fizike-Kimi _Billogji_) per shkollat e rindërtura të Arsimit Bazë të dëmtuara nga tërmeti	50,382,229
19AF401	Pagese TVSH-je per tablete dhuruar nga Fondacioni "..."	20,000,000

Konstatohet se është përdorur fondi për zhvillimin e rajoneve për financimin e projekteve të investimeve që nuk financohen nga FZHR pasi nuk ka vendime të KZHR përgjatë vitit për shpërndarjen e këtyre fondeve, duke qenë se këto projekte janë nga aparati i ministrisë. Gjatë muajit Korrik ka ndodhur edhe rishikimi në rritje në shumën 20 milion lekë për projektin 19AF401 ÷Pagesë TVSH-je për tablete dhuruar nga Fondacioni ...ö, e cila nuk ka ndodhur si pasojë e rialokimit, por me shtesë, duke rritur planin e miratuar me 20 milion lekë, efekt i cili është mbartur edhe në planin përfundimtar në krahasim me fondet e miratuara me aktin normativ të fundit të vitit, reflektuar nga përdorimi i fondit rezervë përgjatë vitit. Konstatohet se pagesa e TVSH është çelur si projekt investimi ndërkohë që granti i përfituar në natyrë për tabletat e dhuruara nuk është regjistruar në listën e investimeve publike të realizuara në vitin 2020, duke paraqitur si investim vetëm pagesën e TVSH.

-Në muajin Dhjetor 2020 janë pakësuar fondet e investimeve në shumën 45,300,000 lekë në projekte investimi të alokuara në bashki për FZHR, në 4 projekte në bashkitë Elbasan, Krujë, Kavajë dhe Fier.

Realizimi faktik i programit 9120 ÷Arsimi bazë përfshirë parashkollorinö paraqiten në shumën 1,047,953,725 lekë me një realizim për 33 produkte nga 43 produkte të buxheturara. Krahasuar me planin përfundimtar paraqitet një realizim në rreth 96 % të totalit të programit. Nga auditimi konstatohet se nga vlera e realizuar e programit në total, vlera prej 559,731,584 lekë është përdorur për shpenzime të realizuara nga bashkitë me burim financimi fondin e zhvillimit të rajoneve për vitin 2020. Nga këto fonde të shpenzuara, vlera prej 111,323,903 lekë përfshijnë detyrime të prapambetura duke përdorur buxhetin e miratuar për vitin 2020 për shlyerjen e faturave të viteve të kaluara të cilat paraqiten si në tabelën e mëposhtme me njësi shpenzuese dhe datë furnitori:

Institucioni	Kod projekti	Pershirm projekti	Data fatures	Shuma
Bashkia Elbasan (0808)	18BC889	Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare "Jorgji Dilo", bashkia Elbasan	30.07.19	361,760
Bashkia Fier (0909)	18BC876	Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare "Penellopi Pirro", bashkia Fier	06.12.19	7,933,611
Bashkia Roskovec (0909)	18BC874	Rikonstruksion I shkolles 9-vjecare Velmisht	30.07.19	10,427,520
Bashkia Roskovec (0909)	18BC874	Rikonstruksion I shkolles 9-vjecare Velmisht	30.07.19	10,427,526
Bashkia Pustec (1515)	18BC877	Rikonstruksion i shkolles se mesme te bashkuar Pustec, bashkia Pustec	04.11.19	207,755
Bashkia Pustec (1515)	18BC877	Rikonstruksion i shkolles se mesme te bashkuar Pustec, bashkia Pustec	06.12.19	5,879,892
Bashkia Librazhd (0821)	18BC890	Shtese anesore 3 kat-ndertim palestere per shkollen 9-vjecare "Vilson Blloshmi", bashkia Librazhd	12.12.19	2,249,658
Bashkia Lushnje (0922)	18BC891	Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare "4 Deshmoret", bashkia Lushnje	01.11.19	14,838,880
Bashkia Divjake (0922)	18BC875	Ndertim kopshti me dreke ne Cerme-Sektor	12.12.19	345,722
Bashkia Divjake (0922)	18BC892	Rikonstruksion+shtese anesore 2kt. i shkolles se mesme te bashkuar "Mihal Nako" fshati Fier-Seman, Bashkia Divjake	11.12.19	8,581,146
Bashkia Rreshen (2026)	18BC880	Rikonstruksion i plote i kompleksit te godinave 1,2,3 shkolla "Vaso Pasha", rreshen, bashkia Mirdite	04.11.19	2,339,789
Bashkia Bajram Curri (1836)	18BC885	Rikonstruksion i shkolles "Tinka Kurti", nj.ad. Lekbibaj, bashkia Tropoje	08.11.19	3,099,260
Bashkia Bajram Curri (1836)	18BC885	Rikonstruksion i shkolles "Tinka Kurti", nj.ad. Lekbibaj, bashkia Tropoje	08.11.19	3,099,260
Bashkia Roskovec (0909)	M112765	Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare "Ajet Toska", Suk 2	26.09.19	628,127
Bashkia Korce (1515)	M112401	Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare Lekas (FZHR)	28.08.14	1,588,143
Bashkia Sarande (3731)	M112606	EKO Kampus Saranda	06.12.18	11,782,645
Bashkia Tirana (3535)	M112279	Ndertimi i shkolles 9-vjecare fshati Mihajas	15.09.17	17,104,580
Bashkia Tirana (3535)	M112279	Ndertimi i shkolles 9-vjecare fshati Mihajas	27.12.18	10,428,629
Totali				111,323,903

8.1.2. Programi buxhetor 9230 "Arsimi i mesëm i përgjithshëm"



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Planifikimi për programin buxhetor “*Arsimi i mesëm i përgjithshëm*” në projekt buxhet dhe ndryshimet me akte normative përgjatë vitit 2020 paraqiten:

Programi	Projekt Buxheti	Ligji 88/2019	A.N.6	A.N.15	A.N.28	A.N.34
09230	1,112,000	1,112,000	1,112,000	842,000	842,000	821,787

Vlera e detajuar me ligjin e buxhetit është e njëjtë me vlerën e planifikuar në projekt buxhet ndërkohë që përgjatë vitit 2020 me aktin normative nr.15/2020 është ulur financimi për investimet në këtë program në shumën 270,000 mijë lekë dhe më Aktin Normativ nr.34 është ulur financimi më tej me 20,213 mijë lekë. Në detajimin fillestar të projekteve të investimeve sipas informacionit të vendosur në dispozicion konstatohet se janë detajuar projektet e përmbeldhura si më poshtë:

Emertim projekti	Buxhet
Fondi per Zhvillimin e Rajoneve 2018-2019	253,673,547
Pajisje laboratorike, Fizike-Kimi-Bilogji, arsimit i mesëm i përgjithshëm	30,000,000
Pajisje mobilierie arsimit i mesëm i përgjithshëm	60,000,000
Krijim fondi bibliotekash për shkollat e arsimit të mesëm	11,049,932
Blerje pajisje elektronike, kompjutera per arsimin e mesem	58,625,000
Rikonstruksion dhe shtese i shkolles se mesme Lagja "Kastrioti", Fushe Kruje	21,024,524
Rikonceptim dhe rikonstruksion i shkolles se muzikes "Jan Kukuzeli" Durres	48,972,956
Rikonstruksion i shkolles "Sami Frasheri", B Permet	27,380,253
Rikonstruksion i shkolles se mesme te pergjithshme, Kelcyre	20,109,193
Rikonstruksion dhe shtese anesore e shkolles se mesme "Haxhi Qehajaj", Rrogozhine	7,303,610
Të tjera FZHR në vazhdim	553,860,985
Fond I ngrirë	20,000,000

Nga vlera e përgjithshme e programit buxhetor 9230 në shumën 1,112,000 mijë lekë konstatohet se janë detajuar në çeljen fillestare të investimeve projekte të infrastrukturës vendore dhe rajonale projekte në shumën 932,325 mijë lekë. Gjatë vitit 2020 kanë ndodhur rishikimet e mëposhtme:

-Në muajin Prill 2020 është reflektuar efekti i aktit normativ nr.15/2020 duke ulur vlerën e projektit “*Fondi per Zhvillimin e Rajoneve 2018-2019*” në shumën 250,000 mijë lekë dhe projektit “*Fond i ngrirë*” në shumën 20,000 mijë lekë, pra 270,000 mijë lekë në total.

-Në muajin Qershor është kryer rialokim ndërmjet projekteve duke pakësuar përsëri projektin “*Fondi per Zhvillimin e Rajoneve 2018-2019*” për pjesën e mbetur të tij në shumën 3,673,547 lekë dhe duke shtuar projektin “*Blerje pajisje Elektronike, Kompjutera për shkollat e arsimit të mesëm*”, për aparatet e Minsitrisë së Arsimit dhe Sportit.

Në muajin Dhjetor 2020 është reflektuar efekti i pakësimit me aktin normative nr. 34 duke pakësuar 4 projekte në shumën 20,213,000 lekë si më poshtë:

Kod projekti	Emertim projekti	Shuma
M112629	Krijim fondi bibliotekash për shkollat e arsimit të mesëm	10,000,000
18BC903	Blerje pajisje Elektronike, Kompjutera për shkollat e arsimit të mesëm	3,673,747
M112771	Rikonstruksion i shkolles "Sami Frasheri", Permet	3,885,725
18BD037	Rikonstruksion i shkolles mesme "Jovan Ndreko" Libofshe	2,653,528

Realizimi faktik i programit 9230 “*Arsimi i mesëm i përgjithshëm*” paraqitet në shumën 817,468,936 lekë me një realizim për 27 produkte nga 30 produkte të buxhetuara. Krahasuar me planin përfundimtar paraqitet një realizim në rreth 99 % të totalit të programit. Nga auditimi konstatohet se nga vlera e realizuar e programit në total, vlera prej 669,456,884 lekë është përdorur për shpenzime të realizuara nga bashkitë me burim financimi fondin e zhvillimit të rajoneve për vitin 2020. Nga këto fonde të shpenzuara, vlera prej 104,630,946 lekë përfshijnë detyrime të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

prapambetura duke përdorur buxhetin e miratuar për vitin 2020 për shlyerjen e faturave të viteve të kaluara të cilat paraqiten si në tabelën e mëposhtme me njësi shpenzuese dhe datë furnitori:

Emri institucionit	Kod projekti	Data e fatures	Shuma
Bashkia Durres (0707)	M112754	22.08.19	16,964,220
Bashkia Fier (0909)	M112768	31.12.18	14,355,107
Bashkia Fier (0909)	M112768	31.01.19	2,286,003
Bashkia Fier (0909)	M112768	31.12.18	2,317,847
Bashkia Kruje (0716)	M112752	12.09.18	21,024,524
Bashkia Kelcyre (1128)	M112772	30.12.19	10,490,615
Bashkia Kelcyre (1128)	M112772	30.09.19	713
Bashkia Kelcyre (1128)	M112772	30.09.19	9,617,865
Bashkia Fier (0909)	18BD037	09.12.19	3,751,673
Bashkia Fier (0909)	18BD037	09.12.19	6,560,351
Bashkia Kucove (0217)	18BD030	25.10.19	2,011,394
Bashkia Lushnje (0922)	18BD035	23.10.19	9,107,261
Bashkia Peqin (0827)	18BD034	12.12.19	434,694
Bashkia Vore (3535)	18BD044	13.12.19	5,708,679
Totali			104,630,946

8.1.3 Programi buxhetor 9450 "Arsimi i lartë"

Planifikimi për programin buxhetor Arsimi i lartë në projekt buxhet është kryer në 3 projekte investimi në shumën 630 milion lekë sipas listës së mëposhtme:

Emërtim projekti	Shuma
Fondi Grant per Zhvillimin Institucional 2017-2019-2020 Fond per zhvillim ne IAL, sipas nenit 111 te ligjit 80/2015.	589,217
Rikonstruksion i ndertesave se korpusit kryesor, U Arteve Tirane	30,783
Tvsh per projektet e huaja	10,000
Totali	630,000

Miratimi dhe ndryshimet përgjatë vitit me akte normative i investimeve kapitale me financim të brendshëm për arsimin e lartë paraqitet:

Pershkrimi	Ligji 88/2019	A.N.6	A.N.15	A.N.28	A.N.34
Investime kapitale me financim te brendshem	630,000	530,000	430,000	930,000	385,672
Diferenca ndermjet akteve		(100,000)	(100,000)	500,000	(544,328)

Nga auditimi konstatohet se në detajimin fillestar janë çelur projektet e mëposhtme të investimit si më poshtë:

Kod projekti	Emertim projekti	Njesi shpenzuese	Plani buxhetor
18BD508	Pajisje akomoduese të blera për konviktet	Aparati Ministrise Arsimit	120,000,000
M112692	Fondi per Zhvillimin e Rajoneve 2017-2019	Aparati Ministrise Arsimit	352,995,864
M112799	Rikualifikimi I ndërtesave të UPT-se	Aparati Ministrise Arsimit	78,287,748
M112680	TVSH per projektet e huaja	Aparati Ministrise Arsimit	10,000,000
M112801	Rikonstruksion i ndërtesave se korpusit kr	Akademia e Arteve (3535)	68,716,388
Totali			630,000,000

Në detajimin e fondit të investimeve kapitale me financim të brendshëm projektet e çelura janë të ndryshme nga ato të paraqitura në projekt buxhet, në listën e investimeve publike 2020-2022, duke përfshirë FZHR e cila nuk ka qenë e planifikuar në projekt buxhet si dhe projektin rikualifikim i ndërtesave të UPT, kontratë në vazhdim nga viti 2018.

Me aktin normativ nr.6/2020 dhe 15/2020 vlera e këtij program është ulur me 200 milion lekë, reflektuar në projektin për FZHR 2017-2019. Me Aktin normative nr. 28/2020 vlera e këtij programi është rritur me 500 milion lekë, e reflektuar duke ulur vlerën e FZHR 2017-2019 me 50



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

milion lekë dhe duke shtuar projektet M112308 “Ndërtimi i një godine të re universitare” në shumën 50 milion lekë dhe projektin 18BD509 “Studim projektim të konvikteve” në shumën 500 milion lekë me përfitues Bashkinë Tiranë. Në muajin Shtator janë kryer rialokime ndërmjet projekteve, duke ulur më tej vlerën e FZHR 2017-2019 me 61,055,120 lekë dhe shtuar projektin M112308 “Ndërtimi i një godine të re universitare” me përfitues Universitetin Aleksandër Moisiu. Nga auditimi konstatohet se me akt normativ është detajuar ky projekt investimi dhe është shtuar vlera nëpërmjet rishikimit në rritje ndërkohë që projekti i investimit paraqitet sipas kontratës së vitit 2016 dhe fatura të gjitha të vitit 2018 në shumën totale 111,055,120 lekë. Rialokimi nga projekti për FZHR 2017-2019 drejt projektit të ndërtimit të godinës universitare është kryer për financimin e kontratës që paraqitet detyrim i prapambetur dhe nuk është kryer që në fillim të vitit sipas parashikimeve të bëra në udhëzimin për zbatimin e buxhetit të vitit 2020. Në këtë mënyrë kostatohet se çelja e projekteve me akt normative dhe rritja me rialokime gjatë viteve kryhet për detyrime të prapambetura.

Ndryshimet e fundit të planit kanë ndodhur me aktin 34/2020 ku vlera e këtij program ka shkuar në shumën 385,672,000 lekë, e reflektuar nga ulja e projektit 18BD509 “Studim projektim të konvikteve” në shumën 500 milion lekë me përfitues Bashkinë Tiranë.

Nga projektet e buxhetuara në këtë program për investime kapitale me financim të brendshëm janë realizuar projekte në shumën 318,580,417 lekë, nga të cilat 111,055,120 lekë për detyrime të prapambetura nga viti 2018.

Mos detajimi i detyrimeve të prapambetura në këtë program buxhetor nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në buxhetin e vitit 2020 nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 17 të udhëzimit plotësues nr. 2 datë 20.01.2020 të MFE “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, ku citohet që “*Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në vazhdim, të financuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve në përputhje me ecurinë e projektit...*”. Edhe miratimi nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë i planit fillestar për këto projekte të paraqitura për miratim si pjesë e detajimit të fondeve të investimeve për këtë program nuk është në përputhje me këtë udhëzim, duke sjellë planifikimin e projekteve të tjera dhe ndjekjen e të gjithë hapave për kontraktimin e tyre pa shlyer detyrimet kontraktuale për fatura të prapambetura.

8.2 Programi buxhetor 6220 “Infrastruktura Vendore dhe Rajonale” në Fondin Shqiptar të Zhvillimit

Fondet për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, të parashikuara si program buxhetor në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, janë një mekanizëm financiar që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor. Autoriteti programues, kontraktues dhe zbatues është Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Nga fondi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces me burim financimi ish-Fondin e Zhvillimit të Rajoneve-Infrastruktura Vendore dhe Rajonale.

Përgjatë vitit 2020, rezulton se shpërndarja e fondeve është kryer nga Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Miratimi i detajimit dhe ndryshimeve në plan përgjatë vitit është kryer nga Ministria e Financave pas kërkesave të FSHZH. Sipas projektbuxhetit, ligjit për buxhetin e vitit 2020 dhe ndryshimet sipas Akteve Normative përkatëse, planifikimi për programin 06220 “Infrastruktura Vendore dhe Rajonale” paraqitet si më poshtë:

INFRASTRUKTURA VENDORE DHE RAJONALE	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Projekt buxheti	3,500,000	3,000,000	3,000,000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Ligji I miratuar	4,500,000	3,000,000	3,000,000
Akti normativ 6	4,500,000	3,000,000	3,000,000
Akti normativ 15	4,500,000	3,000,000	3,000,000
Akti normativ 28	4,500,000	3,000,000	3,000,000
Akti normativ 34	3,500,000	3,000,000	3,000,000

Planifikimi fillestar është paraqitur për 3.5 miliardë lekë ndërkohë që me ligjin e miratuar fondet për këtë program janë vendosur në shumën 4.5 miliard lekë. Edhe pas ndyshimeve të vazhdueshme të buxhetit përgjatë vitit, nuk janë ndryshuar fondet në total, me përjashtim të Aktit Normativ nr. 34 datë 16.12.2020 ku janë pakësuar fondet në total për 1 miliard lekë, duke reflektuar një plan përfundimtar në shumën 3.5 miliard lekë për vitin 2020. Vlera e realizimit të programit infrastruktura vendore dhe rajonale për vitin 2020 është në shumën 3,303,787,548 lekë, nga të cilat 2,689,320,697 lekë për projekte të infrastrukturës vendore dhe rajonale dhe 614,466,851 lekë për projekte të detajuara për detyrime të prapambetura 2011-2013 dhe investime në proces 2014-2018 (këtu përfshihen projektet që fillojnë me M99 dhe tre projekte që fillojnë me M56).

8.2.1 Mbi fondin për zhvillimin e rajoneve

Në detajimin fillestar të investimeve nga programi infrastruktura vendore dhe rajonale është detajuar projekti 18BP001 "Projekte te grantit infrastruktura vendore dhe Rajonale" në shumën 450,000,000 lekë.

Në muajin Mars është kryer rialokim ndërmjet projekteve duke ulur vlerën e këtij projekti në shumën 259,705,036 lekë dhe duke çelur projekte për detyrime të prapambetura me njësi shpenzuese njësitë e vetqeverisjes vendore. Në muajin Korrik është kryer përsëri rishpërndarje duke financuar edhe 104,010,137 lekë detyrime të tjera të njësitë të vetqeverisjes vendore dhe duke ulur vlerën e projektit 18BP001 "Projekte te grantit infrastruktura vendore dhe Rajonale". Në muajin Tetor 2020 është kryer rishpërndarje fondesh rritur vlerën e projektit 18BP001 "Projekte te grantit infrastruktura vendore dhe Rajonale" me 86,269,620 lekë dhe vlerën e projekteve të tjera detyrime të prapambetura me njësi shpenzuese njësitë e vetqeverisjes vendore në shumën 81,250,560 lekë. Në muajin Dhjetor 2020 është kryer rishpërndarja e fundit e fondeve në zbatim të aktit normativ nr. 34/2020 duke rritur vlerën e projekteve të FZHR në shumën 223,084,573 lekë, e financuar nëpërmjet uljes së vlerës së projektit 18BP001 "Projekte te grantit infrastruktura vendore dhe Rajonale" në shumën 172,554,445 lekë. Në total, vlera e buxhetuar për detyrime të FZHR rezulton në shumën 803,028,737 lekë, nga të cilat janë shpenzuar 614,446,851 lekë. Nga vlera e paguar prej 614,446,851 lekë, janë paguar detyrime për fatura të prapambetura në shumën 491,212,451 lekë, të paraqitura sipas projekteve të mëposhtëm:

Kod	Emertim projekti	Shuma e paguar
M990190	Rik.rruga e Dardhes	22,013,520
M990619	Rikonstruksion e asfaltim rruga Funar Mollagjesh perroi Korre	33,146,895
M991053	Rikonstruksion i rrugës Veterrik - Gur i Bardhë	2,507,149
M991062	Sistemim asfaltim rruge Lisi Buzuqit Vendreshe	1,495,929
M991072	Rionstr.Asfalt Katund i Ri - Qerret	69,056,423
M991073	Rikonstruksion i rruges Hushi-Deda fshati ne fshatin Kamerras	3,480,883
M991085	Rikonstruksion rruge Bersnik Nj.Adm.Kodovjat	7,117,558
M991101	Sistemim Asfaltim i rruges Hysgjokaj-Ballagat	25,524,892
M991106	Rikonstruksion i rruges Qafa e Kashit- Usoje - Kalenje	45,321,400
M991119	Sistemim asfaltim I rruges kryqezimi Vithkuq-Lubonje	5,872,709
M991164	Ndërtimi i rrugës "Pjetër Bogdani"	4,965,234
M991166	Rikonstruksion i rruges Pellumbas-Kllojke	2,800,023
M991190	Rik.rr. Kthesa e Ariut Perlat	32,540,016
M991215	Rikonstuksion i rruges "A.Gjergjevicaç (Shkoze) Nj nr. 1	45,108,263
M991218	Ndertim i rruges qe lidh rrugen ç5 Majiç me rrugen çSelaudin Zorbaç	36,427,966
M991220	Rikonstruksioni i rruges "Qemal Butka"	18,078,543
M991221	Rikonstuksion i rruges "Pandi Stilla"	9,046,851
M991223	Sistemim, Asfaltim, Kanalizim, Ndricim Rrugor në segmentin rrugor; Babru Qendër - Kodër e Kuqe Puseta	1,005,900



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

M991226	Sistemit dhe asfaltim i rrugës Bexull 9 Lagjia Mukje	34,944,797
M991231	Sistemit, Asfaltim Rruga Qeha - Mangull - Gurra e Madhe	16,485,594
M991234	Rikon.e rruges Arapaj-Koder Rrashb-Xhavzotaj	28,465,651
M991448	Rehabilitim i rrugës Dermish-Dhivër-Cerkovicë	508,739
M991506	Rehabilitimi i fasadave dhe rikonstruksioni i rrugës "Rauf Nallbani", si dhe rrijtëzimi i hapësirës së terminalit të autobusave	15,590,826
M991543	Rehabilitimi i rrugës Pllakë - Kulluricë	24,113,411
M990339	Pedonalja e qytetit dhe Unaza e Poshtme	4,643,280
M991219	Rikonstruksion Rruga Teki Selenica	949,999
Totali		491,212,451

Nga auditimi konstatohet se financimi i detyrimeve të fondit të zhvillimit të rajoneve nuk është kryer sipas përparësisë së përcaktuar në aneksin 3 të ligjit nr. 88/2019 për buxhetin e vitit 2020, të ndryshuar duke qenë se vlera fillestare e detajuar është 450,000,000 lekë, duke detajuar fondet në projekte të tjera për të cilat kanë filluar procedurat e prokurimit, ndërkohë që me rishikimet përgjatë vitit vlera e rishikuar për financimin e projekteve në vazhdim paraqitet në shumën 803,028,737 lekë. Miratimi nga ana e MFE për detajimin e fondeve të investimeve nuk ka kontribuar në uljen e detyrimeve të prapambetura dhe mirëmenaxhimin e fondeve të këtij programi. Mos detajimi i detyrimeve të prapambetura në këtë program buxhetor që i përkasin infrastrukturës vendore dhe rajonale, nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 13 të udhëzimit plotësues nr. 2 datë 20.01.2020 të MFE për zbatimin e buxhetit të vitit 2020, ku citohet që Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në detajimin e planit të miratuar të investimeve për programin buxhetor për infrastrukturën vendore dhe rajonale në buxhetin e vitit 2020 me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces me burim financimi ish-Fondin e Zhvillimit të Rajoneve. Edhe miratimi nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë i planit fillestar për këto projekte të paraqitura për miratim si pjesë e detajimit të fondeve të investimeve për këtë program nuk është në përputhje me këtë udhëzim, duke sjellë planifikimin e projekteve të tjera dhe ndjekjen e të gjithë hapave për kontraktimin e tyre pa shlyer detyrimet kontraktuale për fatura të prapambetura.

8.2.2 Mbi projektet e tjera të programit të infrastrukturës vendore dhe rajonale

Gjatë vitit 2020 në programin 06220 ËInfrastruktura vendore dhe rajonale janë planifikuar dhe projekte të tjera investimit publik, sipas përcaktimeve të bëra në aneksin 3 të ligjit nr.88/2019 të ndryshuar në të cilat autoritet programues, prokurues, kontraktues dhe zbatues është Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Nga auditimi konstatohet se gjatë vitit 2020 janë financuar kontrata të lidhura në vitet e mëparshme buxhetore dhe në të njëjtën kohë kontrata të reja të lidhura përgjatë vitit 2020.

Në lidhje me kontratat në vazhdim nga viti 2019 janë konstatuar problematika që paraqiten si në vijim sipas projekteve specifike:

-18BP002 "Rikualifikimi i sheshit Italia". Kontrata është lidhur në 27.08.2019. Kohëzgjatja e punimeve është 3 muaj sipas dokumentave të tenderit. Faturimi është kryer në Dhjetor 2020 sipas situacionit 4 dhe realizimi në total paraqitet në shumën 73.177.491 lekë.

Projekti	Celja fillestare	Plani Dhjetor	Realizimi faktik
18BP002	Rikualifikimi i Sheshit Italia	97,145,409	75,145,409

-18BP003 "Permirosimi i aksesit në sitet turistike dhe lehtësimi i trafikut në zonat urbane në rajonet veriore". Kontrata me emërtimin P/Punë 2019/GOA/IVR-38 e lidhur me afat 12 muaj në datë 22.10.2019 me vlerë 409,902,524 lekë. Buxhetimi fillestar dhe ndryshimet përgjatë vitit paraqiten:

Projekti	Celja fillestare	Plani Dhjetor	Realizimi faktik
18BP003	Permirosimi i aksesit në sitet turistike dhe lehtësimi i trafikut në zonat urbane në rajonet veriore	349,133,790	324,133,790

Të gjitha pagesat i përkasin faturave të vitit 2020, nuk ka detyrime të prapambetura të paguara.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

-18BP004 “Studime fizibiliteti, plane biznesi, plane zhvillimore, plane menaxhimi dhe veprimi, masterplane, projekt – ide teknike”. Nuk ka kontratë të lidhur në databazën e prokurimeve megjithëse ka procedurë të hapur shërbim konsulence. Buxhetimi fillestar dhe ndryshimet përgjatë vitit paraqiten:

Projekti	Celja filletare	Plani Dhjetor	Realizimi faktik
18BP004 Studime fizibiliteti, plane biznesi, zhvillimore, menaxhimi dhe veprimi, masterplane, ngritje kapacitetesh, etj	104,037,404	34,000,000	0

- 18BP005 “Rivitalizimi urban i zonave me potencial te larte turistik ne Rajonin 3 dhe 4”. Kontrata “Rivitalizimi urban i zonave me potencial te larte turistik ne Rajonin 3 dhe 4” është e lidhur në 21.11.2019 në shumën 183,819,187 lekë. me afat kontrate 12 muaj. Nga auditimi është konstatuar se në këtë projekt investimi në SIFQ është regjistruar edhe kontrata “Loti II- Ndërtimi i rrugës së re përgjatë lumit Osumit si dhe ndërhyrje përmirësuese në bypassin e rrugës Antipatrea dhe rehabilitimi i rrugës lidhëse ndërmjet rrugës Shëtitorja Osumi dhe rrugës Antipatrea, Bashkia Berat” me datë kontrate 23.12.2019 në shumën 110,555,850 lekë me afat 6 muaj.

Buxhetimi fillestar dhe ndryshimet përgjatë vitit paraqiten:

Projekti	Celja filletare	Plani Tetor	Plani Dhjetor	Realizimi faktik
18BP005 Rivitalizimi urban i zonave me potencial te larte turistik ne Rajonin 3 dhe 4	235,500,030	294,375,037	270,744,953	270,744,953

Nga auditimi konstatohet se janë kryer disa pagesa për këtë projekt të cilat kanë shlyer detyrimet për dy kontratat e mësipërme sipas ndarjes:

-5 pagesa në shumën totale 107,068,238 lekë për kontratën e ndërtimit të rrugës përgjatë lumit Osum dhe;

-9 pagesa në shumën 163,676,715 lekë për kontratën e rivitalizimit urban të zonave me potencial të lartë turistik në rajonin 3 dhe 4.

Fondet e investimit të planifikuara për projektin 18BP005 janë përdorur për të financuar edhe kontratën e lidhur në 23.12.2019 që nuk ka lidhje me projektin e detajuar sipas listës së investimeve publike.

-18BP006 “Permiresimi i infrastruktures rrugore ne funksion te zhvillimit te turizmit dhe agroturizmit ne Rajonin 4”. Për këtë projekt kontrata është lidhur në 22.10.2019 në shumën 505,544,752 lekë me tvsh me afat 12 muaj. Buxhetimi fillestar dhe ndryshimet përgjatë vitit paraqiten:

Projekti	Celja filletare	Plani Nentor	Plani Dhjetor	Realizimi faktik
18BP006 Permiresimi I infrastruktures rrugore ne funksion te zhvillimit te turizmit dhe agroturizmit ne Rajonin 4	396,421,669	384,414,550	324,414,550	324,414,550

Konstatohet se janë kryer 10 pagesa drejt operatorit ekonomik në shumën 324,414,550 lekë të gjitha me datë furnitori 2020. Nga auditimi konstatohet se megjithëse periudha e implementimit të kontratës është 12 muaj, dhe kontrata është lidhur në 22.10.2019 (përfundon në 2020), fondet e alokuara për këtë projekt sipas shkresës nr.4140/2 datë 19.03.2020 të MFE drejtuar FSHZH është miratuar detajimi edhe për vitin 2021 në shumën 73,562,451 lekë dhe për vitin 2020 në shumën 396,421,669 lekë, duke buxhetuar shtyrjen në kohë të pagesës në lidhje me këtë projekt. Gjithashtu konstatohet se në vijim, fondet e investimit për këtë projekt janë pakësuar në muajin tetor në shumën 12,007,119 lekë dhe në muajin dhjetor në shumën 60,000,000 lekë, duke e zhvendosur në kohë detyrimin në lidhje me këtë projekt.

-18BP007 “Nderhyrje per permiresimin e shtresave rrugore”. Nga auditimi konstatohet se për këtë projekt është lidhur kontrata në bazë të marrëveshjes kuadër me dy operatorë ekonomikë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

përgjatë vitit 2020 dhe janë kryer në total 9 pagesa në shumën 397,526,674 lekë. Plani fillestar, ndryshimet përgjatë vitit dhe realizimi faktik për këtë projekt paraqiten:

Projekti	Celja filletare	Plani Tetor	Plani Dhjetor	Realizimi faktik
18BP007	Nderhyrje per permiresimin e shtresave rrugore	333,440,737	477,459,125	398,576,301

-18BP008 “Mbeshtetje per programin (Kosto Operacionale)” përfshin pagesën e mbështetjes për programin dhe kosto operacionale e cila është detajuar në shumën 123,750,000 lekë dhe paraqitet në realizim me të njëjtën shumë. Konstatohet se është regjistruar në fondet e investimeve dhe përfshin një urdhër shpenzim sipas situacionit të shpenzimeve e kyer në Shtator 2020 me përfitues FSHZH. Mbështetja për aktivitetin operativ konstatohet se është kryer duke përdorur fondet e investimit.

-18BP009 “Permiresimi i infrastrukures rrugore ne zonat turistike te rajonit qendror dhe lehtesimi i trafikut ne zonat urbane te tij”. Nga auditimi konstatohet se për këtë projekt është lidhur kontrata në 22.10.2019 në shumën 353,134,076 lekë me tvsh me afat 10 muaj. Plani fillestar, ndryshimet përgjatë vitit dhe realizimi faktik për këtë projekt paraqiten:

Projekti	Celja filletare	Plani Tetor	Plani Dhjetor	Realizimi faktik
18BP009	Permiresimi I infrastrukures rrugore ne zonat turistike te rajonit qendror dhe lehtesimi I trafikut ne zonat urbane te tij	359,579,537	286,175,262	276,175,262

Në lidhje me projektet e reja të investimit janë konstatuar problematika që paraqiten si në vijim sipas projekteve specifike:

Gjatë vitit 2020 nga ana e FSHZH janë detajuar projekte investimi të cilat janë prokuruar përgjatë vitit dhe për të cilat janë lidhur kontratat përkatëse. Nga auditimi konstatohet se pjesa më e madhe e projekteve janë detajuar në çeljen fillestare dhe vetëm një projekt është detajuar në muajin Tetor. Vlera e projekteve është ulur në muajin Dhjetor 2020 si pasojë e ndryshimit me akt normativ nr. 34/2020 që ka reflektuar efektin prej 1 miliard lekë të uljes së vlerës së financimit në total, duke shkurtuar fondet për kontratat e prokuruar rishtazi. Detajimi, muajt në të cilët kanë ndryshuar buxheti, realizimi faktik dhe vlera totale e kontraktuar rezultojnë si në tabelën e mëposhme:

Kodi	Pershkrimi	Janar	Tetor	Dhjetor	Fakti	kontrata lidhur e
18BP015	Ndërtimi i godinës së parkimit dhe hapësirave mbështetëse në Gjirokastër- Sheshi Çerçiz Topulli	80,000,000	100,604,694	-	-	350,545,934
18BP016	Permiresimi i infrastrukures turistike ne funksion te zhvillimit ekonomik rajonal	47,496,274	14,262,300	-	-	
18BP017	ITUN + Kanalizime Valbonë	14,000,000	18,999,769	-	-	50,254,273
18BP018	Ndertimi i ITUN ne Divjake	10,000,000	10,000,000	-	-	29,173,488
18BP019	Rivitalizimi urban i zonave me potencial te larte turistik ne Rajonin 4, Ballina Ujore e Vlores	196,000,000	196,000,000	119,385,660	119,385,660	762,336,498
18BP020	Rivitalizim urban dhe rruga hyrese per ne portin e Vlores	60,000,000	40,000,000	40,000,000	40,000,000	156,000,000
18BP021	Ndërtimi i godinës së parkimit dhe hapësirave mbështetëse në QSUT	46,800,000	-	-	-	
18BP022	Zhvillimi i atraksionit turistik mbeshtetur mbi potencialet lokale	150,000,000	150,000,000	-	-	334,021,251
18BP023	Ndërtimi i godinës së parkimit dhe hapësirave mbështetëse në Berat -Sheshi Teodor Muzaka	80,000,000	95,271,110	-	-	322,088,705
18BP024	Rikonstruksioni i rruges Polis dhe Babje	80,000,000	85,705,690	64,588,514	64,588,514	203,090,995
18BP025	Ngritja e qendrave te ekselences per zhvillimin rajonal dhe vendor	120,000,000	120,000,000	-	-	393,004,180
18BP026	Rikualifikimi i Lulishtes në qendër të qytetit të Elbasanit	20,000,000	7,690,320	-	-	22,010,756
18BP027	Ngritja e platformes unike rajonale te projekteve te NJVV, dixhitalizim,imazheri e softëare	90,000,000	90,000,000	-	-	
18BP028	Sistemimi i hyrje daljes dhe stabilizimi i rreshqitjes ne hyrje te qytetit të Pogradecit	60,000,000	20,000,000	15,792,366	15,792,366	33,619,664
18BP029	Ndërtimi i godinës së re të Bashkisë Divjakë	50,000,000	10,000,000	-	-	166,331,745



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

18BP030	Rikonstruksioni i rruges "Iliaz Kosova", Elbasan	33,418,737	-	83,427,843		
Totali		1,104,296,274	991,952,620	239,766,540	239,766,540	2,905,905,332

Në mënyrë të detajuar problematikat e konstatuara në lidhje me këto kontrata paraqiten:

- *Projekti 18BP015 "Ndërtimi i godinës së parkimit dhe hapësirave mbështetëse në Gjirokastër-Sheshi Çerçiz Topulli"*. Fondet janë detajuar në shumën 80 milion lekë, janë rritur në tetor në shumën 100,604,694 lekë dhe në dhjetor rezultojnë në shumën 0 lekë. Kontrata është nënshkruar në 23.12.2020 në shumën 350,545,934 lekë dhe është regjistruar në SIFQ në 17.01.2021. Plani i buxhetit për këtë projekt investimi paraqitet i ndarë në 3 vite ndërkohë që periudha e kohëzgjatjes së kontratës rezulton 12 muaj sipas buletinit të njoftimeve publike në APP. Kontrata është lidhur në kundërshtim me afatin 15 tetor për ndërmarrjen e angazhimeve të reja të përcaktuar në ligjin e buxhetit.

- *Projekti 18BP017 "ITUN + Kanalizime Valbonë"*. Fondet janë detajuar në shumën 14 milion lekë, janë rritur në tetor në shumën 18,999,769 lekë dhe në dhjetor rezultojnë në shumën 0 lekë. Kontrata është nënshkruar në 12.11.2020 në shumën 50,254,273 lekë dhe është regjistruar në SIFQ në vitin 2020. Plani i buxhetit për këtë projekt investimi paraqitet i ndarë në 3 vite ndërkohë që periudha e kohëzgjatjes së kontratës rezulton 8 muaj sipas buletinit të njoftimeve publike në APP. Kontrata është lidhur në kundërshtim me afatin 15 tetor për ndërmarrjen e angazhimeve të reja të përcaktuar në ligjin e buxhetit.

- *Projekti 18BP018 "Ndërtimi i ITUN ne Divjakë"*. Fondet janë detajuar në shumën 10 milion lekë, dhe në dhjetor rezultojnë në shumën 0 lekë. Kontrata është nënshkruar në 03.09.2020 në shumën 29,173,488 lekë dhe është regjistruar në SIFQ në vitin 2020. Plani i buxhetit për këtë projekt investimi paraqitet i ndarë në 3 vite ndërkohë që periudha e kohëzgjatjes së kontratës rezulton 8 muaj sipas buletinit të njoftimeve publike në APP.

- *Projekti 18BP019 "Rivitalizimi urban i zonave me potencial te larte turistik ne Rajonin 4, Ballina Ujore e Vlores"*. Fondet janë detajuar në shumën 196 milion lekë, dhe në dhjetor rezultojnë në shumën 119,385,660 lekë. Kontrata është nënshkruar në 17.09.2020 në shumën 762,336,498 lekë dhe është regjistruar në SIFQ në vitin 2020. Plani i buxhetit për këtë projekt investimi paraqitet i ndarë në 3 vite ndërkohë që periudha e kohëzgjatjes së kontratës rezulton 12 muaj sipas buletinit të njoftimeve publike në APP.

- *Projekti 18BP020 "Rivitalizim urban dhe rruga hyrese per ne portin e Vlores"*. Fondet janë detajuar në shumën 60 milion lekë, janë rritur në tetor në shumën 40 milion lekë dhe në dhjetor rezultojnë në shumën 40 milion lekë. Kontrata është nënshkruar në 30.07.2020 në shumën 156 milion lekë dhe është regjistruar në SIFQ në vitin 2020. Plani i buxhetit për këtë projekt investimi paraqitet i ndarë në 3 vite ndërkohë që periudha e kohëzgjatjes së kontratës rezulton 12 muaj sipas buletinit të njoftimeve publike në APP.

- *Projekti 18BP022 "Zhvillimi i atraksionit turistik mbeshetur mbi potencialet lokale"*. Fondet janë detajuar në shumën 150 milion lekë, dhe në dhjetor rezultojnë në shumën 0 lekë. Kontrata është nënshkruar në 14.12.2020 në shumën 334,021,251 lekë dhe është regjistruar në SIFQ në 19.04.2021. Plani i buxhetit për këtë projekt investimi paraqitet i ndarë në 3 vite ndërkohë që periudha e kohëzgjatjes së kontratës rezulton 12 muaj sipas buletinit të njoftimeve publike në APP. Kontrata është lidhur në kundërshtim me afatin 15 tetor për ndërmarrjen e angazhimeve të reja të përcaktuar në ligjin e buxhetit.

- *Projekti 18BP023 "Ndërtimi i godinës së parkimit dhe hapësirave mbështetëse në Berat -Sheshi Teodor Muzaka"*. Fondet janë detajuar në shumën 80 milion lekë, janë rritur në tetor në shumën 95,271,110 lekë dhe në dhjetor rezultojnë në shumën 0 lekë. Kontrata është nënshkruar në 23.12.2020



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

në shumën 322,088,705 lekë dhe është regjistruar në SIFQ në 10.06.2021. Plani i buxhetit për këtë projekt investimi paraqitet i ndarë në 3 vite ndërkohë që periudha e kohëzgjatjes së kontratës rezulton 6 muaj sipas buletinit të njoftimeve publike në APP. Kontrata është lidhur në kundërshtim me afatin 15 tetor për ndërmarrjen e angazhimeve të reja të përcaktuar në ligjin e buxhetit.

- *Projekti 18BP024 "Rikonstruksioni i rruges Polis dhe Babje"*. Fondet janë detajuar në shumën 80 milion lekë, janë rritur në tetor në shumën 85,705,690 dhe në dhjetor rezultojnë në shumën 64,588,514 lekë. Kontrata është nënshkruar në 19.08.2020 në shumën 203,090,995 lekë dhe është regjistruar në SIFQ në vitin 2020. Plani i buxhetit për këtë projekt investimi paraqitet i ndarë në 3 vite ndërkohë që periudha e kohëzgjatjes së kontratës rezulton 6 muaj sipas buletinit të njoftimeve publike në APP.

- *Projekti 18BP025 "Ngritja e qendrave te ekselences per zhvillimin rajonal dhe vendor"*. Fondet janë detajuar në shumën 120 milion lekë, në dhjetor rezultojnë në shumën 64,588,514 lekë. Kontrata është nënshkruar në 22.12.2020 në shumën 393,004,180 lekë dhe është regjistruar në SIFQ në 21.06.2021. Plani i buxhetit për këtë projekt investimi paraqitet i ndarë në 3 vite ndërkohë që periudha e kohëzgjatjes së kontratës rezulton 12 muaj sipas buletinit të njoftimeve publike në APP. Kontrata është lidhur në kundërshtim me afatin 15 tetor për ndërmarrjen e angazhimeve të reja të përcaktuar në ligjin e buxhetit.

- *Projekti 18BP026 "Rikualifikimi i Lulishtes në qendër të qytetit të Elbasanit"*. Fondet janë detajuar në shumën 20 milion lekë, janë ulur në tetor në shumën 7,692,320 milion lekë dhe në dhjetor rezultojnë në shumën 0 lekë. Kontrata është nënshkruar në 07.12.2020 në shumën 22,010,756 lekë. Plani i buxhetit për këtë projekt investimi paraqitet i ndarë në 3 vite ndërkohë që periudha e kohëzgjatjes së kontratës rezulton 7 muaj sipas buletinit të njoftimeve publike në APP. Kontrata është lidhur në kundërshtim me afatin 15 tetor për ndërmarrjen e angazhimeve të reja të përcaktuar në ligjin e buxhetit.

- *Projekti 18BP028 "Sistemimi i hyrje daljes dhe stabilizimi i rreshqitjes ne hyrje te qytetit të Pogradecit"*. Fondet janë detajuar në shumën 60 milion lekë, janë ulur në tetor në shumën 20 milion lekë dhe në dhjetor rezultojnë në shumën 15,792,366 lekë. Kontrata është nënshkruar në 08.09.2020 në shumën 33,619,664 lekë dhe është regjistruar në SIFQ në vitin 2020. Plani i buxhetit për këtë projekt investimi paraqitet i ndarë në 3 vite ndërkohë që periudha e kohëzgjatjes së kontratës rezulton 5 muaj sipas buletinit të njoftimeve publike në APP.

- *Projekti 18BP029 "Ndërtimi i godinës së re të Bashkisë Divjakë"*. Fondet janë detajuar në shumën 50 milion lekë, janë ulur në tetor në shumën 10 milion lekë dhe në dhjetor rezultojnë në shumën 0 lekë. Kontrata është nënshkruar në 23.07.2020 në shumën 166,331,745 lekë dhe është regjistruar në SIFQ në 04.03.2021. Plani i buxhetit për këtë projekt investimi paraqitet i ndarë në 3 vite ndërkohë që periudha e kohëzgjatjes së kontratës rezulton 16 muaj sipas buletinit të njoftimeve publike në APP.

- *Projekti 18BP030 "Rikonstruksioni i rruges "Iliaz Kosova", Elbasan"*. Fondet janë detajuar në shumën 33,418,737 lekë tetor në muajin tetor dhe në dhjetor rezultojnë në shumën 0 lekë. Kontrata është nënshkruar në 23.12.2020 në shumën 83,427,843 lekë dhe është regjistruar në SIFQ në 01.04.2021. Plani i buxhetit për këtë projekt investimi paraqitet i ndarë në 3 vite ndërkohë që periudha e kohëzgjatjes së kontratës rezulton 6 muaj sipas buletinit të njoftimeve publike në APP. Kontrata është lidhur në kundërshtim me afatin 15 tetor për ndërmarrjen e angazhimeve të reja të përcaktuar në ligjin e buxhetit.

Nga auditimi mbi këto projekte investimi konstatohet se janë ndërmarrë angazhime përtej datës 15 tetor të sanksionuar në ligjin e buxhetit për afatin e ndërmarrjes së angazhimeve duke sjellë krijim detyrimesh për vitet e ardhshme buxhetore, duke qenë se plani i buxhetit nuk reflekton shlyerjen



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

reale sipas kontratave dhe mundësi për përdorimin e fondeve buxhetore përgjatë vitit aktual. Gjithashtu konstatohet se në disa raste, në momentin e lidhjes së kontratës nuk është në dispozicion fondi prej 20% që kërkohet në vitin e parë të projektit të investimit. Këto veprime, së bashku me shtrirjen e planit të buxhetit përgjatë 3 viteve ndërkohë që kohëzgjatjet e kontratave rezultojnë edhe më pak se 12 muaj zbatim, tregojnë për një keqplanifikim të investimeve në këtë program buxhetor si dhe krijim detyrimesh të prapambetura si pasojë. Marrja e angazhimeve buxhetore pa patur fonde të disponueshme, miratimi i fondeve buxhetore vetëm me qëllimin e lidhjes së kontratës dhe më pas shkurtimi i tyre, mbyllja e investimeve në proces dhe celja e investimeve publike pa kaluar procedurat e menaxhimit të investimeve publike, tregojnë për veprime në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi, për një planifikim të dobët të investimeve publike dhe një monitorim formal nga ana e MFE me qëllim dhënien e një sigurie në menaxhimin eficient dhe transparent të fondeve publike.

Për konstatimet e mësipërme janë paraqitur observacione nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 514/4 datë 24.08.2021 prot. KLSH në të cilën është parashtruar:

....duhet saktësuar dhe sqaruar pse janë përfshirë këto projekte si detyrime të prapambetura, cilës periudhë i përkasin, ndërkohë që referuar edhe paragrafit të fundit të faqes 7 vlera e shpenzimeve vlera e shpenzimeve faktike për detyrimet 2011-2013 dhe 2014-2018 është në vlerën 614.4 milion lekë dhe jo 491.2 milion lekë. Në këtë rast duhet të merret një informacion më i detajuar për secilin projekt të paraqitur duke analizuar faktin nëse klasifikohet ose jo si detyrim i prapambetur, përsa kohë në një vit buxhetor për shkak të mos përfundimit të punimeve apo dorëzimit të projektit të përfunduar në kohë, paraqitja e situacioneve përkatëse nuk është akorduar i gjithë financimi..... Ky proces është realizuar nëpërmjet transferimit të fondeve tek Njësitë e Vetqeverisjes Vendore të cilat në cilësinë e autoritetit kontraktor kanë përmbushur detyrimet e tyre kontraktuale kundrejt të tretëve. FSHZH iu është drejtuar me shkresë zyrtare të gjitha njësive vendore për të dërguar në FSHZH informacion mbi detyrimin kontraktual dhe statusin teknik dhe financiar të objekteve që i takonin periudhave 2011-2014 dhe 2014-2018, financuar nga granti infrastruktura vendore dhe rajonale e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve. Mbështetur në plotshmërinë e dokumentacionit të dërguar nga njësitë vendore, qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin e objekteve, FSHZH financon këto projekte duke transferuar fondet nga programi 06220 ÷Infrastruktura vendore dhe rajonale të bashkitë përkatëse të cilat në cilësinë e autoritetit kontraktor kanë vazhduar me shlyerjen e detyrimeve të prapambetura rast pas rasti ndaj të tretëve. Si rrjedhojë akordimi i fondeve është bërë në përputhje me dokumentacionin e paraqitur pranë FSHZH-së, rast pas rasti për çdo bashki. Mos paraqitja nga kontraktori e situacioneve për përfundimin e punimeve sipas kushteve të përcaktuara në kontratë mund të jetë një arsye e shtyrjes në kohë të financimit. Si rrjedhojë nuk është i saktë konstatimi i grupit të auditimit se miratimi nga ana e MFE-së për detajimin e fondeve të investimeve nuk ka kontribuar në uljen e detyrimeve të prapambetura dhe mirëmenaxhimin e këtij programi.

....Përsa i përket paragrafit 8.2.2 ÷mbi projektet e tjera të programit infrastruktura vendore dhe rajonale ju sqarojmë se analiza e bërë nga grupi i auditimit për çdo projekt të programit lidhur me kontratat e lidhura, afatet, situacionet dhe pagesat nuk është objekt i punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit.

Referuar konstatimit për projektin 18BP006, ku citohet se është buxhetuar shtyrja në kohë e pagesës në lidhje me këtë projekt ju bëjmë me dije se Ministri i Financave dhe Ekonomisë duke u mbështetur në procedurat standarte të buxhetit dhe Programit Buxhetor Afatmesëm miraton detajimin e fondeve bazuar në kërkesën e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si institucioni përgjegjës



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

për menaxhimin e fondeve për çdo projekt. Kërkesa e tyre për shtrirjen në kohë të projektit mund të jetë për arsye të ndryshme për të cilat ju sugjerojmë ti drejtoheni këtij institucioni për informacion më të detajuar. Fondi Shqiptar i Zhvillimit nuk paraqet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit kontratat e miratuara për çdo projekt pasi është detyrë funksionale e këtij institucionit dhe jo e MFE-së menaxhimi i tyre (lidhja e kontratës, afati i kryerjes së punimeve etj).

...Lidhja e kontratave për këto projekte nuk është objekt i punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit. Vonesa në lidhjen e kontratave mund të vij për shkaqe të ndryshme të cilat lidhen me procedurat e prokurimit, për të cilat mund ti kërkohej sqarim institucionit përgjegjës.

...Në zbatim të akteve ligjore në fuqi detajimi i buxhetit bëhet për një periudhë 3-vjeçare. Është detyrë funksionale e institucionit përkatës FSHZH të bëjë analizat përkatëse dhe të sjellë detajimin e fondit të miratuar për çdo program me projektet përkatëse.

..Grupi i auditimit duhet të analizojë me detaje çdo projekt sipas detyrave funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit dhe FSHZH-së dhe më pas të konkludojë nëse realisht ekzistojnë këto problematika. Përsa kohë nuk është në fushën e përgjegjësisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit dhe Drejtorisë së Financave Vendore lidhja e kontratave, situacionet dhe pagesat nuk mund të shprehemi. Ekipi i auditimit duhet ti drejtohet FSHZH-së për të marrë një informacion të detajuar për çdo projekt.

Në përgjigje të këtyre observacioneve sqarojmë se vlera e detyrimeve të raportuara në shumën 491.2 milion përfshin detyrime të prapambetura sipas regjistrimeve në SIFQ me datë fature përpara vitit 2020, ndërkohë që vlera prej 614.4 milion lekë përfshin këto detyrime të rrapambetura së abshku me kontrata nga vitet e kaluara për njësitë e vetëqeverisjes vendore për të cilat faturat janë me datë furnitori vitin 2020. Mos paraqitja në kohë e dokumentacionit në FSHZH si argument për mos detajimin në kohë të projekteve të alokuara gjatë vitit buxhetor nuk qendron pasi faturat e konstatuara janë përpara periudhës object auditimi. Për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Për sa i përket argumentimit në lidhje me përgjegjësinë e FSHZH apo DPB në lidhje konstatimet për kontratat e nënshkruara dhe fondet në dispozicion sqarojmë se objekt i auditimit është veprimtaria në programin buxhetor 06220, ku përfshihet miratimi i detajimit apo i rishpërndarjeve gjatë vitit që referuar bazës ligjore aktuale miratohen nga Ministria e Financave, pavarësisht propozimit të NA të institucioneve buxhetore. Gjithashtu sqarojmë se edhe përgjegjësia për lidhjen e kontratave, jashtë afatit apo në mungesë të fondeve është përcaktuar në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor. Konstatimet për investimet janë realizuar në tërësi mbi shpërndarjen e fondeve buxhetore, ndërkohë që konstatohet mungesa e një analize në lidhje me arsyetimin e miratimit të shtrirjes së planit buxhetor në 3 vite sipas projekteve të miratuara, duke pasur parasysh analizën përpara miratimit të tyre në PBA përkatëse sipas vitit buxhetor. Për këto arsye observacioni merret në konsideratë pjesërisht.

Në lidhje me këto çështje, nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë janë dërguar observacione mbi projekt raportin e auditimit me shkresën nr. 8595/33 datë 30.09.2021 në të cilën është parashtruar ndër të tjera: *.....Ky proces është realizuar nëpërmjet transferimit të fondeve tek njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat në cilësinë e autoritetit kontraktor kanë përbushur detyrimet e tyre kontraktuale kundrejt të tretëve. FSHZH iu është drejtuar me shkresë zyrtare të gjitha njësitë të qeverisjes vendore për të dërguar në FSHZH informacion mbi detyrimin kontraktual dhe statusin teknik dhe financiar të objekteve që i takonin periudhave 2011-2014 dhe 2014-2018, financiar nga granti infrastruktura vendore dhe rajonale e fondit për zhvillimin e rajoneve. Mbështetur në plotshmërinë e dokumentacionit të dërguar nga njësitë vendore ,*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin e objekteve, Fondi Shqiptar i Zhvillimit financon këto projekte duke transferuar fondet nga programi 06220 "Infrastruktura vendore dhe rajonale" te bashkitë përkatëse të cilat në cilësinë e autoritetit kontraktor kanë vazhduar me shlyerjen e detyrimeve të prapambetura rast pas rasti ndaj të tretëve. Si rrjedhojë akordimi i fondeve është bërë në përputhje me dokumentacionin e paraqitur pranë FSHZH-së rast pas rasti.

....Në zbatim të akteve ligjore në fuqi detajimi i buxhetit bëhet për një periudhë 3-vjeçare. Është detyrë funksionale e institucionit përkatës FSHZH të bëjë analizat përkatëse dhe të sjellë detajimin e fondit të miratuar për çdo program me projektet përkatëse....

Në përgjigje të këtyre observacioneve sqarojmë se janë të njëjta me observacionet e paraqitura mbi akt konstatimit. Në vazhdim të diskutimeve të zhvilluara në KLSH në ballafaqimin e datës 06.10.2021, reflektohet në gjetjen përkatëse komenti i bërë mbi paraqitjen rast pas rasti të dokumentacionit për detyrimet e ish-FZHR nga ana e njësisve vendore në FSHZH dhe procesi i analizës së kryer rast pas rasti nga ky institucion. Për sa i përket pretendimit se òeshtë detyrë funksionale e institucionit përkatës të bëjë analizat përkatëse dhe të sjellë detajimin e fondit të miratuar për çdo program me projektet përkatëse, sqarojmë se gjithashtu në zbatim të udhëzimit standart të zbatimit të buxhetit, është detyrë e MFE që të miratojë detajimin e propozuar. Problematikat janë trajtuar vetëm në kuadër të miratimit të dhënë, pavarësisht procesit të propozimit nga ana e FSHZH. Për këtë arsye nuk merret në konsideratë.

Gjetja:	Në FZHR për grantin konkures për arsimin gjatë vitit është ulur vlera e FZHR dhe janë detajuar projekte të reja të cilat nuk rezultojnë nga vendimmarrje të KZHR, janë detajuar gjatë vitit projekte investimi të cilat paraqiten për detyrime të prapambetura dhe nuk janë detajuar që në detajimin fillestar të investimeve publike
Situata:	<p>Për vitin 2020 Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR) përbëhet nga granti konkurrues për arsimin. Në Aneksin 3 të ligjit nr.88/2019 òPër buxhetin e vitit 2020, të ndryshuar është përcaktuar që shpërndarja e fondeve kryhet nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve (KZHR). Parashikimi i fondeve për këto projekte është kryer në një projekt të vetëm investimi me emërtimin òFondi për Zhvillimin e Rajoneve në vazhdim, me njësi zbatuese Aparatin e Ministrisë, ndërkohë që këto fonde, janë të miratuara me vendim të KZHR përkatëse për projekte me përfitues njësitë e vetëqeverisjes vendore.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se nga ana e KZHR nuk është marrë asnjë vendim për shpërndarjen e financimit për projekte të reja përgjatë vitit 2020, por vlera e alokuar për këtë fond është përdorur për financimin e kontratave në vazhdim nga vitet e kaluara si dhe për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura në total për 327,010 mijë lekë.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se në listën shoqëruese të investimeve publike në projekt buxhet, projektet shumë vjeçare të miratuara me vendimet e KZHR në vitin 2019, nuk paraqiten me vlerat e miratuara përgjatë të gjitha viteve, duke paraqitur si vit fillimi dhe vit mbarimi vitin 2019, dhe rrjedhimisht duke mos parashikuar fonde për vitin 2020 e në vazhdim. Gjithashtu është konstatuar se fondet e detajuara për disa projekte janë më të larta në vlerë se paraqitja e tyre në listën e investimeve publike shoqëruese të projekt</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

	<p>buxhetit të vitit 2020.</p> <p>Nga auditimi mbi fondet e alokuara për programin buxhetor 9120 òArsimi bazë është konstatuar se gjatë vitit janë kryer rishpërndarje ndërmjet projekteve të investimit duke pakësuar fondin e FZHR dhe rritur financimin për projektin “Blerje pajisje elektronike, kompjutera për arsimin bazë” për aparatën e Ministrisë, duke përdorur kështu FZHR për projekte të cilat nuk financohen nga FZHR. Rishpërndarje fondesh ndërmjet projekteve të kësaj natyre janë kryer edhe në muajin Korrik 2020 ku është ulur përsëri vlera e fondit FZHR për projekte investimi të reja për blerje pajisje mobilie/mësimore didaktike për shkollat e rindërtuara të arsimit bazë. Në këtë program buxhetor konstatohen gjithashtu rishpërndarje fondesh ndërmjet projekteve duke pakësuar òfondin e ngrirë të detajuara në fillim të vitit dhe duke rritur financimin për projekte të cilat paraqesin detyrime të prapambetura për fatura të vitit 2013. Nga auditimi konstatohet se vlera e përgjithshme e detyrimeve të prapambetura të paguara për programin buxhetor 9120 òArsimi bazë paraqitet në shumën 111,324 mijë lekë, duke përdorur kështu buxhetin e miratuar për vitin 2020 për shlyerjen e faturave të viteve të kaluara. Në programin buxhetor 092300 òArsimi i mesëm i përgjithshëm është konstatuar se fondet e përdorura për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura paraqiten në shumën 104,631 mijë lekë. Vlera e detyrimeve të prapambetura të paguara në vitin 2020 për programin buxhetor 094500 òArsimi i Lartë paraqitet në shumën 111,055 mijë lekë.</p> <p>Për më tepër, në programin buxhetor 094500 òArsimi i lartë, konstatohet se në muajin shtator 2020 janë kryer rishpërndarje fondesh buxhetore ndërmjet projekteve të detajuara si òprojekte të reja por që janë kontrata të lidhura në vitin 2016 dhe faturuara që në vitin 2018. Kështu, janë kryer rialokime ndërmjet projekteve, duke ulur vlerën e FZHR 2017-2019 me 61,055 mijë lekë dhe shtuar projektin M112308 òNdërtimi i një godine të re universitare me përfitues òUniversitetin Aleksandër Moisiu. Nga auditimi konstatohet se me akt normativ është detajuar ky projekt investimi dhe është shtuar vlera nëpërmjet rishikimit në rritje ndërkohë që ky projekt investimi paraqitet sipas kontratës së vitit 2016 dhe fatura të gjitha të vitit 2018 në shumën totale 111,055 mijë lekë. Në këtë mënyrë, në të gjitha rastet e audituara, çelja e projekteve me akt normative dhe rritja me rialokime gjatë vitit është bërë për financimin e detyrimeve të prapambetura.</p>
Impakti:	Krijim detyrimesh të prapambetura
Shkaku:	Mos financim me përparësi të detyrimeve të viteve të kaluara
Rëndësia:	E lartë
Kriteri:	Aneksi 3 i ligjit nr. 88/2019, i ndryshuar dhe USZB
Rekomandimi:	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në procesin e miratimit të detajimit të investimeve publike, në çdo rast të zbatohet radha prioritare e buxhetimit në përputhje me aktet ligjore, duke përfshirë me përparësi detyrimet e prapambetura dhe detyrimet që lindin nga kontratat në proces ekzekutimi me burim financimi FZHR, në mënyrë që të shmanget



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE
EKONOMISË

	<p>kontraktimi i projekteve të reja në kushtet e kufizimeve buxhetore sipas kufijve të programeve buxhetore dhe duke parandaluar kështu e krijimin e detyrimeve të prapambetura. Procesi i miratimit të projekteve të reja të investimit me akte normative për financimin e detyrimeve të prapambetura dhe kontrata të viteve të kaluara, të paraprihet nga një inspektim financiar në lidhje me ligjshmërinë e tyre në momentin e nënshkrimit.</p> <p>-Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në paraqitjen e listës së investimeve publike të projekt buxhetit të vitit të paraqitet vlera e plotë e secilës kontratë në vazhdim duke specifikuar buxhetin për secilin vit sipas periudhës së ekzekutimit të projektit dhe të shmanget praktika e paraqitjes sintetike në një projekt të vetëm me emërtimin ÷FZHR në proces.</p>
--	---

Gjetja:	Gjatë vitit 2020 nuk janë financuar me përparësi detyrimet nga vitet e kaluara për kontratat në vazhdim por detajuar fonde në projekte të reja investime dhe rritja e planit buxhetor është kryer gjatë vitit për detyrimet e prapambetura
Situata:	<p>Për vitin 2020, fondet ÷për infrastrukturën vendore dhe rajonale janë parashikuar si program buxhetor në Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Sipas aneksit 3 të ligjit nr.88/2019 ÷Për buxhetin e vitit 2020÷ të ndryshuar, është përcaktuar financimi me përparësi nga programi buxhetor ÷6220÷ ÷Infrastruktura Vendore dhe Rajonale÷ të ish FZHR, infrastruktura vendore dhe rajonale si dhe financimi i projekteve të tjera të investimit ku autoriteti programues, kontraktues dhe zbatues është Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Autoritetin për shpërndarjen e fondeve e ka Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Planifikimi fillestar sipas projekt buxhetit është parashikuar për 3.5 miliard lekë ndërkohë që me ligjin e miratuar fondet për këtë program janë miratuar në 4.5 miliard lekë. Gjatë vitit ky fond nuk ka pësuar ndryshime me përjashtim të Aktit Normativ nr.34 datë 16.12.2020 ku me të cilin janë pakësuar fondet e FSHZH në total për 1 miliard lekë, duke paraqitur një plan përfundimtar në shumën 3.5 miliard lekë për vitin 2020. Për sa i përket shpenzimeve faktike, vlera e realizimit të programit ÷infrastruktura vendore dhe rajonale÷ për vitin 2020 është në shumën 3,303,788 mijë lekë, nga të cilat 2,689,321 mijë lekë për projekte të infrastrukturës vendore dhe rajonale dhe 614,467 mijë lekë për projekte me detyrime të prapambetura të periudhës 2011-2013 dhe investimeve në proces 2014-2018. Nga auditimi konstatohet se në detajimin fillestar të investimeve për vitin 2020, në programin ÷infrastruktura vendore dhe rajonale" është çelur projekti 18BP001 "Projekte te grantit infrastruktura vendore dhe Rajonale" në shumën 450,000 mijë lekë ndërkohë që në planin e rishikuar fondi për projekte të FZHR rezulton në shumën 803,029 mijë lekë, nga të cilat janë shpenzuar 614,447 mijë lekë, ku detyrimet për fatura të prapambetura paraqiten në shumën 491,212 mijë lekë, ose 80% e fondeve të realizuara për to. Kështu, konstatohet se financimi i detyrimeve të FZHR nuk është kryer sipas përparësisë së përcaktuar në aneksin 3 të ligjit nr. 88/2019 ÷Për buxhetin e vitit 2020÷, të ndryshuar duke detajuar fondet në projekte të tjera për të cilat kanë filluar procedurat e prokurimit,</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

	ndërkohë që vlera për financimin e projekteve në vazhdim sipas rishikimeve buxhetore, paraqitet në shumën 803,029 mijë lekë, pasi procesi i shlyerjes së detyrimeve të njësisve të vetqeverisjes vendore është shoqëruar me verifikim nga FSHZH përgjatë vitit sipas argumentimit të MFE sipas rastit. Miratimi nga ana e MFE për detajimin e fondeve të investimeve nuk ka kontribuar në uljen e detyrimeve të prapambetura pasi nuk janë financuar me përparësi detyrimet e prapambetura të viteve të kaluara në detajimin fillestar të fondeve.
Impakti:	Krijim detyrimesh të prapambetura
Shkaku:	Mos financim me përparësi të detyrimeve të viteve të kaluara
Rëndësia:	E lartë
Kriteri:	Aneksi 3 i ligjit nr. 88/2019, i ndryshuar dhe USZB
Rekomandimi:	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në miratimin e detajimit të investimeve publike të mbahet parasysh prioriteti në financimin e projekteve me detyrime të prapambetura dhe detyrimet që lindin nga kontratat në proces ekzekutimi me burim financimi FZHR, në mënyrë që të shtyhet kontraktimi i projekteve të reja në kushtet e mundësive të kufizuara buxhetore me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura të reja.

Gjetja:	Nga auditimi janë konstatuar detajim buxheti për kontrata me kohëzgjatje disa mujore, lidhje kontratash në kundërshtim me afatin e përcaktuar në LMSB, mos regjistrim kontratash dhe fondesh të obliguara si dhe çelje buxheti vetëm në nivelin 20% të vitit buxhetor.
Situata:	Nga auditimi mbi projektet e investimeve publike në vazhdim të buxhetuara për programin buxhetor 062200 ÷Infrastruktura vendore dhe rajonale në Fondin Shqiptar të Zhvillimit janë konstatuar problematika që përfshijnë detajimin e planin buxhetor në 3 vite për kontrata që përfshijnë periudhë ekzekutimi deri në 12 muaj, duke krijuar detyrime të prapambetura në këtë program, pasi periudha e faturimit nuk përputhet me periudhën e buxhetit të planifikuar për shlyerjen e tyre. Gjithashtu është konstatuar se fondet e parashikuara për një projekt investimi me kod 18BP005 ÷Rivitalizimi urban i zonave me potencial te larte turistik ne Rajonin 3 dhe 40 janë përdorur për financimin e detyrimeve të një kontratë tjetër që nuk ka lidhje me fondet për të cilat janë miratuar me emërtim <i>“Loti II- Ndërtimi i rrugës së re përgjatë lumit Osumit si dhe ndërhyrje përmirësuese në bypassin e rrugës Antipatrea dhe rehabilitimi i rrugës lidhëse ndërmjet rrugës Shëtitorja Osumi dhe rrugës Antipatrea, Bashkia Berat” nënshkruar në 23.12.2019 në shumën 110,556 mijë lekë me afat 6 muaj.</i> Në të njëjtën kohë, fondet e investimeve janë detajuar edhe për financimin e aktivitetit operativ në shpenzime korente të FSHZH në projektin 018BP0080 ÷Mbështetje për programin (kosto operationale)0 buxhetuar dhe realizuar në shumën 123,750 mijë lekë dhe përfshin një urdhër shpenzim sipas situacionit të shpenzimeve e kryer në Shtator 2020 me përfitues FSHZH. Në lidhje me investimet e reja të realizuar përgjatë vitit 2020 në këtë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

	<p>program buxhetor konstatohet se pjesa më e madhe e projekteve janë detajuar në çeljen fillestare dhe vetëm një projekt i cili është detajuar në muajin Tetor. Nga auditimi konstatohet se kontratat për këto investime janë lidhur në shumicën e rasteve pas datës 15 Tetor që është afati i sanksionuar në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar për ndërmarrjen e angazhimeve të reja. Angazhimi i fondeve në këto projekte ka sjellë si pasojë edhe regjistrimin e këtyre kontratave me vonesë në SIFQ, duke përfshirë edhe periudhën Qershor 2021 si datë regjistrimi. Në momentin e ndërmarrjes së angazhimit, për asnjë nga investimet e planifikuara nuk është respektuar zbatimi i kërkesave ligjore për disponimin e vlerës së 20% të investimit në vitin e parë të tij, duke qenë se me aktin normativ nr.34/2020 fondet për këtë program janë ulur me 1 miliard lekë. Në pjesën më të madhe të angazhimeve të ndërmarrja, plani buxhetor për financimin e investimeve përfshin një periudhë shlyerje për tre vite ndërkohë që nga auditimi konstatohet se periudha e implementimit të kontratave përfshin një afat nga 5-16 muaj, duke krijuar detyrime të prapambetura, pasi periudha e faturimit nuk përputhet me planin buxhetor të miratuar për projektet e investimit të miratuara rast pas rasti.</p>
Impakti:	Marrje angazhimesh pa fonde, krijim detyrimesh të prapambetura
Shkaku:	Lidhja kontratave jashtë afatit të përcaktuar në LMSB
Rëndësia:	E lartë
Kriteri:	Neni 40-51 i ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar
Rekomandimi:	Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të përfshihet në mënyrë të menjëhershme përputhja e planit buxhetor të miratuar me periudhën e faturimit për secilën kontratë të nënshkruar për investimet e financuara nga programi buxhetor infrastruktura vendore dhe rajonale. Të ndalohej rishpërndarja e fondeve me akte normative përtej afatit të sanksionuar për kryerjen e rishpërndarjes së fondeve, me qëllim shmangien e krijimit të detyrimeve të prapambetura si dhe të ndalohej praktika e detajimit të projekteve të reja të investimit në periudhën e fundit të vitit buxhetor.

9. Mbi auditimin e përputhshmërisë së përdorimit të Fondit Rezervë të Këshillit të Ministrave dhe Fondit të Kontingjencës për vitin 2020.

Në zbatim të programit të auditimit, u shqyrtua legjislacioni dhe dokumentacioni si më poshtë:

Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar:

Në kreun e I, nenin 3, pika 15 dhe 16, përcaktohet se:

• Fond rezervë është fond, që krijohet për të financuar shpenzime jo të përhershme dhe të paparashikuara, në fazën e përgatitjes së buxhetit.

• Fond kontingjence është fond i pashpërndarë, që krijohet për të mbuluar risqet e mundshme, për të ardhurat dhe shpenzimet, gjatë zbatimit të buxhetit.

Në kreun e I, nenin 4/1 parimet dhe rregullat fiskale, pika 1 • Qëndrueshmërinë e borxhit publik, pika 8, citohet: • Në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontingjencë e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

veçantë, prej jo më pak se 0,7% e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit, ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit; Fondi i kontingjencës krijohet për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave dhe efektet e paparashikuara të normave të interesit.

Në kreun V "Zbatimi i buxhetit", neni 63 Miratimi i raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit, citohet: Këshilli i Ministrave, brenda muajit qershor, miraton dhe përcjell në Kuvend raportin vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit, i cili përmban: pika 63 raportin për përdorimin e fondit rezervë dhe të kontingjencës. Fondi Rezervë i Këshillit të Ministrave, përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Miratimi i përdorimit të tij bëhet me Vendim të Këshillit të Ministrave. Fondi Rezervë dhe Fondi i Kontingjencës, miratohen nga Kuvendi në ligjin buxhetor vjetor deri në masën 3% të vlerës totale të fondeve të miratuara.

Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.9, datë 20.03.2018 Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, në kapitullin I "Të përgjithshme, në pikat:

Në pikën 13 të këtij udhëzimi citohet: Ministri i Financave refuzon ose pranon kërkesat për fonde shtesë, në bazë të rekomandimit nga Nëpunësi i Parë Autorizues, i cili shqyrton kërkesat për fonde shtesë të njëjësive të qeverisjes qendrore.

Në pikën 14 të këtij udhëzimi citohet: Në rast se kërkesa për fonde shtesë pranohet nga Ministri përgjegjës për Financat, por nuk mund të plotësohet, duke respektuar të drejtat dhe limitet e përcaktuara në nenin 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Ministri përgjegjës për Financat mund të propozojë Këshillit të Ministrave plotësimin e saj, nëpërmjet përdorimit të fondit rezervë të Buxhetit të Shtetit. Në bazë të kërkesës së bërë nga kryetari i komisionit parlamentar përgjegjës për financat publike, Ministri përgjegjës për Financat vë në dijeni me shkrim Kuvendin për kërkesat për shtesë fondesh, të miratuara nga Këshilli i Ministrave nëpërmjet përdorimit të fondit rezervë të buxhetit të shtetit.

Në pikën 28 citohet: Nëpunësi i Parë Autorizues shqyrton kërkesat për fonde shtesë të njëjësive të qeverisjes qendrore dhe i rekomandon Ministrit përgjegjës për Financat refuzimin, ose pranimin e kërkesave për fonde shtesë të argumentuara.

Në pikën 89 të këtij udhëzimi citohet: Fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve të paparashikuara, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Miratimi i përdorimit të tij bëhet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Në pikën 90 të këtij udhëzimi citohet: Procedura për përdorimin e këtij fondi kalon në këto faza:

a. Ministritë e linjës paraqesin tek Ministri përgjegjës për Financat një projektvendim, ku kërkohet shtesë fondi në buxhetin e vitit nga përdorimi i fondit rezervë, duke përcaktuar edhe llojin e shpenzimeve. Relacioni shoqëruar i projektvendimit duhet të përmbajë informacionin si më poshtë: Të argumentojë qëllimin për të cilin do të përdoren fondet shtesë, si edhe domosdoshmërinë e krijimit të produkteve, apo projekteve të reja nëpërmjet kryerjes së shpenzimeve shtesë gjatë vitit buxhetor, duke paraqitur impaktin e tyre; Të paraqesë një preventiv të detajuar lidhur me zërat e shpenzimeve shtesë, si dhe përlllogaritjen e tyre; Të argumentojë pamundësinë e planifikimit të këtij shpenzimi gjatë fazës së përgatitjes së projektbuxhetit; Të argumentojë pamundësinë e përballimit të këtij shpenzimi nëpërmjet rialokimit të fondeve brenda sistemit nëpërmjet paraqitjes së analizës së realizimit të buxhetit për periudhën raportuese.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

b. Ministri përgjegjës për Financat, pas shqyrtimit të kërkesave dhe analizës së tyre, jep vërejtjet dhe sugjerimet, të cilat duhet të sqarohen dhe të plotësohen detyrimisht kur të përgatitet projekt-vendimi përfundimtar.

c. Me mendimin e ministrive të interesuara dhe atë të Ministrisë përgjegjës për Financat, projektvendimi paraqitet në Këshillin e Ministrave.

- Në pikën 91 të këtij udhëzimi citohet: ÷Fondi i kontingjencës krijohet për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave dhe efektet e paparashikuara të normave të interesit.

Në vlerësim të përputhshmërisë të sa më sipër, nga auditimi për vitin 2020, konstatohet se:

Në zbatim të ligjit vjetor nr.88/2019, datë 18.12.2019 ÷Për buxhetin e vitit 2020, në nenin

11, 14 dhe 15 ÷Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit dhe Fondet e Kontigjencës janë përcaktuar:

Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

- Shpenzime të buxhetit qendror	412 705	milione lekë;
- Fondi rezervë	1 700	milione lekë;
- Kontingjencë për risqet e borxhit	4 000	milione lekë;

Fondi rezervë i buxhetit të shtetit prej 1,700 milion lekë, përdoret nga Këshilli i Ministrave për raste të paparashikuara të njësisë të qeverisjes së përgjithshme; Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4,000 milionë lekësh përdoret nga Ministri përgjegjës për Financat për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhajtjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në shpenzimet për interesa.

Planifikimi i Fondit Rezervë dhe Fondit të Kontigjencës bëhet në përputhje me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 ÷Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, kreun e II, nenin 5, sipas të cilit: “Buxheti i Shtetit përfshin një fond rezervë dhe një fond kontingjence të pashpërndarë, i cili miratohet nga Kuvendi në ligjin e buxhetit vjetor, deri në masën 3% të vlerës totale të fondeve të miratuara. Konstatohet se në Ligjin e Buxhetit vjetor ky koeficient është në masën 1% duke ruajtur kështu kufirin ligjor në planifikimin e fondeve rezervë të buxhetit të shtetit dhe të kontigjencave.

Në milion lekë

Nr.	Struktura Buxhetore	Me ligjin nr. 88/2019
1	Shuma e fondit rezervë	1,700
2	Shuma kontigjencave	4,000
I	Shuma 1+2	5,700
II	Fondet e miratuara (shpenzimet)	549,374
	Koeficienti (I/II)	1.0%

Shënim: Tabela hartuar nga grupi i auditimit në bazë të dhënave të MFE.

- Në zbatim të aktit normativ nr.6, datë 21.03.2020 ÷Për disa ndryshime në ligjin nr.88/2019, datë 18.12.2019 ÷Për buxhetin e shtetit të vitit 2020, në nenin 9 të tij, këto fonde janë përcaktuar:

- Fondi rezervë i buxhetit të shtetit prej 9,200 milion lekë, përdoret për raste të paparashikuara të institucioneve buxhetore, nga Këshilli i Ministrave si më poshtë:

1,700 milionë lekë për raste të paparashikuara të njësisë të qeverisjes së përgjithshme.

6,500 milionë lekë si kontigjencë për paketën sociale anti-Covid-19

1,000 milionë lekë për emergjenca të tjera në kuadër të masave anti-covid 19

- Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4,000 milionë lekë përdoret për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhajtjet në kurset e këmbimit, ose normat e interesit, me ndikim në shpenzime për interesa.

Nr.	Struktura Buxhetore	AN 6 dt.21.03.2020
1	Shuma e fondit rezervë	1,700
	Kontigjencë për paketën sociale anti-Covid 19	6,500
	Emergjenca të tjera në kuadër të masave anti-Covid 19	1,000
2	Shuma kontigjencave	4,000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

I	Shuma 1+2	13,200
II	Fondet e miratuara (shpenzimet)	558,374
	Koeficienti (I/II)	2.4%

Konstatohet se pas aktit normativ nr.6 koeficienti prej 2.4% është në kufirin ligjor të parashikuar në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, *kreun e II, nenin 5*.

Në vijim të këtyre ndryshimeve, referuar të dhënave të SIFQ, në datën 24.03.2021 rezultojnë të regjistruara veprimet e mëposhtme në tre kode projektsh të krijuara për të ndjekur përdorimin e fondit rezervë sipas destinacionit të miratuar:

94901AA- Fondi Rezervë i Këshillit të Ministrave, (fond i cili nuk pësoi rritje me Aktin Normativ)

94901AB- Fondi në formën e kontigjencave për paketën sociale anti-Covid 19

94901AC- Fondi Rezervë në kuadër të masave anti-Covid 19

BUDGET REV I D	BUDGET BALAN CE	Shtesa sipas AN nr.6	FR Bëhet	Kodi Projekt it	Dt.regjistrim it	Fondi
6178302	1,158,070.2	1,000,000	2,158,070.2	94901AA	24-Mar-20	Fondi Rezerve i Keshillit te Ministrave
6178302	-	6,500,000	6,500,000	94901AB	24-Mar-20	Kontigjenca per paketen sociale antiCOVID-19
Net			8,658,070.2			

Nga sa më sipër konstatohet se Fondi Rezervë në total, në datën 24.03.2021 është rritur me 7,500 milionë lekë. Në datën 26.03.2020 rezultojnë dy veprime për rialokimin e fondit shtesë prej 1,000 milionë lekë në kodin e duhur 94901AC- Fondi Rezervë në kuadër të masave anti-Covid 19 akorduar me VKM nr. 240 datë 21.03.2020.

BUDGET REVISIO N ID	BUDGET BALAN NCE	Shtesa	Pakesim e	BËHET	Kodi Proje ktit	Dt.regjistri mit	Fondi
6179294	2,158,070.2		(1,000,000)	1,158,070.2	94901AA	26-Mar-20	Fondi Rezerve i Keshillit te Ministrave
6179294	-	1,000,000,000		1,000,000	94901AC	26-Mar-20	Fond rezerve në kuadër të masave anti-covid 19

Deri në momentin e ndryshimit me Aktin Normativ të datës 21.03.2020, Fondi Rezervë i KM prej 1,700 milionë lekë ishte përdorur në masën 468,824.8 mijë lekë ose 28% e tij. Përdorimi i këtij fondi është bërë nëpërmjet 3 VKM-ve, konkretisht: VKM nr.181 datë 26.02.2020; VKM nr.204 datë 09.3.2020 dhe VKM nr.205 datë 09.03.2020 paraqitur më hollësisht në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Kodi i Fondit Rezervë	Kodi Institucioni	Institucioni përfitues	Llog.Ekonomike	Shuma në mijë lekë	Kërkesa	VKM nr.	VKM Datë	Kodi
1	94901AA	1087002	Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare	603	44,000		181	26/02/2020	98705AA
2	94901AA	1017089	Reparti Ushtarak nr.6630 Tirane	602	13,824	miratohet 18/3/2020	204	9/3/2020	91703AM
2/1				231	11,000	miratohet 18/3/2020	204	9/3/2020	19AD401
3	94901AA	1013001	Aparati i MSHMS	602	200,000	9/3/2020	205	9/3/2020	91301AB
3/1				231	200,000		205	9/3/2020	19AD301

Burimi: Përpunimi i të dhënave të dosjeve të vëna në dispozicion nga MFE

Përfituesit nga Fondi Rezervë janë: Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për mbulimin e një eventi qeveritar në shumën 44,000 mijë lekë, Ministria e Mbrotjtjes në shumën 24,824 mijë lekë për ngritjen e shërbimit të karantinës, nga të cilat 13,824 mijë lekë për shpenzime kapitale, si dhe Ministria e Shëndetësisë në kuadër të marrjes së masave paraprake për infeksionin e shkaktuar nga COVID-19 në shumën 400,000 mijë lekë nga të cilat 200,000 mijë lekë për shpenzime kapitale.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Nga shqyrtimi i dosjeve të këtyre vendimeve, rezultojnë me mangësi në dokumentacionin e kërkuar në përputhje me *kreun V "Zbatimi i buxhetit", neni 45* òKërkesat për fonde shtesë, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 òPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RShë, i ndryshuar, cituar: òNëpunësit autorizues të njëjësive të qeverisjes qendrore paraqesin pranë NPA kërkesë për fonde shtesë, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në kohën e përgatitjes së buxhetit dhe që nuk mund të shtyhen për vitin buxhetor pasardhës. ... Kërkesa për fonde shtesë shoqërohet me justifikimin e paraqitjes së kërkesës, duke argumentuar: a. arsyet e mosplanifikimit në kohën e përgatitjes së buxhetit; b. produktet që përfitojnë nga veprimtaritë e që do të financohen nga kërkesat shtesë; c. kontributin në qëllimet dhe objektivat e politikave; ç. zërat e tjerë të fondeve buxhetore të miratuara, që mund të reduktohen për të siguruar fondin e nevojshëm, si dhe pasojat që një reduktim i tillë do të kishte mbi arritjen e objektivave të tjerë. NPA shqyrton kërkesat për fonde shtesë të njëjësive të qeverisjes qendrore dhe i rekomandon Ministrin të Financave refuzimin, ose pranimin e kërkesave për fonde shtesë të argumentuara". Kështu:

-Në dosjen e VKM nr. 181 datë 26.02.2020 mungon kërkesa e argumentuar e institucionit kërkuar, mendimi i Ministrin të Financave, shkresa përcjellëse e Ministrin të Financave me relacionin shoqëruar të Projekt òVendimit. Duke qenë se ky është një event ndërkombëtar nuk jepen argumenta përse këto fonde nuk ishte parashikuar në kohën e përgatitjes së buxhetit dhe cfarë kostosh përfshihen në fondin e kërkuar (sipas databazës së pagesave rezultojnë vetëm dy të tilla të lidhura me eventin e Samitit Ballkanik në shumën 689 mijë lekë.)

-Në dosjen e VKM nr. 204 datë 09.03.2020 përveç dokumentit VKM ku përcaktohet òshtëpia e pushimit të ushtarakëve të FARSH-it me vendndodhje në Plepa, Durrës, si strukturë për shërbimin e karantinës, në funksion të marrjes së masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit nga COVID-19ë dhe òcaktimin e Ministrisë së Mbrojtjes si autoriteti kontraktor për zhvillimin e procedurave të prokurimit..ë dhe shkresave përcjellëse drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit për celjen e fondeve sipas VKM-së, mungon mendimi i Ministrin të Financave; nuk ka një relacionin shoqëruar me argumenta dhe preventivin cfarë përfshihet në vlerën e fondit të miratuar prej 24,824 mijë lekë, nga të cilat për shpenzime kapitale 11,000 mijë lekë dhe 13,824 mijë lekë shpenzime korrente në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

Sipas regjistrimeve të kryera në SIFQ rezultojnë një shpërndarje në buxhetin e Repartit Ushtarak nr.4401 në shumën 11,000 mijë lekë në datën 10.03.2020 për rritjen e buxhetit të shpenzimeve kapitale dhe një regjistrim në datën 18.03.2020 për rritjen e buxhetit të shpenzimeve korrente nga 165,000 mijë lekë në 178,824 mijë lekë.

Në mijë lekë

REVISION ID	Buxheti	Lloji rishikimit	Shuma	Kodi Instit.	Llogari Ek.	Kodi Projektit	Dt. regjistrimit	Institucioni
6174312	-	I	11,000	1017089	231	19AD401	10-MAR-20	Reparti Nr.4401 Ushtarak
6177295	165,000	I	13,824	1017089	602	91703AM	18-MAR-20	Reparti Nr.4401 Ushtarak

Deri në fund të vitit 2020 për kodin e projektit 19AD401- òRikonstruksion dhe përshtatje si infrastrukturë karantine i Shtëpise se pushimit të ushtarakëve, Plepa, Durrës, prona nr.231ë, në databazën e pagesave për vitin 2020 rezultojnë të shpenzuara vetëm 5,328 mijë lekë ose rreth 50% e shumës së shpërndarë nga Fondi Rezervë.

-Në dosjen e VKM nr. 205 datë 09.03.2020 me përfitues Ministrinë e Shëndetësisë, shpërndahen 200,000 mijë lekë për shpenzime kapitale dhe 200,000 mijë lekë për shpenzime korrente. Tabela shoqëruar në relacion parashikon blerjen e respiratorëve në shumën 166 milionë lekë me kod projekti 19AD301, si dhe artikuj të tjerë duke ju referuar në shumicën e rasteve cmimeve të kontratave të vitit 2014. Ndërkohë në dosje mungon mendimi/përgjigja e Ministrisë së



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave sa kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë. Ndërkohë fondi i shpërndarë është përdorur nga institucioni përfitues në muajt Nëntor-Dhjetor 2020 pra më shumë se 7-8 muaj nga momenti i miratimit dhe obligimit të fondeve.

Në mijë lekë

REVISION_ID	Buxheti	REV TYPE	Shuma	Kodi Institucioni	Llogari Ekon	Kodi Projektit	Dt.regjistrimit	Institucioni
6174297	-	I	200,000	1013001	602	91301AB	10-MAR-20	Aparati Ministrise se Shendetesise
6174299	-	I	200,000	1013001	231	19AD301	10-MAR-20	Aparati Ministrise se Shendetesise

Në tabelën analitike të përdorimit të fondit rezervë për vitin 2020, raportohen edhe 2 VKM të tjera për përdorimin e Fondit Rezervë në muajin Shkurt (përpara situatës së pandemisë COVID-19) dosja e të cilave nuk na u vu në dispozicion nga subjekti, konkretisht:

Në mijë lekë

Nr.	Perfituesi	Kodi	VKM	EMERTIMI I VKM	Shuma e Fondit Shtesë Në mijë lekë
1	Ministrise se Brendshme	16	Nr 188, 27.02.2020 dt	Për një shtesë fondi ne buxhetin e vitit 2020, miratuar për Ministrine e brendshme"	27,000
2	Ministrise se Brendshme	16	Nr.106, 05.02.2020 dt	"Për dhënie miratimi për përdorim fondesh dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020 miratuar për Min e Brendshme	150,000

Burimi: MFE

Në raportin periodik të MFE òMbi përdorimin e Fondit Rezervë raportohet se këto fonde shtesë janë akorduar për shpenzime për investime, cituar: *ò 27 milionë lekë janë akorduar për përballimin e shpenzimeve të kontratës me kompaninë "T."; 150 milion lekë janë akorduar për investime për MB me VKM nr. 106, dt 05.02.2020".*

Në mungesë të dosjeve fizike, për të identifikuar projektet të cilat kanë përfituar dhe argumentat përse këto shpenzime nuk janë parashikuar në fazën e përgatitjes së buxhetit jemi referuar databazës së rishikimeve buxhetore sipas të cilës kodet e projekteve përfituese të fondeve shtesë janë:

- **VKM nr.188 datë 27.02.2020** për 27,000 mijë lekë për shpenzime operative me kod **91601AB**- òAuditime të kryeraò. Në databazën e pagesave nuk rezulton pagesë për kompaninë òT...ò, dhe

- **VKM nr.106 datë 05.02.2020** për 150,000 mijë lekë për shpenzime për investime për projektin me kod **18CK101**- òPërshtatja e Mjediseve të Punës për prokurorinë e Posaçme të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe byronë kombëtare të hetimit dhe sigurimi i mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për funksionimin e tyreò. Ky projekt është një projekt në vazhdim dhe sipas databazës së pagesave rezulton edhe me pagesa për kontrata në vazhdim nga viti 2019, gjë që nuk e justifikon mospërfshirjen në fazën e planifikimit të buxhetit 2020.

Referencat e regjistrimeve në SIFQ paraqiten në tabelën në vijim:

Në mijë lekë

Kodi i Rishikimit	PeriudhaGL	BUDGET BALANCE	Shuma e rishikuar	Kodi Institucioni	Llog. Ekonomike	Kodi Projektit
6172302	03-2020	68,600	27,000	1016001	602	91601AB
6172302	03-2020	1,656,000	(27,000)	1049001	609	94901AA
6181292	03-2020	1,158,070.2	(150,000)	1049001	609	94901AA
6181292	03-2020	-	150,000	1016001	231	18CK101

Burimi: MFE

Në zbatim të aktit normativ nr.15, datë 15.04.2020 òPër disa ndryshime në ligjin nr.88/2019, datë 18.12.2019 òPër buxhetin e shtetit të vitit 2020ò, në nenin 1 të tij, këto fonde janë përcaktuar:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

-Fondi rezervë i buxhetit të shtetit prej 16,200 milion lekë, përdoret për raste të paparashikuara të institucioneve buxhetore, nga Këshilli i Ministrave si më poshtë:

1,700 milionë lekë për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme.

13,500 milionë lekë si kontigjencë për paketën sociale anti-Covid-19.

1,000 milionë lekë për emergjenca të tjera në kuadër të masave anti-covid 19.

-Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4,000 milionë lekë përdoret për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit, ose normat e interesit, me ndikim në shpenzime për interesa.

Nr.	Struktura Buxhetore	AN 15 dt.15.04.2020 (në milionë lekë)
1	Shuma e fondit rezervë	1,700
	Kontigjencë për paketën sociale anti-Covid 19	13,500
	Emergjenca të tjera në kuadër të masave anti-Covid 19	1,000
2	Shuma kontigjencave	4,000
I	Shuma 1+2	20,200
II	Fondet e miratuara (shpenzimet)	558,374
	Koeficienti (I/II)	3.6%

Konstatohet se pas Aktit normativ nr.6, koeficienti prej 3.6% është në tejkalim të kufirit ligjor të parashikuar në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 ðPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, *kreun e II, nenin 5, sipas të cilit: "Buxheti i Shtetit përfshin një fond rezervë dhe një fond kontigjencë të pashpërndarë, i cili miratohet nga Kuvendi në ligjin e buxhetit vjetor, deri në masën 3% të vlerës totale të fondeve të miratuara.*

Ndërkohë, nga auditimi rezulton se deri në momentin e daljes së Aktit Normativ nr.15 datë 15.04.2020, Fondet Rezervë ishin përdorur si vijon:

94901AA- ðFondi i Këshillit të Ministrave në shumën 645,824 mijë lekë ose rreth **38%**.

94901AB- ðFondi në formën e kontigjencave për paketën sociale anti-Covid 19, në shumën 5,850,000 mijë lekë ose **90%**,

94901AC- ðFondi Rezervë në kuadër të masave anti-Covid 19 në shumën 57,105.8 mijë lekë ose **6%**.

Përdorimi i fondit rezervë është bërë nëpërmjet 9 akteve normative. Konkretisht:

VKM nr.258 datë 27.03.2020, VKM nr.259 datë 27.03.2020, VKM nr.354 datë 29.04.2020, VKM nr.371 datë 06.05.2020, VKM nr.378 datë 08.05.2020, VKM nr.437 datë 03.06.2020, VKM nr.463 datë 10.06.2020, VKM nr.464 datë 10.06.2020 dhe VKM nr.474 datë 15.06.2020. Nga shqyrtimi i dosjeve fizike të çdo VKM-je, u konstatuan mangësi në dokumentacionin që duhet të përmbajë dosja në kundërshtim me kreun V ðZbatimi i buxhetit, neni 45 ðKërkesat për fonde shtesë, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 ðPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSh, i ndryshuar. Vetëm në një rast u gjend kërkesa e institucionit për shtesën e fondeve. Në disa prej dosjeve mungonte mendimi i Ministrisë së Financave apo shkresa përcjellëse miratuese për në Këshillin e Ministrave si psh në dosjen e VKM-së nr.378 datë 08.05.2020 dhe dosjen nr.464 datë 10.06.2020. Në rastin e dosjes së VKM-së nr.258 dt.27.3.2020 ajo përmban vetëm një dokument, shkresën miratuese të Sekretarit të Përgjithshëm dërguar Degës Thesarit Tiranë për celjen e fondeve në zbatim të VKM,- së një kopje të së cilës nuk ndodhet gjithashtu në këtë dosje.

Nr.	Kodi i Fondit Rezervë	Kodi Institucioni	Institucioni përfutur	Llog. Ekono mike	Shuma	Nr. Vendi mit	VKM Date	Kodi
1	94901AA	1010001	Aparati i MFE	609	97,843,200	258	27/03/2020	91003AD
2	94901AC	1013001	Aparati I MSHMS	600	11,000,000	259	27/03/2020	91301AC
3	94901AC	1013001	Aparati I MSHMS	600	19,000,000	354	29/04/2020	91301AC
4	94901AC	1013141	Shërbimi Social Shtetëror	600	12,700,000	371	6/5/2020	91307AI



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

5	94901AC	1026090	Agjensia Kombëtare e Bregdetit	602	95,200,000	378	8/5/2020	92603AB
6	94901AA	1011001	Aparati i MARS	231	20,000,000	437	3/6/2020	19AF401
7	94901AA	1006054	ARRSH	231	200,000,000	463	10/6/2020	M062993
8	94901AA	1006001	Aparati i MIE	230	150,000,000	464	10/6/2020	19AA702
9	94901AA	1010039	DPT	606	26,000,000	474	15/06/2020	91004AD

Burimi: MFE

Sipas tabelës analitike të përdorimit të Fondit Rezervë, gjatë periudhës 27 Mars deri 2 Korrik 2021, Fondi rezervë është përdorur në shumën 631,743.2 mijë lekë nga të cilat:

- shpenzime për investime në shumën 370,000 mijë lekë me përfitues ARRSH, Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe Aparati i Ministrisë së Arsimit,
- shpenzime korrente në shumën 261,743.2 mijë lekë me përfitues Aparati MFE, MSHMS, Shërbimi Social Shtetëror, Agjensia Kombëtare e Bregdetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Në lidhje me shpërndarjet e Fondit rezervë për shpenzime për investime nga auditimi i veprimeve të regjistrimit dhe pagesave konstatohet se:

për VKM nr.463 datë 10.06.2020 rezulton se projekti përfitues është **M062993- "Shpronësimi në shtesë** me shumën 200,000 mijë lekë. Po i njëjti projekt preket përsëri një muaj më vonë nga VKM nr.610 datë 29.07.2020 në pakësim prej 140,000 mijë lekë për të financuar projekte të administruara nga AKSHI. Pra rritja neto e këtij projekti është 60,000 mijë lekë. Ndërkohë, konstatohet se sipas përshkrimit në urdhër shpenzime në referencë të VKM nr.463 janë bërë pagesa në shumën 166,590 mijë lekë. Ndërkohë që preket Fondi Rezervë, po në të njëtin muaj Korrik 2020, ky kod projekti ka përfituar një rritje buxheti në shumën 2.9 miliard lekë dhe përdorimi i Fondet Rezervë duket i panevojshëm dhe jo në kushtet e emergjencës apo paprashikueshmërisë së ndodhjes së ngjarjes/shpenzimit, nëkohë që ka qenë në proces planifikimi dhe miratimi një rritje e buxhetit për shpronësimet, në shifra shumë herë më të larta.

Në lidhje me përdorimin e Fondit rezervë për shpenzime për investime në kodin e projektit **19AA702 -[Rishikimi i studimit të fizibilitetit dhe hartimi i projektit të detajuar inxhinierik "Ndërtimi i Tunelit të Llogarasë".** Ky projekt nuk ka të planifikuar fonde me ligjin e buxhetit vjetor. Pas shtesës nga përdorimi i Fondit Rezervë me VKM nr.464 datë 10.06.2020, për të cilin në dosjen fizike nuk ka një relacion/argumentim për rishikimin e projektit në këtë moment. Për më tepër një muaj më vonë ky projekt avancohet me një shtesë fondesh prej 600,000 mijë lekë⁷ dhe në 20 Dhjetor pakësohet me 519,400 mijë lekë⁸ menjëherë pas pagesës së faturës në shumën 222,588 mijë lekë. Në mungesë të dokumentacionit shoqëruar nuk mund të vlerësohet kriteri pse ky shpenzim nuk është përfshirë në fazën e hartimit të buxhetit vjetor 2020 si dhe nëse kërkesa për fonde në muajin Qershor 2020, ishte në kushtet e emergjencës për të justifikuar përdorimin e Fondit Rezervë.

Në mijë lekë

BUDGET REVISION ID	Periudha GL	BUDGET BALANCE	Shuma në mijë lekë	Kodi Institucioni	Programi	Llog. Ekonomike	Kodi_Projektit	Dt.regjistrimit
6231300	06-2020	-	150,000	1006001	04520	230	19AA702	19-JUN-20

⁷ Budget revision ID#6253293: Pakësohen projektet me kod 18BJ901 me 150 milionë lekë; 18BK001 me 500 milionë lekë dhe 19AB403 me 100 milionë lekë. Këto projekte rezultojnë të planifikuara në ligjin e buxhetit 2020 por me realizim zero.

⁸ Budget revision ID#6310297: shtohet projekti 18BA201 me 485 milionë lekë dhe projekti me kod M064243 me 34 milionë lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

6253293	07-2020	150,000	600,000	1006001	04520	230	19AA702	28-JUL-20
6310297	12-2020	750,000	519,400	1006001	04520	230	19AA702	09-DEC-20

Burimi: MFE

Përdorimi i Fondit Rezervë me VKM nr.437 datë 03.06.2020, për projektin 19AF401- Pagesë TVSH-je për tabletë dhuruar nga Fondacioni "...", referuar kërkesës së institucionit me argumentat justifikues, plotëson kriterin e paparashikueshmërisë së shpenzimit. Megjithatë, nga auditimi rezulton se ky projekt nuk është i raportuar në vlerën e plotë në investimet e realizuara për vitin 2020 me burim ògrante të brendshmeò.

Nga auditimi i databazës së rishikimeve nga SIFQ, rezultojnë 9 regjistrime të shpërndarjeve të Fondit Rezervë:

BUDGET REV ID	Periudha	BUDGET BALANCË	Pakesime	BËHET	Kodi Projektit	Dt.regjistrimit	Fondi	VKM
6188300	04-2020	953,894.2	(11,000)	942,894.2	94901AC	7-Apr	Fond rezervë në kuadër të masave anti-covid 19	259 dt.27 Mars
6211293	05-2020	942,894.2	(95,200)	847,694	94901AC	18-May	Fond rezervë në kuadër të masave anti-covid 19	378 dt.8 Maj
6217292	05-2020	847,694.2	(19,000)	828,694.2	94901AC	27-May	Fond rezervë në kuadër të masave anti-covid 19	354 dt. 29 Prill
6223296	06-2020	828,694.2	(12,700)	815,994.2	94901AC	4-Jun	Fond rezervë në kuadër të masave anti-covid 19	371 dt.6 Maj
6231300	06-2020	1,054,176	(150,000)	904,176	94901AA	19-Jun	Fondi Rezervë i KM	464 dt. 10 Qershor
6234295	06-2020	904,176	(200,000)	704,176	94901AA	24-Jun	Fondi Rezervë i KM	463 dt.10 Qershor
6237300	07-2020	704,176	(20,000)	684,176	94901AA	1-Jul	Fondi Rezervë i KM	437 dt.3 Qershor
6241303	07-2020	684,176	(26,000)	658,176	94901AA	7-Jul	Fondi Rezervë i KM	474 dt.15 Qershor
6249299	07-2020	1,474,170.2	(97,843.2)	1,376,327	94901AA	20-Jul	Fondi Rezervë i KM	258 dt.27 Mars

Burimi: MFE

Nga tabela evidentohet se përgjithësisht ekzekutimi i VKM në sistem bëhet me vonesë nga 10 ditë deri në 1 muaj nga data e publikimit të VKM-së. Ndërkohë VKM nr.258 e datës 27 Mars 2020 është regjistruar më 20 Korrik 2020. Pra fondet prej 97,843 mijë lekë, për institucionin përfitues MFE dhe kod 91003 janë bërë të vlefshme 4 muaj pas kërkesës dhe miratimit për fonde shtesë ndërkohë që fatura e parë për këtë shërbim është lëshuar në muajin Qershor 2021. Pagesat në total për këtë shërbim gjatë vitit 2020 rezultojnë në shumën 81,536 mijë lekë ose 16,300 mijë lekë më pak se fondi i kërkuar. Në mungesë të dokumentacionit shoqërues nuk mund të vlerësohet kriteri pse ky shpenzim nuk është përfshirë në fazën e hartimit të buxhetit vjetor dhe kriteri i klasifikimit si òemergjencëò.

Në zbatim të aktit normativ nr.28, datë 02.07.2020 òPër disa ndryshime në ligjin nr.88/2019, datë 18.12.2019 òPër buxhetin e shtetit të vitit 2020ò, në nenin 4 të tij, këto fonde janë përcaktuar:

-Fondi rezervë i buxhetit të shtetit prej 16,200 milion lekë, përdoret për raste të paparashikuara të institucioneve buxhetore, nga Këshilli i Ministrave si me poshtë:

2 700 milionë leke për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme.

13 500 milionë leke si kontingjencë per paketën sociale anti-Covid-19

-Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4,100 milionë lekë përdoret për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit, ose normat e interesit, me ndikim në shpenzime për interesa.

Në këtë akt normativ nuk ka patur shtesa në fondin rezervë por rritje të shpenzimeve të buxhetuara të miratuara:

Nr.	Struktura Buxhetore	AN 28 dt.02.07.2020 (në milionë lekë)
1	Shuma e fondit rezervë	2,700



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

	Kontigjencë për paketën sociale anti-Covid 19	13,500
2	Shuma kontigjencave	4,000
I	Shuma 1+2	20,200
II	Fondet e miratuara (shpenzimet)	579,535
	Koeficienti (I/II)	3.5%

I vetmi ndryshim i konstatuar në paraqitjen e Fondit Rezervë në Aktin Normativ, është raportimi i konsoliduar i dy kodeve: 94901AA- òFondi i Këshillit të Ministraveò dhe 94901AC- òFondi Rezervë në kuadër të masave anti-Covid 19ò. Duke vijuar kështu edhe në raportimin e fundvitit me raportimin e òFondit Rezervë të Këshillit të Ministraveò në total në shumën 2,700 mijë lekë. Në vijim të këtij Akti Normativ, në SIFQ, sipas databazës së rishikime, në datën 07.07.2020 është kryer edhe regjistrimi për riklasifikimin e balancës së papërdorur prej 815,994.2 mijë lekë nga Fondi rezervë për masat anti Covid në Fondin Rezervë të Këshillit të Ministrave:

Në mijë lekë

BUDGET_REVISION_ID	GL_PERIOD	BUDGET_BALANCE	Ndryshimi	Shuma	Kodi Institucioni	Kodi Projektit	Data e Regjistrimit
6241304	07-2020	658,176	Shtesë	815,994.2	1049001	94901AA	7-Jul-20
6241304	07-2020	815,994.2	Pakësim	(815,994.2)	1049001	94901AC	7-Jul-20

Burimi: MFE

Deri në këtë moment **Fondi Rezervë i dedikuar, i identifikuar me kodin 94901AC është përdorur në masën 184,005 mijë lekë ose 18.4% për shpenzime korrente të lidhura me shpenzime në kushtet e shkaktuara nga COVID-19**, më hollësisht paraqitur në tabelën në vijim:

Institucioni përfitues	Shuma	Nr. Vendimit	VKM	Kodi	Destinacioni
Aparati i MSHMS	46,105,800	240	21/03/2020	94901AA	Për marrjen e masave paraprake për përhapjen e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19
Aparati i MSHMS	11,000,000	259	27/03/2020	91301AC	"Për dhënien e ndihmës me personel shëndetësor, mjekë dhe infermierë, në kushtet e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, Republikës ë Italisë. Bonus për mjek dhe infermierë jashtë shtetit
Aparati i MSHMS	19,000,000	354	29/04/2020	91301AC	"Për dhënien e ndihmës me personel infermier për Republikën e Italisë"
Shërbimi Social Shtetëror	12,700,000	371	6/5/2020	91307AI	Për shpërblimin për personelin që ka shërbyer në institucionet e përkujdeit shoqëror rezidencial publik në përgjegjësi administrimi nga Shërbimi Social Shtetëror dhe Bashkitë"
Agjensia Kombëtare e Bregdetit	95,200,000	378	8/5/2020	92603AB	Për përballimin e strukturave akomoduese të miratuara nga Komiteti Ndërmintorror i Emergjencave Civile

Burimi: MFE

Në vijim, të gjitha përdorimet e Fondit Rezervë të periudhës Gusht- Dhjetor 2020 janë regjistruar në kodin 94901AA-Fondi Rezervë i Këshillit të Ministrave.

Në zbatim të aktit normativ nr.34, datë 16.12.2020 òPër disa ndryshime në ligjin nr.88/2019, datë 18.12.2019 òPër buxhetin e shtetit të vitit 2020ò, në nenin 4 të tij, këto fonde janë përcaktuar:

-Fondi rezervë i buxhetit të shtetit prej 16,200 milion lekë, përdoret për raste të paparashikuara të institucioneve buxhetore, nga Këshilli i Ministrave si më poshtë:

2,700 milionë lekë për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme.

13,500 milionë lekë si kontigjencë për paketën sociale anti-Covid-19



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

-Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4,100 milionë lekë përdoret për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit, ose normat e interesit, me ndikim në shpenzime për interesa.

Në këtë akt normativ nuk ka patur shtesa në fondin rezervë.

Përdorimi i Fondit Rezervë nga data 02.07.2020 e Aktit Normativ nr.28 deri në fund të vitit 2020 është përdorur me VKM-të:

Kodi Instit.	Institucioni përfitues	Llog.Ek	Shuma në lekë	Nr. Vendimi	VKM	Kodi	Përshkrimi
1087006	AKSHI	231+602	860,000,000	610	29/07/2020	98703AB	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020, e miratuar për AKSHI 1 miliard lekë
1017001	Aparati i MM	602	2,500,000	611	29/07/2020	91701AE	Për pagesën e kontributit financiar të vendit tonë në Fondin e Mirëbesimit të organizatës NATO
1012001	Aparati i Ministrisë së Kulturës	231	149,000,000	647	30/07/2020	18AE710;404 ; 405;406;407; 408;218;403; 219;214	Për një shtesë në fondin e buxhetit të vitit 2020, miratuar për MK në programet "Trashëgimia kulturore dhe muzetë" dhe "Art&Kulturë".
1003001	Aparati i Kryeministrisë	606	500,000	652	17/08/2020	90301AE	Për dhënie ndihme financiare familjes së viktimës Samuel Nik Ndoj
1015002	Përfaqësitë Diplomatike	605	8,701,000	717	16/09/2020	91502AE	Për dhënie ndihme financiare nga KM për mbështetjen e funksionimit të Këshillit Kombëtar Shqiptar në Serbi, Mal të Zi.
1013141	Shërbimi Social Shtetëror	600	20,570,000	754	23/9/2020	91307AI	Për një ndryshim në VKM nr.371
1022001	Akademia e Shkencave	602	4,600,000	838	11/11/2020	92201AA	"Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Akademinë e Shkencave" për shpenzimeve për projektet studimore lidhur me COVID-19
1029041	Gjykata e Lartë	600+602	14,000,000	890	21/10/2020	92902AA	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Gjykatën e Lartë" për mbështetjen e aktivitetit të KED
2112001 / 2113001	Bashkia Patos/ Bashkia Roskovec	604	53,502,863	911	4/11/2020	91707AA	"Mbrojtja e jetës njerëzore , pronës , trashëgimisë kulturore dhe pyjeve nga zjarri"
1010001	Aparati i MFE	602	3,783,390	1019	16/12/2020	91003AC	Për ekzekutimin e vendimit të GjEDNJ
1015002	Përfaqësitë Diplomatike	605	31,250,000	1116	29/12/2020	91502AE	Për dhënie ndihme financiare nga KM për qeverinë e Kroacisë për dëmet e shkaktuara nga tërmeti I datës 29.12.2020.
1056001	FZSH	232	170,000,000	1127	30/12/2020	19AF001	Blerja e godinës Poli i Drejtësisë

Nga auditimi rezulton se Fondi Rezervë i Këshillit të Ministrave është përdorur në një rast përsëri për masat në kuadër të situatës COVID-19 në shumën 20,570 mijë lekë me VKM nr.754 "Për një ndryshim në VKM.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

nr 371, datë 06.05.2020, "Për dhënie shpërblimi për personelin që shërben në institucionet e përkujdesjes shoqërore rezidenciale publike, që janë në përgjegjësi administrimi të Sherbimit Social Shtetëror dhe të Bashkive".

Nga të dhënat rezultojnë se Fondi Rezervë është përdorur edhe për shpenzime të cilat duhej të ishin planifikuar në ligjin e buxhetit vjetor. Si në rastin e fondeve akorduar AKSHI-t, referuar relacionit shoqëruar gjendur në dosjen fizike të VKM nr. 610 datë 29.07.2020, fondet për mirëmbajtjen e sistemeve që administrojnë ky institucion si dhe fondet e nevojshme për të bërë upgrate sistemit dhe risqet që mbartin moskryerja e tyre janë paraqitur disa herë nga institucioni AKSHI. Për më tepër argumentohet se këto fonde janë emergjente edhe për faktin që kontratat ekzistuese kanë gjeneruar detyrime të cilat duhen paguar për të siguruar vijimësinë e kontratës.

Në dosje nuk ka ndonjë arsytim të NPA apo Ministrisë të Financave për mbulimin e fondit të kërkuar prej 1 miliard lekë dhe miratimi i tij për mbulim prej 860 milionë lekë nga Fondi Rezervë dhe 140 milionë nga projekti M062993- Shpronësime (ARRSH).

Ky miratim dhe rishpërndarje fondesh buxhetore bëhet vetëm pak javë pas Aktit Normativ të radhës i cili supozohet të përfshijë të gjitha kërkesat buxhetore sipas prioriteteve për fonde, fonde shtesë, etj.

Në lidhje me përdorimin e Fondit rezervë të kontigjencës anti-COVID-19 për vitin 2020, i akorduar me Aket Normative nr.6 dhe 5 në total 13,500 milionë lekë kanë dalë vendimet:

nr. 254 datë 27.03.2020, òPër përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e COVID-19 në shumën 5,850 milionë lekë.

Nr.284 datë 10.04.2020 òPer disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 254 date 27.3.2020ò në shumën 566 milionë lekë.

Nr. 305 datë 14.04.2020 òPer përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit elarguar nga puna si pasojë e COVID-19 në shumën 7,040 milionë lekë.

Në total përdorimi i këtij fondi është 13,456 milionë lekë ose 99.7%⁹.

Sipas të databazës së rishikimeve nga SIFQ, rezultojnë këto regjistrime për shtesa dhe pakësime të Fondit rezervë me kod 94901AB:

Në mijë lekë

BUDGET_REVISION_ID	Periudha	BUDGET_BALANCE	Shtesa	Pakesime	BEHET	Dt.regjistrimit
6178302	03-2020	-	6,500,000		6,500,000	24-Mar-20
6184295	04-2020	6,500,000		(1,031,655.3)	5,468,344.7	2-Apr-20
6186292	04-2020	5,468,344.7		(4,818,344.7)	650,000	4-Apr-20
6196298	04-2020	650,000,000	7,000,000		7,650,000	21-Apr-20
6196315	04-2020	7,650,000,000		(566,000,000)	7,084,000	22-Apr-20
6196316	04-2020	7,650,000,000		(7,000,000,000)	650,000	22-Apr-20
6197299	04-2020	84,000,000		(40,000,000)	44,000	27-Apr-20

1,031,655.3 mijë lekë i ka përfituar Administrata e Shërbimeve Sociale Shtetërore në kodin 91307AA-

4,818,344.7 mijë lekë i ka përfituar:

118,344 mijë lekë Agjensia e Punësimit dhe Aftësive në kodin 91013AE

4,700,000 mijë lekë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në **kodin 91013AG-**

Pagat e biznesit për masat anti COVID-19ö

⁹ Statusi i përdorimit të Paketës sociale I dhe II në aneksin e këtij akt-konstatimi sipas përditësimit më të fundit të MFE në faqen zyrtare datë 03.11.2020 ku totali i fondit të kontigjencës për COVID-19 rezultojnë i përdorur në masën 12,934,989 mijë lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

Pjesa e mbetur e papërdorur nga Paketa I-rë e ndihmës sociale prej 650,000 mijë lekë në shtesë të fondit prej 7,000,000 mijë lekë akorduar me AN nr.15, i ka përfituar:

566,000 mijë lekë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

✓ 7,000,000 mijë lekë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

✓ 40,000 mijë lekë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Të gjitha këto 3 shpërndarje kanë prekur **kodin 91013AG-** òPagat e biznesit për masat anti COVID-19ò kod i cili sipas databazës së pagesave në SIFQ rezulton të jetë përdorur si më poshtë:

Llog.ekonomike	Përshkrimi i llogarisë	Shuma në mijë lekë
6061099	Te tjera transferata tek individet	230,924
6062300	Transferata per ndihme ekonomike ndaj individeve te biznesit te vogel ne kushtet e pandemise Covid-19	5,371,156
6062301	Transferata per ndihme ekonomike ndaj individeve te mbetur pa pune ne kushtet e pandemise Covid-19 (paketa 2)	7,128,562
Total		12,730,642

Titulli i gjetjes:	i	Mbi përputhshmërinë e përdorimit të Fondit Rezervë dhe Fondit të Kontigjencës
Situata1:		<p>Planifikimi i Fondit Rezervë dhe Fondit të Kontigjencës bëhet në përputhje me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 òPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, kreun e II, nenin 5, sipas të cilit: “Buxheti i Shtetit përfshin një fond rezervë dhe një fond kontingjence të pashpërndarë, i cili miratohet nga Kuvendi në ligjin e buxhetit vjetor, deri në masën 3% të vlerës totale të fondeve të miratuara. Në zbatim të ligjit vjetor nr.88/2019, datë 18.12.2019 òPër buxhetin e vitit 2020, në nenin 11, 14 dhe 15, Fondi rezervë i buxhetit të shtetit prej 1,700 milion lekë, përdoret nga Këshilli i Ministrave për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme; Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4,000 milionë lekësh përdoret nga Ministri përgjegjës për Financat për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në shpenzimet për interesa. Konstatohet se në Ligjin e Buxhetit vjetor koeficienti është në masën 1% duke ruajtur kështu kufirin ligjor në planifikimin e fondeve rezervë të buxhetit të shtetit dhe të kontigjencave. Në zbatim të aktit normativ nr.6, datë 21.03.2020 òPër disa ndryshime në ligjin nr.88/2019, datë 18.12.2019 òPër buxhetin e shtetit të vitit 2020, në nenin 9 të tij, këto fonde janë përcaktuar: <u>Fondi rezervë i buxhetit të shtetit prej 9,200 milion lekë dhe koeficienti prej 2.4%</u> është në kufirin ligjor të parashikuar në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 òPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, kreun e II, nenin 5. Në zbatim të aktit normativ nr.15, datë 15.04.2020 òPër disa ndryshime në ligjin nr.88/2019, datë 18.12.2019 òPër buxhetin e shtetit të vitit 2020, në nenin 1 të tij, këto fonde janë përcaktuar: <u>Fondi rezervë i buxhetit të shtetit prej 16,200 milion lekë. Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4,000 milionë lekë përdoret për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit, ose normat e interesit, me ndikim në shpenzime për interesa.</u> Konstatohet se pas Aktit normativ nr.6, koeficienti prej 3.6% është në tejkallim të kufirit ligjor të parashikuar në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 òPër Menaxhimin e Sistemit</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, *kreun e II, nenin 5 i tij*. Në lidhje me procedurën e miratimit dhe kriteret e përdorimit të Fondit Rezervë, nga shqyrtimi i dosjeve të këtyre vendimeve, rezultojnë me mangësi në dokumentacionin e kërkuar në përputhje me *kreun V “Zbatimi i buxhetit”, neni 45* òKërkesat për fonde shtesë, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 òPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSh, i ndryshuar. Kështu: në **dosjen e VKM nr. 181 datë 26.02.2020** mungon kërkesa e argumentuar e institucionit kërkues, mendimi i Ministrit të Financave, shkresa përcjellëse e Ministrit të Financave me relacionin shoqërues të Projekt òVendimit. Duke qenë se ky është një event ndërkombëtar nuk jepen argumenta përse këto fonde nuk ishte parashikuar në kohën e përgatitjes së buxhetit dhe çfarë kostosh përfshihen në fondin e kërkuar (*sipas databazës së pagesave rezultojnë vetëm dy të tilla të lidhura me eventin e Samitit Ballkanik në shumën 689 mijë lekë*). Në **dosjen e VKM nr. 204 datë 09.03.2020** përveç dokumentit VKM ku përcaktohet *òshtëpia e pushimit të ushtarakëve të FARSH-it me vendndodhje në Plepa, Durrës, si strukturë për shërbimin e karantinës, në funksion të marrjes së masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit nga COVID-19* dhe *òcaktimin e Ministrisë së Mbrojtjes si autoriteti kontraktor për zhvillimin e procedurave të prokurimit..ò* dhe shkresave përcjellëse drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit për çeljen e fondeve sipas VKM-së, mungon mendimi i Ministrit të Financave; nuk ka një relacionin shoqërues me argumenta dhe preventivin çfarë përfshihet në vlerën e fondit të miratuar prej 24,824 mijë lekë, nga të cilat 13,824 mijë lekë shpenzime korrente në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe për shpenzime kapitale 11,000 mijë lekë për kodin e projektit **19AD401- “Rikonstruksion dhe përshtatje si infrastrukturë karantine i Shtëpise se pushimit të ushtarakëve, Plepa, Durrës, prona nr.231ò**. Deri në fund të vitit 2020 për këtë kod projekti në databazën e pagesave për vitin 2020 rezultojnë të shpenzuara vetëm 5,328 mijë lekë ose rreth 50% e shumës së akorduar nga Fondi Rezervë.

Referuar tabelës analitike të përdorimit të fondit rezervë për vitin 2020 të raportuar nga MFE, listohen edhe 2 VKM për përdorimin e Fondit Rezervë në muajin Shkurt (përpara situatës së pandemisë COVID-19) dosja e të cilave nuk na u vu në dispozicion nga subjekti, konkretisht VKM nr,188 datë 27.02.2020 në shumën 27,000 mijë lekë *òakorduar për përballimin e shpenzimeve të kontratës me kompaninë “T...”*; dhe VKM nr.106 datë 05.02.2020 në shumën 150,000 mijë lekë *janë akorduar për investime për Ministrinë e Brendshme*. Në mungesë të dosjeve fizike, për të identifikuar projektet të cilat kanë përfituar dhe argumentat përse këto shpenzime nuk janë parashikuar në fazën e përgatitjes së buxhetit jemi referuar databazës së rishikimeve buxhetore sipas të cilës kodet e projekteve përfituese të fondeve shtesë janë: **VKM nr.188 datë 27.02.2020** për 27,000 mijë lekë për shpenzime operative me kod **91601AB-** òAuditime të kryeraò. Në databazën e pagesave nuk rezulton pagesë për kompaninë òT...ò, dhe **VKM nr.106 datë 05.02.2020** për 150,000 mijë lekë për shpenzime për investime për projektin me kod **18CK101-** òPërshtatja e Mjediseve të Punës për prokurorinë e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Posaçme të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe byronë kombëtare të hetimit dhe sigurimi i mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për funksionimin e tyre. Ky projekt është një projekt në vazhdim dhe sipas databazës së pagesave rezulton edhe me pagesa për kontrata në vazhdim nga viti 2019, gjë që nuk e justifikon mos përfshirjen në fazën e planifikimit të buxhetit 2020.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe regjistrimeve në SIFQ konstatohet se në dosjen e VKM nr. 205 datë 09.03.2020 me përfitues Ministrinë e Shëndetësisë, me të cilën shpërndahen 200,000 mijë lekë për shpenzime kapitale dhe 200,000 mijë lekë për shpenzime korrente, mungon mendimi/përgjigja e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave sa kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë. Tabela shoqëruese në relacion parashikon blerjen e respiratorëve në shumën 166 milionë lekë me kod projekti 19AD301, si dhe artikuj të tjerë duke ju referuar në shumicën e rasteve çmimeve të kontratave të vitit 2014. Ndërkohë fondi i akorduar në kushtet e emergjencës është përdorur nga institucioni përfitues në muajt Nëntor-Dhjetor 2020 pra më shumë se 7-8 muaj nga momenti i miratimit dhe obligimit të fondeve në sistem.

Në dosjen e VKM-së nr.378 datë 08.05.2020 dhe dosjen nr.464 datë 10.06.2020. Në rastin e dosjes së VKM-së nr.258 dt.27.3.2020 për një shtesë fondi në buxhetin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, miratuar për vitin 2020, për pagesën e këshilltarit financiar për menaxhimin e borxhit shtetërorë, ajo përmban vetëm një dokument, shkresën miratuese të Sekretarit të Përgjithshëm dërguar Degës Thesarit Tiranë për çeljen e fondeve në zbatim të VKM,-së një kopje të së cilës nuk ndodhet gjithashtu në këtë dosje.

Me Aktin Normativ të datës 21.03.2020 Fondi Rezervë i Këshillit të Ministrave mbetet në shumën 1,700 milionë lekë por janë shtuar dy fonde të tjera të dedikuara për përballimin e situatës COVID -19. Në kuadër të këtyre ndryshimeve, referuar të dhënave të SIFQ, në datën 24.03.2021 rezultojnë të regjistruara veprimet e mëposhtme në tre kode projektsh të krijuara për të ndjekur përdorimin e fondit rezervë sipas destinacionit të miratuar: 94901AA- Fondi Rezervë i Këshillit të Ministrave, (fond i cili nuk pësoi rritje me Aktin Normativ), 94901AB- Fondi në formën e kontigjencave për paketën sociale anti-Covid 19 në shumën 6,500 milionë lekë, 94901AC- Fondi Rezervë në kuadër të masave anti-Covid 19 në shumën 1,000 milionë lekë. Ndërkohë, nga auditimi rezulton se deri në momentin e daljes së Aktit Normativ nr.15 datë 15.04.2020, Fondet Rezervë ishin përdorur si vijon: 94901AA- òFondi i Këshillit të Ministrave në shumën 645,824 mijë lekë ose rreth 38%; 94901AB- òFondi në formën e kontigjencave për paketën sociale anti-Covid 19, në shumën 5,850,000 mijë lekë ose 90%, 94901AC- òFondi Rezervë në kuadër të masave anti-Covid 19 në shumën 57,105.8 mijë lekë ose 6%.

Në rastin e shpërndarjes me VKM nr.463 datë 10.06.2020 rezulton se projekti përfitues është M062993- “Shpronësimi në shtesë me shumën 200,000 mijë lekë. Po i njëjti projekt preket përsëri një muaj më vonë nga VKM nr.610 datë 29.07.2020 në pakësim prej 140,000 mijë lekë për të financuar projekte të administruara nga AKSHI. Pra rritja neto e këtij projekti është 60,000 mijë



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

lekë. Ndërkohë, konstatohet se sipas përshkrimit në urdhër shpenzime në referencë të VKM nr.463 janë bërë pagesa në shumën 166,590 mijë lekë. Ndërkohë që preket Fondi Rezervë, po në të njëtin muaj Korrik 2020, ky kod projekti ka përfituar një rritje buxheti në shumën 2.9 miliard lekë dhe përdorimi i Fondet Rezervë duket i panevojshëm dhe jo në kushtet e emergjencës apo pa parashikueshmërisë së ndodhjes së ngjarjes/shpenzimit, në kohë që ka qenë në proces planifikimi dhe miratimi një rritje e buxhetit për shpronësimet, në shifra shumë herë më të larta. Në rastin e shpërndarjes me **VKM nr.464 datë 10.06.2020**, për të cilin në dosjen fizike nuk ka një relacion/argumentim për rishikimin e projektit në këtë moment janë akorduar fonde për shpenzime për investime në kodin e projektit **19AA702 -|Rishikimi i studimit të fizibilitetit dhe hartimi i projektit të detajuar inxhinierik "Ndërtimi i Tunelit të Llogarasë".** Ky projekt nuk ka të planifikuar fonde me ligjin e buxhetit vjetor. Për më tepër një muaj më vonë ky projekt avancohet me një shtesë fondesh prej 600,000 mijë lekë¹⁰ dhe në 20 Dhjetor pakësohet me 519,400 mijë lekë¹¹ menjëherë pas pagesës së faturës në shumën 222,588 mijë lekë. Në mungesë të dokumentacionit shoqërues nuk mund të vlerësohet kriteri pse ky shpenzim nuk është përfshirë në fazën e hartimit të buxhetit vjetor 2020 si dhe nëse kërkesa për fonde në muajin Qershor 2020, ishte në kushtet e emergjencës për të justifikuar përdorimin e Fondit Rezervë. Përdorimi i Fondit Rezervë me **VKM nr.437 datë 03.06.2020**, për projektin 19AF401- Pagesë TVSH-je për tabletë dhuruar nga Fondacioni "V...", referuar kërkesës së institucionit me argumentet justifikues, plotëson kriterin e pa parashikueshmërisë së shpenzimit. Megjithatë, nga auditimi rezulton se ky projekt nuk është i raportuar në vlerën e plotë në investimet e realizuara për vitin 2020 me burim ògrante të brendshmeö.

Nga auditimi i databazës së rishikimeve nga SIFQ, evidentohet fakti se përgjithësisht ekzekutimi i VKM në sistem bëhet me vonesë nga 10 ditë deri në 1 muaj nga data e publikimit të VKM-së. Në rastin e VKM nr.258 e datës 27 Mars 2020 e regjistruar më 20.07. 2020. Pra fondet prej 97,843 mijë lekë, për institucionin përfitues MFE dhe **kod 91003** janë bërë të vlefshme 4 muaj pas kërkesës dhe miratimit për fonde shtesë ndërkohë që fatura e parë për këtë shërbim është lëshuar në muajin Qershor 2020. Pagesat në total për këtë shërbim gjatë vitit 2020 rezultojnë në shumën 81,536 mijë lekë ose 16,300 mijë lekë më pak se fondi i kërkuar. Edhe në këtë rast, në mungesë të dokumentacionit shoqërues nuk mund të vlerësohet kriteri pse ky shpenzim nuk është përfshirë në fazën e hartimit të buxhetit vjetor dhe kriteri i klasifikimit si òemergjencëö.

¹⁰ Budget revision ID#6253293: Pakësohen projektet me kod 18BJ901 me 150 milionë lekë; 18BK001 me 500 milionë lekë dhe 19AB403 me 100 milionë lekë. Këto projekte rezultojnë të planifikuara në ligjin e buxhetit 2020 por me realizim zero.

¹¹ Budget revision ID#6310297: shtohet projekti 18BA201 me 485 milionë lekë dhe projekti me kod M064243 me 34 milionë lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Në zbatim të aktit normativ nr.28, datë 02.07.2020 òPër disa ndryshime në ligjin nr.88/2019, datë 18.12.2019 òPër buxhetin e shtetit të vitit 2020ò, në nenin 4 të tij, ka përcaktuar: *Fondi rezervë i buxhetit të shtetit prej 16,200 milion lekë, përdoret për raste të paparashikuara të institucioneve buxhetore, nga Këshilli i Ministrave si 2,700 milionë leke për raste të paparashikuara të njësisve të qeverisjes së përgjithshme; 13,500 milionë lekë si kontigjencë për paketën sociale anti-Covid-19; -Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4,100 milionë lekë përdoret për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit, ose normat e interesit, me ndikim në shpenzime për interesa.* Në fakt, në këtë akt normativ nuk ka patur shtesa në fondin rezervë por rritje të shpenzimeve të buxhetuara të miratuara. I vetmi ndryshim i konstatuar në paraqitjen e Fondit Rezervë në Aktin Normativ, është raportimi i konsoliduar i dy kodeve: 94901AA- òFondi i Këshillit të Ministraveò dhe 94901AC- òFondi Rezervë në kuadër të masave anti-Covid 19ò. Duke vijuar kështu edhe në raportimin e fundvitit me raportimin e òFondit Rezervë të Këshillit të Ministraveò në total në shumën 2,700 mijë lekë. Në vijim të këtij Akti Normativ, në SIFQ, sipas databazës së rishikime, në datën 07.07.2020 është kryer edhe regjistrimi për riklasifikimin e balancës së papërdorur prej 815,994.2 mijë lekë nga Fondi rezervë për masat anti Covid në Fondin Rezervë të Këshillit të Ministrave. Deri në këtë moment **Fondi Rezervë i dedikuar, i identifikuar me kodin 94901AC është përdorur në masën 184,005 mijë lekë ose 18.4% për shpenzime korrente të lidhura me shpenzime ne kushtet e shkaktuara nga COVID-19 me përfitues Ministrinë e Shëndetësisë, Shërbimin Social Shtetëror dhe Agjensia Kombëtare e Bregdetit. Pas këtij riklasifikimi, nga auditimi rezulton se Fondi Rezervë i Këshillit të Ministrave është përdorur në një rast përsëri për masat në kuadër të situatës COVID-19 në shumën 20,570 mijë lekë me VKM nr.754 "Për një ndryshim në VKM nr. 371, datë 06.05.2020, "Për dhënie shpërblimi për personelin që shërben në institucionet e përkujdesjes shoqërore rezidenciale publike, që janë në përgjegjësi administrimi të shërbimit social shtetëror dhe të Bashkive".** Nga të dhënat rezulton se Fondi Rezervë është përdorur edhe për shpenzime të cilat duhej të ishin planifikuar në ligjin e buxhetit vjetor. Si në rastin e fondeve akorduar AKSHI-t, referuar relacionit shoqërues gjendur në dosjen fizike të VKM nr. 610 datë 29.07.2020, fondet për mirëmbajtjen e sistemeve që administrojnë ky institucion si dhe fondet e nevojshme për të bërë upgrate sistemit dhe risqet që mbartin moskryerja e tyre janë paraqitur disa herë nga institucioni AKSHI. Për më tepër argumentohet se këto fonde janë emergjente edhe për faktin që kontratat ekzistuese kanë gjeneruar detyrime të cilat duhen paguar për të siguruar vijimësinë e kontratës. Në dosje nuk ka ndonjë arsyetim të NPA apo Ministrisë të Financave për mbulimin e fondit të kërkuar prej 1 miliard lekë dhe miratimi i tij për mbulim prej 860 milionë lekë nga Fondi Rezervë dhe 140 milionë nga projekti M062993- Shpronësime (ARRSH). Ky miratim dhe rishpërndarje fondesh buxhetore bëhet vetëm pak javë pas Aktit Normativ të radhës i cili supozohet të përfshijë të gjitha kërkesat buxhetore sipas prioriteteve për fonde, fonde shtesë, etj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Në lidhje me përdorimin e Fondit rezervë të kontigjencës anti-COVID-19 për vitin 2020, i akorduar me Aktet Normative nr.6 dhe 5 në total 13,500 milionë lekë kanë dalë vendimet: nr. 254 datë 27.03.2020, òPër përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e COVID-19 në shumën 5,850 milionë lekë. Nr.284 datë 10.04.2020 òPër disa ndryshime dhe shtesa ne VKM nr. 254 date 27.3.2020ò në shumën 566 milionë lekë. Nr. 305 datë 14.04.2020 òPër përcaktimin e procedurave te dokumentacionit dhe te masës se përfitimit te ndihmës financiare për të punësuarit aktuale dhe punonjësit e larguar nga puna si pasoje e COVID-19 në shumën 7,040 milionë lekë. Në total përdorimi i këtij fondi është 13,456 milion lekë ose 99.7%¹². Sipas të databazës së rishikimeve nga SIFQ, rezultojnë këto regjistrime për shtesa dhe pakësime të Fondit rezervë me kod 94901AB: 1,031,655.3 mijë lekë i ka përfituar Administrata e Shërbimeve Sociale Shtetërore në kodin 91307AA- 4,818,344.7 mijë lekë i ka përfituar 118,344 mijë lekë Agjensia e Punësimit dhe Aftësive në kodin 91013AE 4,700,000 mijë lekë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në kodin 91013AG- Pagat e biznesit për masat anti COVID-19ò. Pjesa e mbetur e papërdorur nga Paketa I-rë e ndihmës sociale prej 650,000 mijë lekë në shtesë të fondit prej 7,000,000 mijë lekë akorduar me Aktin Normativ nr.15, i ka përfituar: 566,000 mijë lekë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; 7,000,000 mijë lekë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; 40,000 mijë lekë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Të gjitha këto 3 shpërndarje kanë prekur **kodin 91013AG-** òPagat e biznesit për masat anti COVID-19ò kod i cili sipas databazës së pagesave në SIFQ rezulton të jetë përdorur si transferta tek individët në shumën 260,924 mijë lekë; si transferta ndaj individëve të biznesit të vogël në shumën 5,371,156 mijë lekë dhe si transferta ndaj individëve të mbetur papunë në shumën 7,128,562 mijë lekë. Në konkluzion, deri në datën 31.12.2020, Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit i planifikuar për raste të paparashikuara, është përdorur nëpërmjet 28 Vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM) me vlerë totale prej rreth 2.68 miliard lekësh, nga 2.7 miliard lekë të planifikuara ose në rreth 99.5% përqind të planit të ndryshuar. Konstatohen në vijimësi mangësi në dosjet e vendimeve për përdorimin e fondit rezervë për shpenzimet e paparashikuara. Të gjitha praktikatat e dosjeve të vëna në dispozicion, nuk janë të inventarizuara, për të treguar ecurinë se si është marrë një VKM për përdorimin e këtij fondi. Mungojnë dosjet e VKM-ve nr.106, 188 dhe 984 me përfitues Ministrinë e Brendshme. Në pjesën më të madhe të dosjeve mungon relacioni i plotë dhe preventivi i shpenzimeve nga institucioni përfituese për përdorimin e tij, në kundërshtim me legjislacionin e mësipërm. Mungon mendimi i NPA dhe i Ministrisë të Financave. **Në 7 Vendime të Këshillit të**

¹² Statusi i përdorimit të Paketës sociale I dhe II në aneksin e këtij akt-konstatimi sipas përditësimit më të fundit të MFE në faqen zyrtare datë 03.11.2020 ku totali I fondit të kontigjencës për COVID-19 rezulton i përdorur në masën 12,934,989 mijë lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

	<p>Ministrave, në vlerë 1.64 miliard lekë, fondi rezervë është përdorur si “shtesë buxheti”, fonde të cilat, duhet të parashikoheshin në përputhje me procedurat dhe kriteret ligjore të planifikimit të buxhetit, dhe të miratoheshin me ligjin vjetor të tij. Nga auditimi rezulton se në disa raste shpërndarja e fondit rezervë më pas është rishpërndarë në projekte të tjera. Fondi rezervë prej 1,000 milionë lekë i akorduar për shpenzime të shkaktuara nga situata COVID-19 është përdorur në masën 18% dhe balanca e mbetur është riklasifikuar si Fond Rezervë i Këshillit të Ministrave dhe është përdorur për shpenzime të tjera korrente dhe për investime të cilat nuk ishin planifikuar në ligjin e buxhetit duke krijuar dhe detyrime të prapambetura. Fondi i Kontingjencës për risqet e borxhit prej 4,100 milionë lekë nuk është përdorur gjatë vitit 2020.</p>
Kriteri:	Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 òPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar UMF nr.9, datë 20.03.2018 òPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetit ò Ligji r.88/2019 datë 18.12.2019 òPër buxhetin e vitit 2020, i ndryshuar.
Impakti:	Fondeve buxhetore të përdorura jo sipas kriterëve dhe përcaktimeve ligjore.
Shkaku:	Strukturat drejtuese e menaxhuese të njërive të qeverisjes qëndrore, kërkojnë përdorimin e këtij fondi pa kriteret e domosdoshme, MFE i miraton e alokon këto fonde pa pasur dokumentacionin e miratuar ligjor dhe strukturat e Këshillit të Ministrave që i miratojnë këto vendime pa pasur dokumentacionin e plotë ligjor.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi	Strukturat drejtuese të Ministrisë së Financave/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, të krijojnë për çdo VKM të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit, dosjen e plotë të dokumentacionit të domosdoshëm për të vlerësuar kriteret e përdorimit të Fondit Rezervë i cili edhe gjatë vitit 2020, pavarësisht situatës së veçantë të pandemisë, është përdorur për shpenzime të cilat duhej të ishin planifikuar në ligjin e buxhetit dhe nuk e plotësojnë në vlerë dhe koherencë pagese kriterin e pa parashikueshmërisë dhe emergjencës. Gjithashtu për të gjitha kërkesat për përdorimin e fondit rezervë sipas procedurës, të shmanget praktika e mos marrjes së mendimit të Minsitrisë së Financave dhe Ekonomisë.

10. Risqet fiskale dhe detyrimet kontigjente

10.1 Monitorimi i pagesave për kontratat e koncesioneve/PPP me mbështetje buxhetore.

Sipas raportimit në raportin e zbatimit të buxhetit të publikuar nga MFE, rezulton se për vitin 2020 nga 13 kontrata koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore, për 10 prej tyre janë realizuar pagesa ndërkohë që për 3 prej tyre nuk është kryer asnjë pagesë. Në total, plani përfundimtar për këto projekte paraqitet në shumën 9,734,118 mijë lekë lekë, ndërkohë që pagesat rezultuan në shumën 9,633,635 mijë lekë, me një realizim në masën 99%.

Shuma totale e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojë kufirin prej 5 përqind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor. Në rast tejkalimi të këtij kufiri, Këshilli i Ministrave merr masa korrektuese në krahun e të ardhurave



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

buxhetore, të nevojshme dhe të mjaftueshme, për t'ua rikthyer brenda kufirit të lejuar, gjatë dy viteve të ardhshme buxhetore.

Pagesat vjetore faktike nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për kontratat koncesionare apo PPP, rezultuan në shumën 9,634 milion lekë *ose 2.26 përqind e totalit të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2019, prej rreth 426,271 milion lekë*, duke qenë brenda kufirit të pagesave prej 5% të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2019 që përlogaritet në rreth 21.3 miliardë lekë. Të detajuara sipas kontratave respektive plani dhe pagesat për kontratat koncesionare/PPP aktualisht në zbatim paraqiten:

Autoriteti Kontraktor	Nr	Emërtimi i Kontratës PPP	Viti i fillimit	Viti i mbarimit	2019		2020			
					Plan	Fakt	Plan fillestar	Plani vjetor i ndryshuar	Fakt	
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1	Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë së Elbasanit	2014	2020	661,500	631,317	661,500	586,770	582,720	
	2	Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier	2016	2023	752,772	752,770	752,770	755,500	752,770	
		Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi (BOT) HEC mbi lumin Devoll, rimbursimi i ndërtimit të rrugëve zëvendësuese	2015	2019	1,506,276	1,505,822				
	3		Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës së Arbrit	2018	2031	3,913,800	3,910,860	2,662,000	2,691,110	2,691,055
			<i>Ndërtim, Operim, Mirëmbajtje</i>	2018	2031	3,780,000	3,780,000	2,520,000	2,520,000	2,520,000
			<i>Oponencë Teknike</i>	2020	2020			2,000	2,000	2,000
			<i>Supervizion</i>	2018	2022	133,800	130,860	140,000	169,110	169,055
	4		Ndërtim, Operim dhe Mirëmbajtje e Rrugës Milot-Morinë	2017	2047	575,753	570,643	810,259	813,259	811,734
			<i>Defektet e Fshehura</i>			269,000	268,273	0	0	0
			<i>Supervizioni</i>	2017	2022	60,000	59,393	70,000	73,000	72,973
			<i>Subvencion</i>	2019	2032	246,753	242,977	740,259	740,259	738,761
	5		Ndërtimi dhe Operimi i Porti Jahteve Orikum - Dukat					172,000	500	0
			Projektim, Ndërtim, Mirëmbajtje	2020	2033			100,000		
			Shërbime konsulence të pavarura për zbatimin e kontratës	2020	2020			70,000	500	
			<i>Oponencë Teknike</i>	2020	2020			2,000		
	6		Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës Milot - Balldren					72,000	0	0
		Ndërtimi dhe operimi	2020	2033						
		<i>Supervizioni i punimeve</i>	2020	2020			70,000			
		<i>Oponencë Teknike</i>	2020	2020			2,000			
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1	Shërbimi i Skanimit në Dogana	2013	2030	1,512,571	1,509,659	1,540,896	1,140,896	1,140,893	
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1	Konçesioni/PPP Kontrolli bazë i popullsisë (check up)	2015	2025	876,083	876,083	876,083	352,083	322,322	
	2	Konçesioni/PPP (Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i	2016	2026	2,168,827	2,163,282	1,760,000	1,300,700	1,288,269	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

		mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale)							
	3	Konçesioni/PPP (Ofrimi i shërbimit të dializës)	2016	2026	807,448	804,388	733,000	733,300	733,203
	4	Ofrimi i shërbimeve laboratorike spitalore	2020	2030			800,000	80,000	30,670
Bashkia Tiranë/Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	1	Ndërtimi i Shkollave të Arsimit Parauniversitar në Bashkinë e Tiranës	2018	2025			0		0
MIE / Bashkia Tiranë	1	Inceneratori i Tiranës	2017	2047	977,125	977,125	1,180,000	1,280,000	1,280,000
					477,125	477,125	480,000	580,000	580,000
					500,000	500,000	700,000	700,000	700,000
	13	TOTAL			13,752,155	13,701,949	12,020,508	9,734,118	9,633,635

Në mënyrë të detajuar, auditimi në lidhje me koncesionet/PPP me mbështetje buxhetore duke përfshirë, planin, pagesat faktike dhe regjistrimet në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë paraqiten sipas si në vijim:

1. Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë së Elbasanit.

Ky projekt koncesionar është planifikuar në PBA 2020-2022 sipas tabelës së mëposhtme:

Produkti 2	Impianti i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Elbasan	Kodi i Projektit sipas listes se investimeve	M064078		
			2019	2020	2021
Kosto totale (në mijë lekë)	661,500	661,500	331,000	0	

Projekti koncesionar/PPP për inceneratorin e Elbasanit është detajuar në fondet e investimeve me kod projekti 0M0640780 dhe ka pësuar ndryshime në ulje dhe rritje përgjatë vitit sipas tabelës së mëposhtme:

Vlera buxhetit sipas muajve	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
	661,500,000	661,500,000	661,500,000	414,270,000	224,270,000	224,270,000
	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
242,770,000	242,770,000	272,770,000	351,770,000	351,770,000	586,770,000	

Pagesat e kryera gjatë vitit 2020 për këtë kontratë koncesionare janë në shumën 582,719,856 lekë, sipas 9 urdhër shpenzimeve të regjistruara në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë të kryera nga ana e aparatit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ndërkohë që konstatohen raste të faturave në grup si dhe pagesa pjesore të kryera sipas përshkrimit të pagesës, ku vetëm shuma prej 231,051,239 lekë është kaluar në Dhjetor 2020 dhe i përket faturave të muajve Gusht-Dhjetor 2020 ndikuar nga rishikimet e ndodhura gjatë vitit për buxhetin e këtij projekti investimi, i cili është celur për vlerën e plotë të planifikuar në PBA, është ulur gjatë prill-shtator dhe është rritur në muajt tetor-dhjetor 2020.

2. Ndërtimi, operimi dhe transferimi i inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier

Ky projekt koncesionar është planifikuar në PBA 2020-2022 sipas tabelës së mëposhtme:

Produkti 1	Impianti i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Fier.	Kodi i Projektit sipas listes se investimeve	M064079		
			2019	2020	2021



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Kosto totale (në mijë lekë)	752,772	752,770	752,770	752,770
-----------------------------	---------	---------	---------	---------

Projekti koncesionar/PPP për inceneratorin e Fierit është detajuar në fondet e investimeve me kod projekti 0M0640790 dhe ka pësuar ndryshime në ulje dhe rritje përgjatë vitit sipas tabelës së mëposhtme:

Vlera buxhetit sipas muajve	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
	752,770,000	752,770,000	552,770,000	-	190,000,000	190,000,000
	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
190,000,000	190,000,000	408,500,000	508,500,000	508,500,000	755,500,000	

Pagesat e kryera gjatë vitit 2020 për këtë kontratë koncesionare janë në shumën 752,770,224 lekë, sipas 9 urdhër shpenzimeve të regjistruara në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë të kryera nga ana e aparatit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ndërkohë që konstatohen raste të faturave në grup si dhe pagesa pjesore të kryera sipas përshkrimit të pagesës, ndikuar nga rishikimet e ndodhura gjatë vitit për buxhetin e këtij projekti investimi, i cili është celur për vlerën e planifikuar në PBA, është ulur në Mars-Gusht 2020 dhe është rritur në Shtator-dhjetor 2020 për tu rikthyer në nivelin e planifikuar.

3. Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës së Arbrit

4.1. Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e rrugës së Arbrit. Kontrata e koncesionit është nënshkruar në 16.03.2018, në vlerën 33.6 miliard lekë pa TVSH ose 40.32 miliard lekë me TVSH. Ky projekt koncesionar është planifikuar në PBA 2020-2022, faza e II, pasi faza e III nuk është publikuar:

Produkti 1	Kontrata koncesionare "Përndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e rrugës së Arbrit PPP"	Kodi i Projektit sipas listës së investimeve	18BA201	
	2019	2020	2021	2022
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Kosto totale (në mijë lekë)	2,520,000	3,780,000	3,180,000	2,940,000

Ky projekt është detajuar në fondet e investimeve me kod projekti 018BA2010 dhe ka pësuar ndryshime në ulje dhe rritje përgjatë vitit sipas tabelës së mëposhtme:

Vlera buxhetit sipas muajve	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
	2,520,000,000	2,520,000,000	2,520,000,000	1,520,000,000	1,520,000,000	1,520,000,000
	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1,520,000,000	1,520,000,000	1,520,000,000	1,890,000,000	1,890,000,000	2,520,000,000	

Pagesat e kryera gjatë vitit 2020 për këtë kontratë koncesionare janë në shumën 2,520,000,000 lekë, sipas 6 urdhër shpenzimeve të regjistruara në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë të kryera nga ana e aparatit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ndërkohë që konstatohen raste të pagesave pjesore të kryera sipas përshkrimit të pagesës, ndikuar nga rishikimet e ndodhura gjatë vitit për buxhetin e këtij projekti investimi, i cili është çelur për vlerën e planifikuar në PBA, është ulur në prill 2020 dhe është rritur në tetor-dhjetor 2020 për tu rikthyer në nivelin e planifikuar.

Supervizion i kontratës koncesionare për përmirësimin, ndërtimin, operimin, dhe mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit. Supervizioni i rrugës së Arbrit është kontraktuar në 09.11.2018 sipas përshkrimit në pagesat e realizuara në SIFQ me operator ekonomik fitues GR Albania. Plani fillestar dhe ndryshimet përgjatë vitit 2020 paraqiten:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Vlera buxhetit sipas muajve	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
	140,000,000	140,000,000	140,000,000	140,000,000	140,000,000	140,000,000
	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
135,110,000	135,110,000	135,110,000	135,110,000	135,110,000	135,110,000	169,110,000

Plani i pagesave i detajuar në shumën 140,000,000 lekë ka pësuar ulje në korrik dhe rritje në muajin dhjetor 2020. Pagesat e kryera gjatë vitit 2020 për këtë projekt janë në shumën 169,054,348 lekë, sipas 6 urdhër shpenzimeve të regjistruara në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë të kryera nga ana e aparatit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ndërkohë që konstatohen raste të pagesave pjesore të kryera sipas përshkrimit të pagesës.

Oponenca teknike. Përgjatë vitit 2020 është kryer edhe pagesa për oponencën teknike drejt Institutit të Ndërtimit në shumën 2,000,000 lekë që sipas përshkrimit të pagesës në modulën e pagesave në SIFQ i përket detyrimeve të prapambetura nga viti 2018 si në vijim:

MIE, pagese pjesore oponenca teknike, maarrveshje nr7080/1 dt.11.5.2018, fat nr95(48570795dt14.5.2018, shkresa nr119/3 dt.14.5.18

4. Ndërtim, Operim dhe Mirëmbajtje e Rrugës Milot-Morinë

Planifikimi në PBA 2020-2022 faza II, duke qenë se transporti rrugor në fazën III nuk është publikuar paraqitet:

Produkti 3	Subvencioni i Kontrates koncesionare "Per ndertimin, permiresimin, shrytezimin, mirembajtjen dhe rehabilitimin e autostrades Milot - Morine "	Kodi i Projektit sipas listes se investimeve	18BA203	
	2019	2020	2021	2022
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Kosto totale (në mijë lekë)	320,000	660,000	660,000	660,000

Projekti koncesionar/PPP për subvencionimin e rrugës Milot - Morinë është detajuar në fondet e investimeve me kod projekti 018BA2030 në shumën 740,259,000 lekë, i cili ka mbetur i pandryshuar përgjatë vitit:

Vlera buxhetit sipas muajve	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
	740,259,000	740,259,000	740,259,000	740,259,000	740,259,000	740,259,000
	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
740,259,000	740,259,000	740,259,000	740,259,000	740,259,000	740,259,000	740,259,000

Pagesat e kryera gjatë vitit 2020 për këtë projekt janë në shumën 738,760,500 lekë, sipas 2 urdhër shpenzimeve të regjistruara në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë të kryera nga ana e aparatit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Supervizion i kontrates koncesionare për ndertimin, operimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin e autostradës Milot- Morinë. Projekti koncesionar/PPP për supervizionin e rrugës Milot - Morinë është detajuar në fondet e investimeve me kod projekti 0M0638420 në shumën 70,000,000 lekë, i cili është ndryshuar në rritje në muajin dhjetor 2020 sipas tabelës së mëposhtme:

Vlera buxhetit sipas muajve	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
	70,000,000	70,000,000	70,000,000	70,000,000	70,000,000	70,000,000
	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
70,000,000	70,000,000	70,000,000	70,000,000	70,000,000	70,000,000	73,000,000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Pagesat e kryera gjatë vitit 2020 për këtë projekt janë në shumën 72,973,200 lekë, sipas 6 urdhër shpenzimeve të regjistruara në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë të kryera nga ana e aparatit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

5. Ndërtimi dhe Operimi i Porti Jahteve Orikum–Dukat

Në PBA 2020-2022 të fazës së II, ky projekt koncesionar paraqet planin e pagesave si më poshtë:

Produkti 7	Ndërtim dhe operimi i rruges Orikum-Dukat	Kodi i Projektit sipas listes se investimeve		
	2019	2020	2021	2022
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Kosto totale (në mijë lekë)	0	313,147	1,007,880	963,300

Plani buxhetor i detajuar për projektin me kod 018BA2130 në fillim të vitit 2020 dhe i ndryshuar përgjatë vitit sipas muajve përkatës paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Vlera buxhetit sipas muajve	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
	100,000,000	100,000,000	-	-	-	-
	-	-	-	-	-	-

Gjatë vitit është rishikuar në ulje vlera e këtij projekti në Mars 2020 në vlerën 0 dhe nuk është kryer asnjë pagesë rrjedhimisht.

-Supervizioni i kontrates koncesionare per permiresimin, ndertimin, operimin dhe mirembajtjen e rruges se Orikum-Dukat (Ura e Shen Elizes). Në PBA 2020-2022 të fazës së II, ky projekt paraqet planin e pagesave si më poshtë:

Produkti 8	Supervizioni i kontrates koncesionare per permiresimin, ndertimin, operimin dhe mirembajtjen e rruges se Orikum-Dukat	Kodi i Projektit sipas listes se investimeve		
	2019	2020	2021	2022
	Buxheti	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Kosto totale (në mijë lekë)	0	80,000	80,000	73,000

Plani buxhetor i detajuar për projektin me kod 018BA2140 në fillim të vitit 2020 dhe i ndryshuar përgjatë vitit sipas muajve përkatës paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Vlera buxhetit sipas muajve	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
	70,000,000	70,000,000	-	-	-	-
	-	-	-	-	-	-

Gjatë vitit është rishikuar në ulje vlera e këtij projekti në Mars 2020 në vlerën 0 dhe nuk është kryer asnjë pagesë rrjedhimisht.

-Oponence teknike per kontraten koncesionare per permiresimin, ndertimin, operimin dhe mirembajtjen e rruges Porti I Jahteve - By Pass Orikum -m Dukat (Ura e Shen Elizesë). Në PBA 2020-2022 të fazës së II, ky projekt nuk është parashikuar. Plani buxhetor i detajuar për projektin me kod 018BA2150 në fillim të vitit 2020 dhe i ndryshuar përgjatë vitit sipas muajve përkatës paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Vlera buxhetit sipas muajve	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
	2,000,000	2,000,000	-	-	-	-
	-	-	-	-	-	-



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Gjatë vitit është rishikuar në ulje vlera e këtij projekti në Mars 2020 në vlerën 0 dhe nuk është kryer asnjë pagesë rrjedhimisht.

6. Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës Milot–Balldren

Në PBA 2020-2022 të fazës së II, ky projekt koncesionar paraqet planin e pagesave si më poshtë:

Produkti 6	Kontrata Koncesionare/PPP, per projektimin, ndertimin, dhe mirembajtjen e segmentit rrugor Milot - Balldre	Kodi i Projektit sipas listes se investimeve		
			2019 Buxheti	2020 Parashikimi
Sasia	0	0	0	25

Vlera e parashikuar për vitin 2020 është 0 lekë dhe rrjedhimisht ky projekt nuk është detajuar në vitin 2020 dhe nuk është kryer asnjë pagesë.

Supervizioni i punimeve per ndertimin dhe operimi i rruges Milot – Balldre. Në PBA 2020-2022 të fazës së II, ky projekt koncesionar paraqet planin e pagesave si më poshtë:

Produkti 6	Supervizioni I kontrates koncesionare per permiresimin, ndertimin, operimin dhe mirembajtje e rruges Milot - Balldre	Kodi i Projektit sipas listes se investimeve		
			2019 Buxheti	2020 Parashikimi
Sasia	0	1	1	1
Kosto totale (në mijë lekë)	0	100,000	100,000	100,000

Plani buxhetor i detajuar për projektin me kod 018BA2120 në fillim të vitit 2020 dhe i ndryshuar përgjatë vitit sipas muajve përkatës paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Vlera buxhetit sipas muajve	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
		70,000,000	70,000,000	-	-	-
	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
	-	-	-	-	-	-

Vlera e parashikuar për vitin 2020 është 0 lekë dhe rrjedhimisht ky projekt nuk është detajuar në vitin 2020 dhe nuk është kryer asnjë pagesë.

-Oponence teknike per kontraten koncesionare per permiresimin, ndertimin, operimin dhe mirembajtje e rruges Milot – Balldre. Në PBA 2020-2022 të fazës së II, ky projekt nuk paraqitet.

7. Shërbimi i Skanimit në Dogana

Në PBA 2020-2022 të fazës së III, ky projekt koncesionar paraqet planin e pagesave si më poshtë:

Produkti 12	Shërbim skanimi			
	2019 Buxheti	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi	2022 Parashikimi
Kosto totale (në mijë lekë)	1,543,779	1,540,896	1,578,159	1,634,737
Kosto për njësi (në mijë lekë)	308,756	308,179	315,632	326,947

Vlera e detajuar në fillim të vitit për këtë projekt koncesionar paraqitet në shumën 1,540,896,284 lekë dhe është rishikuar në ulje në shumën (700,000,000) lekë në muajin prill dhe në rritje në muajin korrik në shumën 300,000,000 lekë, sipas modulit të rishikimeve buxhetore, me një plan përfundimtar në shumën 1,140,896,284 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHPETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Pagesat e realizuara në vitin 2020 sipas databazës së pagesave në SIFQ rezultojnë në shumën 1,131,666,025 lekë sipas 45 urdhër shpenzimeve të regjistruara për llogari të buxhetit të vitit 2020, në ndryshim nga vlera e raportuar në tabelën e faktit të publikuar nga MFE në shumën 1,140,893 mijë lekë.

Nga vlera e paguar për këtë kontratë, konstatohet se për 5 urdhër shpenzime, në shumën 126,266,408 lekë i përkasin detyrimeve të prapambetura të muajit dhjetor 2019 të cilat janë paguar duke përdorur buxhetin e miratuar për vitin 2020. Gjithashtu nga auditimi në bazë të pagesave të kryera pas periudhës raportuese janë konstatuar pagesa duke përdorur buxhetin e vitit 2021 për detyrime të vitit 2020. Në pagesat e kryera në vitin 2021 evidentohen 5 raste të pagesës së kyer nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në shumën totale 128,465,678 lekë sipas faturave të datës 21.12.2020, pra për shpenzime që i përkasin buxhetit të vitit 2020.

8. Ndërtimi i Shkollave të Arsimit Parauniversitar në Bashkinë e Tiranës

Për këtë kontratë koncesionare nuk ka të regjistruar asnjë projekt investimi dhe nuk buxhet të detajuar dhe rrjedhimisht asnjë pagesë të realizuar përgjatë vitit 2020. Aktualisht rezulton vetëm LOT1 (nga katër lote të parashikuara) i kontratës koncesionare të nënshkruar në datën 17.10.2018 ndërmjet MAS dhe Bashkisë Tiranë me BOE në shumën 2,364,096,027 lekë, në të cilën është ndërmarrë angazhimi për kryerjen e pagesës së kësaj shumë për shtatë vjet nga momenti i marrjes në dorëzim. Nuk rezulton që kjo kontratë të jetë e regjistruar në modulën e kontratave sipas auditimit deri në këtë moment.

9. Inceneratori i Tiranës

Në PBA 2020-2022 të fazës së III, ky projekt koncesionar, vetëm për pjesën e financuar nga ana e MIE në programin e mbetjeve urbane paraqet planin e pagesave si më poshtë:

Produkti 1	Impianti i prodhimit të energjisë nga mbetjet në Tiranë			
	2019	2020	2021	2022
Kosto totale (në mijë lekë)	500,000	700,000	200,000	200,000

Vlera e detajuar në fillim të vitit për këtë projekt koncesionar paraqitet në shumën 700,000,000 lekë dhe është rishikuar në ulje në shumën 200,000,000 lekë në muajin mars dhe në rritje në muajin dhjetor në shumën 200,000,000 lekë, sipas modulit të rishikimeve buxhetore, me një plan përfundimtar në shumën 700,000,000 lekë.

Pagesat e realizuara përgjatë vitit 2020 sipas databazës së pagesave në SIFQ rezultojnë në shumën 1,280,000,000 lekë me 38 rekorde pagesash. Këto pagesa janë financuar në shumën 700,000,000 lekë nga buxheti i MIE, programi i mbetjeve urbane dhe pjesa tjetër prej 580,000,000 lekë prej të ardhurave të veta të Bashkisë Tiranë. Konstatohet se janë paguar në 6 rekorde detyrime të prapambetura të muajve Tetor-Dhjetor 2019 në shumën 229,896,122 lekë duke përdorur buxhetin e miratuar për vitin 2020. Gjatë vitit 2020 kjo kontratë koncesionare nuk është financuar plotësisht për vlerën e shpenzimeve të ndodhura duke qenë se janë krijuar detyrime të prapambetura të cilat janë paguar në vitin 2021 me buxhetin e vitit 2021, për fatura të vitit 2020. Nga auditimi është konstatuar se janë realizuar pagesa duke përdorur buxhetin e vitit 2021 për shpenzime të ndodhura në vitin 2020, të cilat nuk janë raportuar si të tilla, në 5 raste në shumën totale 139,094,166 lekë për fatura të periudhës Tetor-Dhjetor 2020.

Në lidhje me konstatimet e mësipërme janë paraqitur observacione nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 514/9 datë 25.08.2021 prot. KLSH ku është parashtruar që:



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

-Përcaktimi në vlera e pagesave faktike vjetore 2020 për kontratën e ÷Shërbimit të skanimit në dogana, të publikuar nga MFE në shumën 1,140,893 mijë lekë përputhet plotësisht si me raportimin zyrtar (sipas përcaktimeve të udhëzimit plotësues nr.2 datë 20.01.2020 ÷Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020) të autoritetit kontraktor, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ashtu edhe me faktin vjetor 2020 të gjeneruar në SIFQ. Për rrjedhojë konstatimi juaj nuk qendron.

Në përgjigje të këtyre observacioneve sqarojmë se konkluzioni i arritur bazohet nga databaza e pagesave me datë libri i madh vitin 2020 gjeneruar po nga SIFQ dhe vendosur në dispozicion nga MFE, për këtë arsye, konstatojmë se nuk është dhënë argument mbi diferencën dhe për rrjedhojë observacioni nuk merret në konsideratë.

Në lidhje me këto çështje, nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë janë dërguar observacione mbi projekt raportin e auditimit me shkresën nr. 8595/33 datë 30.09.2021 në të cilën është parashtruar ndër të tjera: *“Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes strukturës përkatëse për monitorimin e kontratave të koncesionit, në Drejtorinë e Koncesioneve monitoron risqet e kontratave koncesionare bazuar në përcaktimet e Udhëzimit nr.35 datë 12.12.2019, Aneksi nr.4 “Matrica e rreziqeve fiskale për qeverinë nga PPP”, ku përfshihet edhe risku i kërkesës lidhur me kontratat koncesionare (siç përmendet më sipër), nuk është përgjegjësi e Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit, e cila monitoron vetëm ecurinë e pagesave faktike dhe treguesve të performancës për kontratat koncesionare me mbështetje buxhetore për vitin korrent buxhetor.*

Në përgjigje të këtyre observacioneve sqarojmë se rekomandimi i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe jo vetëm Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit. Gjithashtu, sikurse përcaktohet në observacion që monitorohet ÷curia e pagesave faktike, akumulimi i detyrimeve nga viti i kaluar dhe krijimi i detyrimeve të reja, sikurse është konstatuar, pohon mungesën e monitorimit të saktë gjatë kohës që risqet materializohen në efekte monetare. Për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Gjetja:	Pagesat vjetore faktike për projektet koncesionare rezultojnë brenda kufirit prej 5% të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës, megjithatë konstatohet se mos realizimi i 3 projekteve nga 13 në zbatim gjatë këtij viti për të cilat nuk është kryer asnjë pagesë dhe njëkohësisht mos financimi për vlerën e plotë të shpenzimeve duke qenë se janë krijuar detyrime të prapambetura në 2 projekte krijojnë risk për pagesat e kërkuara për vitet në vijim në raport me të ardhurat tatimore.
Situata:	Sipas raportimit në raportin e zbatimit të buxhetit të publikuar nga MFE, rezulton se për vitin 2020 për 13 kontrata koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore në total, plani përfundimtar paraqitet në shumën 9,734,118 mijë lekë, ndërkohë që pagesat rezultuan në shumën 9,633,635 mijë lekë, me një realizim në masën 99%. Këto pagesa janë kryer për 10 kontrata ndërkohë që për 3 prej tyre nuk është kryer asnjë pagesë. Shuma totale e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojë kufirin prej 5% të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor. Në rast tejkalimi të këtij kufiri, Këshilli i Ministrave merr masa korrektuese në krahun e të ardhurave buxhetore, të nevojshme dhe të mjaftueshme, për t’u rikthyer brenda kufirit të lejuar, gjatë dy viteve të ardhshme buxhetore. Aktualisht, pagesat vjetore faktike nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

	<p>kontratat koncesionare apo PPP, në shumën 9,634 milion lekë <u>zënë 2.26% e totalit të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2019, prej rreth 426,271 milion lekë</u>, duke qenë brenda kufirit të pagesave prej 5% të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2019 që përlllogaritet në rreth 21.3 miliard lekë.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se në dy projekte koncesionare, janë krijuar detyrime të prapambetura si dhe gjatë vitit janë shlyer detyrime të viteve të mëparshme, konkretisht projekti i inceneratorit të Tiranës dhe koncesioni i skanimit në dogana. Këto dy projekte përfshijnë kryerjen e pagesave në bazë të nivelit shërbim të ofruar kushtëzuar nga kërkesa për këtë shërbim, kërkesë kjo që mund të jetë mbi nivelin e buxhetuar. Realizimi i shërbimit përtej vlerës së buxhetuar ka shkaktuar krijimin e detyrimeve të prapambetura për vitin aktual dhe në të njëjtën kohë mbartjen e tyre në vitin pasardhës.</p> <p>Në një rast, detyrimet kontraktuale nuk rezultojnë të buxhetuara, dhe as të regjistruara si obligim në SIFQ, konkretisht për projektin e ndërtimit të shkollave në Bashkinë e Tiranës, konstatim i njëjtë me vitin e kaluar, ku kontrata e nënshkruar nuk është regjistruar dhe nuk është buxhetuar.</p> <p>Konstatohet se, gjatë vitit 2020, situata pandemike ka kushtëzuar uljen e financimit në disa prej kontratat koncesionare me ndryshimet e ligjit nr. 88/2019 për buxhetin e vitit 2020, gjatë muajit mars dhe prill 2020, konkretisht projektet koncesionare në fushën e infrastrukturës, menaxhimit të mbetjeve dhe shëndetësisë. Megjithatë, disa nga këto kontrata janë ri financuar në vlerën fillestare të parashikuar në fillim të vitit, me aktin normativ nr. 28 datë 02.07.2020 dhe aktin normativ nr.34 datë 16.12.2020, me përjashtim të dy kontratave koncesionare në infrastrukturën rrugore, projektet e rrugëve Milot-Balldren dhe Orikum Dukat.</p>
Impakti:	Risk i shtuar
Shkaku:	Kontratat koncesionare, niveli i kërkesës për shërbime që ofrohen nga këto kontrata, mos regjistrimi i plotë i shpenzimeve në lidhje me këto kontrata apo i vetë obligimeve që rrjedhin nga këto kontrata.
Rëndësia:	E mesme
Kriteri:	Ligji nr.88/2019, i ndryshuar
Rekomandimi:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me autoritetet kontraktuese, të monitorojë me rigorozitet detyrimet që lindin nga kontratat koncesionare, pagesat e të cilave bazohen në nivelin e shërbimit dhe që krijojnë detyrime të prapambetura për t'u mbartur në vitet e ardhshme buxhetore ndërkohë që nisin edhe projekte të reja koncesionare për zbatim.

10.2 Monitorimi i detyrimeve të prapambetura.

Në zbatim të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, VKM-së nr. 50 datë 05.02.2014 për miratimin e Strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimtari, Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, Udhëzimit nr.5, datë 27.02.2014 për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura; Udhëzimit nr. 2, datë 20.01.2020, për zbatimin e buxhetit të vitit




KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

2020-ö i ndryshuar , Udhëzimit nr.9 datë 20.07.2018 për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit, Udhëzimit nr.37, datë 06.10.2020 për Monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme, Udhëzimit nr. 46, datë 24.12.2020 për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2020, u vlerësua monitorimi i kryer nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të detyrimeve të prapambetura të njësisve të qeverisjes së përgjithshme.

Akumulimi i detyrimeve të prapambetura përbën një problematikë për sistemin buxhetor dhe me qëllim evidentimin, monitorimin dhe shlyerjen e tyre, është kërkuar vazhdimisht një angazhim maksimal i MFE dhe institucioneve buxhetore, në zbatim të VKM-së nr. 50 datë 05.02.2014 “Për miratimin e Strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit. Pikërisht në vitin 2014, u ndërmorën angazhime për shlyerjen përfundimtare të detyrimeve të prapambetura të akumuluar ndër vite (56.6 miliard lekë)¹³, me qëllim shmangien në të ardhmen të këtij fenomeni. Megjithatë, aktualisht konstatohet se ndodhemi në një situatë ku këto detyrime janë në rritje të vazhdueshme.

Në fund të vitit 2020¹⁴, FMN i ka raportuar detyrimet e prapambetura në vlerën rreth 30 miliardë lekë, pra pothuajse në të njëjtat nivele me vitin 2019.



Burimi: Raporti i FMN “First post-program monitoring—press release; staff report; and statement by the executive director for Albania”

Pavarësisht rekomandimeve të lëna prej saj, ku më hollësisht u është kërkuar autoriteteve përkatëse se duhet të shmangët krijimi i detyrimeve të reja dhe se institucionet shtetërore duhet t'i përmbahen planit për reduktimin e stokut ekzistues, vihet re se niveli aktual i këtij stoku kërkon një vëmendje maksimale nga njësitë përgjegjëse për monitorimin.

Stoku i detyrimeve të prapambetura përbëhet nga detyrimet financiare të transaksioneve të shpenzimeve të njësisve shpenzuese së qeverisjes së përgjithshme që rezultojnë të papaguara 60 ditë kalendarike mbi datën e faturës së operatorit ekonomik (duke përfshirë afatin 30 ditor të thesarit në shtesë nga 30 ditët e pagesës nga autoriteti publik), sipas përcaktimeve në nenin 7 të Ligjit nr. 48/2014 për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare; apo afateve të përcaktuara në

¹³ <https://www.parlament.al/Files/LigjeRishqyrtim/11866buxheti.pdf>

¹⁴ <https://www.imf.org/en/Publications/CR/Issues/2020/11/30/Albania-First-Post-Program-Monitoring-Press-Release-Staff-Report-and-Statement-by-the-49923>



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

marrëveshjet respektive për likuidimin e tyre. Këto detyrime nuk përlllogariten dhe nuk përfshihen si vlerë në raportet dhe statistikat e borxhit publik¹⁵, duke e nënvlerësuar këtë të fundit.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë në drejtim të monitorimit dhe raportimit të detyrimeve të prapambetura dhe në zbatim të udhëzimit nr. 2, datë 20.01.2020, për zbatimin e buxhetit të vitit 2020, kapitulli III "Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes qendrore, përgatit raportin e konsoliduar të këtyre detyrimeve çdo tre muaj bazuar në raportimet e njësitë të qeverisjes së përgjithshme. Ky raportim është konkretizuar më pas në **Udhëzimin nr.37, datë 06.10.2020** për "Monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme. Në këtë udhëzim reflektohen procedurat që duhet të ndjekin strukturat përgjegjëse në njësitë shpenzuese për raportimin e informacionit lidhur me detyrimet e prapambetura për të cilat nuk ka fonde në dispozicion nëpërmjet Urdhër Regjistrimit të Detyrimeve të Prapambetura (URDP), dhe më pas regjistrimin nga ana e Thesarit të këtyre detyrimeve, për të vijuar me likuidimin e tyre pas regjistrimit të fondeve shtesë në SIFQ nga Buxheti. Ky udhëzim ka ndryshuar edhe metodologjinë e raportimit për shkak se deri në Shtator 2020 raportimi kryhej në bazë të vetë deklaratimit të njësitë duke përfshirë vetëm ministritë e linjës dhe njësitë e vendore; ndërsa aktualisht synohet një raportim në nivel qeverisjeje të përgjithshme ku të dhënat mbi pagesat e detyrimeve të prapambetura do të gjenerohen automatikisht nga moduli përkatës në SIFQ, për tu konsoliduar më pas me raportimin nga DPT për stokun e rimbursimit të TVSH. Më hollësisht, udhëzimi përcakton se:

-Struktura përgjegjëse për Thesarin në qendër gjeneron periodikisht nga SIFQ raportet e të dhënave të detajuara të stokut të detyrimeve të prapambetura sipas njësitë shpenzuese të qeverisjes qendrore dhe vendore, si dhe sipas natyrës ekonomike të detyrimit të prapambetur. Mbi bazë të këtij informacioni të detajuar gjenerohen të dhënat e agreguara sipas niveleve të qeverisjes së përgjithshme (qendrore dhe vendore) si dhe natyrës ekonomike të detyrimeve të prapambetura (sipas Aneksit nr.1 të këtij udhëzimi), përveç llogarisë 486500-Rimbursimi i TVSH-së. Të dhënat agregohen në një skedar në format Ms Excel duke u lidhur me formula me të dhëna të detajuara përkatëse në të njëjtin skedar. Të dhënat e agreguara janë pjesë e raportimit mujor të treguesve fiskal të konsoliduar në version përfundimtar.

Këto të dhëna i dërgohen me e-mail DPB.

-Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve gjeneron periodikisht dhe dërgon në format Excel të dhënat e stokut të detyrimeve të prapambetura nga rimbursimi i TVSH-së sipas aneksit 1 të udhëzimit dhe ja dërgon me e-mail DPB dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Makroekonomike e Fiskale, jo më vonë se 7 ditë pune përpara afatit final për publikim sipas datave në pikën 1 të seksionit IV të udhëzimit.

-Njësia Përgjegjëse për monitorimin e risqeve buxhetore koordinon në vijimësi dhe periodikisht të gjithë procesin që ka për qëllim ky udhëzim duke mbledhur të dhënat e detyrimeve të prapambetura dërguar nga DPTH dhe DPT dhe përgatit një informacion të konsoliduar tabelor sipas Aneksit 1.

-Në faqen e MFE publikimi do të jetë brenda datës 1 shkurt të çdo viti për stokun e detyrimeve që i korrespondon periudhës fiskale Janar-Dhjetor të vitit paraardhës në version paraprak dhe brenda muajit Maj në version përfundimtar; Brenda datës 30 Prill të çdo viti për periudhën janar-mars; Brenda datës 31 korrik për periudhën janar qershor dhe brenda datës 30 tetor për periudhën janar-shtator.

¹⁵ https://cfr.ëorlbank.org/sites/default/files/2020-12/Country%20Presentation%20ALBANIA_Debt%20Reporting%20and%20Transparency%20%20ALB.pdf



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Megjithatë, kjo metodologji e rishikuar ka arritur të përmirësojë raportimin vetëm për sa i përket pakësimit të stokut të detyrimeve të prapambetura për shkak se tanimë ato gjenerohen automatikisht nga SIFQ dhe jo në bazë të vetëdeklarimit, por ajo nuk mundëson verifikimin e detyrimeve të prapambetura sipas kohës së krijimit të tyre; shmangien e diferencave mes stokut së deklaruar të detyrimeve dhe atë të pasqyrave financiare; apo pagesave të kryera jashtë skemës për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Referuar këtij udhëzimi, të dhënat e paraqitura sipas nivelit të qeverisjes së përgjithshme dhe natyrës ekonomike të detyrimeve, përcillen nga Drejtoria e Thesarit për Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit. Nga auditimi u konstatua se pavarësisht përcaktimeve të hollësishme të këtij udhëzimi në drejtim të procedurave dhe periodicitetit të raportimeve mbi këto detyrime, të dhënat e raportuara nga MFE paraqiten me diferenca krahasuar me të dhënat që rezultojnë në SIFQ nga Drejtoria e Thesarit në MFE, ashtu edhe me të dhënat që rezultojnë nga përlllogaritjet e KLSH. Informacioni final dhe i konsoliduar i stokut të detyrimeve të prapambetura për periudhën Janar-Dhjetor publikohet brenda datës 1 Shkurt të çdo viti si version paraprak; ndërsa versioni përfundimtar publikohet brenda muajit Maj. Si rezultat, ekzistenca e këtyre diferencave në raportime mes drejtorive mund të jetë ndikuar nga afati kohor në të cilin është kryer raportimi (pra nëse informacioni i konsoliduar i publikuar i MFE është bazuar në të dhënat paraprake të Drejtorisë së Thesarit dhe jo atij përfundimtar), apo kryerjen e veprimeve sistemuese nga Drejtoria e Thesarit pasi ato janë përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit.

Gjithashtu, gjatë vitit 2020 është miratuar edhe urdhri i përbashkët nr. 304, datë 17.12.2020 mes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë òPër miratimin e planit të masave të reduktimit të detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike është miratuar plani i masave për reduktimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike, efektet e së cilit do të shqyrtohen gjatë vitit 2021. Sipas këtij plani, për vitin 2020 është vlerësuar stok i papaguar ndaj OSHEE në vlerën 3,8 miliardë lekë, subjekt akt rakordimi mes palëve.

A. Mbi monitorimin e kryer nga MFE për detyrimet e prapambetura

Monitorimi aktual i kryer nga MFE konstatohet se nuk mundëson përputhshmërinë e plotë me të gjitha përcaktimet e Udhëzimit nr.5, datë 27.02.2014 òPër shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, i ndryshuar i cili parashikon në pikën 31 të tij, se *òInformacioni financiar për pagesat e detyrimeve të prapambetura do të përditësohet çdo muaj dhe do të publikohet në faqen e internetit të MF-së me bazë mujore. Ky raport do të përfshijë gjendjen fillestare të verifikuar sipas kategorive, sektorëve dhe kohës së krijimit, pagesat e bëra gjatë periudhës nga çdo institucion buxhetor, llojin e detyrimit financiar, përfituesin dhe balancën e verifikuar mbyllëse të mbeturë dhe në pikën 33 të tij se “Krahas monitorimit të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura Ministria e Financave zhvillon një sondazh tremujor tek ministrinë e linjës, nëse ka detyrime financiare të krijuara rishtas dhe të papaguara në kohë për të përcaktuar pagesat e reja të kërkueshme, që rrjedhin nga faturat ose pretendimet e marra pas datës 1 janar 2014 si dhe do të zhvillojë një analizë të periudhës së pretendimeve, duke përcaktuar përgjegjësinë dhe vendosur masa administrative sipas kuadrit ligjor në fuqi..ò.* Si rezultat, formati i administrimit të të dhënave mbi detyrimet e prapambetura nga ana e Ministrisë së Financave **nuk paraqet informacion mbi kohën e krijimit të detyrimit së bashku me shtesat dhe pakësimet përgjatë vitit.** Ky lloj



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

informacioni do të mund të garantonte edhe respektimin e parimit FIFO në shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, për të cilat nga ane KLSH janë identifikuar një sërë parregullsish, veçanërisht në likuidimin e detyrimeve si rezultat i vendimeve për largimin nga puna të ish punonjësve. Gjithashtu, konstatohet se **nuk ka një plan veprimi** të miratuar për ndërmarrjen e iniciativave në drejtim të menaxhimit të dhe një plani për likuidimin e tyre. Mungesa e tij nuk mundëson edhe kryerjen e një raportimi në bazë të objektivave të paracaktuara për monitorimin e rritjes apo krijimit të detyrimeve të prapambetura nga ana e njësive publike.

Nga auditimi paralel nga KLSH në Drejtorinë e Thesarit për periudhën objekt auditimi vitin 2020, janë konstatuar një sërë problematikash lidhur me disiplinimin e angazhimeve buxhetore dhe parandalimit të krijimit të detyrimeve të prapambetura nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Më hollësisht janë konstatuar 550 nga 743 urdhër-prokurime me datë kontrate përpara datës së regjistrimit të urdhër-prokurimit; 7 raste me vlerë fondi limit 4.27 miliard lekë, ku janë marrë angazhime për projekte pa kaluar në procesin ligjor të miratimit në PBA; 13 procedura të zhvilluara pas datës 15 tetor pa qenë pjesë e buxhetit tre vjeçar, me vlerë fondi limit 2.85 miliard lekë; 14982 kontrata ose 63% e totalit të kontratave të regjistruara me vlerë 131.5 miliard lekë janë regjistruar në shkelje të afatit 5 ditor; mos respektim i radhës së pagesave (parimi FIFO); 32927 fatura me vlerë 45.4 miliard lekë të dorëzuara në Thesar jashtë afatit 30 ditor; 66 raste me vlerë 122 milion lekë të tejkalimit të afatit 30 ditor të procesimit dhe ekzekutimit të pagesave; 79 raste të regjistrimit dhe pagesave pjesore të faturave. Këto situata konstatohen si me impakt negativ për krijimin e detyrimeve të prapambetura për shkak të cënimit të kontrolleve për marrjen e angazhimeve buxhetore pa fonde disponibël, apo për marrjen e masave për reduktimin e këtij stoku.

Rekomandimi i MFE për njësitë e auditit të brendshëm në sektorin publik që në planin strategjik dhe vjetor të veprimtarisë audituese për vitet 2018-2020 të përfshijnë programe auditimi për analizimin dhe vlerësimin e detyrimeve të prapambetura si fusha me risk të lartë dhe që duhet të trajtohen me përparësi, është bërë pjesë edhe e raportit vjetor të KBFP për vitin 2020. Sipas këtij raporti, vetëm **64 njësi shpenzuese** kanë përcjellë pranë Drejtorisë së Harmonizimit informacione mbi kryerjen e auditimeve të detyrimeve të prapambetura. Konkluzionet e raportit tregojnë për një përmirësim të situatës mbi detyrimet e prapambetura por megjithatë është evidentuar nevoja për ndërmarrjen e veprimeve korigjuese dhe kontrolleve shtesë për minimizimin e riskut që lidhet me to.

A. 1 Detyrimet e prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore

Sipas raportimit të kryer nga njësia përgjegjëse për monitorimin e risqeve të përgjithshme, publikuar në faqen zyrtare të MFE, situata deri në Dhjetor 2020 e stokut të detyrimeve për njësitë e vetëqeverisjes vendore paraqitet si më poshtë:

Stoku i Detyrimeve Dhjetor 2020-Institucionet e Qeverisjes Vendore

Në milion lekë

Institucioni	Ven.gjyq	Shërb	Mirëmb	Invest	Rim.TVSH	Mallra	Të tjera	Sig.shoq	Sig.Shënd	Të ardh.pers	Të tj	Total
B/Tiranë	41.5	29.9	4	418.5	0	80.7	187.1	00	0	0	0.1	761.8
B/Kavajë	63.3	42.1	0	114.5	0	0	507.9	0	0	0	0	727.8
B/Vorë	7.5	0	108	587	0	0	0	0	0	0	0	702.6
B/Pogradec	118.9	95.8	1.8	82	0	12.5	18.7	7.6	1.1	0.4	0	338.7
B/Lezhë	2.3	57.1	0	113.8	0	7.4	127.8	0	0	0	0	308.4
B/Roskovec	0.5	8.9	4.3	283.6	0	4.8	0.2	0	0	0	0	302.2
B/Kamëz	2	55.3	0	208.1	0	0	0	0	0	0	0	265.4



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT


RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

B/Vlorë	0	14.5	59.1	53	0	13.2	116.8	0	0	0	0	256.6
B/Malësi	16.5	0	0	207.4	0	0	0	0	0	0	0	223.9
Madhe												
B/Durrës	137.3	0	0	48.2	0	0	0	0	0	0	0	185.4
B/Dibër	108.1	9.9	0.1	37.4	0	9.7	0.8	1.8	0.3	6.7	0	174.6
B/Kucovë	0.5	16.2	0	126.5	0	0.3	12.9	0	0	0	0	156.3
B/Elbasan	1.6	47.3	4.9	78.2	0	21.1	0.7	0	0	0	0	153.9
B/Berat	9.7	22.7	0	82.9	0	5.5	22.6	0	0	0	0	143.3
B/Lushnjë	1	11.6	11.4	104.1	0	5.7	1.1	0	0	0	0	134.8
B/Divjakë	2.5	4.7	1	87.1	0	25.7	9.3	0	0	0	0	130.2
B/Belsh	0	10	0	117.8	0	0.4	0	0	0	0	0	128.2
B/Ura Vajg	16.9	4.6	6.7	69.6	0	0	26.3	0	0	0	0	124.1
B/Tropojë	11.1	1.2	13.2	93.7	0	0.1	0	0	0	0	0	119.3
B/Rrogozhin	0	24.3	0	88.4	0	0	0.5	0	0	0	0	113.2
B/Cërrik	1.4	4.1	3.8	86.2	0	7.3	8.8	0	0	0	0	111.8
B/Polican	8.2	18.9	0	54.3	0	0	21.3	0	0	0	0	102.7
B/Selenicë	20.2	7.3	0	58.3	0	3.5	8.7	0.4	0	0	0.6	99
B/Fier	0	10	0.2	68.6	0	0	9.6	0	0	0	0	88.5
B/Himarë	0.1	4.1	0	61.3	0	0.8	8.9	0	0	0	0	75.2
B/Kukës	3.1	5.1	0	13	0	0.2	9.6	20.4	1.4	13.2	6.7	72.7
B/Mirditë	0	22.2	0	34.1	0	2.8	7.9	0	0	0	0	66.9
Q/Durrës	63.1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	63.1
B/Pukë	10.1	5.7	0	43.5	0	0	0	0	0	0	0	59.3
B/Klos	2.5	3.2	1.1	47	0	1.4	3.2	0	0	0	0	58.4
B/Tepelenë	5.7	7	5.1	11.5	0	15.3	13.5	0	0	0	0	58.1
B/Devoll	4.9	30.1	0	6.9	0	0	14.4	0.1	0	0.1	0.7	57.3
B/Sarandë	8.5	46.2	0	0.9	0	1.6	0	0	0	0	0	57.2
B/Librazhd	1.9	0.3	0.1	53.5	0	0	0	0	0	0	0	55.8
B/Korçë	4.8	17.3	13.6	12.2	0	5.4	0	0	0	0	0	53.3
B/Delvinë	2.4	8.4	0	39.9	0	1.1	0	0	0	0	0	51.8
B/Finiq	0.1	0.1	0	25.1	1.8	2.5	20.6	0	0	0	0	50.1
B/Krujë	9.4	1.4	0	36.2	0	0	3.1	0	0	0	0	50
Q/Berat	41.3	0	0	0.7	0	0	0.1	0	0	0	0	42.2
B/Peqin	9.9	3.4	0.7	12.6	0	1.3	4.4	0	0	0	0	32.3
B/Skrapar	8.5	0.5	4.7	3.6	0	0.1	12.2	0	0	0	0	29.6
B/Bulqizë	0	0	0.5	27.8	0	0	0	0	0	0	0	28.3
B/Has	0.4	0	0	25.4	0	1.7	0	0	0	0	0	27.5
B/Memaliaj	0.2	13.8	1.5	1.2	0	1.8	6	0	0	0	0	24.3
B/Mat	3.8	9.9	0	0	0	5.3	0.3	0.4	0.1	0	0.1	19.9
B/Gramsh	8	4.5	0	5.5	0	1.6	0	0	0	0	0	19.7
Q/Gjirokastër	16.5	0	0	0	0	1	1.3	0	0	0	0	18.7
B/Përrenjas	3.2	12.9	0	0.1	0	0	0	0	0	0	0	16.2
B/Kurbin	8	2	0	5.8	0	0	0	0	0	0	0	15.8
B/Maliq	2.5	8.6	0	1.6	0	1.5	0	0	0	0	0	14.1
B/Konispol	0	9.3	0	0	0	0	3.7	0.4	0	0	0.2	13.6
B/Kolonjë	8.3	1.5	0.9	0	0	1.5	0	0	0	0	0	12.2
B/Mallakastër	0.9	0.1	0	2.9	0	0	6.6	0	0	0	0	10.6
B/Shijak	0	0	0	9.6	0	0	0	0	0	0	0	9.6
B/Libohovë	0	0.2	0.4	7.4	0	0	0	0	0	0	0	8
B/Fush Arrëz	8	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	8
B/Vau Dejës	3.3	0	0	4.5	0	0	0	0	0	0	0	7.8
B/Përmet	1.7	2.3	0	2.2	0	0	0	0	0	0	0	6.3
B/Gjirokastër	1	0.1	0	1.1	0	1.1	0	0	0	0	0	3.3
B/Shkodër	0	0	0	3.2	0	0	0	0	0	0	0	3.2
Q/Korçë	1.4	0.8	0	0	0	0.3	0.6	0	0	0	0	3
B/Pustec	0	0.2	0	0.5	0	0.8	0	0	0	0	0	1.4
Q/Vlorë	0	1.3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1.3
TOTAL	814.3	718.6	247.3	3,770	1.8	246.7	1,197.6	31.1	2.8	20.5	8.4	7,058.9

Burimi: Raporti i MFE për detyrimet e prapambetura të gjeneruara nga sistemi SIFQ dhe DPT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit bazuar në evidencat e MFE

Pra, vetëm 8 bashki (përkatësisht Bashkia Tiranë, Kavajë, Vorë, Pogradec, Lezhë, Roskovec, Kamëz dhe Vlorë) përbëjnë mbi 50% (përkatësisht 52%) të totalit të stokut të detyrimeve të prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Në raportin mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2020 hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, stoku i detyrimeve të prapambetura për njësitë e vetëqeverisjes vendore në fund të muajit dhjetor 2020, është paraqitur në masën 6.9 miliard lekë (faqe 52 e raportit të MFE mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2020), duke rezultuar me diferencë krahasuar me të dhënat e SIFQ në Drejtorinë e Thesarit ku ato rezultojnë në rreth 7.2 miliard lekë, dhe sipas përlllogaritjes së KLSH në vlerën rreth 7.5 miliard lekë.

Në zbatim të pikën 35 të Udhëzimit nr. 26, datë 27.09.2019 procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore Ministria e Financave dhe Ekonomisë, brenda muajt pasardhës të çdo katër mujori është përgjegjëse për hartimin e një informacioni përmbledhës mbi treguesit e raportit të gjendjes financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore. Në raportin mbi statusin e vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2020 është pasqyruar situata sipas vetëvlerësimit të 58 bashkive (duke mos përfshirë 3 bashki: Konispoli, Pusteci dhe Rrogozhina) rezultatet e të cilave paraqiten si më poshtë:

Numri i bashkive	% e detyrimeve të prapambetura ndaj totalit të shpenzimeve vjetore të miratuara 2020	Situata Financiare
37	0 -15 %	Pa probleme financiare
11	16% -25%	Me probleme financiare
10	26%- 70%	Në vështirësi financiare

Burimi: Raporti i MFE mbi statusin e vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2020



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Pra, janë evidentuar **10 bashki** (Roskovec, Lezhë, Tepelenë, Këlcyrë, Belsh, Pogradec, Kuçovë, Poliçan, Kavajë, Vorë) me vështirësi financiare.

Udhëzimi plotësues nr.27, datë 10.07.2020 òPër përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023ö, ndër të tjera ka përcaktuar se në hartimin e tavaneve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023, njësitë e vetëqeverisjes duhet të përfshijnë edhe planin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura. Në zbatim të saj, njësitë vendore kanë përcjellë informacion lidhur me detyrimin e mbetur deri në muajin Dhjetor 2020 duke hartuar edhe planin e shlyerjes së stokut të detyrimeve për tre vitet në vazhdim 2021-2023 përpara hartimit të projekt .Sipas këtij plani të vendosur në dispozicion, në total për 61 bashki dhe 12 qarqe është parashikuar të kryhen pagesa në vlerë rreth **3,831 milion** milion lekë gjatë vitit 2021; **1,072 milion** lekë për vitin 2022 dhe **2,152 milion** lekë për vitin 2023:

Në mijë lekë

Emërtimi	Detyrimi i mbetur deri në dhjetor 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
61 Bashki	6,930,639	3,720,276	1,065,437	2,144,925
12 Qarqe	128,304	111,696	7,271	7,337
Total	7,058,943	3,831,972	1,072,708	2,152,262

Burimi: Raporti i MFE mbi statusin e vështirësive financiare të njërive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2020

Pra, për vitin 2021 është planifikuar shlyerja e rreth 54% e stokut të detyrimeve të prapambetura të akumuluar deri në Dhjetor 2020 për të gjitha bashkitë dhe qarqet. Për sa u përket detyrimeve të mbetura deri në Dhjetor 2020 sipas planit të mësipërm të shlyerjes për vitin 2020 janë raportuar si detyrime për bashkitë dhe qarqet rreth 7.05 miliard lekë. Nga të dhënat e pagesave të gjeneruara nga thesari rezultojnë se janë likuiduar detyrime të prapambetura në vlerë rreth 6.34 miliard lekë, me një diferencë prej rreth 0.71 miliard lekë të detyrimeve të konstatuara por të pa likuiduara sipas planit të shlyerjes.

A.2 Detyrimet e prapambetura të njërive të qeverisjes së përgjithshme qendrore

Sipas raportimit të kryer nga njësia përgjegjëse për monitorimin e risqeve të përgjithshme, publikuar në faqen zyrtare të MFE, situata deri në Dhjetor 2020 e stokut të detyrimeve për njësitë e qeverisjes së përgjithshme qendrore paraqitet si më poshtë:

Stoku i Detyrimeve Dhjetor 2020-Institucionet e Qeverisjes Qendrore


Në milion lekë

Institucioni	Ven.gjyq	Shërb	Mirëmb	Invest	Rim.TVSH	Mallra	Të tjera	Sig.shoq	Sig.Shënd	Të ardh.pers	Të tj	Total
MFE	994.1	419.4	0	573.8	8.8	0	82.6	0.5	0	0.2	0	2,079.4
MIE	1,470.5	1.9	244.3	207.3	14.3	0.5	0.6	0	0	0	0	1,939.5
MM	57.3	1.1	0	303.2	0	0	858.1	173.6	21.5	45	0	1,459.8
MB	667.5	2.9	0	56.4	0	0	1.6	4.4	0.2	1.5	0	734.4
MSHMS	208.9	32.4	13.5	11.2	2.3	67.4	143.7	0	0	0	0.1	479.5
MTM	78.9	0	0	20.1	0	0	0	0	0	0	0	99.1
MASR	5.2	0.3	0	30.5	0.3	0	0.7	0	0	0.1	0	37
PP	12.8	4.7	0.1	0	0	0	16.2	0	0	0	0	33.7
MK	0	0.1	0	13	0	0	19.2	0	0	0	0	32.2
FSHZH	0	0	0	31.5	0	0	0	0	0	0	0	31.5
Kuvend	15.4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	15.4
MD	0.4	0	0	14.1	0	0	0	0	0	0	0	14.6
Inst.tjera	6.7	0	0	3.2	0	0	0.1	0	0	0	0	10
Qev												
MBZHR	0.7	0.9	0	1.8	0	0	0.2	0	0	0	0	3.6
KLQJ	0	0	0	0	0	0	0	0	0.1	0	0	0.1
Presidenca	0	0.1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
TOTAL	3,518.4	463.9	258	1,266	25.8	67.9	1,122.9	178.5	21.7	46.8	0.1	6,969.9

Burimi: Raporti i MFE për detyrimet e prapambetura të gjeneruara nga sistemi SIFQ dhe DPT



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit bazuar në evidencat e MFE

Pra, vetëm 3 Ministritë (përkatësisht Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe Ministria e Mbrojtjes) përbëjnë rreth 78% të totalit të stokut të detyrimeve të prapambetura të njësive të qeverisjes qendrore.

Në udhëzimin për procedurat standarde të hartimit të PBA-së nr.7, datë 28.02.2018 përcaktohet se *“Detyrimet e prapambetura duhet të jenë pjesë e llogaritjeve të politikave ekzistuese, bazuar në planin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura të rënë dakord me ministrinë përgjegjëse për financat.”* Në këtë drejtim, **planifikimi buxhetor për një periudhë afatmesme parashikohet të trajtojë me prioritet likuidimin e detyrimeve** krahasuar me fondet që do të alokohen për projekte të reja. Ndryshe nga sa kërkuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë **nuk ka kërkuar nga njësitë e qeverisjes qendrore hartimin e një plani për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, me qëllim përfshirjen e tij në propozimet e PBA-së.** Hartimi në këtë formë i PBA-së do të mund të garantonte që fondet e kërkuara nga institucionet të kenë marrë në konsideratë fillimisht likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe detyrimet në kuadër të kontratave në zbatim, përpara financimit të projekteve të reja. Kjo edhe në zbatim të nenit 43 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, Ligjit për Buxhetin e vitit 2020, dhe Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 i cili në pikën 63 të tij përcakton prioritet për t'u mbajtur parasysh në planifikim, ku më hollësisht gjatë detajimit të planit të buxhetit, njësitë e qeverisjes qendrore më parë shpërndajnë fonde për të paguar detyrimet e prapambetura të viteve të kaluara për të gjitha llojet e shpenzimeve dhe se plani i investimeve i detajuar nga njësitë e qeverisjes qendrore në nivel projekti, mban parasysh këtë rradhë prioritare: a. Investimet në proces nga viti i kaluar; Objektet e investimeve të paraqitura në Kuvend, gjatë shqyrtimit të projektobuxhetit; Bashkëfinancimet e buxhetit të shtetit në projektet me financime të huaja; Investimet sipas prioriteteve sektoriale të miratuara në programin buxhetor afatmesëm. Një plan shlyerje shoqëruar me një plan veprimi në rang institucional nga ana e njësive të qeverisjes së përgjithshme, jo vetëm që do të ishte një indikator për matjen e iniciativave konkrete nga institucionet për shlyerjen e detyrimeve, por gjithashtu do të adresonte risqet e identifikuar gjatë këtij procesi me qëllim monitorimin e tyre për çdo vit buxhetor.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Kryerja e rishikimeve përgjatë vitit për alokimin e fondeve të cilat janë përdorur për likuidimin e detyrimeve të kontratave të lidhura në vitet e mëparshme, është një ndër treguesit që gjatë hartimit të projekt buxhetit, nuk janë marrë në konsideratë këto detyrime. Nga analizimi i të dhënave të rishikimeve për vitin 2020 u konstatuan 54 raste projekte investimi ku vlera e rishikimeve paraqitet rreth 2 miliard lekë dhe alokimi i fondeve shtesë është kryer për likuidimin e faturave të prapambetura (rreth 897 milion lekë) të këtyre projekteve, dhe këto projekte nuk ka qenë pjesë e projekteve të miratuara me ligjin vjetor të buxheti. Gjithashtu, relacioni i Aktit Normativ Nr.28 datë 02.07.2020 ÷Për disa ndryshime në Ligjin nr.88/2019 ÷Për buxhetin e vitit 2020, i ndryshuar dhe Akti Normativ nr. 34 datë 16.12.2020 i faktin mangësitë në fazën e çeljes së buxhetit, pasi në këto akte parashikohet alokimi i fondeve në masën totale 4.2 miliardë lekë për shpenzime shpronësimi dhe shlyerje detyrimesh të prapambetura në sektorin e infrastrukturës, të cilat nuk janë marrë në konsideratë në planin buxhetor fillestar të vitit 2020.

B. Diferencat e konstatuara në raportimin e detyrimeve të prapambetura

B.1 Raportimi i stokut të detyrimeve të prapambetura të njësisve të qeverisjes së përgjithshme dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore

Detyrimet e prapambetura deri në fund të vitit 2020 paraqiten në shumën 14,316,778 mijë lekë (v.2019: 17,371,031 mijë lekë) ose 17% më i ulët se një vit më parë. Të dhënat progresive të raportuara një vit më parë krahasuar me të dhënat progresive të raportuar të periudhës raportuese, si dhe detyrimi i mbetur në fund të vitit 2020 krahasuar me vitin 2019 rezultojnë si në vijim:

	Gjendja progresive të raportuara	Detyrimi i mbetur në fund të vitit raportues
Stoku progresiv 2019	40,963,096	17,371,031
Stoku progresiv 2020	53,398,641	14,316,777
Neto ndryshimi stokut 2020-2019	12,435,545	(3,054,254)

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit bazuar në evidencat e Drejtorisë së Thesarit në MFE

Megjithatë nga auditimi i KLSH në Drejtorinë e Thesarit është konstatuar se ky raportim rezulton jo i plotë dhe i saktë pasi konstatohen diferenca në balancën e fillimit të detyrimeve (data 31.12.2019) për shkak të regjistrimeve të kryera pas datës 08.07.2020; diferenca në pagesat e raportuara për likuidimin e tyre dhe shtesat përgjatë vitit. **Më hollësisht:**

-Vlera e detyrimeve në datën 31.12.2019 (raportuar edhe në Raportin për Zbatimin e Buxhetit në vitin 2019) paraqitej në shumën 17,279,441 mijë lekë deri në datën 08.07.2020, në një kohë ku në datën 14.04.2021 nga Drejtoria e Thesarit janë bërë regjistrime pas kësaj date, duke raportuar si detyrime 91,589 mijë lekë më tepër.

- Nga verifikimi i KLSH rezultojnë shtesa në detyrime të prapambetura përgjatë vitit 2020 në vlerën 12,435,625 mijë lekë.

- Sipas raportit të pagesave rezultojnë të jenë kryer pagesa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 15,188,571 mijë lekë, në një kohë ku sipas databazës së pagesave nga Thesari rezultojnë të jenë kryer pagesa në vlerë 14,518,078 mijë lekë , pra 670,493 mijë lekë më e vogël se pagesat sipas raportimit.

- Si rezultat, duke u nisur nga gjendja neto në datën 31.12.2019, duke përllogaritur shtesat dhe pakësimet, vlera e gjendjes neto të detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2020 e përllogaritur nga grupi i auditimit rezulton në shumën 14,618,085 mijë lekë, **me një diferencë prej 301,308 mijë lekë** nga raportimi i kryer nga thesari, i cili e përllogarit këtë vlerë si 14,316,777 mijë lekë. Kjo diferencë vjen për shkak se disa institucione nuk kanë raportuar detyrime të prapambetura në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Ilog 486, ose të dhënat e raportuara për pagesat nuk janë të njëjta me pagesat në sistemin e Thesarit.

-Janë konstatuar diferenca në masën rreth 670 milion lekë në deklarin nga njësitë për detyrimet òe paguara ò për detyrimet e prapambetura krahasuar kundrejt pagesave të kryera faktikisht në të dhënat e SIFQ gjatë vitit 2020 për shpenzime për investime dhe shërbime.

-Janë konstatuar pagesa për detyrime të prapambetura të kryera jashtë skemës së përcaktuar në udhëzimet përkatëse duke rezultuar me diferenca në raportim ku më hollësisht identifikohen 156 institucione kanë kryer pagesa por po nuk i kanë raportuar me diferencë 2,557,527 mijë lekë; 38 institucione që kanë raportuar 3,930,001 mijë lekë më pak se pagesat; 263 Institucione që kanë raportuar 7,158,022 mijë lekë më shumë se pagesat e kryera.

Në raportin e gjeneruar nga SIFQ raportohen detyrime të prapambetura vetëm për disa prej shoqërive UK. Akti normativ nr. 34 datë 16.12.2020 ka alokuar shtesën e fondeve në masën 420 milion lekë në zërin e subvencionit të ndërmarrjeve ujësjellës-kanalizimeve sh.a., me qëllim, shlyerjen në masën 100% të stokut të detyrimeve të prapambetura në zërin kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe në zërin tatimfitimi. Sipas observacioneve të DPB pas Akt konstatimeve sqarohet se në raportin përfundimtar nuk reflektohen detyrimet e prapambetura të institucioneve me vetëfinancim si UK, Universitete, detyrime me transferta të kushtëzuara. Këto veprime nuk janë të parashikuara në Udhëzimin nr.37, datë 06.10.2020.

Sipas Drejtorisë së Thesarit në MFE stoku i detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2020 paraqitet në shumën 14,316 milion lekë nga të cilat 7,104 milion lekë i përkasin njësive të qeverisjes qendrore dhe 7,212 milion lekë njësive të vetëqeverisjes vendore. Ndërkohë sipas përlllogaritjeve të KLSH, stoku i detyrimeve të prapambetura më datën 31.12.2020 paraqitet në vlerën 14,618 milion lekë. Nëse i referohemi raportit të publikuar në faqen zyrtare të MFE, në zbatim të udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2020 gjendja neto të detyrimeve të prapambetura në 31.12.2020 rezulton si më lartë në total 14,028.8 milion lekë. Si rezultat, konstatohet se të dhënat kanë **mos përputhje** si në përlllogaritjen e kryer nga Drejtoria e Thesarit, ashtu edhe në publikimin e të dhënave në lidhje me stokun e detyrimeve të prapambetura të vitit 2020 nga MFE. Më hollësisht:


Në mijë lekë

Institucionet	Detyrimet sipas Thesarit	Detyrimet sipas raportit të MFE	Detyrimet sipas përlllogaritjeve KLSH
Qendrore	7,104,881	6,969,916	7,088,562
Vendore	7,211,896	7,058,943	7,529,442
TOTAL	14,316,777	14,028,859	14,618,004

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit bazuar në evidencat e MFE



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit bazuar në evidencat e MFE

Referuar të dhënave të gjeneruara nga Drejtoria e Thesarit në MFE, në rang institucionesh, situata lidhur me detyrimet e prapambetura deri në fund të vitit 2020, duke evidentuar gjendjen fillestare, shtesat e pakësimet paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Institucioni	Gjendja e fillimit	Shtesa	Paguar	Detyrimet KLSH	Detyrimet kundrejt totalit të stokut
1 Presidencia	415		313	102	0%
2 Kuvendi	5,262	10,140		15,402	0%
5 Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	14,229	29,076	39,728	3,577	0%
6 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	5,036,232	2,890,080	5,881,248	2,045,064	14%
10 Ministria e Financave dhe Ekonomisë	407,967	2,305,921	639,688	2,074,199	14%
11 Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	113,235	144,267	191,773	65,729	0%
12 Ministria e Kulturës	33,613	264	1,640	32,237	0%
13 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	588,604	392,753	470,048	511,309	3%
14 Ministria e Drejtësisë	107,100	21,540	114,067	14,573	0%
16 Ministria e Brendshme	726,404	109,498	144,504	691,397	5%
17 Ministria e Mbrojtjes	1,140,999	1,282,413	963,630	1,459,781	10%
19 RTSH	50,000		50,000		0%
26 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	189,597	20,150	110,695	99,052	1%
28 Prokuroria e Përgjithshme	16,241	20,720	2,882	34,079	0%
29 Këshilli i Lartë Gjyqësor	240	9,268	9,373	136	0%
50 Dega e INSTAT Korçë		7	7		0%
56 Fondi Shqiptar i Zhvillimit		31,484		31,484	0%
87 Institucione te tjera Qeveritare		10,441		10,441	0%
0 Bashkitë dhe Qarqet	8,940,893	5,157,523	6,568,974	7,529,442	52%
Total	17,371,031	12,435,545	15,188,571	14,618,004	100%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit bazuar në evidencat e Drejtorisë së Thesarit në MFE

Për sa më sipër konstatohet se nga totali i detyrimeve të njëjësive të përgjithshme të qeverisjes qendrore, detyrimet e MIE dhe MFE përbëjnë respektivisht 14% të këtij totali, për t'atë ndjekur më



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

pas nga Ministria e Mbrojtjes me 10% të totalit të detyrimeve. Nëse analizojmë shtesat e detyrimeve, në këto institucione janë kryer edhe shtesat më të mëdha të detyrimeve të prapambetura.

Në tabelën e mëposhtme paraqesim diferencat në raportim të detyrimeve sipas Drejtorisë së Thesarit, Buxhetit dhe ato që rezultojnë sipas përlllogaritjeve të KLSH bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Thesarit.

Në mijë lekë

Kod i	Institucionet	Detyrimet sipas Thesarit	Detyrimet sipas raportit të MFE	Detyrimet sipas përlllogaritjeve KLSH
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	2,079,445	2,079,445	2,074,199
06	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	2,045,064	1,939,478	2,045,064
17	Ministria e Mbrojtjes	1,459,781	1,459,781	1,459,781
16	Ministria e Brendshme	734,376	734,376	691,397
13	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	480,080	479,537	511,309
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	99,052	99,052	99,052
11	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	65,729	37,050	65,729
28	Prokuroria e Përgjithshme	33,402	33,690	34,079
12	Ministria e Kulturës	32,237	32,237	32,237
56	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	31,484	31,484	31,484
02	Kuvendi	15,402	15,402	15,402
14	Ministria e Drejtësisë	14,573	14,573	14,573
87	Institucione të tjera Qeveritare	10,441	9,996	10,441
05	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	3,577	3,577	3,577
29	Këshilli i Lartë Gjyqësor	136	136	136
01	Presidenca	102	102	102
00	Bashki	7,211,896	7,058,944	7,529,442
Total		14,316,778	14,028,860	14,618,004

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit bazuar në evidencat e Drejtorisë së Thesarit në MFE

Diferencat mes raportimit në ëeb të detyrimeve të prapambetura nga raporti i MFE dhe ato të raportuara nga Thesari konsistojnë në institucionet: MIE, MSHMS, MASR, Prokuroria e Përgjithshme dhe grupi Institucioneve të tjera qeveritare, si më poshtë:

Në mijë lekë

Kodi	Institucionet	Detyrimet sipas Thesarit	Detyrimet sipas raportit të MFE	Diferenca
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	2,079,445	2,079,445	
06	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	2,045,064	1,939,478	105,586
17	Ministria e Mbrojtjes	1,459,781	1,459,781	
16	Ministria e Brendshme	734,376	734,376	
13	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	480,080	479,537	544
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	99,052	99,052	
11	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	65,729	37,050	28,679
28	Prokuroria e Përgjithshme	33,402	33,690	(288)
12	Ministria e Kulturës	32,237	32,237	
56	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	31,484	31,484	
02	Kuvendi	15,402	15,402	
14	Ministria e Drejtësisë	14,573	14,573	
87	Institucione të tjera Qeveritare	10,441	9,996	445
05	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	3,577	3,577	
29	Këshilli i Lartë Gjyqësor	136	136	
01	Presidenca	102	102	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

00	Bashki	7,211,896	7,058,944	152,953
TOTAL		14,316,778	14,028,860	287,918

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit bazuar në evidencat e Drejtorisë së Thesarit në MFE

Pra, në raportin e publikuar të MFE janë raportuar **589,226 mijë lekë** më pak detyrime me sa kanë rezultuar nga KLSH, dhe **287,918 mijë lekë** më pak me sa rezultojnë nga Thesari. Më hollësisht diferencat që konsistojnë sipas llojit të detyrimit paraqiten si më poshtë:

Në mijë lekë

Stoku	Vendime Gjyqësore	Shër bime	Mirëm bajtje	Inves time	Rimbursim i TVSH	Mallr a	Te tjera	Sigurime Shoqërore	Sigurime Shëndetësore	Te Ardhura Personale	Tatime te Tjera	Total
Publi kuar	4,332,704	1,182,451	505,216	5,035,960	27,538	314,598	2,320,560	209,537	24,560	67,281	8,449	14,028,859
Thesa ri	4,333,609	1,228,690	507,960	5,092,807	27,538	407,661	2,376,459	222,950	26,062	68,404	24,631	14,316,777
Dif	905	46,238	2,743	56,847	-	93,062,978	55,898	13,413	1,502	1,123	16,181	287,917

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit bazuar në evidencat e MFE

Në auditimet paralele të kryera nga KLSH në disa institucione si MFE (aparati), MSHMS, DPT, DPD, Ujësjiellësi Kurbin, etj, janë konstatuar problematika për shkak të mos raportimit të vlerës së plotë të detyrimeve që faktikisht ekzistojnë në këto pasqyra gjatë hartimit të pasqyrave financiare (kryesisht vendime gjyqësore të formës së prere), apo diferencave mes vlerës së detyrimeve në pasqyra me atë të raportuar në SIFQ.

B.2 Raportimi i stokut të detyrimeve të prapambetura nga rimbursimi i TVSH-së

Sipas të dhënave të thesarit llogaria 4864500, detyrimet e prapambetura për rimbursimin e TVSH-së paraqitet në vlerën rreth 29.3 milion lekë dhe përbëhet nga detyrimet e prapambetura të raportuara nga qendrori në vlerën 27.5 milion lekë dhe nga vendori në vlerën rreth 1.8 milion lekë. Në zbatim të udhëzimit nr.37, datë 06.10.2020 për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme, çështja III ÷Përgjegjësitë e strukturave përfshirëse për raportim dhe publikim, pika 5 parashikon se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të gjenerojë periodikisht dhe do të dërgojë të dhëna mbi stokun e detyrimeve të prapambetura nga rimbursimi i TVSH-së sipas Aneksit nr.1 të udhëzimit, për t'ja dërguar (duke mbajtur në korrespondenca Sekretarin e Përgjithshëm të MFE dhe Zv.Ministrin që mbulon fushën e tatimeve), Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Makroekonomike e Fiskale brenda 7 ditë përpara afatit për publikimin e tyre.

Drejtori i Rimbursimit të TVSH-së në DPT me email-i i datës 15 Janar ka përcjellë raportimi periodik që Drejtoria e Rimbursimit ka bërë në MFE, në zbatim të Udhëzimit nr.37 datë 06.10.2020 ÷Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme, mbi detyrimet e krijuara rishtazi dhe stokun e detyrimeve të prapambetura për periudhën deri në 31 Dhjetor 2020 ku ato paraqiten në vlerën rreth **9,797.3 milion lekë**. Këto detyrime, janë reflektuar këtë vit edhe në raportimin e MFE sipas udhëzimit nr. 37, dhe në vijim të rekomandimeve të lëna nga KLSH në vitet e mëparshme. Si rezultat vlera totale e stokut të detyrimeve të prapambetura raportuar nga MFE paraqitet në vlerën **23,826.2 milion lekë**:

Në milion lekë


Institucionet	Detyrimet e prapambetura 2020
Institucionet Qendrore	6.969,9



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË


Institucionet Vendore	7,058.9
Stoku i rimbursimit të TVSH	9,797.3
Total	23,825.2

Ecuria e totalit të detyrimeve të prapambetura përgjatë çdo 3 mujori të vitit 2020, duke përfshirë detyrimet e institucioneve qendrore, vendore dhe stokun e rimbursimit të TVSH-së paraqitet si më poshtë:



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MFE

Nëse i referohemi ecurisë së detyrimeve për secilin nëngrup, situata përgjatë vitit paraqitet si më poshtë:



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MFE

B.3 -Raportimi i stokut të detyrimeve të prapambetura nga vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit dhe Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ).

Në raportimin mbi detyrimet e prapambetura, nga ana e MFE nuk pasqyrohen informacione mbi detyrimet e prapambetura të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit dhe Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ).

Sipas raportit mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2020 hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për çështjet që lidhen me kompensimin e



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCIVE DHE EKONOMISË

pronave, vendimet e GJEDNJ janë identifikuar si me risk financiar për shkak të aftësisë dobët parashikuese dhe për këtë arsye nga ana e MFE është duke u konsideruar shlyerja me këste e këtyre detyrimeve duke negociuar me përfituesit, bazuar në buxhetin në dispozicion.

Më zbatim të ligjit për Avokaturën e Shtetit, ekzekutimi i shpërblimeve mbi 10 mijë Euro kryhet në bazë të VKM-së (ku për vitin 2020 janë ekzekutuar vendime në vlerë 30 mijë euro nga fondi rezervë i buxhetit); dhe për vendimet deri nën 10 mijë euro ato ekzekutohen nga MFE (ku sipas raportit për vitin 2020 nuk është ekzekutuar asnjë vendim i GJEDNJ nga MFE). Duke gjukuar se këto vendime mund të shoqërohen me efekte financiare për çdo ditë vonese nëse nuk likuidohen brenda 3 muajsh nga vendimi i formës së prerë, grupi i auditimit kërkoi informacion nëse përgjatë vitit 2020 janë përcjellë kërkesa nga ana e avokaturës së shtetit për këto vendime pranë Ministrisë së Financave, për të cilin sipas informacionit nga MFE, nuk ka patur asnjë vendim të përcjellë dhe të pa ekzekutuar.

Për sa u përket vendimeve të arbitrazhit, nga ana e ministrive të linjës janë likuiduar vendimet për ato raste ku ato kanë qenë palë e paditur, dhe për vendimet ku palë ka qenë qeveria apo shteti shqiptar ato janë likuiduar nga MFE. Më hollësisht sipas raportit vendimet e likuiduara gjatë vitit 2020:

Institucioni	Vlera e vendimit të paguar
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1.5 milion lekë
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	8.694 milion lekë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	23.1 milion lekë

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Grupi i auditimit kërkoi informacion nga MFE mbi vendimet e ekzekutuara dhe ato të pa ekzekutuar të vitit 2020 nga GJEDNJ dhe Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit, përcjellë si informacione për MFE nga Avokatura e Shtetit apo burime të tjera, ku u përcoll informacioni përkatës duke sqaruar se gjatë vitit 2020, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ka ardhur vetëm një vendim i GJEDNJ, përkatësisht vendimi datë 23.6.2020, për çështjen -Kasmi kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 1175/06. Lidhur me këtë vendim, Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM nr.1019 datë 16.12.2020 për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 23.06.2020, për çështjen -Kasmi kundër Shqipërisë, kërkesa nr.1175/06, me një vlerë totale prej 30.000 Euro (rreth 3.78 milion lekë), të cilat janë përballuar nga Fondi Rezervë i buxheti i shtetit, i miratuar për vitin 2020. Gjatë vitit 2020, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nuk ka ardhur dhe për pasojë nuk është ekzekutuar asnjë vendim i GJEDNJ-së, me vlerë përkatëse nën 10.000 Euro.

Në raportin e mes vitit të MFE, lidhur me detyrimin total të akumuluar për Arbitrazhet Ndërkombëtare është raportuar se ai rezultoi në rreth 109.5 milion EUR:

Tabela 1: Detyrime për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar (në EUR)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

MINISTRIA ELINJËS	Përshkrimi i Vendimeve të Arbitrazhit	Detyrimi mbetur
MIE	4.188.308,51 Euro dhe 3.183.263 lekë Arbitrazhi për çështjen me palë paditëse "J&P AVAX" S.A kundër ish Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (sot MIE)	4,214,402
	2.495.166 Euro detyrimi i MIE në favor të shoqërisë SAFA sh.p.k për projektin e ndërtimit të rrugës "Tiranë-Elbasan" + 876.940,02 Euro interes i shumësisë së dhënë nga gjykata + 171.231,86 Euro interes për tarifat e arbitrazhit	3,543,338
MFE (Shteti Shqiptar)	ICSID Case no ARB/17/6	1,000,000
	99.487.000 EUR dhe 111.579,989 EUR Arbitrazhi ICSID nr.ARB/15/28 oHydro dhe të tjerët kundër Shqipërisë	99,598,580
	Kosto administrative dhe ankimimi për Arbitrazhi ICSID nr.ARB/15/28 oHydro dhe të tjerët kundër Shqipërisë	311,413
	Porti i Karpen "HFW" LLC (Detyrim i përbashkët me MIE)*	217,563
MBZHR	TIA shpk (Detyrim i përbashkët me MIE)*	50,000
	750.000 EUR shpenzimet për avokatët dhe 19.500 euro kostot fillestare të arbitrazhit, Arbitrazhi për çështjen Valeria Italia S.r.l	550,000
Total		109,485,296

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë-Raporti i Mes vitit 2020

Në raportin vjetor të vitit 2020, nuk është paraqitur një analizë si ajo e mes vitit, por është raportuar se bazuar në informacionin që disponon Ministria e Financave dhe Ekonomisë, vlera totale e vendimeve të arbitrazhit të paguara nga buxheti i shtetit rezulton në masën rreth 33.3 milion lekë. Nga këto:

1.5 milion lekë, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (ARRSH), për likuidimin e faturave të shërbimeve juridike, për përfaqësimin dhe mbrojtjen në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar nr.23988/MHM.

8.694 milion lekë nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për pagesën e kostove administrative të Tribunalit për PCA Case 2018-49 'Valerial SRL'.

23.1 milion lekë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për pagesën e shërbimeve juridike dhe procesin e anulimit të vendimit të arbitrazhit ICSID Case no.ARB 15/28.

Në vijim të kërkesës për informacion lidhur me këto vendime, nga institucioni është raportuar se për vitin 2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk është njoftuar nga Avokatura e Shtetit mbi çështje të reja të Arbitrazhit Ndërkombëtar.

Megjithatë për sa kohë detyrimet e prapambetura të GJEDNJ dhe Arbitrazhit nuk raportohen në formatin e aneksit për raportimin e detyrimeve të prapambetura, në kundërshtim me Udhëzimin nr.5 datë 27/02/2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", nuk mund të japim siguri mbi detyrime të këtij grupi të papagura nga periudhat e mëparshme.

Në konkluzion konstatohet se raportimi aktual i vlerës totale të detyrimeve të prapambetura nuk është i plotë dhe i saktë për shkak të:

- Mungesës së raportimeve mbi detyrimet e prapambetura nga disa njësi të mëdha shpenzuese ku përmendim FSHZH, AKSHI-n, të cilat vijojnë të mos raportojnë;
- Mos përfshirjen e stokut të detyrimeve të prapambetura të Ujësjellës Kanalizimeve;
- Pamundësi për të evidentuar shtesat e kryera përgjatë vitit për të monitoruar respektimin e parimit FIFO;
- Klasifikim të detyrimeve sipas kohës së krijimit;
- Diferencave të konstatuara në stokun e fillim vitit për shkak të regjistrimeve të kryera pas kryerjes së sistemimeve finale për efekt raportimi;
- Diferencat në vetë deklarinimin e stokut për efekt regjistrimi në SIFQ me atë të njohur në pasqyrat financiare në njësi;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

- Diferencat në vlerën e stokut edhe në rang institucionesh, pa efekt në total;
- Pagesa të kryera jashtë skemës së likuidimit të detyrimeve të prapambetura;
- Mungesa e monitorimeve për të evidentuar se vlera e regjistruar në pasqyrat financiare të institucioneve reflekton stokun real dhe të plotë të detyrimeve të prapambetura;
- Mos reflektim i të gjithë detyrimeve të prapambetura.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr 8595/24, prot në MFE datë 23.08.2021 dhe në KLSH prot me shkresën nr. 514/12, datë 25.08.2021 “Observacion mbi Akt-Konstatimin nr.10, të paraqitur nga grupi i auditimit për Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit (DPB)” nga znj.M.Dh., X.A., A. K. dhe për dijeni z. O.M., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Lidhur me diferencat në raportimin e detyrimeve të prapambetura MFE ka hartuar udhëzimin nr.37, datë 06.10.2020 ku të dhënat gjenerohen automatikisht nga SIFQ për t’u konsoliduar më pas me ato të DPT mbi rimbursimin e TVSH, ku në zbatim të udhëzimit monitorimi bëhet me anë të sistemit SIFQ. Njësia përgjegjëse për monitorimin e risqeve buxhetore koordinon në vijimësi duke mbledhur të dhënat nga DPTH dhe DPT dhe përgatit një informacion të konsoliduar për Ministrinë. Duhet të kihet parasysh metodologjia e përdorur nga ana e këtij sektori për publikimin përfundimtar të stokut të detyrimeve të prapambetura. Në këtë raport nuk përfshihen UK dhe universitetet dhe detyrimet lidhur me transfertat e kushtëzuara të cilat janë përfshirë në detyrimet e ministrive përkatëse. Të dhënat për raportin e publikuar janë marrë nga raporti i përditësuar i DTH datë 01.03.2021. ë kuadër edhe të rekomandimeve të FMN, MFE po bën adoptimet e duhura që në regjistrin e detyrimeve të përfshihen edhe data e regjistrimit të detyrimeve për monitorimin e zbatimit të standartit FIFO.

Lidhur me konstatimin për mos kërkesën e planit për shlyerje e detyrimeve në PBA, shkrehemi se kjo është përcaktuar qartë në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008.

Lidhur me raportimin e vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit MFE ka përcjellë informacion në vijim të kërkesës së email-it atë 22.07.2021 mbi vendimet e ekzekutuara dhe të pa ekzekutuara të vitit 2020. Në mënyrë periodike kërkohet dhe merret informacion nga Avokatura e Shtetit lidhur me këtë çështje në raportet vjetore dhe mes vitit të zbatimit të buxhetit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Për sa i përket diferencave në raportimin e detyrimeve të prapambetura, në udhëzimin e ri nr.37, datë 06.10.2020 është parashikuar qartë metodologjia që do të ndiqet për efekt raportimi, sipas së cilës njësia e monitorimit të risqeve (sektor pjesë e Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit) mbledh të dhënat e përcjella nga DPTH dhe DPT dhe përgatit informacionin e konsoliduar sipas aneksit nr. 1 të udhëzimit, duke mos parashikuar këtu një metodologji shtesë të këtij sektori për të kryer sistemime të mëtejshme në vijim të të dhënave që janë përcjellë nga DPTH, shtuar këtu edhe faktin se rregullorja e rishikuar e MFE nuk ka parashikuar misionin, detyrat edhe përgjegjësitë e këtij sektori. Gjithashtu, lidhur me raportimin e kryer nga DPTH versioni i përcjellë në e-mail për grupin e auditimit nga kjo drejtori është ai paraprak i datës 05.02.2021, pasi versioni final nuk u përcoll për grupin e auditimit. Megjithatë, versioni i trajtuar në këtë auditim është ai i vendosur në dispozicion për grupin e auditimit në DPTH sipas programit të auditimit nr. 177/1, 12.02.2021, i cili është përcjellë si versioni final i stokut të detyrimeve të prapambetura, pjesë e këtij projektraporti.

Për sa i përket mungesës së planit të shlyerjes në propozimin e PBA-së për rastin e njësive qendrore në dallim me ato vendore për shkak se ky kriter është përcaktuar qartë në ligjin nr. 9936,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

datë 26.06.2008, sqarojmë se ky kriter është i vlefshëm edhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore për të cilat nga ana e MFE është kërkuar një plan i tillë për tu bërë pjesë e dokumentit të PBA. Gjithashtu, ky konstatim i grupit vjen edhe në vijim të problematikave në auditimet e KLSH-së ku ka rezultuar se nuk është respektuar radha e angazhimeve në buxhetin e vitit pasardhës. Lidhur me vendimet e arbitrazhit dhe GJEDNj, informacioni i përcjellë nga MFE është reflektuar në material.

Për sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet e tyre ngarkohen me përgjegjësi NA dhe NZ e institucioneve trajtuar më sipër që nuk kanë parashikuar likuidimin e detyrimeve të prapambetura përpara ndërmarrjes së angazhimeve të reja gjatë detajimit të planit buxhetor, dhe strukturat drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit që nuk kanë rezultuar efektive për monitorimin e tyre.

Gjetja:	Problematika të konstatuara mbi saktësinë dhe plotësinë e raportimit të stokut të detyrimeve të prapambetura
Situata:	<p>Stoku i detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2020 sipas raportit të MFE për njësitë e qeverisjes qendrore dhe ato të vetëqeverisjes vendore paraqiten në shumën rreth 14,316,777 mijë lekë (në vitin 2019 paraqitej në 17,371,031 mijë lekë) ose 17% më pak se një vit më parë.</p> <p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë në zbatim të udhëzimit nr. 2, datë 20.01.2020, òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020ò, kapitulli III òRaportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes qendroreò dhe në drejtim të monitorimit dhe raportimit të detyrimeve të prapambetura, përgatit raportin e konsoliduar të këtyre detyrimeve çdo tre muaj bazuar në raportimet e njësisve të qeverisjes së përgjithshme. Ky raportim është konkretizuar më pas në Udhëzimin nr.37, datë 06.10.2020 për òMonitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshmeò, i cili ka ndryshuar edhe metodologjinë e raportimit për shkak se deri në Shtator 2020 raportimi kryhej në bazë të vetëdeklarimit të njësisve duke përfshirë vetëm ministritë e linjës dhe njësitë e vendore në zbatim të VKM-së nr.50, datë 05.02.2014 òPër miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimitò, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 5 datë 27.02.2014 òPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò. Udhëzimi i ri ka synuar një raportim në nivel qeverisjeje të përgjithshme ku të dhënat mbi detyrimet e prapambetura do të gjenerohen automatikisht nga moduli përkatës në SIFQ, për t'u konsoliduar më pas me raportimin nga DPT për stokun e rimbursimit të TVSH dhe më pas njësisia përgjegjëse për monitorimin e risqeve buxhetore koordinon në vijimësi dhe periodikisht këtë proces duke mbledhur të dhënat e detyrimeve të prapambetura të dërguara nga DPTH dhe DPT për të përgatitur informacionin e konsoliduar për Ministrin.</p> <p>Megjithatë, kjo metodologji e rishikuar ka arritur të përmirësojë raportimin vetëm për sa i përket pakësisimit të stokut të detyrimeve të prapambetura për shkak se tanimë ato gjenerohen automatikisht nga SIFQ dhe jo në bazë të vetëdeklarimit, por ajo nuk mundëson verifikimin e detyrimeve të prapambetura sipas kohës së krijimit të tyre; shmangien e diferencave mes stokut së deklaruar të detyrimeve dhe atë të pasqyrave financiare; apo pagesave të kryera jashtë skemës për likuidimin e</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

detyrimeve të prapambetura.

9.2 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se pavarësisht procedurave të hollësishme të udhëzimit të ri për konsolidimin dhe raportimin e detyrimeve e prapambetura, të dhënat e raportuara nga MFE paraqiten **me diferenca** krahasuar me të dhënat që rezultojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në MFE, ashtu edhe me të dhënat që rezultojnë nga auditimi i KLSH-së pranë kësaj drejtorie.¹⁶ Disa nga shkaqet mund të jetë se informacioni final dhe i konsoliduar i stokut për periudhën Janar-Dhjetor publikohet brenda datës 1 Shkurt si version paraprak, ndërsa versioni final brenda muajit Maj dhe diferenca mund të jetë ndikuar nga afati kohor kur është bërë ky raportim, pra nëse informacioni i raportuar nga MFE është bazuar në të dhënat paraprake të Drejtorisë së Thesarit apo atë përfundimtar; ose kryerja e veprimeve sistemuese nga DTh pasi ato janë përcjellë në DPB.

Në raportin e gjeneruar nga SIFQ raportohen detyrime të prapambetura vetëm për disa prej shoqërive UK. Akti normativ nr. 34 datë 16.12.2020 ka alokuar shtesën e fondeve në masën 420 milion lekë në zërin e subvencionit të ndërmarrjeve ujësjellës-kanalizimeve sh.a., me qëllim, shlyerjen në masën 100% të stokut të detyrimeve të prapambetura në zërin kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe në zërin tatimfitimi. Sipas observacioneve të DPB pas Akt konstatimeve sqarohet se në raportin përfundimtar nuk reflektohen detyrimet e prapambetura të institucioneve me vetëfinancim si UK, Universitete, detyrime me transferta të kushtëzuara. Këto veprime nuk janë të parashikuara në Udhëzimin nr.37, datë 06.10.2020.

Nga auditimi i KLSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit është konstatuar se detyrimet e prapambetura sipas përlllogaritjes së grupit paraqiten rreth 14,618,004 mijë lekë me një diferencë prej 301,308 mijë lekë nga raportimi i kryer nga thesari, për shkak të diferencave në balancën e fillimit të detyrimeve në vijim të regjistrimeve të kryera pas datës 08.07.2020; diferencave në pagesat e raportuara për likuidimin e tyre dhe shtesave përgjatë vitit. Ndërkohë edhe raportimi i kryer nga thesari paraqitet me diferencë prej rreth 287,918 mijë lekë me vlerën e stokut të raportuar nga MFE. Konkretisht:

Në mijë lekë

Institucionet	Detyrimet sipas Thesarit	Detyrimet sipas raportit të MFE	Detyrimet sipas përlllogaritjeve KLSH
Qendrore	7,104,881	6,969,916	7,088,562
Vendore	7,211,896	7,058,943	7,529,442
TOTAL	14,316,777	14,028,859	14,618,004

Nga totali i detyrimeve të njërive të përgjithshme të qeverisjes qendrore, detyrimet e MIE dhe MFE përbëjnë respektivisht 14% të këtij totali, për t'u ndjekur më pas nga Ministria e Mbrojtjes me 10% të totalit të detyrimeve. Ndërsa, nga totali i stokut të detyrimeve të prapambetura të njërive të vetëqeverisjes vendore, vetëm 8 bashki (përkatesisht Bashkia Tiranë, Kavajë, Vorë, Pogradec, Lezhë, Roskovec, Kamëz dhe Vlorë) përbëjnë 52% të këtij totali. Diferencat në stokun e detyrimeve të prapambetura sipas strukturës së tij paraqiten si me poshtë:

¹⁶ Programi i auditimit nr. 177/1, 12.02.2021



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

Në milion lekë

Stoku	Ven d. Gjy q.	Shër b	Mirm b	Inv	Rim b TVS H	Mall ra	Te tjera	Sig. Sho q	Sig. Shën d	Te Ardh. Pers	Tatim e te Tjera	Tota l
Rapoti MFE	4,33 3	1,18 3	505	5,03 6	28	315	2,320	209	24	67	8	14,02 8
Thesari	4,33 4	1,22 9	508	5,09 3	28	408	2,376	222	26	68	24	14,31 6

Pjesën më të madhe të stokut e përbëjnë detyrime si rezultat i investimeve (36%), për t'u ndjekur më pas me vendimet gjyqësore për kthimin në punë të ish-punonjësve (31%), dhe më pas shpenzime të tjera (17%).

Në zbatim të Udhëzimit nr.37 datë 06.10.2020, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në DPT ka përcjellë informacion mbi stokun e rimbursimit, i cili paraqitet në vlerën rreth **9,797 milion lekë**, dhe zbatim të rekomandimeve të KLSH në auditimet e mëparshme këto detyrime janë përfshirë këtë vit në raportimin e MFE duke e çuar **vlerën totale të stokut të detyrimeve të prapambetura raportuar nga MFE në rreth 23,826 milion lekë**.

Për sa i përket detyrimeve të prapambetura si rezultat i vendimeve të miratuara për pagesë por të pa likuiduara të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit dhe Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ), sipas informacionit të MFE nuk ka patur asnjë rast të tillë për periudhën objekt auditimi, megjithatë për sa kohë këto detyrime nuk raportohen në formatin e aneksit për raportimin e detyrimeve të prapambetura, në kundërshtim me Udhëzimin nr.5 datë 27/02/2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", nuk mund të japim siguri mbi detyrime të këtij grupi të papagura nga periudhat e mëparshme.

Në auditimet paralele të kryera nga KLSH në disa institucione si MFE (aparati), MSHMS, DPT, DPD, Ujësjiellësi Kurbin, etj, janë konstatuar problematika për shkak të mos raportimit të vlerës së plotë të detyrimeve që faktikisht ekzistojnë në këto pasqyra gjatë hartimit të pasqyrave financiare (kryesisht vendime gjyqësore të formës së prere), apo diferencave mes vlerës së detyrimeve në pasqyra me atë të raportuar në SIFQ.

Në konkluzion konstatohet se raportimi aktual i vlerës totale të detyrimeve të prapambetura nuk është i plotë dhe i saktë për shkak të: Mungesës së raportimeve mbi detyrimet e prapambetura nga disa njësi të mëdha shpenzuese ku përmendim FSHZH, AKSHI-n, të cilat vijojnë të mos raportojnë; Mos përfshirjen e stokut të detyrimeve të prapambetura të Ujësjiellës Kanalizimeve; Pamundësi për të evidentuar shtesat e kryera përgjatë vitit për të monitoruar respektimin e parimit FIFO; Klasifikim të detyrimeve sipas kohës së krijimit; Diferencave të konstatuara në stokun e fillim vitit për shkak të regjistrimeve të kryera pas kryerjes së sistemeve finale për efekt raportimi; Diferencat në vetë deklarin e stokut për efekt regjistrimi në SIFQ me atë të njohur në pasqyrat financiare në njësi; Diferencat në vlerën e stokut edhe në rang institucionesh, pa efekt në total; -Pagesa të kryera jashtë skemës së likuidimit të detyrimeve të prapambetura; -Mungesa e monitorimeve për të evidentuar se vlera e regjistruar në pasqyrat financiare të institucioneve reflekton stokun real dhe të plotë të detyrimeve të prapambetura; Mos reflektim i të gjithë detyrimeve të prapambetura.

Kriteri: Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

	e Shqipërisë, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 2, datë 20.01.2020, ÷Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020; Udhëzimi nr.37, datë 06.10.2020 për ÷Monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme; Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme; Udhëzimit nr. 46, datë 24.12.2020 ÷Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2020
Impakti:	Pasaktësi në raportimin e stokut të detyrimeve të prapambetura mes Drejtorive të MFE;
Shkaku:	Përlllogaritja e detyrimeve në bazë të vetë deklaramit; rikrijimi i detyrimeve të prapambetura, pra shtesa e detyrimeve është më e lartë se niveli i pakësimit; metodologjia aktuale e raportimit të detyrimeve nuk parashikon raportimin e borxhit sipas krijimit të tij, shtesave përgjatë vitit dhe monitorimi aktual nuk përjashton riskun e mos ekzistencës së diferencave mes vlerës së raportuar të detyrimeve dhe atë të pasqyrave financiare; apo kryerjen e pagesave për likuidimin e detyrimeve jashtë skemës së parashikuar për këtë proces.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	- NPA dhe strukturat përgjegjëse pranë MFE të marrin masat për kryerjen e sondazheve periodike tek ministritë e linjës, nëse ekzistojnë detyrime financiare të krijuara rishtas dhe të papaguara në kohë për të përcaktuar pagesat e reja të kërkueshme, që rrjedhin nga faturat ose pretendimet e marra përtej fondeve në dispozicion duke përcaktuar përgjegjësinë dhe vendosur masa administrative sipas kuadrit ligjor në fuqi. -Pas miratimit të pasqyrave financiare të shqyrtohet mundësia e zhvillimit të rakordimeve me ministritë e linjës me angazhimet që ato kanë marrë për të konfirmuar vlerën e detyrimeve të prapambetura të institucioneve, më qëllim raportimin sa më të plotë dhe të saktë të stokut të detyrimeve në raportimet e konsoliduara të MFE.

Gjetje	Mangësi të konstatuara në drejtim të monitorimit të stokut të detyrimeve të prapambetura
Situata:	Nga auditimi u konstatua se monitorimi aktual i stokut të detyrimeve të prapambetura i kryer nga Ministria e Financave nuk mundëson përputhshmërinë e plotë me Udhëzimin nr.5, datë 27.02.2014 ÷Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, konkretisht pikën 31 të tij, e cila parashikon ndër të tjera hartimin e një informacioni duke përfshirë <i>gjendjen fillestare të detyrimeve sipas kategorive, sektorëve dhe kohës së krijimit dhe zhvillimin e një sondazh tremujor tek ministritë e linjës nga MFE për të verifikuar detyrimet financiare të krijuara rishtas dhe të papaguara në kohë, duke përcaktuar përgjegjësinë dhe vendosur masa administrative sipas kuadrit ligjor në fuqi</i> . Në kushtet kur MFE, nuk ka shfuqizuar udhëzimin e vitit 2014, në udhëzimin e ri të vitit 2020 nuk ka parashikuar procedura të ngjashme monitoruese, por ka rregulluar procesin e raportimit të informacionit mbi këto detyrime nëpërmjet sistemit të thesarit dhe DPT, por pa mundur të përmirësojë raportimin e detyrimeve të reja të prapambetura, ky mbetet sërisht një proces vetëdeklarues i cili nuk siguron protësinë dhe saktësinë e stokut të detyrimeve të prapambetura.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

- Nga auditimi konstatohet se **nuk ka një plan veprimi** të miratuar për ndërmarrjen e iniciativave në drejtim të menaxhimit të detyrimeve të prapambetura dhe një plani konkret për likuidimin e tyre. Në këto kushte nuk mund të kryhet një raportim në bazë të objektivave të paracaktuara për të monitoruar kështu rritjen/pakësimin e stokut apo krijimit rishtaz të detyrimeve të prapambetura nga ana e njësive publike. Një plan shlyerje në zbatim të radhës së prioriteteve në zbatim të nenit 43 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 oPër menaxhimit e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, Ligjit për Buxhetin e vitit 2020, dhe pikën 63 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, shoqëruar me një plan veprimi në rang institucional nga ana e njësive të qeverisjes së përgjithshme, jo vetëm që do të ishte një indikator për matjen e iniciativave konkrete nga institucionet për shlyerjen e detyrimeve, por gjithashtu do të adresonte risqet e identifikuar gjatë këtij procesi me qëllim monitorimin e tyre për çdo vit buxhetor. Udhëzimi plotësues nr.27, datë 10.07.2020 oPër përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023, ndër të tjera ka përcaktuar se në hartimin e tavaneve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023, njësitë e vetëqeverisjes duhet të përfshijnë edhe planin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura. Në zbatim të saj, njësitë vendore kanë përcjellë informacion lidhur me detyrimin e mbetur deri në muajin Dhjetor 2020 duke hartuar edhe planin e shlyerjes së stokut të detyrimeve për tre vitet në vazhdim 2021-2023. Megjithatë, ndryshe nga sa kërkuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka kërkuar nga njësitë e qeverisjes qendrore hartimin e një plani për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, me qëllim përfshirjen e tij në propozimet e PBA-së. Hartimi në këtë formë i PBA-së do të mund të garantonte që fondet e kërkuara nga institucionet të kenë marrë në konsideratë fillimisht likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe detyrimet në kuadër të kontratave në zbatim, përpara financimit të projekteve të reja në zbatim të nenit 43 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 oPër menaxhimit e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, Ligjit për Buxhetin e vitit 2020, dhe Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 i cili në pikën 63 të tij përcakton prioritet për t'u mbajtur parasysh në planifikim.

- Nga auditimi paralel nga KLSH në Drejtorinë e Përgjithshme Thesarit sipas programit të auditimit nr. 177/1, 12.02.2021 për periudhën objekt auditimi vitin 2020, janë konstatuar një sërë problematikash lidhur me **disiplinimin e angazhimeve buxhetore dhe parandalimit të krijimit të detyrimeve të prapambetura nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme**. Më hollësisht janë konstatuar 550 nga 743 urdhër-prokurime me datë kontrate përpara datës së regjistrimit të urdhër-prokurimit; 7 raste me vlerë fondi limit 4.27 miliard lekë, ku janë marrë angazhime për projekte pa kaluar në procesin ligjor të miratimit në PBA; 13 procedura të zhvilluara pas datës 15 tetor pa qenë pjesë e buxhetit tre vjeçar, me vlerë fondi limit 2.85 miliard lekë; 14982 kontrata ose 63% e totalit të kontratave të regjistruara me vlerë 131.5 miliard lekë janë regjistruar në shkëlqje të afatit 5 ditor; mos respektim i radhës së pagesave (parimi FIFO); 32927 fatura me vlerë 45.4 miliard lekë të dorëzuara në Thesar jashtë afatit 30 ditor; 66 raste me vlerë 122 milion lekë të tejkalimit të afatit 30 ditor të procesimit dhe ekzekutimit të pagesave; 79 raste të regjistrimit dhe pagesave



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

	<p>pjesore të faturave. Nga auditimi për vitin 2020 u konstatuan 54 raste projekte investimi ku vlera e rishikimeve paraqitet rreth 2 miliard lekë dhe alokimi i fondeve shtesë është kryer <u>për likuidimin e faturave të prapambetura (rreth 897 milion lekë) të këtyre projekteve, dhe këto projekte nuk ka qenë pjesë e projekteve të miratuara me ligjin vjetor të buxheti.</u> Gjithashtu, relacioni i Aktit Normativ Nr.28 datë 02.07.2020 òPër disa ndryshime në Ligjin nr.88/2019 òPër buxhetin e vitit 2020, i ndryshuar dhe Akti Normativ nr. 34 datë 16.12.2020 i faktin mangësitë në fazën e çeljes së buxhetit, pasi në këto akte parashikohet alokimi i fondeve në masën totale 4.2 miliardë lekë për shpenzime shpronësimi dhe shlyerje detyrimesh të prapambetura në sektorin e infrastrukturës, të cilat rezultojnë se nuk janë marrë në konsideratë në planin buxhetor fillestar të vitit 2020. Kryerja e rishikimeve përgjatë vitit për alokimin e fondeve të cilat janë përdorur për likuidimin e detyrimeve të kontratave të lidhura në vitet e mëparshme, është një ndër treguesit që gjatë hartimit të projekt buxhetit, nuk janë marrë në konsideratë këto detyrime. Këto situata konstatohen si me impakt negativ për krijimin e detyrimeve të prapambetura dhe nuk kanë garantuar parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja të prapambetura, për shkak të cënimit të kontrolleve për marrjen e angazhimeve buxhetore pa fonde disponibël, apo për marrjen e masave për reduktimin e këtij stoku.</p> <p>Sipas raportit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik për vitin 2020, vetëm 64 njësi shpenzuese kanë përcjellë pranë Drejtorisë së Harmonizimit informacion mbi kryerjen e auditimeve të detyrimeve të prapambetura nga njësitë e AB të tyre, duke reflektuar kështu një rol pasiv të këtyre njësive për sa kohë që detyrimet e prapambetura janë përcaktuar si fushë me risk të lartë dhe duhet të trajtohen me përparësi nga auditimi i brendshëm, për të paraqitur gjendjen aktuale dhe për të dhënë rekomandime sa më të vlefshme për shlyerjen e tyre në afate të përcaktuara.</p>
Kriteri:	Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 òPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; VKM nr. 50 datë 05.02.2014 òPër miratimin e Strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit, Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, Udhëzimit nr.5, datë 27.02.2014 òPër shlyerjen e detyrimeve të prapambetura; Udhëzimi nr. 2, datë 20.01.2020, òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020 i ndryshuar, Udhëzimi nr.9 datë 20.07.2018 òPër Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit, Udhëzimi nr.37, datë 06.10.2020 për òMonitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme, Udhëzimi nr. 46, datë 24.12.2020 òPër procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2020.
Impakti:	Krijim i detyrimeve të prapambetura rishtaz, Kryerje të rishikimeve të fondeve buxhetore për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, për shkak të mos marrjes në konsideratë të tyre në miratimin e detajimit të projekteve në çelje.
Shkaku:	Shkelje e disiplinimit të angazhimeve buxhetore dhe parandalimit të krijimit të detyrimeve të prapambetura nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme; mangësitë e identifikuar në monitorimin aktual të kryer nga MFE për këto detyrime;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE
EKONOMISË

	mungesa e një plani veprimi dhe shlyerje.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	<p>-Drejtorja e Përgjithshme e Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit të marrin masat për implementimin e kontrolleve shtesë për të shmangur në të ardhmen diferencat mes tyre në përlllogaritjet e stokut të detyrimeve të prapambetura, duke mundësuar verifikimin e detyrimeve të prapambetura sipas kohës së krijimit të tyre apo shtesave përgjatë vitit me qëllim kryerjen e një raportimi sa më të saktë dhe të plotë të tyre në materialin përfundimtar të përgatitur dhe publikuar nga njësi përgjegjëse për monitorimin e risqeve të përgjithshme në MFE.</p> <p>-DPB të marrë masat që raporti final i detyrimeve të prapambetura të reflektojë stokun real e gjithëpërfshirës të sistemit të qeverisjes së përgjithshme duke përfshirë këtu edhe institucione si FSHZH, AKSHI, Ujësjetllës Kanalizimeve, etj.</p> <p>-MFE të parashikojë procedura shtesë kontrolli për të monitoruar raportimin aktual të detyrimeve të prapambetura për të shmangur si diferencat mes vlerës së raportuar të detyrimeve me atë të pasqyrave financiare, ashtu edhe mes vlerës së njohur në pasqyrat financiare dhe atë që faktikisht duhet të ishte regjistruar, ku përmendim vendimet gjyqësore me risk të lartë për këtë fenomen.</p>

11. Zbatimi i rekomandimeve të vitit të mëparshëm

Në zbatim të programit të auditimit nr.514/1 Prot., datë 15.04.2021 për periudhën 01.01.2020 ó 31.12.2020, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1.Vendimi i Kryetarit të KLSH, Nr.111 datë 29.10.2020, për miratimin e Raportit Përfundimtar, Opinionit dhe rekomandimeve të lëna në auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit òMbi përputhshmërinë për periudhën nga 01.01.2019-31.12.2019.
2. Vendimi i Kryetarit të KLSH, nr.110 datë 29.10.2020 për miratimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit, Opinionit dhe rekomandimeve në auditimin e ushtuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë òMbi Zbatimin e Buxhetit të vitit 2019ò.
3. Shkresa òPlani i masave për zbatimin e rekomandimeveò dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
4. Shkresa òRaportim mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSHò dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, neni 15 Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, pika òjò cituar: *òtë vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës”,* Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vijim të përcjelljes së raportit përfundimtar të auditimit dhe rekomandimeve me shkresën nr.350/7 datë 30.10.2020 ka dërguar në KLSH planin e masave për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. prot. 6369/17 datë 27.11.2020 administruar në KLSH me nr. prot. 458/10 datë 14.12.2020 në tejkalim të afatit 20 ditor të parashikuar në ligj.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

Në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, neni 30 Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2 e tij cituar: “*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*”, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar në KLSH raportimin mbi zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. prot. 786 datë 30.04.2021 administruar në KLSH me nr. Prot. 559 datë 17.05.2021.

Theksojmë se në këto shkresa janë përfshirë raportimet për rekomandimet e lëna në auditimin e kryer në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në dy programe auditimi, përkatësisht: nr. prot 349/1 datë 12.05.2021, i ndryshuar dhe nr. prot 350/1 datë 12.05.2021.

Në lidhje me zbatueshmërinë e rekomandimeve:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se në auditimin e kryer sipas programit nr.349/1 datë 12.05.2020, i ndryshuar janë lënë gjithsej **13 rekomandime nga të cilat:**

7 masa organizative nga të cilat: Pranuar 4; pranuar pjesërisht 2; pa pranuar 1

4 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike (3E) nga të cilat:

Pa përgjigje 3; pa pranuar 1

1 masë administrative pa përgjigje

1 masë disiplinore pa përgjigje

Shkalla e pranimit të rekomandimeve nga subjekti: 85% duke konsideruar si të pranuar rekomandimet pa përgjigje.

Statusi i zbatimit të rekomandimeve rezulton si më poshtë:

7 masa organizative nga të cilat:

Pranuar 4 masa: janë zbatuar plotësisht 2 masa, janë zbatuar pjesërisht 2 masa dhe 1 masë është e pazbatuar

Pranuar pjesërisht 2 masa: zbatuar pjesërisht 1 masë.

Pa pranuar 1 masë, pa zbatuar 1 masë.

4 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike (3E) nga të cilat:

Pa përgjigje 3 dhe pa pranuar 1: rezultojnë 4 masa pazbatuar.

1 masë administrative pa përgjigje, pa zbatuar

1 masë disiplinore pa përgjigje, pa zbatuar

Pra nga 13 masa të lëna në gjithsej rezultojnë të zbatuara plotësisht vetëm 2 masa dhe zbatuar pjesërisht 2 masa.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se në auditimin e kryer sipas programit nr.350/1 datë 12.05.2020, janë lënë gjithsej **12 rekomandime nga të cilat:**

8 masa organizative nga të cilat:

Pranuar pjesërisht 2; pa pranuar 3; pa përgjigje 3

2 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike (3E) nga të cilat:

Pranuar 1; pa përgjigje 1

1 masë administrative pa përgjigje

1 masë disiplinore pa përgjigje

Shkalla e pranimit të rekomandimeve nga subjekti: 75% duke konsideruar si të pranuar rekomandimet pa përgjigje.

Statusi i zbatimit të rekomandimeve rezulton si më poshtë:

8 masa organizative nga të cilat:

Pranuar pjesërisht 2 masa: janë zbatuar pjesërisht 2 masa



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Pa pranuar 3 masë, pa zbatuar 3 masë.

Pa përgjigje 3 masa, pa zbatuar 3 masa

2 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike (3E) nga të cilat:

Pranuar 1 masë: zbatuar pjesërisht 1 masë

Pa përgjigje 1 masë: pa zbatuar 1 masë

1 masë administrative pa përgjigje, pa zbatuar

1 masë disiplinore pa përgjigje, pa zbatuar

Pra nga 12 masa të lëna në gjithsej rezultojnë të zbatuara plotësisht vetëm 3 masë zbatuar pjesërisht.

Më hollësisht, rekomandimet **sipas programit nr. 349 datë 12.05.2020**, dhe statusi i tyre i pranimit dhe zbatimit paraqitet si vijon:

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, si përgjegjëse për hartimin e Planit Buxhetor Afatmesëm (PBA), duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për:

a. Përgatitjen e Tavanëve Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm për fazën strategjike, të Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal (KMF), përgatitjen e dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, të Tavanëve Përfundimtarë të shpenzimeve të PBA 2019-2021 (faza teknike) për periudhën 2019-2021, të përgatitjes së Projektbuxhetit të vitit 2019, si dhe të dokumentit të rishikuar të PBA-së 2019 brenda kohës së përcaktuar në kalendarin e miratuar, tavanet përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm, duke përgjegjësuar për vonesat strukturat që ndikojnë në përgatitjen e tyre.

b. Ministria e Financës dhe Ekonomisë jo vetëm ti drejtohet Shkollës Shqiptare të Administratës Publike për hartimin e kurikulës dhe trajnimeve në lidhje me hartimin e dokumentit të PBA, por edhe të ketë të evidentuar me prova pjesëmarrjen dhe temat në këto trajnime.

c. Për mbështetjen e Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike, në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), në tryezën e konsultimit me fokus rritjen e transparencës dhe gjithë përfshirjes në përparësitë e Programeve Buxhetore Afatmesme, të marrin pjesë sa më shumë institucione e të jenë të evidentuara në raportin e këtyre takimeve të gjitha shqetësimet dhe diskutimet e pjesëmarrësve dhe jo vetëm një përmbledhje e drejtimeve kryesore të prioriteteve në arsim, në çështjet sociale, në shëndetësi dhe bujqësi, në mënyrë që të përcaktohen qartë se nga vijnë ndryshimet në zërat gjatë përgatitjes dhe aprovimit të fazave të PBA.

d. Përgatitja e kërkesave shtesë për Programin Buxhetor Afatmesëm për çdo institucion të përmbledhura (kërkesat për financimin e Politikave Ekzistuese dhe Politikave të Reja mbi tavanin) të jetë i barabartë me shumën e shtesave (politikat ekzistuese plus shtesat për politikat e reja), e sidomos tek zëri i investimeve, për të treguar se përgatitja e PBA dhe evidentimi i kërkesave të institucioneve të bëhet me përgjegjësi si nga institucionet buxhetore dhe nga strukturat që i përmbledhin ato.

e. Miratimi dhe publikimi i programit buxhetor afat mesëm të rishikuar në faqen zyrtare të MFE, *të bëhet i plotë e për të gjitha institucionet*, me përmbledhësen e të gjitha institucioneve dhe shumat e tyre me artikuj dhe me programe.

f. Ministria e Financave dhe Ekonomisë/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit si përgjegjëse për hartimin e dokumentit të Planit Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe buxhetit vjetor duhet të marrë të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

gjitha masat e nevojshme që analizat e të gjitha institucioneve për hartimin e tyre të jenë efikase, në mënyrë që mangësitë të mos përsëriten vit pas viti, duke vendosur dhe masa ndëshkimi për institucione që i përsëritin ato.

b. Për mangësitë në institucionet e audituara për vitin 2019 dhe për grupet e menaxhimit të programeve të tyre, MFE të marrë masa që këto mangësi të mos përsëriten dhe strukturat që merren me përgatitjen e tyre të përgjegjësohen për mangësitë e konstatuara, si në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrinë e Brendshme, duke bërë diferencimin midis tyre edhe në vlerësimet dhe masat ndëshkuese për strukturat që merren me përgatitjen e PBA.

Afati: Menjëherë

Observacioni i subjektit nr.8595/27 datë 23.08.2021 administruar në KLSH me nr. 514/16 datë 25.8.2021:

Në lidhje me pikë a). MFE në përputhje me nenin 16 e në vijim të ligjit 9936/2008 i rishikuar është autoriteti përgjegjës për hartimin dhe miratimin e një sistemi rregullash ,standardesh dhe procedurash , që sigurojnë administrimin ekonomik, eficient dhe efektiv të burimeve financiare publike. Në zbatim të këtij përcaktimi si dhe të përcaktimeve të Kreut IV “Përgatitja, shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit të shtetit”, të ligjit të sipërcituar, MFE përgatit dhe propozon KM të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore të përcaktuara për miratimin e PBA. Ndërkohë theksojmë se përgatitja , miratimi dhe cilësia e këtij dokumenti është tërësisht detyrë dhe përgjegjësi e të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë dokument sikurse përcaktohet në të gjithë përmbajtjen e ligjit...Pavarësisht nga sa më sipër, MFE referuar fushës së saj të përgjegjësisë ka iniciuar, analizuar, përgatitur dhe dërguar në afatet e përcaktuara të gjitha projektaktet për të cilat është përgjegjëse...Analizimi i këtyre akteve dhe afatet kohor të miratimit të tyre janë janshtë fushës së përgjegjësisë së MFE, dhe për rrjedhojë nuk mund të përbëjnë një rekomandim për MFE-në, pasi nuk mund të realizohen nga MFE. Gjithashtu theksohet se në cdo rast, afatet e miratimit të akteve të përmendura në pikën a. janë afate indikativë të procesit të punës, pasi referuar ligjit organik të buxhetit, nga ana jonë në asnjë rast nuk janë tejkaluara afatet e përcaktuara në ligjin 9936/2008 i ndryshuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: rekomandimi 1.a i drejtohet MFE me strukturën e saj përgjegjëse, për monitorimin e procesit të hartimit të dokumentit PBA dhe rrjedhimisht monitorimin dhe zbatimin e një kalendari veprimesh të miratuar.

Në lidhje me pikën b). Kurrikula e hartuar nga ASPA bëhet përmes një procesi përzgjedhjeje të personave që hartojnë dhe zhvillojnë trajnimin. Jo domosdoshmërisht këta persona janë staf i MFE. Në këtë kontekst, monitorimi i punës dhe cilësisë së kryer nga ASPA nuk është në fushën e përgjegjësisë së ministrisë përgjegjëse për financat dhe për rrjedhojë nuk mund të përbëjnë një rekomandim për MFE-në, pasi nuk mund të realizohet.

Qëndrimi i grupit të auditimit: sqarojmë se rekomandimi 1.b) konsiston në kërkesën për monitorimin nga ana e MFE të pjesëmarrjes së dokumentuar në trajnimet e kryera nga ASPA.

Në lidhje me germën d) ju informojmë se ky rekomandim është pranuar dhe zbatuar në dokumentet pasardhës të PBA-së.

Qëndrimi i grupit të auditimit: observacioni pranohet.

Në lidhje me rekomandimin në germën e). kemi sqaruar se: Miratimi dhe publikimi i dokumentit PBA në cdo fazë të tij, është publikuar në faqen zyrtare të ministrisë, në përputhje me nenin 26 të ligjit nr.9936/2008, dhe konkretisht me përcaktimin e pikës 4, të këtij neni sipas të cilit PBA përmban: “Tërësinë e dokumentacionit të dërguar nga njësitë e qeverisjes qendrore, sipas formateve tandardë, i cili duhet minimalisht, të përmbajë: qëllimet e politikave të programeve,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

objektivat e politikave të programeve, projektet e investimeve publike, produktet e programeve dhe kostot e tyre respektive”. Pra nëse një institucion nuk ka paraqitur kërkesa buxhetore të programit të tij, ai nuk mund të jetë pjesë e dokumentit dhe për rrjedhojë nuk mund të publikohet.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Problematika e publikimit të dokumentit të PBA, jo të plotë në numër, pra për të gjitha institucionet (ministritë e linjës dhe njësi varësie me peshë në investime publike) është konstatuar edhe në auditimin e vitit 2020.

Në lidhje me rekomandimin në gjermën f), kemi sqaruar se në zbatim të nenit 26 të ligjit nr.9936/2008, ... nga ana jonë është punuar me kujdes dhe përgjegjësi në hartimin e analizave buxhetore, analiza të cilat nuk janë komentuar nga ana juaj dhe as nga njësitë e qeverisjes qendrore. Për rrjedhojë reflektimi analizave të kryera dhe të dërguara nga ana jonë, është në fushën e përgjegjësisë së institucionit dhe nuk mund të kërkohej nga MFE. Për këtë arsye edhe rekomandimi i bërë, pranohet pjesërisht, pasi MFE do të vijojë punën e saj për të nxitur sa më shumë rritjen e cilësisë së kërkesave buxhetore. Lidhur me rekomandimin e marrjes së masave ndëshkimore për mangësitë e konstatuara dhe të përsëritur në analizat buxhetore, sqarojmë se, ligji 9936/2008, neni 71 i tij nuk parashikon masa të tilla administrative. Për më tepër MFE nuk mund të marrë masa administrative për grupet e menaxhimit të programeve, pasi kjo është jashtë fushës së përgjegjësisë së MFE dhe mbetet përgjegjësi e institucionit përkatës. Gjithashtu, vlerësojmë se MFE nuk mund të propozojë reduktimin apo eliminimin e fondeve buxhetore të një programi për shkak të pasaktësisë apo mosreflektimit të komenteve në analizat buxhetore...

Qëndrimi i grupit të auditimit: Observacioni për këtë pikë pranohet.

Statusi: Rekomandimi është pranuar pjesërisht dhe rezultoi i zbatuar pjesërisht.

2. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik të shqyrtojnë mundësinë e parashikimit të afati për procesin e detajimit dhe miratimit të fondeve buxhetore në vijim të pikës 50 të Udhëzimit nr.9 datë 20.03.2018 për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit, pjesa II.1 të Buxheti Vjetor Shpërndarja e Fondeve Buxhetore.

Afati: Menjëherë

Sipas subjektit—Lidhur me këtë rekomandim sqarojmë se referuar pikës 50 të Udhëzimit nr.9 dt 20.03.2018 “Për procedurat standarte të Zbatimit të buxhetit, pjesa II. E cila thekson: “Brenda 10 ditëve, nga publikimi në Fletoren Zyrtare të ligjit të buxhetit vjetor Nëpunësi i Parë Autorizues informon, me shkrim, nëpunësit autorizues të çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme për fondet e miratuara nga Kuvendi në ligjin e buxhetit vjetor”, brenda këtij afati bëhet njoftimi lidhur me fondet e miratuara, afat i cili është respektuar në vijimësi nga NPA.

-Nga ana tjetër ashtu sic e kemi sqaruar edhe me sipër, në shkresën e dërguar nga nëpunësi i parë autorizues të gjitha njësitë të qeverisjes qendrore nëpërmjet së cilës bëhet njoftimi për fondet buxhetore të miratuara nga Kuvendi në Ligjin e Buxhetit Vjetor për tre vitet, kërkohej paraqitja e detajimit të buxhetit në formë zyrtare dhe në formë elektronike brenda një afati të përcaktuar. Pra është përcaktuar një afat brenda të cilit të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore duhet të paraqesin në MFE detajimin e planit të buxhetit të miratuar me qëllim që të bëhet efektiv edhe në SIFQ

Statusi: Rekomandimi është pranuar dhe zbatuar pjesërisht.

Observacioni i subjektit nr.prot. 8595/19 datë 23.08.2021 administruar në KLSH me nr.514/7 datë 25.08.2021 në lidhje me këtë rekomandim nuk sjell dokumentacion provues të vendosjes së afatit të brendshëm në shkresat dërguar institucioneve për detajimin e planit buxhetor. Gjatë auditimit të vitit 2020 u konstatua e njëjta problematikë. Observacioni nuk pranohet.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

3. Rekomandimi:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të marri në shqyrtim procesin aktual të detajimit të fondeve buxhetore sipas ndarjes aktuale të përgjegjësive midis Drejtorive të saj, përfshirë rolin dhe veprimet ndihmëse që ato kryejnë për njësitë buxhetore me akses në SIFQ, me qëllim vlerësimin e procedurave aktuale apo hartimin e udhëzuesve të brendshëm shtesë, ku përcaktohen qartë hapat dhe mënyra e dokumentimit të veprimeve në SIFQ, me raporte të gjeneruara po nga sistemi, për të siguruar kështu gjurmën e auditimit për verifikimin e saktësisë dhe kronologjisë së regjistrimeve në përputhje me dokumentacionin shkresor miratues.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit të marrin masa për korrigjimin e rasteve të pasaktësive të konstatuara në këtë auditim duke parashikuar dhe një procedurë periodike në vijimësi për saktësimin e klasifikimeve të kodeve në çelje dhe atyre faktike.

Afati: Menjëherë

Sipas subjektit: *Procesi i detajimit të fondeve buxhetore nga ana e DMB bëhet sipas procedurës dhe radhës së punës së përcaktuar nga administratorët e sistemit në përputhje me përgjegjësinë që ka kjo drejtori në përdorimin e SIFQ.*

Për sa më sipër, bëjmë sqarimin : Hedhja në SIFQ e këtyre tavanëve nuk është përgjegjësi e Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit por e Drejtorisë së Analizave dhe Programimit Buxhetor. Duam të saktësojmë që Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit kontrollon dhe monitoron procesin e detajimit të planit fillestar deri në nivel njësie shpenzuese, artikulli dhe produkti, në përputhje me tavanet e miratuara në ligj si në formë zyrtare (duke miratuar me shkresë detajimin e fondeve), ashtu edhe hedhjen në SIFQ, si për ministritë dhe institucionet që kanë akses (duke kontrolluar detajimin në momentin e dhenies së “Shpërndarjes Masive”, gjatë procesit të hedhjes në sistem prej tyre), ashtu edhe për institucionet që nuk kanë akses, duke vepruar në sistem. Nga DPTH, janë hartuar raporte në SIFQ, të cilat gjenerojnë të dhënat mbi fondet e detajuara të planit sipas Ligjit Fillestar të miratuar.

Statusi: Rekomandimi është pranuar pjesërisht dhe i zbatuar pjesërisht. Ndarja e përgjegjësive brenda të njëjtës Drejtori të Përgjithshme nuk duhet të ndikojë në marrjen e masave për përmirësimin e situatës dhe zbatimin e rekomandimit.

Observacioni i subjektit nr.prot. 8595/19 datë 23.08.2021 administruar në KLSH me nr.514/7 datë 25.08.2021 në lidhje me këtë rekomandim nuk sjell dokumentacion shtesë provues të kryerjes së rakordimeve dhe sistemeve për saktësimin dhe pastrimin e rekordeve të regjistruara në kodet përkatëse të projekteve (planit dhe faktit). Gjatë auditimit të vitit 2020 u konstatua e njëjta problematikë. Observacioni nuk pranohet.

4. Rekomandimi:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të marrë në shqyrtim rastet e rishikimeve buxhetore për të analizuar ato sipas llojit, kronologjisë dhe njësiteve buxhetore me numrin më të lartë të kërkesave për rishikim dhe argumentimin shoqërues të tyre, me qëllim përmirësimin e performancës në programimin buxhetor, implementimin e sistemeve të reja të kontrollit për të shmangur risqet që këto rishikime të shpeshta mbartin në zbatimin e procedurave për zbatimin e buxhetit në përputhje me parashikimet për disiplinimin fiskal dhe financiar.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të marrë në shqyrtim rastet e regjistrimeve me data efektive retrospektive edhe pse ato mund të jenë regjistrime të njësiteve buxhetore me akses të drejtpërdrejt në SIFQ, në zbatim të misionit dhe përgjegjësive që kjo drejtori ka.

Afati: Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Sipas MFE- *Shprehemi dakord me rekomandimin, ndërkohë bëjmë sqarimin si me poshtë lidhur me gjetjet e konstatuara:*

-Për rialokimet për shpenzimet korrente, të cilat janë përgjegjesi e Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit për t'u hedhur në sistem, të cilat janë paraqitur si gjetje nga KLSH dhe për të cilat është evidentuar një diferencë në kohë midis datës së postimit në sistem dhe datës kontabile të regjistruar, sqarojme se:

o-Rialokimet e paraqitura dhe që janë hedhur në sistem nga DMB, përfaqësojnë disa shkresa të përdorimit të fondit të vecantë të universiteteve dhe spitaleve të cilat janë kompetencë e tyre dhe paraqiten nga Degët e Thesarit në DMB, vetëm për t'u hedhur në sistem. Data e hedhjes përputhet me datën e paraqitjes së shkresës përcjellëse të Degës së Thesarit, ndërsa periudha kontabile për llogari të së cilës është hedhur rialokimi përputhet me datën e shkresës së institucionit dhe periudhën e kërkuar në këto shkresa.

Gjithsesi jemi dakord që rialokimet duhet të hidhen në sistem me datën aktuale kur bëhet shkresa. Lidhur me konstatimin nga KLSH, se "...DPB ka përgjegjësinë për vendosjen dhe zbatimin e sistemeve të kontrollit lidhur me saktësinë dhe vlefshmërinë e rregjistrimeve në SIFQ edhe kur këto janë përgjegjesi të institucionit kërkues...", duam të sqarojmë se:

-Një sistem i tillë ekziston dhe është pikërisht procesi i rakordimit të planit të buxhetit me ministrinë e institucionet qendrore që realizon këtë proces.

Statusi: Rekomandimi është i pranuar dhe i pazbatuar.

Observacioni i subjektit nr.prot. 8595/19 datë 23.08.2021 administruar në KLSH me nr.514/7 datë 25.08.2021 në lidhje me këtë rekomandim nuk sjell dokumentacion shtesë provues të arsyeve të regjistrimeve me data më të hershme përveç atyre të justifikuara me AN34, ndërkohë numri i rasteve të konstatuara përfshin edhe periudha të tjera gjatë vitit. Gjatë auditimit të vitit 2020 u konstatua e njëjta problematikë. Observacioni nuk pranohet.

5. Rekomandimi:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit dhe AKSHI-n të marrë masa për dokumentimin e plotë të ngjarjes së ndodhur në modulën PSB të SIFQ, me përdorues punonjësit e kësaj drejtorie duke përfshirë këtu identifikimin e rasteve që janë spastruar gabimisht me kryqëzim.

2. Pavarësisht kufizimeve në numrin e përdoruesve të aplikacionit në modulën PSB, nisur nga fakti që një regjistrim për çelje apo rishikim buxheti bëhet pasi janë marrë miratimet përkatëse shkresore, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit duhet të analizojë shkaqet dhe rastet kur një rekord mund të mbetet në sistem me status oi pa miratuarö për sa kohë regjistrimi në SIFQ vjen pas miratimit shkresor.

3. Zgjatja e periudhës së ruajtjes së të dhënave të shoqërohet me parashikimin e përpilimit të një dokumentacioni shkresor për rekordet e spastruara të datuar dhe sigluar nga përdoruesi përkatës.

Afati: Menjëherë

Sipas MFE Kjo problematikë dhe ky rekomandim nuk ngarkon me përgjegjësi Drejtorinë e Buxhetit. Ajo duhet të trajtohet në strukturat që menaxhojnë funksionimin e SIFQ, funksion i cili nuk është në përgjegjësinë e Drejtorisë së Buxhetit.

Statusi: Rekomandimi është i papranuar dhe i pazbatuar.

Observacioni i subjektit nr.prot. 8595/19 datë 23.08.2021 administruar në KLSH me nr.514/7 datë 25.08.2021 në lidhje me këtë rekomandim nuk sjell dokumentacion shtesë provues të kryerjes së dokumentimin e rasteve të spastruara sipas kodeve apo paraqitjen e hartimin e ndonjë procedure



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCIVE DHE EKONOMISË

për përdorimin e këtij aplikacioni nga usera-të kufizuar. Për sa i takon përgjegjësisë ajo rrjedh nga fakti se përdorues i këtij moduli është DPB. Observacioni nuk pranohet.

6. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për hartimin e Rregullores së Brendshme të institucionit me qëllim reflektimin në të, të një sërë pozicionesh, funksionesh e detyrash të krijuara me strukturën e re.

Afati: Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është pranuar dhe i zbatuar.

Observacioni i subjektit nr.prot. 8595/19 datë 23.08.2021 administruar në KLSH me nr.514/7 datë 25.08.2021 në lidhje me këtë rekomandim pranohet.

7. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit si përgjegjëse për raportimin e konsoliduar të stokut të detyrimeve të prapambetura në bashkëpunim me Drejtorinë e Harmonizimit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit të hartojnë një udhëzues ku në vijim të raportimeve individuale të njësive qendrore dhe vendore dhe konsolidimit të tyre të parashikojnë dhe rakordime periodike të vlerave të raportuara me ato të regjistruara në kontabilitet.

Afati: Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është pranuar dhe zbatuar. Është miratuar udhëzimi nr. 37, date 6.10.2020 për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme. Ndërkohë në Udhëzimin nr. 4, date 25.01.2021 për zbatimin e Buxhetit të vitit 2021, është percaktuar që ministria e Financave dhe Ekonomisë mund të kërkojë informacion shtesë mbi të dhënat e raportuara në SIFQ apo problematika të tjera eventuale, në përmbushje të rolit të saj monitorues mbi detyrimet e prapambetura.

C. I MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE, PËRFSHI SHPENZIME TË REALIZUARA NË KUSHTE TË PALIGJSHMËRISË PROCEDURIALE.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik, të marrin masa për rishikimin e politikave aktuale me qëllim heqjen dorë përfundimisht nga marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore nga njësitet e qeverisjes së përgjithshme.

1.2 Rekomandimi: Ministri i Financave dhe Ekonomisë, duhet të kushtojë vëmendje problematikave sistematike të konstatuara nga KLSH në lidhje me, procesin e planifikimit dhe realizimit të investimeve publike dhe rekomandimeve të lëna me qëllim menaxhimin efektiv të parasë publike.

1.3 Rekomandimi: Ministri i Financave dhe Ekonomisë, të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim:

- Inkurajimin e njësive të qeverisjes së përgjithshme me qëllim rritjen e cilësisë së planifikimit të buxhetit.
- Të fuqizohet roli i Drejtorisë së Menaxhimit të Investimeve Publike në MFE, në drejtim të monitorimit të procesit të investimeve publike me qëllim rritjen e cilësisë së menaxhimit të fondeve publike dhe llogaridhënies së strukturave që kryejnë shpenzime buxhetore.
- Në kuadër të sigurimit të kontrollit, në fushat e identifikuara si problematike, të rritet numri i auditimeve nga ana e Auditit të Brendshëm me qëllim identifikimin dhe parandalimin e shkeljeve të mundshme dhe adresimin e rekomandimeve në kohë sa më të shpejtë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

d) Fuqizimin e kontrollit të brendshëm në drejtim të monitorimit sistematik të investimeve publike për tu siguruar që, realizimi i projekteve të investimit është në përputhje me planet vjetore, me qëllim raportimin e saktë të Treguesve Fiskalë të Buxhetit të Konsoliduar.

e) Në tabelën nr.04 të Treguesit Fiskalë, të ligjit vjetor të buxhetit, në zërin të Shpenzimeve Kapitale me Financim të Brendshëm, të shtohet në zëri të Investimeve nga të ardhurat dytësore të institucioneve qendrore me planin përkatës.

Afati: *Menjëherë*

Statusi: Për këtë rekomandim nuk ka përgjigje nga subjekti dhe është i pazbatuar.

2. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa me qëllim fuqizimin e kontrollit të brendshëm në drejtim të monitorimit sistematik të investimeve publike për të siguruar që, realizimi i projekteve të investimit është në përputhje me planet vjetore me qëllim marrjen në kohë të masave për mënjanimin problematikave të konstatuara dhe raportimin e saktë të Treguesve Fiskalë të Buxhetit të Konsoliduar.

Afati: *Menjëherë*

Statusi: Ky rekomandim nuk është pranuar dhe është i pazbatuar.

D. MASA ADMINISTRATIVE: KLSH i rekomandon Nëpunësit të Parë Autorizues marrjen e masave në përputhje me kërkesat e nenit 51 të *Menaxhimit të Angazhimeve* dhe nenit 71 të *Kundërvajtjet administrative* të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, duke analizuar rast pas rasti gjetjet e mësipërme, të reflektuara më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Statusi: Për këtë rekomandim nuk ka përgjigje nga subjekti dhe është i pazbatuar.

E. MASA DISIPLINORE: Mbështetur në nenet 57, 58 dhe 59 të ligjit nr. 153/2013 për nëpunësin civil, pasi të jenë identifikuar personat përgjegjës në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet Titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe Komisionit Disiplinor përkatës për vlerësim dhe dhënie masash disiplinore nga vërejtjet e deri në largim nga puna sipas përgjegjësisë individuale të drejtuesve konkret.

Statusi: Për këtë rekomandim nuk ka përgjigje nga subjekti dhe është i pazbatuar.

I. Më hollësisht, rekomandimet sipas programit nr.350 datë 12.05.2020, dhe statusi i tyre i pranimit dhe zbatimit paraqitet si vijon:

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të marrë të gjitha masat e nevojshme për shpërndarjen e njëtrajtshme të shpenzimeve buxhetore gjatë vitit, me qëllim shmangien e shpenzimeve inefficente dhe reduktimin e luhatjeve të treguesve ekonomikë dhe financiarë.

Afati: Në vijimësi

Sipas MFE, ky rekomandim nuk pranohet: *Ecuria e realizimit të deficitit/suficitit përgjatë gjithë periudhës (periudhave të ndërmjetme) të vitit buxhetor, është dinamike, pra jo thjesht e njëtrajtshme. Kjo pasi, kjo ecuri është subjekt i një sere faktoreve, si nga kahu i të ardhurave ashtu*



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

edhe ai i shpenzimeve, te cilet ndikojne ne nivelin e realizuar te deficitit/suficitit, per periudhen perkatese.

Statusi: Rekomandimi është i papranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

Observacioni i subjektit nr.prot. 8595/19 datë 23.08.2021 administruar në KLSH me nr.514/7 datë 25.08.2021 në lidhje me këtë rekomandim pranohet pjesërisht duke marrë në konsideratë dinamikën e vitit 2020.

2. Rekomandimi:

a. Strukturat drejtuese të Ministrisë së Financave/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, në bashkëpunim me strukturat menaxhuese të Këshillit të Ministrave, **të përcaktojnë në hartimin e ligjit vjetor të buxhetit dhe në udhëzimin vjetor të zbatimit të tij, klauzolat e alokimit të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit**, duke vendosur edhe sanksione për ata që i shkelin këto përcaktime ligjore.

b. Strukturat drejtuese të Ministrisë së Financave/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, të krijojë për çdo VKM të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit, dosjen e dokumentacionit të domosdoshëm për të, në mënyrë që të jetë më e qartë se ku mungon dokumentacioni (në protokoll, apo nuk ka kaluar nga kjo drejtori) dhe të marrin fund justifikimet e përvitshme se òkëto mungesa e pasaktësi nuk qëndrojnë, pasi asnjë projektvendim i KM, ku preket fondi rezervë, nuk merr miratimin paraprak të MFE nëse i mungon përlllogaritja e efekteve financiare.

Afati: Brenda 3 mujorit të parë të vitit 2021

Sipas MFE: *1.Në Ligjin Organik të Buxhetit është përcaktuar që “Përdorimi i Fondit Rezervë bëhet me VKM”. Ndërsa procedura e paraqitjes së kërkesës, si dhe mënyra e alokimit të fondeve të miratuara është përcaktuar në Udhëzimin nr.9 dt 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”. Ndërkohë, sanksionet për ata që shkelin përcaktimet ligjore dhe procedurat përkatëse, janë ato që përcakton Ligji Organik i Buxhetit.*

Në nenin 13 të Ligjit të Buxhetit për vitin 2019 të ndryshuar, është përcaktuar , masa dhe mënyra e përdorimit të F. Rezervë.

Procedura e përdorimit të Fondit Rezerve të Buxhetit të Shtetit është tashmë e përcaktuar dhe e përfshirë në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, si mëposhtë:

“Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit dhe Fondi i Kontingjencës

Fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve të paparashikuara, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Miratimi i përdorimit të tij bëhet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Procedura për përdorimin e këtij fondi kalon në këto faza:

Ministrinë e linjës paraqesin tek Ministri përgjegjës për Financat një projektvendim ku kërkohet shtesë fondi në buxhetin e vitit nga përdorimi i fondit rezerve, duke përcaktuar edhe llojin e shpenzimeve. Relacioni shoqërues i projektvendimit duhet të përmbajë informacionin si më poshtë: Të argumentojë qëllimin për të cilin do të përdoren fondet shtesë, si edhe domosdoshmërinë e krijimit të produkteve apo projekteve të reja nëpërmjet kryerjes së shpenzimeve shtesë gjatë vitit buxhetor, duke paraqitur impaktin e tyre;

Të paraqesë një preventiv të detajuar lidhur me zërat e shpenzimeve shtesë si dhe përlllogaritjen e tyre;

Të argumentojë pamundësinë e planifikimit të këtij shpenzimi gjatë fazës së përgatitjes së projektbuxhetit;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

Të argumentojë pamundësinë e përballimit të këtij shpenzimi nëpërmjet rialokimit të fondeve brenda sistemit nëpërmjet paraqitjes së analizës së realizimit të buxhetit për periudhën raportuese. Ministri përgjegjës për Financat, pas shqyrtimit të kërkesave dhe analizës së tyre, jep vërejtjet dhe sugjerimet, të cilat duhet të sqarohen dhe të plotësohen detyrimisht kur të përgatitet projektvendimi përfundimtar.

Me mendimin e ministrive të interesuara dhe atë të Ministrit përgjegjës për Financat, projektvendimi paraqitet në Këshillin e Ministrave.

2. Lidhur me rekomandimin se DPB duhet të krijojë për çdo vendim që prek Fondin Rezervë dosjen e dokumentacionit të plotë për të, në mënyrë që të jetë më e qartë se ku mungon dokumentacioni, nuk e gjejnë të drejtë dhe nuk shprehemi dakord me këtë rekomandim. Kjo, për sa kohë që dokumentat përkatës për çdo projektvendim dhe vendim janë të protokolluara dhe pjesë e dosjeve dhe regjistrat zyrtar që mban zyra e protokollit në MFE, për dokumentacionin origjinal respektiv.

Statusi: Rekomandimi është pranuar pjesërisht dhe është i pazbatuar. Nga auditimi i përdorimit të fondit rezervë në vitin 2020 konstatohen të njëjta problematika.

Observacioni i subjektit nr.prot. 8595/19 datë 23.08.2021 administruar në KLSH me nr.514/7 datë 25.08.2021 në lidhje me këtë rekomandim nuk sjell argumenta apo dokumentacion shtesë nga ai i trajtuar. Observacioni nuk merret në konsideratë.

3. Rekomandimi:

a. Strukturat drejtuese të Ministrisë së Financave/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, në bashkëpunim me strukturat menaxhuese të Këshillit të Ministrave dhe të Kuvendit të Shqipërisë, të përcaktojnë:

-Detajimin e fondeve rezervë të institucioneve të drejtësisë dhe rialokimet e strukturave të krimeve të rënda, nga Prokuroria e Përgjithshme në SPAK;

-Përcaktimin/parashikimin e trajtimit financiar të OPGJ;

-Përcaktimin e një draft VKM^{je} për pagat e administratës gjyqësore, administratës së SPAK/Byro hetimi/ILD dhe Administratës së Prokurorisë së Përgjithshme;

-KLGJ të hartojë një projekt udhëzim për miratimin e tarifave gjyqësore, të cilat do të përcjellin të ardhura të shtuara për mbulimin e kostove financiare të reformës në drejtësi.

b. Strukturat drejtuese të Ministrisë së Financave/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, të krijojë për çdo VKM të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit, dosjen e dokumentacionit të domosdoshëm për të, në mënyrë që të jetë më e qartë se ku mungon dokumentacioni (në protokoll, apo nuk ka kaluar nga kjo drejtori), ku preket fondi rezervë, apo ku nuk merr miratimin paraprak të MFE dhe në cilën VKM mungon përllogaritja e efekteve financiare.

Afati: Brenda 3 muajve të parë të vitit 2021

Sipas MFE ky rekomandim nuk pranohet. Të gjitha fondet e miratuara në Ligjin e Buxhetit Vjetor të cilat shpërndahen gjatë vitit buxhetor, si edhe të gjitha rishpërndarjet e fondeve gjatë vitit i nënshtrohen rregullave si edhe procedurave përkatëse të cilat janë të përcaktuara në Ligjin Organik të Buxhetit, në Ligjin Vjetor si edhe në Udhëzimin për procedurat standarte të buxhetit dhe në Udhëzimin plotësues "Për zbatimin e buxhetit vjetor. Nëse ka një ndryshim të ligjit të buxhetit vjetor nuk është e mundur përfshirja e të gjitha shpërndarjeve dhe rishpërndarjeve, pasi nuk mund të kemi përputhje në kohë të ndryshimit të ligjit të buxhetit vjetor me kohën e kryerjes së shpërndarjeve dhe rishpërndarjeve të fondeve të cilat sipas llojit të tyre mund të kryhen edhe deri në fund të vitit buxhetor.

Statusi: Ky rekomandim është i papranuar dhe i pazbatuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

4. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në MFE dhe departamentet Bankës së Shqipërisë si agjentë fiskal të saj, të cilët merren me regjistrimin dhe konfirmimin e Llogarisë së Unifikuar të Thesarit dhe Depozitë qeverie, të përcaktojnë qartë se kush departament duhet të konfirmojë me të paktën 6 grupe të ardhurat dhe shpenzimet e kësaj llogarie, në mbështetje të përcaktimeve ligjore.

Afati: Brenda vitit 2020

Statusi: Ky rekomandim është i papranuar dhe i pazbatuar.

5. Rekomandimi: Nga ana e MFE të merren masa për regjistrimin e menjëhershëm në SIFQ të angazhimeve që rrjedhin nga kontratat koncesionare/PPP aktualisht në zbatim, për vlerën e plotë të tyre dhe sipas viteve respektive. Miratimi i këtyre kontratave të kryhet vetëm pasi të realizohet integrimi në ciklin e menaxhimit të investimeve publike, në mënyrë që të respektohen mundësitë buxhetore për financimin e tyre për shmangien e krijimit të detyrimeve të prapambetura.

Afati: Në vijimësi

Statusi: Ky rekomandim nuk pa përgjigje dhe është i pazbatuar.

6.1 Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për informimin e Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve në lidhje me shumën totale të fondeve që ka në dispozicion Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve për të financuar projekte të reja për çdo grant konkurrues, me qëllim uljen e riskut të krijimit të detyrimeve të prapambetura.

Afati: Në vijimësi

Statusi: Ky rekomandim nuk pa përgjigje dhe është i pazbatuar.

6.2 Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për raportimin e pagesave të kryera për detyrimet e prapambetura, si zë më vete në Tabelën e Treguesve Fiskal të Konsoliduar, me qëllim që të ofrohet një paraqitje e drejtë e vlerës së investimeve kapitale të kryera gjatë vitit buxhetor.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Sipas MFE: *Me buxhetin e vitit 2019, për Fondin Shqiptar të Zhvillimit ka qënë shumë e rëndësishme financimi dhe mbyllja e gjithë projekteve në vazhdim me autoritet kontraktues njësitë vendore, me qëllim mos krijimin e detyrimeve të prapambetura në vitet e ardhshme buxhetore. Në aneksin 3 të ligjit nr.99, datë 03.12.2018 "Për buxhetin e vitit 2019", është përcaktuar se nga fondi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces me burim financimi ish-Fondin e Zhvillimit të Rajoneve-Infrastruktura Vendore dhe Rajonale. Si rrjedhojë, në të ardhmen nuk do të ketë detyrime të prapambetura për pjesën e ish-FZHR-Infrastruktura Vendore dhe Rajonale.*

Statusi: Ky rekomandim është i pranuar pjesërisht dhe i pazbatuar.

6.3 Rekomandim: Ministria e Financave dhe Ekonomisë përpara miratimit të Akteve Normativ për ndryshimet e Ligjit të Buxhetit duhet të identifikojë dhe të reflektojë të gjitha rishpërndarjet e fondeve të ndodhura gjatë vitit, midis programeve të ndryshëm buxhetorë, me qëllimi paraqitjen e plotë, të drejtë dhe të saktë të vlerave përfundimtareve të programeve buxhetore në Tabelën e Treguesve Fiskal të Konsoliduar.

Afati: Në vijimësi

Sipas MFE: *Ky rekomandim nuk pranohet. Të gjitha fondet e miratuara në Ligjin e Buxhetit Vjetor të cilat shpërndahen gjatë vitit buxhetor, si edhe të gjitha rishpërndarjet e fondeve gjatë vitit i*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

nënshtrohen rregullave si edhe procedurave përkatëse të cilat janë të përcaktuara në Ligjin Organik të Buxhetit, në Ligjin Vjetor si edhe në Udhëzimin për procedurat standarte të buxhetit dhe në Udhëzimin plotësues “Për zbatimin e buxhetit vjetor. Nëse ka një ndryshim të ligjit të buxhetit vjetor nuk është e mundur përfshirja e të gjitha shpërndarjeve dhe rishpërndarjeve, pasi nuk mund të kemi përputhje në kohë të ndryshimit të ligjit të buxhetit vjetor me kohën e kryerjes së shpërndarjeve dhe rishpërndarjeve të fondeve të cilat cilat sipas llojit të tyre mund të kryhen edhe deri në fund të vitit buxhetor

Statusi: Ky rekomandim është i papranuar dhe i pazbatuar.

Observacioni i subjektit nr.prot. 8595/19 datë 23.08.2021 administruar në KLSH me nr.514/7 datë 25.08.2021 në lidhje me këtë rekomandim nuk sjell argumenta apo dokumentacion shtesë nga ai i trajtuar në auditim. Observacioni nuk merret në konsideratë.

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në rolin e mbikëqyrësit financiar të veprimtarisë të njësisë së qeverisjes vendore, duhet të marrë të gjithë masat e nevojshme me qëllim:

- a. Rishpërndarjen e planit buxhetor në drejtim të njësisë të qeverisjes vendore me qëllim eliminimin e detyrimeve të akumuluar dhe planifikimin vit pas viti duke paraqitur edhe pjesën e fondeve të trashëguara të papërdorura për transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta.
- b. Ngritjen e një grupi pune me qëllim saktësimin e shifrës së Detyrimeve të Prapambetura duke marrë në konsideratë shifrën e pasqyruar në pasqyrat financiare të bashkive dhe shifrën e deklaruar po nga këto bashki pranë MFE.
- c. Analizimin e situatës për të gjitha ato bashki të cilat paraqitën në vështirësi financiare dhe vështirësi serioze financiare me qëllim marrjen e masave të menjëhershme për daljen nga situata e krijuar.

Afati: Menjëherë dhe në vijimësi

Sipas MFE: Për pikën a. Në këtë këndvështrim Drejtoria e Financave Vendore po punon të disiplinonjë të gjithë procesin e buxhetimit në nivel vendor me synimin kryesor uljen e nivelit të detyrimeve të prapambetura dhe përmirësimin e menaxhimit financiar në nivel vendor. Ndërkohë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të analizojë mundësinë e evidentimit të fondeve të trashëguara të papërdorura në tabelën e treguesve fiskalë.

Për pikën b: Lidhur me pjesën e detyrimeve është miratuar Udhëzimi i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”. Ky udhëzim do të realizojë unifikimin e burimit të të dhënave për detyrimet e prapambetura, dhe ky burim që do jetë vetëm Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ). Po ashtu këto të dhëna duhet të jenë të njëjta edhe në tepricat e llogarive të pozicioneve financiare të institucioneve. Në këtë mënyrë, problemi burimit të informacioni dhe unifikimit të të dhënave është i rregulluar me udhëzimin e sipërcituar.

Lidhur me pikën c: Ministria e Financave dhe Ekonomisë pas përfundimit të periudhës tranzitore mbi vlerësimin e situatës së vështirësisë së gjendjes financiare të njësisë vendore do të vazhdojë punën e saj në përputhje me përcaktimet procedurale të udhëzimit nr. 26 datë 27.09.2019 dhe Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Statusi: Ky rekomandim është i pranuar dhe pjesërisht i zbatuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

2. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë të saktësojnë rakordojnë dhe raportojnë Brenda vitit vlerën për sasinë e printuar, emetuar, asgjësuar dhe atë të pashpërndarë të bonove të privatizimit. Të vendosen procedura raportimi dhe rakordimi midis dy institucioneve në baza gjashtë mujore.

Afati: Menjëherë

Statusi: Ky rekomandim nuk ka përgjigje dhe është i pazbatuar.

D. MASA ADMINISTRATIVE

KLSH i rekomandon Nëpunësit të Parë Autorizues marrjen e masave në përputhje me kërkesat e nenit 51 *Menaxhimi i Angazhimeve* dhe nenit 71 *“Kundërvajtjet administrative”* të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, *ËPër menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*, të ndryshuar, duke analizuar rast pas rasti gjetjet e mësipërme, të reflektuara më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Afati: Menjëherë

Statusi: Ky rekomandim nuk ka përgjigje dhe është i pazbatuar.

E. MASA DISIPLINORE: Mbështetur në nenet 57, 58 dhe 59 të ligjit nr. 153/2013 *ËPër nëpunësin civilë*, pasi të jenë identifikuar personat përgjegjës në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet Titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe Komisionit Disiplinor përkatës për vlerësim dhe dhënie masash disiplinore nga *ËVërejtje* deri në *ËLargim* nga puna sipas përgjegjësisë individuale të drejtuesve konkret.

Afati: Menjëherë

Statusi: Ky rekomandim nuk ka përgjigje dhe është i pazbatuar.

Titulli i gjetjes:	Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm kryer me programin nr.349/1 dhe 350/1 datë 12.05.2020, të ndryshuar.
Situata:	Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve rezulton se Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) në vijim të përcjelljes së raportit përfundimtar të auditimit dhe rekomandimeve me shkresën nr.350/7 datë 30.10.2020 ka dërguar në KLSH planin e masave për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr.6369/17, datë 27.11.2020 administruar në KLSH me nr. prot. 458/10 datë 14.12.2020 në tejkallim të afatit ligjor 20 ditor. Në përmbushje të detyrimit 6-mujor për raportimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve, MFE ka raportuar me shkresën nr. prot. 786 datë 30.04.2021 administruar në KLSH me nr. prot. 559 datë 17.05.2021. Në këto shkresa janë përfshirë raportimet për rekomandimet e lëna në auditimin e kryer në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në dy programe auditimi, përkatësisht: nr. prot 349/1 datë 12.05.2021, i ndryshuar dhe nr. prot 350/1 datë 12.05.2021. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se në auditimin e kryer sipas programit nr.349/1 datë 12.05.2020, i ndryshuar janë lënë gjithsej 13 rekomandime nga të cilat: 7 masa organizative nga të cilat: Pranuar 4; pranuar pjesërisht 2; pa pranuar 1. Janë lënë 4 masa për eliminimin e



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE
EKONOMISË

	<p>efekteve negative në administrimin e fondeve publike (3E) nga të cilat: Pa përgjigje 3; pa pranuar 1. Është lënë 1 masë administrative pa përgjigje dhe 1 masë disiplinore pa përgjigje. Nga auditim statusi i zbatimit të rekomandimeve rezulton si më poshtë:</p> <p><u>7 masa organizative nga të cilat: Pranuar 4 masa: janë zbatuar plotësisht 2 masa, janë zbatuar pjesërisht 2 masa dhe 1 masë është e pazbatuar; Janë pranuar pjesërisht 2 masa: zbatuar pjesërisht 1 masë; Nuk janë pranuar 1 masë, pa zbatuar 1 masë.</u></p> <p><u>4 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike (3E) nga të cilat: Pa përgjigje 3 dhe pa pranuar 1: rezultojnë 4 masa pazbatuar.</u></p> <p><u>1 masë administrative pa përgjigje, pa zbatuar dhe 1 masë disiplinore pa përgjigje, pa zbatuar</u></p> <p>Pra nga 13 masa të lëna në gjithsej rezultojnë të zbatuara plotësisht vetëm 2 masa dhe zbatuar pjesërisht 2 masa.</p> <p>Për sa i përket rekomandimeve të lëna në auditimin e kryer sipas programit nr.350/1 datë 12.05.2020, ato janë gjithsej 12 rekomandime nga të cilat: 8 masa organizative nga të cilat: Pranuar pjesërisht 2; pa pranuar 3; pa përgjigje 3. Janë lënë <u>2 masa për eliminimin e efekteve negative</u> në administrimin e fondeve publike (3E) nga të cilat: Pranuar 1; pa përgjigje 1. Është lënë masë administrative pa përgjigje dhe masë disiplinore pa përgjigje. Nga auditimi statusi i zbatimit të rekomandimeve rezulton si më poshtë:</p> <p><u>8 masa organizative nga të cilat: Janë pranuar pjesërisht 2 dhe zbatuar pjesërisht 2 masa; Nuk janë pranuar dhe konsideruar pa zbatuar 3 masa; nuk janë dhënë përgjigje dhe konsideruar pazbatuar për 3 masa.</u></p> <p><u>2 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike (3E) nga të cilat:</u></p> <p>Janë pranuar 1 masë e zbatuar pjesërisht 1 masë; nuk janë dhënë përgjigje për 1 masë e konsideruar e pa zbatuar.</p> <p><u>1 masë administrative pa përgjigje dhe e pa zbatuar dhe 1 masë disiplinore pa përgjigje dhe e pa zbatuar.</u></p> <p>Pra nga 12 masa të lëna në gjithsej rezultojnë vetëm 3 masa të zbatuara pjesërisht.</p>
Kriteri:	Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 oPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.
Ndikimi/Efekti:	Mos zbatim i rekomandimeve të lëna nga auditimi i grupit të KLSH
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nisur nga problematikat sistematike të konstatuara edhe në këtë auditim, rikërkojmë që Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara, të papranuara apo të zbatuara pjesërisht.

III.GJETJE DHE REKOMANDIME



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve rezulton se Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) në vijim të përcjelljes së raportit përfundimtar të auditimit dhe rekomandimeve me shkresën nr.350/7 datë 30.10.2020 ka dërguar në KLSH planin e masave për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr.6369/17, datë 27.11.2020 administruar në KLSH me nr. prot. 458/10 datë 14.12.2020 në tejkalim të afatit ligjor 20 ditor. Në përmbushje të detyrimit 6-mujor për raportimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve, MFE ka raportuar me shkresën nr. prot. 786 datë 30.04.2021 administruar në KLSH me nr. prot. 559 datë 17.05.2021. Në këto shkresa janë përfshirë raportimet për rekomandimet e lëna në auditimin e kryer në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në dy programe auditimi, përkatësisht: nr. prot 349/1 datë 12.05.2021, i ndryshuar dhe nr. prot 350/1 datë 12.05.2021. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se në auditimin e kryer **sipas programit nr.349/1 datë 12.05.2020, i ndryshuar janë lënë gjithsej 13 rekomandime statusi i të cilave paraqitet më poshtë:**

7 masa organizative nga të cilat: Pranuar 4 masa: janë zbatuar plotësisht 2 masa, janë zbatuar pjesërisht 2 masa dhe 1 masë është e pazbatuar; Janë pranuar pjesërisht 2 masa: zbatuar pjesërisht 1 masë; Nuk janë pranuar 1 masë, pa zbatuar 1 masë.

4 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike (3E) nga të cilat: Pa përgjigje 3 dhe pa pranuar 1: rezultojnë 4 masa pazbatuar.

1 masë administrative pa përgjigje, pa zbatuar dhe 1 masë disiplinore pa përgjigje, pa zbatuar

Pra nga 13 masa të lëna në gjithsej rezultojnë të zbatuara plotësisht vetëm 2 masa dhe zbatuar pjesërisht 2 masa.

Për sa i përket rekomandimeve të lëna në auditimin e kryer **sipas programit nr.350/1 datë 12.05.2020, ato janë gjithsej 12 rekomandime statusi i të cilave paraqitet si më poshtë:**

8 masa organizative nga të cilat: Janë pranuar pjesërisht 2 dhe zbatuar pjesërisht 2 masa; Nuk janë pranuar dhe konsideruar pa zbatuar 3 masa; nuk janë dhënë përgjigje dhe konsideruar pazbatuar për 3 masa.

2 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike (3E) nga të cilat:

Janë pranuar 1 masë e zbatuar pjesërisht 1 masë; nuk janë dhënë përgjigje për 1 masë e konsideruar e pa zbatuar.

1 masë administrative pa përgjigje dhe e pa zbatuar dhe 1 masë disiplinore pa përgjigje dhe e pa zbatuar.

Pra nga 12 masa të lëna në gjithsej rezultojnë vetëm 3 masa të zbatuara pjesërisht.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Nisur nga problematikat sistemike të konstatuara edhe në këtë auditim, rikërkojmë që Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara, të papranuara apo të zbatuara pjesërisht.

Brenda vitit 2021

2. Gjetje nga auditimi: Sipas raportimit në raportin e zbatimit të buxhetit të publikuar nga MFE, rezulton se për vitin 2020 për 13 kontrata koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore në total, plani përfundimtar paraqitet në shumën 9,734 milion lekë, ndërkohë që pagesat rezultuan në shumën 9,634 milion lekë, me një realizim në masën 99%. Këto pagesa janë kryer për 10 kontrata ndërkohë që për 3 prej tyre nuk është kryer asnjë pagesë. Shuma totale e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCIVE DHE EKONOMISË

partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojë kufirin prej 5% të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor. Në rast tejkalimi të këtij kufiri, Këshilli i Ministrave merr masa korrektuese në krahun e të ardhurave buxhetore, të nevojshme dhe të mjaftueshme, për t'u rikthyer brenda kufirit të lejuar, gjatë dy viteve të ardhshme buxhetore. Aktualisht, pagesat vjetore faktike nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për kontratat koncesionare apo PPP, në shumën 9,634 milion lekë zënë 2.26% e totalit të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2019, prej rreth 426,271 milion lekë, duke qenë brenda kufirit të pagesave prej 5% të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2019 që përlogaritet në rreth 21,300 milion lekë.

Nga auditimi konstatohet se në dy projekte koncesionare, janë krijuar detyrime të prapambetura si dhe gjatë vitit janë shlyer detyrime të viteve të mëparshme, konkretisht projekti i inceneratorit të Tiranës dhe koncesioni i skanimit në dogana. Këto dy projekte përfshijnë kryerjen e pagesave në bazë të nivelit shërbim të ofruar kushtëzuar nga kërkesa për këtë shërbim, kërkesë kjo që mund të jetë mbi nivelin e buxhetuar. Realizimi i shërbimit përtej vlerës së buxhetuar ka shkaktuar krijimin e detyrimeve të prapambetura për vitin aktual dhe në të njëjtën kohë mbartjen e tyre në vitin pasardhës.

Në një rast, detyrimet kontraktuale nuk rezultojnë të buxhetuara, dhe as të regjistruara si obligim në SIFQ, konkretisht për projektin e ndërtimit të shkollave në Bashkinë e Tiranës, konstatim i njëjtë me vitin e kaluar, ku kontrata e nënshkruar nuk është regjistruar dhe nuk është buxhetuar jo në përputhje me parashikimet e udhëzimit standard të zbatimit të buxhetit.

Konstatohet se gjatë vitit 2020, situata pandemike ka kushtëzuar uljen e financimit në disa prej kontratat koncesionare me ndryshimet e ligjit nr. 88/2019 òPër buxhetin e vitit 2020, gjatë muajit mars dhe prill 2020, konkretisht projektet koncesionare në fushën e infrastrukturës (rruga e Arbrit etj.), menaxhimit të mbetjeve (inceneratorët) dhe shëndetësisë (check-up). Këto projekte në vijim janë ri financuar me aktin normativ nr. 28/2020 dhe aktin normativ nr.34/2020 në vlerën fillestare të parashikuar, me përjashtim të dy kontratave koncesionare në infrastrukturën rrugore: projektet e rrugëve Milot-Balldren dhe Orikum Dukat.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me autoritetet kontraktuese, të monitorojë me rigozitet detyrimet që lindin nga kontratat koncesionare, pagesat e të cilave bazohen në nivelin e shërbimit dhe që krijojnë detyrime të prapambetura për t'u mbartur në vitet e ardhshme buxhetore ndërkohë që nisin edhe projekte të reja koncesionare për zbatim.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në lidhje me llogarinë òDepozitë e qeverisë dhe rakordimi i saj me Bankën e Shqipërisë u konstatua se për vitin 2020, Banka e Shqipërisë çdo muaj ka dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë shkresa për konfirmimin e gjendjes së Llogarisë së Unifikuar të Thesarit òDepozitë Qeverie, mbi të ardhurat totale dhe shpenzimet totale, por jo të grupuara në të paktën 7 grupe kryesore si: Të ardhura tatimore; Të ardhura jo tatimore; Shpenzime të përgjithshme; Shpenzime për interesa; Financim i brendshëm nëpërmjet emetimit; Financimi i jashtëm; Instrumentet, duke sjellë vështirësi në auditimin e kësaj llogarie dhe krahasimin e saj me regjistrimin midis dy institucioneve jo në përputhje me Ligjet: nr.9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 8, 54 i tij si dhe me Marrëveshjen Kuadër, midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Bankës së Shqipërisë. Si rezultat i regjistrimit të ndryshëm të llogarisë së Unifikuar të Thesarit òDepozitë Qeverie në të dy institucionet, për faktin e dizenjimit të sistemeve të ndryshme nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

njëri tjetri, të dy grupet e analizuara të shpenzimeve dhe të ardhurave, rezultoi se nga mbledhja e diferencave të zërave të shpenzimeve dhe të ardhurave, totali nuk reflekton diferenca, pra është zero. Gjithashtu diferenca midis totalit të të ardhurave dhe totalit të shpenzimeve sipas Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është në vlerë të njëjtë, për 20,246 milion lekë, vlerë e cila paraqet edhe gjendjen e llogarive në fund të vitit 2020 sipas dy institucioneve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe departamentet e Bankës së Shqipërisë si agjentë fiskal të saj, të cilët regjistrojnë dhe konfirmojnë llogarinë e unifikuar të thesarit ÷Depozitë qeverie, të përcaktojnë qartë se kush departament duhet të konfirmojë të ndarë në grupe të ardhurat dhe shpenzimet e kësaj llogarie në mbështetje të përcaktimeve ligjore.

Brenda vitit 2021

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në lidhje me procesin e menaxhimit të financave publike në nivel vendor u konstatua se në fillim të vitit 2020, njësitë e qeverisjes vendore kanë trashëguar fonde të papërdorura në vitin 2019, në vlerën **11,038 milion lekë** nga të cilat 10,758 milion lekë i përkasin bashkive dhe 280 milionë lekë qarqeve. Në mbyllje të vitit 2020, të ardhurat e pa përdorura dhe të trashëguara për vitin 2021, në total janë 19,910 milion lekë, të cilat përfaqësojnë 39% të të ardhurave totale faktike të vitit 2020. Në totalin e fondeve të trashëguara për vitin 2021, janë të përfshira edhe fondet e papërdorura të akorduara për rindërtimin në **vlerën 6,524 milion lekë**. Nga auditimi rezulton se të ardhurat e trashëguara për vitin 2021 kanë diferencë prej 3,813 milionë lekë me vlerën e të ardhurave që duhet të ishte trashëguar realisht. Në total për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore raportohet se janë trashëguar 19,910 milion lekë, ndërkohë sipas testeve të kryera nga grupi i auditimit duhet të ishin trashëguar 16,097 milion lekë.

Për sa i përket raportimit të detyrimeve të prapambetura, në fund të vitit 2020, referuar raportit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ÷Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale si dhe raportit vjetor ÷Financat publike vendore 2020, stoku i detyrimeve të prapambetura për njësitë e vetëqeverisjes vendore në fund të muajit dhjetor 2020, raportohet rreth 6,931 milionë lekë. Sipas të dhënave të dërguara nga Drejtoria e Financave Vendore dhe tabelave bashkëlidhur raporteve të mësipërme stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2020, për 61 bashki dhe 12 qarqe rezulton të jetë rreth 7,059 milion lekë. Sipas të dhënave të thesarit në llogarinë 4864, totali i detyrimeve të prapambetura për njësitë e qeverisjes vendore është 7,212 milion lekë, duke reflektuar diferencë në vlerën 153 milion lekë me vlerën totale të detyrimeve të njërive të qeverisjes vendore të raportuar dhe publikuar nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Rezulton se diferenca në raportim krijohet kryesisht nga detyrimet e prapambetura të Ujësjellës - Kanalizime Krujë dhe Ujësjellës-Kanalizime Rrëshen.

Nëse do të vlerësohej situata e stokut të detyrimeve të bashkive (6,931 milion lekë), përkundrajt të ardhurave të pa përdorura të cilat trashëgohen në vitin buxhetor pasardhës prej 19,562 milion lekë referuar të dhënave të MFE-së, kjo vlerë është afërsisht tre herë më e madhe se vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura të deklaruar dhe që nëpërmjet një planifikimi të drejtë do të përdorehin për uljen e këtij stoku dhe përmirësimin e gjendjes financiare të qeverisjes vendore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë-Drejtoria e Financave Vendore, në rolin e mbikëqyrësit financiar të veprimtarisë të njërive të qeverisjes vendore, duhet të marrë të gjithë masat e nevojshme për monitorimin e shpërndarjes së planit buxhetor të njërive të qeverisjes vendore sipas prioriteteve me qëllim shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe parandalimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

krijimit të detyrimeve të reja, duke përfshirë planifikimin sipas prioriteteve si të fondeve të trashëguara nga transfertat e pakushtëzuar edhe të fondeve të veta.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Financave Vendore, në lidhje me statusin e gjendjes financiare të njësive të qeverisjes vendore ka hartuar Raportin mbi statusin e vështirësive financiare, ku është analizuar gjendja financiare e 58 bashkive nga 61 bashki, duke u bazuar në vetë deklarin e tyre. Sipas këtij raporti, 37 bashki janë klasifikuar ôpa probleme financiare, 11 bashki janë klasifikuar ôme probleme financiare dhe 10 bashki janë klasifikuar ônë vështirësi financiare. Gjithashtu, konstatohet se llogaritja e gjendjes financiare të paraqitura në këtë raport është hartuar duke u bazuar në vetë deklarin e bashkive në lidhje me vlerën e detyrimeve të prapambetura dhe jo në vlerën e detyrimeve të kontabilizuar dhe të raportuar në llogarinë 486 të thesari për çdo bashki, si dhe nuk është përfshirë vlera e borxhit afatgjatë për njësitë e qeverisjes vendore.

Nga auditimi i të dhënave të Drejtorisë së Financave Vendore për vlerën totale të shpenzimeve të miratuara, të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik për borxhin afatgjatë të bashkive si dhe në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit për detyrimet e prapambetura, grupi i auditimit ka vlerësuar situatën financiare të njësive të qeverisjes vendore në përputhje me kërkesat e neneve 55, 56, 57 të Ligjit nr. 68/2017 ôPër financat e qeverisjes vendore si dhe në kërkesat e udhëzimit nr. 26, datë 27.09.2019 ôProcedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Kështu, nga auditimi rezulton se 38 bashki klasifikohen ôpa probleme financiare, 10 bashki me ôprobleme financiare dhe 13 bashki klasifikohen me ôvështirësi financiare.

Referuar metodologjisë së përcaktuar në bazën ligjore të mësipërme, gjendja financiare e njësive të qeverisjes vendore llogaritet përkundrejt shpenzimeve të miratuara. Nga auditimi ka rezultuar se njësitë e qeverisjes vendore të cilat paraqiten me probleme financiare kanë realizim faktik të shpenzimeve shumë më të ulët krahasuar me shpenzimet e miratuara. Konkretisht, nga auditimi rezulton se më problematike paraqitet gjendja dhe situata financiare për bashkinë Kavajë dhe për bashkinë Vorë. Bashkia Kavajë gjatë vitit 2020 ka planifikuar të shpenzojë 1,111 milion lekë, ndërkohë që realizimi faktik është në vlerën 709.8 milion lekë ose **64%**. N.q.s. gjendja financiare e bashkisë Kavajë do të vlerësohej mbi bazën e shpenzimeve faktike të realizuara, raporti i detyrimeve të prapambetura me shpenzimet faktike do të ishte rreth 120.5% dhe kjo bashki do të klasifikohet me probleme serioze financiare. Gjithashtu, Bashkia Vorë gjatë vitit 2020 ka planifikuar të shpenzojë 939.8 milion lekë, ndërkohë që realizimi faktik është në vlerën 3430.7 milion lekë ose **37%**. N.q.s. gjendja financiare e bashkisë Vorë do të vlerësohej mbi bazën e shpenzimeve faktike të realizuara, raporti i detyrimeve të prapambetura me shpenzimet faktike do të ishte rreth 204% dhe kjo bashki do të klasifikohet pa aftësi paguese.

Sipas të dhënave të MFE-së, totali i shpenzimeve të miratuara është në vlerën 68,955 milion lekë ndërsa totali i shpenzimeve faktike të njësive të qeverisjes vendore rezulton të jetë 50,991 milion lekë. Kundrajt totalit të shpenzimeve faktike të 61 bashkive, stoku i detyrimeve paraqitet në masën 14.7% të totalit, ndërsa kundrejt shpenzimeve të miratuara stoku i detyrimeve është në masën 10.3%. Vlerat e ulëta të realizimit faktik të shpenzimeve, tregon jo vetëm për një planifikimin të dobët nga ana e njësive të qeverisjes vendore por këto vlera ndikojnë edhe në mos paraqitjen e drejtë të gjendjes financiare reale të njësive të qeverisjes vendore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në rolin e mbikëqyrësit financiar të veprimtarisë të njësive të qeverisjes vendore, të analizojë situatën për të gjitha ato bashki të cilat



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

paraqiten në ÷vështirësi financiarë dhe ÷vështirësi serioze financiare me qëllim hartimin e një plani veprimi për daljen nga situata e krijuar.

Menjëherë

6.1. Gjetje nga auditimi: Në ligjin nr.88/2019 është parashikuar fondi i rindërtimit për shkak të fatkeqësisë natyrore të tërmetit të ndodhur në vitin 2019 në shumën 20,000 milion lekë. Përgjatë vitit 2020, ky fond është rishikuar në rritje me Aktin Normativ nr. 28 datë 02.07.2020 në shumën 34 miliard lekë dhe më pas është rishikuar në ulje me Aktin Normativ nr.34 datë 16.12.2020 në shumën 32,000 milion lekë, nga të cilat 3,000 milion lekë grante dhe 29,000 milion lekë financim nga buxheti qendror. Fondet për procesin e rindërtimit janë realizuar në shumën 16,591 milion lekë, nga 32,000 milion lekë të planifikuara sipas Aktit Normativ nr.34, ose 51.8% me një mos realizim në shumën 15,409 milion lekë. Referuar tabelës 4 të Treguesit Fiskal të konsoliduar të ligjit nr.88/2019, konstatohet se vlera e parashikuar për fondin e rindërtimit për vitet 2021 dhe 2022 është 0 lekë, ndërkohë që është parashikuar që fondi i rindërtimit i përdorur në vitin 2020 trashëgohet në vitin pasardhës buxhetor. Gjithashtu, në ligjin nr.88/2019 të ndryshuar është përcaktuar që mënyra e përdorimit të Fondit të Rindërtimit, programet buxhetore ku do alokohet fondi si dhe institucionet dhe agjencitë zbatuese të tij, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave. Sipas informacioneve të vendosura në dispozicion nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë mbi përdorimin e fondit të rindërtimit përgjatë vitit 2020, në bazë të VKM-ve përkatëse, konstatohet se janë shpërndarë në total fonde për rindërtimin në shumën 78,471 milion lekë, nga të cilat detajuar për vitin 2020 në shumën 28,071 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se vlera e fondeve të shpërndara me VKM deri në 31.12.2020 prej 78,471 milion lekë është mbi vlerën e përcaktuar në ligjin e buxhetit për fondet e parashikuara të rindërtimit prej 32,000 milion lekë (shumë kjo e përcaktuar vetëm për vitin 2020). Kështu, shpërndarja e fondeve me VKM nuk është shoqëruar me ndryshim të vlerës së fondit të rindërtimit në vitet pasardhëse buxhetore, duke qenë se plani vijon të paraqitet në shumën 0 lekë për vitet 2021 dhe 2022 tabelat shoqëruese të ligjit nr. 88/2019 për buxhetin e vitit 2020, të ndryshuar.

Nga auditimi konstatohet pjesa më e madhe e fondeve të shpërndara me VKM të cilat janë ndryshuar në fund të vitit buxhetor, detajojnë vetëm vlerën prej 20% të investimit në vitin e parë, ndërkohë që janë lidhur kontrata në mënyrë të vazhdueshme po në këtë periudhë të pa regjistruara në SIFQ, efekti i të cilave pritet të reflektohet në vitet e ardhshme buxhetore ndërkohë që referuar projekt buxhetit 2021 financimi për fondin e rindërtimit paraqitet 28,000 milion lekë për vitin 2021; 6,000 milion lekë për vitin 2022 dhe 0 lekë për vitin 2023.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të reflektohet në vitet pasardhëse buxhetore për secilin komponent të treguesve fiskalë të buxhetit të konsoliduar, referuar tabelave shoqëruese të ligjit të buxhetit të vitit, efekti i fondeve të shpërndara me VKM në mënyrë që të realizohet programimi i saktë i shpenzimeve buxhetore brenda limiteve buxhetore të miratuara në këtë ligj.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2020 Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR) përbëhet nga granti konkurrues për arsimin. Në Aneksin 3 të ligjit nr.88/2019 për buxhetin e vitit 2020, të ndryshuar është përcaktuar që shpërndarja e fondeve kryhet nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve (KZHR). Parashikimi i fondeve për këto projekte është kryer në një projekt të vetëm investimi me emërtimin "Fondi për Zhvillimin e Rajoneve në vazhdim", me njësi zbatuese



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Aparatin e Ministrisë, ndërkohë që këto fonde, janë të miratuara me vendim të KZHR përkatëse për projekte me përfitues njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Nga auditimi konstatohet se nga ana e KZHR nuk është marrë asnjë vendim për shpërndarjen e financimit për projekte të reja përgjatë vitit 2020, por vlera e alokuar për këtë fond është përdorur për financimin e kontratave në vazhdim nga vitet e kaluara si dhe për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura në total **për 327 milion lekë**.

Nga auditimi konstatohet se në listën shoqëruese të investimeve publike në projekt buxhet, projektet shumë vjeçare të miratuara me vendimet e KZHR në vitin 2019, nuk paraqiten me vlerat e miratuara përgjatë të gjitha viteve, duke paraqitur si vit fillimi dhe vit mbarimi vitin 2019, dhe rrjedhimisht duke mos parashikuar fonde për vitin 2020 e në vazhdim. Gjithashtu është konstatuar se fondet e detajuara për disa projekte janë më të larta në vlerë se paraqitja e tyre në listën e investimeve publike shoqëruese të projekt buxhetit të vitit 2020.

Nga auditimi mbi fondet e alokuara për programin buxhetor 9120 òArsimi bazë është konstatuar se gjatë vitit janë kryer rishpërndarje ndërmjet projekteve të investimit duke pakësuar fondin e FZHR dhe rritur financimin për projektin “*Blerje pajisje elektronike, kompjutera për arsimin baze*” për aparatin e Ministrisë, duke përdorur kështu FZHR për projekte të cilat nuk financohen nga FZHR. Rishpërndarje fondesh ndërmjet projekteve të kësaj natyre janë kryer edhe në muajin Korrik 2020 ku është ulur përsëri vlera e fondit FZHR për projekte investimi të reja për blerje pajisje mobilierie/mësimore didaktike për shkollat e rindërtuara të arsimit bazë. Në këtë program buxhetor konstatohen gjithashtu rishpërndarje fondesh ndërmjet projekteve duke pakësuar òfondin e ngrirë të detajuara në fillim të vitit dhe duke rritur financimin për projekte të cilat paraqesin detyrime të prapambetura për fatura të vitit 2013. Nga auditimi konstatohet se vlera e përgjithshme e detyrimeve të prapambetura të paguara për programin buxhetor 9120 òArsimi bazë paraqitet në shumën 111.3 milion lekë, duke përdorur kështu buxhetin e miratuar për vitin 2020 për shlyerjen e faturave të viteve të kaluara. Në programin buxhetor 092300 òArsimi i mesëm i përgjithshëm është konstatuar se fondet e përdorura për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura paraqiten në shumën 104.6 milion lekë. Vlera e detyrimeve të prapambetura të paguara në vitin 2020 për programin buxhetor 094500 òArsimi i Lartë paraqitet në shumën 111 milion lekë.

Në programin buxhetor 094500 òArsimi i lartë, konstatohet se në muajin shtator 2020 janë kryer rishpërndarje fondesh buxhetore ndërmjet projekteve të detajuara si òtë reja por që janë kontrata të lidhura në vitin 2016 dhe faturuara në vitin 2018, duke ulur vlerën e FZHR 2017-2019 me 61 milion lekë dhe shtuar projektin M112308 òNdërtimi i një godine të re universitare me përfitues òUniversitetin Aleksandër Moisiu. Në rastet e audituara konstatohet se çelja e projekteve me akt normative dhe rritja me rialokime gjatë vitit është bërë për financimin e detyrimeve të prapambetura.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1.Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në procesin e miratimit të detajimit të investimeve publike, në çdo rast të zbatohet radha prioritare e buxhetimit në përputhje me aktet ligjore, duke përfshirë me përparësi detyrimet e prapambetura dhe detyrimet që lindin nga kontratat në proces ekzekutimi me burim financimi FZHR, në mënyrë që të shmanget kontraktimi i projekteve të reja në kushtet e kufizimeve buxhetore sipas kufijve të programeve buxhetore dhe duke parandaluar kështu e krijimin e detyrimeve të prapambetura. Procesi i miratimit të projekteve të reja të investimit me akte normative për financimin e detyrimeve të prapambetura dhe kontrata të viteve të kaluara, të paraprihet nga një inspektim financiar në lidhje me ligjshmërinë e tyre në momentin e nënshkrimit.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

7.2. Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në paraqitjen e listës së investimeve publike të projekt buxhetit të vitit të paraqitet vlera e plotë e secilës kontratë në vazhdim duke specifikuar buxhetin për secilin vit sipas periudhës së ekzekutimit të projektit dhe të shmangët praktika e paraqitjes sintetike në një projekt të vetëm me emërtimin òFZHR në procesò.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2020, fondet òpër infrastrukturën vendore dhe rajonaleò janë parashikuar si program buxhetor në Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Sipas aneksit 3 të ligjit nr.88/2019 òPër buxhetin e vitit 2020ò të ndryshuar, është përcaktuar financimi me përparësi nga programi buxhetor ò6220ò òInfrastruktura Vendore dhe Rajonaleò të ish FZHR, infrastruktura vendore dhe rajonale si dhe financimi i projekteve të tjera të investimit ku autoriteti programues, kontraktues dhe zbatues është Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Autoritetin për shpërndarjen e fondeve e ka Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Planifikimi fillestar sipas projekt buxhetit është parashikuar për 3,500 milion lekë ndërkohë që me ligjin e miratuar fondet për këtë program janë miratuar në 4,500 milion lekë. Gjatë vitit me Aktin Normativ nr.34 datë 16.12.2020 janë pakësuar fondet e FSHZH duke paraqitur një plan përfundimtar në shumën 3,500 milion lekë. Për sa i përket shpenzimeve faktike, vlera e realizimit të programit òinfrastruktura vendore dhe rajonaleò për vitin 2020 është në shumën 3,304 milion lekë, nga të cilat 2,689 milion lekë për projekte të infrastrukturës vendore dhe rajonale dhe 614.4 milion lekë për projekte me detyrime të prapambetura të periudhës 2011-2013 dhe investimeve në proces 2014-2018. Nga auditimi konstatohet se në detajimin fillestar të investimeve për vitin 2020, në programin òinfrastruktura vendore dhe rajonale" është çelur projekti 18BP001 "Projekte te grantit infrastruktura vendore dhe Rajonale" në shumën 450 milion lekë ndërkohë që në planin e rishikuar fondi për projekte të FZHR rezulton në shumën 803 milion lekë, nga të cilat janë shpenzuar 614.4 milion lekë, ku detyrimet për fatura të prapambetura paraqiten në shumën 491 milion lekë, ose 80% e fondeve të realizuara për to. Kështu, konstatohet se financimi i detyrimeve të FZHR nuk është kryer sipas përparësisë së përcaktuar në aneksin 3 të ligjit nr. 88/2019 òPër buxhetin e vitit 2020ò, të ndryshuar duke detajuar fondet në projekte të tjera për të cilat kanë filluar procedurat e prokurimit, pasi procesi i shlyerjes së detyrimeve të njëjësive të vetqeverisjes vendore është shoqëruar gjatë vitit me verifikim nga FSHZH sipas argumentimit të MFE. Miratimi nga ana e MFE për detajimin e fondeve të investimeve nuk ka kontribuar në uljen e detyrimeve të prapambetura pasi nuk janë financuar me përparësi detyrimet e prapambetura të viteve të kaluara në detajimin fillestar të fondeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në miratimin e detajimit të investimeve publike të mbahet parasysh prioriteti në financimin e projekteve me detyrime të prapambetura dhe detyrimet që lindin nga kontratat në proces ekzekutimi me burim financimi FZHR, në mënyrë që të shtyhet kontraktimi i projekteve të reja në kushtet e mundësive të kufizuara buxhetore me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura të reja.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në listën e investimeve publike është paraqitur i planifikuar dhe realizuar në shumën 198 milion lekë projekti 18AV703 "Pagesa ndërkombëtare në institucione financiare të tjera", në programin 1130 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Ndërkohë, në databazën e pagesave në SIFQ konstatohet se janë kryer pagesa duke përdorur llogarinë e lëshimit të garancive me përfitues Korporatën Shqiptare të Investimeve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

me numër llogarie 466213 “Garanci te vitit vazhdim për sigurimin e kontratës, të dala” me datë furnitori 31.12.2020. Kjo pagesë është kryer me kod projekti A000005 “Mallra e shërbime(kap.6)”, në shumën 197.8 milion lekë ndërkohë që pjesa tjetër është kryer me kod projekt 18AV703 “Pagesa ndërkombëtare ne institucione financiare te tjera” në shumën 197.7 mijë lekë. Për kryerjen e kësaj pagese janë përdorur llogaritë e garancisë së vitit në vazhdim, ndërkohë që sipas informacioneve mbi investimet kapitale të dërguara nga Drejtoria e Investimeve kjo pagesë rezulton e planifikuar dhe realizuar nga llogaritë e investimeve. Për këtë arsye, vlera prej 197.8 milion lekë nuk rezulton të jetë e pasqyruar në treguesit fiskalë në zërin e investimeve kapitale, duke nënvlerësuar këtë tregues në publikim.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1.Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të reflektohen në treguesit fiskal efekti i pagesës së kryer për projektin 18AV703 sipas fondeve të miratuara për këtë qëllim dhe të shmanget praktika e pagesës së detyrimeve që nuk kanë lidhje me përdorimin e llogarive të garancive të cilat përdoren sipas rezervimit fillestar të krijuar për to dhe jo vetëm.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Në zbatim të Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 20.01.2020 òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020 dhe në mbështetje të nenit 11 të Ligjit të Buxhetit nr.88/2019 òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020, NPA nëpunësit autorizues të njëjësive të qeverisjes qendrore dërgojnë pranë NPA për miratim detajimin e tyre, i cili bëhet i vlefshëm për zbatim vetëm pasi regjistrohet në SIFQ. Nga auditimi konstatohet se në kushtet kur ende nuk është përcaktuar një afat maksimal për kryerjen e detajimit në udhëzimet për zbatimin e buxhetit, shkresat për detajimin e shpenzimeve kapitale rezultojnë deri në muajin Mars 2020, duke reflektuar kështu një proces të tejzgjatur . Më hollësisht, nga auditimi mbi detajimin e fondeve për investime për periudhën 2020-2022, konstatohen shkresa miratimi të detajimit nga MFE që datojnë deri në muajin Mars, ku ndër të tjera rezulton Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe vetë Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Procesi i miratimit të fondeve buxhetore përfundon me bërjen disponibël të tyre në SIFQ dhe paralelisht duhet të reflektohet në planet e prokurimit që njësitë e përgjithshme duhet të dorëzojnë në Degën e Thesarit çdo fillim viti. Në kushtet kur për çeljen e fondeve nuk janë sanksionuar afate konkrete për këtë proces, kjo situatë mund të bëhet shkak për shkeljen e disiplinës në ndërmarrjen e angazhimeve buxhetore, pra fillimin e procedurave të prokurimit përpara miratimit dhe çeljes së fondeve në SIFQ. Kështu, nga kryqëzimi i të dhënave me regjistrin e APP, u konstatuan rastet, në të cilat procedura e prokurimit janë shpallur përpara datës së shkresës së MFE për miratimin e detajimit të shpenzimeve kapitale nga ana e ministrive të linjës. Konkretisht, rezultojnë 3 procedura prokurimi të iniciuara nga FSHZH, 2 procedura të iniciuara nga KLGJ, dhe 1 procedurë e iniciuar nga Ministria e Mbrojtjes.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të marrë masat për të përcaktuar afate konkrete të detajimit dhe miratimit të fondeve buxhetore në kuadrin rregullator për zbatimin e buxhetit për kontrollin e angazhimeve buxhetore, në mënyrë që të shmangen situatat e tejzgjatjes së këtij procesi me impakt në iniciimin e procedurave të prokurimit në kushtet kur fondet nuk bëhen disponibël sipas projekteve që në fillim të vitit.

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se pavarësisht kontrolleve ekzistuese, si funksionet dhe raportet e ndërtuara në SIFQ për qëllime të planifikimit buxhetor, për të garantuar saktësinë e tavaneve të miratuara, ashtu sikundër është trajtuar edhe në auditimin e mëparshëm, u konstatuan diferenca në të dhënat e raportuara në treguesit fiskale të buxhetit të konsoliduar sipas Tabelës nr. 4 të Ligjit të Buxhetit me atë të regjistruar në sistemin SIFQ në planin fillestar të vitit 2020, konkretisht në zërat e shpenzimeve dhe financimit të deficitit.

Sistemi SIFQ ka dizenuar kontrolle për të garantuar saktësinë e hedhjes së këtyre të dhënave sipas formateve të miratuara. Megjithatë, diferencat e evidentuara në tabelën fiskale të gjeneruar nga SIFQ me atë të miratuar në ligj janë një tregues që formatet e standardizuara të përdorura për ngarkimin e çeljeve nuk janë implementuar nga njësitë përgjegjëse, ose nuk janë të mjaftueshme për të garantuar saktësinë e detajimit brenda tavaneve të miratuara. Gjithashtu, nga verifikimi i raporteve të gjeneruara për buxhetin fillestar dhe atë operativ në SIFQ u konstatua se vlerat e regjistruara për disa projekte janë të dublikuara duke raportuar për të njëjtin projekt fillimisht vlerën fillestare, dhe më pas projekti raportohet sërish me të njëjtin kod për të regjistruar vlerën e rishikuar, kjo edhe për shkak të mos koordinimit të punës nëpërmjet drejtorive, në mënyrë që ky proces të konsolidohet dhe të mundësojë monitorimin e tij, situatë kjo që përbën risk për pasaktësi mbi raportimin e treguesve të planifikimit dhe realizimit të projekteve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të vlerësojë kontrollet ekzistuese dhe procedurat aktuale për garantimin e saktësisë së regjistrimeve të planit fillestar pas miratimit të ligjit, në vijim të konstatimit më sipër duke parashikuar procedura periodike për të kryer rakordimet përkatëse dhe kontrolle/procedura shtesë për të shmangur pasaktësitë në hedhjen e planit të miratuar në SIFQ.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi rishikimet buxhetore përgjatë vitit 2020, u konstatua se ka patur **rreth 2327 rishikime** të fondeve buxhetore me një ndryshim neto midis projekteve prej 50.7 miliard lekë, nga të cilat 632 rishikime prekin projekte për investime kapitale.

Numri i rishikimeve që kanë materializuar aktet normative është 130. Sipas Udhëzimit të përhershëm nr. 2 datë 06.12.2012, të ndryshuar, pika 79: *“Numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit”*, dhe numri i lartë i rishikimeve edhe gjatë vitit 2020 tregon për një planifikim të dobët të shpenzimeve për investime ashtu edhe ato për shpenzime operacionale, nga ana e institucioneve qendrore dhe vendore, mungesës së analizave të mirëfillta gjatë planifikimit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, mungesë monitorimi të zbatimit të buxhetit dhe veçanërisht të ecurisë së zbatimit të investimeve.

Gjithashtu, nga auditimi i të dhënave të rishikimeve buxhetore, u konstatua se janë kryer 442 rishikime pas datës 15 Nëntor të vitit 2020, veprim në kundërshtim me nenin 48 *“Afati për rishpërndarjen e fondeve buxhetore të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ku citohet: “E drejta e njërive të qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve, të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri në datën 15 nëntor të çdo viti buxhetor”*. Ekzekutimi në SIFQ i rishikimeve buxhetore buxhetore që prekin vitin 2020 ka vazhduar të kryhet deri në datën 24 shkurt 2021, në kundërshtim me nenin 52 të Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.*

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

12.1 Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë me drejtoritë përgjegjëse: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në kuadër të zbatimit të Metodologjisë për Monitorimin e Investimeve Publike, të marrë në konsideratë përfshirjen e numrit të rishpërndarjeve të kërkuara nga çdo njësi në grupin e treguesve të matjes së performancës financiare me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë dhe cilësisë së programimit buxhetor.

12.2 Rekomandimi: Nëpunësi i Parë Autorizues të marrë masa për verifikimin e të gjitha rasteve të regjistrimeve pas datës 15 Nëntor, të rishpërndarjeve buxhetore të vitit 2020 për të nxjerrë përgjegjësitë administrative përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan problematika mbi sistemin e SIFQ të cilat mund të ndikojnë në sigurinë e sistemit në drejtim të kryerjes së pagesave pa pasur fonde të mjaftueshme të alokuara. Më konkretisht:

- Projekti me kod 18BA301 nuk ka pasur fonde të alokuara deri në muajin korrik kur edhe i janë alokuar 448 mijë lekë. Edhe pse pa fonde, për këtë projekt është paguar fatura me vlerë 448 mijë lekë në datën 03.03.2020. Në këtë mënyrë, në muajin korrik i janë alokuar fonde po në këtë vlerë por me periudhë kontabël janar 2020.

Sipas Drejtorisë së Procesimit të Biznesit, kjo situatë është shkaktuar si pasojë e lidhjes së faturës së paguar me një kontratë të regjistruar paraprakisht si obligim.

- Buxheti për projektin me kod 18BP401, deri në datën 31 dhjetor 2020 është 39.9 milion lekë. Ndërkohë nga verifikimi i regjistrit të pagesave rezulton se vlera totale e pagesave të kryera gjatë vitit 2020 është 41.8 milion lekë, pra më shumë se buxheti aktual. Rishikimi për këtë kod projekti rezulton i regjistruar më datë 19.01.2021 (pasi janë kryer pagesat).

Sipas Drejtorisë së Procesimit të Biznesit, kjo shkaktohet pasi pakësimin e fondeve të ndodhur faktikisht sipas regjistrit të rishikimeve datë 24.12.2020, e cila do e çonte balancën e fondeve në dispozicion për këtë projekt në vlerën 39.9 milion lekë, sistemi e njeh si obligim negativ, duke e shtuar balancën me këtë vlerë dhe duke lejuar kështu kryerjen e pagesës mbi limit. Një situatë të ngjashme, Drejtoria e Procesimit të Biznesit e ka zgjidhur në qershor të vitit 2020, por duke ndërhyrë në mënyrë të izoluar vetëm për atë rast.

Kjo problematikë e SIFQ, deri momentin e auditimit ka marrë zgjidhje të përkohshme, për raste të izoluar duke u monitoruar nëpërmjet raporteve periodike. Sipas Drejtorisë së Procesimit të Biznesit zgjidhja kërkon një ndërhyrje të specializuar në kodifikimin e sistemit në mënyrë që rastet të parandalohen automatikisht, zgjidhje e cila nuk realizohet dot nga MFE. Në vlerësimin tonë, rastet e konstatuara tregojnë për thyerje të mekanizmave parandalues të sistemit duke mbetur një risk potencial të tejkalimit të vlerave të alokuara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1 Rekomandimi: MFE në bashkëpunim me AKSHI-n, nisur nga rastet e konstatuara në drejtim të thyerjes së mekanizmave parandalues të sistemit SIFQ, të kryejnë një analizë të përgjithshme të sistemeve të kontrollit dhe gjithë problematikave të konstatuara ndër vite në lidhje me anën funksionale të sistemit, për të mundur kontraktimin e mirëmbajtjes funksionale të sistemit.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i rishikimeve të fondeve buxhetore për sa i përket fondeve të dedikuara për përballimin e situatës së shkaktuar nga COVID-19, u konstatua se krahas faktit se



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

kodet e projekteve nuk janë konsistente, janë kryer rishikime të shumta të këtyre fondeve, pas akteve normative me disa VKM, duke e bërë të vështirë gjurmimin e realizimit përfundimtar.

-Me Aktin Normativ nr. 6 datë 21.03.2020, është parashikuar krijimi i një fondi anti-Covid-19 prej **2,500 milion lekë**, i cili do të detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për shpenzime korente dhe kapitale. Për këtë, transferimet nga buxheti i shtetit për sigurimet shëndetësore janë rritur me 1,200 milion lekë e cila është akorduar në kodin e dedikuar për shpenzimet COVID-19: 91304AJ òPacientë të trajtuar në shërbimin spitalor për Covid-19. **Për pjesën tjetër prej 1,300 milion lekë**, janë pakësuar 450 milion lekë fonde nga programi parësor 07220 (reduktuar shpenzimet e akorduara në kodin e projektit 91303AB òPersona që përfitojnë check up) dhe 850 milion lekë nga programi dytësor (spitalor) 07330 òPacientë të trajtuar në shërbimin spitalor. Pra, në total nga 1,300 milion lekë të akorduara fillimisht për programet shëndetësore të FSDKSSH, duke marrë në konsideratë shtesën prej 500 milion lekë që i janë akorduar institucionit, janë reduktuar me 0.8 miliard lekë fondet për programet parësore dhe dytësore të FSDKSSH. Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se të gjitha shtesat e fondeve të akorduara me VKM përgjatë këtij viti, konstatuar në: VKM-së nr. 205, datë 09.03.2020 ku është përcaktuar se Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) i shtohet fondi prej 200 milion lekë shpenzime kapitale dhe 200 milion lekë shpenzime korrente dhe në VKM nr. 249, datë 27.03.2020 ku MSHMS i shtohen fondet prej 800 milion lekë si shpenzime korrente dhe 1,000 miliard lekë si shpenzime kapitale, nuk janë reflektuar në tabelat shoqëruese respektive të Akteve Normative.

-Në regjistrin e pagesave, disa nga kodet e projekteve të cilat sipas përshkrimit janë të dedikuara për mbulimin e shpenzimeve për COVID-19, dhe nga auditimi rezultoi se në disa raste këto fonde janë përdorur për mbulimin e shpenzimeve të tjera operative, si: likuidime të energjisë elektrike, internetit, dieta, shërbim ruajtje objekti, lavaxantierie, kontratave të ndryshme mirëmbajtjeje në vazhdim, etj. Konkretisht:

Projekti me kod 91301AB òMateriale mbrojtëse të blera për COVID-19. Vlera totale e pagesave për këtë kod projekti është 964 milion lekë, nga të cilat janë paguar 15 fatura me vlerë totale 39.7 milion lekë për pagesën e shpenzimeve të cilat nuk lidhen me COVID-19; Projekti me kod 91704AF òFond Emergjence për masat anti-Covid-19 (me VKM) (Korente)ò. Vlera totale e pagesave për këtë kod projekti është 167.5 milion lekë. Nga ky kod projekti janë paguar 30 fatura me vlerë totale 48.7 milion lekë për pagesën e shpenzimeve të cilat nuk lidhen me COVID-19; Projekti me kod 91304AJ òPacientë të trajtuar në shërbimin spitalor për Covid-19. Vlera totale e pagesave për këtë kod projekti është 464.3 milion lekë, nga të cilat janë paguar 58 fatura me vlerë totale 114.8 milion lekë për pagesën e shpenzimeve të cilat nuk lidhen me COVID-19. **Në total, vetëm për rastet e konstatuara më sipër, rezultoi se janë paguar 203.3 milion lekë për shpenzime të ndryshme nga COVID-19.** Shkak për këtë situatë mund të jetë edhe pamundësia e institucioneve përfituese për të raportuar shpenzimet në kodet e duhura për të veçuar këto shpenzime nga ato të aktivitetit rutinë të institucionit.

-Me Aktin Normativ nr. 6 është parashikuar gjithashtu fond prej **2,000 milion lekë** (1,000 milion lekë shpenzime korrente dhe 1,000 milion lekë shpenzime kapitale) për COVID-19 krijuar nëpërmjet rialokimeve brenda buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes për tu përdorur për furnizimin me ushqim të komuniteteve të caktuara që do të rezultojnë të prekura nga pandemia, për familje me ndihmë ekonomike, pensionistë të vetmuar që do të kenë nevojë për ndihmë direkte dhe për nevoja të ekipeve mjekësore, si në spitalet civile ashtu edhe në spitalin ushtarak.

Në vijim, me Aktin Normativ nr. 15, datë 15.04.2020 në nenin 1 të tij, fondi prej 2,000 milion lekë është pakësuar me 1,000 milion lekë; dhe më pas me Aktin Normativ nr. 28, datë 02.07.2020 me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

nenin 5, pika 2 të tij, paragrafi i fundit i nenit 11 të ligjit është shfuqizuar, duke e çuar në 0 mbështetjen financiare për shëndetësinë nën Ministrinë e Mbrojtjes. Nga verifikimi i regjistrit të rishikimeve buxhetore rezulton se fondi është pakësuar me rreth 1,800 milion lekë, pasi rreth 181 milion lekë të akorduara për Spitalin e Traumës nuk janë rishpërndarë. Këto shkurtime janë rialokuar si shtesa në programin e ÷Emergjencave Civile÷ për të cilin fillimisht me ligjin e buxhetit ishin planifikuar 315 milion lekë (nga të cilat 295 milion lekë shpenzime korrente dhe 20 milion lekë shpenzime kapitale); dhe pas shtesave dhe pakësimeve përgjatë vitit pas Aktit Normativ nr. 34, ky program rezulton me një buxhet prej 815 milionë lekë (314 milion shpenzime korrente dhe **501 milion lekë shpenzime kapitale**). Me këto fonde janë likuiduar fatura të kontratave të lidhura një vit më parë në kuadër të tërmetit në qytetin e Korçës, fonde të cilat rezultojnë të paplanifikuara në fillim të vitit me Ligjin e Buxhetit.

- Nga auditimi u konstatuan 3 projekte me vlerë totale **15.8 milion lekë** të çelura për t'u realizuar me **burim financimi nga fondi** i COVID-19 (nga 1,000 milion lekë të alokuara nga ky fond për investime në kuadër të pandemisë). Me këto fonde janë likuiduar fatura të kontratave të lidhura një vit më parë për projektin: *÷Rikonstruksione në disa ambiente të godinës së MSHMS*".

-Nga auditimi i të dhënave të rishikimeve buxhetore, konstatohet se **nga Fondi i Kontigjencës për COVID-19** ndër të tjera është alokuar për Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive në shumën **118.3 milion lekë** në programin 10550- ÷Tregu i punësö. Në vijim, me VKM nr. 856, datë 04.11.2020 është vendosur akordimi i një ndihme financiare për disa prej kategorive kryesore të ndërmarrjeve, të cilat zbatojnë protokollat e sigurisë, në kuadër të parandalimit të pandemisë COVID-19. Për financimin e këtyre shpenzimeve nuk është akorduar një buxhet shtesë, por është vendosur që efektet financiare në vlerë deri në masën **187 milion lekë** të përballohen nga zëri *"Nxitja e punësimit"*, në programin 10550- ÷Tregu i punësö, në buxhetin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, miratuar për vitin 2020. Në konkluzion, në total për programin ÷Tregu i punësö duke krahasuar shtesat nga Fondi i Kontigjencës për COVID-19, me pakësimin e kryer për të mundësuar zbatimin e VKM nr. 856, datë 04.11.2020, i kanë reduktuar me **68.7 milion lekë** fondet për Drejtoritë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive në programin 10550.

14. 2 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua mungesë monitorimi për buxhetin e alokuar për rindërtimin, pasi kodet e projekteve të çelura për këtë qëllim nuk janë lehtësisht të gjurmueshme. Në lidhje me këtë problematikë, Ministri i Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 23038 prot, datë 10.12.2020, ka kërkuar sistemimin e fondit të rindërtimit sipas kodeve të produkteve specifike, për shkak se rezultojnë të regjistruar në të njëjtin kod produkti si fondet për kryerjen e veprimtarisë normale të njësisë shpenzuese ashtu edhe fondet e rindërtimit. Më hollësisht, pas miratimit të Ligjit për vitin 2020, në regjistrin e SIFQ është çelur projekti i rindërtimit me kod 94902AA në vlerën 20,000 milion lekë. Rishikimet e kryera gjatë vitit në këtë kod, për alokimet e kryera në njësitë e qeverisjes së përgjithshme qendrore dhe vendore nuk mundësojnë identifikimin e projekteve në të cilat janë akorduar fondet. Në këto kushte, nuk mund të verifikohet reflektimi i VKM-ve në regjistrin e rishikimeve, për të identifikuar vlerat e fondeve që u janë akorduar njësisë, dhe periudhën kohore në të cilën janë miratuar fondet në sistem. Gjithashtu, në lidhje me realizimin e fondeve, duke qenë se kodet e produkteve /projekteve të rindërtimit nuk janë konsistente nga momenti i alokimit të fondeve në zbatim të VKM-ve, deri në realizimin e shpenzimeve sipas regjistrit të pagesave, nuk është i mundur verifikimi i saktësisë së raportit të gjeneruar nga MFE për përdorimin e fondit të rindërtimit.

- Nga auditimi u konstatua se në zbatim të VKM-ve të dala për përdorimin e fondeve të rindërtimit për bashkitë, në rastet kur si burim i financimit është përcaktuar granti i rindërtimit, kjo shtesë e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

fondeve buxhetore nuk rezulton të jetë reflektuar në planin buxhetor. Si rezultat, raporti i gjeneruar nga MFE për përdorimin e fondit të rindërtimit krahasuar me planin, nuk pasqyron të dhëna për pjesën e Fondit të Rindërtimit me burim financimi grante. Më hollësisht, sipas MFE për bashkitë plani i fondeve për rindërtimin të miratuara me VKM, për vitin 2020 është në vlerë 14,909 milion lekë, (pa përfshirë këtu kapitullin 6) dhe realizimi në vlerë 8,385 milion lekë. Ndërkohë, sipas VKM-ve, pjesë e planit buxhetor në kuadër të fondit të rindërtimit duhet të reflektohej edhe vlera prej 2,257 milion lekë.

- Referuar të dhënave të raportuar nga MFE për përdorimin e fondit të rindërtimit, duke marrë në konsideratë vetëm pjesën e fondeve të buxhetit të shtetit dhe jo grantet, rezulton të jetë rreth 25,000 milion lekë nga të cilat janë realizuar pagesa rreth 15,000 milion lekë ose 60% e fondit të shpërndarë. Sipas SIFQ gjendja e pashpërndarë e fondeve të dedikuara për Rindërtimin (pa përfshirë grantet) sipas Akteve normative në fund të vitit 2020 është 3,236 milion lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit pranë MFE, të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme në kodet e projekteve të çelura në kuadër të pandemisë dhe atyre të rindërtimit si dhe raportimin e konsoliduar sipas burimit të financimit të këtyre fondeve duke përfshirë grantet, në mënyrë që të mundësohet monitorimi i këtyre projekteve si për efekt të rishpërndarjeve në planin buxhetor, ashtu edhe në realizimin e tyre deri në fund të vitit, në zbatim edhe të parimeve të qeverisjes bazuar mbi transparencën e informacionit në mënyrë që ai të jetë lehtësisht i aksesueshëm nga palët e interesit.

14.2. Rekomandimi: Për rastet e trajtuar më sipër ku përshtkrimi i faturës nuk rezulton të lidhet me situatën e shkaktuar nga COVID-19, Nëpunësi i Parë Autorizues të marrë masat për të ngritur një grup pune për të verifikuar nëse kemi të bëjmë me një keq klasifikim të shpenzimeve në kodin e COVID-19 apo këto institucione kanë shpenzuar fondet e COVID-19 për mbulimin e detyrimeve të tjera ndaj atyre të parashikuara për rastet e trajtuara, dhe të marrë masat kundrejt NA dhe NZ respektive.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se afatet e përcaktuara në dispozitat ligjore mbi përgatitjen e PBA, nuk janë zbatuar plotësisht. Më konkretisht:

Kalendari i menaxhimit të shpenzimeve publike është miratuar me VKM nr. 52, datë **06.02.2019**, veprim në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, òPërgatitja e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike, si dhe në kundërshtim me Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 òPër procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm, pika 3.1 dhe 3.2.

Udhëzimi për përgatitjen e PBA, është miratuar në shkelje të afatit të përcaktuar në nenin 24 òUdhëzimi për përgatitjen e buxhetit të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, i cili përcakton muajin shkurt si afatin për përgatitjen e buxhetit. Ndërkohë, edhe pse udhëzimi nr. 8 mban datën 28 shkurt 2019, në pikën 2 të tij ai i referohet VKM-së nr. 117 datë 13.03.2019 të datës 13 mars, çka vërteton se udhëzimi realisht ka dalë pas datës 13 mars.

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2020-2022, janë miratuar me VKM nr. 523, datë 25.07.2019, në kundërshtim me afatin e caktuar në kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike, ku përcaktohet data 29 qershor.

Udhëzimi plotësues për përgatitjen e PBA, është miratuar në shkelje të afatit të përcaktuar në nenin 27 òUdhëzimi plotësues për përgatitjen e buxhetit të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, i cili përcakton datën 10 korrik si afatin e fundit për nxjerrjen e Udhëzimit. Edhe pse udhëzimi në letër mban datën 10.07.2019, pra brenda afatit të përcaktuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, i ndryshuar, faktikisht ky akt ka dalë më vonë, pasi në udhëzim përmendet VKM nr. 523 datë 25.07.2019 (datë e mëvonshme nga udhëzimi), pra udhëzimi realisht ka dalë pas datës 25.07.2019.

Dokumenti i rishikuar i PBA 2020-2022, është miratuar me VKM nr. 845, datë 24.12.2019 për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022, të rishikuar, në kundërshtim me Nenin 29 të Projektbuxheti vjetorë, i cili përcakton datën 25 tetor si afatin për miratimin e projekt buxhetit, si dhe pikën 3.2.5 të Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm, i cili përcakton datën 10 Tetor si afatin për paraqitjen për miratim të projektligjit nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, si përgjegjëse për hartimin e dokumentit të Planit Buxhetor Afatmesëm (PBA), duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për përgatitjen e etapave të Programit Buxhetor Afatmesëm brenda kohës së përcaktuar në dispozitat ligjore dhe kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike, duke nxjerrë përgjegjësitë për vonesat që ndikojnë në përgatitjen e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të afateve të dorëzimit të kërkesave të PBA për fazën strategjike dhe teknike nga ana e njërive të qeverisjes qendrore, u konstatua se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Mbrojtjes (faza 1), Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (faza 2) dhe AKSHI, kanë dorëzuar kërkesat e PBA jashtë afateve të caktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 28.02.2019 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022”. Gjithashtu nga verifikimi i PBA të dorëzuara nga institucionet e qeverisjes qendrore, si dhe analizave të kryera nga ana e MFE mbi to, u konstatua se paraqitja e kërkesave buxhetore shfaq problematika të tilla si: Mungesa e kërkesave buxhetore për programe të caktuara; Mos respektim i afateve të dorëzimit të PBA; Mos respektim i formateve të miratuara për paraqitjen e PBA; Mungesë e relacioneve për kërkesat buxhetore; Mungesë e analizës nga ana e MFE; Paraqitja e kërkesave për politika të reja apo kërkesa buxhetore shtesë mbi tavanin e miratuar në të gjitha programet buxhetore; Nuk është paraqitur informacion nëse ka zhvilluar konsultime me shoqërinë civile; etj. Në lidhje me këto, edhe pse janë problematika të cilat vazhdojnë vit pas viti, nuk rezulton të jetë marrë asnjë masë nga ana e NPA. Gjithashtu u konstatuan raste të mungesës së analizës së kërkesave të PBA nga ana e DPB, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 “Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, pika 2.2/4. Konkretisht mungojnë analizat për institucionet MFE, AKSHI dhe FSHZH.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandimi: Nëpunësi i Parë Autorizues të vlerësojë arsyet e vonesave dhe mangësive të evidentuara mbi kërkesat e PBA, duke marrë masat kundrejt NA dhe NZ të institucioneve të cilat kanë dorëzuar me vonesë apo me mangësi fazat e kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Për sa i përket kërkesave buxhetore për PBA 2020-2022 nëpërmjet AFMIS, u konstatua se nuk janë përgatitur sipas përcaktimeve në pikën 4 të Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2019 për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022. Me anë të shkresës me nr. 16222 prot, datë 11.09.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm, u është kërkuar tre institucioneve,



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

saktësisht Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Departamentit të Administratës Publike, dërgimi i emrave të përdoruesve për sistemin e AFMIS. Nisur nga kjo shkresë, rezulton se kanë filluar ta përdorin këtë sistem pas datës 11.09.2019 vetëm tre institucione (pra nuk ka filluar prej fillimit të përgatitjes së kërkesave të PBA). Ndërkohë institucionet e tjera nuk kanë përgatitur asnjë fazë të PBA përmes AFMIS, veprim në kundërshtim me pikën 4 të Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2019 për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1 Rekomandimi: MFE me strukturën përgjegjëse -Drejtorinë e AFMIS të marrë masa për implementimin e plotë të AFMIS, si dhe të monitorojë zbatimin e tij nga ana e institucioneve qendrorë në drejtim të plotësimit të kërkesave të PBA nëpërmjet këtij sistemi.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan diferenca të mëdha të fondeve të alokuara për projekte të caktuara, nga PBA 2019-2021 në PBA 2020-2022, çka flet për një parashikim të dobët, duke zbehur vlerën e parashikimeve afatmesme për shpenzimet e buxhetit të shtetit. Nga auditimi i ndryshimeve midis PBA 2019-2021 dhe PBA 2020-2022, u konstatuan: 15 raste ku projektet e investimit të miratuara për PBA 2019-2021, nuk reflektohen në PBA 2020-2022, ose reflektohen me vlera konsiderueshëm më të ulëta me qëllim ruajtjen e tavanëve të miratuara dhe alokimin e fondeve për projekte të reja, si dhe 13 raste ku projektet e investimit miratohen fillimisht në PBA 2019-2021 si projekte të reja me vlerë të ulët, duke ruajtur tavanet e miratuara dhe më pas rriten në PBA 2020-2022 që arrijnë deri në dyfishimin e fondeve të parashikuara fillimisht.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1 Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë/ Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, në vijimësi të krahasojë kërkesat buxhetore edhe me PBA-të e viteve të kaluara duke rakorduar ecurinë e investimeve kapitale me qëllim mirë menaxhimin e tyre për të evituar krijimin e detyrimeve të prapambetura, ndryshimet në prioritetet e projekteve, si dhe cënimin apo favorizimin e projekteve specifike.

Menjëherë dhe në vijimësi

19.1. Gjetje nga auditimi: Me Urdhrin nr.89 datë 13.06.2018 të Kryeministrit është miratuar struktura organizative e MFE, ku Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit paraqitet me 5 drejtori varësie: Drejtoria e Analizës dhe Programit Buxhetor, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike, Drejtoria e Financave Vendore dhe Drejtoria e Strehimit. Nga auditimi konstatohet se pas miratimit të strukturës nuk është rishikuar Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për rrjedhë edhe e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit. Rregullorja e Brendshme miratuar me Urdhrin nr.17 datë 29.01.2016 të Ministrit (në fuqi përgjatë kësaj periudhe) nuk ka parashikuar një sërë pozicionesh të krijuara me strukturën e re, dhe paraqitet në mospërputhje me nenet 8 dhe 9 të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar. Pjesë e strukturës së DPB është bërë edhe Drejtoria e Strehimit, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e programit të strehimit duke hartuar përgjatë vitit propozimet për hartimin e buxhetit nën këtë program, përcjelljen e kërkesave për rishikim të fondeve të këtij programi gjatë vitit (si për shpenzime operative, subvencionime apo projekte investimi) dhe monitorimin e realizimit të buxhetit. Këto dokumentacione përcillen pranë DPB, e cila nga ana tjetër është përgjegjëse për menaxhimin në tërësi të procedurave lidhur me buxhetin, dhe janë pikërisht drejtoritë e DPB që kryejnë vlerësimet sipas detyrave dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

përgjegjësi përkates për procedurat e hartimit, rishikimit dhe monitorimit të buxhetit sipas programeve të miratuara, ku një ndër programet është pikërisht ai i strehimit, i menaxhuar nga një drejtori varësie e DPB.

19.2 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në regjistrin për risqet që i përkasin Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit konstatohen sërish problematikat e trajtuara edhe në auditimin e mëparshëm të KLSH. Konkretisht, ky dokument i referohet risqeve vetëm për 2 Drejtori nga 5 të DPB (Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor dhe Drejtorinë e Menaxhimit të Buxhetit) ku risqet e adresuara janë të përditësuara vetëm për Drejtorinë e Menaxhimit të Buxhetit. Pjesa tjetër e risqeve i referohet periudhave të mëparshme duke mos qenë risqe relevante të lidhura me periudhën objekt auditimi.

19.3 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në vijim të masave të marra për implementimin e 18 produkteve të shkëputura nga Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2019-2022 që i përkasin Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, është përcjellë informacion vetëm për objektivat që lidhen me Drejtorinë e Menaxhimit të Buxhetit, konkretisht 3 produkte. Në kushtet ku nuk është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacionin mbështetës si dhe statusin e realizimit të këtyre produkteve, apo raporti e monitorimit të vitit 2020 nga Drejtoria e PFM pranë MFE (i cili rezulton i pa publikuar në faqen zyrtare), arrijmë në konkluzionin se për vitin 2020 nuk është ndërmarrë asnjë masë për arritjen e tyre. Risqet që mund të jenë identifikuar gjatë vitit 2020 që kanë çuar më pas në mos realizim (si periudha e tërmetit apo COVID-19), nuk janë reflektuar në regjistrin e risqeve për të parashikuar planin e aktiviteteve për periudhën e mbetur të strategjisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1. Rekomandimi: Ministri i Financave dhe Ekonomisë të analizojë rolin dhe rëndësinë e programit që Drejtoria e Strehimit menaxhon, dhe ekzistencën e një konflikti të mundshëm në procesin e miratimit të buxhetit për shkak të organigramës aktuale, e cila e cakton këtë drejtori në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit.

Brenda vitit 2021

19.2. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për plotësimin e Rregullores së Brendshme të institucionit më qëllim reflektimin në të, të disa elementëve thelbësorë si përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi deri në nivelin e drejtorëve, përgjegjësve, specialistëve, etj; sipas strukturës organizative të institucionit, si dhe të rishikojë regjistrin e risqeve duke identifikuar, vlerësuar dhe kontrolluar problematikat koherente të pesë drejtorive në strukturën e saj, në zbatim të ligjit për MFK.

Menjëherë dhe në vijimësi

20.1 Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Strehimit, pjesë e strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit menaxhon fondet për Programin e Strehimit (06190), duke hartuar kërkesat buxhetore për PBA-në mbështetur në Strategjinë Sociale të Strehimit 2016-2025. Përgjatë vitit, kjo drejtori (varësi e DPB) monitoron ekzekutimin e buxhetit në programin e strehimit, i cili ka përfshirë shpenzime operative për bonusin e qerasë, subvencionimin e kredive ekzistuese, kredive të reja, grant i menjëhershëm; dhe shpenzime kapitale për projektet e investimit për përmirësimin e kushteve të banimit, rikonstruksionin e godinave në pronësi të njësi të vetëqeverisjes vendore dhe banesave me kosto të ulët. Në vitin 2020 është shtuar edhe produkti i subvencionimit të qerave të familjeve të prekura nga tërmeti.

Konstatohet se niveli aktual i financimit për mbulimin e nevojave financiare në programet sociale të strehimit rezulton të ketë mbuluar deri në fund të vitit 2020, 2,440 milion lekë ose 43% të buxhetit parashikuar në Strategjinë për Strehimin Social 2016-2025, ku rezulton se në vijim të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

propozimeve të DS gjatë PBA-së, për vitin 2020 janë miratuar fondet vetëm për investimet në vazhdim, dhe jo për projekte të reja. Draft vlerësimi i Strategjisë së hartuar nga Drejtoria e Strehimit është kryer duke përfshirë në realizim edhe fondet e alokuara përgjatë vitit 2020 për subvencionimin e qerave të familjeve të prekura nga tërmeti dhe shpronësimet në vijim të programit të rindërtimit të cilat faktikisht nuk janë marrë në konsideratë në momentin e hartimit të strategjisë. Një analizim i tillë, e paraqet nivelin e realizimit deri në vitin 2020 në masën 95% të objektivave planifikuar në harkun 10 vjeçar 2016-2025, ku faktikisht në mënyrë që të jenë të krahasueshëm dhe të mos mbivlerësohen, nuk duhet të përfshijnë fondet e subvencionimit të qerave të tërmetit, të cilat i përkasin një situatë emergjente.

Akti normativ nr.8, datë 17.12.2019 òPër përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qerasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019 ka parashikuar fondin sipas produktit 91010AE òSubvencionim i qirasë për familjet e prekura nga tërmeti” në Programin e Strehimit prej 1 miliard lekë me afat 1 vjeçar. Nga auditimi konstatohet se në bazë informacionit të vendosur në dispozicion nga bashkitë për kërkesat për subvencionim qeraje në fillim të vitit 2020, ky nivel financim do të mbulonte vetëm 44% të kërkesave. Deri në fund të vitit, pas shtesave të fondeve nën këtë produkt janë alokuar për 13 bashki rreth 2,900 milion lekë, pra rreth 1.9 miliard më shumë se plani fillestar, dhe gjithashtu është shtyrë periudha e subvencionimit parashikuar me aktin normativ fillimisht për vetëm 1 vit, duke vijuar edhe përgjatë vitit 2021, në kushtet kur ende nuk ka përfunduar rindërtimi i objekteve për sistemimin e qytetarëve të prekura nga tërmeti.

20.2 Gjetje nga auditimi: Në zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 22/2018 òPër Strehimin Socialò, çdo subjekt privat, që pas hyrjes në fuqi të ligjit, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2000 m² ka detyrimin të kalojë pranë bashkisë të paktën 3% të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm në favor të fondit publik të banesave sociale. Për zbatimin e këtij kriteri nga ana e SP të MFE është përcjellë në vitin 2019 shkresa për vendosjen në dispozicion të informacioneve përkatëse, pra për lejet e dhëna mbi 2000 m² dhe sipërfaqet e kaluara në funksion të banesave sociale. Në zbatim të saj, pranë Drejtorisë së Strehimit është përcjellë informacion përgjatë vitit 2019 nga vetëm 7 bashki (nga të cilat vetëm Bashkia Elbasan ka raportuar për 3 banesa sociale në vijim të lejeve të dhëna mbi 2000m²), dhe përgjatë vitit 2020 nga asnjë bashki. Në zbatim të ligjit nuk rezulton të jetë hartuar një akt apo udhëzim për të saktësuar procedurat konkrete që do të ndiqen si për efekt përlllogaritjes të këtyre banesave që do të kalohen në pronësi të bashkisë.

20.3 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se deri në fund të periudhës së auditimit, nuk është hartuar nga Drejtoria e Strehimit një bazë e të dhënave në nivel kombëtar për: nevojat për strehim, me programe sociale strehimi; inventarin e banesave sociale me qira, pronë publike; kushtet fizike dhe teknike të banesave sociale me qira; numrin e familjeve të strehuara me programet sociale të strehimit; sipërfaqen e nevojshme të truallit që duhet pajisur me plan zhvillimi dhe infrastrukturë për ndërtim banesash; sipërfaqet e trojeve, të pajisura me infrastrukturë për ndërtim banesash; bazuar në informacionet e njësive të vetëqeverisjes vendore, detyrë kjo e përcaktuar në të nenin 72, gërma d dhe neni 73, pika 2 të ligjit nr.22/2018 òPër Strehimin Socialò. Për zbatueshmërinë e këtij kriteri Drejtoria e Strehimit nëpërmjet strukturave drejtuese të MFE ka patur një sërë korrespondencash me AKSHI-n dhe Drejtorinë Juridike në MFE dhe Drejtorinë e Strehimit për të saktësuar nëse autoriteti për krijimin e një databaze kombëtare mund të ushtrohet nga ministri me një udhëzim sikundër përcakton ligji, apo ky udhëzim duhet miratuar nga nivele më të larta hierarkike; ku konstatohet se në vijim të cilave ende nuk është mundësuar krijimi i këtij regjistri pa të cilin nuk mund të kryhet asnjë planifikim apo analiza të situatës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1. Rekomandimi: MFE të marrë masat për të hartuar një udhëzues për strehimin social duke përcaktuar procedurat konkrete që do të ndiqen për të përlogaritur dhe kaluar në pronësi të bashkive banesat e shërbimit social për lejet e dhëna mbi 2000 m², dhe periodicitetin e raportimit të njësisive të vetëqeverisjes vendore për numrin e lejeve të ndërtimit të përcjella nga data 30 Nëntor 2018; sipërfaqen totale ndërtimore të banimit sipas lejes së ndërtimit dhe sipërfaqen që i takon bashkisë dhe numrin e banesave sociale që sigurohen deri në vitin 2021 pranë Drejtorisë së Strehimit në MFE.

Brenda vitit 2021

20.2. Rekomandimi: MFE, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në drejtorinë juridike të institucionit të marrin masat për zgjidhjen e problematikave që nuk kanë mundur deri në këto momente krijimin e një bazë të dhënave në nivel kombëtar bazuar në informacionet e njësisive të vetëqeverisjes vendore.

Menjëherë

20.3. Rekomandimi: Gjatë hartimit të vlerësimit afatmesëm të Strategjisë së Strehimit, Drejtoria e Strehimit të diferencojë fondet e realizuara në kuadër të tërmetit, me fondet e akorduara për aktivitetin normal të programit të strehimit, në mënyrë që plani i objektivave në hartimin e strategjisë 10 vjeçare të jetë i krahasueshëm me faktin, duke mos e mbivlerësuar këtë të fundit.

Në vijimësi

21.1 Gjetje nga auditimi: Nga vlerësimi i kuadrit rregullator në fuqi lidhur me ciklin buxhetor u konstatua se:

-Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 *“Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 48 i tij ò Afati për rishpërndarjen e fondeve buxhetore, përcakton se ò E drejta e njësisive të qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve, të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri në datën 15 nëntor të çdo viti buxhetor. ò Nëse i referohemi afatit të përcaktuar në udhëzimin nr.9 datë 20.07.2018 òPër Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit, pika 76 e tij përcakton se “ E drejta e njësisë së qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri në datën 15 nëntor të çdo viti, e cila konsiderohet data e fundit e paraqitjes së kërkesës tek Nëpunësi i Parë Autorizues. ò Në kuptim të kësaj pike, çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme mund të kryejë rishpërndarje të fondeve të miratuara me kusht që kërkesa nga ana e tyre të jetë iniciuar dhe dorëzuar tek NPA përpara datës 15 Nëntor, ndërkohe që përcaktimi në ligj i referohet datës së fundit ku mund të ushtrohet e drejta për rishpërndarje të fondeve nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në dallim me përcaktimin në udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018 ku data 15 nëntor i referohet datës së fundit kur mund të përcillet kërkesa për rishpërndarje pranë NPA. Si rezultat, rishpërndarjet e fondeve të njësisive të qeverisjes së përgjithshme janë konstatuar të miratohen dhe reflektohen në SIFQ jo vetëm pas datës 15 Nëntor, por edhe në fillim të vitit pasardhës, me kushtin e vetëm që kërkesa nga njësitë të jetë përcjellë deri në datën 15 Nëntor.*

-Në të njëjtën linjë si më sipër, neni 51, pika ògö e Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH, përcaktohet se òNëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor”.* Ndërkohë, udhëzimi për zbatimin e buxhetit, në pikën 83 të tij se *“Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor”*, dhe në aneksin òGjurma Standarte e Auditimit për Ekzekutimin e Shpenzimeve 2/5 ò përcakton se



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

“Angazhim, do të thotë ngurtësim i fondeve për shumën e kontratës”. VKM nr. 807 datë 16.11.2016 òPër disiplinimin e angazhimeve buxhetore publikeò, e dalë në zbatim të ligjit, e lidh ndërmarrjen e angazhimeve me publikimin e procedurave të reja të prokurimit, duke përcaktuar në pikën 1 të saj se: òPas datës 15 tetor të çdo viti buxhetor, njësitë e qeverisjes së përgjithshme nuk mund të publikojnë njoftimin për prokurimin e mallrave/punëve/shërbimeve, të cilat nuk janë përfshirë në regjistrin e prokurimeve publike, deri në këtë datë.”. Pika. 2 e kësaj VKM përcakton se: òPas datës 15 tetor, procedurat e prokurimeve publike, të parashikuara në regjistrin e prokurimeve publike, mund të fillojnë/vazhdojnë vetëm për ato projekte që janë pjesë e buxhetit tre-vjeçar, të miratuar për njësinë përkatëse të qeverisjes së përgjithshme. Lidhja e kontratës në këtë rast bëhet vetëm pasi fondi të jetë vënë në dispozicion në llogarinë e autoritetit kontraktor, në buxhetin e tij, të miratuar për vitin buxhetor pasardhësò.

21.2 Gjetje nga auditimi: Udhëzimi nr.22, datë 17.11.2016 òPër Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit për Njësitë e Qeverisjes Qendrorëò, përcakton procedurat dhe afatet që duhet të ndjekin njësitë e qeverisjes qendrore gjatë monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e politikës së realizuar për çdo program të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të PBA. Nga auditimi konstatohet se për sa i përket procedurave që duhet të ndjekin të gjitha institucionet e buxhetore të varësisë nga ana e MFE nuk është hartuar një udhëzues i ngjashëm. Si rezultat, mbetet i pa rregulluar procesi i monitorimit të ekzekutimit të buxhetit nga këto njësi, me qëllim vlerësimin e performancës nëpërmjet krahasimit të treguesve faktik me ato të planifikuar, si dhe propozimin e ndërmarrjes së veprimeve korrigjuese për ri alokimin e burimeve, problematikë kjo e konstatuar edhe në auditimet e KLSH pranë tyre. Mungesa e këtyre raporteve të progresit për performancën e objektivave, produkteve dhe shpenzimeve, nuk mundëson sigurimin e informacionit nga ana e njërive të qeverisjes qendrore eprore ku këto institucione e cila është thelbësore veçanërisht në fondet e investimeve, për të kryer më pas rishikime të fondeve në dispozicion bazuar në ecurisë e implementimit të tyre.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë me strukturat e saj të iniciojnë procesin e vlerësimin dhe harmonizimit të kuadrit ligjor me atë nënligjor, në lidhje me afatin e fundit të rishpërndarjeve buxhetore në kuptim të òushtrimit të së drejtës së institucioneve të njërive të qeverisjes së përgjithshmeò duke përcaktuar një datë kërkesë më të hershme që mundëson miratimin e tyre në një afat kohor ku është i mundur përdorimi i tyre brenda vitit buxhetor, dhe shmang nxjerrjen e akteve normative për rishpërndarje buxhetore në fundvit.

21.2. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë me strukturat e saj të iniciojnë procesin e vlerësimin dhe harmonizimit të kuadrit ligjor me atë nënligjor, në kuptim të nenit 51, pika ògò e Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò: òNëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor”.

21.3. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik të marrin masat për hartimin e një udhëzuesi të brendshëm për procedurat e monitorimit të buxhetit nga njësitë e varësive të njërive të qeverisjes qendrore, në mënyrë që informacioni i konsoliduar mbi ecurinë e investimeve publike në përgjegjësinë e tyre të jetë i plotë dhe koherent me statusin aktual të ecurisë së projekteve. Kjo për të shërbyer ndërmarrjes në kohë të veprimeve korrigjuese për rishpërndarjen e fondeve buxhetore të këtyre njërive sipas rastit.

Brenda vitit 2021



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

22.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se monitorimi aktual i stokut të detyrimeve të prapambetura i kryer nga Ministria e Financave nuk mundëson përputhshmërinë e plotë me Udhëzimin nr.5, datë 27.02.2014 *oPër shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*, konkretisht pikën 31 të tij, e cila parashikon ndër të tjera hartimin e një informacioni duke përfshirë *gjendjen fillestare të detyrimeve sipas kategorive, sektorëve dhe kohës së krijimit dhe zhvillimin e një sondazh tremujor tek ministritë e linjës nga MFE për të verifikuar detyrimet financiare të krijuara rishtas dhe të papaguara në kohë, duke përcaktuar përgjegjësinë dhe vendosur masa administrative sipas kuadrit ligjor në fuqi*. Në kushtet kur MFE, nuk ka shfuqizuar udhëzimin e vitit 2014, në udhëzimin e ri të vitit 2020 nuk ka parashikuar procedura të ngjashme monitoruese, por ka rregulluar procesin e raportimit të informacionit mbi këto detyrime nëpërmjet sistemit të thesarit dhe DPT, por pa mundur të përmirësojë raportimin e detyrimeve të reja të prapambetura, Ky mbetet sërish një proces vetëdeklarues i cili nuk siguron plotësinë dhe saktësinë e raportimit të stokut të detyrimeve të prapambetura.

22.2 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se **nuk ka një plan veprimi** të miratuar për ndërmarrjen e iniciativave në drejtim të menaxhimit të detyrimeve të prapambetura dhe një plani konkret për likuidimin e tyre. Udhëzimi plotësues nr.27, datë 10.07.2020 *oPër përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023*, ndër të tjera ka përcaktuar se në hartimin e tavanëve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023, njësitë e vetëqeverisjes duhet të përfshijnë edhe planin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura. Në zbatim të saj, njësitë vendore kanë përcjellë informacion lidhur me detyrimin e mbetur deri në muajin Dhjetor 2020 duke hartuar edhe planin e shlyerjes së stokut të detyrimeve për tre vitet në vazhdim 2021-2023. Megjithatë, ndryshe nga sa kërkuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka kërkuar nga njësitë e qeverisjes qendrore hartimin e një plani për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, me qëllim përfshirjen e tij në propozimet e PBA-së. Hartimi në këtë formë i PBA-së do të mund të garantonte që fondet e kërkuara nga institucionet të kenë marrë në konsideratë fillimisht likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe detyrimet në kuadër të kontratave në zbatim, përpara financimit të projekteve të reja në zbatim të nenit 43 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *oPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*, Ligjit për Buxhetin e vitit 2020, dhe Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 i cili në pikën 63 të tij përcakton prioritet për t'u mbajtur parasysh në planifikim.

22.3 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi paralel nga KLSH në Drejtorinë e Përgjithshme Thesarit sipas programit të auditimit nr. 177/1, 12.02.2021 për periudhën objekt auditimi vitin 2020, janë konstatuar një sërë problematikash lidhur me **disiplinimin e angazhimeve buxhetore dhe parandalimit të krijimit të detyrimeve të prapambetura nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme**. Më hollësisht janë konstatuar 550 nga 743 urdhër-prokurime me datë kontrate përpara datës së regjistrimit të urdhër-prokurimit; 7 raste me vlerë fondi limit 4,270 milion lekë, ku janë marrë angazhime për projekte pa kaluar në procesin ligjor të miratimit në PBA; 13 procedura të zhvilluara pas datës 15 Tetor pa qenë pjesë e buxhetit tre vjeçar, me vlerë fondi limit 2,850 milion lekë; 14982 kontrata ose 63% e totalit të kontratave të regjistruara me vlerë 131,500 milion lekë janë regjistruar në shkelje të afatit 5 ditor; mos respektim i radhës së pagesave (parimi FIFO); 32927 fatura me vlerë 45,400 milion lekë të dorëzuara në Thesar jashtë afatit 30 ditor; 66 raste me vlerë 122 milion lekë të tejkalimit të afatit 30 ditor të procesimit dhe ekzekutimit të pagesave; 79 raste të regjistrimit dhe pagesave pjesore të faturave. Nga auditimi për vitin 2020 u konstatuan 54 raste projekte investimi ku vlera e rishikimeve paraqitet rreth 2,000 milion lekë dhe alokimi i fondeve shtesë është kryer për likuidimin e faturave të prapambetura (rreth 897 milion lekë) të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

këtyre projekteve, dhe këto projekte nuk ka qenë pjesë e projekteve të miratuara me ligjin vjetor të buxheti. Gjithashtu, relacioni i Aktit Normativ Nr.28 datë 02.07.2020 òPër disa ndryshime në Ligjin nr.88/2019 òPër buxhetin e vitit 2020, i ndryshuar dhe Akti Normativ nr. 34 datë 16.12.2020 i faktin mangësitë në fazën e çeljes së buxhetit, pasi në këto akte parashikohet alokimi i fondeve në masën totale 4,200 milion lekë për shpenzime shpronësimi **dhe shlyerje detyrimesh të prapambetura në sektorin e infrastrukturës**, të cilat rezultojnë se nuk janë marrë në konsideratë në planin buxhetor fillestar të vitit 2020. **Kryerja e rishikimeve përgjatë vitit për alokimin e fondeve të cilat janë përdorur për likuidimin e detyrimeve të kontratave të lidhura në vitet e mëparshme, është një ndër treguesit që gjatë hartimit të projekt buxhetit, nuk janë marrë në konsideratë këto detyrime.** Këto situata konstatohen si me impakt negativ për krijimin e detyrimeve të prapambetura dhe nuk kanë garantuar parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja të prapambetura, për shkak të cënimit të kontrolleve për marrjen e angazhimeve buxhetore pa fonde disponibël, apo për marrjen e masave për reduktimin e këtij stoku.

Sipas raportit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik për vitin 2020, **vetëm 64 njësi shpenzuese** kanë përcjellë pranë Drejtorisë së Harmonizimit informacion mbi kryerjen e auditimeve të detyrimeve të prapambetura nga njësitë e Auditit të Brendshëm, duke reflektuar kështu një rol pasiv të këtyre njësive për sa kohë që detyrimet e prapambetura janë përcaktuar si fushë me risk të lartë dhe duhet të trajtohen me përparësi nga auditimi i brendshëm, për të paraqitur gjendjen aktuale dhe për të dhënë rekomandime sa më të vlefshme për shlyerjen e tyre në afate të përcaktuara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1. Rekomandimi: NPA dhe strukturat përgjegjëse pranë MFE të marrin masat për kryerjen e sondazheve periodike tek ministritë e linjës, nëse ekzistojnë detyrime financiare të krijuara rishtas dhe të papaguara në kohë për të përcaktuar pagesat e reja të kërkueshme, që rrjedhin nga faturat ose pretendimet e marra përtej fondeve në dispozicion duke përcaktuar përgjegjësinë dhe vendosur masa administrative sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Pas miratimit të pasqyrave financiare të shqyrtohet mundësia e zhvillimit të rakordimeve me ministritë e linjës me angazhimet që ato kanë marrë për të konfirmuar vlerën e detyrimeve të prapambetura të institucioneve, më qëllim raportimin sa më të plotë dhe të saktë të stokut të detyrimeve në raportimet e konsoliduara të MFE.

Menjëherë dhe në vijimësi

22.2. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit Financiar Publik, apo struktura të tjera të MFE të marrin masat për të hartuar dhe miratuar një plan veprimi konkret dhe një plan shlyerjeje në drejtim të masave që duhet të ndërmerren për pakësimin e stokut ekzistues të detyrimeve të prapambetura dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja, duke u kërkuar njësive e qeverisjes qendrore që gjatë hartimit të tavanëve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm të përfshihet edhe plani i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, sikundër është vepruar për njësitë e vetëqeverisjes vendore, për të garantuar kështu respektimin e prioriteteve që duhet të merren në konsideratë në planifikimin e buxhetit.

Brenda vitit 2021

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi detajimin e fondeve për investimeve publike me financim të brendshëm të miratuara me ligjin nr.88/2019 òPër buxhetin e vitit 2020, të ndryshuar, konstatohet se janë detajuar në institucione të ndryshme **19 Projekte Investimi me vlerë 683.8 milion lekë me përshkrimin “Fond i ngrirë”**. Institucionet më përfaqësuese ku janë detajuar këto



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

fonde përgjatë vitit përfshijnë Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe Autoritetin Rrugor Shqiptar. Detajimi i këtyre fondeve të ngrira për investime kapitale nuk është në përputhje me përkufizimin e projektit të investimit publik ku citohet se *“Projekt investimi” është një seri punimesh, aktiviteteve apo shërbimesh, që synojnë të përmbushin një objektiv të pandashëm të një natyre specifike ekonomike apo teknike, me qëllime qartësisht të identifikuar*. Rezervimi i fondeve të këtyre investimeve sipas detajimit fillestar nuk krijon mundësinë e zhvillimit të procedurave për prokurimin përgjatë vitit apo kryerjen e pagesave në rast të detyrimeve të mbartura dhe në vijim kryhen rishpërndarje ndërmjet projekteve për çdo njësi shpenzuese. Në fund të vitit, sipas planit përfundimtar, vlera e këtyre projekteve paraqitet në shumën 10.4 milion lekë. Detajimi i këtyre fondeve pa projekt specifik në çeljen fillestare në shumën 683.8 milion lekë nuk është në përputhje me kërkesat e udhëzimit plotësues nr. 2 datë 20.01.2020 të MFE, pika 19, ku janë të parashikuara kriteret dhe përparësitë në financimin e projekteve dhe nuk parashikohet çelja e fondeve të ngrira për investimet kapitale të miratuara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

23.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të shmanget praktika e detajimit të fondeve të investimeve në projekte me përshkrim *“Fond i ngrirë”* dhe të alokohen fondet e investimit në projekte specifike për të krijuar mundësinë e përdorimit të fondeve buxhetore të miratuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi investimet kapitale me financim të brendshëm të realizuara nga të ardhurat dytësore, për vitin 2020 të regjistruara në SIFQ, konstatohet se janë realizuar investime kapitale me financim të brendshëm në vlerën për 309.1 milion lekë. Këto investime nuk kanë plan buxheti të miratuar, ndërkohë që në Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar janë raportuar të realizuara ndaj planit të buxhetit. Sipas të dhënave të raportuara në investimet e realizuara për vitin 2020, këto investime janë realizuar në pjesën më të madhe nga të ardhurat e veta të njësisve buxhetore në programin e shërbimeve të kujdesit dytësor të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në shumën 211 milion lekë.

Nga auditimi mbi investimet kapitale me financim të brendshëm të realizuara me burim financimi të ardhurat e arsimit të lartë konstatohet se janë kontabilizuar në llogarinë 231 *“Investime Kapitale Të Trupëzuara”* 13 projekte investimi me vlerë 192.6 milion lekë me përshkrimin investimi *“Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve”* dhe 1 projekt investimi në shumën 977 mijë lekë me përshkrimin *“IAL dhe programe studimi të akredituara”*, në disa njësi shpenzuese të ndryshme. Gjithashtu konstatohet se për këto investime është përdorur i njëjti kod projekti investimi për disa institucione të arsimit të lartë, duke mos identifikuar specifikisht investimet e kryera në nivel produkti investimi me impakt në cilësinë e informacionit të raportuar dhe vështirësi në ndjekjen e ecurisë së tyre. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

24.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të reflektohet në treguesit fiskalë të konsoliduar, sipas tabelës 4 të ligjit të buxhetit të vitit, plani buxhetor për të gjitha investimet kapitale të brendshme me burim financimi të ardhurat e veta sikurse parashikohen për investimet nga të ardhurat e arsimit të lartë. Në të njëjtën kohë, të detajohen në nivel analitik investimet e realizuara nga të ardhurat e veta të arsimit të lartë dhe të shmanget çelja e projekteve të investimit në një kod të përgjithshëm ndërkohë që projektet zbatohen nga njësi shpenzuese të ndryshme.

Menjëherë dhe në vijimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

B. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE, PËRFSHI SHPENZIME TË REALIZUARA NË KUSHTE TË PALIGJSHMËRISË PROCEDURIALE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në lidhje me kontratat e nënshkruara për investimet përgjatë vitit 2020, sipas modulit të kontratave në SIFQ konstatohet se janë nënshkruar mbi 500 kontrata për investime publike me vlerë të kontraktuar rreth 23 miliard lekë, pas datës 15 Tetor, jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. Institucionet më përfaqësuese të cilat nuk respektojnë këtë përcaktim të ligjit përfshijnë Fondin Shqiptar të Zhvillimit me vlerë të kontraktuar 10 miliard lekë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me vlerë të kontraktuar në shumën 7.8 miliard lekë. Lidhja e kontratave pas kësaj date krijon kushtet për lindjen e detyrimeve të prapambetura dhe në të njëjtën kohë për përdorim pa efikasitet të fondeve buxhetore në nivelin e 20% (rreth 5 miliard lekë) të koston së projektit në vitin e parë të zbatimit të tij, pasi koha e mbetur për përdorimin e këtij fondi deri në fund të vitit buxhetor është shumë e shkurtër.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me APP të parashikohen procedura kontrolli përtej atyre aktuale si dhe të integrohen sistemet informatike përkatëse me qëllim disiplinimin e ndërmarrjes së angazhimeve buxhetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi investimet kapitale me financim të brendshëm konstatohet se janë raportuar si investime kapitale, shpenzime të kryera për aktivitetin korent të institucioneve buxhetore në **shumën 1,198 milion lekë**, të cilat duhet të ishin planifikuar dhe realizuar në zërin e shpenzimeve korente sipas klasifikimit të bërë në tabelën 4 të ligjit të buxhetit të vitit. Rastet në të cilat janë konstatuar këto problematika përfshijnë:

-Në Autoritetin Rrugor Shqiptar, konstatohet se raportohet si investim i realizuar në vitin 2020, projekti i investimit me kod M062991 me përshkrim ÷Vendime gjyqësore në procesë me vlerë për 446.6 milion lekë, buxhetuar dhe realizuar nga ky institucion, nga të cilat 397 milion lekë për vendime gjyqësore të viteve 2014-2019 sipas datës së paraqitur në sistemin informatik financiar të qeverisë, ndërkohë që për planifikimin dhe realizimin e këtyre shpenzimeve duhet të ishin përdorur llogaritë e shpenzimeve operative.

-Në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në programin buxhetor 6210 ÷Programe zhvillimi raportohet si investim i realizuar kosto lokale e menaxhimit të projekteve të investimit në shumën 302 milion lekë, me kod projekti ÷M5603220 Projekti i rrugëve dytësore dhe lokale, me përfitues Fondin Shqiptar të Zhvillimit, ndërkohë që këto fonde përdoren në llogari bankare të nivelit të dytë nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për aktivitetin e shpenzimeve korente të institucionit.

-Në AZHBR, nga auditimi mbi investimet e realizuara në programin 4250 ÷Zhvillimi rural konstatohet se janë raportuar investime kapitale me kod projekt 18AL301 ÷Përfitues nga Programi IPARD II nga masa 10 në shumën 449 milion lekë, nga kapitulli 3 ÷kosto lokale. Në bazën e të dhënave të pagesave të realizuara në SIFQ konstatohet se njësi shpenzuese është AZHBR me përfitues Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me përshkrimin Fondi Kombëtar IPARD II, kosto lokale dhe sipas pagesës së listave përkatëse. Këto pagesa kryhen në kuadër të bashkëfinancimit të fondeve të BE për mbështetjen e fermerëve/agroturizimit në kryerjen e investimeve nga ana e investitorëve. Pjesa e buxhetit të shtetit në kuadër të bashkëfinancimit është në masën 25%, ndërkohë që konstatohet se për nga natyra, nuk kemi të bëjmë me investim kapital, por me grant të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

dhënë të tretëve. Në këtë mënyrë, treguesit e investimeve publike janë të mbivlerësuar si pasojë e raportimit të realizimit të këtij projekti, pasi nuk kemi të bëjmë me kryerjen e investimeve publike ku pronar është shteti, por dhënien e grantit drejt përfituesve të ndryshëm për kryerjen e investimeve nga ana e tyre.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë gjatë fazës së diskutimit të kërkesave buxhetore dhe në vijim të detajimit të fondeve sipas kërkesave të institucioneve buxhetore të zhvillohet një analizë mbi natyrën ekonomike të fondeve të kërkuara me qëllim klasifikimin dhe raportimin e drejtë të shpenzimeve sipas natyrës dhe destinacionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2020, nga auditimi i investimeve kapitale me financim të huaj është konstatuar se, 2 projekte investimi në vlerën 12.7 milion lekë janë realizuar pa pasur një plan buxhetor të miratuar me Ligjin e Buxhetit apo me Aktet Normative në zbatim të tij. 12 projekte investimesh të huaja me Kredi për vlerën 1,995 milion lekë janë realizuar në tejkallim të planit të buxhetit dhe 48 projekte investimesh të huaja në formën e Grantit për vlerën 1,423 milion lekë janë realizuar në tejkallim të planit të buxhetit. Referuar të dhënave në SIFQ. Është konstatuar se në 3 raste, i njëjti projekt investimi është çelur në SIFQ, me më shumë se dy kode.

Gjithashtu për 39 projekte investimi me financim të huaj në vlerën totale 2,273 milion lekë, referuar përshkrimit janë konstatuar keq klasifikime në llogarinë 231 Investime për aktiveve afatgjata materiale. Nga auditimi janë konstatuar projekte shërbimi, studimi, asistencë, konsultimi, monitorim të cilat janë klasifikuar si investime për rritjen e aktiveve afatgjata material, të cilat duhet të ishin klasifikuar në llogarinë 230 Investime afatgjata jo material. Gjithashtu janë konstatuar edhe projekte të klasifikuar si investime për rritjen e aktiveve afatgjata materiale ose investime për rritjen e aktiveve afatgjata jo materiale, si IPARD, ERASMUS, P.A.S.T 4 Future, NEST, etj, për të cilët janë angazhuar fonde të planifikuara si investime, për kryerjen e shpenzimeve operative si paga, dieta, sigurime, evente, transfera ndaj të tretëve. Për këto projekte nuk janë kryer shpenzime për krijimin e një asemi të prekshëm ose të paprekshëm dhe rrjedhimisht nuk plotësohen kushtet për njohjen e një aktivi në pasqyrën e pozicionit financiar. Sa më sipër konstatohet se ka mungesë monitorimi në raportimet për investime kapitale me financim të huaj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për fuqizimin e kontrollit të brendshëm në drejtim të raportimit të saktë dhe të plotë të investimeve publike me financim të huaj, nëpërmjet përfshirjes së tyre në ciklin e menaxhimit të shpenzimeve buxhetore për t'u siguruar për përputhshmërinë me planet vjetore dhe tavanet përkatës buxhetore.

3.2 Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë/ Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të marrë masa për fuqizimin e rolit të Drejtorisë së Menaxhimit të Investimeve Publike në MFE, në drejtim të monitorimit të procesit të investimeve publike me financim të huaj me qëllim rritjen e cilësisë së menaxhimit të fondeve publike dhe llogaridhënies së strukturave që kryejnë shpenzime buxhetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi detajimin dhe rishpërndarjen e fondeve të investimeve përgjatë vitit 2020 janë konstatuar problematika në lidhje me mosrespektimin e kontroleve të parashikuara për disiplinimin e angazhimeve buxhetore që përfshijnë: marrjen e angazhimeve pa fonde buxhetore në dispozicion, detajimin e projekteve të investimeve publike me akt normativ pa



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

kaluar në PBA 2020-2022, detajimin e fondeve të investimeve për vetëm vlerën e 20% të kostos së projektit pa buxhet në vitet pasardhëse buxhetore, detajimin e planit buxhetor në 3 vite për kontrata që parashikojnë periudhë faturimi më të vogël se një vit, shkurtimin e fondeve të investimit në momentin e lidhjes së kontratës dhe rialokimin drejt projekteve të tjera të investimit publik detyrime të prapambetura apo në proces nga vitet e kaluara, mos regjistrimin e kontratave dhe obligimit në SIFQ duke krijuar detyrime të prapambetura. Miratimi i dhënë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në detajimin fillestar të fondeve të investimit apo rialokimet e kryera përgjatë vitit me akte normative ose jo, nuk kanë kontribuar në disiplinimin e angazhimeve buxhetore dhe rrjedhimisht në parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura. Problematika për angazhimet përtej fondeve të disponueshme reflektohet edhe në projekt buxhetin e vitit 2021 në programet e transportit rrugor, programe zhvillimi dhe furnizimi me ujë dhe kanalizime pasi konstatohet përfshirja e planit të buxhetit pas vitit 2023, jashtë periudhës në të cilën miratohet buxheti duke mos marrë në konsideratë financimin trevjeçar të tyre.

Celja e shumë projekte të investimit publik dhe copëzimit të buxhetit për kontratat e nënshkruara apo angazhimet në proces, krijojnë kushte për detyrime të prapambetura dhe presion rritës në nivelin e borxhit publik e imponuar nga nevoja për financim në përputhje me ecurinë e faturimit të punimeve.

Vlerat e detajuara për projektet e investimeve dhe rishikimet e buxhetit përgjatë vitit nuk kanë shkuar për financimin e projekteve ekzistues, por për hapjen e projekteve të reja, duke lejuar krijimin e detyrimeve të prapambetura në këtë program buxhetor, kjo jo në përputhje me **parashikimet e bëra në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Me gjithë ndryshimin e buxhetit me akte normative edhe në fund të vitit, shtesa e fondeve buxhetore akomodimin e detyrimeve të prapambetura të mbartura dhe ato të krijuara rishtas gjatë vitit.**

Të analizuara sipas programeve buxhetore për investime kapitale me financim të brendshëm dhe institucioneve përkatëse ku janë konstatuar problematikat paraqiten si vijon:

-Programi buxhetor 6210 “Programe zhvillimi” nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Nga auditimi konstatohet se ky program buxhetor me Aktin Normativ nr. 28 datë 02.07.2020 është rritur me 3 miliard lekë për hapjen e 21 projekteve të reja investimi të cilët nuk kanë kaluar ciklin e menaxhimit të investimeve publike në PBA 2020-2022¹⁷. Nga auditimi konstatohet se buxheti i kërkuar për vitin 2021 për këto 21 projekte paraqitet në shumën 6,994 milion lekë, ndërkohë që sipas ligjit nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, i ndryshuar tavani buxhetor është miratuar në shumën 3.8 miliard lekë, duke lejuar kështu ndërmarrjen e angazhimeve përtej kufirit të miratuar. Në vijim, me Aktin Normativ nr. 34 datë 16.12.2020 fondi Programi buxhetor 6210 Programe zhvillimi nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit është ulur me 1.3 miliard lekë. Faktikisht, nga auditimi rezulton se për 20 nga 21 projekte të parashikuara, kontratat e nënshkruara janë në shumën 5,951 milion lekë ndërkohë që fondet në dispozicion në muajin dhjetor 2020 për to paraqiten në shumën 880 milion lekë ose **1,271 milion lekë angazhime përtej tavanit të miratuar për vitin 2021.**

Përveç projekteve të mësipërme, në muajt Shtator dhe Tetor 2020, është miratuar rialokimi i projekteve të reja, duke detajuar vetëm vlerën e 20% të projektit të investimit në vitin e parë. Vlëra e buxhetuar për vitin 2020 për këto projekte është në shumën 543 milion lekë dhe plani përfundimtar pas rishikimeve në shumën 238 milion lekë (as sa 20% e buxhetit të vitit të parë),

¹⁷ referuar shkresës së MFE nr. 12507/97 datë 03.08.2020 për miratimin e rialokimit të fondeve me kërkesën e FSHZH me nr. 1453/3 datë 27.07.2020.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

ndërkohë që konstatohet se janë lidhur 4 kontrata me afat 8-12 muaj në shumën 1,431 milion lekë duke rezultuar kështu **me një angazhim në shumën 1,193 milion lekë përtej tavanit të vitit 2021.**

-Programi buxhetor 4520 “Transporti rrugor”, MIE dhe ARRSH. Programi buxhetor “Transporti rrugor” për investimet me financim të brendshëm është planifikuar me ligjin e buxhetit të vitit në shumën 14,496 milion lekë. Me Aktin Normativ nr.6 datë 21.03.2020 është ulur financimi i këtij programi me 500 milion lekë, në projektet e studim projekteve në fushën e infrastrukturës, supervizionit të punimeve dhe një kontratë koncesionare. Me aktin Normativ nr. 15 datë 15.04.2020 vlera e investimeve është ulur me 1 miliard lekë, reflektuar në planin e kontratës koncesionare të rrugës së Arbrit. Me aktin Normativ nr. 28 datë 28/2020 vlera e financimit është rritur me 7,196 milion lekë. Në muajin Gusht është kryer rialokim ndërmjet projekteve, ku fondi i ngrirë është detajuar në projektin 18BS609 “Ndërtim mbikalimi Teg dhe rrugët lidhëse të tij”. Në muajin Tetor 2020 janë kryer përsëri rialokime duke shtuar projektet 18BA201 “Kontrata e Koncesionit/PPP për përmirësimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e rrugës së Arbrit” në shumën 370 milion lekë (ulja e mëparshme 1,000 milion lekë) dhe duke shtuar projektin 18BS612 “Ndërtim rruga Palasë Dhërmi” në shumën 440 milion lekë (përballuar nga ulja “Ndërtim rruga Kardhiq - Delvine Loti 7”, projekt në vazhdim nga viti 2019 dhe projekti i shpronësimeve). Në muajin Nëntor është ulur përsëri vlera e shpronësimeve të planifikuara dhe janë shtuar dy projekte të reja të investimeve, konkretisht projekti 18BS532 “Rikonstruksion i rrugës Dukaj - Sinanaj, Tepelenë” në shumën 100 milion lekë dhe projekti 18BS533 “Ndërtim i rrugës, lidhja e Autostrades Milot - Morine me Aeroportin e Kukësit” në shumën 144 milion lekë. Konstatohet se rialokimet ndërmjet projekteve shtojnë vlerat për projekte të reja, ndërkohë që ndërpresin financimin për projekte në vazhdim, projektin koncesionar dhe kontrata të vitit 2019, me efekt në krijimin e detyrimeve në prapambetura. Kryerja e rishikimeve pas 15 Nëntorit është në kundërshtim me afatin e parashikuar në ligjin e buxhetit për rishpërndarjen e fondeve buxhetore si dhe akomodon efektet e detyrimeve të pa financuara si pasojë e alokimit të buxhetit në projekte infrastrukturore në masën 20 % të çelura me akt normativ në Korrik 2020, pa kaluar në PBA 2020-2022.

Projektet e evidentuara me problematika nga auditimi në këtë program buxhetor përfshijnë:

-Projekti 18BS612 “Ndërtim rruga Palasë – Dhërmi”, është detajuar në muajin Tetor 2020 me vlerë të buxhetuar vetëm për vitin 2020 në shumën 440 milion lekë, e cila në Dhjetor 2020 është rishikuar me plan përfundimtar 1,000 lekë. Ky projekt nuk ka qenë pjesë e PBA 2020-2022, ndërkohë që paraqitet në PBA 2021-2023 në shumën 850 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se për këtë projekt janë filluar procedurat e prokurimit në datë 22.10.2020 është lidhur kontrata në shumën 1,875 milion lekë me TVSH në vitin 2021. Konstatohet se procedura e prokurimit ka vazhduar megjithëse nuk ka pasur fonde dhe vlera e angazhuar në total nuk përputhet me koston e këtij projekti në PBA 2021-2023 në shumën 850 milion lekë, **duke ndërmarrë angazhime përtej buxhetit të miratuar në shumën 1,025 milion lekë** me efekt në krijimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe ky projekt nuk është parashikuar të financohet në Projekt Buxhetin 2021.

-Projekti 18BS609 “Ndërtim mbikalimi TEG dhe rrugët lidhëse të tij”, është detajuar në muajin Gusht 2020 me vlerë të buxhetuar për vitin 2020 në shumën 340 milion lekë, e cila në Dhjetor 2020 është rishikuar me plan përfundimtar 1,000 lekë. Ky projekt nuk ka qenë pjesë e PBA 2020-2022, ndërkohë që paraqitet në PBA 2021-2023 në shumën 889 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se për këtë projekt janë filluar procedurat e prokurimit në datë 15.10.2020 dhe është lidhur kontrata në shumën 1,683 milion lekë me TVSH në vitin 2021. Konstatohet se procedura e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

prokurimit ka vazhduar megjithëse për këtë projekt investimi nuk ka pasur fonde në dispozicion dhe vlera e angazhuar në total nuk përputhet me koston e këtij projekti në PBA 2021-2023 në shumën 889 milion lekë, **duke ndërmarrë angazhime përtej buxhetit të miratuar në shumën 794 milion lekë.**

-Projekti 18BS532 “Rikonstruksion i rrugës Dukaj–Sinanaj Tepelenë”, është detajuar në muajin Nëntor 2020 me vlerë të buxhetuar për vitin 2020 në shumën 100 milion lekë, e cila në Dhjetor 2020 është rishikuar me plan përfundimtar 1,000 lekë. Ky projekt nuk ka qenë pjesë e PBA 2020-2022, ndërkohë që nuk paraqitet as në PBA 2021-2023 dhe as në listën e investimeve paraqitur me Projekt Buxhetin 2021. Nga auditimi konstatohet se për këtë projekt janë filluar procedurat e prokurimit në datë 19.10.2020 dhe është lidhur kontrata në 21.12.2020 në shumën 457 milion lekë. Konstatohet se procedurat e prokurimit kanë filluar përpara se të detajohen fondet në SIFQ, pra pa pasur fondet në dispozicion dhe **vlera e angazhuar në total në shumën 457 milion lekë.**

-Projekti 18BS533 “Ndërtim i rrugës, lidhja e Autostradës Milot - Morinë me Aeroportin e Kukësit”, është detajuar në muajin Nëntor 2020 me vlerë të buxhetuar për vitin 2020 në shumën 144 milion lekë, e cila në Dhjetor 2020 është rishikuar me plan përfundimtar 1,000 lekë. Ky projekt nuk ka qenë pjesë e PBA 2020-2022, ndërkohë që nuk paraqitet as në PBA 2021-2023 dhe as në listën e investimeve paraqitur me Projekt Buxhetin 2021. Nga auditimi konstatohet se për këtë projekt janë filluar procedurat e prokurimit në datë 19.10.2020 dhe është lidhur kontrata në 24.12.2020 në shumën 681 milion lekë. Konstatohet se procedurat e prokurimit kanë filluar pa pasur fondet në dispozicion dhe **vlera e angazhuar në shumën 681 milion lekë është përtej buxhetit të miratuar,** si dhe ky projekt nuk është parashikuar që të në Projekt Buxhetin 2021.

-Projekti 18BS529 “Ndërtim rruga Korçë Ersekë Loti 2 (pjesa e parë), është parashikuar në PBA 2020-2022 me plan buxheti në total për tre vite në shumën 1,200 milion lekë. Detajimi i këtij investimi është kryer me Aktin Normativ nr.28/2020 në shumën 576 milion lekë në muajin Korrik dhe është rishikuar në rritje në Dhjetor 2020 duke paraqitur një plan përfundimtar në shumën 607 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se për këtë projekt është lidhur kontrata në shumën 2,822 milion lekë me TVSH me afat 24 muaj, duke angazhuar fonde përtej atyre të planifikuara në PBA 2020-2022 (në vlerën 1.2 miliard lekë) me datë kontrate 08.10.2020, regjistruar në SIFQ në datë 12.10.2020. **Ndërmarrja e angazhimit është përtej fondeve në dispozicion për diferencën në shumën 1,622 milion lekë.**

- Programi buxhetor 6370 “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”

Programi buxhetor ÷Furnizimi me ujë dhe kanalizime është planifikuar me ligjin e buxhetit të vitit në shumën 3,970 milion lekë. Me aktin normativ nr. 28/2020 është rritur financimi me 1,500 milion lekë, dhe me aktin normativ nr. 34/2020 është rritur financimi me 3,100 milion lekë. Shtesa e projekteve të investimeve në këtë program është kryer duke çelur projekte të reja për vetëm 20% të vlerës në vitin e parë të projektit ndërkohë që për vitet e tjera nuk është mbuluar me buxhet vlera e kontraktuar. Për projektet e mësipërme, është detajuar vlera prej 826 milion lekë me njësi zbatuese njësi të vetëqeverisjes vendore apo njësi varësie të tyre. Vlera e kontratave të regjistruara në SIFQ rezulton në shumën 3,920 milion lekë, duke marrë angazhime mbi fondet në dispozicion. **Për rrjedhojë diferenca prej 3,094 milion lekë rezulton angazhim pa fonde disponibël për 23 projekte ku ndër të tjera disa prej tyre nuk plotësojnë as vlerën prej 20% të koston së projektit në vitin e parë të zbatimit, në krahasim me shumën e kontraktuar. Konkretisht disa nga këto projekte përfshijnë:**

-Projekti 19AF206 “Ndërtim ujësjellësi për furnizimin me ujë të qytetit Burrel të fshatrave të njësisë administrative Derjan dhe Rukaj –Loti I”. Në PBA faza II 2020-2022 dhe Projekt Buxhetin e vitit 2020, ky investim nuk është parashikuar. Fondet për këtë projekt investimi janë detajuar në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

muajin Korrik në shumën 135 milion lekë për vitin. Ky investim është kontraktuar nga Bashkia Mat në shumën 669 milion lekë me afat zbatimi 12 muaj. Shpërndarja e buxhetit sipas viteve nuk përputhet me afatin kohor të zbatimit të punimeve duke krijuar detyrime të prapambetura. Kosto totale e projektit në PBA 2021-2023 dhe Projekt Buxhetin 2021 është respektivisht 225 milion lekë dhe 674 milion lekë duke lejuar ndërmarrjen e **angazhimeve pa fonde disponibël në shumën 444 milion lekë.**

-Projekti 19AF901 “Ndërtim ujësjellësi për qytetin Ersekë dhe fshatrat, Faza e II-të nga Burimet e Kozelit, nuk rezulton i parashikuar në PBA 2020-2022 dhe është kontraktuar nga Bashkia Kolonjë në shumën 497 milion lekë me afat zbatimi 24 muaj. Nga auditimi konstatohet se shpërndarja e buxhetit sipas viteve nuk përputhet me afatin kohor të zbatimit të punimeve prej 24 muaj. Fondet e detajuara për këtë projekt investimi në muajin Korrik 2020 të vitit 2020 paraqiten në shumën 99.6 milion lekë dhe në PBA 2021-2023 vlera totale e parashikuar për tu financuar paraqitet në shumën 189.6 milion lekë. **Për rrjedhojë diferenca paraqitet angazhim pa fonde disponibël në shumën 307.7 milion lekë.**

Me Aktin Normativ nr.34 datë 16.12.2020 shtesa e fondeve buxhetore në shumën 3,100 milion lekë nuk ka mundur mbulimin e efektit të ndërmarrjes së angazhimeve pa fonde buxhetore, duke qenë se janë krijuar detyrime të prapambetura, në shumën 638 milion lekë.

Projekte të tjera të cilat janë alokuar gjatë vitit 2020 mbi të cilat janë konstatuar problematika përfshijnë:

-Produkti 18BQ445 “Rikonstruksion magjistrali kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit qytetit Patos Loti I”. Në PBA faza II 2020-2022 dhe Projekt Buxhetin e vitit 2020, ky investim është parashikuar në shumën 542 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se ky investim është kontraktuar nga Bashkia Patos në shumën 533 milion lekë me afat zbatimi 18 muaj. Kontrata e lidhur është lidhur në kushtet e mungesës së fondeve të nevojshme **në shumën 523 milion lekë,** duke qenë se në momentin e lidhjes së saj janë të çelura në SIFQ fonde në vitin e parë në shumën 10 milion lekë, për vitin 2021 është në shumën 10 milion lekë dhe për vitin 2022 në shumën 20 milionë lekë.

-Produkti M064166 “Rikonstruksion magjistrali kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Patos Loti II”. Në PBA faza II 2020-2022 dhe Projekt Buxhetin e vitit 2020, ky investim nuk është parashikuar. Fondet për këtë projekt investimi janë detajuar në muajin Qershor 2020 në shumën 144 milion lekë dhe janë ulur në Nëntor në shumën 9 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se ky investim është kontraktuar nga Bashkia Patos në shumën 705 milion lekë me afat zbatimi 24 muaj. Kontrata është lidhur në kushtet e mungesës së fondeve të nevojshme duke qenë se në momentin e lidhjes së saj janë të çelura në SIFQ vetëm fonde në vitin e parë në shumën 9 milion lekë. Në PBA 2021-2023 kosto totale e projektit është në shumën 190 milion lekë ndërkohë që në projekt buxhet 2021 është në shumën 720 milion duke lejuar copëzimin e fondeve sipas viteve dhe krijuar kushtet për ndërmarrjen e **angazhimeve pa fonde disponibël në shumën 696 milion lekë.**

-Projekti 18CG001 “Linja kryesore për furnizimin me ujë dhe rrjeti shpërndarës i ujësjellësit për qytetin e Belshit, Faza II” dhe Projekti 18CG003 “Linja Kryesore për furnizimin me ujë dhe rrjeti shpërndarës i ujësjellësit për qytetin e Belshit, Faza III”. Në PBA faza II 2020-2022 dhe Projekt Buxhetin e vitit 2020, investimet janë parashikuar në vlera të ndryshme respektivisht 416 milion lekë dhe 1,090 milion lekë. Paraqitja në projekt buxhet nuk është e saktë për sa i përket koston totale të investimit pasi shuma e buxhetit të shpërndarë sipas viteve prej 416 milion lekë nuk rakordon me koston totale të projektit në shumën e paraqitur prej 1,090 milion lekë. Ky investim i parashikuar në PBA 2020-2022 në një produkt të vetëm që përfshin fazën II dhe fazën III në vijim



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

është ndarë në dy produkte të ndryshme investimi. Nga auditimi konstatohet se nga Bashkia Belsh, janë nënshkruar dy kontrata në shumën 954 milion lekë, të ekzekutueshme brenda vitit 2020, duke qenë se kohëzgjatja e kontratës është 4 muaj nga data e lidhjes. Fondet në dispozicion sipas detajimit fillestar paraqiten në shumën 135 milion lekë. Shpërndarja e buxhetit sipas viteve nuk përputhet me afatin kohor të zbatimit të punimeve prej 4 muaj duke **ndërmarrë angazhime pa fonde disponibël në shumën 819 milion lekë.**

*-Projekti 19AF201 "Furnizimi me ujë nga burimi i Gramës për ujësjellësin e Peshkopisë", i kontraktuar nga Bashkia Dibër në shumën 737 milion lekë me afat zbatimi 14 muaj nuk rezulton i parashikuar në PBA 2020-2022. Shpërndarja e buxhetit sipas viteve nuk përputhet me afatin kohor të zbatimit të punimeve prej 14 muaj. Nga auditimi konstatohet se detajimi i fondeve për këtë projekt është realizuar në muajin Qershor 2020 vetëm për vlerën e 20% të kostonë së projektit duke u përfshirë në PBA 2021-2023, me kostonë projektit më të ulët se kostonë reale e tij në shumën 140 milion lekë. Buxhetimi i shlyerjes së këtij investimi përtej periudhës 3 vjeçare dhe kontratës së nënshkruar sjellë **ndërmarrjen e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde disponibël në shumën 581 milion lekë.***

*-Projekti 18BQ616 "Ujësjellësi -Zona e ujit te ftohte dhe lungomares Rrapi Uji I Ftohte - Shkolla e Marinës". Në PBA faza II 2020-2022 dhe Projekt Buxhetin e vitit 2020, ky investim është parashikuar respektivisht në shumën 447 milion lekë dhe 701 milion lekë. Nga auditimi konstatohet se për këtë investim është nënshkruar kontrata në shumën 630 milion lekë me afat kontrate 12 muaj. Fondet e detajuara për këtë projekt investimi në muajin Prill 2020 paraqiten në shumën 128 milion lekë. **Lidhja e kontratës përtej vlerës së parashikuar në PBA 2020-2022 është angazhim pa fonde buxhetore duke qenë vlera e kontraktuar është më e madhe se vlera e buxhetuar sipas PBA 2020-2022 llogaritur në shumën 182 milion lekë.***

*-Projekti 18BQ394 "Ndërtim linjë transmetimi nga puseta Yzberisht deri në Depo Katund, Katund i Ri & Ndërtim linjë transmetimi nga puseta Yzberisht deri në Depo Qytet Nxënësve, Bashkia Tiranë", nuk rezulton i parashikuar në PBA 2020-2022 dhe është kontraktuar nga Sh.a Ujësjellës-Kanalizime Tiranë në shumën 458 milion lekë me afat zbatimi 4 muaj. Fondet e detajuara në muajin Janar 2020 në shumën 97 milion lekë kanë ndryshuar në ulje duke u paraqitur me plan përfundimtar në shumën 60 milion lekë. Buxhetimi i shlyerjes së këtij investimi përtej periudhës 3 vjeçare dhe përtej periudhës së përcaktuar për realizimin dhe faturimin e tij sjell krijimin e detyrimeve të prapambetura nëpërmjet tejkalimit të kufijve për fondet e investimit të planifikuar. Në PBA 2021-2023 vlera e këtij projekti paraqitet në shumën 50 milion lekë, duke reflektuar angazhime **pa fonde disponibël në shumën 408 milion lekë.***

Programi 01610 "Planifikimi menaxhimi dhe administrimi", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve 73. Nga auditimi konstatohet se me aktin normativ nr. 34/2020 është rritur financimi për investimet kapitale me financim të brendshëm në shumën 673 milion lekë në këtë program. Realizimi i këtyre fondeve të detajuara me AN 34/2020 rezulton në shumën 0 lekë duke qenë se nuk ka asnjë mundësi ligjore për prokurimin, lidhjen e kontratës dhe përdorimin e tyre përgjatë vitit buxhetor 2020. Detajimi i tyre është bërë në masën 20% të vlerës së investimit. Nga evidencat e prokurimeve konstatohet se hapja e procedurës së prokurimit në datën 23.12.2020 me procedurë negociim pa shpallje me fond limit në shumën 2,112 milion lekë dhe vlerë kontratë në shumën 2,420 milion lekë. Konstatohet se detajimi i këtyre fondeve me akt normativ, bëhet shkak për krijimin e detyrimeve të prapambetura duke qenë se detyron uljen e financimit për projekte të tjera të kaluara në projekt buxhet ndërkohë që lidhet një kontratë për të cilën nuk ka kaluar në asnjë fazë të ciklit buxhetor dhe është mbi tavanet e miratuara për vitet pasardhëse buxhetore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCEVE DHE EKONOMISË

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të ndërmerren inspektive financiare dhe masa administrative përkatëse për të gjitha rastet problematike të identifikuara sipas përgjegjësive përkatëse; të kryejë përputhjen e kostos së plotë të projekteve të investimeve publike me vlerën e përcaktuar në PBA; të shmangët praktika e shtyrjes së planit buxhetor përtej periudhës së parashikuar për kohëzgjatjen e kontratave; të merren masa për regjistrimin në kohë të fondeve të obliguara në SIFQ, duke koordinuar edhe me Agjencinë e Prokurimit Publik si dhe integrimin e sistemit elektronik të prokurimit publik me sistemin informatik financiar të qeverisë.

4.2 Rekomandimi: Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të reflektohet efekti i VKM të dala gjatë vitit në tabelën e ligjit të buxhetit të vitit në të cilën miratohen fondet në nivel programi për çdo institucion.

4.3 Rekomandimi: Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të shmangët detajimi i projekteve të reja të investimit publik me akte normative gjatë si dhe në përfundim të vitit buxhetor, të cilat nuk krijojnë mundësinë e përdorimit të buxhetit prej 20% të kërkuar në vitin e parë të zbatimit të tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 88/2019 të ndryshuar, programi buxhetor 6210 òPrograme zhvillimiö është përdorur për procesin e rindërtimit, ku rast pas rasti me Vendim të Këshillit të Ministrave janë detajuar fonde për Fondin Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) për rindërtimin e objekteve të dëmtuara nga tërmeti. Efekti i VKM-ve të dala në funksion të procesit të rindërtimit me përfitues FSHZH nuk është pasqyruar në tabelën nr.1 në ligjit të buxhetit. Nga auditimi mbi fondin e rindërtimit konstatohet se buxheti i investimeve paraqitet në shumën 10,452 milion lekë dhe realizimi faktik në shumën 7,120 milion lekë¹⁸. Nga auditimi mbi të dhënat e publikuara në treguesit fiskalë të konsoliduar¹⁹, konstatohet se vlera e buxhetit paraqitet në shumën 10,149 milion lekë ndërkohë që realizimi faktik paraqitet në shumën 6,818 milion lekë, duke paraqitur diferenca. Nga auditimi konstatohet se diferenca në fondet e rindërtimit të raportuara rezulton prej projektit M560322 òProjekti i rrugëve dytësore dhe lokale kosto lokaleö, planifikuar dhe realizuar në shumën 302 milion lekë, në të cilin janë regjistruar kostot e menaxhimit të projektit me përfitues FSHZH.

Në mënyrë të detajuar auditimi në lidhje me zbatimin e fondeve të rindërtimit në FSHZH për investime kapitale që përbëjnë dhe pjeën më të madhe të fondeve të rindërtimit, të alokuara si investime, paraqitet si vijon:

-Mbi projektin e investimit për rindërtimin e banesave individuale, kod projekti 19AD201

Ky projekt investimi paraqet fondet e shpërndara sipas: VKM nr.202 datë 05.03.2020 e ndryshuar, nr.307 datë 16.04.2020 e ndryshuar dhe nr.587 datë 22.07.2020 e ndryshuar, për ndërtimin e banesave individuale, ndërtimin e banesave pallat dhe infrastrukturën publike. Plani përfundimtar për këto investime nga FSHZH, për vitin 2020 sipas VKM-ve paraqitet në shumën 5,528 milion lekë, ndërkohë që referuar të dhënave nga Drejtoria e Investimeve, plani për vitin 2020 paraqitet në shumën 5,138 milion lekë, duke mos reflektuar ndryshimet e VKM-ve në vlerën e saktë, me një diferencë prej 390 milion lekë në krahasim me planin e paraqitur në SIFQ. Mos reflektimi i saktë i ndryshimeve të VKM-ve tregon për mosndjekje të fondeve të investimeve të lëvruara për procesin

¹⁸ sipas të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit

¹⁹ sipas të dhënave të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit dhe raporti i gjeneruar nga SIFQ mbi rindërtimin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

e rindërtimit, mungesë saktësie dhe konsistence në raportimet e kryera. Gjithashtu konstatohet se këto fonde janë përmbledhur në një kod projekti të vetëm investimi ndërkohë që për nga natyra, projektet e investimit përfshijnë: infrastrukturë publike, banesa individuale dhe ndërtesa pallat në rajone të ndryshme gjeografike si dhe për të cilat përfshihen kontrata të ndryshme. Këto veprime nuk janë në përputhje me përcaktimin e bërë në ligjin e buxhetit, për përkufizimin e investimit kapital, me mënyrën e funksionimit të ecurisë së rasteve të tjerë të projekteve të investimit, krijon pamundësi monitorimi dhe ndjekje në vazhdimësi për respektimin e parimeve mbi të cilat funksionin sistemi buxhetor. Mungesa e detajimit në kodifikime për projekte specifike sikurse janë prokuruar nuk mundëson ndjekjen e planit dhe ndërmarrjen e angazhimeve për këto projekte në raport me fondet në dispozicion për secilin investim.

Nga auditimi konstatohet se buxheti i akorduar në total për FSHZH, në programin buxhetor 6210 ÷për rindërtimin e banesave individuale, infrastrukturën publike dhe banesat pallatë sipas VKM-ve përkatëse dhe ndryshimeve deri në 31.12.2020 rezulton në shumën 26,639 milion lekë, nga të cilat 6,465 milion lekë për banesat individuale, 3,975 milion lekë për infrastrukturën publike dhe 16,198 milion lekë për banesat pallat. Nga kjo vlerë totale e buxhetuar deri në 31.12.2020 janë kontraktuar punime në shumën 16,543 milion lekë (62%) nga të cilat 5,684 milion lekë për banesa individuale, 2,685 milion lekë për infrastrukturën publike dhe 8,173 milion lekë për banesa pallat. Realizimi faktik i punimeve deri në 31.12.2020 sipas regjistrimeve në SIFQ për kod projekti 19AD201 rezulton në shumën 3,268 milion lekë, duke mos detajuar se për cilën komponent të rindërtimit janë paguar, duke qenë se janë përmbledhur të gjithë në një kod projekti dhe bërë të pamundur ndjekjen e secilit komponent të rindërtimit.

Nga auditimi mbi rindërtimin e banesave individuale sipas VKM nr. 202, dt 5.03.2020, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të këtyre banesave", i ndryshuar, konstatohet se kontratat janë lidhur në periudhën gusht-dhjetor 2020, ndërkohë që regjistrimi i tyre në SIFQ është kryer në dhjetor-prill 2021. Gjithashtu, në një rast, konstatohet se nuk është regjistruar kontrata e lidhur sipas minikonkursit nr.3 në shumën 629 milion lekë deri në datën 30.06.2021, duke mos regjistruar obligimet që rrjedhin nga kjo kontratë në sistem. Mos regjistrimi i obligimeve dhe lidhja e kontratave në muajin Nëntor- Dhjetor pa asnjë mundësi për realizimin e fondeve të buxhetuara për vitin 2020, krijon presion për rritjen e kërkesës për financim në vitet pasardhëse buxhetor.

Nga auditimi mbi rindërtimin e infrastrukturës publike sipas VKM nr. 307 datë 16.04.2020 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike, në zonat e reja të shpallura për zhvillim të detyruar", i ndryshuar konstatohet se kontratat janë lidhur në periudhën qershor-dhjetor 2020, ndërkohë që regjistrimi i tyre në SIFQ është kryer në periudhën gusht 2020-prill 2021. Gjithashtu në një rast, konstatohet se nuk është regjistruar kontrata e lidhur sipas minikonkursit nr.7 në shumën 237 milion lekë.

Nga auditimi mbi rindërtimin e banesave pallat sipas VKM nr. 587 datë 22.07.2020 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njërive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar", i ndryshuar konstatohet se kontratat janë lidhur më së shumti në muajin dhjetor 2020 ndërkohë që regjistrimi i tyre në SIFQ është kryer në periudhën janar qershor 2021. Janë konstatuar 3 raste në të cilat kontratat e lidhura në 16.12.2020 në shumën 692 milion lekë, në 18.12.2020 në shumën 519 milion lekë dhe në 28.12.2020 në shumën 508 milion lekë nuk janë regjistruar në SIFQ deri në 30.06.2021.

- **Mbi projektet e investimit për rindërtimin e objekteve arsimore.** Procesi i rindërtimit të projekteve arsimore nga buxheti i shtetit me njësi zbatuese FSHZH është përcaktuar në VKM



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

nr.212 datë 11.03.2020 òPër përdorimin e fondit të rindërtimi për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore, të ndryshuar, në të cilën është parashikuar kosto totale e investimit në shumën 4,348 milion lekë, nga të cilat buxhetuar për vitin 2020 në shumën 4,126 milion lekë, sipas VKM të përditësuar deri në 31.12.2020. Detajimi i projekteve të investimit është kryer në muajin Qershor 2020 për çdo rajon gjeografik të kryerjes së investimit dhe jo sipas objektit të investimit në shkollën përkatëse duke përfshirë:

-Projekti 19AD203 “Rindërtimi i Objekteve Arsimore Qarku Lezhë (Bashkia Kurbin dhe Lezhë)”. Vlera fillestare e buxhetuar në shumën 127.8 milion lekë, plani përfundimtar për vitin 2020 në shumën 444.8 milion lekë, lidhur 2 kontrata në shumën 397.4 milion lekë dhe realizuar gjithsej deri në 31.12.2020 në shumën 309.7 milion lekë.

-Projekti 19AD204 “Rindërtimi i Objekteve Arsimore Qarku Krujë (Bashkia Krujë)”. Vlera fillestare e buxhetuar në shumën 122.6 milion lekë, plani përfundimtar për vitin 2020 në shumën 442.2 milion lekë, lidhur 3 kontrata në shumën 462 milion lekë, nga të cilat një kontratë me objekt të rindërtimit të objektit 1-2 kate të shkollës së mesme të bashkuar Selman Daci nuk është regjistruar fare në SIFQ në shumën 122.5 milion lekë dhe realizuar gjithsej deri në 31.12.2020 në shumën 215 milion lekë.

-Projekti 19AD205 “Rindërtimi i Objekteve Arsimore Qarku Durrës (Bashkia Durrës1)”. Vlera fillestare e buxhetuar në shumën 211.4 milion lekë, plani përfundimtar për vitin 2020 në shumën 845.7 milion lekë, lidhur 4 kontrata në shumën 817.5 milion lekë dhe realizuar gjithsej deri në 31.12.2020 në shumën 695 milion lekë.

-Projekti 19AD206 “Rindërtimi i Objekteve Arsimore Qarku Durrës (Bashkia Durrës2)”. Vlera fillestare e buxhetuar në shumën 212.6 milion lekë, plani përfundimtar për vitin 2020 në shumën 850.6 milion lekë, lidhur 3 kontrata në shumën 701.7 milion lekë dhe realizuar gjithsej deri në 31.12.2020 në shumën 631.5 milion lekë.

-Projekti 19AD207 “Rindërtimi i Objekteve Arsimore Qarku Tiranë (Bashkia Kavajë, Bashkia Rrogozhinë)”. Vlera fillestare e buxhetuar në shumën 103.7 milion lekë, plani përfundimtar për vitin 2020 në shumën 462.8 milion lekë, lidhur 4 kontrata në shumën 462.8 milion lekë dhe realizuar gjithsej deri në 31.12.2020 në shumën 367.8 milion lekë.

-Projekti 19AD208 “Rindërtimi i Objekteve Arsimore Qarku Tiranë (Bashkia Kamëz)”. Vlera fillestare e buxhetuar në shumën 155.4 milion lekë, plani përfundimtar për vitin 2020 në shumën 621.7 milion lekë, lidhur 3 kontrata në shumën 524 milion lekë dhe realizuar gjithsej deri në 31.12.2020 në shumën 471.5 milion lekë.

-Projekti 19AD209 “Rindërtimi i Objekteve Arsimore, Qarku Tiranë (Bashkia Vorë) Qarku Durrës, (Bashkia Shijak)”. Vlera fillestare e buxhetuar në shumën 110.1 milion lekë, plani përfundimtar për vitin 2020 në shumën 507 milion lekë, lidhur 4 kontrata në shumën 607.5 milion lekë dhe realizuar gjithsej deri në 31.12.2020 në shumën 408 milion lekë.

Detajimi i projekteve të investimit nuk është kryer sipas objektit të investimit në infrastrukturën arsimore përkatëse por është kryer sipas grupimit në rajone gjeografike të rindërtimit të infrastrukturës arsimore. Përveç problematikave në lidhje me parimet e funksionimit të sistemit buxhetor, kjo praktikë krijon pamundësinë e ndjekjes së historikut të investimit në asetet publike.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të merren masa për regjistrimin e të gjitha kontratave të nënshkruara përgjatë periudhës objekt auditimi dhe ato të kontraktuara gjatë vitit pasardhës në sistemin informatik financiar të qeverisë nga njësitë përkatëse. Nga ana e Ministrisë së Financave të bëhet detajimi në nivel analitik sipas objektit të infrastrukturës, banesave, ndërtesave pallat në të cilin është realizuar investimi publik, në mënyrë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

që të merret në kontroll procesi i rindërtimit sipas VKM-ve respektive, duke qenë se shumë nga këto asete publike janë objekt edhe i transferimit kapital pas përfundimit të punimeve drejt përfituesve të procesit të rindërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi projektet e investimeve publike në vazhdim të buxhetuara për programin buxhetor 062200 ÷Infrastruktura vendore dhe rajonale në Fondin Shqiptar të Zhvillimit janë konstatuar problematika që përfshijnë detajimin e planin buxhetor në 3 vite për kontrata që përfshijnë periudhë ekzekutimi deri në 12 muaj, duke krijuar detyrime të prapambetura në këtë program, pasi periudha e faturimit nuk përputhet me periudhën e buxhetit të planifikuar për shlyerjen e tyre. Gjithashtu është konstatuar se fondet e parashikuara për një projekt investimi me kod 18BP005 ÷Rivitalizimi urban i zonave me potencial te larte turistik ne Rajonin 3 dhe 40 janë përdorur për financimin e detyrimeve të një kontratë tjetër që nuk ka lidhje me fondet për të cilat janë miratuar me emërtim “*Loti II- Ndërtimi i rrugës së re përgjatë lumit Osomit si dhe ndërhyrje përmirësuese në bypassin e rrugës Antipatrea dhe rehabilitimi i rrugës lidhëse ndërmjet rrugës Shëtitorja Osumi dhe rrugës Antipatrea, Bashkia Berat*” nënshkruar në 23.12.2019 në shumën 110.5 milion lekë me afat 6 muaj.ö.

Në lidhje me investimet e reja të realizuar përgjatë vitit 2020 në këtë program buxhetor konstatohet se pjesa më e madhe e projekteve janë detajuar në çeljen fillestare dhe vetëm një projekt i cili është detajuar në muajin Tetor. Nga auditimi konstatohet se kontratat për këto investime janë lidhur në shumicën e rasteve pas datës 15 Tetor që është afati i sanksionuar në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 ÷Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar për ndërmarrjen e angazhimeve të reja. Angazhimi i fondeve në këto projekte ka sjellë si pasojë edhe regjistrimin e këtyre kontratave me vonesë në SIFQ, duke përfshirë edhe periudhën Qershor 2021 si datë regjistrimi. Në momentin e ndërmarrjes së angazhimit, për asnjë nga investimet e planifikuara nuk është respektuar zbatimi i kërkesave ligjore për disponimin e vlerës së 20% të investimit në vitin e parë të tij, duke qenë se me aktin normativ nr.34/2020 fondet për këtë program janë ulur me 1 miliard lekë. Në pjesën më të madhe të angazhimeve të ndërmarra, plani buxhetor për financimin e investimeve përfshin një periudhë shlyerje për tre vite ndërkohë që nga auditimi konstatohet se periudha e implementimit të kontratave përfshin një afat nga 5-16 muaj, duke krijuar detyrime të prapambetura.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të përfshihet në mënyrë të menjëhershme përputhja e planit buxhetor të miratuar me periudhën e faturimit për secilën kontratë të nënshkruar për investimet e financuara nga programi buxhetor infrastruktura vendore dhe rajonale. Të ndalohet rishpërndarja e fondeve me akte normative përtej afatit të sanksionuar për kryerjen e rishpërndarjes së fondeve, me qëllim shmangien e krijimit të detyrimeve të prapambetura si dhe të ndalohet praktika e detajimit të projekteve të reja të investimit në periudhën e fundit të vitit buxhetor.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.1 Gjetje nga auditimi: Stoku i detyrimeve të prapambetura pa përfshirë TVSH, deri në fund të vitit 2020 sipas raportit të MFE për njësitë e qeverisjes qendrore dhe ato të vetëqeverisjes vendore paraqiten në shumën rreth **14,317 milion lekë** (në vitin 2019 paraqitej në 17,371 milion lekë) ose 17% më pak se një vit më parë. Në zbatim të Udhëzimit nr.37 datë 06.10.2020, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në DPT ka përcjellë informacion mbi stokun e rimbursimit, i cili



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

paraqitet në vlerën rreth **9,797 milion lekë**, dhe zbatim të rekomandimeve të KLSH në auditimet e mëparshme këto detyrime janë përfshirë këtë vit në raportimin e MFE duke e çuar **vlerën totale të stokut të detyrimeve të prapambetura raportuar nga MFE në rreth 23,826 milion lekë**.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë në zbatim të udhëzimit nr. 2, datë 20.01.2020, òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2020, kapitulli III òRaportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes qendrore dhe në drejtim të monitorimit dhe raportimit të detyrimeve të prapambetura, përgatit raportin e konsoliduar të këtyre detyrimeve çdo tre mujor bazuar në raportimet e njësisive të qeverisjes së përgjithshme. Ky raportim është konkretizuar më pas në Udhëzimin nr.37, datë 06.10.2020 për òMonitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme, i cili ka ndryshuar edhe metodologjinë e raportimit për shkak se deri në Shtator 2020 raportimi kryhej në bazë të vetëdeklarimit të njësisive duke përfshirë vetëm ministritë e linjës dhe njësitë e vendore në zbatim të VKM-së nr.50, datë 05.02.2014 òPër miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimtò, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 5 datë 27.02.2014 òPër shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Udhëzimi i ri ka synuar një raportim në nivel qeverisjeje të përgjithshme ku të dhënat mbi detyrimet e prapambetura do të gjenerohen automatikisht nga moduli përkatës në SIFQ, për t'u konsoliduar më pas me raportimin nga DPT për stokun e rimbursimit të TVSH dhe më pas njësi përgjegjëse për monitorimin e risqeve buxhetore koordinon në vijimësi dhe periodikisht këtë proces mbledhur të dhënat e detyrimeve të prapambetura të dërguara nga DPTH dhe DPT për të përgatitur informacionin e konsoliduar për Ministrin.

Megjithatë, kjo metodologji e rishikuar ka arritur të përmirësojë raportimin vetëm për sa i përket pakësimit të stokut të detyrimeve të prapambetura për shkak se tanimë ato gjenerohen automatikisht nga SIFQ dhe jo në bazë të vetëdeklarimit, por ajo nuk mundëson verifikimin e detyrimeve të prapambetura sipas kohës së krijimit të tyre; shmangien e diferencave mes stokut së deklaruar të detyrimeve dhe atë të pasqyrave financiare; apo pagesave të kryera jashtë skemës për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

7.2 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se pavarësisht procedurave të hollësishme të udhëzimit të ri për konsolidimin dhe raportimin e detyrimeve të prapambetura, të dhënat e raportuara nga MFE paraqiten **me diferenca** krahasuar me të dhënat që rezultojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në MFE, ashtu edhe me të dhënat që rezultojnë nga auditimi i KLSH-së pranë kësaj drejtorie.²⁰

Në raportin e gjeneruar nga SIFQ raportohen detyrime të prapambetura vetëm për disa prej shoqërive Ujësjiellës Kanalizime (UK). Akti normativ nr. 34 datë 16.12.2020 ka alokuar shtesën e fondeve në masën 420 milion lekë në zërin e subvencionit të ndërmarrjeve ujësjiellës-kanalizimeve sh.a., me qëllim, shlyerjen në masën 100% të stokut të detyrimeve të prapambetura për kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe për tatimfitimin. Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në raportin përfundimtar nuk reflektohen detyrimet e prapambetura të institucioneve me vetëfinansim si UK, Universitete, etj. Këto veprime nuk janë të parashikuara në Udhëzimin nr.37, datë 06.10.2020.

Nga auditimi i KLSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit është konstatuar se detyrimet e prapambetura sipas përlllogaritjes së grupit paraqiten rreth 14,618 milion lekë me një diferencë prej 301.3 milion lekë nga raportimi i kryer nga thesari, për shkak të diferencave në balancën e fillimit të detyrimeve në vijim të regjistrimeve të kryera pas datës 08.07.2020; diferencave në pagesat e raportuara për likuidimin e tyre dhe shtesave përgjatë vitit. Ndërkohë edhe raportimi i kryer nga

²⁰ Programi i auditimit nr. 177/1, 12.02.2021



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

thesari paraqitet me diferencë prej rreth 288 milion lekë me vlerën e stokut të raportuar nga MFE. Konkretisht:

Në mijë lekë

Institucionet	Detyrimet sipas Thesarit	Detyrimet sipas raportit të MFE	Detyrimet sipas përlllogaritjeve KLSH
Qendrore	7,104,881	6,969,916	7,088,562
Vendore	7,211,896	7,058,943	7,529,442
TOTAL	14,316,777	14,028,859	14,618,004

Nga totali i detyrimeve të njërive të përgjithshme të qeverisjes qendrore, detyrimet e MIE dhe MFE përbëjnë respektivisht 14% të këtij totali, për t'u ndjekur më pas nga Ministria e Mbrojtjes me 10% të totalit të detyrimeve. Ndërsa, nga totali i stokut të detyrimeve të prapambetura të njërive të vetëqeverisjes vendore, vetëm 8 bashki (përkatësisht Bashkia Tiranë, Kavajë, Vorë, Pogradec, Lezhë, Roskovec, Kamëz dhe Vlorë) përbëjnë 52% të këtij totali. Diferencat në stokun e detyrimeve të prapambetura sipas strukturës së tij paraqiten si me poshtë:

Në milion lekë

Stoku	Vend. Gjyq.	Shërb	Mirmb	Inv	Rimb TVSH	Mallra	Te tjera	Sig. Shoq	Sig. Shënd	Te Ardh. Pers	Tatime te Tjera	Total
Rapoti MFE	4,333	1,183	505	5,036	28	315	2,320	209	24	67	8	14,028
Thesari	4,334	1,229	508	5,093	28	408	2,376	222	26	68	24	14,316

Pjesën më të madhe të stokut e përbëjnë detyrime si rezultat i investimeve (36%), për t'u ndjekur më pas me vendimet gjyqësore për kthimin në punë të ish punonjësve (31%), dhe më pas shpenzime të tjera (17%).

Për sa i përket detyrimeve të prapambetura si rezultat i vendimeve të miratuara për pagesë por të pa likuiduara të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit dhe Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ), sipas informacionit të MFE nuk ka patur asnjë rast të tillë për periudhën objekt auditimi, megjithatë për sa kohë këto detyrime nuk raportohen në formatin e aneksit për raportimin e detyrimeve të prapambetura, në kundërshtim me Udhëzimin nr.5 datë 27/02/2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", nuk mund të japim siguri mbi detyrime të këtij grupi të papagura nga periudhat e mëparshme.

Në auditimet paralele të kryera nga KLSH në disa institucione konstatohet mos raportim i vlerës së plotë të detyrimeve financiare (kryesisht vendime gjyqësore të formës së prere).

Në konkluzion konstatohet se raportimi aktual i vlerës totale të detyrimeve të prapambetura nuk është i plotë dhe i saktë për shkak të: Mungesës së raportimeve mbi detyrimet e prapambetura nga disa njësi të mëdha shpenzuese ku përmendim FSHZH, AKSHI-n, të cilat vijnë të mos raportojnë; Mos përfshirjen e stokut të detyrimeve të prapambetura të Ujësjellës Kanalizimeve; Diferencave të konstatuara në stokun e fillim vitit për shkak të regjistrimeve të kryera pas kryerjes së sistemimeve finale për efekt raportimi; -Pagesa të kryera jashtë skemës së likuidimit të detyrimeve të prapambetura; -Mungesa e monitorimeve për të evidentuar se vlera e regjistruar në pasqyrat financiare të institucioneve reflekton stokun real të vetë deklaruar të detyrimeve të prapambetura për efekt regjistrimi në SIFQ me atë të njohur në pasqyrat financiare të njërive.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit të marrin masat për implementimin e kontroleve shtesë për të shmangur në të ardhmen diferencat mes tyre në përlllogaritjet e stokut të detyrimeve të prapambetura, duke mundësuar verifikimin e detyrimeve të prapambetura sipas kohës së krijimit të tyre apo shtesave



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

përgjatë vitit me qëllim kryerjen e një raportimi sa më të saktë dhe të plotë të tyre në materialin përfundimtar të përgatitur dhe publikuar nga njëسيا përgjegjëse për monitorimin e risqeve të përgjithshme në MFE.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.2. Rekomandimi: DPB të marrë masat që raporti final i detyrimeve të prapambetura të reflektojë stokun real e gjithëpërfshirës të sistemit të qeverisjes së përgjithshme duke përfshirë këtu edhe institucione si FSHZH, AKSHI, Ujësjellës Kanalizimeve, etj.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.3 Rekomandimi: MFE të parashikojë procedura shtesë kontrolli për të monitoruar raportimin aktual të detyrimeve të prapambetura për të shmangur si diferencat mes vlerës së raportuar të detyrimeve me atë të pasqyrave financiare, ashtu edhe mes vlerës së njohur në pasqyrat financiare dhe atë që faktikisht duhet të ishte regjistruar, ku përmendim vendimet gjyqësore me risk të lartë për këtë fenomen.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave të kryera gjatë vitit 2020, evidentohen 7212 regjistrime për fatura për shpenzime të kryera në vitet e mëparshme, në vlerën prej 14.5 miliard lekë nga të cilat 1845 regjistrime në vlerën 11.3 miliard lekë për shpenzime për investime²¹. Detyrimet e prapambetura të paguara në vlerën 6,396 milion lekë për investime kapitale me Financim të Brendshëm përfaqësojnë rreth 11% të investimeve të brendshme të realizuara në total për vitin 2020. Institucionet më përfaqësuese të cilat kanë paguar detyrime të prapambetura përfshijnë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Fondin Shqiptar të Zhvillimit, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe grupin e institucioneve të tjera qeveritare me përfaqësues Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

Nga auditimi rezultojnë 54 projekte për investime në 33 institucione buxhetore me një vlerë totale të paguar prej 2,169 milion lekë, fondet disponibël të të cilave janë buxhetuar gjatë vitit për të paguar detyrimet e prapambetura sipas kontratave dhe jo në fillim të vitit 2020. Ndër këto institucione përmendim: Aparati i Ministrisë së Brendshme ka likuiduar detyrime të prapambetura në vlerë 712 milion lekë, Aparati i Ministrisë së Mbrojtjes 477 milion lekë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve 206 milion lekë, Bashkia Tirana 158 milion lekë, Bashkia Durrës 133.5 milion lekë, Universiteti ðAleksandër Moisiu 115 milion lekë, etj.

Pagesa e këtyre detyrimeve të cilat janë raportuar si shpenzime/investime të vitit 2020, nuk është në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor ku përcaktohet se metoda e njohjes së shpenzimeve është në momentin e ndodhjes së tyre, pavarësisht momentit të pagesës. Për këtë arsye, treguesit e realizimit janë të mbivlerësuar për këtë nivel, duke paraqitur si investime të vitit, investime, faturat e të cilave datojnë që nga viti 2013. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

8.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të ndërmerren inspektive financiare dhe masa administrative në lidhje me detyrimet e prapambetura, për rastet e thyerjes së disiplinës buxhetore sipas përgjegjësisve përkatëse të funksionarëve publik të ngarkuar dhe autorizuar për kryerjen e shpenzimeve publike.

8.2 Rekomandimi: Nëpunësi i Parë Autorizues të marrë masat e nevojshme për Drejtorinë e Përgjithshme e Buxhetit dhe njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për të respektuar radhën

²¹ sipas balancave në llogarinë 230 dhe 231



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

prioritare të buxhetimit gjatë detajimit buxhetit, për të shmangur rishikimet e kryera për të likuiduar detyrimet e periudhave të mëparshme, apo krijuar rishtaz detyrime të prapambetura.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Planifikimi i Fondit Rezervë dhe Fondit të Kontigjencës bëhet në përputhje me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, kreun e II, nenin 5. Në zbatim të ligjit vjetor nr.88/2019, datë 18.12.2019 për buxhetin e vitit 2020, në nenet 11, 14 dhe 15, *Fondi rezervë i buxhetit të shtetit prej 1,700 milion lekë, përdoret nga Këshilli i Ministrave për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme; Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4,000 milionë lekësh përdoret nga Ministri përgjegjës për Financat për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në shpenzimet për interesa.* Nga auditimi konstatohet se në Ligjin e Buxhetit vjetor koeficienti është në masën 1% duke ruajtur kështu kufirin ligjor në planifikimin e fondeve rezervë të buxhetit të shtetit dhe të kontigjencave. Në zbatim të aktit normativ nr.6, datë 21.03.2020 këto fonde janë përcaktuar: *Fondi rezervë i buxhetit të shtetit prej 9,200 milion lekë* dhe koeficienti prej 2.4% është në kufirin ligjor të parashikuar. Në zbatim të aktit normativ nr.15, datë 15.04.2020 për disa ndryshime në ligjin nr.88/2019, datë 18.12.2019 për buxhetin e shtetit të vitit 2020, në nenin 1 të tij, këto fonde janë përcaktuar: *Fondi rezervë i buxhetit të shtetit prej 16,200 milion lekë, Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4,000 milionë lekë përdoret për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit, ose normat e interesit, me ndikim në shpenzime për interesa.* Konstatohet se pas Aktit normativ nr.6, koeficienti prej 3.6% është në tejkalim të kufirit ligjor të parashikuar.

Në lidhje me procedurën e miratimit dhe kriteret e përdorimit të Fondit Rezervë, nga shqyrtimi i dosjeve të këtyre vendimeve, rezultojnë me mangësi në dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kreun V “Zbatimi i buxhetit”, neni 45 të Kërkesat për fonde shtesë, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSh, i ndryshuar. Kështu: në **dosjen e VKM nr. 181 datë 26.02.2020** mungon kërkesa e argumentuar e institucionit kërkues, mendimi i Ministrit të Financave, shkresa përcjellëse e Ministrit të Financave me relacionin shoqëruar të Projektit të Vendimit. Duke qenë se ky është një event ndërkombëtar nuk jepen argumenta përse këto fonde nuk ishte parashikuar në kohën e përgatitjes së buxhetit dhe çfarë kostosh përfshihen në fondin e kërkuar. Sipas databazës së pagesave rezultojnë vetëm dy të tilla të lidhura me eventin e Samitit Ballkanik në shumën 689 mijë lekë. Në **dosjen e VKM nr. 204 datë 09.03.2020** përveç dokumentit VKM ku përcaktohet *ështëpia e pushimit të ushtarakëve të FARSH-it me vendndodhje në Plepa, Durrës, si strukturë për shërbimin e karantinës, në funksion të marrjes së masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit nga COVID-19 dhe ÷caktimin e Ministrisë së Mbrojtjes si autoriteti kontraktor për zhvillimin e procedurave të prokurimit..* ÷ mungon mendimi i Ministrit të Financave; nuk ka një relacionin shoqëruar me argumenta dhe preventivin çfarë përfshihet në vlerën e fondit të miratuar prej 24.8 milion lekë. Deri në fund të vitit 2020 për këtë kod projekti në databazën e pagesave për vitin 2020 rezultojnë të shpenzuara vetëm 5.5 milion lekë ose rreth 50% e shumës së akorduar nga Fondi Rezervë.

Referuar tabelës analitike të përdorimit të fondit rezervë për vitin 2020 të raportuar nga MFE, listohen edhe 2 VKM për përdorimin e Fondit Rezervë në muajin Shkurt (përpara situatës së pandemisë COVID-19) dosja e të cilave nuk na u vu në dispozicion nga subjekti, konkretisht VKM nr.188 datë 27.02.2020 në shumën 27 milion lekë për shpenzime operative me kod **91601AB**- ÷ Auditime të kryera, ÷ akorduar për përballimin e shpenzimeve të kontratës me kompaninë “T.....” projekt për të cilin në databazën e pagesave nuk rezulton pagesë për kompaninë ÷ T...÷, dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

VKM nr.106 datë 05.02.2020 për 150 milion lekë akorduar për shpenzime për investime për projektin me kod **18CK101- òPërshtatja e Mjediseve të Punës për prokurorinë e Posaçme të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe byronë kombëtare të hetimit dhe sigurimi i mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për funksionimin e tyre** ò i cili rezulton të jetë një projekt në vazhdim nga viti 2019, gjë që nuk e justifikon mos përfshirjen në fazën e planifikimit të buxhetit 2020.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe regjistrimeve në SIFQ konstatohet se në **dosjen e VKM nr. 205 datë 09.03.2020 me përfitues Ministrinë e Shëndetësisë**, me të cilën shpërndahen 200 milion lekë për shpenzime kapitale dhe 200 milion lekë për shpenzime korrente, mungon mendimi/përgjigja e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave sa kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë. Tabela shoqëruese në relacion parashikon blerjen e respiratorëve në shumën 166 milionë lekë me kod projekti 19AD301, si dhe artikuj të tjerë duke ju referuar në shumicën e rasteve çmimeve të kontratave të vitit 2014. Ndërkohë fondi i akorduar në kushtet e emergjencës është përdorur nga institucioni përfitues në muajt Nëntor-Dhjetor 2020 pra më shumë se 7-8 muaj nga momenti i miratimit dhe obligimit të fondeve në sistem duke mos justifikuar kështu elementin e òemergjencës.

Në rastin e dosjes së **VKM-së nr.258 dt.27.3.2020 “Për një shtesë fondi në buxhetin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, miratuar për vitin 2020, për pagesën e këshilltarit financiar për menaxhimin e borxhit shtetëror**ò, ajo përmban vetëm një dokument, shkresën miratuese të Sekretarit të Përgjithshëm dërguar Degës Thesarit Tiranë për çeljen e fondeve në zbatim të VKM,- së një kopje të së cilës nuk ndodhet gjithashtu në këtë dosje.

Me Aktin Normativ të datës 21.03.2020 Fondi Rezervë i Këshillit të Ministrave mbetet në shumën 1,700 milion lekë por janë shtuar dy fonde të tjera të dedikuara për përballimin e situatës COVID - 19. Në kuadër të këtyre ndryshimeve, në datën 24.03.2021 në SIFQ rezultojnë tre kode projektsh të krijuara për të ndjekur përdorimin e fondit rezervë sipas destinacionit të miratuar: **94901AA-** Fondi Rezervë i Këshillit të Ministrave, (fond i cili nuk pësoi rritje me Aktin Normativ), **94901AB-** Fondi në formën e kontigjencave për paketën sociale anti-Covid 19 në shumën 6,500 milion lekë, **94901AC-** Fondi Rezervë në kuadër të masave anti-Covid 19 në shumën 1,000 milion lekë. Deri në momentin e daljes së Aktit Normativ nr.15 datë 15.04.2020, Fondet Rezervë ishin përdorur si vijon: 94901AA- òFondi i Këshillit të Ministraveò në shumën 645.8 milion lekë ose rreth 38%; 94901AB- òFondi në formën e kontigjencave për paketën sociale anti-Covid 19ò, në shumën 5,850 milion lekë ose 90%, 94901AC- òFondi Rezervë në kuadër të masave anti-Covid 19ò në shumën 57.1 milion lekë ose 6%.

Në vijim konstatohet disa rialokime si në rastin e shpërndarjes me **VKM nr.463 datë 10.06.2020** me përfitues projektin M062993- òShpronësimeò në shtesë me shumën 200 milion lekë. Po i njëjti projekt preket përsëri një muaj më vonë nga **VKM nr.610 datë 29.07.2020 në pakësim** prej 140 milion lekë për të financuar projekte të administruara nga AKSHI. Pra rritja neto e këtij projekti është 60 milion lekë ndërkohë që në referencë të VKM nr.463 janë bërë pagesa në shumën 166.6 milion lekë. Po në muajin Korrik 2020, ky kod projekti ka përfituar një rritje buxheti në shumën 2,900 milion lekë dhe përdorimi i Fondet Rezervë me VKM 463 duket i panevojshëm dhe jo në kushtet e emergjencës dhe në të njëjtën kohë ka qenë në proces rishikimi buxhetor në shifra shumë herë më të larta.

Në rastin e shpërndarjes me **VKM nr.464 datë 10.06.2020**, për të cilin në dosjen fizike nuk ka një relacion për akordimin e fondeve rezervë në kodin e projektit 19AA702 -|*Rishikimi i studimit të fizibilitetit dhe hartimi i projektit të detajuar inxhinierik "Ndërtimi i Tunelit të Llogarasë"*. Në mungesë të dokumentacionit shoqërues nuk mund të vlerësohet kriteri pse ky shpenzim nuk është



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

përfshirë në fazën e hartimit të buxhetit vjetor 2020 si dhe nëse kërkesa për fonde në muajin Qershor 2020, ishte në kushtet e emergjencës për të justifikuar përdorimin e Fondit Rezervë. Për më tepër, një muaj më vonë ky projekt avancohet me një shtesë fondesh nga buxheti prej 600 milion lekë²² dhe në 20 Dhjetor pakësohet me 519.4 milion lekë²³ menjëherë pas pagesës së faturës në shumën 222.6 milion lekë.

Për sa i takon rregullshmërisë në regjistrimeve në SIFQ, nga auditimi evidentohet fakti se përgjithësisht ekzekutimi i VKM në sistem bëhet me vonesë nga 10 ditë deri në 1 muaj nga data e publikimit të VKM-së. Konkretisht, në rastin e **VKM nr.258 e datës 27 Mars 2020** e regjistruar më 20 Korrik 2020, fondet prej 97.8 milion lekë, për institucionin përfitues MFE dhe kod 91003 janë bërë të vlefshme 4 muaj pas kërkesës dhe miratimit për fonde shtesë ndërkohë që fatura e parë për këtë shërbim është lëshuar në muajin Qershor 2020. Pagesat në total për këtë shërbim gjatë vitit 2020 rezultojnë në shumën 81.5 milion lekë. Edhe në këtë rast, në mungesë të dokumentacionit shoqërues nuk mund të vlerësohet kriteri pse ky shpenzim nuk është përfshirë në fazën e hartimit të buxhetit vjetor dhe kriteri i klasifikimit të tij si òemergjencë.

Në zbatim të aktit normativ nr.28, datë 02.07.2020 òPër disa ndryshime në ligjin nr.88/2019, datë 18.12.2019 òPër buxhetin e shtetit të vitit 2020, nuk ka patur shtesa në fondet rezervë por rritje të shpenzimeve të buxhetuara të miratuara. I vetmi ndryshim konsiston në paraqitjen e Fondit Rezervë në Aktin Normativ, me raportimin e konsoliduar i dy kodeve: 94901AA- òFondi i Këshillit të Ministrave ò dhe 94901AC- òFondi Rezervë në kuadër të masave anti-Covid 19 ò në total në shumën 2,700 milion lekë, duke vijuar kështu edhe në raportimin e fundvitit. Në vijim të këtij Akti janë kryer dhe regjistrimet përkatëse në SIFQ në datën 07.07.2020 për riklasifikimin e balancës së papërdorur prej 816 milion lekë nga òFondi rezervë për masat anti Covid ò në òFondin Rezervë të Këshillit të Ministrave. Deri në këtë moment **Fondi Rezervë i dedikuar për COVID-19 është përdorur në masën 184 milion lekë ose 18.4% me përfitues Ministrinë e Shëndetësisë, Shërbimin Social Shtetëror dhe Agjensia Kombëtare e Bregdetit.** Pas këtij riklasifikimi, nga auditimi rezulton se Fondi Rezervë i Këshillit të Ministrave është përdorur në një rast përsëri për masat në kuadër të situatës COVID-19 në shumën 20.6 milion lekë me VKM nr.754 "Për një ndryshim në VKM nr. 371, datë 06.05.2020, "*Për dhënie shpërblimi për personelin që shërben në institucionet e përkujdesjes shoqërore rezidenciale publike, që janë në përgjegjësi administrimi të shërbimit social shtetëror dhe të Bashkive*". Gjithashtu, me VKM nr. 610 datë 29.07.2020 janë akorduar fonde për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për mirëmbajtjen e sistemeve që administron ky institucion. Referuar relacionit shoqërues gjendur në dosjen fizike të kësaj VKM-je, rezulton se AKSHI ka paraqitur disa herë kërkesën për fonde buxhetore në shumën 1,000 milion lekë për këto shpenzime duke theksuar risqet që mbart mos azhurnimi i sistemeve të rëndësishme që ky institucion administron. Për më tepër argumentohet se këto fonde janë emergjente edhe për faktin që kontratat ekzistuese kanë gjeneruar tashmë detyrime të cilat duhen paguar për të siguruar vijimësinë e tyre. Në dosje nuk ka ndonjë arsyetim të NPA apo Ministrisë të Financave për mos buxhetimin e fondit të kërkuar nga AKSHI me ligj buxheti dhe më pas përdorimin prej 860 milionë lekë nga Fondi Rezervë dhe 140 milionë nga projekti

²² Rishikimi buxhetor ID#6253293: Pakësohen projektet me kod 18BJ9001 me 150 milionë lekë; 18BK001 me 500 milion lekë dhe 19AB403 me 100 milion lekë. Këto projekte rezultojnë të planifikuara në ligjin e buxhetit 2020 por me realizim zero.

²³ Rishikimi buxhetor ID#6310297: shtohet projekti 18BA201 me 485 milion lekë dhe projekti me kod M064243 me 34 milion lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

M062993- Shpronësime (ARRSH). Ky miratim bëhet vetëm pak javë pas Aktit Normativ të radhës i cili supozohet të kishte përfshirë të gjitha kërkesat buxhetore sipas prioriteteve për fonde, fonde shtesë, etj.

Në lidhje me përdorimin e Fondit rezervë të kontigjencës anti-COVID-19 për vitin 2020, i akorduar me Aktet Normative nr.6 dhe 5 në total 13,500 milion lekë kanë dalë vendimet: nr. 254 datë 27.03.2020, për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e COVID-19 në shumën 5,850 milionë lekë. Nr.284 datë 10.04.2020 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 254 datë 27.3.2020 në shumën 566 milionë lekë. Nr. 305 datë 14.04.2020 për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e COVID-19 në shumën 7,040 milionë lekë. Në total përdorimi i këtij fondi është 13,456 milion lekë ose 99.7%²⁴. Sipas të databazës së rishikimeve nga SIFQ, rezultojnë këto regjistrime për shtesa dhe pakësime të Fondit rezervë me kod 94901AB: 1,032 milion lekë i ka përfituar Administrata e Shërbimeve Sociale Shtetërore në kodin 91307AA- 4,818 milion lekë i ka përfituar 118.3 milion lekë Agjensia e Punësimit dhe Aftësive në kodin 91013AE 4,700 milion lekë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në kodin 91013AG- Pagat e biznesit për masat anti COVID-19.

Të gjitha këto 3 shpërndarje kanë prekur **kodin 91013AG**- pagat e biznesit për masat anti COVID-19 kod i cili sipas databazës së pagesave në SIFQ rezultojnë të jetë përdorur si transferta tek individët në shumën 261 milion lekë; si transferta ndaj individëve të biznesit të vogël në shumën 5,371 milion lekë dhe si transferta ndaj individëve të mbetur papunë në shumën 7,128 milion lekë. Në konkluzion, deri në datën 31.12.2020, Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit i planifikuar për raste të paparashikuara, është përdorur nëpërmjet Vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM) me vlerë totale prej rreth 2,680 milion lekësh, nga 2,700 milion lekë të planifikuara ose në rreth 99.5% përqind të planit të ndryshuar. **Në 7 Vendime të Këshillit të Ministrave, në vlerë 1,640 milion lekë, fondi rezervë është përdorur si “shtesë buxheti”,** fonde të cilat, duhet të parashikoheshin në përputhje me procedurat dhe kriteret ligjore të planifikimit të buxhetit, dhe të miratoheshin me ligjin vjetor të tij. Nga auditimi rezultojnë se në disa raste shpërndarja e fondit rezervë më pas është rishpërndarë në projekte të tjera. Fondi rezervë prej 1,000 milion lekë i akorduar për shpenzime të shkaktuara nga situata COVID-19 është përdorur në masën 18% dhe balanca e mbetur është riklasifikuar si Fond Rezervë i Këshillit të Ministrave dhe është përdorur për shpenzime të tjera korrente dhe për investime të cilat duhej të ishin planifikuar në ligjin e buxhetit pasi kanë krijuar edhe detyrime të prapambetura.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 9 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Ministrisë së Financave/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, të krijojë për çdo VKM të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit, dosjen e plotë të dokumentacionit të domosdoshëm për të vlerësuar kriteret e përdorimit të Fondit Rezervë i cili edhe gjatë vitit 2020, pavarësisht situatës së veçantë të pandemisë, është përdorur për shpenzime të cilat duhej të ishin planifikuar në ligjin e buxhetit dhe nuk e plotësojnë në vlerë dhe koherencë pagesë kriterin e pa parashikueshmërisë dhe emergjencës. Gjithashtu për të gjitha kërkesat për përdorimin e fondit rezervë sipas procedurës, të shmanget praktika e mos marrjes së mendimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

²⁴ Statusi i përdorimit të Paketës sociale I dhe II në aneksin e këtij akt-konstatimi sipas përditësimit më të fundit të MFE në faqen zyrtare datë 03.11.2020 ku totali i fondit të kontigjencës për COVID-19 rezultojnë i përdorur në masën 12,934,989 mijë lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Menjëherë dhe në vijimësi

IV. OPINIONI I AUDITIMIT

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve mbi të cilat kjo drejtori realizon misionin e saj.

Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë²⁵, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për disa zëra buxhetorë, u konstatuan parregullsi dhe vendimmarrje jo në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale dhe të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e **një opinionit të kundërt të përputhshmërisë**²⁶ (ISSAI 4000).²⁷

Baza për opinionin e auditimit

Nga evidencat e marra për veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në MFE, rezultoi se problematikat e konstatuara nga KLSH edhe në vitet e mëparshme janë të pranishme edhe në vitin 2020 në të gjitha fazat e planifikimit, miratimit, ezekutimit, monitorimit dhe raportimit të buxhetit dhe kryesisht konsistojnë në:

-detajimin e projekteve të investimeve publike me akt normativ pa kaluar në PBA 2020-2022, detajimin e fondeve të investimeve për vetëm vlerën e 20% të kostos së projektit pa buxhet në vitet pasardhëse buxhetore,

- shkurtrimin e fondeve të investimit në momentin e lidhjes së kontratës dhe rialokimin e këtyre fondeve drejt projekteve të tjera të investimit publik për detyrime të prapambetura apo në proces nga vitet e kaluara, mos regjistrimin e kontratave dhe rrjedhimisht mos regjistrimin e obligimit në SIFQ duke lejuar ndërmarrjen e angazhimeve buxhetore dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura.

-Nga auditimi i pagesave të kryera gjatë vitit 2020, evidentohen 7212 regjistrime për fatura për shpenzime të kryera në vitet e mëparshme, në vlerën prej 14.5 miliard lekë nga të cilat 1845 regjistrime në vlerën 11.3 miliard lekë për shpenzime për investime.

-Është konstatuar ndërmarrja e angazhimeve pa fonde buxhetore dhe mos respektimi i tavaneve të ligjit për vitet e ardhshme buxhetore, kryesisht në programet buxhetore oprograme zhvillimi në rreth 2.4 miliard lekë, otransporti rrugorë në rreth 4.5 miliard lekë, ofunizimi me ujë dhe kanalizime në rreth 6.3 miliard lekë.

-Nga auditimi i të dhënave në lidhje me kontratat e nënshkruara për investimet përgjatë vitit 2020, sipas modulit të kontratave në SIFQ konstatohet se janë nënshkruar mbi 500 kontrata për investime publike me vlerë të kontraktuar rreth 23 miliard lekë, pas datës 15 Tetor

- Shpërndarja e fondeve me VKM nuk është shoqëruar me ndryshim të vlerës së fondit të rindërtimit në vitet pasardhëse buxhetore, duke qenë se plani paraqitet në shumën 0 lekë për vitet 2021 dhe 2022 sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 88/2019 oPër buxhetin e vitit 2020o, të ndryshuar.

²⁵ Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së"

²⁶ Një opinion i kundërt shprehet kur efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, janë materiale dhe të përhapura

²⁷ ISSAI 4000 – Udhërrëfyese i Auditimit të Përputhshmërisë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

- Nga auditimi konstatohet se nga ana e KZHR nuk është marrë asnjë vendim për shpërndarjen e financimit për projekte të reja përgjatë vitit 2020, por vlera e alokuar për këtë fond është përdorur për financimin e kontratave në vazhdim nga vitet e kaluara si dhe për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura në total **për 327 milion lekë**.

- Afatet për procesin e planifikimit të buxhetit të vitit 2020 janë shkëlur në përgatitjen e kalendarit të shpenzimeve, tavanëve buxhetore si dhe udhëzimeve përkatëse.

- Nga auditimi i të dhënave të rishikimeve buxhetore, u konstatua se janë kryer një numër i lartë rishikimesh buxhetore pas datës 15 nëntor të vitit 2020. Ndryshimet buxhetore që prekin vitin 2020 vazhdojnë deri në datën 24 shkurt 2021, edhe pse ligjërisht pagesat me efekt kontabël 2020 lejohen deri në datën 21 janar 2021.

- Fondi Rezervë rezultojnë të jetë përdorur edhe për shpenzime të cilat duhej të ishin planifikuar në ligjin e buxhetit vjetor dhe përgjatë vitit ai është rishpërndarë në projekte të tjera nga sa planifikuar fillimisht.

- Nga auditimi i rishikimeve të fondeve buxhetore për sa i përket fondeve të dedikuara për situatën COVID-19 dhe të rindërtimit u konstatua se krahas faktit se nuk janë konsistente, janë kryer rishikime të shumta të këtyre fondeve, duke e bërë të vështirë gjurmimin e realizimit përfundimtar dhe verifikimin e saktësisë së raportit të gjeneruar nga MFE për përdorimin e fondit të rindërtimit.

Në regjistrin e pagesave, disa nga kodet e projekteve të cilat sipas përshkrimit janë të dedikuara për mbulimin e shpenzimeve për COVID-19, dhe nga auditimi rezultoi se në disa raste këto fonde janë përdorur për mbulimin e shpenzimeve të tjera operative, si: likuidime të energjisë elektrike, internetit, dieta, shërbim ruajtje objekti, lavaxantierie, kontratave të ndryshme mirëmbajtjeje në vazhdim në shumën 203 milion lekë.

-Në fondin e rindërtimit janë konstatuar problematika në planin e akorduar sipas VKM-ve dhe atij të regjistruar në SIFQ si dhe në të njetjën kohë mos regjistrim të obligimeve në bazë të kontratave të nënshkruara.

-Të ardhurat e trashëguara nga pushteti vendor rezultojnë tre herë më të larta se detyrimet e prapambetura të tij, që në rast se do shoqëroheshin me planifikimin e shpenzimeve për pushtetin vendor do të sillnin përmirësimin e treguesit të vështirësisë financiare për shumë bashki.

- Detyrimet e prapambetura raportuar nga MFE në rreth 23,826 milion lekë nuk janë të përfshira në treguesit fiskalë të konsoliduar si dhe kjo vlerë nuk paraqitet e saktë me diferenca të konstatuara në rreth 590 milion lekë.

-Për vitin 2020, nga auditimi i investimeve kapitale me financim të huaj është konstatuar se, 2 projekte investimi në vlerën 12.7 milion lekë janë realizuar pa pasur një plan buxhetor, 12 projekte investimesh të huaja me Kredi për vlerën 1,995 milion lekë janë realizuar në tejkalim të planit të buxhetit dhe 48 projekte investimesh të huaja në formën e Grandit për vlerën 1,423 milion lekë janë realizuar në tejkalim të planit të buxhetit.

-Janë konstatuar 39 projekte investimi me financim të huaj në vlerën totale 2,273 milion lekë, të cilat referuar përshkrimit rezultojnë me keq klasifikime në llogarinë 231 Investime për aktiveve afatgjata materiale.

-Nga auditimi mbi investimet kapitale me financim të brendshëm konstatohet se janë raportuar si investime kapitale, shpenzime të kryera për aktivitetin korent të institucioneve buxhetore në **shumën 1,198 milion lekë**, të cilat duhet të ishin planifikuar dhe realizuar në zërin e shpenzimeve korente sipas klasifikimit të bërë në tabelën 4 të ligjit të buxhetit të vitit.

Përgjegjësitë e Drejtimit.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BUXHETIT NË MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Drejtimi është përgjegjës për menaxhimin e procesit të hartimit, ekzekutimit dhe raportimit buxhetor, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Ligjit nr. 88/2019 òPër buxhetin e vitit 2020, të ndryshuar, nxjerrjen dhe garantimin e zbatimit të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre, ndërkohe që theksojmë se të gjitha institucionet qendrore dhe vendore, janë përgjegjës për programimin dhe ekzekutimin e shpenzimeve për realizimin e aktivitetit të tyre dhe disiplinën financiare që garanton ligjshmërinë dhe përputhshmërinë me kuadrin ligjor buxhetor të nxjerrë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, por Drejtimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit të treguesve fiskal.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse treguesit fiskalë të raportuar nuk paraqesin anomali materiale, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi përputhshmërinë e hartimit, ekzekutimit, raportimit dhe monitorimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2020, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar.

